

ASLLAN HAMITI - AJTEN QAMILI

**DIALEKTOLOGJIA
E GJUHËS SHQIPE**

ASLLAN HAMITI – AJTEN QAMILI

**DIALEKTOLOGJIA
E GJUHËS SHQIPE**

**UIShM
Shkup, 2014**

Redaktor:

prof. dr. Avzi Mustafa

Recensues:

prof. dr. Haki Ymeri

prof. dr. Remzi Nesimi

Botues:

Unioni i Intelektualëve Shqiptarë
Në Republikën e Maqedonisë (UIShM)
Shkup, 2014

Shtypi:

Sak-Stil, Shkup

Redaktor teknik:

Kiril Taleski

Tirazhi:

300 copë

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

811.18'28

НАМИТИ, Asllan

Dialektologjia e gjuhës shqipe / Asllan Hamiti, Ajten Qamili. –

Shkup: UIShM, 2014. – 322 стр. : илустр. ; 25 цм

Библиографија: стр. 312-321

ISBN 978-608-4557-03-6

1. Qamili, Ajten [автор]

а) Албански јазик – Дијалектологија

COBISS.MK-ID 97288714

Libri u botua me ndihmën materiale të Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

KREU I

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME
- 1.1. Objekti i dialektologjisë
- 1.2. Dialektet shoqërore
- 1.3. Njësitë dialektore
- 1.4. Lidhjet e dialektologjisë me shkencat e tjera
- 1.5. Rëndësia e gjuhës dialektore dhe e dialektologjisë
- 1.6. Tiparet universale të gjuhës popullore
- 1.7. Metodatat e vjeljes së materialit dialektor
- 1.8. Mënyrat e përshkrimit të dialekteve
- 1.9. Transkriptimi dhe transliterimi
- 1.10. Udhëzues tematik i punimit të diplomës për një të folme

KREU II

2. GJEOGRAFIA GJUHËSORE
- 2.1. Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe
- 2.2. Zbatimi i gjeografisë gjuhësore edhe për mikrosistemet e shqipes dialektore
- 2.3. Regjistrime zanore të të folmeve shqipe në Internet

KREU III

3. DEGËZIMI DIALEKTOR I GJUHËS SHQIPE DHE STUDIMI I SAJ
- 3.1. Baza e përbashkët e dy dialekteve
- 3.2. Gegërishtja dhe nëndialektet e saj
- 3.3. Toskërishtja dhe nëndialektet e saj
- 3.4. Ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë në ndarjen dialektore të shqipes
- 3.5. Dialektet në rrjedhë të kohës
- 3.6. Pasqyrë e studimeve dialektore të shqipes
- 3.7. Gjendja dhe perspektiva e studimeve dialektore në Maqedoni
- 3.8. Historiku i lëvrimin të shqipes

KREU IV

4. DALLIMET DHE NGJASHMËRITË FONETIKE E FONOLOGJIKE
- 4.1. Gjatësia e zanoreve në të folmet shqipe
- 4.2. Hundorësia e zanoreve në të folmet shqipe
- 4.3. Theksi
- 4.4. Përcaktimi i inventarit të fonemave zanore të të folmeve
- 4.5. Zanoret e theksuara dhe të patheksuara
- 4.5.1. Zanorja /a/
- 4.5.2. Zanorja /e/

4.5.3. Zanorja /ë/	
4.5.4. Zanorja /o/	
4.5.5. Zanorja /y/	
4.5.6. Zanoret /i/ dhe /u/.....	
4.6. Diftongimi i fonemave /i/, /y/ dhe /u/ në të folmet e gegërishtes qendrore	
4.7. Prirja e monoftongimit të diftongjeve dytësore	
4.8. Togjet e zanoreve, diftongjet dhe diftongoidet	
4.9. Dallimet dialektore në sistemin e bashkëtingëlloreve	
4.10. Dallime ndërmjet folësve të shqipes në bazën artikulative	

KREU V

5. DALLIMET DHE NGJASHMËRITË MORFOLOGJIKE	
5.1. Ndërrimet morfonologjike në të folmet shqipe	
5.2. Emri	
5.3. Mbiemri	
5.4. Përemri	
5.5. Folja	

KREU VI

6. NGJASHMËRITË DHE DALLIMET LEKSIKORE E FRAZELOGJIKE	
6.1. Ngjashmëritë dhe dallimet leksikore	
6.2. Fjalët krahinore e dialektore dhe leksiku i shqipes standarde	
6.3. Frazelogjizmat dialektorë – pronë e shqipes letrare dhe standarde	

KREU VII

7. TIPARET GJUHËSORE TË GRUPEVE TË TË FOLMEVE	
7.1. Gegërishtja verilindore	
7.2. Gegërishtja veriperëndimore	
7.3. Gegërishtja qendrore	
7.4. Gegërishtja e Shqipërisë së Mesme	
7.5. Të folmet kalimtare	
7.6. Toskërishtja veriore	
7.7. Toskërishtja jugore	
7.7.1. Labërishtja	
7.7.2. Çamërishtja	

KREU VIII

8. TË FOLMET SHQIPE TË DIASPORËS	
8.1. Arbëreshët e Italisë	
8.1.1. Të folmet e arbëreshëve të Italisë	
8.2. Arbëreshët e Greqisë	
8.2.1. Të folmet e arbëreshëve të Greqisë	
8.3. E folmja e arbneshëve të Zarës (Dalmaci)	

8.4. E folmja shqipe e katundit Mandrica (Bullgari)	
8.5. E folmja e shqiptarëve të Ukrainës	
8.6. E folmja e kelmendasve të Peshterit	
8.7. Shqiptarët e Turqisë	

KREU IX

9. MARRËDHËNIET E DIALEKTEVE ME GJUHËN STANDARDE	
9.1. Baza dialektore e shqipes standarde	
9.2. Uniteti dhe variacioni historik, territorial, stilistik dhe shoqëror i gjuhës shqipe	
9.3. Shqipja dialektore, shqipja standarde dhe gjuha e letërsisë	

KREU X

10. ONOMASTIKA DHE DEGËT E SAJ	
10.1. Studimet onomastike shqiptare	
10.2. Toponimia dhe degët e saj	
10.3. Antroponimia dhe degët e saj	
11. Tekste dialektore	
11.1. Tekste nga të folmet e gegërishtes	
11.2. Tekste nga të folmet kalimtare	
11.3. Tekste nga të folmet e toskërishtes	
11.4. Tekste nga të folmet arbëreshe	
Literatura e konsultuar	
Skica dialektore	

PARATHËNIE

Libri “Dialektologjia e gjuhës shqipe” është tekst mësimor me karakter pedagogjik hartuar për nevojat e studentëve të Degës së gjuhës e të letërsisë shqiptare, për fakultetet e mësuesisë si dhe për të gjithë studentët e fakulteteve të tjera ku dialektologjia mund të jetë lëndë mësimore. Atë mund ta shfrytëzojnë edhe pedagogët e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar, gazetarët, njerëzit e profesioneve të tjera dhe përgjithësisht të gjithë ata që duan të sigurojnë të dhëna të përgjithshme për variantin dialektor të shqipes si dhe për marrëdhëniet e saj me variantet e tjera.

Deri më tani janë botuar tetë variante të teksteve të Dialektologjisë: pesë nga prof. Jorgji Gjinari (Tiranë, 1963, 1969, 1975, 1988, 1989); dy variante të tjera më të zgjeruara (më 1997 dhe 2000, ribotuar 2003, 2013) në bashkautorësi të prof. Jorgji Gjinarit e prof. Gjovalin Shkurtajt. Më 2012 akademik Gjovalin Shkurtajt botoi një tekst të ri të Dialektologjisë shqiptare, të emërtuar “Dialektet e shqipes, Tiparet e përbashkëta dhe dallimet dialektore, sipas hartave të ADGjSh-së, Të folmet shqipe të diasporës (shkurtoje për sistemin “Bachelor”)", 288 faqe. Dy dialektologët tanë të mirënjohur, titullarë të lëndës, hartues të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, përvojën e tyre pedagogjike, shkencore e hulumtuese e kanë shkrirë edhe në tekstet mësimore të dialektologjisë. Në të gjitha qendrat universitare shqiptare në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, po edhe në qendrat albanologjike të Evropës e në diasporë po përdoren tekstet e dy autorëve. Këto tekste sigurisht se do të vazhdojnë të përdoren edhe në të ardhmen.

Kujtojmë se botimi i këtij teksti mësimor nuk ua ulë vlerën teksteve të mëparshme, por përkundrazi do t'i vë në pah edhe më tepër vlerat e tyre dhe se edhe më tej do të mbeten të pakapërcyeshme dhe të pazëvendësueshme.

Atëherë, cila është arsyeja e botimit të një teksti të ri të dialektologjisë? Arsyet janë të shumta. E para, jemi dëshmitarë se të rinjtë tanë, për fat të keq, gjithnjë e më pak lexojnë. Për të ngjallë interesimin e studentëve për të lexuar, përgatitëm një material përmbledhës dhe krahas librit të Dialektologjisë (nga J. Gjinari e Gj. Shkurtajt) për disa vjet ua jepnim studentëve si material ndihmës.

Nga ana tjetër, tekstet e deritashme të dialektologjisë kanë karakter shkencor, ndërsa ky tekst ka karakter pedagogjik. Librin e kemi hartuar në leksione, e pas çdo leksioni kemi dhënë pyetje, detyra e ushtrime. Për të ngjallë dëshirën e kureshtjen e studentëve për të lexuar studime me karakter përgjithësues, monografi e vepra të tjera dialektore, për të konsultuar Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe, tekstet e deritashme të dialektologjisë etj., në libër kemi dhënë kopertinat e jo pak veprave si dhe udhëzime e këshilla për të lexuar materiale të postuara në Internet, për të dëgjuar emisione dokumentare, seriale televizive me aktorë visesh të ndryshme, por edhe emisione humoristike, incizime zanore nga të folmet shqipe përgatitur nga Robert Elsie etj.

Së treti, në këtë tekst mësimor, përveç temave të trajtuara në tekstet e deritashme të Dialektologjisë, kemi trajtuar edhe tema të papërfshira deri më tani, si tiparet universale të gjuhës popullore, zbatimi i gjeografisë gjuhësore edhe për mikrosistemet e shqipes dialektore, ndikimi i

faktorëve të jashtëm në degëzimin dialektor të gjuhës shqipe, gjendja dhe perspektiva e studimeve dialektore në Maqedoni, dallime ndërmjet folësve të shqipes në bazën artikulative, ndërrimet morfonologjike në të folmet shqipe, frazeologjizmat dialektorë - pronë e shqipes letrare dhe standarde; uniteti dhe variacioni historik, territorial, stilistik dhe shoqëror i gjuhës shqipe; shqipja dialektore, shqipja standarde dhe gjuha e letërsisë. Për të ndihmuar e nxitur studentët që të hartojnë një punim seminari ose diplome për një të folme (rëndom të folmen e tyre) kemi dhënë disa udhëzime themelore.

Duke parë se jo vetëm te studentët e ciklit të studimeve të shkallës së parë e të dytë, por edhe në jo pak studime dialektore të deritashme, çështja e përcaktimit të inventarit të fonemave të të folmeve, veçmas të fonemave zanore, del e vështirë e problematike; në këtë tekst mësimor-pedagogjik do të japim edhe disa udhëzime të përgjithshme për të ndihmuar studiuesit e ardhshëm që të mund të përcaktojnë më me saktësi inventarin e fonemave zanore të cilësdo të folme.

Kreun e njëmbëdhjetë të këtij teksti mësimor ia kemi kushtuar onomastikës, edhe pse nuk duhet përfshirë në lëndën e dialektologjisë. Kemi vepruar kështu për qëllime pedagogjike e praktike: t'i udhëzojmë studentët si të vjelin jo vetëm material dialektor (me leksionin metodat e vjeljes së materialit dialektor), por edhe të marrin njohuritë themelore të onomastikës dhe mbledhjes së materialit onomastik nga vendbanimet shqiptare në Maqedoni. Si pedagogë edhe deri më tani nga studentët tanë kemi kërkuar të na sjellin material dialektor e onomastik, e disa prej tyre kanë hartuar edhe punim seminari a punim diplome lidhur me materialin burimor. Konsiderojmë se puna e vjeljes së pasurisë dialektore e onomastike dhe studimi i tyre duhet vazhduar, zgjeruar e thelluar në të gjitha trojet shqiptare, veçmas në viset jashtë Shqipërisë, përfshirë edhe Maqedoninë. Këto njohuri bazë e përvojë filletare për vjeljen dhe vrojtimin e kësaj pasurie gjuhësore, ndonjë kandidat mund t'i zgjërojë në të ardhmen në studimet e shkallës së dytë e të tretë. Thjesht, synimi ynë kryesor në kursin e dialektologjisë dhe në këtë tekst është që studentët: t'i përgatisim për t'i dërguar në terren e për të mos u kthyer "duarthatë", dhe më pas, për të bërë një punë të sukseshme kërkimore e shkrimore.

Jemi të vetëdijshëm se hartimi i një teksti përgjithësues për dialektologjinë shqiptare, qoftë edhe si ky yni me karakter mësimor e didaktik, mund të hasë edhe në vërejtje e kritika. Lëshime natyrash të ndryshme e mospajtime mendimesh nga specialistët mund të kemi për arsye të shumta, si nga pamundësia që të kemi në dorë gjithë literaturën dialektore të botuar deri më tani për shqipen, nga vështirësitë e sintetizimit të pikëpamjeve e të mendimeve shpeshherë kundërthënëse të gjuhëtarëve për çështje të veçanta të shqipes, veçmas për raportet e dialekteve me gjuhën standarde, për bazën dialektore të shqipes standarde, për nevojën e rishikimit, pasurimit dhe përmirësimit të standardit apo për paprekshmërinë e tij etj.

Autorët

KREU I

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME

1.1. OBJEKTI I DIALEKTOLOGJISË

Termi *dialektologji* rrjedh nga greqishtja e vjetër *dialektos* “e folme, bisedë” dhe *logos* “shkencë, dije”. Dialektologjia është degë e gjuhësisë e cila merret me studimin e dialekteve territoriale, d.m.th. gjuhës së folur popullore. Ajo studion variantet gjeografike të një gjuhe të përbashkët. P.sh. dialektologjia shqiptare merret me studimin e larmisë dhe veçorive të përbashkëta gjuhësore të të folmeve shqipe.

Ndryshimet dialektore janë pasojë e veçimit, e mungesës së shkëmbimeve midis grupeve të ndryshme njerëzish. Populli të caktuara, kur veçohen njëra nga tjetra, pa marrëdhënie të mjaftueshme, pavarësisht se dikur mund të kenë pasur një gjuhë të përbashkët, të njësuar; fillojnë të zhvillojnë forma të ndryshme të përdorimit të të njëjtës gjuhë. Gjuha është si qenie e gjallë që zhvillohet në drejtime të ndryshme, sipas mjedisit ku jeton, sipas përdoruesve dhe rrethanave natyrore. Me fjalë të tjera, diferencimi dialektor i shqipes është rrjedhojë historike e rrethanave politike, ekonomike dhe kulturore të cilat kanë mbizotëruar në trojet shqiptare që nga periudha antike e deri në ditët e sotme.

Gjuha e një kombi megjithëse karakterizohet nga një unitet, ajo prapëseprapë ka laramani në shtrirjen gjeografike të saj. Me studimin e këtyre larmive territoriale të një gjuhe të përbashkët merret dialektologjia (Gjinari, 1970: 7). Ajo ka objektin e studimit dhe metodat e saja (vrojtimin e drejtpërdrejtë, metodën e anketës dhe gjeografinë gjuhësore).

Për arsye se qytetet shqiptare përgjithësisht janë një shumësi pikash të folmesh të ndryshme, mund të thuhet se qyteti nuk përfaqëson një pikë dialektologjike. Rrjedhimisht edhe dialektologjia shqiptare është rurale (merret me të folmet e fshatrave).


Objekt studimi i dialektologjisë shqiptare janë jo vetëm të folmet shqipe me vazhdimësi tokësore në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi, por edhe gjuha e ngulimeve shqiptare me trajtat e saj arkaike. Të folmet e shqiptarëve me punë të përkohshme jashtë atdheut, të shpërndarë anekënd botës nuk janë lëndë e dialektologjisë, sepse ato janë më të reja dhe shqiptarët, krahas gjuhës shtetërore, flasin po atë variant territorial prej nga edhe janë.

Duhet përmendur se përkatësinë dialektore të qyteteve e përcaktojnë të folmet e fshatrave përreth tij. P.sh. e folmja shqipe e qytetit të Shkupit i takon gegërishtes qendrore, sepse shumica e banorëve shqiptarë të Shkupit janë nga katundet përreth tij. Qytetet shqiptare, veçmas ato me përzierje popullatash që flasin dy e më tepër gjuhë, sigurojnë material për shqyrtimin e ndërlydhjeve midis fakteve gjuhësore dhe fakteve shoqërore (karakteri shoqëror i gjuhës) dhe me këtë studimet *sociolinguistike* të gjuhësisë së zbatuar.

Qytetet dhe vendbanimet e tjera me shumësi të folmesh të së njëjtës gjuhë apo të dy e më tepër gjuhëve të ndryshme në takim sigurojnë material të vlefshëm burimor për studime sociolinguistike. P.sh. Në Shkup, me maqedonas e shqiptarë bashkëjetojnë edhe turq, serbë, boshnjakë, romë, vllleh etj. Pothuajse të gjithë shqiptarët e Shkupit dinë edhe maqedonisht, disa mund të komunikojnë edhe në turqisht apo edhe në ndonjë gjuhë tjetër. Kjo qendër më e

rëndësishme ekonomike, politike e kulturore e Maqedonisë gjithnjë ka tërhequr njerëz visesh të ndryshme joshqiptarë e shqiptarë. Një numër i madh banorësh kanë zbritur nga katundet përreth, disa kanë ardhur edhe nga vendet e tjera të Maqedonisë, të Kosovës e të viseve të tjera. Tani më këtu kemi përzierje të folmesh të grupeve të caktuara krahinore. Kontaktet e përditshme, fqinjësia, martesat, ndikimi i shqipes standarde e i maqedonishtes kanë ndikuar në rrafshimin e veçorive gjuhësore midis folësve të Shkupit. Kjo gjë mund të vërtetohet lehtë po të krahasojmë gjuhën e një familjeje të ardhur në Shkup para 50-60 vitesh me të folmen e fshatit të tyre.


Veçanërisht dy dekadat e fundit me ndryshimet e mëdha gjeopolitike, me heqjen e perdes së hekurt të kufijve, shqiptarët kanë filluar të lëvizin lirisht në arteriet e kombit. Kjo



lëvizje shoqërohet me lëvizjen e gjuhës, e cila bashkë me përdoruesit e saj del nga enklavat territoriale për t'u ballafaquar në “tregun” gjuhësor kombëtar. Nga ana tjetër, brenda kufirit politik të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, ndryshimet politike e shoqërore janë shoqëruar me lëvizje demografike, të cilat kanë pasur si pasojë zhvendosje të popullsisve drejt qendrave urbane, kryesisht metropoleve apo edhe në hapësirën bregdetare.

Në këto kushte, konceptet “të folme”, “dialekt” etj., po humbin vlerën e tyre teorike klasike dhe gjuha shqipe, nën efektet e shoqërisë globale e të sipërmarrjes së lirë, po ballafaqohet me dukuri të reja, siç janë sociolektet apo të folme të grupimeve të ndryshme a një

lloj “përzierjeje idiolektore” etj. Në një shkrim tjetër prof. Shezai Rrokaj vë në dukje se: “Ndryshimi gjeopolitik pas viteve ‘90 krijon mundësi të reja qarkullimi të njerëzve, bashkë me ta edhe të fjalëve, të cilat dalin nga enklavat, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga kufijtë politikë. Brenda kufijve politikë lëvizja e lirë ka vënë në dyshim konceptet klasike të të folmeve dhe të dialekteve në të mirë të krijimit të sociolekteve a të një “përzierjeje të folmesh” me prurje heterogjene...” (Shezai Rrokaj, *Roli i dialekteve në zgjerimin e standardit*, në <http://www.panorama.com.al>).



Dialektologjia tradicionale shqiptare është rurale, d.m.th. ajo merret me të folmen e fshatrave. Por, kohën e fundit nga interesimi për gjeografinë gjuhësore, gjegjësisht për shtrirjen hapësinore të dukurive a të tipareve dialektore, u shtua kureshtja për larminë gjuhësore brenda qendrave të mëdha qytetare (dialektologjinë urbane).

Dialektologjia mund t’i studiojë dialektet duke përshkruar gjendjen e tyre në një etapë të dhënë të zhvillimit historik, zakonisht në gjendjen e sotme; por ajo mund të studiojë edhe zhvillimin që kanë pësuar dialektet nëpër etapa të ndryshme të historisë së tyre. Me studimin e gjendjes së sotme të të folmeve merret dialektologjia *përshkruese* (sinkronike), kurse me zhvillimin e të folmeve në rrjedhë të kohës merret dialektologjia *historike* (diakronike).



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç’është dialektologjia?
2. Pse themi se variantet gjeografike të gjuhës shqipe nuk janë gjuhë të ndryshme?
3. A kemi dallime gjuhësore ndërmjet gjeneratave: të rinjve, gjeneratës së mesme dhe të të moshuarve?
4. Çfarë ndryshimesh gjeopolitike janë bërë këto 10-15 vitet e fundit në shtetet ballkanike ku jetojnë shqiptarët. Ç’ndikim kanë këto ndryshime në gjuhën dialektore dhe në shqipen standarde?
5. Çfarë ndryshimesh shoqërore janë bërë në dhjetëvjetëshin e fundit në Maqedoni? Si shfaqen këto ndryshime në gjuhën dialektore dhe në zbatimin e normës letrare të ne?
6. Ç’rol kanë shkolla dhe mjetet e informimit publik në marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën standarde?

1.2. DIALEKTET SHOQËRORE

Gjuha, në realizimin e saj të folur, ndryshon jo vetëm sipas krahinave (andaj kemi dialektet, nëndialektet, grupet e të folmeve, të folmet vendore), por ajo ndryshon edhe sipas faktorëve shoqërorë, përkatësisht sipas:

- **moshës së folësve** (prandaj kemi gjuhë fëmijësh, gjuhë të rinjsh, gjuhë të të moshuarve);
- **gjinisë** (ligjërim grash, ligjërim burrash);
- **shkallës së arsimimit** (gjuhë e të shkolluarve, gjuhë e të pashkolluarve);
- **profesionit** të folësve (dallohët ligjërimi i mjekëve nga ligjërimi i politikanëve, i arsimtarëve nga argjendarët, ligjërimi i bujkut nga ligjërimi i gazetarit);
- **besimit fetar** përkatës (ndryshon të folurit e një ateisti nga një besimtar, i një myslimani nga një i krishterë ose një ortodoks etj.);
- Të folurit tonë ndryshon dhe përshtatet edhe sipas **vendit** (mjedisit) ku kryhet procesi i të folurit (në shtëpinë tonë apo në shtëpinë e dikujt tjetër, në zyrën tonë të punës apo në një zyrë tjetër ku aty jemi klient, në studio televizive apo në treg). Po kështu, ndryshe flasim në dasmë e ndryshe në ngushëllime për vdekjen e dikujt, ndryshe në një konferencë shkencore e ndryshe në ligjëratë me studentë.
- Duhet të themi se të folurit pëson ndryshim edhe sipas **bashkëbiseduesit**: ndryshe flet një njeri me të shoqen, me fëmijët, ndryshe me të panjohur, me njerëz të pushtetit, me personalitete që i nderon etj. Në dialektologjinë urbane a në sociolinguistikë është parë se ka një shkallëzim të pafund ndryshorësh, prandaj është e nevojshme të studiohet bashkëlidhja apo ndërëlidhja e bashkësisë shoqërore me bashkësinë gjuhësore përkatëse (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 2003, f. 47-48).


Me një fjalë, gjuha realizohet nëpërmjet ligjërimin që varet dhe kushtëzohet nga faktorë shoqërorë: **kush?, si?, kur?, ku?, kujt? dhe pse flet?**.

Pra, në çdo gjuhë, përveç larmive gjeografike gjuhësore, vërehen edhe dallime gjuhësore që lidhen me shkaqe sociale, si ato midis klasave ose shtresave të ndryshme të shoqërisë, midis profesioneve, gjinive etj. Këto variante sociale të gjuhës quhen *dialekte shoqërore* a *sociale* ose *sociolekte* (duke përfshirë argotë dhe zhargonet, me dallim që këto të fundit kanë edhe leksikun e vet). *Sociolekti mund të përkufizohet si ligjërim i një shtrese të veçantë shoqërore*. Dialektet shoqërore përdoren nga një grup i vogël njerëzish të një profesioni a të një kategorie tjetër shoqërore, si muratorë, lëkurëpunues, peshkatarë, muziktarë, nxënës, studentë etj. Dialektet shoqërore (sociale) lindin në kushte të caktuara historike nga një grup i kufizuar njerëzish për t'u marrë vesh midis tyre e të mos kuptohen nga të tjerët që nuk i përkasin grupit, prandaj ato shpesh quhen edhe të folme të fshehta. P.sh. një sociolekt që ekziston krahas dialekteve të anglishtes së ShBA, është dialekti *Black English* 'anglishtja e zezë', që rrjedh nga një pixin afrikan. Kjo në kohën e tregtisë së skllëvërve, ishte e vetmja gjuhë me anë të së cilës mund të merreshin vesh zezakët e bashkësive të ndryshme gjuhësore.



Dallimi natyror në gjininë e njerëzve pasqyrohet edhe në ligjërimin e tyre. P.sh. është vërejtur se gratë amerikane kanë një zë më të trashë se para njëqind vjetësh, që shpjegohet me pjesëmarrjen e madhe të femrës në jetën shoqërore. Dallime në ligjërim vërehen edhe në mjediset tona shkollore dhe universitare, ndonëse nuk kemi të bëjmë me sociolekt. Tipike janë shkurtesat, si *faks* për fakultet, *flm* për faleminderit, *sps* për s'ka përse, *nqs* – në qoftë se etj.

Të rinjtë struganë, varësisht nga qyteti ku kanë mbaruar studimet: në Tiranë, në Shkup, në Tetovë, në Prishtinë ose në njërin nga universitetet private në Strugë kanë krijuar edhe zhargone që dallohen nga njëri-tjetri. Deri para se të hapen universitetet në Tetovë, ata të cilët janë shkolluar në Maqedoni (Shkup, Ohër ose Manastir) në gjuhën maqedonase (këtu përjashtohen profilet gjuhë dhe letërsi shqiptare dhe ai i mësuesisë, sepse ato zhvilloheshin në gjuhën shqipe, natyrisht me disa përjashtime), pa dyshim që ata kanë qenë të ngulfatur nga



terminologjia sllave, pikërisht këtu ka qenë burimi kryesor i krijimit të kalkeve me strukturë sllave, që më pas të shoqërohet me një shqipe të cunguar e të shtrembëruar ashtu sikurse u ka konvnuar secilit individ. Ja disa të tilla: Ministria për arsim (Ministria e arsimit), *për dallim* nga ajo (në krahasim me atë), është *në pyetje* kjo punë (bëhet fjalë për këtë punë), do të flasim për këtë *pyetje* (do të flasim për këtë çështje) e shumë e shumë të tjera.

Megjithatë, në Tetovë pas hapjes së dy universiteteve ka përmirësim të dukshëm të nivelit të zbatimit të shqipes standarde për shkak të konkurrencës së madhe. Nëse krahasojmë periudhën kur popullata e Tetovës dhe e Gostivarit kryesisht merreshin me tregti (ëmbëltore) nëpër bregdetin e ish-Jugosllavisë dhe tash mund të thuhet se sllavizmat janë pakësuar bukur mirë.

Kur të rinjtë shqiptarë shkolloheshin në Prishtinë, hetoheshin elemente kosovare, gjegjësisht të gegërishtes verilindore, përdornin paskajoren (infinitivin), në vend të togut [ua], përdornin [ue] ose [u:], si p.sh. *gru*, *s'du*; përdornin dendur emra prejfoljorë në vend të foljeve të mirëfillta, si p.sh.: *do të bëjmë mbjelljen e pemëve* (në vend të: *do të mbjellim pemë*), *do të kryejmë regjistrimin e studentëve* (në vend të: *do t'i regjistrojmë studentët*), *krijoi një grup pune me qëllim mbledhjen e të dhënave dialektore* (në vend të: *krijoi një grup pune për të mbledhur të dhëna dialektore*) etj.; më shpesh përdornin formën joveprore, sesa atë veprore, si p.sh.: *ai u mund nga shokët* (në vend të: *atë e mundën shokët*); përdornin struktura analitike foljore, në vend të atyre sintetike, si p.sh.: *kjo u ka ndodh shkaku jot* (në vend të: *kjo ndodhi shkaku yt*) etj.

Tiparet gjuhësore që vërehen tek ata që janë shkolluar në Tiranë janë: shqiptimi më i butë e me më pak dridhje i dridhëses /r/, shqiptim tërësisht qiellzor i /q/ dhe /gj/, përdorim të /ë/-së së theksuar të toskërishtes veriore në vend të /e/-së theksuar, si *vënd*, *mëndje*, *mënçur*; kohën e ardhme e ndërtojnë me *do + foljen* (në vend: *do të + folja*), pastaj përdorin disa italianizma që nuk i përdor askush në Maqedoni etj.

Edhe pa krijuar argo të veçantë, njerëzit ndonjëherë përdorin ligjërim të fshehtë. Kështu, në një dasmë shqiptare një grup muzikantësh me daulle e surle duke interpretuar një valle, kur panë se valltarët nuk dinin mirë të vallëzonin, njëri muzikant i tha tjetrit: *Ramazan!*, *ramazan!*; me kuptimin bjeri daulles pa vëmendje të duhur, bjeri si për Ramazan, pa përshtatur ritmin për mënyrën e vallëzimit; siç i bihet kur njerëzit dikur zgjoheshin, jo me orë, por me të rëna

joritmike të daulles për syfyr. Në Strugë kur ndonjë dasmor porosit këngë që nuk e dinë apo nuk duan ta këndojnë muzikantët, ata mes veti thonë *të motrën*, d.m.th. të këndojnë ndonjë këngë tjetër që pak a shumë i ngjan asaj kënge.

Në fushën e profesioneve, sa më të ngushta që të jenë specialitetet, aq më të vështirë e kemi ta kuptojmë bisedën midis specialistëve të tyre, siç ndodh, për shembull, kur dëgjojmë ligjëratën e një programuesi në kompjuter, të një specialisti të fizikës bërthamore etj.

Të folmet shoqërore kanë sistem të njëjtë fonetiko-fonologjik e gramatikor me të folmen vendore, por dallohen vetëm në një pjesë të leksikut. Argotë e shqipes e kanë formuar leksikun e tyre:

a) duke u ndërruar kuptimin disa fjalëve të shqipes, përkatësisht duke u dhënë atyre kuptim metaforik (khs: *i bëshëm* = i madh, *garth* = fshat, *garth i bëshëm* = qytet, *bishto* = qen, *cfurk* = pirun, *djegje* = qepë);

b) duke i shkurtuar fjalët nga përbërja fonetike (*pazo* = pazar, *qevo* = qeveri) dhe

c) duke marrë hua fjalë nga gjuhët e tjera (greqishtja, arumanishtja, sllavishtja, turqishtja, italishtja etj., si greq. *gambres* = dhëndër, *gligora* = shpejt; arum. *gline* = pulë, *mane* = dorë; sllav. *jajca* = vezë, *mbleko* = qumësht etj.).

Deri më sot janë më të njohura tri të folme shoqërore të shqipes: dogançja e kallajxhinjve të zonës së Përmetit, purishtja e muratorëve të Oparit dhe dalipbebcja e punëtorëve mëditës belaxhinj të Shëngjergjit të Tiranës. Të folmet shoqërore nuk janë objekt studimi i dialektologjisë, por me to merret sociolinguistika.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Lexojeni mësimin me vëmendje dhe vlerësoni këto të dhëna me shenjat në tabelë (numëroni faktet shkurtimisht). Në libër nuk kemi lënë vend të mjaftueshëm për të shënuar gjërat, andaj skicojeni atë në fletore ose në kompjuter sipas modelit të dhënë:

√ E dija	- Nuk pajtohem me këto fakte	+ Sot mësova	? Dua të di më shumë për:
1.	1.	1.	1.
2.	2.	2.	2.
3.	3.	3.	3.
4.	4.	4.	4.
5.	5.	5.	5.

2. Ç`janë dialektet shoqërore a sociale?

3. A janë të folmet shoqërore objekt studimi i dialektologjisë? Arsyetoje mendimin tënd.


4. A keni vërejtur deri më tani në jetën tuaj që një grup i caktuar shoqëror të dallohet edhe gjuhësisht? Na shpjegoni këtë.
5. A kanë studentët e fakultetit tuaj ndonjë zhargon? Me se dallohet zhargoni juaj?

1.3. NJESITË DIALEKTORE

Ç'është dialekti, nëndialekti, grupi i të folmeve dhe e folmja?

Shumëgjuhësia e përhapur, nuk është aspak diçka e jashtëzakonshme në botë, gjë që një sociolinguist, që prej tryezës së tij të punës, mund ta kuptojë lehtësisht, duke u mbështetur në faktin që në botë ekzistojnë gjashtë a shtatë mijë gjuhë e dialekte, por vetëm njëqind e gjashtëdhjetë shtete sovraane. Të paktën disa prej këtyre shteteve duhet, pra, të përmbajnë një numër të madh gjuhësh dhe, me sa duket, shumë prej tyre kanë një numër të madh, me një mesatare rreth dyzet gjuhë për shtet (R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Kumanovë, 2007, f. 15).

Gjuhët janë makrosisteme të veçanta dhe të identifikueshme, të përbëra nga dialekte që mund të shpërbëhen, derisa të arrish të individit, si njësi e “dialektit më të vogël”. Pra, gjuha është një makrosistem (sistem i madh apo sistemi më i madh), dialekti është sistem i shkallës së parë, nëndialekti - sistem i shkallës së dytë; grupi i të folmeve - sistem i një shkalle të mëtejme, ndërsa e folmja - një mikrosistem që përfshin sisteme edhe më të vogla - të folmet e individëve a idiolektet.



Në gjuhësi, veçmas në dialektologji si pjesë e saj, përdoren dendur termat *dialekt*, *nëndialekt*, *grup i të folmeve* dhe *e folme*. Këto shpesh përdoren gabimisht njëra në vend të tjetrës, si p.sh. *Nga dialekti duket se është tetovar*, apo *Çdo vend ka dialektin e vet* etj., këtu është e qartë se bëhet fjalë për të folme.

Gjuha e një bashkësie kombëtare paraqitet si një strukturë e organizuar në mënyrë hierarkike. Ky organizim mund të përfytyrohet në formën e shtresave të gurëve të një piramide. Shtresën e parë të gjuhës së një bashkësie e përbëjnë *idiolektet*, d.m.th. ligjërimet e individëve të veçantë; mbi këto ngrihen *të folmet vendore*, ku futen të folmet e fshatrave, të qytezave a të qyteteve të veçanta, si p.sh. e folmja e fshatit Sllupçan, e folmja e Kumanovës, e Shkupit, e Tetovës, e Preshevës, e Gjilanit, e Matit, e Vlorës, e Gjirokastrës etj. Në një shkallë më lart vijjnë *të folmet krahinore*, si p.sh. e folmja e Karadakut të Shkupit, e folmja e Pollogut (qarku i Tetovës), e folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës, e folmja Malësisë së Madhe në Veri, e folmja e Bregdetit në Jug etj.

Të folmet krahinore përfshihen në një sistem më të madh dialektor, në një *grup të folmesh*, si p.sh. grupi i të folmes së gegërishtes qendrore, gegërishtes veriperëndimore, verilindore, labërishte, çamërishte etj. Grupet e të folmeve përfshihen në një *nëndialekt*, si p.sh.

gegërishtja veriperëndimore dhe verilindore përbëjnë nëndialektin e gegërishtes veriore, labërishtja dhe çamërishtja janë pjesë përbërëse të toskërishtes jugore etj. Nëndialektet përfshihen në *dialekte*, që janë ndarjet më të mëdha të një gjuhe. P.sh. të gjitha idiolektet, të folmet vendore, krahinore dhe nëndialektet i përkasin njërit dialekt të shqipes: gegërishtes ose toskërishtes.

Si gur i kreut i piramidës gjuhësore të një kombi shërben *gjuha standarde*, që në traditën tonë gjuhësore është quajtur gjuhë letrare. Pra, shqipja e sotme përfshin gjuhën standarde dhe dialektet, si dy nivele me shtrirje dhe funksione të ndryshme. Variantet territoriale dhe gjuha standarde përbëjnë *gjuhën kombëtare*.

Dialektet janë pjesë e gjallë e gjuhës dhe prania e tyre lidhet me larminë dhe pasurinë e ligjërimeve e të dallimeve gjuhësore sipas krahinave, porse ato, gjithmonë kanë qenë e mbeten pjesë përbërëse e gjuhës shqipe, me bazë të gjerë të përbashkët. Baza e njëjtë dhe e përbashkët e shqipes duhet mbrojtur, ruajtur e përkrahur edhe më tej, sepse përbën treguesin themelor të përbashkësisë shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve kudo që ndodhen, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në trojet e veta ballkanike dhe në diasporat arbëreshe e shqiptare kudo në botë.

Gjuha standarde shërben për dialektet si një ombrellë. Çdo gjuhë standarde mbulon dialektet e veta. Dialektet e veta i bashkon, kurse dialektet e huaja që fliten në territorin e saj, i asimilon. Në këtë funksion, shqipja standarde mbulon dialektet e veta të trojeve etnike dhe të folmet shqipe të diasporës, duke i ruajtur këto të fundit nga asimilimi (Memushaj, 2009 : 12).




Fig. 2. Variantet territoriale + gjuha standarde = gjuha kombëtare.

Gjuha shqipe kombëtare = shqipja dialektore + shqipja standarde

Dialekti është njësia më e madhe e degëzimit gjeografik të një gjuhe të përbashkët (makrosistem), ndërsa nëndialekti, grupi i të folmeve dhe e folmja janë njësi më të vogla dialektore (mikrosisteme). Dialekti, mund të përkufizohet se është një *variant territorial* i gjuhës së përbashkët që flitet në territor relativisht të gjerë dhe që ka karakteristika gjuhësore të dallueshme prej varianteve të tjera të një gjuhe, por jo të atilla sa ta bëjnë të pamundur komunikimin midis bartësve të tyre.

Pra, që një variant gjuhësor të jetë dialekt i një gjuhe, duhet:

a) së pari, të ndajë truallin e gjuhës përkatëse në dy a më tepër variante të një brumi të përbashkët;

b) së dyti, të ketë me variantet e tjera më shumë pika të përbashkëta se dallime në sistemin gjuhësor dhe,

c) së treti, përdoruesit e kësaj gjuhe duhet të kenë lidhje vëllazërie.

Kështu, dialekti Perëndimor i maqedonishtes dhe dialekti Verior i shqipes megjithëse kufizohen njëri me tjetrin, nuk janë dialekte të një gjuhe, pasi kanë sisteme gjuhësore të ndryshme dhe folësit nuk kanë lidhje birërie midis tyre. Po ashtu, ilirishtja dhe shqipja nuk mund të quhen dialekte të së njëjtës gjuhë, pasi shqipja është bijë e ilirishtes.

Nëndialekti është pjesë e dialektit ku përfshihen një grup të folmesh shumë të afërta. Dy dialektet e shqipes kanë nga dy nëndialekte. Gegërishtja ndahet në nëndialektin e gegërishtes veriore dhe në nëndialektin e gegërishtes jugore, ndërsa toskërishtja në toskërishten veriore dhe në toskërishten jugore. **Grupi i të folmeve** është pjesë e nëndialektit. **E folmja** është njësia më e imët dialektore që nuk ndahet më tej. P.sh. e folmja e një pike të banuar (e një fshati), si e folmja e fshatit Tanushë, e folmja e fshatit Zajaz si dhe e çdo katundi tjetër, ose e disa pikave (e folmja e dy e më tepër katundeve, e një qarku, krahine), si e folmja e Karshiakës, e folmja e Karadakut të Shkupit, e folmja e Tetovës me rrethinë, e folmja e Tuhinit të Kërçovës, e folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij, e folmja e Kaçanikut, e folmja e Shkodrës, të folmet e arbëreshëve të Italisë etj.

Dialekti dhe nëndialekti, si degëzime kryesore të gjuhës nuk janë diçka reale, po konstrukte mendore, koncepte të ndërtaura me anë të abstraktimit të veçorive të përbashkëta të një grupi të madh të folmesh që ndajnë një territor të përbashkët. Edhe pse themi “Ai flet toskërisht” apo “Ai flet gegërisht”, në të vërtetë asnjë jugor nuk flet një toskërishte të përgjithshme, as çamërishte të përgjithshme a labërishte të përgjithshme; po ashtu askush nga Veriu nuk flet një gegërishte të përgjithshme, as një gegërishte jugore, veriperëndimore apo verilindore. Në qoftë se nuk flasim në gjuhën standarde, si jugori edhe veriori do të flasim në të folmen e tyre, pra në një të folme të ngushtë që shtrihet në disa fshatra ose në një qytet me popullsi të papërzier (Rami Memushaj, *Standardi dhe Kostallari*, 25 nëntor 2012, në <http://www.shqiptarja.com>).

Pyetje, detyra e ushtrime:



1. Ç'është dialekti?
2. Çfarë është nëndialekti?
3. Si e përkufizoni grupin e të folmes?
4. Ç'është e folmja?
5. Ç'përbëjnë bashkërisht variantet territoriale dhe gjuha standarde?

1.4. LIDHJET E DIALEKTOLOGJISË ME SHKENCAT E TJERA

Studimi i dialekteve duhet bërë gjithnjë në lidhje të ngushtë me disiplina të shumta gjuhësore e jogjuhësore, me qëllim që të fitohet një kuadër i gjerë historik, etnologjik, ekonomik, kulturor, shoqëror dhe gjuhësor. Pa njohje të thelluar të çdo gjëje që ndodh në fusha të tjera të afërta, përparimi i studimeve dialektologjike do të ishte i pamundur.

Dialektologjia lidhet ngushtë me një varg dijesh shoqërore, si me historinë, etnografinë, folklorin, arkeologjinë etj. Të dhënat e këtyre shkencave e ndihmojnë shumë dialektologjinë për shpjegimin e disa dukurive dialektore, por nga ana tjetër edhe dialektologjia me faktet e saj ndihmon për zgjidhjen e problemeve, ngandonjëherë edhe të vështira që u dalin atyre.

Dialektologjia ka lidhje të ngushtë me të gjitha disiplinat gjuhësore, sidomos me *fonetikën e fonologjinë*, me *morfologjinë*, *sintaksën e leksikologjinë*. Për dialektologun njohja e këtyre fushave gjuhësore është e domosdoshme, ashtu siç është e dobishme njohja e shqipes truallsore për fonetikanin, morfologun, sintaksologun e leksikologun e shqipes standarde. Përshkrimi i të folmes bëhet rëndom duke paraqitur veçoritë fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të saj krahasuar me shqipen standarde. Bie fjala, pa njohjen e sistemit fonetik të shqipes standarde nuk mund të bëjmë fjalë për veçoritë fonetike të asnjë të folmeje. Për të hetuar domosdoshmërinë e përgatitjes së mirë teorike e praktike të përgjithshme gjuhësore të dialektologut, mjafton të lexoni një monografi dialektore. Për këtë do të bindeni edhe gjatë nxënies së materialit të dialektologjisë shqiptare.

Dialektologjia ka ndërlidhje të ngushtë edhe me historinë e gjuhës, sociolinguistikën, etnolinguistikën, historinë e popullit, gjeografinë, demografinë, arkeologjinë, onomastikën, folklorin, etnografinë etj. Në përshkrimet dialektore zakonisht në fillim jepen të dhëna për shtrirjen gjeografike të vendbanimit, të dhëna për popullsinë (numrin, ndarjen në fise, mëhallë, prejardhjen e tyre etj.), për historinë e vendit, kushtet shoqërore-ekonomike, shkollimin, infrastrukturën dhe shumë e shumë karakteristika të tjera që lidhen me territorin në fjalë.



Nuk ka si të shpjegohet larmia e të folmeve dhe e dialekteve e një gjuhe pa shikuar rrugën historike nëpër të cilën ka kaluar ai popull që e flet atë gjuhë me atë dialekt. Prandaj, dialektologjia dhe historia e gjuhës duhet t'i shfrytëzojnë shumë të dhënat e **historisë**. Kur studiohet e folmja e një krahine, apo edhe e një katundi të vetëm, duhet patjetër të shikohet edhe historia e asaj krahine, apo katundi, të shihet origjina, lëvizjet, marrëdhëniet ekonomike etj., sepse bartësit e të folmeve janë njerëzit dhe njerëzit kanë historinë e tyre (Gjinari, 1970 : 12).

Historia me dokumentet e saj të shkruara i jep të dhëna të rëndësishme dialektologjisë për organizimin shoqëror dhe për rrugët nëpër të cilat ka kaluar një popull gjatë historisë së tij, për ndarjet krahinore të një vendi në periudha të caktuara, për qendrat ekonomike e administrative të tyre, për marrëdhëniet e banorëve të një krahine me një tjetër, për origjinën dhe lëvizjet e tyre dhe për marrëdhëniet e një populli me popuj të tjerë fqinjë, për pushtimet e një vendi nga të huajt etj. (Gjinari, 1975 : 2).

Arkeologjia nëpërmjet gjetjeve në vendbanimet e në varrezat e lashta jep të dhëna nga periudha të hershme për të cilat mungojnë dokumentet historike të shkruara.

Fusha e **onomastikës** ofron dhe do të ofrojë brumë gjuhësor me peshë të madhe për studimin e historisë së shqiptarëve e të gjuhës shqipe, si gjuhë e njërit prej popujve më të mocëm të Ballkanit, por e dëshmuar me shkrim relativisht vonë.

Emrat e viseve dhe emrat e njerëzve paraqiten me interes jo vetëm për gjuhësinë (sidomos për dialektologjinë dhe historinë e gjuhës), po edhe për disiplina shkencore të tjera, si për arkeologjinë, historinë, etnografinë, gjeografinë, për folklorin etj. Onomastika ka me këto shkenca lidhje të ndërsjella. Emrat e vendeve dhe të njerëzve përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojnë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Në këtë vështrim, onomastika e një vendi duhet parë si një histori e pashkruar e popullit.

Leksiku onomastik varet nga veçoritë e gjuhës konkrete dhe nga veçoritë e jetës vendore të popullatës, që lidhen me kulturën, me natyrën, me klimën, me kontaktet etj.

Kur bëjmë përshkrimin e çdo të folmeje, është e udhës të japim edhe hartën e shtrirjes së saj. Dialektologjia me gjeografinë lidhen si mishi me thoin me gjeografinë gjuhësore, përkatësisht me paraqitjen në harta të dukurive dialektore (Shih: AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Napoli, 2007 dhe Vëllimi II, Napoli, 2008).

Duke qenë se historia e një populli lë gjurmë të dukshme edhe në veshjen, në orënditë, në mjetet e punës, në banesat e në zakonet e tij; dialektologjia ndihmohet shumë prej etnografisë, që studion kulturën materiale dhe shpirtërore të popullit. Shpeshherë veçoritë etnografike dhe veçoritë dialektore të një krahine përputhen midis tyre (Gjinari, 1975: 2).

Folklori dhe **etnografia** po kështu ndërlidhen me dialektologjinë. Me të drejtë konstatojnë prof. Jorgji Gjinari e Gjovalin Shkurtaj (në *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 48)., se gjuha e folklorit i intereson si folkloristit ashtu edhe gjuhëtarit, sidomos dialektologut dhe historianit të gjuhës, sepse ajo formon një farë nënsistemi në gjuhën e një populli... Gjuha e folklorit pasqyron në mënyrën më të drejtpërdrejtë dhe besnikërisht gjuhën e folur popullore... Kënga dhe çdo lloj i krijimtarisë popullore janë kurdoherë më pak spontane sesa të folurit e zakonshëm. Ato i përmbahen gjithmonë edhe një tradite që mëton të jetë, në mos kombëtare, së paku mbikrahinore.

Folklori është letërsi popullore gojore. Së këndejmi del se aty ka gjetur shprehje edhe aftësia krijuese e artistike e popullit, edhe përpjekja për të dhënë me një gjuhë sa më të goditur dhe shprehëse mendime e ndjenja, për të lënë mbresa a përshtypje sa më të gjalla në mendjen e zemrën e dëgjuesve... Kalimi gojë më gojë, nga ai që e krijon për herë të parë tek ata që e mbartin dhe e riprodhojnë atë brez pas brezi, i jep folklorit atë përpunim që mund të krahasohet vetëm me lëmimin e gurëve të lumit nga uji që rrjedh pa pushim... Epika popullore shqiptare përbën një përmendore të mrekullueshme të kulturës së gjuhës, një trashëgimi të paçmueshme në të cilën mund të verifikohen dëshmi shumë interesante të proceseve historike e dialektologjike të shqipes.


Në këngët e kreshnikëve, duke qenë ato pjesë e një stili të lartë, përdoren dendur mjetet dhe mënyrat e ndryshme të sintaksës afektive. Ndeshim aty me denduri rimarrjen a përsëritjen, paralelizmin strukturor, apostrofat, fjalitë thirrmore, fjalitë pyetëse retorike, dhanoren etike, mënyrën habitore me funksione treguese etj.

Në rrjedhë të moteve, shumë gjuhëtarë, sidomos dialektologë, kanë pasur për zemër edhe njohjen e hetimin e kulturës materiale e shpirtërore të vendeve ku regjistrin të folmen apo dialektin. Madje, ndonjëherë, ka pasur raste që dialektologë të shquar janë marrë aq thekshëm me etnografinë saqë, me kohë, kanë bërë emër edhe si etnografë të mirëfilltë. I tillë është, p.sh., rasti i zviceranit Pol Shërmajer (Paul Scheurmeier), i cili, në fillim ishte dialektolog, por u shndërrua pak nga pak në etnograf të mirëfilltë. Ai pati deklaruar se: “para se të filloja hulumtimet për Atlasin gjuhësor dhe etnografik të Italisë dhe të Zvicrës Jugore unë nuk qeshë as folklorist, as etnograf, as gjeograf; por unë u nisa linguist dhe u ktheva folklorist”. Vepra e Shërmajerit është vlerësuar si “e domosdoshme për cilindo që merret me folklor, gjuhësi, histori, gjeografi në Itali e në pjesët italiane e retoromane të Zvicrës“ (shih: Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaç, Dialektologjia, Tiranë, 1997, f. 39-56).

KRAHINA ETNOGRAFIKE. Trevë e caktuar, ku prej kohësh banonin një bashkësi njerëzish me kushte ekonomike-shoqërore të afërta dhe me mënyrë jetese të përbashkët. Si pasojë e lidhjeve të gjata, e ndikimit të ndërsjellë dhe e fateve të njëjta historike, tek banorët e kësaj treve krahas tipareve të përgjithshme etnike-kombëtare, formohen edhe tradita kulturore më të ngushta, me tipare të dalluara edhe gjuhësore. Krahinat etnografike mbajnë emra të veçantë, si p.sh.: Malësia, Luma, Shpati, Benda, Mokra, Opari, Dangëllia, Shqeria, Zagoria, Rrëza, Kelmendi, Rrafshi i Dukagjinit, Hasi, Kraja, Myzeqeja etj... Krahinat etnografike kanë karakter historik: ato lindin në kushte ekonomike-shoqërore të caktuara dhe ndryshojnë me ndërrimin e këtyre kushteve... Gjatë Mesjetës (shek. XI-XV) procesi historik i mbështetur në zhvillimin ekonomik çoi në krijimin e principatave, si principata e Arbërit a Dukagjinëve, e Kastriotëve, e Muzakajve, e Pultit, e Topiajve etj., që ndikuan në përqendrimin e krahinave më të vogla e më të lashta etnografike në njësi të reja më të mëdha.

Me gjithë pushtimin e gjatë osman, gjurmët e tyre mbetën në vetëdijen, në traditat e kulturës së popullit, përfshirë edhe gjuhën e tyre. Në shekullin XVII rigjallërimi ekonomik dhe forcimi i ndjenjës së kombësisë ndikoi në një formësim të ri të krahinave etnografike. Mbi trojet e principatës së Pultit të vjetër lindi Mirdita; në atë të Kastriotëve lindën Malet e Gegëve; mbi trojet e Muzakajve lindi Myzeqeja etj. Ndërsa, në shekullin XVIII morën trajtë më të përcaktuara dy grupe të mëdha etnografike: Gegëria dhe Toskëria, ndonëse midis tyre, sidomos në pjesët qendrore të vendit, nuk u ndërpre në asnjëherë lidhjet e përbashkëta. Gjatë shekullit XIX, me zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste e sidomos me procesin e fuqishëm të formimit të kombit shqiptar, dy njësitë e mëdha, Gegëria e Toskëria erdhën duke u afruar në mes tyre. Ndërkaq, disa veçori të lidhura me krahinat etnografike, si: veshjet, vallet, muzika, doket e traditat etj., jo vetëm studiohen nga pikëpamja historike dhe etnografike, por kanë gjithashtu interes si shfaqje të pasurisë e të larmisë së kulturës materiale e shpirtërore të Shqiptarëve, brenda njësisë së pandarë kombëtare (marrë nga Fjalori enciklopedik shqiptar 2, Tiranë, 2008, f. 1330-1331).

Nga sa u parashtrua deri tani mund të përfundohet se dialektologjinë e ndihmojnë mjaft shkenca, por edhe dialektologjia u ndihmon shkencave të tjera. Të dhënat e dialektologjisë kanë rëndësi të madhe në radhë të parë për



njohjen dhe shpjegimin e historisë së gjuhës të një populli ose të gjuhëve të disa popujve të afërt nga pikëpamja e origjinës, pastaj për njohjen e rrugëve të formimit të gjuhës letrare.

Për studimin e historisë së gjuhës të dhënat e dialektologjisë kanë vlerë të dorës së parë, ato janë burim i rëndësishëm, sepse nëpër dialekte edhe sot e kësaj dite ruhen gjurmë të fazave të hershme dhe të etapave të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar gjuha e një populli gjatë zhvillimit të saj. Kjo duhet thënë jo vetëm për gjuhët që janë dokumentuar vënë në shkrim, por edhe për ato që kanë dokumente të hershme shkrimi. Në dialektet ruhet mirë gjuha e gjallë e folur. Aty gjejmë tingujt e gjuhës me timbret e nuancat e ndryshme të tyre, gjejmë forma gramatikore e ndërtime sintaksore me gjithë pasurinë leksikore të gjuhës, që, për arsye të ndryshme, kurrsesi nuk mund të pasqyrohen të gjitha në shkrim (Gjinari, 1975 : 2-3).

Me studime ndërdisiplinore gjuhësore, etnografike, folklorike shqiptare janë marrë jo vetëm studiues të huaj, por edhe shqiptarë. Shquhen për vrojtime të tilla prof. Eqrem Çabej, Maksimilian Lamerci, Agnia Desnickaja, Vilfrid Fidleri, Zihni Sako, Qemal Haxhihasani, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Gjovalin Shkurtaç etj.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Pse është e nevojshme që dialektologu të ketë njohuri solide nga fonetika, morfologjia e leksikologjia?
2. Me cilat disiplina shkencore ka lidhje të ngushtë dialektologjia dhe pse?
3. Si e shpjegoni lidhjen e dialektologjisë me historinë e gjuhës?
4. Çlidhje ka dialektologjia me gjeografinë?
5. Çfarë ndërlidhje ka dialektologjia me onomastikën?
6. Thoni disa elemente ndërlidhëse të dialektologjisë me folklorin dhe etnografinë.
7. Shënojeni një këngë popullore burimore të vendit dhe bëni analizën gjuhësore të saj.
8. Tekstin e dhënë dialektor (nga e folmja e një fshati të Karadakut të Shkupit) shndërrojeni në shqipe standarde:

Po jo be / se shtëi nuk ka dimën / përpåra ishin dimnat / mos vet // Ani mã / kur ishim n'Bre:z / ku-ku: sa kemi he'k n'dimën / kaniher si zike di mu:j para Vitit Ri ene mã kur dilke n'Shinxherxh // Skamja e mãdhe / masåne: kishmi xhå ushim kishmi pak / kur u çoshmi n'saba vdo^ura e zike derën // Shka me bâ: / u dashke me mãrr kacåien e me çel udhën / barem deri te kroi sa me mu:sh u:j //

Idåre s'kishmi / nuk kishmi me mãrr harxh/ çu mos me pås gajle për ni mu:j a di // Napër çat vdo^r u dashke me mãrr kålin e mu nis / e me shku: a mos pe nrro^ujm doni kampir / a me shåit e me mãrr doni harxh // Menzi shkojshmi me niçin gazëpe napër at ftoft e napër at vdo^r ene apët ishte zor mej shåit / he t'i håje gjålli // Ene kur i shëitshmi / shka me mãrr me to / s'un mirshmi harxh as për trë-kåtër dit / a gjith at rê udhe çu e hëcshmi // Kur u ktheshmi / shka m'u kthåi / n'pe'k t'na^otës t'lodht / t'lagjt virån / se mo kåmt nuk i mirrshmi vësh a jan to^unat // Valla kur u çoshmi t'nësrit n'saba / krejt vuxhuti na dhe:mke //

S'u bãshin tre-kåtër dit apët u dashke me shku: / mora me shku / se disshin callt ûni / ene masane: shlu Zoti ka virånllåiki be / bãjshmi kallablle'k call // Ene nuk e di shka bãjshmi / jo me prå ushîmin e xhåve atëi ñat dikun / po e lishmi çagje ku e kosëitshmi ene prët e bãj dimnit

masane: / mëitu napër vdo^{ur} // As drû nuk bájshmi házer/ a çatêi maj shpêi i kishmi // O: ene për mën kemi hek be përpara // A shtëi / ju krejt punt i keni me kollâille^k ene apet kanu //

1.5. RËNDËSIA E GJUHËS DIALEKTORE DHE E DIALEKTOLOGJISË

Gjuha e ruajtur në gojën e popullit është një enciklopedi e gjithë jetës së popullit tonë. Thëniet e gdhendura të kanuneve, krijimtaria gojore popullore janë shfaqje e mirëfilltë e përpunimit stilistik të shqipes.

Gjuha jeton përmes dialekteve, që janë limfa e jetës së saj. Kjo e vërtetë megjithatë shpesh harrohet dhe dialektet shihen si një shfaqje „historike“ dhe e tepërt, që njeriut modern nuk i duhet. Sidomos në kohën tonë të globalizimit dhe masmediave, dialektet shumëkund janë në tkurrje dhe shuarje të plotë. Në rast se, në globin tonë çdo dy javë shuhet një gjuhë, sikundër e nxirrte një studim amerikan i para disa muajve, dialektet ndoshta mund të treten dita-ditës. E prapëseprapë askush nuk mund të thotë se ka rënë kambana e dialekteve ose të folmeve të veçanta dhe se njeriu modern nuk do t'i rikthehet edhe në këtë pikë asaj çka i kanë lënë trashëgim shekujt.

Me sa duket është një tharm i fortë që s'ka për të vdekur asnjëherë. Aq më shumë kur njerëzit ta kuptojnë dalëngadalë se përdorimi i një dialekti nuk tregon as prapambetje e as injorancë, por mbart jetë dhe ngrohtësi njerëzore si shumë pak tjetër gjë e kësaj bote (Ardian Klosi).

Njohja dhe studimi i imët i dialekteve janë themelore për të gjitha studimet gjuhësore: për fonetikën e fonologjinë, për morfologjinë, për sintaksën, historinë e gjuhës dhe, pa dyshim për semasiologjinë, leksikologjinë dhe frazeologjinë e gjuhës.

Dialektet dhe të folmet e gjalla përbëjnë dëshmi të rëndësishme, që kanë peshë apo vlerë të krahasueshme me vlerën që kanë bimët për botanistin, objektet dhe veshjet (kostumet) popullore për etnografin, si këngët e vallet për folkloristin, si dokumentet arkivore e kronikat e drejtpërdrejta për historianin. Të dhënat e dialekteve janë të rëndësishme sepse në to na jepet një pamje autentike e të folmeve apo e dialekteve nëpërmjet të folurit të rrjedhshëm e të gjallë, ashtu siç rron në gojën e njerëzve të rëndomtë, pa ndonjë përpunim e tëhollim libror.

Dijetari i shquar frëng Charl Nodie para më se 150 vjetësh ka thënë se *“ai njeri që nuk ka hulumtuar me kujdes dialektet dhe të folmet e gjuhës së vet, nuk njeh as gjysmën e saj”*, e kjo thënie mbetet edhe sot një aksiomë. Na duket me vlerë të kujtojmë thënien e Rusëlo-së se dialektet dhe të folmet e një vendi në krahasim me gjuhën letrare meritojnë të njëjtën përparësi të gjuhëtarit siç meritojnë *“parapëlqimin e botanistit bimët dhe lulet e fushës në krahasim me lulet e lulishteve tona”* (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, ShBLU, Tiranë, 1997, f. 11-16).

Dialektet dhe të folmet e një gjuhe pasqyrojnë të kaluarën e njerëzimit në përgjithësi e të një bashkësie shoqërore në veçanti. Për këtë arsye studiuesit kanë vënë re se njohja e larmive gjeografike gjuhësore sjellin përfitime jo vetëm për filologjinë, por edhe për shkencat e tjera. Është më se e nevojshme të bëhet studimi sistematik i gjuhës dialektore, sepse ajo rrezikohet të zhduket.

Dihet se krijimi i standardit të një gjuhe, si mjet komunikimi mbarëkombëtar, nuk përjashton ekzistencën e dialekteve. Ato vijojnë jetën e tyre duke pësuar ndryshime në përshtatje me vetë zhvillimin e krahinës ku fliten dhe në marrëdhënie me standardin. Rastet e gjuhëve të mëdha të Evropës, si anglishtes, frëngjishtes, italishtes etj., që kanë krijuar standardin e tyre prej disa shekujsh duke ruajtur edhe dialektet, janë një shembull i qartë për këtë. E njëjta gjë mund të thuhet për gjuhën shqipe, e cila, ndryshe nga gjuhët e mësipërme, ka një standard të ri, të krijuar prej jo më shumë se një gjysmë shekulli, por dialektet e saj gjëllijnë duke hyrë në marrëdhënie të ndërsjella me të: nga njëra anë, standardi ushtron ndikimin e vet mbi dialektet duke futur elemente të modernizimit të gjuhës, fjalë të reja që lidhen me mënyrën e re të jetesës dhe ndryshimet e mëdha ekonomike e shoqërore; nga ana tjetër, dialektet derdhin vazhdimisht pasurinë e tyre leksikore e frazeologjike në gjuhën standarde. Për këtë arsye çdo nënvleftësim i fuqisë krijuese të dialekteve sjell dobësim e varfërim jo vetëm të dialektit por edhe të vetë standardit.

Gjuha popullore, që jeton përmes dialekteve, është ajo që i jep jetë e gjallëri standardit, që e freskon dhe e njom, e përtërin, dhe e këndell, duke e mbrojtur nga shterpësia e thatësira dhe nga krijimet me gjedhe të huaja. Sidomos standardi i shqipes, që është i ri, ka nevojë për pasurinë e dialekteve, për krijimet popullore, që mund të gjenden në të folmet e popullit. Nëse e përbashkëta e krijuar, gjuha standarde, shkëputet nga baza e vet prej së cilës ka dalë, ajo rrezikon të shterpëzohet e të dobësohet, duke u ushqyer jo më me gjakun e vet, por me gjak të huaj (Kolec Topalli, Dialektet dhe standardi në kushtet e globalizmit, në <http://www.voal-online.ch>).

Thesari gjuhësor i të folmeve, sidomos fondi i pasur leksikor dhe frazeologjik, paraqet burim të pashtershëm për pasurimin e gjuhës standarde shqipe. Njohuritë dialektologjike kanë rëndësi të madhe edhe për arsimitarin e gjuhës e të letërsisë, sepse prej tij kërkohet jo vetëm që të jetë për nxënësit model i korrektesisë së përdorimit të gjuhës standarde shqipe, por edhe të mënjanojë nga nxënësit veçoritë e të folmes vendore. Mësuesi duhet të njohë të folmen e asaj qendre ku punon e jeton. Dialektologjia shërben shumë për të dalluar dialektizmat që ka përdorur një shkrimtar në gjuhën e vet dhe në gjuhën e personazheve për individualizimin e gjuhës së tyre.

Gjuhëtari frëng Antuan Meje (Antoine Meillet) ka thënë: “*nuk ka histori gjuhe pa dialektologji dhe sidomos pa gjeografinë gjuhësore complete dhe të zbatuar mirë*”. Gegërishtja e toskërishtja janë dy “miniera” kryesore për të kuptuar të kaluarën e të tashmen e gjuhës shqipe. Varietetet truallsore të shqipes sigurojnë dëshmi gjuhësore për të parë jo vetëm zhvillimin e brendshëm të shqipes në rrjedhë të kohës, por edhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera në takim, veçmas me latinishten, greqishten, gjuhët sllave, turqishten, arumanishten etj. Shqipja e folur (por edhe e shkruar) na jep fakte me vlera unike për rindërtimin e gjuhës mëmë indoevropiane. Ajo ende ruan shumë tipare të moçme të leksikut, të fonologjisë, të morfologjisë dhe të sintaksës indoevropiane (shih: Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986; ose Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa I dhe II)*, Prishtinë, 1980).



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Ç'ëndësi ka shqipja dialektore?
2. Çfarë rëndësie ka dialektologjia?
3. Si mund të pasurohet leksiku i shqipes standarde?
4. A ka ndonjë fjalë e të folmes tënde që mund të bëhet pjesë e leksikut të shqipes standarde? Thoni ato fjalë. Pse mund të bëhen pronë e përgjithshme kombëtare?
5. A ka nevojë që shqipja standarde të pasurohet nga dialektet në fushën e fonetikës e të gramatikës (morfologjisë e sintaksës)? Arsyetoje mendimin tënd.
6. Çfarë ka thënë gjuhëtari frëng Antuan Meje. Shpjegoje më gjerësisht këtë pohim.
7. Komentojeni thënien e Rusëlo-së.
8. Ç'ëndësi ka dialektologjia për mësimdhënësit e gjuhës shqipe?
9. Çfarë ka thënë dijetari i shquar frëng Charl Nodie për rëndësinë e njohjes së dialekteve dhe të të folmeve të gjuhës amtare?

1.6. TIPARET UNIVERSALE TË GJUHËS POPULLORE

Pothuaj se të gjithë popujt kanë gjuhën dialektore (popullore) dhe gjuhën standarde (letrare). Edhe pse gjuha popullore dhe gjuha standarde shqipe kanë shumë afri, ato megjithatë dallohen njëra nga tjetra. Gjuha me të cilën komunikojnë shtresat e gjera popullore në jetën e përditshme quhet gjuhë popullore.

Gjuha dialektore është krijuar nga paraardhësit tanë (populli ynë), është bartur brez pas brezi në rrjedhë të kohës dhe sot e kësaj dite ne e mësojmë atë që nga fëmijëria. Gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë. Një ndërhyrje e tillë, e quajtur “standardizim” prodhon një gjuhë standarde, aty ku më parë kishte vetëm “dialekte” (pra variante jostandarde).

Disa tipare të gjuhës popullore kanë karakter të përgjithshëm, universal për të gjitha gjuhët e botës. Tipare më të rëndësishme të gjuhës dialektore janë:

1. Rëndom, gjuha standarde ka formë të shkruar dhe të folur, ndërsa gjuha popullore njih vetëm formën e folur. Gjuhën dialektore e flasin masa e gjerë popullore, ndërkaq në gjuhën standarde flasin të shkolluarit.
2. Një dallim tjetër me rëndësi është shtrirja dhe funksioni i tyre: gjuha dialektore flitet në një territor më të vogël e të kufizuar, ndërsa gjuha standarde ka shtrirje mbi tërë truallin ku flitet ajo gjuhë, d.m.th. ka përdorim gjithëkombëtar.
3. Në gjuhën popullore, kuptimi i thënies (bisedës) përveç fjalëve, ka si mjet sqarimi dhe saktësimi vetë rrethanat në të cilat kryhet biseda, gjë që i jep rëndësi të madhe sidomos intonacionit dhe mënyrës së shqiptimit.
4. Folësit përdorin dendur edhe gjestet e mimikën, me anën e të cilave theksohet, përcaktohet ose kompletrohet mendimi, ndjenja, ideja e shprehur me fjalë.

5. Ritmi i të folurit në bisedën e zakonshme është pak a shumë i shpejtuar, intonacioni mëshon mbi ndjenjat e folësit, spikat dhe bëhet shprehës e përçues i mendimit të kumtuar.
6. Shqiptimi, në përputhje me ritmin e tij disi të shpejtuar, ka edhe shmangie, përngjashmime (asimilime) e rënie tingujsh: *s'un shkoj* < *s'mund të shkoj*, *shpi* < *shtëpi*, *fni* < *fëmijë*, *shtir* < *vështirë*, *shtëllungë* < *shllung*; *tung*, *tungjat* < *tungjatjeta* etj. Në këtë kategori hyjnë edhe shkurtimet e zvogëlimit dhe të përkëdhelisë, si: *kusho* < *kushëri*, *bush* < *babush*, *loke* < *nënëloke*; si dhe fjalë të tjera për zbunim (përkëdhelje, ledhatim, llastim): *nipçe*, *bablok*, *vëllaçko*, *babagjysh* etj; trajta të dyta zbuuese të emrave vetjakë: *Braho* < *Ibrahim*, *Is* < *Ismail*, *Islam*, *Hysen*; *Demo* < *Demush* etj.
7. Ndërtimi i ligjëratës a i bisedës në të folurit popullor bëhet me fraza a fjali të shkurtra, të përshtatshme për vetë natyrën e zhdërvjellët të bisedës: *Shkova n'pazar*. *Bleva ni k'mi:sh*. *Atje e pash Islamin*. *Ju bani t'fala...* Përdorim të dendur kanë fjalitë e paplota: *Mbylle!* a *Mshile!* (*Mbylle gojën, mos fol!*).
8. Gjuha e folur popullore merr shpesh trajtën e dialogut dhe kërkon kontakt të afërt midis bashkëfolësve. Edhe pse nuk shprehen gjymtyrët kryesore të fjalisë, ato kuptohen nga konteksti ose nga situata. Forma pyetje-përgjigje bën që shumë herë thënia të jetë vetëm prej një fjale, pa strukturë të plotë të fjalisë a periudhës. P.sh.: *Sa vjet i ke?* – *Njizet*. *I kujt je?* – *I Bardhylit*; ose me fjali të pagjymtyrëzueshme, si: *A po vjen?* – *Po*.
9. Më të pëlqyera janë periudhat me bashkërenditje, prandaj edhe lidhëzat kryesore aty janë: *e, edhe, por, veç, mirëpo*.
10. Në gjuhën e folur popullore përdoren dendur fjalët (përemrat, ndajfoljet dhe pjesëzat) pyetëse: *kush?*, *cili?*, *sa?*; *ku?*, *kur?*, *pse?*, *si?*, *qysh?*; *a? mos?* etj.
11. Përdoret shumë dendur shkalla krahasore dhe sipërore e ndajfoljeve: *shumë mirë, fort mirë, shumë keq, më mirë, më keq, bukur shumë, bukur mirë ...*
12. E tashmja e dëftores shpesh shpreh kuptimin e së ardhmes, sidomos të një të ardhmeje të afërt: *po vij nesër* “do të vij nesër”, *sonte bie shi me siguri* “do të bjerë shi”, *ai niset nesër* “ai do të niset nesër”.
13. E kryera e thjeshtë përdoret dendur me kuptimin e së tashmes: *erdha* “po vij”, *ta lidha, ta zdrita* “po ta lidhi, po ta zdriti (një pëllëmbë, shuplakë); *ta solla* “po ta sjell”.
14. Shumë të dendura në gjuhën popullore janë fjalët modale *ndoshta, mund, kushedi, sigurisht, bën vaki*, si dhe lidhëza e pasthirrma të ndryshme: *medet, vajmedet, mjerë, mazallah* etj.
15. Në gjuhën e folur popullore janë karakteristike fjalët e prejardhura me kuptime e vlera afektive (prekëse, tronditëse, mallëngjyese), që nuk përdoren në gjuhën e shkruar, si *zezoj* “nxij, bëj të zezë”, *pusoj* “bëj pus, prish diçka”.
16. Shpesh fjalë të zakonshme vishen me kuptime të dyta figurative, si *peshk* “trup të drejtë e të formuar mirë”; *dem, bik, thi* “i majmë, i trashë”, *gisht* “i dobët, thatanik” etj.
17. Në gjuhën popullore janë karakteristike frazeologjizmat krahasuese, si: *zi si korbi, bardh si bora, i kuq si gjaku, shkojnë si macja me miun, vuan si gjarpri nën gur, rri si macja ndër sofër* etj.

18. Të dendur janë edhe togfjalëshat e qëndrueshëm të ndërtuar mbi bazën e metonimisë (< gr. metonimia = zëvendësim emrash, përdorimi i një fjale a i një shprehjeje në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, duke u mbështetur në afrinë që kanë sendet e dukuritë; figurë letrare e ndërtuar në këtë mënyrë) a të metaforës (< gr. metafora = bartje, përdorimi i një fjale a i një shprehjeje me kuptim të figurshëm në bazë të krahasimit sipas ngjashmërisë). P.sh. *qafë mali, këmbë ure, grykë shisheje*.
19. Gjithashtu, të dendura janë hiperbola (< gr. tejkalim, teprim, zmadhim i tepërt, stërmadhim) dhe litota (< gr. thjeshtësim, figurë stilistike me të cilën shprehja e vërtetë zëvendësohet me shprehje tjetër më të dobët dhe të kundërt). P.sh. *plasa, e tmerrshme, vdiqa për bukë, u çmenda së studiuar, të kam thënë njëqind herë; më jep një pikë ujë, mora nja dy kokrra rrushi, hëngra një gojë bukë* etj.
20. Shumë të pëlqyera janë ironia (< gr. përqeshje, tallje; figurë stilistike me anën e së cilës përqeshet a vihet në lojë dikush a diçka) dhe antifraza (< gr. anti+frazis = kundër+të folur, figurë stilistike me anën e së cilës kuptimi i dëshiruar shprehet me fjalë të kundërta. Pra, për tjetër flitet e tjetër gjë kuptohet): *Mirë, shumë mirë paske bërë!* “shumë keq”. *Po na nderon!* “po na turpëron”. *Kështu të ka hije, vetëm vazhdo!* “hiq dorë nga kjo udhë, kuptoje se je gabim” (Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f. 104-106).



Pyetje, detyra, ushtrime:

1. Çfarë e dallon gjuhën popullore (dialektore) nga gjuha standarde? Përgjigjen jepe edhe mbi bazën e njohurive të fituara nga mësimet (leksionet) e mëparshme.
2. Krahaso shqipen dialektore dhe shqipen standarde sipas shtrirjes territoriale, funksionit dhe kodifikimit.
3. Plotësojeni tabelën në vijim:

përdoren më shpesh:	<i>në ligjërimin popullor</i>	<i>në ligjërimin letrar</i>	<i>Pse?</i>
gjestet dhe mimikat	Po / Jo	Po / Jo	
dialogu (bashkëbisedimi)	po / jo	po / jo	
frazeologjizmat	po / jo	po / jo	
fjalitë e periudhat e shkurtra	po / jo	po / jo	
fjalë me rënie tingujsh	po / jo	po / jo	
ironia dhe hiperbola	po / jo	po / jo	


4. A hetohen variante territoriale në përdorimin e shqipes standarde? Si zbatohet norma letrare në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni në mjetet e informimit publik? Jep shembuj.

1.7. METODAT E VJELJES SË MATERIALIT DIALEKTOR

Për t'u studiuar dialektet e një gjuhe, së pari duhet vjelë material dialektor. Proceset që nevojiten për këtë hulumtim (studim) janë dy:

1. *procesi i vjeljes së materialit dialektor të gjuhës së gjallë* dhe
2. *procesi i studimit të dialekteve*.

Materiali dialektor është materiali bazë, pa të cilën nuk mund të bëhet studimi i dialekteve. Ky material mbledhet në terren drejtpërdrejt nga gjuha e gjallë *nga gjuhëtarët* ose *përmes anketimit* të popullatës nga jospécialistë për këtë punë.



Metoda e drejtpërdrejtë e kërkimit të materialit dialektor bëhet nga specialistë (gjuhëtarë) të përgatitur enkas për këtë punë, duke vjelë materialin në terren.

Para se gjuhëtari të shkojë në terren, duhet të bëjë disa parapërgatitje: të mbledhë të dhëna për historinë e vendit ku do të shkojë, duhet të njihet me veçoritë etnografike, kulturore, ekonomike, zejtarinë, klimën, arsimimin, pozitën gjeografike etj. dhe me gjuhën e asaj të folmeje dhe të të folmeve përreth përmes studimeve të ndryshme për atë vend, nga folklori apo nga burime të tjera.

Pastaj kur specialisti shkon në vendin e vrojtimit, i zgjeron dhe kompletton këto të dhëna. Mëson më shumë për historinë e këtij vendi, për marrëdhëniet farefisnore dhe ekonomike që ka pasur e ka vendi përkatës me vendbanimet përreth, cilat vendbanime e rrethojnë këtë vend, sa


larg është qyteti më i afërt, ç'rrugë kalojnë nëpër këtë vend apo pranë tij, çfarë institucionesh, monumentesh, greminash etj. ka në këtë vend, si është niveli arsimor i popullatës, sa është i pranishëm emigrimi, sa është e zhvilluar tregtia e këtij vendi etj.

Për vjeljen e materialit dialektor mund të na ndihmojnë pyetësorët ekzistues. Por, mbledhësi mund të plotësojë e të përshtat pyetësorin sipas qëllimit të hulumtimit, veçorive dalluese të të folmes përkatëse etj. Një pyetësor të vlefshëm ka përpiluar Spiro Floqi, Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe, botuar në Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 371-447. Në faqet e fundit të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, vëllimi I, si shtojcë është dhënë edhe Pyetësori (për fonetikë, morfologji, sintaksë dhe leksik) hartuar nga Jorgji Gjiniari, Gjovalin Shkurtaj dhe Xheladin Gosturani që është përdorur për të siguruar material gjuhësor për Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe (shih: Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, vëllimi I, Napoli, f. 437-464).

Varësisht nga qëllimi që i ka vënë përpara vetes specialisti, përcakton kohëzgjatjen e qëndrimit në terren dhe numrin, moshën apo gjininë e të anketuarve. Megjithatë, për një studim të përgjithshëm, mjafton që specialisti të qëndrojë 4-5 ditë në terren dhe të anketojë 5-6 banorë.

Parapëlqehet që gjuhëtari nga secili informator të mbledhë gjithë materialin gjuhësor të atij rrethi, me qëllim që materiali i çdo informatori të jetë i krahasueshëm me materialin e informatorit tjetër. Siç dihet, shpesh ndodh që informatorët të kenë veçori individuale shqiptimore dhe kështu gjuhëtari mund të arrijë në përfundime të gabueshme.

Të anketuarit duhet të jenë nga brezi i vjetër, të jenë sa më pak të arsimuar, të shumtat të jenë të gjinisë femërore, sepse ato më rrallë kanë lëvizur nga fshati apo krahina e tyre dhe, natyrisht, duke mos pasur kontakt me të folmet e tjera, më mirë e kanë ruajtur të folmen e tyre në gjendjen e saj të ruajtur. Gjithashtu duhet që këto informatore të jenë të lindura e të martuara në këtë vend, pra të mos jenë të ardhura nga ndonjë fshat apo krahinë tjetër. Kusht tjetër është që informatorët të mos kenë të meta me aparatit e të folurit, sepse mund të vilen të dhëna të gabuara shqiptimore.



Nëse qëllimi i studimit është e folmja në dinamikën e zhvillimit të sotëm të saj, atëherë informatorët duhet të jenë nga breza të ndryshëm (nga brezi i vjetër, i mesëm dhe i ri).

Më mirë do të ishte që në terren të shkojnë dy apo tre gjuhëtarë, që të mund t'i ndajnë detyrat: përderisa njëri bisedon me informatorin, tjetri të mbajë shënime, tjetri të incizojë. Veç asaj, të shkuarit në terren 2-3 vetë ka edhe një të mirë tjetër: se specialistët mund të konsultohen mes veti, ta rikujtojnë apo ndihmojnë njëri-tjetrin.

Ditën e parë në terren mbledhësi nuk duhet të mbajë shënime, por të dëgjojë, me qëllim që të përftojë një pasqyrë të përgjithshme për të folmen apo ta ushtrojë veshin me atë të folme, megjithatë mund t'i incizojë bisedat. Informatorët duhet të pyeten një nga një dhe jo nga dy-tre informatorë njëkohësisht. Do të jetë më mirë që t'i shkohet në shtëpi secilit informator, sepse aty ndihen nikoqirë, ndjehen më mirë dhe mund të flasin më lirshëm e më gjatë.

Shënimet për secilin informator duhet të bëhen veçmas dhe që në fillim të shkruhet emri, mbiemri, mosha, shkalla e arsimimit, vendbanimi, njeh apo jo gjuhë të huaja, a ka lëvizur për një kohë të gjatë jashtë vendbanimit si dhe ndonjë shënim tjetër me vlerë që mund të na shërbejnë për të shpjeguar faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë që eventualisht do të shfaqen në idiolektin e informatorit.

Velja e materialit duhet bërë përmes bisedës së lirë, rrëfimeve e përjetimeve të ndryshme, përrallave, ngjarjeve historike, legjendave, bisedës rreth veprimtarisë së vendit etj.; pastaj duke parashtruar pyetje me qëllim që të mund të përfshihen më shumë dukuri që i interesojnë gjuhëtarit. Por, duhet pasur kujdes që pyetjet të jenë të tërthorta, sepse, po të jenë të drejtpërdrejta, informatori mund të përgjigjet me po ato fjalë që do t'i parashtrohet pyetja. Është mirë që edhe gjuhëtari të flasë në gjuhën popullore të vendit dhe jo në variantin standard, sepse edhe kjo mund të ndikojë që informatori të ndihet inferior e të mundohet që edhe ai të flasë më “mirë” ose siç thuhet shpesh “me gramatikë”. Po ashtu, informatori nuk ka nevojë ta dijë qëllimin e vjelësit, sepse edhe ky fakt mund të ndikojë që informatori të flasë ndryshe nga ajo e zakonshme. Me fjalë të tjera, gjithë puna e specialistit duhet bërë për të arritur synimin kryesor: materiali i vjelë të jetë autentik, ta paraqesë me besnikëri të folmen.

Përveç bisedave dhe pyetjeve të lira, vjelësi mund të shfrytëzojë edhe pyetësin, paraprakisht të përgatitur për këtë qëllim, që të mund ta kompletojë tërë materialin gjuhësor. Megjithatë, dialektologu gjithmonë duhet pasur parasysh që informatorin të mos e bezdisë e ta lodhë, sepse mund të dështojë bashkëpunimi me të.

Materialin e vjelë specialisti duhet ta rishikojë në mbrëmje, që ta dijë se çka i mungon e të mos ndodh që të largohet nga terreni pa e vjelë tërë materialin gjuhësor.

Pasi të përfundojë vjeljen e materialit dialektor, dialektologu kthehet në vendin e punës, ku e analizon, e përpunon dhe e klasifikon materialin që e ka vjelë në dukuri të veçanta. Nëse kanë qenë 2 apo 3 vjelës, atëherë duhet që përpunimi të bëhet bashkërisht, duke i grumbulluar shënimet dhe incizimet e secilit.

Metoda e anketimit mund të kryhet nga njerëz që nuk janë specialistë. Atyre u dërgohen pyetësorë të përgatitur nga specialistë dhe ata vetëm u përgjigjen pyetjeve sipas të folmes së atij vendi. Materiali i mbledhur në këtë mënyrë mund të mos jetë edhe aq i sigurt, sepse ai që i plotëson pyetësorët mund të jetë vendës e nuk mund t'i vërejë disa veçori të të folmes së vet, të cilat i duken të zakonshme. Gjithashtu mund të ndikohet nga parashtrimi i pyetjeve në gjuhë standarde (drejtshkrimi) dhe transkriptimin mund të mos e bëjë në formën e duhur.

Gabimet që mund të përvidhen nga kjo metodë, duhet të kontrollohen e korrigojnë nga dialektologu dhe nxirren statistikat e përgjithshme për të folmen në shqyrtim.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Si vilet materialin dialektor me metodën e vrojtimit (vëzhgimit) të drejtpërdrejtë?
2. Si vilet materialin dialektor nëpërmjet anketës?

5. Ndahuni në grupe nga 4-5 veta dhe duke e imagjinuar veten se jeni duke shkuar të vilni material dialektor. Përshkruani në hollësi të gjitha hapat e këtij hulumtimi, duke filluar që nga përgatitja, ndarja e përgjegjësive, nisja, arritja, vjelja.
6. Aktroni në mësojtore. Tre veta le të luajnë rolin e vjelësve (njëri e mban bisedën me informatorin, i dyti regjistron (shënon) bisedën, ndërsa i treti incizon), ndërsa i katërti luan rolin e informatorit dialektor.
7. Studentët të ndahen në tri grupe të barabarta. Grupi i parë le të vjelë material dialektor në fushën e fonetikës e të fonologjisë, grupi i dytë: në fushën e morfologjisë, grupi i tretë: në fushën e leksikut. Secili grup të përpunojë materialin e vjelë dhe të hartojë me shkrim nga një skicë dialektore. Rezultatet e hulumtimit tuaj prezantoni në klasë.
8. Hartoni një pyetësor (anketë) të përshtatshëm për të vjelë materialin dialektor të të folmes tënde.
9. Bashkë me mësimdhënësin organizoni dhe bëni një ekspeditë për vjeljen e materialit dialektor.

1.8. MËNYRAT E PËRSHKRIMIT TË DIALEKTEVE

Pas vjeljes së materialit dialektor dhe përpunimit të tij, duhet shkruar një punim për të, për ta realizuar studimin dialektor plotësisht. Pra, mbi bazën e materialit të vjelë, duhet bërë përshkrimin e të folmes, duhet hartuar e mbarështuar me shkrim një punim dialektor. Në përshkrimet e të folmeve shqipe gjejmë: a) monografi, b) punime të tipit të mesëm dhe c) skica dialektore.

Monografia është studim i gjerë e i hollësishëm shkencor, që trajton një çështje a një temë të veçantë. Monografi shkruhen jo vetëm në përshkrimin e të folmeve (në gjuhësi), por edhe në të gjitha fushat e tjera të veprimtarisë njerëzore, si p.sh. monografi për vende, shtete, periudha e ngjarje historike, shkrimtarë, artistë, sportistë, qytete, bimë ... Shkroi (botoi) një monografi për të folmen e Preshevës, të folmen e Durrësit, të folmen e Korçës, të folmen e Arbëreshëve të Italisë ...

Përshkrimi i dialekteve me anë të monografive është gjetur si më i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për etapën e parë të ngritjes së dialektologjisë së një gjuhe. Zakonisht, parapëlqehet që monografia të jetë e plotë dhe e gjithanshme. Kërkesa për të dhënë karakteristikën e plotë të sistemit të një të folmeje është relative, sepse ajo mund të bëhet duke karakterizuar strukturën e së folmes si sistem vetëm me veçoritë dalluese bazë apo të jetë më i hollësishëm, duke u zgjeruar dhe thelluar proporcionalisht në trajtimin e të gjithë përbërësve të strukturës së gjuhës.

Skica dialektore është përshkrim i shkurtër i të folmes, ku paraqiten tiparet kryesore të një të folmeje. Skica dialektore mund të hartojnë edhe studentët në punimet e seminareve ose në punimet e diplomës.

Për të kuptuar më mirë se ç'kuptim ka fjala skicë, po japim shpjegimin e Fjalorit elektronik shpjegues: skicë *f. sh.* “1. vizatim që paraqet vetëm vijat kryesore të diçkaje dhe që mund të plotësohet më pas. Skicë me laps. Skicë nga natyra. Skicë sipas kujtesës. Bëri një skicë. 2. Vizatimi me pak vija i një vepre artistike, i një ndërtimi, i një makine etj., që përmban të dhënat e nevojshme për përgatitjen e plotë të tyre. Skicat e tablosë. Skicat e dekorit (e skenës). Skica e fabrikës. Skicat për kostumet e shfaqjes. Skica e një detali. Përgatit skicat. E bëri sipas skicës. 3. Plani paraprak i një vepre letrare në vijat kryesore. Skica e romanit (e dramës, e tregimit). 4. let. Përshkrim i shkurtër faktesh e ngjarjesh, të jetuara a të para drejtpërdrejt nga autori, që paraqiten me një stil të thjeshtë e të rrjedhshëm, zakonisht në shtypin periodik. Skicë letrare.”


Tipi i mesëm i përshkrimit të të folmeve, si për nga hollësia e trajtimit të dukurive gjuhësore, ashtu edhe për nga numri i faqeve të punimit, gjendet në mes të monografisë dhe skicës dialektore. Po të shihni me kujdes literaturën e shfrytëzuar, të dhënë në fund të librit, do të mund të lexoni jo pak autorë e tituj monografish, punime të tipit të mesëm si dhe skica dialektore.

Në përshkrimin e të folmeve dhe dialekteve, përveç monografisë, tipit të mesëm dhe skicës dialektore bëhen edhe: ç) studime përshkruese të përgjithshme të gjithë dialekteve të një gjuhe, d) studime krahasimtare, dh) fjalorë krahinorë, e) harta dialektore, f) atlasë dialektorë etj.

Përshkrimi i përgjithshëm i dialekteve të një gjuhe është mënyra më e përgjithësuar dhe më e përciptë e përshkrimit të veçorive gjuhësore të të folmeve, sepse aty pasqyrohen vetëm karakteristikat më tipike dhe që paraqiten te 60% i të folmeve të atij grupi të folmesh apo nëndialekti. Dhe gjithsesi ky lloj përshkrimi duhet mbështetur në monografitë, punimet e tipit të mesëm apo skicat e shumta që ekzistojnë për të gjitha të folmet. Zakonisht ndodh që të mos ketë monografi për çdo të folme, atëherë merren tiparet dalluese më tipike që përsëriten te shumica e të folmeve të një qarku apo zone të caktuar. Një përshkrim të përgjithshëm të dialekteve ka bërë dialektologu i njohur shqiptar Jorgji Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989. Në të vërtetë, synimi kryesor i të gjitha teksteve mësimore të dialektologjisë është të japin në mënyrë të përmbledhur të folmet e dialektet e shqipes. Deri më sot janë botuar një varg tekstesh të tilla: Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Prishtinë, 1970; Tiranë, 1975, 1998 e më pas në bashkautorësi me prof. Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, 2000, ribotuar edhe më pas. Një përshkrim të përgjithshëm të dialekteve mëtojmë të bëjmë edhe ne në këtë tekst mësimor.

Objekt studimi i studimeve përshkruese mund të jetë vetëm njëra sferë e gjuhës, p.sh.: fonetika, morfologjia, leksiku apo edhe vetëm një pjesë e sistemit të këtyre disiplinave, p.sh. vetëm sistemi foljor, emëror, vetëm një sferë e leksikut etj.

Nëse një studim dialektologjik ka për qëllim zbulimin e dinamikës së zhvillimit apo ndryshimit të një të folmeje, atëherë duhet pasqyruar tiparet dalluese nga brezat e ndryshëm të folësve dhe mund të përshkruhen vetëm dukuri të caktuara të asaj të folmeje ose e gjithë struktura gjuhësore.



Studimet krahasimtare mund të pasqyrojnë dallimet e një të folmeje kundrejt gjuhës letrare apo një dialekti kundrejt një dialekti tjetër, një grupi të folmesh kundrejt një grupi tjetër të folmesh, gjendjes së sotme dialektore kundrejt gjendjes më të vjetër të saj etj.

Në **fjalorët krahinorë** (glosarët) jepen fjalët që janë tipike për një krahinë apo dialekt. Në fjalorët e tillë në të shumtën e rasteve shënohen fjalë shqipe e joshqipe që nuk i gjejmë në të folmet e tjera, që përdoren me kuptim tjetër, që kanë përbërje fonematike të dallueshme nga të folmet e krahinave të tjera.

Hartat dialektore paraqesin ndarjet dialektore të një territori të caktuar ku shtrihet një gjuhë e caktuar.

Atlasi dialektor është mënyra e hartografimit të fenomeneve gjuhësore dialektore. Në çdo hartë të atlasit pasqyrohet dhe trajtohet një tipar gjuhësor me dallimet territoriale. Atlasi mund të jetë gjuhësor dhe etnografik.

Rezultatet përfundimtare të studimeve dialektore të një gjuhe pasqyrohen në atlasët gjuhësorë, që tregojnë me harta shtrirjen e një dukurie gjuhësore ose të një njësie leksikore. Vijat që bashkojnë pikat e truallit ku shfaqet e njëjta dukuri fonetike e fonologjike, gramatikore ose njësi leksikore, quhen *izoglosa*. Nga përcaktimi i këtyre izoglosave arrihet në një përfundim më të saktë për ndarjen dialektore të një gjuhe. Për disa gjuhë, atlasë të tillë janë botuar që në shek. XIX. Edhe për shqipen nga dialektologët e Institutit të Gjuhësisë është hartuar *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* dhe është botuar në dy vëllime: vëllimi I Napoli, 2007 dhe vëllimi II, Napoli, Itali, 2008.

Me anë të gjeografisë gjuhësore janë paraqitur dukuritë fonetike e fonologjike, morfologjike, sintaksore e leksikore veç e veç nëpër harta gjeografike. Me këtë është arritur të hartografohet shtrirja territoriale e çdo dukurie gjuhësore, përkatësisht izoglosa e tyre. Hartat e një atlasit dialektor kanë për gjuhëtarin atë rëndësi e vlerë që kanë hartat fizike për gjeografin.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Ç'janë monografia dialektore, tipi i mesëm dhe skica dialektore?
2. Lexojeni një monografi dialektore, një studim të tipit të mesëm dhe një skicë dialektore. Shkruaj nga një recension për çdonjërin prej tyre.

1.9. TRANSKRIPTIMI DHE TRANSLITERIMI

Fjala *trans* e latinishtes përdoret shumë shpesh si parashtesë në kuptimin *kaloj, zhvendos, bart, shndërroj* etj. për të formuar fjalë me parashtesim: *trans - tej*, si *transferoj – mbart*, *shpie nga një vend në një vend tjetër*, *transportim – mbartje e mallrave dhe e njerëzve me mjete transportuese*, *transplantoj – mbjell*, *shartoj diçka në një vend tjetër*; *transoqeanik – tejoqeanik*, *transit – kalim, kapërcim, kalim nëpër një vend pa u ndalur gjatë*; *transformoj - shndërroj etj.*)

Termi *transkriptim* rrjedh nga latinishtja *transcriptio* që ka kuptimin *përshkrim*. Pra, me transkriptim kuptojmë shënimin e tingujve të të folurit me të gjitha dallimet e hollësishtme të shqiptimit, duke përdorur disa shenja të veçanta. *Transliterim-i* (lat. transliteratio) është shqipëruar me fjalën *tejskronjëzim*. Në Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja (Mikel Ndreca, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 706) folja *transliteroj* (lat. trans – tej + littera – shkronjë) shpjegohet si: shkruaj një tekst duke zëvendësuar shkronjat e një alfabeti me shkronjat e alfabetit tjetër.

Termet transkriptim e transliterim shpeshherë përdoren për të shprehur të njëjtin kuptim. Në *Fjalorin elektronik shpjegues të gjuhës shqipe* fjala **transkriptoj** kal. është shpjeguar kështu: 1. *gjuh.* Kthej në shkrimin e sotëm një tekst të shkruar me shkronja e me shenja që ndryshojnë nga sistemi i sotëm i shkrimit. Transkripto i “Mesharin” e Gjon Buzukut. Transkriptoj një tekst (një dorëshkrim). 2. *gjuh.* Shënoj tingujt e të folurit me të gjitha dallimet e holla të shqiptimit, duke përdorur disa shenja të veçanta. Sidoqoftë, parapëlqejmë që termi transkriptim të përdoret kur formën e folur të ligjëritit e shkruajmë me përpikëri, ndërsa transliterimi kur një tekst i shkruar rishkruhet me alfabet tjetër.

Shkronjat janë shenja grafike që përfaqësojnë fonemat e gjuhës. Shkrimi *fonemor* përdoret për të dhënë jo gjithë nuancat fonetike të gjuhës së folur, por vetëm përbërjen fonemore të fjalëve. Në të vërtetë, për të shkruar shqipen standarde përdorim pikërisht këtë shkrim fonematik, sipas parimit një fonemë një shkronjë (njëshe apo dyshe): 36 shkronja për të shkruar 36 fonemat e shqipes (me pak përjashtime).

Me shkrimin fonemor nuk mund të regjistrojmë të folurit në mënyrë të përpiktë. Në mënyrë më besnike të folurit paraqitet me anë të transkriptimit, përkatësisht me përdorimin e disa shenjave plotësuese (diakritike) që vihen mbi, nën ose anash shkronjave të rëndomta si dhe me përdorimin e disa shkronjave të veçanta për tingujt që nuk i ka gjuha standarde.

Transkriptimi (që quhet edhe shkrim fonetik) është një sistem i veçantë shenjash grafike që përdoret për të dhënë shqiptimin e saktë të fjalëve ose të teksteve të tëra. Transkriptimin e përdorin fonetikanët dhe dialektologët për përshkrimin e sistemeve fonetike të gjuhëve apo të dialekteve; e përdorin edhe hartuesit e fjalorëve për të dhënë shqiptimin e fjalëve, p.sh. në fjalorët e anglishtes, frëngjishtes etj. Shenjat e transkriptimit synojnë të japin deri hollësitë e shqiptimit të tingujve dhe për këtë qëllim përdoren si shkronjat e alfabetit, ashtu edhe shenja diakritike që vihen poshtë, lart ose pas shkronjave të alfabetit të zakonshëm.

Ka sisteme të ndryshme shenjash transkriptimi, por më i njohuri është *Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar* (angl. IPA = I(nternacional) P(honetic A(lphabet), i cili ka karakter universal.

Transliterimi është një lloj tjetër shkrimi që shërben për të dhënë me alfabetin e një gjuhe një tekst të shkruar me një alfabet të ndryshëm. Teksti i gjuhës së panjohur jepet fjalë për fjalë dhe shkronjë për shkronjë me shkronjat e alfabetit të njohur, me qëllim që të ndihmohet lexuesi që nuk e di atë gjuhë, t’i lexojë fjalët e saj. P.sh., emrat e përveçëm të shkruar me alfabetin grek ose me alfabet cirilik jepen me alfabetin latin (Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, f. 17):

	<i>origjinali</i>	<i>transliterimi</i>
<i>rusisht</i>	Архангельск	Arhangelsk
<i>maqedonisht</i>	Станислав	Stanisllav

Transliterimi përdoret edhe kur del nevoja e leximit të teksteve të shkruara me një alfabet të vjetër që nuk përdoret më. Kështu, librat e autorëve tanë të vjetër, që janë me alfabete të ndryshme nga ky i sotmi, janë transliteruar dhe transkriptuar për t'u bërë të lexueshëm sot. P.sh., "Mesharin" e Buzukut, që nuk mund të lexohet në origjinal për shkak të tipit të shkronjave që janë përdorur, gjuhëtari Eqrem Çabej e ka transliteruar dhe transkriptuar këtë vepër të rëndësishme.

Në studimet dialektore si dhe në tekstet e dialektologjisë deri më tani janë përdorur sisteme të ndryshme transkriptimi. Që nga shkrimet e vjetra shqipe e deri vonë zanoret e gjata shkruheshin me dyzimin e tyre ose me një vizë lart: si *vllaa* ose *vllā*, *njerii* a *njerī*, *deet* a *dēt* ... Në shkrimet e sotme mbizotëron transkriptimi fonetik, si më poshtë:

Transkriptimi i shkronjave të shqipes me Alfabetin Fonetik Ndërkombëtar:

alfabeti i shqipes	a	b	c	ç	d	dh	e	ë	f	g	gj	h	i	j	k	l	ll	m
<i>transkriptimi</i>	a	b	ts	tʃ	d	ð	ɛ	ə	f	g	ʝ	h	i	j	k	l	ɫ	m

alfabeti i shqipes	n	nj	o	p	q	r	rr	s	sh	t	th	u	v	x	xh	y	z	zh
<i>transkriptimi</i>	n	ɲ	ɔ	p	c	r	r	s	ʃ	t	θ	u	v	dʒ	dʒ	y	z	ʒ


Siç mund të shihet edhe nga paraqitja tabelore e mësipërme, Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar për bazë ka alfabetin latin të plotësuar edhe me disa shkronja të alfabeve të tjera.

Përveç fonemave zanore e bashkëtingëllore që ka shqipja standarde, në të folmet shqipe dëgjohen edhe disa zanore e bashkëtingëllore të tjera si dhe alofone të ndryshme. Për të fituar idenë se si shqiptohen zanoret që i ka apo nuk i ka shqipja standarde e që i kanë disa të folme shqipe, do të paraqesim zonën e nyjetimit të tyre në trapezin akustik:

Po japim edhe disa shenja të tjera që përdoren në shkrimet dialektore:

- η - bashkëtingëllore mbylltore, prapagjuhore, sonante, hundore (p.sh. ngat > ηat)
- [] – kllapa katrore për të shënuar tingujt (p.sh. tingulli [a])
- // - kllapa të pjerrëta për të shënuar fonemat (p.sh. fonema /p/)
- <> - shenjë konvencionale për të shënuar shkronjat (p.sh. shkronja <t>)
- ~ - kundërvënie fonologjike midis dy gjymtyrëve të kundërvënies (p.sh. /a/ ~ /e/: dash ~ desh)
- [...] – forma shqiptimore e fjalës (p.sh. shkruhet: <pedagogia>, lexohet [pedagog-ja])
- > - forma në të majtë kalon fonetikusht në formën në të djathtë (p.sh. shtëpi > shpi)
- < - forma në të djathtë kalon fonetikusht në formën në të majtë (p.sh. rryp < rrip)
- / - shënon një ndërprerje të shkurtër në të folurit (presjen), si (p.sh. Agroni/ shoku im ...)
- // - shënon një pushim të gjatë, të ngjashëm me pikën (p.sh. Unë jam student//)

Zanoret			Shenja diakritike	
i		u	ˇ = zanore e shkurtër	→ ă , si <i>kăm</i> “kam”
	y		: = zanore e gjatë	→ a:, si <i>pla:k</i> “plakë”
	ø		. = zanore e mesme	→ a., si <i>plaki</i> “plaku”
e	ə	o	˜ = zanore hundore	→ ã, si <i>nã:n</i> “nënë”
	æ	a	ı̇ = gjysmëzanore	→ ı̇, si <i>ai</i> “ai”
			˘ = diftong	→ âi, si <i>shpâi</i> “shtëpi”
			í = zanore e theksuar	→ lírí
			ì = zanore me theks dytësor	→ lírídâshës
ə = ë		→ nənə		“nënë”
ø = y e hapur		→ vø		“ve, vezë”
æ = a e përparme, më e mbyllur		→ præp		“prapë”



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Ç'kuptoni me transkriptim dhe me transliterim?
2. Transliteroni emrat vetjakë a mbiemrat e shqiptarëve me alfabetin cirilik:

me alfabetin latin	me alfabetin cirilik	me alfabetin latin	me alfabetin cirilik
Muharrem		Dhimitër	
Rrezarta		Thaç	
Ylber		Shpresë	
Yll		Shkëndijë	
Përparim		Syart	
Shkëlqim		Kryezi	

3. Transliterojeni fragmentin e dhënë të Fjalorit trigjuhësh: maqedonisht – shqip – turqisht (Beograd, 1875) të Gjorgji Pulevskit me alfabetin e shqipes së sotme:

Кувенд

Машум гјуха, тадијм, н аште нкадухет, препас вет њерји нка мате наљти, њерте мате унђет, арада, циљи пошкон наана теветуи, нде моти сотис, кијо, камѠа, еде нде либерти парас.

Ћетер екам кувендова, сиподухет, шум мот, њертафортоим, еде гјуха те нонас тонте, татњофим, еде тат мсоим, ајо подухет, препас вет, табароим, псе ашту пас менд, шиндоши, кркоје, пор пастаи, еде њетер гјуха, пасте духет, ветис, тамсоим.

4. Një i/e moshuar le të tregojë ngadalë një përrallë, tregim apo anekdotë në formën e vet dialektore. Shënojeni atë duke përdorur shenjat e transkriptimit.

1.10. UDHËZUES TEMATIK I PUNIMIT TË DIPLOMËS PËR NJË TË FOLME

Pasi të kemi grumbulluar e shfrytëzuar gjithë literaturën që na siguron të dhëna të mjaftueshme gjeografike, historike, ekonomike, kulturore e gjuhësore të vendbanimit dhe pasi kemi vjelë material dialektor nga e folmja me metodën e vrojtimit të drejtpërdrejtë dhe me metodën e anketës, nis faza e hartimit të punimit përshkrues për të folmen në fjalë. Në qoftë se qëllimi ynë është të përshkruajmë gjendjen e sotme të të folmes në rrafshin fonetik e fonologjik, morfologjik e leksikor, punimi duhet mbarështruar në fusha, tema e nëntema të veçanta. Për të drejtuar punën tuaj në hartimin e një punimi seminari ose punimi diplome, po japim një udhëzues tematik. Ky udhëzues mund të shërbejë edhe si orientim tematik për hartimin e skicës dialektore, punimit të tipit të mesëm apo edhe të monografisë për ndonjë të folme të caktuar:

Parathënie: objekti i vëzhgimit, qëllimi i punës, metoda, vështirësitë dhe problemet gjatë punës, motivi, falënderimet etj.

1. HYRJE

1.1. Të dhëna gjeografike, historike, ekonomike dhe kulturore të vendbanimit:

1.1.1. Pozita gjeografike e vendbanimit, infrastruktura

1.1.2. E kaluara e vendbanimit

1.1.3. Popullsia

1.1.4. Veprimtaria e tyre gjatë historisë dhe tani

1.1.5. Arsimiti i banorëve

1.1.6. Veçori të tjera të rëndësishme (etimologjia e emrit të vendbanimit, mikrotoponimia, antroponimia, mëhallët, legjendë a rrëfim që lidhet me fshatin apo rajonin)

1.1.7. Gjendja e studimeve të deritashme dialektologjike për të folmen

1.1.8. Metoda e punës, vështirësitë dhe problemet gjatë punës sonë

2. TIPARET FONETIKE E FONOLOGJIKE

2.1. SISTEMI I ZANOREVE

- 2.1.1. Gjatësia e zanoreve
- 2.1.2. Hundorësia e zanoreve
- 2.1.3. Theksi në të folmen
- 2.1.4. Inventari i fonemave zanore
- 2.1.5. Përndarja e fonemave zanore
- 2.1.6. Togjet e zanoreve dhe diftongjet

2.2. SISTEMI I BASHKËTINGËLLOREVE

- 2.2.1. Inventari i fonemave bashkëtingëllore
- 2.2.2. Përndarje e fonemave bashkëtingëllore
- 2.2.3. Togjet e bashkëtingëlloreve

2.3. DUKURITË FONETIKE TË TË FOLMES

- 2.3.1. Përngjashmimi dhe shpërngjashmimi
- 2.3.2. Rënia dhe shtimi i tingujve
- 2.3.3. Shkrija e tingujve, metateza, haplologjia etj.

3. DUKURITË MORFONOLOGJIKE

- 3.1. Qiellzorizimi i fonemave
- 3.2. Metafonia
- 3.3. Apofonia
- 3.4. Dukuri të tjera morfonologjike

4. VEÇORITË MORFOLOGJIKE

4.1. SISTEMI EMËROR

- 4.1.1. Gjinia e emrit (mashkullore, femërore dhe asnjane)
- 4.1.2. Shquarsia e emrave (trajta e pashquar dhe e shquar e emrave)
- 4.1.3. Numri i emrit (shumësi i emrave të gjinisë mashkullore, shumësi i emrave të gjinisë femërore)
- 4.1.4. Lakimi i emrave (në njëjës e në shumës) dhe funksioni i tyre. Ndarja e emrave në lakime.

- 4.2.1. Mbiemrat
- 4.2.2. Numërorët
- 4.2.3. Përemrat

4.3. SISTEMI FOLJOR

- 4.3.1. Mënyrat dhe kohët e foljes
- 4.3.2. Mënyra dëftore (koha e tashme, koha e pakryer, e kryera e thjeshtë, koha e kryer, më se e kryera, koha e ardhme)
- 4.3.3. Mënyra lidhore (koha e tashme, koha e pakryer, e kryera dhe më se e kryera)
- 4.3.4. Mënyra habitore
- 4.3.5. Mënyra dëshirore
- 4.3.6. Mënyra urdhërore
- 4.3.7. Mënyra kushtore
- 4.3.8. Format e pashtjelluara (pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja)

4.4. PJESËT E PANDRYSHUESHME

- 4.4.1. Ndajfoljet
- 4.4.2. Parafjalët
- 4.4.3. Pjesëzat
- 4.4.4. Lidhëzat
- 4.4.5. Pashirrat

5. FJALËFORMIMI

- 5.1. Formimi i fjalëve me parashtesim
- 5.2. Formimi i fjalëve me prapashtesim
- 5.3. Fjalëformimi me parashtesim e prapashtesim njëherazi
- 5.4. Fjalët e përbëra
- 5.5. Fjalët e përngjitura

6. LEKSIKU

- 6.1. Fjalët anase dhe fjalët e huaja
- 6.2. Huazimet orientale (turke)
- 6.3. Huazimet sllave
- 6.4. Huazime nga gjuhët e tjera
- 6.5. Barbarizmat
- 6.6. Përshtatja fonetike e morfologjike e huazimeve
- 6.7. Ndikimi i gjuhëve të huaja në gramatikën e të folmes
- 6.8. Fjalorth i fjalëve tipike të të folmes
- Vendi i të folmes në strukturën dialektore të shqipes
- Përmyllje (në shqip) dhe rezyme (në anglisht)
- Harta e skica dialektore që lidhen me të folmen përkatëse
- Tekste autentike të të folmes në fjalë
- Literatura e shfrytëzuar.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Përpunojeni materialin e vjelë dialektor. Hartoni një skicë dialektore (për të folmen tuaj ose për ndonjë të folme tjetër).
2. Lexoni një monografi dialektore. Shkruani një recension për të.

KREU II


2. GJEOGRAFIA GJUHËSORE

Më parë dialekti është konsideruar si njësi gjuhësore gjeografikisht e mbyllur me kufij të prerë me përpikëri. Por, aty nga fundi i shekullit XIX u vërtetua se njësitë dialektore (dialektet, nëndialektet, grupet e të folmeve) nuk kanë unitet gjuhësor të mbyllur, me kufij gjeografikë të prerë, por ka dukuri gjuhësore me shtrirje territoriale të veçantë që shpeshherë nuk përfshijnë gjithë dialektin ose kapërcejnë kufijtë e përgjithshëm dialektorë. P.sh. gegërishtja ka fonema zanore të gjata, por edhe të folmet më jugore shqipe, pra të folmet e Çamërisë kanë zanore të gjata. Të folmet e gegërishtes kanë zanore hundore, por disa prej tyre, si e folmja e Dibrës, e Ulqinit, e Preshevës etj. nuk kanë zanore të tilla. Në të folmet e veriut tipike është paskajorja gege (me punue), ndërsa të folmet e jugut kanë lidhoren (të punoj) ose pjesoren toske (për të punuar). Shumica e të folmeve e gegërishtes qendrore (si e folmja e Shkupit, Tetovës, Gostivarit etj.) përdorin paralelisht dy format foljore: paskajoren gege (me punue) dhe lidhoren (të punoj).

Gjeografia gjuhësore është degë e gjuhësisë që studion shtrirjen në hapësirë dhe përndarjen e dukurive gjuhësore të përbashkëta në varietete të ndryshme të një dialekti ose të dialekteve të ndryshme të një gjuhe, apo edhe të një grupi gjuhësh të një familjeje. Materialet gjuhësore të mbledhura në pika të caktuara paraqiten në harta gjuhësore dhe në këtë mënyrë përftohet një pamje e menjëhershme e arealeve gjeografike. Pra, nëpërmjet gjeografisë gjuhësore bëhet hartografimi i dukurive të veçuara (fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore). Këto areale në gjeografinë gjuhësore quhen *izoglosa* (nga greqishtja *iso* – “e njëjtë, e barabartë, unike” dhe *glossa* – “gjuhë, e folme”). Pra, vijat që përcaktojnë kufijtë e shtrirjes territoriale të një dukurie gjuhësore quhen izoglosa.

Gjeografia gjuhësore (linguistike) filloi të zhvillohet nga fundi i shekullit XIX, së pari në Gjermani e më pas në Francë. Në vitin 1876 dijetari gjerman Gustav Venker (Gustav Wenker) i hyri punës për mbledhjen e materialit dialektor për hartimin e atlasit gjeografik të gjermanishtes. Për këtë ai përpiloi dhe shpërndau një pyetësor që përmbante 335 fjalë të përfshira në 40 fraza të formuluar në gjermanishten standarde dhe ua shpërndau mësuesve të vendeve të ndryshme që t'i “përkthenin” nga gjuha letrare në të folmen lokale.

Atlasi i Venkerit u vlerësua nga kritika e kohës si një punë tepër e ngadalshme: për 20 vjet ai botoi vetëm gjashtë harta dhe se nuk pasqyronte realitetin e të folmeve gjermane. Pas



vdekjes së Venkerit (më 1911) puna vazhdoi nga bashkëpunëtorët e tij me në krye Vrede-nin. Një pjesë e këtyre hartave u botua më vonë, më 1926.

Pak më vonë se në Gjermani, gjeografia gjuhësore filloi të zhvillohet edhe në Francë nga dijetari Jul Zhileron (Gillieron), i quajtur edhe “babai i gjeografisë gjuhësore”. Më 1897 nisi anketën në terren Edmond Edmondi për Atlasin gjuhësor të Francës dhe Mateo Bartoli për dalmatishten. Ndryshe nga materiali i mbledhur me metodën e anketës në Gjermani, në Francë materiali u mbledh në mënyrë të drejtpërdrejtë në terren nga Edmond Edmondi, bashkëpunëtori i Zhileronit. Zhileroni hartoi një pyetësor me nja 2000 fjalë e shprehje, për t’u përgjigjur e përshtatur në të folmet vendore. Projektin e mbështeti fuqishëm ministri i Arsimit, Gaston Parisi. Materiali u vol në 550 pika (vendbanime) për katër vjet (1897-1901) dhe u regjistruan një milion përgjigje. Atlasi gjuhësor i Francës (Atlasi linguistik i Francës, shkurt: ALF) përmban 1920 harta fjalësh me rend alfabetik të botuara në tri seri. Gjeografia gjuhësore përjetoi zhvillim të hovshëm sidomos pas botimit të ALF-së.

Pas atlasëve gjuhësorë të gjermanishtes e të frëngjishtes, u botuan edhe atlasë gjuhësorë të shumë gjuhëve të tjera, si atlas i italishtes, i rumunishtes, i rusishtes, i bullgarishtes, i maqedonishtes, i shqipes etj. Në këtë drejtim, vlen të përmendim se më 1903 Gerlin de Ger (Guerlin de Guer) botoi *Atlasin dialektor të Normandisë*, i cili është një atlas fonetik. Më 1909 Gustav Vajgandi botoi *Atlasin gjuhësor të dakorumanishtes*, më 1938 Sever Bopi botoi *Atlasin e vogël gjuhësor rumun etj*.

Atlasi gjuhësor i Evropës (Atlante linguistico d’Europa, shkurt: ALE). - Për herë të parë një sprovë për të paraqitur në një atlas të gjitha gjuhët e Evropës e bëri gjuhëtari italian Bernardo Biondeli (1804 - 1886). Më 1841 ai botoi veprën “*Atlante linguistico d’Europa*”. Ideja e një atlasit gjuhësor të përmasave të mëdha, që të përfshinte gjuhët e Evropës, sado të ndryshme midis tyre, do të mbetej në fuqi edhe më vonë. Në vitet ‘30-60 të shekullit XIX mund të përmendet puna e disa studiuesve me famë, me qendër në viset skandinave, si A. Vajnen (Weijnen) e A. Hagen të cilët mendonin për një *Atlas ndërgjuhësor krahasues* (Interlingual comparativ atlas, shkurt ICA), që do të mbështetej në të dhëna të atlasëve të veçantë kombëtarë. Roman Jakobsoni përkrahu këtë ide dhe madje hartoi një pyetësor të posaçëm, por projekti mbeti i porealizuar për shkak të Luftës së Dytë Botërore.



Disa vjet më vonë, ideja e një atlasit gjuhësor evropian u rimor disa herë. Në këtë drejtim, më 1965 u mbajt Kongresi Ndërkombëtar i Dialektologjisë së Përgjithshme në Marburg, gjatë të cilit, Mario Alinei propozoi të themelohej grupi për hartimin e një *Atlasit gjuhësor evropian*, që duhej të trajtonte zhvillimin e fonemave indoevropiane.

Në vitet '70-80 do të kalohej në një realizim konkret e me një ekip shkencor ndërkombëtar të përbërë nga ajka e dialektologëve të Evropës për të hartuar **Atlasin e gjuhëve të Evropës** (Atlas linguarum Europae, shkurt ALE), me qendër në Nimegen (Suedi) e të drejtuar nga A. Vajnen. ALE-ja synon të paraqesë pikëtakimet (kontaktet) e gjuhëve të kontinentit evropian dhe jep mundësi të vëzhgohet e të zgjerohet fusha e krahasimit shumëgjuhësh. Mëtimi themelor i ALE-së është paraqitja e materialeve të krahasueshme të gjuhëve të afërta ose jo të afërta, duke e bërë këtë në të gjitha fushat gjuhësore: në fonetikë, fonologji, morfologji, sintaksë dhe në leksikologji, semantikë e në frazeologji. Në këtë veper **është përfshirë edhe gjuha shqipe**, kryesisht me materiale të mbledhura me anketa të drejtpërdrejta brenda Shqipërisë si dhe në një numër pikash për të folmet e diasporës arbëreshe. Anketimet në terren në dhjetë pika brenda Shqipërisë si dhe përpunimi i fishave të ALE-së janë bërë nga ekipi i dialektologëve shqiptarë në përbërje: Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaj, Minella Totoni dhe Xheladin Gosturani (Shih: J. Gjinari – Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997, f. 74-81).

Duke gërshetuar metodën e vjetër të gjuhësisë krahasimtare me atë të disiplinës më të re, gjeografisë gjuhësore, kërkimet shumëgjuhëshe kanë arritur deri më tani në rezultate premtuese. Deri më tani janë botuar disa atlasë gjuhësorë shumëgjuhësh. Të gjitha pakicat gjuhësore të Gadishullit Italian qenë paraqitur në *Atlasin italian të Zvicrës* si edhe në *Atlasin gjuhësor italian*.

Atlasi gjuhësor i Mesdheut përmbledh gjuhë që u përkasin familjeve të ndryshme, prandaj mund të thuhet se ALE-ja, edhe pse e zgjeron krahasimin shumëgjuhësh, nuk është i pari atlas shumëgjuhësh.

Ka edhe *Atlas gjuhësor të gjuhëve sllave*, *Atlas gjuhësor alpin* etj. Disa gjuhëtarë janë përpjekur t'i shtrijnë kërkimet e gjeografisë gjuhësore jo vetëm në përmasa evropiane, por edhe në shkallë botërore, përkatësisht kanë shfaqur idenë për të hartuar një atlas dialektor të gjuhëve të botës.

Edhe për gjuhën shqipe tani më kemi atlas dialektor. Atlasi dialektor i shqipes është vepra më domethënëse në fushën e gjeografisë gjuhësore për ne.

Pas gati një shekull përpjekjesh, më në fund shqiptarët kanë edhe një Atlas dialektor. E nisur dekada më parë si një projekt i disa albanologëve italianë dhe i pasuar nga profesor Eqrem Çabej, veprës madhore iu dhanë "duart e fundit" nga emra të njohur të gjuhësisë shqiptare, si: prof. dr. Jorgji Gjinari (drejtues), prof. dr. Bahri Beci, prof. dr. Gjovalin Shkurtaj dhe prof. dr. Xheladin Gosturani. Atlasi Dialektor i Gjuhës Shqipe (ADGjSh), është një nga veprat themelore të gjuhësisë shqiptare, i cili u botua me vonesë (vëllimi I më 2007, vëllimi II më 2008) për arsye teknike, pasi është mbaruar që në vitet '90.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Çfarë nënkupton me gjeografi gjuhësore?
2. Ku filloi për herë të parë të zbatohet gjeografia gjuhësore?
3. Çfarë bënë Zhilëroni dhe Edmondi për hartimin e Atlasit dialektor të frëngjishtes?
4. A kemi Atlas gjuhësor të Evropës? Na thoni diçka për të.
5. A është përfshirë edhe shqipja në Atlasin gjuhësor të Evropës?
6. Cilët dialektologë shqiptarë janë angazhuar për të paraqitur shqipen në Atlasin gjuhësor të Evropës?
7. A mund të hartohet një atlas dialektor i gjuhëve ballkanike?
8. Lexo e shih në internet material e harta për atlasët gjuhësorë e dialektorë.

2.1. ATLASI DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE


Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, botoi Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe në dy vëllime: vëllimi I 2007, vëllimi II 2008, Napoli, Itali. Dalja në dritë e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe bashkë me disa vepra themelore të gjuhësisë shqiptare shënon një periudhë të artë të arritjeve të shkencës shqiptare. Atlasi është ndër veprat më të mira të kohës, si vepër kolektive me rëndësi kombëtare. Në rrugën e zhvillimit ka faza në të cilat një fushë studimesh shkencore shënon arritje shumë të rëndësishme. Për dialektologjinë shqiptare, një arritje e këtillë me rëndësi të veçantë është Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe.

Mbi këtë bazë, sigurisht, do të zgjerohen e do të thellohen më tej njohuritë për dialektet e shqipes dhe do të bëhet e mundur të nxirren përfundime më të përditësuara për gjendjen e sotme

të dialekteve tona e për historinë e tyre. Vlen për t'u theksuar fakti që Atlasi sjell të dhëna jo vetëm për dialektologjinë, sociolinguistikën, historinë e gjuhës, por edhe për disiplina të tjera të veçanta gjuhësore të shqipes standarde, si për leksikologjinë, fonetikën e fonologjinë, morfologjinë e sintaksën, madje për disiplina jogjuhësore, si për historinë e popullit, etnologjinë etj.

Ideja për hartimin e një atlasit të tillë është hedhur për herë të parë në vitet '30-'40 të shekullit të kaluar nga prof. Eqrem Çabej. Ai e mendoi i pari domosdoshmërinë e një atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, madje hartoi që atëherë edhe një pyetësor të gjerë për këtë punë. Më tej, ideja ka vijuar me punën e prof. Mahir Domit dhe të shumë e shumë pasardhësve dhe kolegëve të tjerë gjuhëtarë, që kanë kontribuar për plotësimin e Atlasit me materialet, studimet dhe hulumtimet e kryera ndër vite.

Kjo vepër është me rëndësi të veçantë për dialektologjinë dhe historinë e shqipes. Në radhë të parë është një vepër që i adresohet publikut të specializuar. Atlasi do të vlejë dhe do të shërbejë vazhdimisht në të ardhmen si një pikë referimi për të gjitha studimet gjuhësore. Albanologjia shqiptare, ajo e huaj dhe gjuhësia e përgjithshme, do ta kenë të dobishëm këtë Atlas.



Atlasi u jep përgjigje shumë pyetjeve që padyshim ngrihen dhe u interesojnë gjuhëtarëve në punën e tyre studimore-shkencore. Është një vepër me interes në përgjigjet që jep për dialektologjinë shqiptare të zonave të caktuara, por edhe në përgjithësi. Vepra jep një pasqyrë tërësore, përgjithësuese, të dialekteve dhe të folmeve të gjuhës sonë, të tipareve të përbashkëta dhe veçorive të tyre. Padyshim, jepen kufijtë e shtrirjes së këtyre veçorive, pra, një vështrim i përgjithshëm i gjuhës shqipe në variacionin e saj gjeografik. Kjo është e para vepër e hartuar sipas koncepteve dhe metodave të gjeografisë gjuhësore, një vepër, realizimi i së cilës u bë i mundur nga një veprimtari paraprirëse 25-vjeçare me studime e hulumtime të gjuhës shqipe. Vepra sjell të dhëna jo vetëm për dialektologjinë, por edhe për disiplina të tjera të veçanta gjuhësore si leksikologjia e, po kështu, edhe për ndonjë disipinë jogjuhësore, si historia e popullit tonë dhe ajo e gjuhës shqipe. Siç thashë (thotë prof. Gjovalin Shkurtaj), kjo është një vepër madhore e gjuhësisë shqipe, që ka interes për gjuhësinë historike, problemet e kontakteve të gjuhëve, studimet ballkanistike dhe probleme të tjera lidhur me to. Një ndihmesë të veçantë i sjell historisë së gjuhëve kufitare nga të cilat të folmet shqipe, kryesisht të folmet anësore, ruajnë shumë gjurmë frazash të moçme të kontakteve të zhdukura ndonjëherë në vetë trevat e atyre gjuhëve

ADGjSh është i vlefshëm për të gjithë: për studentët, për mësuesit dhe pedagogët, për specialistët e fushave të ndryshme, si edhe për cilindo që kërkon të dijë më shumë dhe të rritë më tej nivelin e tij gjuhësor, kulturor e shkencor. Ai është i vlefshëm jo vetëm për gjuhësinë shqiptare, por edhe për gjuhësinë ballkanike, historinë, etnologjinë etj. Ky kurorëzim bëhet duke përdorur edhe metodën e gjeografisë gjuhësore në shkallën më të përparuar të saj.

Pas një pune të madhe për skedimin e materialeve të mbledhura në pikat e banuara të krahinave të ndryshme më përfaqësuese të të folmeve të shqipes, mbi bazën e materialeve të grumbulluara e të shkencorizuara në një qendër të përbashkët, u themeluan edhe Kartoteka kombëtare e dialekteve të shqipes, pastaj edhe Fonoteka e dialekteve e të folmeve të shqipes, të cilat do të pasuroheshin më tej në mënyrë të pandërprerë edhe nga anketimet e bëra nga bashkëpunëtorë të jashtëm, kryesisht mësues të dalluar të gjuhës shqipe të rretheve, të dhënë pas studimeve dialektologjike.

Të gjitha anketat për ADGjSh-në janë regjistruar edhe në magnetofon. Bobinat e regjistruara si dhe blloqet e shënimeve të anketave për Atlasin ruhen në kartotekën e fonotekën e sektorit të gramatikës e të dialektologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Në fillim, ADGjSh-ja ka disa harta jogjuhësore: harta fizike, harta administrative, harta historike, harta etnografike, harta me emrat e katundeve ose qyteteve ku janë bërë anketimet dhe rreth 700 harta gjuhësore.

Hartat e Atlasit janë dy llojesh: harta sqaruese dhe harta josqaruese, d.m.th. harta ku shënohet fjala pranë numrit të pikës së anketuar dhe harta ku nuk vihen fjalët a format, por simbole të llojeve të ndryshme. Pas hartave analitike ka edhe harta përgjithësuese.

Në shumë harta leksikore dhe në disa harta morfologjike dallimet gramatikore dhe dallimet fonetike që nuk janë objekt i tyre, pasqyrohen në një tregues në shpinën e hartës paraprirëse. Në tregues, sipas një renditjeje të shkallëzuar, pasqyrohen variantet e ndryshme gramatikore, fjalëformuese e fonetike për hartën leksikore dhe variantet fonetike për hartën morfologjike. Sigurisht, këta tregues bëhen vetëm kur shihet e domosdoshme. Po kështu, kur është e nevojshme, edhe komentari jepet brenda hartës përkatëse.

Duke pasur në dorë atlasin, njerëzit mund të binden vetiu se nga pjesa më veriore e deri në atë më jugore gjen njëjtat fjalë me forma të ndryshme. Gjen elemente të strukturës që e për afrojnë gjuhën shqipe dhe tregojnë se shqipja e moçme me shqipen e sotme kanë disa ndryshime, por ato nuk janë ndryshime tepër të mëdha dhe kjo tregon rëndësinë që ka atlasin për të mbështetur zgjidhjet e sotme që janë bërë për gjuhën standarde.

Përgjithësisht është konstatuar se vazhdimësia tokësore e shtrirjes së shqiptarëve në Ballkan bashkëpërputhet me vazhdimësinë gjuhësore. Nga kjo pikëpamje, të folmet shqipe në mënyrë të shkallëshkallshme gërshetohen njëra me tjetrën.

Ky shkallëzim gjuhësor me zona kalimtare nga një tip të folmesh në tipin tjetër, që më së miri e pasqyron ADGjSh me izoglosa e jo me kufij të prerë dialektor, është një dëshmi e fuqishme gjuhësore se shqiptarët në Ballkan janë autoktonë dhe se me shekuj kanë jetuar e jetojnë aty. Kontinuiteti tokësor, etnik, historik e gjuhësor i shqiptarëve në Ballkan mohojnë bindshëm hipotezën e disa dashakqinjve të popullit tonë se kinse para dy-tre shekujsh paskësh pasur dyndje të mëdha popullsie nga Shqipëria në Maqedoni.

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (në dy vëllime: Napoli, 2007, 2008) është një vepër madhore përgjithësuese e dialektologjisë sonë, sintezë e të arriturave të deritashme në fushën e dialektologjisë shqiptare dhe kurorëzim i punës shumëvjeçare ekipore të koordinuar të punonjësve shkencorë. Në të me metodën e hartografimit jepet shtrirja e dukurive gjuhësore në gjithë hapësirën e shqipes.

Pas gati një shekull përpjekjesh, kultura shqiptare u pasurua edhe me Atlas dialektologjik. E nisur dekada më parë si një projekt i disa albanologëve italianë, të prof. Mateo Bartolit (1929), më pas të prof. Karlo Taliavinit (1940) dhe i pasuar nga profesor Eqerem Çabej, kjo vepër madhore u kurorëzua me punën shumëvjeçare të emrave të njohur të gjuhësisë shqiptare: të Jorgji Gjinarit (drejtues), Bahri Becit, Gjovalin Shkurtajt, të ndjerit Xheladin Gosturani si dhe të ndihmesës së pakrysyer që dhanë shumë bashkëpunëtorë të tjerë, sidomos Anastas Dodi e Minella Totoni.

Atlasi dialektologjik të gjuhës shqipe është rrjedhojë e punës paraprake që kanë bërë shumë gjuhëtarë të huaj e shqiptarë, hartues të monografive e të skicave dialektore. Ky projekt i rëndësishëm për gjuhën, kulturën dhe gjithë kombin shqiptar u kurorëzua me punën njëzetepesëvjeçare të gjuhëtarëve tanë të shquar si me ekspeditat shkencore në terren brenda 6 vitesh, ashtu edhe me punën kabinetike të përpunimit të materialit dhe të hartografimit të tij.

Në ADGjSh jepet një pasqyrë e përgjithshme e gjuhës shqipe në variacionin e saj gjeografik sipas koncepteve e metodave të gjeografisë gjuhësore. Ai ka vlera të shumta jo vetëm shkencore, por edhe praktike.

Përhapja gjeografike e fjalëve, e dukurive fonetike, fonologjike, morfologjike e sintaksore sigurojnë material të vlefshëm jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, por edhe për historinë e shqipes e të shqiptarëve, për raportet e brendshme të të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të shqipes, për marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde, për gjuhët në takim e për gjuhësinë ballkanike.

Dy vëllimet e Atlasit janë literaturë e patjetërsueshme jo vetëm për studentët e filologjisë shqiptare, por edhe për çdo intelektual tjetër shqiptar. Me këtë vepër kapitale është bërë një hap i madh përpara në studimet shqiptare. Me vlerat që ka, ai do të ndihmojë zhvillimin e një faze më të ngritur të gjuhësisë sonë.

ADGjSh përfshin një rrjet dialektor prej 175 pikash, nga të cilat 85 vendbanime në Republikën e Shqipërisë, 66 në trevat shqiptare jashtë saj: në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, në anët e Peshterit, të Jablanicës dhe të Preshevës e Bujanovcit, në diasporën arbëreshe të Italisë, të Greqisë dhe të arbëreshëve të Zarës (Dalmaci).

Hartuesit e Atlasit u përballën me probleme të shumta jo vetëm gjuhësore, por edhe me probleme politike e financiare. Në një deklaratë prof. Gjovalin Shkurtaj thotë: "Në atë periudhë kur është shkruar kjo vepër nuk shkonim dot në disa vende, për arsye të konjunkturave politike, i kemi plotësuar duke marrë vepra apo botime të albanologëve ose të studiuesve shqiptarë në ato treva. Pra, është bërë një punë e vështirë dhe e madhe, por si për çdo vështirësi, pasi kalohet, njeriu ndjen vetëm gëzim. Unë mund të them pa mburrje që libri që sapo kemi marrë në dorë, dy vëllimet e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe shkon jo vetëm krahas me Fjalorin dhe me Gramatikën, por shkon edhe më tej se ato, për faktin se ndërsa ato janë vepra që kanë gjithmonë vulën e një autori, kjo është një vepër që ka vulën e autorëve dhe të një populli të tërë, sepse ne kemi bërë ekspedita, kërkime në të gjitha trevat shqiptare. Krahas me emrat tanë në faqet e para të Atlasit, janë edhe emrat e shumë informatorëve me të cilët ne kemi qëndruar me ditë të tëra, i kemi pyetur dhe ata na janë përgjigjur me shumë durim.

Departamenti i Studimeve të Evropës Lindore të Universitetit Oriental të Napolit në Itali të botoi Atlasin në dy vëllime me fondet financiare që ndau për të, falë edhe angazhimit të madh të prof. Italo Costante Fortinos.

Nga ADGjSh përftohet një tablo shumë e gjerë e fenomeneve gjuhësore që lidhen me fonetikën, morfologjinë, sintaksën (vëllimi I) dhe leksikun (vëllimi II). Përfundimet janë të pasqyruara në harta gjeografike shumëngjyrëshe për të lehtësuar leximin e simboleve që përfaqësojnë varietetet e fenomeneve gjuhësore.

Duhet theksuar se ky është Atlas i tërë shqipes dialektore dhe jep një pasqyrim të plotë të dialekteve e të folmeve të shqipes, të tipareve e veçorive të tyre. E njëjta dukuri gjuhësore është pasqyruar në një hartë të caktuar, në të gjithë hapësirën shqipfolëse, duke na dhënë mundësinë të dallojmë tiparet dialektore në një rrafsh krahasues. Atlasi përmban 10 harta jogjuhësore dhe 405 harta gjuhësore që trajtojnë e pasqyrojnë në dy vëllime dallimet dialektore fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës shqipe.

Vlera e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe. - ADGjSh ka rëndësi të shumëfishtë. Përmbledhtas mund të thuhet se:

- Nga ADGjSh përftohet një tablo shumë e gjerë e dukurive gjuhësore që lidhen me fonetikën e fonologjinë, morfologjinë, sintaksën (vëllimi I) dhe leksikun (vëllimi II). Përfundimet janë të pasqyruara në harta gjeografike shumëngjyrëshe për të lehtësuar leximin e simboleve që përfaqësojnë varietetet gjuhësore. Ai ka vlera të shumta jo vetëm shkencore, por edhe praktike.
- Përhapja gjeografike e fjalëve, e dukurive fonetike, fonologjike, morfologjike e sintaksore sigurojnë material të vlefshëm jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, por edhe për historinë e shqipes e të shqiptarëve, për raportet e brendshme të të folmeve, nëndialekteve e dialekteve të shqipes, për marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde, për gjuhët në takim e për gjuhësinë ballkanike. Me një emërtesë të përbashkët mund të thuhet se Atlasi është një enciklopedi e gjuhës dhe e kulturës popullore.
- Në Atlas janë përmbledhur (sintetizuar) me sukses qindra e mijëra faqe tekst të monografive dhe të skicave dialektore.
- Ai sjell një metodologji të re në studimin e dialektologjisë shqiptare, metodën e gjeografisë gjuhësore në shkallën më të përparuar të saj. Kjo metodë e hartografimit të dukurive gjuhësore në të ardhmen mund të zbatohet edhe për mikrosistemet dialektore.
- Mbi këtë bazë, sigurisht, do të zgjerohen e do të thellohen më tej mjohuritë për dialektet e shqipes dhe do të bëhet e mundur të nxirren përfundime më të përditësuara për gjendjen e sotme të dialekteve tona e për historinë e tyre.
- Populli ka ruajtur materialin burimor të këtij atlas. Ai ka merita shumë të mëdha që ka arritur të ruajë vazhdimësinë gjuhësore nga ilirishtja – shqipja e vjetër – arbërishtja – shqipja e re. Atlasi ka vulën e popullit, sepse në të pasqyrohet gjuha e tij dhe nëpërmjet saj sigurohet një material burimor për botën materiale e shpirtërore të tij. Atlasi dokumenton shqipen territoriale të shekullit XX.
- Dijetari i shquar frëng Charl Nodie me të drejtë ka thënë “ai që nuk ka hulumtuar me kujdes dialektet dhe të folmet e gjuhës së vet, nuk njih as gjysmën e saj“. Me ADGjSh

zgerohen, thellohen dhe saktësohen njohuritë tona për larminë territoriale të shqipes, por nga ana tjetër edhe për unitetin e saj, dhe bashkë me gramatikat normative, fjalorët dhe veprat e tjera shtohen studimet themelore për gjuhën dhe kulturën kombëtare.

- Dy vëllimet e Atlasit janë literaturë e domosdoshme jo vetëm për studentët e filologjisë shqiptare, por edhe për çdo intelektual tjetër shqiptar. Me këtë vepër kapitale është bërë një hap i madh përpara në studimet shqiptare. Me vlerat që ka, ai do të ndihmojë zhvillimin e një faze më të ngritur të gjuhësisë sonë.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Kërko në internet, gjej dhe lexo material plotësues lidhur me Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe.
2. Përpiqu të sigurosh Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe. Shfletije dhe analizoje atë.
3. Lexojeni tekstin e dhënë nga f. 16-33 në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe, vëllimi I, Napoli 2007, ku shpjegohen a) parimet themelore të ADGjSh, b) të dhënat e hartave dhe paraqitja e tyre teknike, c) ecuria e punës për hartimin e ADGjSh, ç) informuesit dhe burime të tjera të dhënash, d) rrjeti i pikave të ADGjSh. Shkruani një përmbledhje në këto tema.
4. Shkruaj një recension (vlerësim) për Atlasin.

2.2. ZBATIMI I GJEOGRAFISË GJUHËSORE EDHE PËR MIKROSISTEMET E SHQIPES DIALEKTORE

Askush nuk duhet të vërë në diskutim vlerat e Atlasit, sepse ato janë të padiskutueshme dhe ai paraqet një nga të arriturat albanologjike më të mëdha të kohës, por duam të vëmë në pah nevojën e vazhdimit të punës së filluar, përkatësisht të zbatimit të gjeografisë gjuhësore edhe për mikrosistemet e shqipes dialektore. Dobiprurës do të jenë atlasët krahinorë. Fjala vjen, do të ishte mirë të hartoheshin nga një atlas dialektor për:

- a) dialektin e gegërishtes;
- b) dialektin e toskërishtes si dhe për:
- c) grupin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore;
- ç) grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore;
- d) grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore;
- dh) grupin e të folmeve të Shqipërisë së Mesme;
- e) grupin e të folmeve të toskërishtes veriore;
- ë) grupin e të folmeve të labërishtes;
- f) grupin e të folmeve të çamërishtes;
- g) arbërishten e Italisë;
- gj) arbërishten e Greqisë etj.

Nga ADGjSh përftohet një tablo shumë e gjerë e fenomeneve gjuhësore që lidhen me fonetikën, morfologjinë, sintaksën (vëllimi I) dhe leksikun (vëllimi II). Përfundimet janë të pasqyruara në harta gjeografike shumëngjyrëshe për të lehtësuar leximin e simboleve që përfaqësojnë varietetet e fenomeneve gjuhësore.

Thuhet edhe në Hyrje se ky “Atlas do të paraprijë atlasët krahinorë, që do të hartohen në etapa të ardhshme për njohjen më me hollësi dhe më në thellësi të tipareve dhe çështjeve të veçanta që kanë njësitë e ndryshme dialektore të shqipes”.

Duhet theksuar se ky është Atlas i tërë shqipes dialektore dhe jep një pasqyrim të plotë të dialekteve e të folmeve të shqipes, të tipareve e veçorive të tyre. E njëjta dukuri gjuhësore është pasqyruar në një hartë të caktuar, në të gjithë hapësirën shqipfolëse, duke na dhënë mundësinë të dallojmë tiparet dialektore në një rrafsh krahasues. Atlasi përmban 10 harta jogjuhësore dhe 405 harta gjuhësore që trajtojnë e pasqyrojnë në dy vëllime dallimet dialektore fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës shqipe.

Siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaç, ndonëse i botuar më 2007 dhe 2008, “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe” paraqet një realitet dhe dukuri gjuhësore të viteve ‘80. Gjuhëtarët nuk e kanë pasuruar materialin me të dhëna të marra pas ‘90-ës, kohë në të cilën lëvizja e madhe demografike e popullsisë dhe intensifikimi i mjeteve komunikuese ka kushtëzuar edhe zhvillime apo ndryshime gjuhësore.

Për hartimin e atlasëve krahinorë do të duhet një organizim tjetër gjuhëtarësh e shkencëtarësh në nivel kombëtar. Tani më nuk ka nevojë të fillohet nga e para, meqë mund të shfrytëzohet përvoja e punës së dialektologëve tanë që kanë bërë për ADGjSh. Rrjedhimisht në këtë punë ekipore duhet të marrin pjesë bashkë me gjuhëtarët e asaj zone edhe autorët e Atlasit dialektologjik të shqipes. Siç thotë me një rast prof. Gjovalin Shkurtaç, “nëse Atlasi përfshin 175 pika anketimi dhe paraqitje hartografike për të gjithë shtrirjen gjuhësore shqiptare, vetëm në një krahinë mund të ketë më shumë se 200 pika”. Me atlasët rajonalë do të plotësohet, do të vërtetohet e do të përimitohet shtrirja gjeografike e dukurive gjuhësore të shqipes.

Që dukuritë gjuhësore të paraqitura në Atlasin e përbashkët të shqipes dhe në Atlasët krahinorë të jenë të krahasueshme do të ishte më mirë të shfrytëzohej i njëjti Pyetësor hartuar nga Jorgji Gjinari, Gjovalin Shkurtaç e i ndjeri Xheladin Gosturani. Kuptohet se për të folme të ndryshme që kanë tipare të veçanta ky pyetësor mund të plotësohet edhe me pyetje të tjera. Bie fjala, për të folmet e gegërishtes qendrore pyetësorit duhet shtuar edhe pyetje për diftongimin e zanoreve të theksuara /i, y, u/, për zhburorëzimin e [y]-së në [i], qiellzorëzimin e bashkëtingëllores [g] në [gj], për evoluimin e grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl], për zhvillimin e grupeve [pl, bl, fl], por edhe ndonjë pyetje të karakterit të përgjithshëm, si për të hetuar vlerën fonologjike të gjatësisë së zanoreve, vlerën fonologjike të hundorësisë së zanoreve, duke kërkuar që këto dukuri të rëndësishme të vërtetohen me çifte minimale fjalësh.

Po kështu duhet të ruhen incizimet origjinale që gjuhëtarët do të bëjnë në terren bashkë me shënimet e tyre. Nga materiali i vjelë të themelohet kartotekë dhe fonotekë e atyre të folmeve. Arkivat audio duhet të digjitalizohen dhe të hidhen në internet, që të kenë një përdorim më të gjerë, e të mos mbeten vetëm në kuadrin e studiuësve të gjuhës. Një punë të ngjashme kanë bërë kolegët maqedonas për dialektet e maqedonishtes.

Do të ishte e udhës të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale. Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Mendojmë se në të ardhmen gjuhësia shqiptare në fushën e dialektologjisë duhet të shtrojë detyra të tjera: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik, leksikor e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt. Hartimi i atlasëve krahinorë do të ngërthente të arriturat në këtë fushë.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. A është paraqitur e folmja jote në Atlasin dialektor të gjuhës shqipe? Nxirr nga Atlasi veçoritë kryesore fonetike-fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes tënde.
2. A duhet të vazhdojë më tej puna e hartimit të atlasëve dialektorë për dialektet, nëndialektet dhe grupet e të folmeve të shqipes?
3. Kush dhe si duhet organizuar puna e hartimit të atlasëve për mikrosistemet dialektore të shqipes?

2.3. REGJISTRIME ZANORE TË TË FOLMEVE SHQIPE NË INTERNET

Regjistrime zanore të 137 të folmeve shqipe. Një risi e mrekullueshme nga studuesi Robert Elsie. Në faqen e tij ka publikuar regjistrime nga 137 të folme të shqipes. Në hartat përkatëse të secilit rajon (në faqen e R. Elsie's: Robert Elsie, Dialektet e gjuhës shqipe, www.albanianlanguage.net) duhet të klikoni në pikat e kuqe për të dëgjuar të folmen e asaj zone nga një njeri i zakonshëm (2~4 minuta kohë).

Albanologu Robert Elsie bën një tjetër shërbim kulturës shqiptare. Këtë herë në fushën e gjuhës. Së fundmi ai bën me dije se në sitin e tij zyrtar, në faqen www.albanianlanguage.net mund të dëgjohen incizime zanore të 137 varianteve dialektore të shqipes nga dhjetë shtete ku ajo flitet si gjuhë vendase. Një hartë e detajuar e hapësirave ku janë realizuar këto incizime të mundëson të dëgjosh se si flitet shqipja jo vetëm brenda territorit shqiptar, por edhe në të gjitha vendet ku ka shqipfolës. Sipas Elsie, mes individëve të incizuar ka nga ata që janë folës të mirë të dialektit, ndërsa disa të tjerë do t'i ndihmojnë të interesuarit të kuptojnë se si flitet sot shqipja në kohët moderne në vende të ndryshme. Incizimet janë bërë në Shqipëri, në Kosovë, në

Maqedoni, në Mal të Zi, tek Arbëreshët e Italisë, në ngulimet e vjetra të dialektit çam në Epir (Pargë dhe Gumenicë), në Kroaci dhe Bullgari ku ka ngulime të hershme të shqiptarëve. Kjo faqe, e cila mund t'u vijë në ndihmë kureshtarëve, por edhe studiuesve të gjuhës shqipe, është e pasuruar edhe me një informacion historik për sa i përket prejardhjes dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, shtrirjes së saj, përshkrimi i shqipes së sotme, dialekteve të saj dhe karakteristikave të kësaj gjuhe.

Kjo faqe interneti: <http://www.albanianlanguage.net> u ofron dëgjuesve inçizime zanore të shqipes nga rajonet e ndryshme të botës shqipfolëse. Ndonëse të folmet e shqipes janë përgjithësisht të kuptueshme për dëgjuesin i cili ka një vesh të stërvitur, ndryshime rajonale janë të dukshme, dhe tepër interesante. **Këtu mund të dëgjoni njerëz që flasin forma më të ndryshme të shqipes.** Disa folës janë zotërues të mirë të dialektit të tyre, kurse të tjerë u zgjodhën rastësisht për të krijuar një ide se si flitet shqipja bashkëkohore në rajonet e ndryshme.

Klikoni mbi një pikë për të dëgjuar inçizimin, i cili do të shfaqet automatikisht në një dritare të re. Nëse përdorni Internet Explorer të Microsoft-it, duhet të instaloni Versionin 7 ose një version më të ri. Nëse përdorni Mozilla Firefox 3, duhet të instaloni Quicktime Plug-in. Përdoruesit e Macintosh-it duhet të përdoren Windows Media Player Plug-in.

Si përfundim (thotë Elsie), dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen time shumë personave të cilët më kanë ndihmuar, apo themi të paktën kishin durim me mua në këtë projekt. Ndër ata janë shumë bujq dhe çobanë shqiptarë të cilët u habitën, madje u hutuan kur u ballafaquan me një të huaj i cili u doli përpara dhe donte, pa arsye të kuptueshme, të kapte dhe të inçizonte gjuhën e tyre. Shpresoj se kjo përmbledhje inçizimesh do të jetë në dobi jo vetëm të dialektologëve, por edhe të gjithë njerëzve në botë që interesohen për gjuhën shqipe.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Në faqen e internetit: <http://www.albanianlanguage.net>, Robert Elsie ka shkruar edhe një tekst përmbledhës të vlefshëm për shtrirjen dialektore të shqipes. Lexojeni atë.
2. Nga kjo faqe e internetit klikoni mbi disa pika të kuqe anëmbanë ku flitet shqipja për të dëgjuar e përkapur dallimet e ngjashmëritë e shqipes dialektore.

KREU III

3. DEGËZIMI DIALEKTOR I GJUHËS SHQIPE DHE STUDIMI I SAJ

Mendoni dhe përgjigjuni:

A keni vërejtur ndonjë dallim ndërmjet gjuhës që flitni në familje dhe asaj që flasin mësimdhënësit në shkollë, asaj që dëgjoni në radio e televizion ose gjuhës së librave, revistave, gazetave etj. Me siguri se po! A keni menduar për këtë çështje, pse është kështu?

Lexojeni me vëmendje të njëjtin tregim popullor që e rrëfeu një gegë dhe më pas një toskë. Krahasojeni gjuhën e rrëfimitarit gegë me gjuhën e rrëfimitarit toskë. Çfarë ngjashmëri e çfarë dallimesh vëreni?

<i>Rrëfimi i një gegu:</i>	<i>Rrëfimi i një tosku:</i>
<p>Plaki dhe çypi me alltën</p> <p>Ishin kân ni plak edhe ni pla:k, ç i kishin pa:s ni xha:l e ni ç i:k. Plaki u smu: ni dit, po jav la ni amanet. E thirri gruen, xhalin, çikën e u tha:</p> <p>- “Une po de:s. Mane mi:r n’men amanetin tem, se muni me hu:p shu:m. N’a:r e kam mshe:f ni çyp me alltan, punone mi:r tokën edhe kini me: xhe:t”.</p> <p>Mas dekës plakit, vllavi e motra shko:jn n’a:r e ja nisin punës. Xhali e livrojke tokën e çika e gjujke farën. Tokën e punun fe:ll, po nuk xhetën kurgjã. K’shtu ja bã:n do vjet.</p> <p>Nime u erdh keç ç i nuk e xhetën çypin, po nuk u idhnu:n se t’korrmet ishin t’mira. Harxhojshin sa kishin nevo:j e tepricën e shitshin. Paret e fitume i shtishin me ni çyp edhe i rujshin. Mas disa vjetve çypi u mush me pare.</p> <p>Çe, ky ke çypi ç i jav la baba. - Puna.</p>	<p>Plaku dhe qypi me flori</p> <p>Kishte qenë një plak dhe një plakë, që kishin patur një djalë e një vajzë. Plaku u sëmur një ditë, por ua la një porosi. E ftoi gruan, djalin, vajzën dhe u tha:</p> <p>- “Unë po vdes. Mbajeni mënt mirë porosinë time, se munt të humbni shumë. Në arë kam fsheur një qyp me flori, punojeni mirë tokën dhe do ta gjeni”.</p> <p>Pas vdekjes së plakut, vëlla e motër shkojnë në arë dhe ia fillojnë punës. Djali e lëvronte tokën, ndërsa vajza hudhte farën. Tokën e punuan thellë, por nuk gjetën asgjë. Kështu ia bënë ca vite.</p> <p>Vërtet u erdhi keq që nuk e gjetën qypin, por nuk u zemëruan se të korrurat ishin të mira. Arxhonin sa kishin nevojë, ndërsa tepricën e shitnin. Paratë e fituara i futnin në një qyp dhe i ruanin. Pas ca vitesh qypi u mbush me para.</p> <p>Ja, ky ishte qypi që ua la babai. - Puna.</p>

Si rrjedhim i evolucionit të shkallëshkallshëm të njërit a të disa dialekteve të ilirishtes jugore, nga gjuha e banorëve të brigjeve lindore të Adriatikut dhe të Jonit u formua gjuha shqipe jo më vonë se në fundin e shekullit VI të erës sonë (Demiraj, 1988 : 203).

Shqipja flitet sot nga më se tetë milionë veta në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare të Maqedonisë, të Malit të Zi, në Preshevë, Bujanovc e Medvegjë, si dhe në viset e Çamërisë në Greqi. Shqipja flitet gjithashtu, në ngulimet shqiptare në Itali, në Greqi, në Kroaci, në Bullgari, në Ukrainë, si dhe në vende të ndryshme të botës, sidomos në Turqi, në Gjermani, Austri, Zvicër, Gjermani, Belgjikë, Suedi; por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, Australi e në mbarë rruzullin tokësor.



Nga gjithë ngulimet larg trungut shqiptar, vetëm ajo e Zarës dhe e Peshterit kanë dalë nga treva e dialektit verior, kurse të gjitha të tjerat janë të folme të toskërishtes, sidomos të toskërishtes jugore.

Shqipen si gjuhë amtare e ruajnë edhe sot një numër i madh shqiptarësh të shpërngulur për arsye ekonomike ose politike (kolonitë shqiptare), si në Turqi (shek. XIX-XX, vlerësohet se vetëm nga ish-Jugosllavia ndërmjet viteve 1953-1960 janë shpërngulur në Turqi mbi 400.000 shqiptarë), Rumani (shek. XIX), Egjipt (shek. XVIII-XIX, Argjentinë; si edhe ata që tani punojnë dhe jetojnë në shumë vende të tjera të Evropës (në Evropën Perëndimore sot ka rreth 500.000 shqiptarë): Gjermani, Zvicër, Austri, Belgjikë, Holandë, Angli, Itali etj. e vende të tjera të botës, si në Amerikë (prej 400 mijë deri më 500 mijë shqiptarë), Australi etj. Pothuajse nuk ka vend në botë ku nuk ka shqiptarë.

Gjuha shqipe mësohet dhe studiohet në disa universitete dhe qendra albanologjike në botë, si në Paris, Romë, Napoli, Kozencë, Palermo, Shën Pjetërburg (Leningrad), Pekin, Minhen, Bukuresht, Selanik, Sofje etj.

Objekt studimi i dialektologjisë shqiptare janë jo vetëm të folmet shqipe me vazhdimësi tokësore në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi, por edhe gjuha e ngulimeve shqiptare me trajtat e saj

arkaike. Të folmet e shqiptarëve me punë të përkohshme jashtë atdheut të shpërndarë anekënd botës nuk janë lëndë e dialektologjisë, sepse ato janë më të reja dhe shqiptarët, krahas gjuhës shtetërore, flasin po atë variant territorial prej nga edhe janë.

Dialektet lindin nga degëzimi i një gjuhe në kushtet e veçimit në hapësirë të folësve të saj gjatë historikut të tyre. Kështu, gjuhët e vjetra indoevropiane kanë qenë dialekte të një gjuhe të përbashkët. Hapësira është kusht i domosdoshëm për lindjen e dialekteve, por faktori kryesor i lindjes së tyre është faktori historik. Fjala vjen, pas shembjes së perandorisë Romake, Italia dhe Gjermania u ndanë në principata feudale, me komunikim ndërkrahinor të vështirësuar ose të ndërprerë. Prandaj, italishtja dhe gjermanishtja kanë nga 13-15 dialekte, të cilat janë mjaft të largëta midis tyre. Vendet e Evropës Juglindore për një kohë shumë të gjatë ishin në kuadrin e perandorive të mëdha (nën perandorinë Romake, Bizantine e Osmane), ku banorët mund të lëviznin pa pengesa brenda kufijve perandorakë dhe, si rrjedhim, asnjë prej gjuhëve të Ballkanit nuk ka më shumë se dy-tri dialekte.

Gjuha shqipe, prej ndryshimeve që ka pësuar në rrjedhë të kohës në krahina të ndryshme, ka arritur të ketë sot një degëzim me dy dialekte, secili dialekt me dy nëndialekte dhe me grupe të folmesh të shkallëve të ndryshme.

Degëzimi dialektor përcaktohet në bazë të dallimeve dhe ngjashmërive gjuhësore në fushë të fonetikës e fonologjisë, morfologjisë, leksikut dhe sintaksës. Në ndarjen dialektore të shqipes rëndom përfshihen të folmet që kanë vazhdimësi tokësore: të folmet brenda kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, ato të ish-Jugosllavisë e të Greqisë.

Të folmet e gjuhës shqipe degëzohen në dy dialekte, të cilat gjeografikisht ndahen me lumin Shkumbin, që përshkon pjesën jugore të Shqipërisë e Mesme. Në pjesën veriore të Shkumbinit e të Strugës shtrihet gegërishtja, ndërsa në pjesën jugore të Shkumbinit e të Strugës shtrihet toskërishtja. E folmja e qytetit të Strugës mund të merret si e folme kalimtare. Lumi Shkumbin buron në malin e Valamares (Shqipëri) dhe derdhet në Detin Adriatik. Ai ndan pothuajse në dy pjesë të barabarta Shqipërinë. Ky lum kolon nëpër krahinën e Mokrës në rrethin e Pogradecit, nëpër rrethin e Librazhdit, vazhdon shumë pranë qytetit të Elbasanit dhe më pas në Peqin e Rrogozhinë deri sa derdhet në Detin Adriatik.

Në pjesën veriore të Strugës (në Maqedoni) e të Shkumbinit (në Shqipëri) shtrihet **dialekti verior (gegërishtja)**, kurse në jug apo në të majtë të këtyre lumenjve shtrihet **dialekti jugor (toskërishtja)**.

Gegërishtja në jug fillon nga bregu i djathtë i Shkumbinit, përshin të gjitha të folmet e Shqipërisë veriore, të folmet e Maqedonisë në veri të Strugës, të folmet e Kosovës, të folmen e Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit dhe të folmet shqipe të Malit të Zi.

Territori në të cilin shtrihet toskërishtja është gjithë Shqipëria jugore, që fillon nga veriu përfaqësisht të lumi Shkumbin (përkatësisht në jug të të folmeve kalimtare), të folmet shqipe të fshatrave që gjenden në jug të Strugës, të Manastirit, Prespës, Resnjës; hidhet përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë në krahinën e Çamërisë, që sot gjendet brenda kufijve politikë të Greqisë.

Përcaktimi i përkatësisë dialektore të të folmeve shqipe të qytetit të Ohrit e të Strugës

Përcaktimi i të folmeve të qyteteve paraqet një vështirësi të madhe për shkak të popullsisë së përzier, imigrimit dhe emigrimit të vazhdueshëm nga zonat e ndryshme përreth, por edhe më larg. Të folmet e qyteteve, në krahasim me të folmet e fshatrave, siç dihet, shumë më tepër u janë ekspozuar ndikimeve të ndryshme gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, pikërisht për shkak të faktorëve të lartpërmendur, por edhe për shkak të martesave të përziera, arsimimit të popullsisë në qendra të ndryshme kulturore, turizmit etj.

Deri më sot në dialektologjinë shqiptare për të folmen shqipe të Ohrit thuhej se i takon toskërishtes veriore, duke u bazuar në të dhëna më të hershme gjuhësore dhe nga vendodhja gjeografike, meqë Ohri gjendet më afër Pogradecit dhe ndodhet në anën e djathtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi, kurse në Atlasin Dialektologjik është caktuar si pika dialektore 103, por nuk jepen veçori dalluese përpos të dhënave që janë të përgjithshme për mbarë shqipen dhe disa të toskërishtes veriore, sepse vjelja e materialit dialektor në këtë rreth është bërë shkarazi apo nga të folmet fqinje, si Pogradeci, Manastiri, Prespa, fshatrat perëndimore të Strugës (në Atlas nuk kemi asnjë informator nga Ohri).

Gjatë këtyre 50-60 viteve të fundit, për shkaqe politike, por edhe për shkaqe ekonomike, në Ohër ka pësuar shumë lëvizje demografike, që ka shkaktuar edhe ndryshimin e strukturës së popullsisë, rrjedhimisht edhe tipin e të folmes. Shqiptarët anas të Ohrit janë shpërngulur në Turqi, në Strugë, në Shkup e në vende të tjera; disa nga myslimanët janë turqizuar, ortodoksët janë sllavizuar, fshatra të tëra shqiptare janë shfarosur, djegur e asimiluar (kështu e pësuan fshatrat Pesočani, Volina, Podmolli, Rashçe, Orovnik, Tërpejca, Lubanishta, Peshtani, Shën Naumi (Sari Salltek) etj.).


Ndërkaq shqiptarët e sotëm të Ohrit, janë të ardhur nga rrethi i Strugës, më shumë gegë, por edhe toskë, prandaj e folmja e tyre është e larmishme nga familja në familje, nga moshja e thyer në moshë të re me kahje drejt përzierjes e shkrirjes gjuhësore. E folmja këtyre qyteteve në përcaktimin e vendit të tyre në strukturën dialektore të shqipes, duket sikur hidhen si top pingpongu herë në toskërishte veriore, herë në gegërishte qendrore e herë mbeten si të mesme, por natyrisht më shpesh i përcaktojnë si të folme toske, për shkak të afrisë gjeografike të fshatrave toske me qytetin e Strugës, si dhe të të folmeve të tjera toske përreth në territorin e Shqipërisë dhe të kontakteve të përhershme me to.

Pas gjithë këtyre ndryshimeve demografike a ka mbetur e folmja e Ohrit toskërishte veriore apo jo? Gjatë vjeljes së materialit dialektor në rrethin e Strugës dhe Ohrit për një periudhë 7-vjeçare (Ajten Qamili, *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*, “Java e Shkencës 2013”, Prishtinë, 14-18 maj 2013) erdhëm në përfundim se të folmet e këtyre dy qyteteve në gjendjen e sotme nuk mund të përcaktohen si të folme toske e as gege, por **e folmja e qytetit të Strugës dhe e qytetit të Ohrit sot i takojnë të folmeve kalimtare** me më shumë elemente toske.

Kufijtë e ndarjes së shqipes në dialekte, nëndialekte e grupe të folmesh nuk janë të prera. - Ndryshimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme dhe shpeshherë të gërshtuara me elemente të të folmeve fqinje. Bie fjala, ndërmjet dy dialekteve, përgjatë rrjedhës së Shkumbinit, përkatësisht në pjesën jugore a në të majtë të tij, që kap një rrip tokësor në perëndim prej detit Adriatik e në lindje deri te Qafa e Thanës, shtrihen të folmet kalimtare a transitore (përfshin pjesën veriore të fushës së Lushnjës, Dumrenë, Sulovën, Shpatin, Polisin, Vërçën, Domosdovën e Rajcën). Pozita gjeografike, marrëdhëniet ekonomike, politike, kulturore etj. në mes të

banorëve të kësaj zone janë faktorët që kanë ndikuar që sistemi gjuhësor i kësaj të folmeje të karakterizohet me gërshetimin e elementeve gege e toske. Jo të gjitha të folmet e gegërishtes kanë seri të zanoreve hundore: nuk e ka e folmja e Dibrës, e folmja shqipe e Krushevës dhe Prilepit, e folmja e Preshevës, e folmja e Ulqinit etj. Dialektet e shqipes nuk priten me kufi të prerë, por me një zonë kalimtare.

Ndarja dialektore e shqipes në gegërishte dhe toskërishte përputhet me ndarjen në mënyrën e të kënduarit të popullit tonë. Në Jug, duke filluar prej Shkumbinit, është karakteristike *polifonia* (të kënduarit me shumë zëra), ndërsa në Veri *homofonia* (të kënduarit me një zë). Në disa krahina të gegërishtes jugore këndohet edhe me dy zëra (në Maqeonin, fjala vjen me dy zëra këndohet në Shkup me rrethinë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë etj.). Gjithashtu, përputhja shihet edhe me veglat muzikore: në Veri mbizotërojnë veglat *kordofone* (instrumentet me tela: çiftelia, lahuta), në Jug veglat *aerofone* (instrumentet me frymë: curla, fyelli etj.). Edhe në kostumet popullore hetohet kjo përputhshmëri dialektore, sepse në Veri burrat veshin *tirqit*, ndërsa në jug *fustanellën*.



Të kënduarit me dy zëra është tipike për të folmet e gegërishtes qendrore. Fjala vjen, shumica e shqiptarëve të Maqedonisë (si burrat, ashtu edhe gratë) edhe sot e kësaj dite këndojnë me dy zëra: njëri/njëra në zërin e parë e tjetri/tjetra mban zërin e dytë. Këtë mënyrë të të kënduarit tradicional e dëgjojmë nga katundet jugore të qarkut të Shkupit e deri në Strugë, përkatësisht në Karshiakë, Saraj, Derven, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Prilep, Krushevë, Dibër e Strugë.

Në pikëpamje gjuhësore, gegërishtja sot paraqitet më e larmishme sesa toskërishtja, e cila është më e njësuar. Relievi në pjesën veriore të tokave shqiptare përgjithësisht është më malor sesa treva jugore, rrjedhimisht e para më e ndarë në krahina të izoluara, ndërsa e dyta me lëvizje e kontakte më të shpeshta të popullatës. Edhe mënyra e jetesës ka lënë gjurmë në gjuhë. Kështu,

në Veri malësorët kanë jetuar në katunde me shtëpi të shpërndara, larg njëra nga tjetra, ku rrallëherë njerëzit janë takuar mes vete ose kanë kontaktuar me ndonjë njeri të një vendi tjetër. Si shembull tipik mund të përmendim shtëpitë e shpërndara e të izoluara të fshatit Brezë, që shtrihet në një regjion të gjerë në malësinë e Karadakut të Shkupit: në sipërfaqe prej 50 km², ku pas vitit 1945 e deri më vitin 2001 jetonin jo më shumë se 600-700 banorë.

Përveç zhvillimit të brendshëm e të mëvetësishëm gjuhësor, në degëzimin dialektor deri diku kanë ndikuar dhe po ndikojnë, sidomos në leksikun dhe në sintaksën e të folmeve anësore, gjuhët e huaja në kontakt. Kështu, ndikimi i gjuhëve sllave është më i madh në të folmet shqipe të Maqedonisë, në kosovarishte e shqipen e Malit të Zi; në Shqipërinë e Jugut vërehet më shumë

ndikimi i greqishtes, në pjesën e bregdetit veriperëndimor është më i fuqishëm ndikimi i italishtes etj.

Ndarja fetare e shqiptarëve (në islamë, ortodoksë e katolikë) nuk ka lënë gjurmë të thella në ndryshueshmërinë gjuhësore të tyre, përveç në emrat vetjakë dhe në fondin e fjalëve që lidhen me ceremonitë, zakonet e kulturën fetare përkatëse.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Cilat janë dialektet e gjuhës shqipe dhe ku shtrihen ato? A ka edhe dallime muzikore e etnologjike ndërmjet shqiptarëve, që përkojnë me ndarjen dialektore?
2. Pse toskërishtja gjuhësisht është më e njësuar sesa gegërishtja?
3. A janë të prerë kufijtë dialektorë të shqipes? Pse?
4. Në cilat fusha gjuhësore hetohen dallimet kryesore ndërmjet dialekteve të shqipes? A mund të përmendni disa nga to?

3.1. BAZA E PËRBASHKËT E DY DIALEKTEVE

Të dy dialektet e shqipes, ashtu si dialektet e çdo gjuhe, karakterizohen nga prania e elementeve gjuhësore të përbashkëta dhe e disa elementeve të veçanta që i dallojnë midis tyre. Elementet e përbashkëta në sistemin fonetik, në strukturën gramatikore dhe në fjalor janë pa krahasim më të shumta dhe më të rëndësishme sesa elementet që i dallojnë këto dy dialekte, dhe e përbëjnë atë që mund të quhet njësia e shqipes si gjuhë kombëtare e të gjithë shqiptarëve. Do pasur parasysh gjithashtu se dallimet midis dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve të gjuhës shqipe janë mjaft më të pakta dhe më të vogla për nga pesha sesa dallimet dialektore dhe nëndialektore të shumë gjuhëve të tjera (Demiraj, 1988: 230).

Dallimet midis dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve të gjuhës shqipe janë më fort të karakterit fonetik. Natyrisht ka edhe dallime të karakterit gramatikor, por këto janë fare të pakta. Përkundrazi, elementet e tyre të përbashkëta janë pa krahasim më të shumta dhe më të rëndësishme. Mjafton të përmendim këtu se struktura morfologjike është pothuaj e njëjtë në të gjitha të folmet e shqipes. Me përjashtim të formës së paskajores të tipit *me punue*, që nuk e kanë të folmet e dialektit jugor, nuk ka formë gramatikore që të mos jetë e njohur si në pjesën veriore ashtu edhe në pjesën jugore të truallit gjuhësor të shqipes. Natyrisht, ka edhe raste që një formë gramatikore është më e përhapur në një dialekt a nëndialekt, por ajo nuk është e panjohur në dialektin tjetër. Kështu, p.sh. e ardhmja e tipit *do të punoj* përdoret më shumë në dialektin jugor, por kjo formë (do të punoj, da punoj, do punoj) përdoret shumë shpesh edhe në të folmet e gegërishtes jugore, krahas formës *kam me punue* (Demiraj, 1988: 230). Shqiptimi i

ndërhundshëm i zanoreve para bashkëtingëlloreve hundorer shfaqet në gegërishte, ndërsa nuk dëgjohej në asnjë të folme të toskërishtes. Por, jo pak të folme geqe nuk kanë zanore hundore, si e folmja e Dibrës, Rekës së Epërme të Gostivarit, e Prilepit dhe Krushevës dhe përgjithsisht të folmet shqipe në Maqedoni nga Tetova e më në jug deri në Strugë. Në këto të folme tani më pothuajse hundorësia është defonologjizuar, pra është e karakterit fonetik e jo fonologjik. Zanoret e gjata janë tipike për të folmet e Veriut, por ato i gjejmë edhe në të folmet Jugore: në Labëri e në Çamëri.

Dallimet dialektore nuk janë aq të mëdha sa të pengojnë të kuptuarit dhe marrëveshjen midis banorëve të trevave të ndryshme të banuara nga shqiptarët.

Pra, shkalla e afërsisë së dialekteve të shqipes është mjaft e madhe. Gegërishtja dhe toskërishtja janë varietete gjeografike të gjuhës së përbashkët kombëtare me kod dhe sistem të njëjtë. Dy dialektet kanë:

1) *kuptueshmërinë*, sepse gegët dhe toskët, kudo që janë, qoftë edhe nga viset më skajore mund të kuptohen midis tyre;

2) *njëllojshmërinë strukturore* si në fonetikë e fonologji, ashtu edhe në morfosintaksë dhe në pjesën më të madhe të fondit të fjalëve dhe të frazeologjizmave;

3) *përdoren nga e njëjta bashkësi gjuhësore* me prejardhje iliro-shqiptare.

Baza e njëjtë dhe e përbashkët e shqipes së njësuar është e paprekshme dhe, si e tillë, ajo duhet mbrojtur, ruajtur e përkrahur edhe më tej, sepse përbën treguesin themelor të përbashkësisë shpirtërore dhe kombëtare të shqiptarëve kudo që ndodhen, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në trojet e veta ballkanike dhe në diasporat arbëreshe e shqiptare kudo në botë.

Për mua, thotë prof. Gjovalin Shkurtaç, gjuha dhe dialektet nuk janë dy ushtri që ndeshen dhe njëra do ta asgjësojë tjetrën, por ujëra të cilat nisen nga treva të ndryshme dhe shkojnë në të njëjtin det të përbashkët. Midis shqipes së shkruar e të njësuar (që po quhet “standarde”) vepron parimi i enëve komunikuese: dialektet marrin nga shqipja standarde terma, fjalë e mënyra të thëni dhe kështu zhvillohen e përparojnë; edhe gjuha standarde përthith e pranon vazhdimisht prurje nga krahinat e dialektet dhe, ndonëse në fillim duket se ato sjellin një farë turbullimi, me kohë vijnë e tretën, bëhen pronë e shqipes standarde, por edhe mund të mbetën jashtë saj. **Prurjet nga krahinat nuk e prishin gjuhën, ato vetëm e begatojnë dhe e përtërijnë forcën shprehëse e kumtuese të shqipes.** Sigurisht, edhe ajo që vjen prej dialekteve, kur pranohet në standard duhet t’u përshtatet rregullave të drejtshkrimit të njësuar.

Gjuha e letërsisë artistike ka qenë dhe vijon të jetë kryesisht në rolin e vet: gjithmonë në kërkim të artit të fjalës, përherë duke qëmtuar bukurinë e shprehjes shqiptarisht, ashtu si bleta që mbledh nektarin e ëmbël dhe e shpie në hojet e mjaltit.

Sot Shqipëria është një vend i hapur, ka një shtet që mban marrëdhënie me të gjithë botën; populli ynë është tashmë në lidhje e takime të drejtpërdrejta me miq të shumtë në botë. Me fjalë të tjera, jemi bërë një shoqëri e hapur. Edhe gjuha shqipe, e cila është e do të jetë edhe më tej “gjuhë e hapur”, ka marrë dhe do të marrë edhe më tej hua nga gjuhët e mëdha të Evropës, po edhe do të përtëritet nga gurrat vetjake (Intervistë me Gjovalin Shkurtaç, Tiranë, 04. 07. 2014, në <http://www.fjalaelire.com/biseda>).

Ndikim të madh rrafshues në mbarë shqipen në rrjedhë të kohës kanë pasur latinishtja, greqishtja, turqishtja; në kohët më të reja gjuhët neolatine e anglishtja.

Jetjëmë në epokën e globalizmit, kur marrëdhëniet e dendura ndërmjet shteteve, krahinave e gjuhëve janë shtuar së tepërmi; kur këmbimet kulturore, letrare e artistike janë shumëfishuar, kur zhvillimi i vrullshëm i shkencës e teknikës ecën me ritme të paparashikuara. Në kushte të tilla, të gjitha gjuhët ndodhen para një dukurie të re, që është globalizmi gjuhësor. Gjuhët e mëdha e të zhvilluara, që kanë përparësinë e zhvillimit ekonomik, shkencor, teknik e artistik, gëzojnë edhe përparësinë gjuhësore duke u bërë rrezatuese të fjalëve, shprehjeve dhe formave të reja në të gjitha gjuhët me të cilat janë në kontakt popujt e vendeve të ndryshme të globit. Një dukuri e tillë është e pashmangshme edhe për shqipen, madje, në një shkallë edhe më të lartë se gjuhët e tjera, që kanë pasur stabilitet më të hershëm kombëtar e gjuhësor, krahas stabilitetit politik, ekonomik e shoqëror.

Për gjuhën shqipe, globalizmi është një dukuri e pashmangshme. Shumë fjalë, shprehje dhe ndërtime gramatikore të gjuhëve të huaja depërtojnë çdo ditë, orë e minutë në gjuhën shqipe. Ky depërtim është i fuqishëm nga dy burime: nga gjuhët romane, për arsye të traditës së krijuar prej disa shekujsh, sipas së cilës elementet e reja të gjuhës kanë depërtuar kryesisht nga këto gjuhë, sidomos prej italishtes e frëngjishtes; e para me kontakte të drejtpërdrejta prej marrëdhënieve historike; e dyta si gjuhë kulture kudo në Evropë në shekujt e fundit. Burimi i dytë është anglishtja, fuqia e së cilës si gjuha me prestigjin më të madh botëror, është bërë e ndjeshme në të gjitha gjuhët evropiane, sidomos në shekullin e fundit, duke përfshirë edhe shqipen.

Në rrethana të tilla, duke qenë globalizmi një dukuri e pashmangshme, në shumë raste mund të mënjanohet duke përdorur në vend të fjalëve, shprehjeve a strukturave të huaja sintaksore, elemente dhe materiale prej brumit të vetë shqipes, që janë farkuar me mjeshtri prej popullit dhe mund të gjenden në dialekte e në të folmet të veçanta, që vijojnë të gjallojnë e të bëjnë jetën e tyre (Kolec Topalli, Dialektet dhe standardi në kushtet e globalizimit, në <http://www.voal-online>).



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. A kanë bazë të përbashkët dy dialektet e shqipes? Thoni disa elemente të përbashkëta.
2. A kanë ndikuar gjuhët e huaja në ndarjen, por edhe në rrafshimin dialektor të shqipes? Shpjegojeni këtë.
3. A kanë bazë të përbashkët dy dialektet e shqipes? Thoni disa elemente të përbashkëta.
4. A kanë ndikuar gjuhët e huaja në ndarjen, por edhe në rrafshimin dialektor të shqipes? Shpjegojeni këtë.
5. Cilat elemente dalluese dialektore janë integruar në gjuhën standarde shqipe? Sipas kësaj, në shqipen letrare më shumë ka elemente toske apo geqe?
6. Shkruani një punim në temë: Gjuha shqipe dhe globalizmi.

7. Lexojeni tekstin për gjuhën shqipe në http://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_shqipe për dialektet, traditën shkrimore, klasifikimin, gramatikën, fjalorin dhe kontaktet me gjuhët e tjera, për shqipen standarde etj.


3.2. GEGËRISHTJA DHE NËNDIALEKTET E SAJ

Në bazë të tipareve dalluese dhe të përbashkëta që kanë të folmet e shqipes, dialektet kanë nëndarjet e tyre, si sisteme më të mëdha që përfshijnë nënsisteme më të vogla. Dialektet ndahen në nëndialekte, ndërsa nëndialektet në grupe të folmesh. Dialekti Verior apo gegërishtja ka dy nëndialekte: **gegërishten veriore** dhe **gegërishten jugore**, që ndahen për afërsisht të lumi Mat.





Gegërishtja veriore shtrihet në të djathtë të Matit: në Mirditë, në Zadrimë, në Pukë, në Lumë, në Has, në Kukës, në Tropojë; në gjithë Kosovën, duke përfshirë edhe të folmet e rrethit të Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës; disa fshatra të qarkut të Kumanovës; në Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Shkodër, Ulqin, Krajë, Larje, Shestan me rrethina etj.

Gegërishtja jugore shtrihet në të majtë të lumit Mat: në zonat e Elbasanit, të Durrësit, të Tiranës, të Krujës, të Matit, të Lumës, të Lurës, Peshkopisë; të Dibrës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Shkupit, (shumica e fshatrave) të Kumanovës, Krushevës, Prilepit, Velesit dhe të pjesës veriore të qarkut të Strugës (Maqedoni).

Drini i Zi e ndan Strugën në dy pjesë. Në anën e majtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi flasin toskërisht (fshatrat Ladorishtë, Frëngovë, Tatesh i Epërm, Teferiç dhe Belicë e



Poshtme), ndërsa në anën e djathtë flasin gegërisht (Veleshtë, Dollogozhdë, Misllodezhdë, Koroshishtë, Livadhi, Dobovjan, Bixhovë etj.). Në qytetin e Strugës jetojnë bashkë gegë e toskë që flasin një variant dialektor të përafërt me toskërishten e me pak elemente të gegërishtes, që mund të merret si e folme kalimtare.

-  Geg. veriore
-  Geg. jugore
-  Tosk. veriore
-  Tosk. jugore



Nëndialektet ndahen në grupe të folmesh. Gegërishtja veriore ndahet në grupin e të folmeve të gegërishtes *veriperëndimore* dhe grupin e të folmeve të gegërishtes *verilindore*. Gegërishtja jugore ndahet në grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore dhe në grupin e të folmeve të Shqipërisë së Mesme. Këto emërtime, si edhe emërtimet e tjera të degëzimit dialektor, janë bërë në bazë të shtrirjes gjeografike të tyre.

Në shtrirjen e pashkëputur të shqipes dialektore, rreth dy të tretat e shqiptarëve, apo mbi 66% janë folës të gegërishtes.

Me ndarjen nëndialektore të gegërishtes, përputhen edhe disa veçori të kulturës popullore materiale. Në gegërishten veriore janë karakteristike *qeleshja sferike* (plisi) dhe *tirqit*. Në gegërishten jugore karakteristike është *qeleshja e rrafshët* (rrashtake) me dy variante: e lartë në anët e Tiranës, të Durrësit e të Kavajës dhe e ulët në zonat e tjera.




Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Përmend nëndialektet e gegërishtes dhe përkufizo shtrirjen gjeografike të tyre.
2. Cilit dialekt e nëndialekt i përket e folmja juaj?
3. A ka ndonjë dallim ndërmjet të folmes tënde dhe të folmeve përreth?
4. A hetoni ndonjë dallim midis të folurit tuaj me të folurit të gjyshit apo gjyshes?
5. Shkruani dallimet kryesore ndërmjet të të folmes suaj dhe gjuhës standarde.
6. Dëgjoni incizime zanore në disa pika dialektore të nëndialektit të gegërishtes në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
7. Tektin e mëposhtëm shndërrojeni në variantin e shqipes standarde:

Kishte qonun ni qak ene i kishte çōumun gjemt (vocat) n’mal për dru:// Ata i kishin thon: “O ba:b/ po t’na prēishet ç’errja ne s’dim ta gjobisim”// Baba u ka thon: “Fkateni nevojën ene dē e gjodisni”// Ata kur kan shkōumun n’mal o prēishun ç’errja// Njoni pi gjēmve ka dalun ene ka bërtētit: ”Oj nevo:j/ ajde t’na e gjodisish ç’erren!”// Amon, iç kërkush s’erdhi/ Mēsëndēi ata kadal - kadal nēisēn vet ta gjodisin// Kur ishin kthēimun n’shpēi i kishin thon babēs vet: “Ce na rrene o

ba:b/ na thae ta fkasim nevojën t'na e gjodise ç'erren/ ene ne fkatëm e fkatëm amon kërkush s'erdh"// Ater aj u tha: "Epo qajo osht nevoja, kur s'ka kush dët ndëife a ke zor/ ater msoesh ene e sos pounën vet"//

3.3. TOSKËRISHTJA DHE NËNDIALEKTET E SAJ



Edhe toskërishtja ka dy nëndialekte: **toskërishten veriore** dhe **toskërishten jugore**. Kufi natyror i ndarjes së këtyre dy nëndialekteve merret lumi Vjosa. Toskërishtja veriore shtrihet në krahun e djathtë të Vjosës: në rrethet e Beratit, të Fierit, të Skraparit, të Pogradecit, të Korçës, të Kolonjës, në zonat e Përmetit e të Tepelenës që ndodhen në krahun e djathtë të Vjosës, në Vlorë (Shqipëri); në Manastir, Prespë, Resnjë dhe në pjesën jugore të Strugës (Maqedoni).

Toskërishtja jugore shtrihet në krahun e majtë të Vjosës: përfshin të folmet e Labërisë e të krahinave të rrethit të Gjirokastrës; të folmet e Konispolit dhe ato të Çamërisë, që shtrihen deri te Gjiri i Prevezës (Greqi).

Toskërishtja veriore për nga veçoritë gjuhësore është më unike sesa nëndialektet e tjera, prandaj këtu vështirë se mund të bëhen nëndarje të tjera. Megjithëkëtë, edhe në të folmet e

toskërishtes veriore gjuhëtarët dallojnë: grupin e të folmeve të anës së Korçës dhe grupin e të folmeve të anës së Beratit.

Në nëndialektin e toskërishtes jugore dallohen dy grupe të folmesh: labërishtja dhe çamërishtja, që gjeografikisht ndahen te lumi i Shalësit.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Sa nëndialekte ka toskërishtja dhe ku shtrihen ato?
2. Me ç'faktorë jashtëgjuhësorë shpjegohet ndarja e sotme dialektore e shqipes? Ç'mund të thoni për faktorin historik?
3. Kur e mori formën përfundimtare degëzimi i sotëm dialektor i shqipes?
4. Si e parashikoni fatin e varianteve territoriale të shqipes në të ardhmen?
5. Shikojeni me vëmendje një episodë të programit televiziv "O sa mirë". Aktorët nga vise të ndryshme shqiptare flasin në të folmen e vendit të tyre. Shënoni disa nga elementet e përbashkëta gjuhësore si dhe dallimet midis aktorëve krahinash të ndryshme.

3.4. NDIKIMI I FAKTORËVE JASHTËGJUHËSORË

NË NDARJEN DIALEKTORE TË SHQIPES

Dihet se ndarja dialektore lidhet me natyrën e vendit dhe me historinë e tij. Degëzimi i shqipes në dialekte, nëndialekte e grupe të folmesh lidhet ngushtë me konfiguracionin tokësor të vendit si dhe me faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë. Në pikëpamje topografike, gegëria është më malore sesa toskëria. Në rrafshira njerëzit e kanë më lehtë të lëvizin, të takohen e të komunikojnë. Përveç kësaj, jugu ka qenë gjithmonë më shumë vend kalimi (transiti) sesa gegëria: prandaj dialektet na paraqiten këtu më të rrafshuara, më të njëjllota.

Edhe prof. Eqrem Çabej, ndarjen dialektore të shqipes, krahas ndikimit të faktorëve historikë e politikë, e sheh edhe si pasojë të natyrës gjeografike të trojeve shqiptare. Sipas tij, zonat në të cilat flitet gegërishtja janë më malore sesa zonat në të cilat flitet toskërishtja. Kjo, sipas tij, ka ndikuar edhe në mënyrën e jetesës. Në zonat në të cilat flitet gegërishtja, në të kaluarën vendbanimet kanë qenë më të shpërndara, ndërkaq në zonat në të cilat flitet toskërishtja ka pasur më shumë fshatra e vendbanime të përqendruara. Kjo gjendje ka ndikuar edhe në dendurinë e kontakteve midis banorëve të atyre zonave (Çabej, 1976: 95). Ndërkaq, Gjinari dhe Shkurtaç theksojnë se tiparet e ndryshme gjuhësore, të cilat i dallojnë dialektet e shqipes kanë lindur që nga Mesjeta, nuk janë aq të mëdha. Sipas këtyre autorëve, kjo nuk është pasojë e shtrirjes së vogël gjeografike të shqipes, sepse largësitë gjeografike nuk e përcaktojnë largimin e dialekteve, por fakti që dobësimi i kontakteve midis grupeve të popullsisë shqiptare dhe koha e zgjatjes së këtij dobësimi kontaktesh nuk ka qenë në atë masë sa ta thellonin largimin e dialekteve të shqipes (Gjinari-Shkurtaç, 2003: 164-165).

Një element tjetër që mund të ketë luajtur rol në zhvillimin divergjent të dialekteve është edhe pushtimi i vazhdueshëm i trojeve shqiptare. Në rrethana të tilla, te shqiptarët, hiq disa

etapa afatshkurtra, siç ishte periudha e Skënderbeut, nuk ka mundur të zhvillohet ndonjë formacion shtetëror, i cili ka mundur të ushtrojë pushtet të centralizuar, që do t'i shkonte për shtati edhe proceseve të afrimit gjuhësor. Në fakt, shqipja dhe dialektet e saj, pikërisht për shkak të rrethanave politike, të shumtën e rasteve ka qenë gjuhë e subordinuar ndaj një gjuhe tjetër superiore (latinishtja, turqishtja etj.). Mosekzistenca e një formacion shtetëror shqiptar përgjatë një periudhe të qëndrueshme më afatgjate historike, ka bërë që shqipja të jetë gjithmonë gjuhë e domeneve private familjare dhe e rretheve ngushta shoqërore, ndërkohë që gjuhë e domeneve zyrtare ka qenë ndonjë gjuhë tjetër (Shkumbin Munishi, Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur, në <http://linguasocio.blogspot.com>).

Një faktor i dytë me rëndësi që ka kontribuar në formimin e dialekteve është elementi njeri, mënyra e jetesës së banorëve. Marrë në përgjithësi katundet e gegërisë kanë qenë me shtëpi të tipit të shpërndarë, ndërsa toskëria me fshatra me shtëpi të tipit të dendur. Në veri malësorët kanë jetuar e jetojnë edhe sot në shtëpi të shpërndara, të izoluara, larg njëra nga tjetra, në vende ku rrallëherë të shpinte një rrugë; prandaj ky ka qenë i izoluar edhe në pikëpamje të gjuhës (Çabej, 1976: 95), si nga të folmet e tjera përreth, ashtu edhe nga ndikimi i gjuhëve të huaja në takim dhe nga gjuhët e pushtuesve. Në Toskëri ka pasur gjithë kohën më shumë katunde me shtëpi të grumbulluara tok. Ka pasur edhe më shumë qytete e tregje; dhe kjo duhet të ketë qenë kështu edhe në kohë të vjetër: kështu dimë se më vitin 168 p. e. s. konsulli romak Paul Emili (Aemilius Paullus) djegi afro 70 qytete në Epir. S'ka dyshim se kjo jetë sociale, mënyra e jetesës ka lënë gjurmët e saj në gjuhë; prandaj në Toskëri janë gatuar zona dialektore më të gjera e të njëllojta.

Po ndarja dialektore e një gjuhe lidhet ngushtë edhe me historinë e vendit. Me cilën trevë ka shkuar një krahinë në pikëpamje politike e administrative, me të afrohet edhe në të folurit. Nga ka qenë orientuar jeta dhe politika, andej është drejtuar edhe gjuha. Edhe këtë gjë ne e vëmë re në dialektet e shqipes. Duke përmbledhur, ne shohim se elementi tokë, elementi njeri dhe historia janë faktorë me rëndësi në ndarjen dialektore të një gjuhe (Çabej, 1976 : 95).

Faktorët e sapopërmendur kanë bërë që gegët të jenë më të izoluar ndërmjet veti, të ndarë në krahina dhe rrjedhimisht të shfaqen më shumë larmi gjuhësore e etnografike. Izolimi, veçimi, ndarja e popullatës gjithnjë ka për rrjedhojë shfaqjen e elementeve të veçanta që dallon njërin grup nga tjetri, përfshirë edhe gjuhën e tyre. Pra, edhe natyra e vendit, formacioni i tokës ka ndikuar thellësisht si në mënyrën e jetesës së banorëve, ashtu edhe në gjuhën e tyre.

Pra, faktorët jashtëgjuhësorë, si ata historikë, gjeografikë e shoqërorë kanë ndikuar në ndarjen dialektore të shqipes, ashtu siç na paraqitet sot. Shqiptarët gjatë historisë së tyre nuk kanë formuar kurrë një njësi politike.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Cilët faktorë jashtëgjuhësorë kanë ndikuar në ndarjen dialektore të shqipes?
2. Si mund të shpjegosh ndikimin e faktorëve historikë në ndarjen dialektore të shqipes?
3. A ka ndikuar edhe konfiguracioni tokësor në degëzimin dialektor të shqipes? Si e shpjegoni këtë?

4. Si ka ndikuar ndarja e shqiptarëve në shumë shtete në Ballkan në variantet krahinore të shqipes?

3.5. DIALEKTET NË RRJEDHË TË KOHËS

Gjuha shqipe, prej ndryshimeve që ka pësuar në rrjedhë të kohës në krahina të ndryshme, ka arritur të ketë sot një degëzim me dy dialekte, secili dialekt me dy nëndialekte dhe me grupe të folmesh të shkallëve të ndryshme. Zbërthimi dialektor i sotëm i shqipes është përfundimi i një diferencimi, i kryer shkallë-shkallë në rrymë të kohëve. Është vërtetuar plotësisht se pak shekuj më parë, dy dialektet tona në shumë pika qëndronin më afër njëra-tjetrës sesa sot. Bie fjala, gjuha e një autori të Veriut (si ajo e Gjon Buzukut) dhe e një autori të Jugut (si gjuha e Lekë Matrëngës) kanë më shumë tipare të përbashkëta ndërmjet tyre sesa dialektet në gjendjen e sotme.

Për arsye të ndryshme historike, ekonomike e sociale, me mungesën e një organizimi shtetëror të mirëfilltë e të një qarkullimi rrugor të rregullt, me kontaktet e pakta ndërkrainore etj., në katër-pesë shekujt e fundit dialektet e shqipes patën një zhvillim më shumë divergjent sesa konvergjent. Laryshia gjuhësore në shtrirjen territoriale të një populli është dukuri e të gjitha gjuhëve të botës.

Megjithë ndryshimet dialektore që kanë ndodhur në të kaluarën, elementet e përbashkëta në dialektet e shqipes janë të shumta dhe shqipja është ruajtur si njësi gjuhësore, me një popull unik që e flet atë gjuhë. Tani mbizotëron afrimi gjuhësor i të folmeve shqipe. Sot ne kemi një gjuhë të vetme standarde për gjithë kombin shqiptar, që ka për bazë elementet e përbashkëta të të dy dialekteve. Shqipja standarde është bërë normë gjuhësore ideale për të gjithë ata që shkruajnë dhe flasin shqip. Me shtrirjen mbarëkombëtare të gjuhës standarde, dallimet gjuhësore ndër shqiptarët gjithnjë po zvogëlohen.

Dialektet janë forma të ndryshme që ka marrë i njëjti brumë gjuhësor i një bashkësie gjatë kohëve në territore të ndryshme. Dialektet janë kategori historike, rezultat i zhvillimit të një gjuhe në formacionet e mëparshme të shoqërisë para formimit të kombit.

Siç dihet, në gjuhë veprojnë njëkohësisht procesi i afrimit (konvergjencës) dhe i largimit (divergjencës) dialektor me mbizotërim herë të njërit proces e herë të tjetrit. Në shoqërinë shqiptare në formacionet para formimit të kombit ka mbizotëruar largimi dialektor, ndërsa pas formimit të kombit, sidomos kohëve të fundit, mbizotëron rrafshimi dhe njësimi i formave dialektore.

Është përdëftuar se dikur shqipja ka qenë më unike, por në rrjedhë të kohës dallimet ndërmjet të folmeve shqipe janë thelluar. Sot në të folmet e shqipes përgjithësisht dallojmë tipare që kanë lindur gjatë mesjetës dhe një numër të vogël nga ato që vijnë prej periudhës antike. Shumica e tipareve dalluese më të reja, ato që kanë lindur këto dy-tre ose edhe katër shekujt e fundit, kanë shtrirje gjeografike më të kufizuara.

Në ndarjen dialektore të shqipes kanë ndikuar faktorët historikë, shoqërorë, gjeografikë, ekonomikë etj. Ndarja e vjetër administrative në provinca të mëdha të administratës pushtuese romake, prej shekullit I-VI të erës sonë paraqet disa përputhje të degëzimit dialektor të shqipes. Kështu, gegërishtja veriore deri te lumi i Matit të kujton pikërisht provincën e Prevalit (shek. I-IV i erës sonë). Toskërishtja jugore që arrin deri te Vjosa përputhet me territorin e Epirit (shek. I-

III) dhe Epirit të Vjetër (shek. IV-VI). Të folmet e toskërishtes veriore dhe ato të gegërishtes jugore shtrihen sot në territorin e provincës Makedonia (shek. I-III) dhe të Epirit të Ri (shek. IV-VI).

Një çështje me rëndësi është që të dimë se **kur është bërë ndarja dialektore e sotme e shqipës**. Edhe këtë gjë ne nuk mund ta ndjekim historikisht, siç jemi në gjendje ta bëjmë bie fjala në greqishten, sepse shqipja është e dokumentuar vonë. Përgjithësisht mund të themi që ndarja e sotme nuk është shumë e vjetër. Po t'i hedhim një sy shqipës së fillimit të kohës së re, ne shohim se në atë kohë gegërishtja me toskërishten nuk ishin aq të ndara nga njëra-tjetra sa janë sot. Këtë ne e shohim kur krahasojmë gjuhën e Buzukut të 1555-ës me gjuhën e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, që janë mbetje e toskërishtes nga mbarimi i mesjetës. Sadoqë këto janë të folme toske, dhe toske jugore, ndërsa Buzuku është geg i Veriut, ne me gjithë ndryshimet që shohim, gjejmë prapëseprapë mjaft afëri në mes tyre. Kjo tregon se të dy dialektet aso kohe nuk ishin larguar aq shumë sa sot (Çabej, 1976: 98).

Ndarja e dy dialekteve nga njëra-tjetra nuk duhet të jetë bërë përnjëherë. Procesi i kristalizimit të tyre si dialekte nuk qe i përnjëhershëm, po u krye shkallë-shkallë. Ato pika, në të cilat ndryshojnë sot gegërishtja me toskërishten, duhet të jenë zhvilluar një pas një. Njëri ndryshim leu më parë, tjetri më vonë. Në këtë lëmë duhet bërë pra një farë kronologjie. Kështu, ndërrimi i **vo**-së në **va**- (votër - vatër) duhet të ketë ngjarë mjaft herët, sepse formën **vatra** e gjejmë edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit, ku duhet të ketë shkuar që moti. Më vonë duhet të ketë dalë rotacizmi në toskërishte, po edhe ky përpara shekullit XIV e XV, sepse e gjejmë të kryer te shqiptarët e Greqisë e të Italisë. Më i ri është së paku në gegërishte ndërrimi i togut **uo** në **ua, ue**; meqë togun zanor **uo** e gjejmë akoma te Buzuku e te Budi (Çabej, 1976: 98).

Duke u ngjitur prapa në histori të dialekteve, ne mbërrim në një periudë të shqipës, në të cilën gjuha nuk ka pasur dy forma dialektore të ndryshme që ka sot: nuk ka pasur **va**- në toskërishte, po kudo **vo**-; as rotacizëm, po kudo **-n**- intervokalike; jo **ua, ue**, po **uo**, më parë **ou** a ndonjë tjetër trajtë fonetike të përbashkët. Rotacizmi në toskërishte duhet të ketë përfunduar nga shek. VII-VIII i erës së re.

Atëherë na del pyetja: Mos ka ekzistuar dikur një shqipe unitare dhe e përbashkët, një shqipe e pandarë në dialekte? Kjo çështje e raportit historik të gjuhëve unitare të pandara ndaj dialekteve të tyre është një nga pikat e vështira në lëmë të gjuhësisë historike. Kësaj pyetjeje është aq më vështirë t'i përgjigjemi në fushë të shqipës, sepse ne historinë e vjetër të kësaj gjuhe nuk e dimë. Po eksperiencia na mëson se gjuhë të pandarë në dialekte nuk ka. Sidomos në shqipe është zor të mendojmë që të ketë ekzistuar një gjuhë e vjetër unitare dhe e pandarë në dialekte. Shqiptarët gjatë historisë së tyre nuk kanë formuar kurrë një njësi politike. Përkundrazi, ndarja e popullit në fise, fuqitë centrifugale të vendit, grindjet e shpeshta nga brenda na bëjnë të pranojmë që diferencime dialektore ka pasur në shqipen edhe më parë. Veçse mund të mendojmë që situata gjuhësore ka qenë kjo: Shqipja do të ketë qenë edhe më parë e ndarë në dialekte, po si duket jo në mënyrën që na paraqitet e ndarë sot. Ndarja dialektore do të ketë ekzistuar, po do të ketë qenë ndonjë tjetër (Çabej, 1976: 98).

Ka tri mendime kryesore përsa i përket kronologjisë së ndarjes mes gegërishtes e toskërishtes: 1. ka përfunduar para kontaktit me gjuhët sllave (Gjinari, 1989); 2. ka filluar përpara, por ka vazhduar edhe gjatë kontaktit me gjuhët sllave (Hamp, 1994); dhe 3. ka filluar pas kontaktit me gjuhët sllave (Janson, 1986).

Lidhur me këtë çështje, pjesa më e madhe e gjuhëtarëve shqiptarë përkrahin tezën se shqipja kishte filluar të degëzohej në 2-3 shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë, për t'u shfaqur me ndarje të qartë në dy dialekte nga fundi i këtij mijëvjeçari (mijëvjeçarit të parë të erës sonë). Degëzimi dialektor i shqipes, ashtu siç e kemi të ruajtur deri në ditët e sotme: me dy dialekte, dialektet me nga dy nëndialekte, nëndialektet me nga dy grupe të folmesh; formën përfundimtare e mori nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX, përkatësisht para Lëvizjes sonë Kombëtare. Në periudhën pas Rilindjes e deri më tani mbizotëron procesi i afrimit të dialekteve. Gegërishtja dhe toskërishtja janë degëzuar për së paku në mijëvjeçarin e parë të erës sonë (http://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_shqipe).



“Fjalori enciklopedik shqiptar 1”, Tiranë, 2008, f. 91-92 për arbërishten na siguron këto të dhëna: **Arbërisht**/e,-ja është emri i parë i gjuhës shqipe në mesjetën e hershme. Kështu e quajnë atë edhe sot Arbëreshët e Italisë dhe Arbëreshët e Greqisë. Fjalët *arbërisht(e)* dhe (gjuhë) *e arbëreshe* (a *e arbëreshe*) janë formuar me prapashtesën *-isht(e)*, përkatësisht *-esh(e)* nga emri i hershëm etnik i popullit dhe i vendit tonë, *Arbër* a *Arbën* (nga Alban-ët, fis ilir nga i cili morën emrin e hershëm Shqiptarët. Fisi *Albanoi* dhe qyteti *Albanopolis* përmenden për të parën herë në shek. II të e. r. nga Ptolomeu, që mendohet të jetë Zgërdheshi i sotëm afër Krujës. Në mesjetë njihet edhe varianti *Arban*, që ka qenë emri etnik i Shqiptarëve në mesjetë). Në Shqipëri gjatë tre-katër shekujve të fundit këto fjalë janë zëvendësuar krejt nga fjalët *shqip* dhe (gjuha) *shqipe*, prej të cilave janë formuar edhe emrat e prejardhur *Shqiptar* e *Shqipëri*. Së pari, del e dokumentuar ndajfolja *shqip*, e cila ndeshet një herë në “Mesharin” e Gjon Buzukut dhe katër herë në veprat e Pjetër Budit. Por shkrimtarët e vjetër të Veriut përdorin zakonisht (gjuha) *e arbëneshe*, ashtu si edhe shkrimtarët e vjetër arbëreshë të Italisë (*gjuha arbëreshe*).

Principatat dhe shtetet e para feudale shqiptare të kohës së sundimit bizantin (shek. XIII-XIV) shtriheshin përafërsisht brenda kufijve të këtyre provincave të dikurshme. Kështu, Balshajt

zotëronin në Veri dhe arrinin deri te Mati. Topiajt që në fillim sundonin në qendër (prej Matit e deri në Shkumbin), më vonë u shtrinë në Jug deri te Vjosa. Shpatajt zotëronin Jugun, duke filluar prej bregut të majtë të Vjosës.

Nga fundi i shek. XVIII në dy krahinat e mëdha shihen përpjekjet e Ali pashë Tepelenës në Jug dhe Bushatlinjve në Veri për të formuar dy shtete feudale të shkëputura nga Turqia.

Në “Fjalorin enciklopedik shqiptar 1”, Tiranë, 2008, f. 464-466 për dialektet e gjuhës shqipe gjejmë këtë tekst: Ndër tiparet dalluese të dy dialekteve, si më të vjetra cilësohen rotacizmi i toskërishtes, sistemi i zanoreve hundore të gegërishtes, zanorja /ë/ e theksuar e toskërishtes e ndonjë tjetër. Këto tipare janë të shekujve të fundit të mijëvjeçarit të parë. Gjatë mesjetës u thellua ndarja e dy dialekteve duke lindur tipare të tjera të reja. Disa nga veçoritë dialektore të shqipes u formuan sidomos këta tre-katër shekujt e fundit. Por krahas procesit të dallimit, sidomos që nga gjysma e dytë e shek. XIX, zhvillohen edhe dukuri të kundërta të rrafshimit të këtyre dallimeve dialektore, gjë që lidhet me proceset e reja ekonomiko-shoqërore e kulturore. Dallimet midis dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha: albanologë të njohur si H. Pedersen, M. Lambertzi etj., kanë vënë re se ato janë më të vogla sesa dallimet dialektore në disa gjuhë të tjera të Europës, si italishtja, gjermanishtja etj... Në kushte krejt të reja historike, shoqërore, ekonomike e kulturore që u krijuan sidomos në gjysmën e dytë të shek. XX nën ndikimin e gjuhës letrare kombëtare, tiparet dialektore po shkojnë shkallë-shkallë drejt rruhdjes.

Nuk kemi të drejtë të parashtrijmë pyetjen se cili dialekt është më i vjetër: gegërishtja ose toskërishtja, meqë na mungojnë dokumente të shkruara nga koha e vjetër dhe e mesme. Më e drejtë është të mendojmë se të dy dialektet e shqipes janë të njëkohshme. Se në të kaluarën shqipja ka qenë më unike dhe në rrjedhë të kohës ajo u degëzua dhe arriti në gjendjen e sotme. Por, lidhur me çështjen se cili dialekt ka ruajtur më mirë format e vjetra të shqipes e cili dialekt ka bërë inovacione, mund të thuhet se në shumë dukuri gjuhësore gegërishtja na del më ruajtëse (konservative) se toskërishtja. Në disa pika të tjera, toskërishtja ka ruajtur forma të moçme, ndërsa gegërishtja ka inovuar.

Ndër **dukuritë gjuhësore të moçme të shqipes**, që **i ka ruajtur gegërishtja** janë:

1. hundorësia e zanoreve;
2. ruajtja e [-n-]-së ndërzanore (pëni, sÿni, drÿni, lakna, mullÿni);
3. ruajtja e paskajores: parafjala me + pjesore e reduktuar, sipas tipit *me punue* ruajtja e togut *vo* në krye të fjalës (në toskërishte *va*);
4. ruajtja e zëshmërisë së bashkëtingëlloreve të zëshme në fundin absolut të fjalës (vend, zog, breg, bredh, murriz).

Toskërishtja është konservative në:

1. ruajtjen e /ë/-së fundore, ndërsa gegërishtja e ka bjerrë, duke bërë zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse (tosk. nënë, geg. nã:n);
2. ruajtjen e togjeve të zanoreve [ua, ie, ye] të cilat gegërishtja i monoftongon në zanore të gjatë të parë të togut (tosk. *dua* - geg. *due* ose *du::*; tosk. *diell* - geg. *di:ll*; tosk. *fyell* - geg. *fy:ll*);
3. ruajtjen e togjeve të bashkëtingëlloreve [mb, nd]: tosk. *dhëmb* - geg. *dham*, tosk. *mbaj* - geg. *maj*.

Toskërishtja është inovuese (risimtare) në:

1. shndërrimin e [-n-]-së ndërzanore të mbarë shqipes së vjetër në [-r-] (rotacizëm): tosk. *syri* - geg. *syni*, tosk. *peri* - geg. *peni*;
2. shndërrimin e [ã]-së hundore të shqipes së moçme në [ë] të theksuar: *hãnë* - *hënë*;
3. zëvendësimin e paskajores së moçme me + pjesore: *me punue* me paskajoren toske *për të punuar* ose lidhoren *të punoj*;
4. shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fundin absolut të fjalës (vënt, zok, brek, breth, murris).

Gjatë evolusionit historik të gjuhës shqipe krahas zhvillimit konvergjent (qendërzues, përbashkues, rrafshues) të të dy dialekteve të saj, kanë vepruar edhe procese divergjente (qendërikëse, larguese, dalluese). Në periudhën e mesjetës dhe në periudhën para Rilindjes kombëtare (d.m.th. deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX) ka mbizotëruar divergjenca, si pasojë kryesisht e faktorëve jashtëgjuhësorë. Midis këtyre faktorëve duhen përmendur sidomos copëzimi feudal dhe sundimi i huaj, që kanë penguar marrëdhëniet e shumanshme ndërmjet trevave veriore dhe jugore, e këto i vështirësonte edhe pozicioni i këtyre trevave.

Periudha e shqipes së sotme, që nis që nga Lëvizja Kombëtare e Rilindjes, karakterizohet kryesisht nga zhvillimi konvergjent i dy dialekteve si dhe i shqipes së shkruar në përgjithësi. Gjatë kësaj periudhe vihet re një ndikim gjithnjë më i fuqishëm i gjuhës së shkruar mbi gjuhën e folur, çka e ka përshpejtuar procesin e afrimit ndërdialektor (Demiraj, 1988 : 210). Me ndryshimet e reja gjeopolitike në Ballkan: me hapjen e Shqipërisë ndaj Evropës, me pavarësimin e Kosovës, me përmirësimin e statusit të shqiptarëve në Maqedoni; pra me kontaktet e drejtpërdrejta, me komunikimin e përditshëm të shqiptarëve krahinash e visesh të ndryshme, me veprimin rrafshues që ka shqipja standarde nëpërmjet shkollës, mjeteve të informimit etj. etj., proceset konvergjente në shqipe janë shumë të vrullshme.

Kuptohet se konvergjenca e gjuhës dialektore do të kryhet shkallë-shkallë nën ndikimin gjithnjë e më të madh të variantit standard të shqipes si dhe rrafshimin dialektor nëpërmjet arsimimit, mjeteve të informimit publik, kontakteve të drejtpërdrejta të shqiptarëve visesh të ndryshme (me karakter ekonomik, turistik, kulturor, sportiv, shkencor etj.), martesave krahinash të ndryshme, migrimeve fshat - qytet etj. Dihet se sa më intensive të jenë marrëdhëniet e kontaktet midis shqiptarëve, aq më i fuqishëm do të jetë procesi i njësimimit të shqipes. Sa më të izoluar të jemi, për aq do të dallohemi edhe gjuhësisht. Sa më tok që jemi, për aq do të flasim njëllëj. Në procesin e integritetit të unitetit gjuhësor e kombëtar, rol vendimtar ka shkalla e arsimimit, niveli i ngritjes sonë kulturore e qytetëruese. **Se në ç'rrugë do të ecim në të ardhmen, në rrugën e përbashkimit apo të largimit, varet prej nesh.**



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Shqipja dialektore dikur ka qenë më unike apo me dallime më të mëdha sesa sot?
2. Krahasoni gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë me gjuhën e shkrimtarëve të hershëm jugorë. Çfarë do të konstatojë?
3. Kur e mori formën përfundimtare degëzimi i sotëm dialektor i shqipes?
4. Cilat dukuri gjuhësore dalluese ndërmjet dy dialekteve të shqipes janë më të hershme, cilat janë të Mesjetës e cilat janë të vonshme?
5. Cili dialekt ka ruajtur më mirë format e vjetra të shqipes e cili dialekt ka bërë inovacione?

6. Në cilat periudha historike ka mbizotëruar konvergjenca dialektore e në cilat periudha divergjenca dialektore e shqipes?
7. Çfarë rrugë ka marrë shqipja dialektore me ndryshimet e reja gjeopolitike në Ballkan?
8. Çfarë rrugë do të ndjekë në të ardhmen shqipja dialektore?
9. Pse themi se gjuha e njësuar standarde shqipe ka rëndësi parësore për ekzistencën e kombit?
10. Si e shpjegon mendimin se: rruga e përbashkimit apo e veçimit gjuhësor varet prej nesh?

3.6. PASQYRË E STUDIMEVE DIALEKTORE TË SHQIPES

Dialektologjia, si disiplinë gjuhësore e veçantë, i ka fillimet e veta aty nga fundi i shekullit XIX, në Gjermani dhe Francë. Tani më u kuptua se dialektologjia shqiptare është degë e gjuhësisë që merret me studimin e dialekteve dhe të folmeve të shqipes. Dialektologjia shqiptare fillimet i ka që nga mesi i shek. XIX. Deri në vitet '50 të shek. XX të dhënat për dialektet e shqipes janë nxjerrë kryesisht nga botime të ndryshme, si gramatika, fjalorë, tekste etnofolklorike etj. Gjatë kësaj periudhe u bënë disa studime të mirëfillta dialektologjike, kryesisht nga studiues të huaj, si G. Vajgandi, M. Lamerci, V. Cimohovski, K. Taljavini dhe nga studiues shqiptarë, si P. Furiqi, Gj. Pekmezi, E. Çabej. Nga fillimi i viteve '40 u ideua edhe një atlas dialektologjik i gjuhës shqipe dhe nisi puna për realizmin e tij, duke u hartuar pyetësori përkatës (1943) prej E. Çabejt (Fjalor enciklopedik shqiptar 1, Tiranë, 2008, f. 466).

Studimet dialektologjike të shqipes kanë përjetuar disa faza zhvillimi, por në përgjithësi dy prej tyre veçohen si më kryesore:

- 1) **periudha para Luftës së Dytë Botërore** dhe
- 2) **periudha pas Luftës së Dytë Botërore.**

Fazën e parë të studimeve dialektologjike të shqipes e karakterizojnë përshkrime kryesisht informative dhe të dhëna për të folmet e diasporës dhe të trevave më skajore të shqipes, pa kriter a plan të caktuar studimi, kryesisht nga gjuhëtarë të huaj. Fazën e dytë të studimeve dialektologjike e karakterizon studimi i organizuar dhe sistemor i tyre (në fillim nga Instituti i Shkencave i R. së Shqipërisë, më pas nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, sektori i Gramatikës dhe i Dialektologjisë - Tiranë), në radhë të parë i atyre të trungut apo të trojeve brenda kufijve të shtetit shqiptar dhe në trevat shqiptare me vijimësi të pandërprerë truallësore në ish-Jugosllavi.

Që nga vitet '50 gjuhëtarët shqiptarë ndërmorën një punë të organizuar, me një program të gjerë, të përcaktuar nga Sektori i gramatikës dhe i dialektologjisë i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë. Puna për plotësimin e këtij programi është drejtuar nga Mahir Domi. Janë bërë kërkime në rreth 300 pika, pothuajse në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Lënda e mbledhur është sistemuar dhe ruhet në kartotekën dhe në fonotekën e dialektologjisë. Janë hartuar nga dialektologët Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Mehmet Çeliku, Minella Totoni, Gjovalin Shkurtaj, Xheladin Gosturani, Qemal Haxhihasani, Shefqet Hoxha, Emil Lafe etj. rreth 60 skica e monografi dialektologjike që përshkruajnë më tepër tiparet dalluese të të folmeve në sistemin fonetik, gramatikor e leksikor, shumica e të cilave janë botuar në revista shkencore e në përmbledhjen "Dialektologjia shqiptare". Janë bërë gjithashtu studime për disa çështje të veçanta

të historisë së dialekteve e të ndarjes dialektore të gjuhës shqipe. U hartua teksti për shkollat e larta “Dialektologjia shqiptare” nga Jorgji Gjinar (1963, 1969, 1975) dhe më vonë një variant më i gjerë i tij në bashkëpunim me Gjovalin Shkurtajn (1997, 2003).


Me studime dialektore për të folmet në Shqipëri, përveç gjuhëtarëve të përmendur që janë ajka e dialektologjisë shqiptare, janë marrë edhe jo pak studiues të tjerë, si Spiro Floqi (për të folmen e Dangëllisë, për pyetësin dialektor), Mehmet Çeliku (për të folmen e Kavajës, të Dumresë, të Shpatit), Jup Kastrati (e folmja e Thethit), Frano Luli (për të folmen e Postribës), Jani Thomai (e folmja e Semanit, leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme), Sh. Hoxha (për të folmen e Vilë-Kalisit të Lumës), Nexhip Mërkuri (e folmja e Përmetit), Haredin Xhaferi (e folmja e Tomoricës) etj., si dhe studiuese të reja në këndvështrime të ndryshme: Aljula Jubani, Gladiola Elezi - Durmishi, Helena Grillo (Mukli), Edlira Troplini - Abdurrahmani etj.

Kërkime dhe studime dialektologjike janë bërë edhe për të folmet shqipe në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Është mbledhur material dialektor pothuaj në të gjithë territorin ku flitet shqipja, por puna e vjeljes së materialit dialektor dhe e studimit të të folmeve nuk duhet ndërprerë. Kërkimet dialektore në Kosovë janë organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës së pari nën drejtimin e Idriz Ajetit e më pas edhe nga studiues të tjerë. Për të folmet e Kosovës është vjelë material burimor, janë botuar jo pak fjalorë të këtyre të folmeve, monografi të veçanta dhe skica dialektore si dhe studime të tjera gjuhësore me vlerë nga Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Hilmi Agani, Mehdi Bardhi, Latif Mulaku, Mehmet Halimi, Imri Badallaj, Fadil Raka, Mehmet Ahmetaj, Abdullah Zymberi, Shaqir Berani, Ragip Mulaku, Zijadin Munishi, Tafil Kelmendi, Bahtijar Kryeziu, Naser Pajaziti, Mehmet Topalli, Adem Hajdaraj, Ismet Lecaj, Bajram Mehmetaj, Bislim Pireva, Vediha Topçiu, Sidorela Doli - Kryeziu etj. Me studime gjuhësore në fushë të shqipes dallohen edhe Shefkije Islamaj, Sala Ahmetaj, Sedat Kuçi, Begzad Baliu, Bardh Rugova, Hava Qyqalla, Rrahman Paçarizi, Shkumbin Munishi, Linditë Sejdiu - Rugova, Haki Hysenaj, Blertë Ismajli etj.

Për studime dialektore në Mal të Zi shquhen: Ruzhdi Ushaku, Mehmet Ahmetaj, Gj. Hasanaj, Marjan Lulgjuraj etj.; për të folmet Arbëreshe të Italisë: Eqrem Çabej, Gerhard Rolfs (studiues gjerman), Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaj, M. Camaj, Françesko Altimari, M. Mandala, Françesko Solano, A. Bellushi, L. Savoia, P. Siciliano, E. Giordano, A. Guzzetta, Rexhep Zllatku (Me arbëreshët) etj.

Për dialektologjinë shqiptare dhe historinë e saj janë me rëndësi sidomos kërkimet dhe studimet për të folmet arbëreshe të Italisë e të Greqisë, të Borgo Ericos, të Mandricës dhe të Ukrainës, të kryera nga studiues shqiptarë, arbëreshë dhe albanologë të huaj, si Eqrem Çabej, Erik Hemp, Martin Camaj, Karlo Taljavini, K. Hebler, H. J. Zase, T. Johalas, F. Solano, F. Altimari, L. Savoia, Gj. Shkurtaj, Dh. Shuteriqi, B. Sokolova, I. Voronina, Dh. Domosileckaja, L. Sharapova etj. Pas këtij hetimi të përgjithshëm u ndërmor hartimi i Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe.

“Dialektologjia shqiptare” është seri me përmbledhje studimesh dialektologjike që botohet prej vitit 1971 nga sektori i gramatikës dhe i dialektologjisë i Institutit të Gjuhësisë dhe



të Letërsisë. Kanë dalë 7 vëllime (1971, 1974, 1975, 1983, 1984, 1987, 2005) në të cilat janë botuar përshkrime dialektologjike të plota e të pjesshme (për fushat e fonetikës, morfologjisë, sintaksës, leksikut dialektor) në formë skicash e monografish, si dhe studime artikuj për çështje të ndryshme të dialektologjisë, për marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën letrare, si dhe studime nga lëmi i dialektologjisë historike; pyetëtori i Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe dhe pyetësorë të tjerë për mbledhjen e materialit dialektor; pyetëtori i mbledhjes së toponimisë shqiptare dhe ndihmesa e materiale nga fusha e onomastikës si dhe recensione për botime të ndryshme dialektologjike.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Cilat janë dy fazat kryesore të zhvillimit të studimeve diaketore të shqipes? Çfarë i karakterizon ato?
2. Thoni disa nga albanologët e huaj dhe ndihmesën e tyre për studimet shqiptare.
3. Cilët gjuhëtarë shquhen me studimet dialektore në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi e në diasporë?
4. Në hyrjen e Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe, vëllimi I, Napoli 2007, nga faqja 12-16 është bërë një vështrim i hollësishëm e me vlerë mbi dialektologjinë shqiptare. Lexojeni atë.

3.7. GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E VËZHGIMEVE DIALEKTORE NË MAQEDONI

Të folmet shqipe të Maqedonisë kanë tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të huaj dhe vendës. I pari ndër të huajt që flet për të folmet shqipe në Maqedoni është albanologu gjerman Jochan Georg Hahn, në veprën *Albanesische Studien* (Studime shqiptare, 1854). Norbert Jokli mbledhi material dialektor edhe nga të folmet shqipe të Maqedonisë, por ai nuk u botua. Më 1925 S. Milladenovi botoi artikullin *Vërejtje mbi shqiptarët dhe shqipen në Maqedoninë Veriore dhe në Serbinë e Vjetër*. Më pas Ahmet Imami më vitin 1930 jep disa të dhëna për të folmen e Dibrës. Petar Skoku më vitin 1941 botoi punimin *“Hulumtime gjuhësore për popullsinë joslave të fushëgropës së Shkupit*. Më 1942 Carlo Tagliavini shkroi skicën *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*.

Pas Luftës së Dytë Botërore për të folmet shqipe në Maqedoni janë shkruar mbi 40 skica e monografi dialektore. Ndhimesë të madhe për përshkrimin e këtyre të folmeve kanë dhënë: Abedin Zenku, Lulzim Aliu (për të folmen e Kërçovës), A. Selimi (për të folmen e Zajazit të Kërçovës), I. Hyseni (për Dervenin e Tetovës), Petro Janura (për Pollogun e Gostivarit), Esat Hoxha (për të folmen toske të Strugës), Naim Basha (të folmen e Dibrës), Fadil Sylejmani (të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës), Remzi Nesimi (të folmen e Tetovës dhe të Dervenit), Qemal Murati (të folmen e Tuhinit të Kërçovës), Haki Ymeri (të folmen e Kumanovës dhe të

Karshiakës së Shkupit), Zihni Osmani (të folmen e Prespës dhe të Manastirit), Sefedin Haruni (për të folmen e Gostivarit), Fehim Reçani (të folmen e Pollogut), Agim Poloska (të folmen e Prespës), Asllan Hamiti (të folmen e Karadakut të Shkupit), Mustafa Ibrahimimi (të folmen e Prilepit dhe të Krushevës), Ajten Qamili (të folmet e Strugës, në pikëpamje diaketore, ballkanike e sociolinguistike) etj.

Janë botuar edhe disa studime përgjithësuese, si Bahri Beci *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 261-269. Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998. Zeqir Kadriu, *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2002. Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në të folmet e gegërishtes qendrore*, Shkup, 2010.

Nuk mungojnë edhe studimet për marrëdhëniet e shqipes truallsore të Maqedonisë me gjuhët e tjera, veçmas me maqedonishten (Olivera Jashar – Nasteva, Qemal Murati, Agim Poloska, Haki Ymeri, Safet Hoxha, Asllan Hamiti, Idajete Mustafa, Zekirija Ibrahimimi, Berton Sulejmani etj.). Në fushën e onomastikës po kështu janë arritur disa rezultate (Qemal Murati, Xhemaludin Idrizi, Haki Ymeri, Mustafa Ibrahimimi etj.). Janë bërë edhe disa vëzhgime sociolinguistike (Mustafa Ibrahimimi, Hamit Xhaferi, Vebi Bexheti, Zeqir Kadriu, Ajten Qamili, Izmit Durmishi, Zarije Nuredini etj.).

E quajmë të dobishme të japim një bibliografi të punimeve e të studimeve për të folmet shqipe në Maqedoni. Kjo bibliografi mund të mos jetë e plotë, ngase mund të na mungojnë të dhënat për to:

Bibliografia e punimeve dhe e studimeve për të folmet shqipe në Maqedoni:

- Abedin Zenku, *Disa karakteristika të krahinës së Kërçovës*, Jehona 3, Shkup, 1968.
- Agim Poloska, *Pasuria leksiokore në të folmen e Prespës*, Jehona, nr. 8, Shkup, 1984.
- Agim Poloska, *Vëzhgime mbi leksikon e kuzhinës në regjionin e Prespës*, Jehona, nr. 1, Shkup, 1987.
- Agim Poloska, *Лексичка интерференција на македонскиот и албанскиот дијалектен јазик*, Менора, Shkup, 1998.
- Agim Poloska, *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Asdreni, Shkup, 2003.
- A. Selimi, *Të folmet e Zajazit me disa karakteristika*, Përparimi 6, Prishtinë, 1961.
- Ajten Qamili, *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndërgjuhësor te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh*, fondi i Fakultetit të Filologjisë, Shkup, 2008.
- Ajten Qamili, *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, fondi i Fakultetit të Filologjisë, Shkup, 2012.
- Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Asllan Hamiti, *Veçoritë leksikore të të folmes së Karadakut të Shkupit*, Vjetari i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” të Shkupit, libri 26, Shkup, 200, f. 435-448.
- Asllan Hamiti, *Maqedonizmat në të folmen e shqiptarëve të Shkupit*, Shqyrtime albanologjike 2, Shkup, 1996, f. 95-100.
- Asllan Hamiti, *Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike*, Aktet – Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, vëllimi I, nr. 1, 2008.
- Asllan Hamiti, *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë*

- shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84.
- Asllan Hamiti, *Tiparet fonetike e fonologjike të të folmes së Karadakut të Shkupit*, kumtesë e Takimit V Ndërkombëtar të Alb-shkencës, më 2-5. 09. 2010, Tiranë.
- Asllan Hamiti, *Vëzhgime për leksikun e Karadakut të Shkupit*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 12-14 tetor 2010, f. 41-55.
- Asllan Hamiti, *Gjendja dhe perspektiva e studimeve gjuhësore në Maqedoni*, kumtesë në Konferencën VII Shkencore Ndërkombëtare Gjuha, Letërsia dhe Kultura Shqiptare nga Pavarësia deri sot, Tetovë, 23. 11. 2012.
- Asllan Hamiti, *Disa dukuri morfonologjike në të folmet e gegërishtes*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 31/1, Prishtinë, 2012, f. 731-737.
- Asllan Hamiti - Ajten Qamili, *Shtrirja e orientalizmeve në të folmet shqipe të Maqedonisë*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Leksikografi Tahir Dizdari dhe turkologët për shqipen”, Shkodër, 31. 01. 2013.
- Asllan Hamiti, *Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe planifikimi gjuhësor*, Konferenca e parë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2007, f. 339-346.
- Asllan Hamiti, *Mikrotoponimet dhe antroponimet e fshatit Goshincë*, Instituti Alb-Shkenca, Takimi VI Vjetor Ndërkombëtar, Prishtinë, 1-4 shtator 2011.
- Asllan Hamiti, *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Konferenca Shkencore “Reka dhe Shqiptarët e Rekës së Epërme”, Gostivar, 14 dhjetor 2013.
- Asllan Hamiti, *Prirja e defonologjizimit të zanoreve hundore në të folmet e gegërishtes*, Java e Shkencës në Kosovë 2014, Prishtinë, 13-16 maj 2014.
- Bahri Beci, *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.
- Bahri Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSh, 1962/2, 1963/3.
- Bahri Beci, *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 261-269.
- Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 39-50.
- Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985.
- Qemal Murati, *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike (SShF) 14-1984, Prishtinë, 1985.
- Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*, Logos-A, Shkup, 2003.
- Qemal Murati, *Fjalor i sllavizmave në të folmet shqiptare të Maqedonisë*, Albas, Tetovë, 2004.
- Qemal Murati, *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Seminari i Albanologjisë, 2008.
- Qemal Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- Esat Hoxha, *E folmja toske e rrethit të Strugës*, Jehona nr. 6, Shkup, 1979.
- Fadil Sylejmani, *Dukuritë fonetike në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Dituria 1, Prishtinë, 1983.
- Fadil Sylejmani, *Vokalizmi në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Gjurmime albanologjike (SShF), 1985/14 dhe 1986/15, Prishtinë.

- Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Feim Reçani, *E folmja e rrethit të Gostivarit* (punim magjistrature në dorëshkrim), Prishtinë, 1977.
- Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Haki Ymeri, *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*, Jehona 1-2, Shkup, 1982.
- Haki Ymeri, *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore* (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova-Rekës), Jehona 3, Shkup, 1994, f. 79-87.
- Haki Ymeri, *Një përkitje ndërgjuhësore ballkanike në fushë të prozodisë*, Shqyrtime albanologjike, Shkup, 1997, f. 43-50.
- Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978.
- Ismet Osmani, *Ndërrimet morfonologjike në gegërishte*, Shkup, 2010.
- Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008.
- Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 105-152.
- Lulzim Aliu, *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011.
- Mehmet Halimi, *Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 353-375.
- Mustafa Ibrahimimi, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.
- Mustafa Ibrahimimi, *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.
- Оливера Јашар - Настева, *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик VIII, кн. 2, Shkup, 1957.
- Оливера Јашар - Настева, *Албански зборови во македонските тајни јазици*, Македонски јазик IV, nr. 3, 4, 5-6, Shkup.
- Petro Janura, *Vrojtime gjuhësore (fonetike) dhe folklorike-etnografike te shqiptarët e Pollogut të Gostivarit*, Гостиварскиот крај (македонскиот, албанскиот и турскиот јазик), Gostivar, 1970.
- Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 81-152.
- Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë 2008.
- Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327-352 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Remzi Nesimi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Sefedin Haruni, *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.
- Zeqir Kadriu, *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2002.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996.
- Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997.

Përgjithësisht është konstatuar se vazhdimësia tokësore e shtrirjes së shqiptarëve në Ballkan bashkëpërputhet me vazhdimësinë gjuhësore. Nga kjo pikëpamje, të folmet shqipe në Maqedoni në mënyrë të shkallëshkallshme gërshetohen me të folmet e Shqipërisë dhe të Kosovës. Bie fjala, pjesa më e madhe e të folmeve të Kumanovës i takojnë gegërishtes qendrore, por ka edhe fshatra të këtij qarku që i përkasin gegërishtes verilindore.

Nga ana tjetër, e folmja e Elez Hanit dhe e Kaçanikut i përket gegërishtes verilindore, por pak fshatra jugorë i takojnë gegërishtes qendrore. Po kështu, të folmet e Karadakut të Shkupit, që gjenden në zonën kufitare ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës, siç janë fshatrat Bllacë dhe Tanushë, janë të folme të gegërishtes qendrore, por me plot elemente të kosovarishtes. Të folmet shqipe në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë, duke filluar nga pjesa jugore e Strugës dhe që përfshijnë Ohrin, Manastirin, Prespën dhe Resnjën janë të folme toske.

Ky shkallëzim gjuhësor me zona kalimtare nga një tip të folmesh në tipin tjetër, që më së miri mund të pasqyrohet me izoglosa e jo me kufij të prerë dialektor është një dëshmi e fuqishme gjuhësore se shqiptarët e Maqedonisë janë autoktonë dhe se me shekuj kanë jetuar e jetojnë aty. Kontinuiteti tokësor, etnik, historik e gjuhësor i shqiptarëve në Ballkan mohojnë bindshëm hipotezën e disa dashakqinjve të popullit tonë se kinse para dy-tre shekujsh paskësh pasur dyndje të mëdha popullsie nga Shqipëria në Maqedoni.

Me kalimin e viteve në studimet dialektore për të folmet shqipe në Maqedoni hetohet një përparim cilësor dhe sasior. Megjithkëtë, vështruar nga pikëpamja e përgjithshme e studimeve dialektologjike shqiptare, mund të thuhet se ne kemi ngecur pak prapa. E kemi kaluar vetëm fazën e parë, ndërsa në të ardhmen na pret edhe realizimi i fazës së dytë.

Duhet zgjeruar dhe thelluar studimet

Nuk duhen mohuar rezultatet e arritura deri më tani në përshkrimin e të folmeve shqipe në Maqedoni, me këtë edhe ndihmesën e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare. Me të dhënat e deritashme mund të merren njoftime të shkëputura nga të cilat fitohet një ide e përgjithshme për të folmet shqipe në Maqedoni, por nuk mund të përvijohen izoglosa të plota për to. Nëse jemi vetëkritik dhe nuk jemi të kënaqur me atë që kemi arritur, por gjithnjë duam të shtrojmë detyra të reja, mund të pohohet se studimet dialektologjike për të folmet shqipe të Maqedonisë i karakterizojnë përshkrime kryesisht informative, pa një kriter a plan të caktuar studimi, pra kemi të bëjmë me një njohje të pjesshme dhe josistemore, me zgjedhje rasti nga vetë studiuesit.

Në të folmet që u përshkruan nuk u vëzhguan kudo të njëjtat dukuri gjuhësore, prandaj edhe është punë mjaft e vështirë që në sajë të tyre të përfitojmë një pasqyrë të qartë të gjendjes gjuhësore të këtyre të folmeve. Nuk jepen mundësi për krahasime dhe për të nxjerrë përfundime, e aq më pak për të nxjerrë izoglosa dialektore. Edhe në tekstet përgjithësuese të Dialektologjisë shqiptare (Jorgji Gjinari: i pari më 1963, i dyti më 1969, i treti më 1975, i katërti më 1988 dhe i pesti në bashkautorësi me Gjovalin Shkurtajn, më 1997, ribotuar më vitin 2000) hetohet një mungesë e të dhënave për këto të folme.

Sipas njohurive tona, edhe në punën madhore të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, për arsye objektive e subjektive, të folmet shqipe në Maqedoni janë lënë disi pas dore, përkatësisht është vjelë material dialektor vetëm në pak pika që është pandehur se janë përfaqësuese. Sipas gjithë gjasash, autorët e Atlasit janë ballafaquar me mungesë material

burimor dhe të dhëna të nevojshme për këto të folme, aq sa disa skica e monografi dialektore janë ende në dorëshkrim, por ka nga to që duhet marrë me rezervë.

Me krijimin e kushteve të volitshme për shkollimin edhe të shqiptarëve të Maqedonisë në gjuhën amtare, si më të rëndësishme ndër to po përmendim: prej sivjet shkollimin e mesëm të detyrueshëm të të rinjve, hapjen e dy universiteteve në Tetovë, themelimin e Institutit për Trashëgimi Kulturor të Shqiptarëve në Maqedoni si dhe disa parakushteve të tjera që do të ishte mirë të siguroheshin, si të hapet një Institut Albanologjik dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve do të kemi një zgjerim, thellim dhe profesionalizëm më të madh edhe në studimet dialektore.

Mendojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha: duhet vjelë edhe më tej pasuria leksikore e frazeologjike e të folmeve tona, por duhet vëzhguar i tërë sistemi gjuhësor: ai fonetiko-fonologjik, morfologjik e sintaksor me një përkushtim e profesionalizëm më të madh si dhe me metoda bashkëkohore. Nga ana tjetër, dobiprurëse do të ishte që të thellohen studimet krahasimtare për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në kontakt, te ne sidomos me maqedonishten.

Do të ishte e udhës në Maqedoni të themelojmë një fonotekë, kartotekë dhe një laborator të fonetikës eksperimentale. Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve të Maqedonisë dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Cilët gjuhëtarë të huaj janë marrë me studimet e të folmeve shqipe në Maqedoni?
2. Cilët gjuhëtarë shqiptarë kanë shkruar monografi e artikuj për të folmet shqipe në Maqedoni?
3. Dëgjoni incizimet zanore të realizuara nga albanologu Robert Elsie në disa pika dialektore të të folmeve në Maqedoni, të postuara në: www.albanianlanguage.net
4. Cilat të folme shqipe në Maqedoni i takojnë gegërishtes e cilat toskërishtes?
5. Cilat të folme shqipe në Maqedoni i përkasin gegërishtes qendrore?
6. A dallojnë të folmet shqipe në Maqedoni nga të folmet e tjera të shqipes?
7. Çfarë dallimi kanë të folmet shqipe në Maqedoni nga të folmet e Shqipërisë në fushën e leksikut?
8. A kemi shumë fjalë sllave në këto të folme? Pse?
9. Çfarë qëndrimi duhet të kemi ndaj barbarizmave?
10. A duhet zgjeruar dhe thelluar studimet për të folmet shqipe, përfshirë edhe të folmet shqipe në Maqedoni? Pse?

11. Shikojeni dokumentarin “Dëshmi e gjallë për shqiptarët ortodoks të Rekës”, Dëshmi e gjallë për shqiptarët ortodoksë të Rekës, Branko Manolovski, realizuar nga Driton Zenku, në <http://www.youtube.com>.

3.8. HISTORIKU I LËVRIMIT TË SHQIPES

Shqipja kishte nisur të përpunohej që në mesjetë. Shkallë të lartë arriti në krijimtarinë popullore, sidomos me këngët epike. Në letërsinë e shkruar mbizotëroi stili popullor, por hetohet edhe një stil i ndikur nga gjuhët e tjera me traditë të gjatë shkrimi. Përveç veprave në gjuhën e atëhershme shqipe, janë përdorur edhe gjuhë të tjera: ose e tërë vepra është shkruar në një gjuhë më me prestigj ose huazimet (nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, italishtja, gjuhët sllave etj.) janë shfrytëzuar si mjete stilistike. Latinishtja mbeti si gjuhë e administratës afërsisht deri në shek. VII, më pas u zëvendësua nga greqishtja e mesme dhe në shek. XII në disa vise edhe nga sllavishtja. Feja ushtrohej latinisht e greqisht, sipas konfesionit të bashkësive fetare. Shkrimet e para shqipe të principatave të Arbërit dilnin nga pena e klerikëve.

Me pushtimin osman u krijua gjendje e re. Autorët e vjetër flasin qartë për nevojën që të ruhet shqipja dhe me veprat e tyre i shërbyen këtij qëllimi. Vioji edhe përdorimi i gjuhëve të huaja. Për Marin Barletin gjuhë e shkencës si kudo në Evropë ishte latinishtja, ashtu si më pas për Frang Bardhin; kurse për Teodor Kavaliotin gjuhë e shkencës ishte greqishtja. Por, me Gjon Buzukun kemi një përpjekje serioze për të përdorur shqipen në shërbesat fetare.

Rryma e bejtexhinjve shquhet për një amalgamë stilistike, përzierje të shqipes me orientalizma të shumtë. Gjuha dhe poezia popullore dallohej dukshëm nga veprat e tyre për pastërti. Për ruajtjen e pastërtisë së shqipes e ngritën zërin Naimi dhe bashkëkohësit e të tij, që të zinte vend fjala shqipe edhe në shtresën poetike, meqë ajo ishte e aftë për vlera artistike.

a) Veçoria e parë e sistemit stilistik të shqipes së shkruar është se nuk ka trashëguar drejtpërdrejt ndonjë stil nga nëna e saj (siç kishte ndjekur italishtja traditën latine, gjuhët sllave traditën e sllavishtes kishtare; greqishtja e re dhe e mesme nga greqishtja e vjetër etj.).

Në shekullin XIX nisi përpunimi i vetëdijshëm i varianteve letrare. Gjatë Rilindjes u zbuluan mudësitë e mëdha shprehëse të shqipes. Në këtë periudhë kemi larmi shkrimesh: a) dialektore, b) shkrime të përpunuara me përzierje dialektore, si dhe c) një gjuhë të folur të përpunuar.

b) Veçori e dytë është se me Rilindjen zë fill një gjuhë e re nga pikëpamja stilistike. Po ata rilindës shkruanin vepra letrare, publicistike, libra shkollorë e vepra fetare. Përpunohet stili i veprimtarisë shoqërore e politike, nis letërsia kombëtare, bëhen përpjekjet e para diturore.

c) Tipari i tretë i rëndësishëm i sistemit stilistik të shqipes është se ai u formua si rrjedhojë e proceseve të brendshme gjatë shekujve XIX e XX dhe vazhdon edhe sot. Hap pas hapi u zgjeruan edhe kontaktet me gjuhët e tjera të përpunuara.

ç) Karakteristikë tjetër është se përpunimi i stileve ka ecur përpara. Pas Pavarësisë së Shqipërisë (1912) u përpunua stili zyrtar, e



sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Më 1908 u përcaktua alfabeti i sotëm i shqipes, më 1972 u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të shqipes etj.

d) Një tjetër tipar i sistemit stilistik të gjuhës shqipe është se, ndryshe nga disa gjuhë të tjera (si në frëngjishte, rumanishte etj.), në shqipen nuk ka pasur ndonjë shkëputje të madhe ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar.

Dallimi i stileve dhe i ligjërimeve është degëzim i gjuhës për ta bërë më të aftë që t'u përgjigjet kërkesave të shumanshme të kombit.

Gjuha standarde shqipe është formuar mbi bazën e përbashkët të të dy dialekteve. Dialekti i toskërishtes, kryesisht në sistemin fonetik e morfologjik, u vendos në shtratin e gjuhës standarde, kurse në sistemin leksikor i është lënë fushë ndërfutjeje edhe dialektit të gegërishtes.

Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyrimë fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi leksikun e gjuhës letrare është i barabartë. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

Gjuha letrare merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, i zymtë, zeje, pushtoj, burrneshë, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore gege, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca kuptimore e ngjyrimë emocionale. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë-grunore-grunajë* "arë e mbjellë me grurë", *tamblak* "qengj pirës"; *tamblatore, tamblore, tamëltore* "lopë që jep shumë qumësht"; *tambloriz, tamëloriz* "oriz me qumësht", *lule a bar tambli; drynoj* "mbyll me dry", *shpeshtinë* "pyll i dendur", *shterpni* "të qenit shterp" etj.

Për ta parandaluar përmbytjen e shqipes me fjalë e gjedhe të huaja, duhet të kushttrimohen të gjithë përdoruesit e saj, që t'u vënë pritë fjalëve të huaja të panevojshme dhe formimeve të tjera të çoroditura.

Në shqipen e sotme veprojnë dy forca çekuilibruese: folësi ka prirje të përdorë sa më shpesh fjalë të huaja dhe të përsërisë të njëjtat fjalë, kurse dëgjuesi kërkon qartësi sa më të madhe dhe laryshi leksikore. Prosesi i globalizimit po bëhet i rrezikshëm për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe mëtej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Sot, problem qenësor është ballafaqimi i gjuhës shqipe me gjuhët e mëdha, veçanërisht me anglishten në rrafshin leksikor e terminologjik. Në Evropën e Bashkuar, ky synojmë të hyjmë, gjuhët kombëtare duhet të bëhen të pajtueshme në nivelin e aftësive shenjuese e komunikuese. Duhet

përcaktuar se si do të quhen në gjuhën shqipe shumë nocione dhe sende të botës së sotme, qoftë me fjalë shqipe ose të ndonjë burimi tjetër.

Planifikimi gjuhësor duhet bërë me ndërgjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja përdoren për një kohë më të gjatë dhe më shpesh, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i gjuhës sonë letrare me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. Lexojeni mësimin me vëmendje. Tabelën e dhënë shkruajeni e zgjerojeni në fletore ose në kompjuter dhe më pas dhe vlerësoni të dhënat e leksionit me shenjat në tabelë (numëroni faktet shkurtimisht).

(√) E dija	(-) Nuk pajtohem me këto fakte	(+) Sot mësova	(?) Dua të di më shumë për:
1.	1.	1.	1.
2.	2.	2.	2.
3.	3.	3.	3.
4.	4.	4.	4.

KREU IV

4. DALLIMET DHE NGJASHMËRITË FONETIKE E FONOLOGJIKE

Tanimë u tha se veçoritë gjuhësore që i dallojnë dy dialektet e shqipes, gegërishten dhe toskërishten, janë fonetike e fonologjike, gramatikore (morfologjike e sintaksore) dhe leksikore. Dallime më të mëdha vërehen në fonetikë, morfologji e leksik, ndërsa dallimet fonologjike e sintaksore janë më të pakta.

Pra, ndërmjet dialekteve të gjuhës shqipe ka dallime fonologjike dhe fonetike. Dallimet fonetike nuk prekin sistemin e fonemave nga ana e inventarit, e organizimit dhe e funksionimit të tyre. **Shqiptimet e llojlojshme të fonemave që dëgjohen nëpër të folmet e shqipes janë alofone krahinore të të njëjtës fonemë.** Kështu, p.sh. zanoret nëpër të folmet shqipe realizohen me nuanca të ndryshme: diku më të hapura e diku më të mbyllura, diku më të përparme e diku më të prapme, diku më shumë e diku më pak të buzorëzuara, deri sa edhe si diftongje ose diftongoide; por, me gjithë laramaninë e tyre, ato kanë funksion të njëjtë, pra **janë nuanca fonetike të të njëjtës fonemë.**

Tiparet dalluese dialektore për nga shtrirja gjeografike nuk janë të njëjta: disa prej tyre shtrihen në tërë territorin dialektor, kurse disa të tjera gjenden në shumicën e të folmeve, por jo në të gjitha. Kështu, p.sh. fjalët me [-n-] ndërzanore (intervokalike) kanë përhapje në tërë truallin e gegërishtes, ndërsa fjalët e njëjta me [-r-] ndërzanore në të gjitha të folmet e toskërishtes. Në dialektin Verior, përveç serisë së zanoreve gojore, ka edhe zanore hundore me vlerë fonologjike. Por, disa të folme të këtij dialekti, si e folmja e Dibrës, e folmja e Preshevës, e folmja shqipe e Prilepit, e Velesit, e Ulqinit etj. nuk kanë zanore hundore, ashtu siç nuk i ka edhe gjithë toskëria.

Ndonjë tipar i një dialekti mund të shtrihet edhe në ndonjë të folme të dialektit tjetër. P.sh. zanoret e gjata me vlerë fonologjike janë tipar dallues i gegërishtes, por zanore të tilla dëgjohen edhe në të folmet e toskërishtes jugore. Ka edhe veçori gjuhësore, të cilat kanë përhapje relativisht të vogël dhe si të tilla nuk mund të fitojnë karakterin e dukurisë mbarëdialektore. Dukuri e tillë, bie fjala, është diftongimi i zanoreve të theksuara /i/ dhe /u/ në diftongje dytësore [âi, êi, ëi] ose [ôi]; respektivisht [âu] apo [ôu] në gegërishten qendrore. Meqenëse ka përhapje të kufizuar vetëm në një grup të folmesh, diftongimi nuk merret për dukuri e përgjithshme dialektore e gegërishtes.

Shumica e tipareve dalluese dialektore nuk e prekin strukturën dhe funksionin fonologjik e gramatikor, por lidhen me variante të të njëjtës fonemë apo me variante ndajshitesash në sistemin gramatikor ose me dendurinë e përdorimit të tyre. P.sh. fonema /e/ nëpër të folmet e shqipes shqiptohet me variante të ndryshme fonetike: në të folmet e gegërishtes veriore ajo realizohet më e hapur në fjalët kur ndodhet para grupeve të bashkëtingëlloreve [-tll] apo [-rdh], si *vetlla* ‘vetulla’, *petlla* ‘petulla’, *t’vevdha* ‘të verdha’ etj. Në të folmet e gegërishtes veriperëndimore e në disa të gegërishtes qendrore ajo shqiptohet si diftongoid [‘e] në fjalët ku gjendet pas bashkëtingëlloreve qiellzore ose lëngëzores [l], si *q’ese* ‘qese’, *gj’el* ‘gjel’, *gj’eth* ‘gjeth’, *l’esh* ‘lesh’ etj. Dallimet në këtë rast janë vetëm fonetike, sepse lidhen me timbrin e

fonemës /e/, por ato janë të parëndësishme për anën fonologjike, sepse nuk preket sistemi dhe funksioni i fonemave. Në shumicën e të folmeve shqipe [a]-ja shqiptohet e pabuzorëzuar, por në jo pak të folme të gegërishtes [ã]-ja hundore ka një buzorëzim shkallësh të ndryshme: buzorëzim të paktë, diku buzorëzimi është më i shprehur, deri sa ka të folme që [ã]-në e kanë buzorëzuar plotësisht, si *nāna, hāna, bāna* > *na^ona, ha^ona, ba^ona* > *nona, hona, bona*. Të gjitha këto variante kombinatorë të buzorëzuara dhe të hundorëzuara janë alofone krahinore të fonemës /ã/ hundore. Pamja reale e sasisë së fonemave, mënyra e shqiptimit (realizimit) të tyre, ndërrimet fonetike, këmbimet morfonologjike e çdo dukuri tjetër gjuhësore del kur shihet çdo e folme në vetvete. Disa të folme me veçori të njëjta fonetike e fonologjike formojnë së bashku një areal dialektor, që shtrihet në një hapësirë të caktuar gjeografike.

Në sistemin morfologjik, bie fjala, dihet se pjesët emërore trajtën e shquar e bëjnë njësoj si në të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në ato të toskërishtes: me mbaresa shquese. Dallimi qëndron në faktin se emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëlloret prapagjuhore [k, g, h] ose me zanore të theksuar në shumicën e të folmeve të gegërishtes shquarësinë e bëjnë me mbaresën -i, ndërsa në të gjitha të folmet e toskërishte me -u (si në gjuhën letrare dhe në pak të folme të gegërishtes).

Siç dihet, në njërin dialekt disa fonema përdoren më shpesh, ndërsa në tjetrin më rrallë. Për të shpjeguar dallimin ndërmjet dy dialekteve të shqipes në dendurinë e përdorimit të fonemave si shembull tipik mund të përmendim fonemat e tingullta /n/ dhe /r/. Edhe /n/-ja edhe /r/-ja bëjnë pjesë në inventarin e fonemave bashkëtingëllore të të dy dialekteve, por dallimi qëndron në faktin se gegërishtja karakterizohet me përdorim të shpeshtë të /n/-së dhe të rrallë të /r/-së, ndërsa toskërishtja me denduri të anasjelltë: /r/-ja përdoret shpesh, ndërsa /n/-ja rrallë, si pasojë e rotacizmit që ka vepruar vetëm në dialektin Jugor (khs. *drūni* - *druri*, *sŷni* - *syri*, *lakën* - *lakër* etj.).

Ndërmjet të folmeve të të dy dialekteve të gjuhës shqipe, gegërishtes e toskërishtes, janë përvijuar disa dallime fonologjike dhe fonetike.

Dallimet fonologjike prekin inventarin dhe sistemin fonologjik të të folmeve, d.m.th.:

- a) ato lidhen me sasinë e fonemave të të folmeve, p.sh., atje ku mungon /y/-ja ka një fonemë më pak sesa në të folmet e tjera;
- b) me vendin që zënë në sistem dhe me kundërvëniet që formojnë, si edhe
- c) dallime që lidhen me këmbimin e fonemave në disa kushte të caktuara fonetike ku neutralizohen kundërvëniet e tyre (p.sh. në shumicën e të folmeve të toskërishtes bashkëtingëlloret e zëshme këmbehen me të shurdhëtat kur ndodhen në fundin absolut të fjalës, si *elp* ‘elb’, *zok* ‘zog’).

Dallimet fonetike e fonologjike në të folmet shqipe janë më të mëdha në sistemin zanor, si në alofoninë e tyre, ashtu edhe në inventarin e fonemave zanore; ndërsa më të pakta në sistemin bashkëtingëllor. Në dialektologjinë shqiptare tani më është bërë praktikë të shqyrtohen gjatësia dhe hundorësia e zanoreve në rrokje të theksuar e të patheksuar, inventari i fonemave zanore, togjet e zanoreve dhe diftongjet, theksi i fjalës; dallimet në inventarin e fonemave bashkëtingëllore, të shqyrtohen grupet e bashkëtingëlloreve dhe disa dukuri të tjera fonetike.

Duke parë se jo vetëm te studentët e ciklit të studimeve të shkallës së parë e të dytë, por edhe në jo pak studime dialektore të deritashme çështja e përcaktimit të inventarit të fonemave të

të folmeve, veçmas të fonemave zanore, del e vështirë e problematike; në këtë tekst mësimor-pedagogjik do të japim edhe disa udhëzime të përgjithshme për të ndihmuar studiuesit e ardhshëm që të mund të përcaktojnë më me saktësi inventarin e fonemave zanore të cilësdo të folme. Këtë kapitull do ta përmbyllim me shtjellimin e dallimeve ndërmjet folësve të shqipes në bazën artikulative.

4.1. GJATËSIA E ZANOREVE NË TË FOLMET SHQIPE

Çështje të përgjithshme

Kuantiteti (gjatësia) përkufizohet si kohë e nevojshme për artikulimin e një tingulli. Gjatësia e tingujve, d.m.th. sasia e kohës që përdoret për shqiptimin e tyre, është dy farësh: *absolute* dhe *relative*. Gjatësia absolute varet drejtpërdrejt nga ritmi apo shpejtësia e të folurit. Kështu, sa më shpejt të flasim, aq më pak kohë zgjat nyjëtimi i çdo tingulli në krahasim me një të folur të ngadalshëm. Por, gjatësia e këtyre nuk paraqet shumë interes për gjuhësinë. Me interes për gjuhësinë është gjatësia relative e tingujve. Kur flasim me të njëjtin ritëm (tempo), tingujt nuk i shqiptojmë me të njëjtën gjatësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm.

Këta faktorë i ndajmë në dy grupe: në faktorë fonetikë dhe në fonologjikë, që përfaqësojnë dy lloj gjatësish: *gjatësi fonetike* (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë), dhe *gjatësi fonologjike* (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por gjatësia ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).

Gjatësi fonetike kemi atëherë kur gjatësia ose shkurtësia e tingujve varet nga një radhë shkaqesh të kushtëzuara fonetike, siç janë karakteri i rrokjes (e hapur - e mbyllur), numri i tingujve në fjalë, rrethimi fonetik i tingullit (tingujt që gjenden para e pas), pozicioni ndaj theksit etj. P.sh. në rrokje të hapur (që mbaron me zanore) zanoret janë më të gjata sesa zanoret në rrokje të mbyllur (që mbarojnë me bashkëtingëllore): krahaso fjalët *ha - hap*, *ka - kam*, *rri - rrip*, *mi - mik* etj. Sa më e shkurtër të jetë fjala, zanoret kanë kushte për shtrirje më të madhe dhe anasjelltas, sa më e gjatë të jetë fjala mundësia e shtrirjes së zanoreve zvogëlohet. Krahaso: *bashkë*, *tingull - bashkëtingëllore*; *krye*, *qytet - kryeqytet*; *zëvendës*, *drejtor - zëvendësdrejtor*; *mirë*, *sjellje - mirësjellje*; *farë e fis - farefis* etj.

Edhe karakteri i bashkëtingëllores që e rrethon zanoren, sidomos i bashkëtingëllores që vjen pas, ndikon në gjatësinë e zanores. Kështu, është përdëftuar se zanoret që gjenden para bashkëtingëllores të tingullta (sonoreve) janë më të gjata sesa ato që përdoren përpara bashkëtingëllores të tjera. Zanoret në pozitë para sonoreve *-r*, *-ll* janë të gjata (khs. *shqipta:r*, *bi:r*, *ma:ll*, *y:ll*, *qu:ll* etj.). Përpara bashkëtingëllores shtegore, zanoret janë diçka më të gjata se para mbylltoreve. Po kështu, para bashkëtingëllores të zëshme zanoret janë më të gjata sesa para të shurdhëtave. Kështu, në shqiptimin letrar në rrokje të mbyllur /a/-ja e theksuar zgjat 8.9 qs.; para frikativeve dhe dridhëseve 16.6 qs. Në rrokje të hapur kur gjendet pas frikativeve dhe afrikateve zgjat 14 qs., ndërkaq pas mbylltoreve zgjat 10 qs. Në pozitë fundore absolute në rrokje

të hapur gjatësia e /a/-së nuk kushtëzohet nga bashkëtingëllorja që gjendet para saj. E tilla nyjëtohet në kohëzgjatje prej 7-11 qs. (Beci, 1985 : 104-105). Kur pas zanores vjen një grup bashkëtingëlloresh, zanorja është zakonisht më e shkurtër sesa kur pas saj vjen vetëm një bashkëtingëllore.

Në të gjitha këto raste, kemi të bëjmë me gjatësi jofonologjike ndërmjet zanoreve normale që zhvillohen plotësisht dhe zanoreve të shtypura, të penguara në zhvillimin e tyre me nisjen e bashkëtingëllores vijuese. Ndaj, në të folmet e toskërishtes (në shqipen standarde si dhe në shumë gjuhë të tjera) gjatësia dhe shkurtësia e zanores është tipar i bashkëlidhjes së fonemave në vargun e ligjëritimit.

Në gjatësinë e zanoreve, rol të rëndësishëm luan edhe theksi. Po të krahasojmë gjatësinë e zanoreve të theksuara dhe të patheksuara, kur kushtet e tjera fonetike janë të njëjta, del se të theksuarat janë relativisht më të gjata sesa të patheksuarat. Raporti ndërmjet tyre në shqipen standarde dhe në të folmet e toskërishtes është **10/7** (Beci, 1985 : 108).

Zgjatja e zanores së theksuar ndikon jo vetëm në shkurtimin e zanoreve të tjera të patheksuara, por edhe në shkurtimin e bashkëtingëlloreve në rrokje të patheksuara. Përveç kësaj, vlen të thuhet se sa më larg theksit të jenë zanoret, aq më të shkurtra janë.

Meqë gjatësia e tipit të këtyllë varet nga faktorë të jashtëm fonetikë, ajo nuk është e qëndrueshme, nuk është tipar i vazhdueshëm apo i përhershëm i tingujve. Prandaj, dallimi i gjatësisë nga kushtet e ndryshme fonetike nuk mund të formojë kundërvënien fonologjike, të dallojë seri tingujsh (zakonisht zanoresh) që t'i vihen përballë njëri-tjetrit, për të dalluar njësi semantike a gramatikore.

Toskërishtja (dhe gjuha standarde shqipe) ka gjatësi zanoresh të tipit fonetik. Zanoret e gjata janë nuanca kombinatorë dhe përgjithësisht mungon kundërvënien fonologjike të shkurtra ~ të gjata.

Sistemi fonetik i toskërishtes (dhe i shqipes standarde), edhe pse përbëhet vetëm nga një seri zanoresh gojore me gjatësi të kushtëzuar fonetike, i plotëson funksionet e veta të gjuhës. Funksionin kuptim dallues të zanoreve të gjata ajo e mbulon në të shumtën e rasteve me mjete të tjera fonetike e gramatikore. Kështu, mbajtja e zanores /ë/ të patheksuar në fund të fjalës zhduk homofoninë ndërmjet emrave të gjinisë femërore e atyre të gjinisë mashkullore (*plakë ~ plak*), shumësit nga forma e njëjësit (*shok ~ shokë*) etj. (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurta, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 201-210).

Në këtë kuptim, mund të thuhet se kuantiteti i zanoreve të shqipes së sotme është kthyer në gjatësi pozicionale dhe mund të shpjegohet me këto tri rregulla bazë (mund të ketë ndonjë rast të veçantë që u bie ndesh rregullave të mëposhtme) (Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 94):

1. zanoret e shkurtra ndodhen në rrokje fundore të mbyllura;
2. zanoret e gjata gjenden në rrokje fundore të hapura;
3. zanoret e gjatësisë së mesme ndodhen në rrokje jofundore.

Gjatësi fonologjike kemi atëherë kur gjatësia a shkurtësia e zanoreve nuk varet nga faktorë thjesht fonetikë, por është tipar i vazhdueshëm i fonemave, sepse vetëm në bazë të gjatësisë fonemat e shkurtra i vihen përballë fonemave të gjata në çifte minimale fjalësh, duke

krijuar opozicion fonologjik. Kundërvënia (opozicioni) e këtillë e fonemave, në mungesë të treguesve të tjerë, përdoret për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. Kjo bën që zanoret e shkurtra nga gjegjëset e tyre të gjata të luajnë rolin e fonemave të veçanta në gjuhë. Rrjedhimisht, kështu dalin dy seri fonemash zanore në rrokje të theksuar:

- a) fonema të shkurtra: /ǎ/, /ě/, /ĩ/, /ǒ/, /ũ/, /y/ dhe
- b) fonema të gjata: /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

Gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes. Me metodën e fonetikës eksperimentale prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1. Me fjalë të tjera, zanorja e shkurtër është njëmorëshe, ndërsa e gjata dymorëshe (Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipës dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 232). Po i njëjti autor konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7 (në artikullin *Sistemi fonologjik ...*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 93-109).

Tani, me botimin e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe (vëllimi I, Napoli, 2007 dhe vëllimi II, Napoli, 2008) na është bërë e mundur të shohim përndarjen edhe të zanoreve sipas gjatësisë në tërë shqipen dialektore. Në hartat nr. 1, 2, 3, 5, 6 të Atlasit I, është pasqyruar kundërvënia e zanoreve të theksuara të shkurtra me zanoret gjegjëse të gjata: /ǎ/ ~ /a:/ në çiftet e fjalëve *plāk ~ pla:k* ‘plak ~ plakë’, /ě/ ~ /e:/: *vësh ~ ve:sh*, /ĩ/ ~ /i:/: (dy, shumë) *dīt ~ (një) di:t*, /ũ/ ~ /u:/: *lūg ~ lu:g* ‘lug-u ~ lugë,-a’, /ǒ/ ~ /o:/: *lōt ~ lo:t* ‘(një) lot ~ (shumë) lotë’ etj.

Zanore të gjata dëgjohen edhe në disa krahina skajore të toskërishtes, si në Labëri, në Bregdet dhe në Çamërishten. E gjejmë dhe tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme. Nga hartat e Atlasit mund të nxirret përfundimi se kemi zanore të gjata në të gjitha të folmet e gegërishtes si dhe në disa të folme toske: në të folmet e bregut të Jonit, duke filluar nga fshatrat në jug të rrethit të Vlorës e deri në të folmet jugore më skajore: të Tepelenës e të Sarandës në krahinën e Labërisë; në Filat, Karbunarë, Arpicë, Muzhakat e Prevezë në krahinën e Çamërisë si dhe në Peloponez në Greqi. Zanore të gjata kemi edhe në të folmet e arbëreshëve të Italisë, si në: rrethin e Puljes, Kamanisë, Bazilikatës, Kalabrisë e të Sicilisë.

Kjo dëshmon se dallimi i zanoreve sipas kuantitetit, përkatësisht kundërvënia fonologjike zanore të shkurtra ~ zanore të gjata, ka qenë e mbarë shqipës. Por, në një periudhë të hershme të zhvillimit, gjatësia fonologjike në dialektin e Jugut është mënjeluar e ka mbetur vetëm në Veri. Gjatësia e zanoreve në toskërishte ka karakter pozicional dhe kombinator e jo fonologjik. Mungesa e saj në pjesën më të madhe të të folmeve toske, nga kjo pikëpamje, shihet si një inovacion, zhvillim i këtyre katër-pesë shekujve të fundit, meqë arbëreshët e shpërngulur nga toskëria e kanë pasur dhe e ruajnë ende gjatësinë fonologjike të zanoreve, ashtu si të folmet periferike.

Në të vërtetë, **edhe në të folmet e gegërishtes mbizotëron gjatësia fonetike e tingujve, por në një numër të konsiderueshëm fjalësh ka edhe gjatësi fonologjike.** Siç dihet, gjatësia e zanoreve të gegërishtes varet nga shumë faktorë. Më së shpeshti ajo përcaktohet nga faktorë të jashtëm fonetikë dhe ndryshon së bashku me ndryshimin e vetë faktorëve: *gjak - gja.ki* ‘gjaku’,

ka: - *kävi* 'kau', *me la*: - *läu* 'lau', *mik* - *mi.ki* 'miku' etj. Nganjëherë gjatësia është tipar i vazhdueshëm i zanores. Kjo tregon se gegërishtja është në një fazë kalimtare (tranzitore). Megjithatë, gjendja e vjetër, kur gjatësia ishte tipar fonologjik, ende ruhet.

Gjatësia në të folmet e gegërishtes edhe sot e kësaj dite **përdoret për të diferencuar kuptimin te disa çifte fjalësh dhe të disa formave gramatikore**. Të tri gjatësitë fonetike (të shkurtra, të mesme dhe të gjata) përbëjnë vetëm një opozicion: të shkurtra e të mesme ~ të gjata. Pra, në aspektin fonologjik dallohen dy shkallë: *zanore të shkurtra* ~ *zanore të gjata*, nga se kuptimi i fjalëve apo i formave gramatikore te disa çifte minimale fjalësh dallohen vetëm nga ky tipar. Zanoret me gjatësi të mesme, në të vërtetë janë neutrale, ato nuk kundërvihen (Rexhep Ismajli, Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara në gjuhën shqipe, Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 193-200).

Bëhet fjalë për një asnjësim të gjatësisë së zanoreve të theksuara, sepse gjatësia e tyre fonetikiq është e kushtëzuar. Kështu, gjatë eptimit të disa fjalëve, gjatësia e caktuar e zanores e bjerr funksionin semantik ose gramatikor dhe ky funksion bartet në mbaresë. P.sh.: Fjalët *plak* dhe *plakë* në toskërishten dhe në shqipen standarde dallohen fonetikiq me anë të zanores fundore [-ë]. Në të folmet gege rënia e [-ë]-së fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, në këtë rast të [a]-së. Kështu që emri i gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar shqiptohet me [ã] të shkurtër (plāk), ndërsa ai i gjinisë femërore me [a:] të gjatë (pla:k). Në trajtën e shquar kemi [pla.k-i, (-u) ~ pla.k-a] ku edhe zanorja e shkurtër edhe zanorja e gjatë shndërrohen në zanore me gjatësi të mesme, nga shkak se gjatësitë më nuk kanë asnjë rol të bartjes së informacionit (nuk është më tregues distinktiv i gjinisë), por rolin e tyre e kryejnë morfemat (mbaresat), përkatësisht fonemat /i/ ose /u/ për gjininë mashkullore dhe /a/ për gjininë femërore. Kalimet e zanoreve të shkurtra në të mesme dhe e të gjatave në të mesme e anasjelltas, për shkak të kushteve të jashtme fonetike, e lëkundin dhe e ngatërrojnë vlerën fonologjike të gjatësisë.

Megjithkëtë, në të folmet e gegërishtes gjatësia shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve. Po sjellim disa shembuj nga të folmet e gegërishtes ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve dhe i formave dallohet vetëm nga ky tipar:

1. **Gjatësia e zanoreve ka funksion leksikor** (semantik), si në çiftet *maz* ~ *ma:z* (mëz - ajkë), *çaj* ~ *ça:j* 'pije e nxehtë freskuese - çaj dru', *kös* ~ *ko:s* 'kosi - kosa', *böll* ~ *bo:ll* 'mjaft - lloj gjarpri', *köt* ~ *ko:t* 'pa dobi - dremit', *shpät* ~ *shpa:t* 'shpati - shpata', *mäll* ~ *ma:ll* 'malli - mallëngjim', *häll* ~ *ha:ll* 'brenjë - hallë-a', *shtät* ~ *shta:t* 'trup - shtatë', *böj* ~ *bo:j* 'trup - ngjyrë' etj.

2. **Gjatësia si mjet fonologjik ka përdorim të dendur, sidomos për dallimin e formave morfologjike**. Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënia e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa karakter leksikor. Kështu, disa emra dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë. Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë. Çifte leksikore me dallim kuptimor dhe dallime gramatikore të fjalëve në bazë të gjatësisë së zanoreve në gegërishten janë krijuar sidomos **me rënie** e /ë/-së **fundore**. Në dialektin e Veriut rënia e /ë/-së

fundore ka shkaktuar **zgjatje kompensatore të gjatësisë** në zanoren që gjendej para saj. Prandaj, emrat në numrin njëjës dhe të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa po të njëjtit emra në shumës dhe në gjininë femërore dalin me zanore të gjatë. Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj:

a) *Dallim në gjini* (mashkullore ~ femërore): *plāk* ~ *pla:k* ‘plak - plakë’, *kunāt* ~ *kuna:t* ‘kumat - kumatë’, *krūshk* ~ *kru:shk* ‘krushk - krushkë’ etj.

b) *Dallim në numër* (njëjës ~ shumës): *vësh* ~ *ve:sh* ‘vesh - veshë’, *dhām* ~ *dha:m* ‘dhëmb - dhëmbë’, *fyshek* ~ *fyshe:k* ‘fyshek - fyshekë’, *dyshek* ~ *dyshe:k* ‘dyshek - dyshekë’, *oxhāk* ~ *oxha:k* ‘oxhak - oxhakë’, *baxhanāk* ~ *baxhana:k* ‘baxhanak - baxhanakë’, *dollāp* ~ *dolla:p* ‘dollap - dollapë, dritare’ etj.

Nga gjithë sa u tha, del se:


a) Të gjitha të folmet e gegërishtes si dhe pak të folme të toskërishtes që realizojnë kundërvënien fonologjike ndërmjet fonemave zanore të shkurtra dhe zanoreve të gjata në rrokje të theksuar kanë dy seri fonemash zanore:

- fonema të shkurtra /a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /y/ dhe

- fonema të gjata /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

Vërejtje: Të folmet gege nuk kanë fonemë /ë/, ndërsa të folmet toske e kanë këtë. Rëndom, të folmet e toskërishtes që kanë zanore të gjata nuk e kanë fonemën /y/. Të folmet e gegërishtes qendrore nuk kanë /y/. Prandaj, është vështirë të jepet një inventar i përbashkët i fonemave zanore për të gjitha të folmet me zanore të gjata. Sasia e fonemave na del më e saktë kur jepet inventari i tyre vetëm në një të folme të caktuar.

b) **Gjatësia e tingujve të shqipes së sotme** (dialektore dhe standarde) është përzierje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve, me tipin e ri të gjatësisë fonetike, të shkaktuar nga faktorë të jashtëm fonetikë.



Po të duam të japim përgjithësime, atëherë mund të themi se për nga gjatësia **toskërishtja ka një seri fonemash zanore**, ndërsa **gegërishtja ka dy: zanore të shkurtra dhe zanore të gjata**. Gjuha standarde (letrare) shqipe ka vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema: /a/, /e/, /ë/, /o/, /i/, /y/, /u/; kurse të gjitha të folmet e dy dialekteve kanë bashkërisht një inventar prej 22 fonemash zanore.

Kur i krahasojmë të folmet e dy dialekteve të gjuhës shqipe vërejmë se të folmet geqe kanë inventar më të pasur fonemash zanore (deri më 19) sesa të folmet toske (prej 6-7), sepse të folmet e Veriut kanë tri seri: zanore të shkurtra, zanore të gjata dhe zanore hundore; ndërsa të folmet e Jugut kanë vetëm serinë e zanoreve gojore.

Në toskërishte zanoret kanë **gjatësi fonetike** (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, siç e ka edhe gjuha standarde), ndërsa gegërishtja ka **gjatësi fonologjike** (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por gjatësia ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).

Nuk ka dyshim se gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes. Megjithatë, në disa përshkrime të të folmeve të veçanta geqe gjatësia e zanoreve nuk trajtohet në mënyrë të duhur, përkatësisht nuk vërtetohet vlera funksionale e tyre dhe nuk përcaktohet inventari i fonemave zanore të shkurtra përballë fonemave zanore të gjata. Nga ana tjetër, tani më kemi edhe monografi që mund të shërbejnë si model ku zanoret janë vështruar si nga aspekti fonetik ashtu edhe nga ai fonologjik. Prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës është 2:1.

Në disa çifte minimale fjalësh, në të folmet e gegërishtes gjatësia e zanoreve nuk varet nga faktorë thjesht fonetikë, por është tipar i vazhdueshëm i fonemave, sepse vetëm në bazë të gjatësisë fonemat e shkurtra i vihen përballë fonemave të gjata, duke krijuar opozicion fonologjik. Kundërvënja e këtyllë e fonemave, në mungesë të treguesve të tjerë, përdoret për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. Kjo bën që në të folmet e Veriut zanoret e shkurtra nga gjegjëset e tyre të gjata të luajnë rolin e fonemave të veçanta. Rrjedhimisht, kështu dalin dy seri fonemash zanore në rrokje të theksuar: fonema të shkurtra /a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /y/ dhe fonema të gjata /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Për nga gjatësia toskërishtja ka një seri fonemash zanore, ndërsa gegërishtja ka dy: zanore të shkurtra dhe zanore të gjata

Gjuha standarde shqipe ka vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema: /a/, /e/, /ë/, /o/, /i/, /y/, /u/; kurse të gjitha të folmet e dy dialekteve kanë bashkërisht një inventar prej 22 fonemash zanore.

Kur i krahasojmë të folmet e dy dialekteve të gjuhës shqipe vërejmë se të folmet geqe kanë inventar më të pasur fonemash zanore (deri më 19) sesa të folmet toske (prej 6-7), sepse të parat kanë tri seri: zanore të shkurtra, zanore të gjata dhe zanore hundore, ndërsa të dytat kanë vetëm serinë e zanoreve gojore.

Në toskërishte zanoret kanë **gjatësi fonetike** (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, siç e ka edhe gjuha standarde), ndërsa në gegërishte në disa çifte minimale fjalësh gjatësia e zanoreve është e natyrës **fonologjike** (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por gjatësia ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).

Kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) në disa çifte minimale fjalësh shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. P.sh. shkurtësia në kundërvënie me gjatësinë e zanores ka funksion kuptimor (semantik): *maz* ~ *ma:z* “mëz - ajkë”, *kos* ~ *ko:s* “kos - kosë”, *shpat* ~ *shpa:t* “shpat - shpatë”; bën dallimin e gjinisë mashkullore nga ajo femërore: *plak* ~ *plak* “plak - plakë”, *kunat* ~ *kuna:t* “kunat - kunatë”; dallon numrin njëjës nga numri shumës: *vesh* ~ *ve:sh* “vesh - veshë”, *fyshek* ~ *fyshe:k* “fyshek - fyshekë”, *oxhak* ~ *oxha:k* “oxhak - oxhakë”, *dollap* ~ *dollap* “dollap - dollapë” etj.

Në të folmet e gegërishtes gjatësia a shkurtësia e zanoreve nuk varet nga faktorë thjesht fonetikë, por është tipar i vazhdueshëm i fonemave, sepse vetëm në bazë të gjatësisë fonemat e shkurtra i vihen përballë fonemave të gjata, duke krijuar opozicion fonologjik. Kundërvënia (opozicioni) e këtyre fonemave, në mungesë të treguesve të tjerë, përdoret për të dalluar kuptimin të fjalëve ose të formave gramatikore. Kjo bën që zanoret e shkurtra nga gjegjëset e tyre të gjata të luajnë rolin e fonemave të veçanta në gjuhë. Rrjedhimisht, kështu dalin dy seri fonemash zanore në rrokje të theksuar: fonema të shkurtra /a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /y/ ose edhe ndonjë tjetër, dhe, fonema të gjata /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

Gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes. Porse kjo vihet re edhe në disa krahina skajore të toskërishtes, si në Labëri, në Bregdet dhe në Çamërishten. E gjejmë dhe tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme. Kjo dëshmon se dallimi i zanoreve sipas kuantitetit, përkatësisht kundërvënia fonologjike e zanoreve të shkurtra ndaj zanoreve të gjata ka qenë i mbarë shqipes. Por, në një periudhë të hershme të zhvillimit kjo kundërvënie në dialektin e Jugut është mënjeluar dhe ka mbetur vetëm në Veri. Gjatësia e zanoreve në toskërishte ka karakter pozicional dhe kombinator e jo fonologjik.

Në të vërtetë, edhe në të folmet e gegërishtes mbizotëron gjatësia fonetike e tingujve, por në një numër të konsiderueshëm fjalësh ende ruhet gjatësia fonologjike. Gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzierje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë fonetike.



Pyetje, ushtrime e detyra:

Analizoje leksionin sipas skemës:

1. Shpjegoje mësimin.
2. Çfarë rëndësie kanë të dhënat e sjella në këtë leksion?
3. Jepi vlerësimet e tua rreth këtyre të dhënave.
4. Çfarë lidhje ka ky mësim me mësimet paraprake?
5. Si do të mund t'i përdor këto të dhëna në punën time profesionale?

4.2. HUNDORËSIA E ZANOREVE NË TË FOLMET SHQIPE

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet shqipe, janë hartuar punime përgjithësuese si dhe janë botuar e ribotuar disa tekste universitare shumë të vlefshme (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, ShBLU, Tiranë, 1997, 2000), është botuar edhe Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. Deri më tani janë shkruar shumë monografi dialektore. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe. Megjithkëtë, vëzhgimet dialektore duhet vazhduar edhe më tej. Pothuajse për çdo të folme geqe thuhet se ka zanore hundore, pa u saktësuar se hundorësia është e tipit fonetik apo fonologjik. Andaj, nga përshkrimet e deritashme dialektore vështirë se mund të krijohet mozaiku i plotë i sistemit vokalik të gegërishtes, sepse për shumë të folme të dhënat për vlerën fonologjike të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve janë të pakta ose mungojnë fare, rrjedhimisht edhe nuk është përcaktuar me saktësi inventari i fonemave për disa të folme.

Dihet se brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve gojore me zanoret hundore nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi. Në ndërgegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Kjo tregon se gegërishtja në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: pjesa më e madhe e të folmeve të nëndialektit verior gegë e ruan tipin fonologjik të hundorësisë, ndërsa një numër i madh të folmesh të nëndialektit të gegërishtes jugore (veçmas të folmet e skajshme lindore, prijnë ato të Maqedonisë) kanë evoluar në tipin fonetik të hundorësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i mungesës përkundër pranisë së hundorësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar.

Të arriturat teorike dhe praktike të dialektologjisë shqiptare si dhe të gjuhësisë shqiptare e të gjuhësisë së përgjithshme duhet zbatuar edhe në përshkrimet dialektore. Dukuria e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe ka ngjallur interesim të madh ndër gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj, rrjedhimisht për këtë dukuri janë shkruar disa artikuj e studime të ndryshme. Në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe I (në hartat 8, 9, 10, 11, 12) është paraqitur përndarja e fonemave hundore /ã/, /ẽ/, /ĩ/, /ỹ/, /ũ/ në të gjitha të folmet shqipe të trungut e të diasporës nëpërmjet fjalëve *bãn* 'bën', *ẽn* 'end', *u pĩ* 'u mpi', *sỹ* ose *sø* 'sy', *hũ* 'huri'. Më pastaj, në hartën përgjithësuese nr. 19 janë paraqitur të gjitha seritë e fonemave zanore të theksuara. Sipas kësaj harte përgjithësuese mund të përfundohet se kemi tri areale:

1. Areal me një seri fonemash zanore të theksuara:

a) vetëm me serinë e zanoreve gojore të shkurtra,

që përfshin të folmet toske (me përjashtim të një rripi të folmesh përgjatë bregdetit të Jonit në Labëri e në Çamëri, të arbëreshëve të Greqisë e disa të folme arbëreshe të Italisë);

2. Areal me dy seri fonemash zanore të theksuara:

a) me serinë e zanoreve gojore të shkurtra, dhe

b) me serinë e zanoreve gojore të gjata,

që përfshin të folmen e Dibrës, rripin e të folmeve përgjatë bregdetit të Jonit në Labëri e në Çamëri, arbërishten e Greqisë e disa të folme arbëreshe të Italisë);

3. Areal me tri seri fonemash zanore të theksuara:

a) me serinë e zanoreve gojore të shkurtra,

- b) me serinë e zanoreve gojore të gjata, dhe
- c) me serinë e zanoreve hundore, që përfshin të gjitha të folmet e gegërishtes, përveç të folmen e Dibrës.

Konstatimi i përgjithshëm se toskërishtja (dhe shqipja standarde) nuk ka fonema zanore hundore është plotësisht i saktë dhe ka karakter universal, ashtu siç është i saktë konstatimi i përgjithshëm se të folmet gege kanë një inventar vokalik prej dy seri zanoresh: a) zanore gojore të shkurtra, dhe b) zanore gojore të gjata.

Por, se të folmet gege në gjendjen e sotme kanë fonema zanore hundore është i diskutueshëm. Duhet **rishqyrtuar vlera fonologjike e zanoreve hundore të në të folmet e gegërishtes veç e veç**. Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore gege; por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute. Gjykojmë se hundorësia e zanoreve tani më është defonologjizuar jo vetëm në nëndialektin e gegërishtes jugore, por edhe në shumë të folme të nëndialektit të gegërishtes veriore. Sistemi vijor (segmentor, linear) i variantit dialektor të shqipes, veçmas i të folmeve gege, duhet analizuar si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

Fonetikanët kanë shpjeguar prej kohësh se hundorësia shtrihet sidomos ndër zanoret që pas tyre kemi një bashkëtingëllore hundore [n, m, nj]. Ky hundorëzim është rezultat i përshtatjes nyjetimore të zanoreve nën ndikimin e bashkëtingëlloreve hundore në takim, i përzierjes nyjetimore të fazës së fundit të zanores me fazën e fillimit të bashkëtingëllores hundore, përkatësisht rrjedhë e ndryshimeve kombinatorë që shkaktohen për shkak të akomodimit të organeve të të folurit (Asllan Hamiti, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe, Shkup, Interdiskont, 2005, f. 218-220). Zanorja /ë/ e theksuar nuk bën pjesë në inventarin vokalik të të folmeve gege, ndërsa /o/-ja nuk i nënshtrohet hundorësisë. Prandaj, nëpër të folmet gege me hundorësi mund të dëgjojmë 6 zanore /ĩ/, / ŷ/, /ó/, /ě/, / ã /, /ũ/ e më pak.

Siç dihet, në të folmet e gegërishtes shqiptohen me timbër hundor ato zanore që gjenden ose dikur janë gjendur në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore [m, n, nj], sipas skemës:

zanore + bashkëtingëllore hundore > zanore me timbër hundor:

[a] + [n] = **tingull [ã] të hundorëzuar = /ã/ fonemë hundore**, në qoftë se krijon kundërvënie fonologjike me zanoren përkatëse gojore.

Është pranuar nga të gjithë se zanoret hundore, krahas zanoreve gojore dikur kanë qenë të mbarë shqipes, me intensitet më të ulët në të folmet e gegërishtes dhe me intensitet më të lartë në ato të toskërishtes, por në një fazë të zhvillimit të saj, në të folmet e Jugut rotacizmi (shndërrimi i [n]-së ndërzanore në [r], që ka vepruar para më se 1300-1500 vjetësh) shkaktoi edhe çhundorëzimin e zanoreve (Shaban Demiraj, Fonologjia historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1996).

Ka zanore me hundorësi në këto pozicione:

- a) përpara bashkëtingëlloreve hundore;
- b) pas bashkëtingëlloreve hundore;
- c) në mes dy bashkëtingëlloresh hundore;
- ç) kur pas zanores ka qenë një bashkëtingëllore hundore që ka rënë;
- d) hundorësi për ngjashmëri (analogji).

Në përshkrimin dialektor të çdo të folmeje gege kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat gojore duhet parë në çifte minimale fjalësh, si p.sh.:

- /a:/ ~ /ã:/: *ha:n* (ata hanë) ~ *hã:n* “hënë”, *va:th-i* ~ *vã:th-t* “vëthët”;
- /ã:/ ~ /a:/: *kã:m* “këmbë” ~ *kam* (unë), *hã:n* “hënë” ~ *han* (ai ha), *atã* “atë” ~ *ata*, *ktã* “këtë” ~ *kta* “këta”;
- /ã/ ~ /ã/: *lãm* (ne) “lam” ~ *lã:m* “lëmë”, *kãn* “kanë” ~ *kã:n* “kënë”;
- /e:/ ~ /ẽ:/: *ve:* “vezë” ~ *vẽ:* “(unë) vë”;
- /i/ ~ /ĩ:/: *mi* (djemt e) “mi” ~ *mĩ:* “miu”etj., por ato mund të jenë të ndryshme nga një e folme në një të folme tjetër.

Në qoftë se një e folme ka çifte të tilla ose të ngjashme fjalësh, atëherë mund të nxirret përfundimi se ajo e folme, përveç gojoreve, ka fonema të veçanta hundore, që krijojnë edhe seri fonemash më vete, të cilat mund t’i quajmë **zanore hundore**. Nga ana tjetër, nëse nuk kemi çifte fjalësh të tilla, rrjedhimisht realizimet e zanoreve me timbër hundor janë variante kombinatorë të fonemave përkatëse gojore, rrjedhimisht ato nuk krijojnë seri të posaçme fonemash dhe mund të quhen **zanore të hundorëzuara**.

Megjithëse shqiptimi i ndërhundshëm i zanoreve në të folmet Veriore të shqipes ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, prapë kanë mbetur pa u sqaruar përfundimisht disa çështje të rëndësishme:

1. Cilat të folme gege kanë fonema zanore hundore e cilat kanë zanore të hundorëzuara?
2. Çfarë inventari vokalik kanë të folmet veç e veç?
3. Çfarë kundërvëniesh krijojnë ato me zanoret e tjera hundore e gojore?
4. Çfarë shkalle të hundorësisë kanë ato?
5. Vallë në gjendjen e sotme hundorësia e zanoreve në të folme të veçanta gege është defonologjizuar apo jo?
6. A formojnë zanoret hundore në mbarë gegërishten seri zanoresh më vete apo diku janë variante kombinatorë të zanoreve përkatëse gojore?

Nuk mëtojmë se mund të japim përgjigje në këto çështje, por po i parashtrojmë si një nga detyrat që duhet zgjidhur në të ardhmen me një bashkërendim të punës, jo vetëm për këtë problematikë, por edhe për çështje të tjera të dialektologjisë e të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi (Asllan Hamiti, Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike, Aktet, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Vëllimi I, nr. 1, 2008).

Bie fjala, ka mundësi të hartohet një pyetësor dialektor i veçantë për vjeljen e materialit në fushën e fonetikës e të fonologjisë, në të cilin do të përfshihen pyetje për kundërvëniet fonologjike të zanoreve sipas mungesës ~ pranisë së hundorësisë dhe ai t’u shpërndahet specialistëve në të gjitha hapësirat ku flitet shqipja. Materialet e siguruar përmes kësaj forme të grumbullohen, sistematizohen dhe përpunohen, natyrisht duke u mbështetur në të dhënat që mund të sigurohen edhe nga punimet e deritashme si dhe nga Atlasi dialektologjik i shqipes.

Në studimet e deritashme dialektore për të folme të veçanta gege vërehet një larmi e madhe. Kjo laryshi është e natyrshme po të kihet parasysh se:

a) Përshkrimi i të folmeve tona është bërë brenda një periudhe kohore 50-60 vjeçare, kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore e deri më tani.

b) Një numër jo i vogël gjuhëtarësh janë marrë me studime dialektore në fazën e hershme të pjekurisë profesionale.

c) Gjatë vjeljes së materialit dialektor dhe përpunimit të tij janë përdorur metoda kërkimore-shkencore të ndryshme.

ç) Veshi ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite aparati i vetëm i përshkrimit të të folmeve tona.

d) Sistemi tingullor në disa përshkrime të folmesh është paraqitur shkarazi, vetëm në aspektin fonetik, ndërsa mungon pikëpamja fonologjike.

Fjala vjen, mund të lexojmë përshkrime të folmesh gege ku thuhet se “akëcila e folme përveç zanoreve gojore ka edhe zanore hundore”, por nuk jepen çifte minimale fjalësh për të përdëftuar vlerën fonologjike të tyre, e as nuk saktësohet inventari i fonemave zanore. Është e vërtetë se çdo e folme gege ka zanore të hundorëzuara. Pra, mungon vështrimi fonetiko-eksperimental (deri më tani kemi vetëm një të këtij lloji për të folmen e Shkodrës) dhe ai fonologjik (me disa përjashtime). Kuptohet se vëzhgimet eksperimentale kërkojnë mjete teknike ndihmëse të posaçme, laborator të fonetikës eksperimentale, të cilin fatkeqësisht nuk e kemi as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoni. Për këndvështrimin fonologjik të sistemit tingullor të të folmeve lipset një përgatitje e nevojshme teorike dhe një përkushtim e punë serioze, veçmas tani kur literatura përkatëse teorike (Dodi, Anastas: *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, IGjL, Tiranë, 2004); dhe modelet e mira të monografive dialektore nuk mungojnë (Shkurtaj, Gjovalin: *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, *Dialektologjia shqiptare IV*, IGjL, Tiranë, 1982, f. 144-278). Praktikisht, **për çdo të folme fonemat duhet identifikuar nëpërmjet kundërvënieve fonologjike** (kuptimdalluese ose gramatikore).

Prania e hundorësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut etj.

Përgjithësisht, në të folmen e skajshme të etnisë: të Preshevës, të Bujanovcit, të Ulqinit, të Llapit e Gollakut si dhe në të folmet lindore të gegërishtes qendrore (veçmas ato të Maqedonisë) hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, përkatësisht aty më nuk mund të gjejmë çifte minimale fjalësh me kundërvënie zanore gojore me zanoren hundore përkatëse.

Nga leximi i punimeve përshkruese të të folmeve gege, lidhur me hundorësinë e zanoreve nuk mund të përftohet pasqyrë e qartë: në disa përshkrime dialektore fitohet ideja se hundorësia e zanoreve ka vlerë fonologjike, ndërsa në disa punime të tjera nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme për ta pohuar ose për ta mohuar atë. Gjatë punës sonë në të ardhmen nuk duhet të kënaqemi vetëm me konstatimin se “në një të folme gege dëgjohen apo nuk dëgjohen zanore hundore”, kur dihet se hundorësia fonetike e zanoreve është veçori e përgjithshme e dialektit Verior, por duhet analizuar vlera fonologjike e tyre, duhet përcaktuar inventari vokalik me: a) serinë e zanoreve gojore të shkurtra, b) serinë e zanoreve të gjata, dhe c) serinë e zanoreve hundore. Gjithsesi, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera duhet rishqyrtuar.

Për gjendjen e sotme të studimeve dialektore në përgjithësi mund të thuhet se shkalla e hundorësisë së zanoreve bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike të tyre: sa më në veri që janë, hundorësia është aq më e madhe dhe anasjelltas. Kështu, në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes kemi një hundorësi me intensitet të lartë, ndërsa në nëndialektin e gegërishtes jugore kemi një shkallë më të ulët hundorësie. Zaten, po të duam të krahasojmë të folmet e Kosovës me të folmet shqipe të Maqedonisë, sipas një shkallëzimi hundorësie, duke filluar nga një shkallë më e lartë e përfunduar me një shkallë më të ulët, afërsisht do të kishim edhe një zbritje gjeografike veri - jug: të folmet e Kosovës, të Preshevës e Bujanovcit, të folmet e Kumanovës, të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës dhe të Strugës. Në këto dy të folmet e fundit pothuajse nuk dëgjojmë fare zanore me timbër hundor. Por, ashtu si për gjatësinë e zanoreve, edhe për shkallën e hundorësisë fjalën e fundit mund ta thotë vetëm analiza laboratorike, ndërsa vlera e tyre fonologjike duhet provuar me metodën e zëvendësimit (komutacionit).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha **ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve.** Nga punimet dialektore që na kanë rënë në dorë, kemi fituar përshtypjen se të folmet e nëndialektit jugor të gegërishtes po shkojnë drejt çhundorëzimit dhe në këtë proces prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë, ku hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, ndërsa gjatësia e tipit fonologjik ende ruhet (sidomos në saje të mosshqiptimit të [ë]-së fundore). Në nëndialektin verior të gegërishtes aty-këtu (por jo gjithkund) vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

Si përfundim, nga monografitë, nga punimet dialektore për të folmet e gegërishtes që i kemi konsultuar gjykojmë se hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes është përzierje e sistemit të vjetër të trashëguar me zanore hundore që janë fonema më vete, me tipin e ri të hundorësisë jofonologjike. Edhe brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve gojore me zanoret hundore nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi. Ajo ka filluar të lëkundet dhe **gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanore hundore.**

Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Kjo tregon se gegërishtja në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: pjesa më e madhe e të folmeve të nëndialektit verior gegë e ruan tipin fonologjik të hundorësisë, ndërsa një numër i madh i të folmeve të nëndialektit të gegërishtes jugore, prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë, kanë evoluar në tipin fonetik të hundorësisë. Edhe atje ku ruhet kundërvënia fonologjike e mungesës kundruall pranisë së hundorësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. **Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar.** Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Nga materiali i vjelë dialektor në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit e patëm shumë vështirë të gjejmë çifte leksikore të tilla ku kuptimi i fjalës do të identifikohet me mungesën apo praninë e hundorësisë së zanores. Pas një përpjekjeje serioze, arritëm të veçonim vetëm pesë çifte fjalësh me kundërvënie fonologjike zanore gojore ~ zanore hundore, katër që realizohen ndërmjet /a/ ~ /ã:/ dhe një fjalë me opozicionin /âi/ ~ /aj/, si më poshtë:

<i>fonema zanore gojore</i>		<i>kundërvënie fonologjike</i>	<i>fonema zanore hundore</i>	
në Karadak	në shqipen		në Karadak	në shqipen standarde

	standarde			
rrâi	rri	/âi/ ~ /aj/	rrã:j	(geg. rrãnjë), rrënjë
lam	(ne) lamë	/a/ ~ /ã:/	lã:m	lëmë
jan	jan, qilim	/a/ ~ /ã:/	jã:n	janë (ata)
tan	tanë (djemtë)	/a/ ~ /ã:/	tã:n	e tund
kan	kanë (ata)	/a/ ~ /ã:/	kã:n	qan, kënë

Shënim: Përveç kundërvënies zanore gojore ~ zanore hundore, këtu realizohet edhe kundërvënia zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë.

U tha edhe më parë se edhe në të folmet geqe ka areale pa fonema zanore hundore. Të tilla janë të folmet e anës së Dibrës, të Rekës së Epërme të Gostivarit, të Velesit, të Prilepit, të Krushevës, të Preshevës, të Ulqinit ose edhe ndonjë tjetër. Në të vërtetë, që nga të folmet shqipe të Karadakut të Shkupit, të Karshiakës (rrethina e Shkupit), të Dervenit (zonë midis Shkupit e Tetovës), të Tetovës, Gostivarit, Kërçovës e të folmet geqe të Strugës shkalla e hundorësisë së zanoreve është shumë e vogël. Te folësit e këtyre krahinave, veçmas të zonave nga Tetova e më në jug të të folmeve shqipe në Maqedoni më nuk dëgjojmë zanore me timbër hundor. Në çhundurëzimin e zanoreve në të folmet skajore të të folmeve lindore të gegërishtes qendrore, përkatësisht të të folmeve shqipe në Maqedoni, veç faktorëve brendagjuhësorë, si duket ka ndikuar edhe gjuha në takim, pra maqedonishtja (që nuk ka zanore hundore as në variantin dialektor e as në variantin standard) si dhe veprimi rrafshues i shqipes standarde (sidomos nëpërmjet shkollës dhe medieje).

Edhe pse **zanoret hundore janë pjesë përbërëse e shprehisë nyjëtimore të folësve gegë**, ekzistimi i një numri të vogël çiftesh minimale të fjalëve, të cilat dallohen vetëm për nga kundërvënia zanore gojore ~ zanore hundore, dëshmon prirjen e të folmeve të gegërishtes, sidomos të gegërishtes jugore për **bjerrjen e vlerës funksionale të hundorësisë**, përkatësisht defonologjizimin e hundorësisë, kalimin nga karakteri fonologjik në karakterin fonetik, zvogëlimin e inventarit të fonemave zanore (vetëm me zanore gojore të shkurtra ~ të gjata).

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Toskërishtja ka vetëm zanore gojore, ndërsa gegërishtja përveç zanoreve gojore (orale), ka edhe zanore hundore (nazale)

Prania e zanoreve hundore në të folmet e dialektit Verior dhe mungesa e tyre në dialektin Jugor është një dukuri fonetike e fonologjike e rëndësishme që dallon dy dialektet e shqipes. Zanoret hundore në këto të folme gjenden ose janë gjetur para bashkëtingëlloreve hundore /m, n, nj/. P.sh. *nãn, kãm, shullã:, ãnërr, lãmsh, shkãm, zã:, zëmër, fëmën, mrëna, pë:, frë:, drũ:, hũ:, gũ:, sÿ:, drÿ, hĩni, brĩ:* etj.

Shkalla e hundorësisë së zanoreve është e kushtëzuar nga pozita që ka zanorja në fjalë. Kështu, zanoret kanë hundorësi më të madhe kur gjenden në rrokje të hapur fundore sesa kur gjenden në rrokje të mbyllur. Kjo varësi mund të dëgjohet edhe në fjalët e njëjta, khs. *zã:* - *zãni*, *pë:* - *pëni*, *frë:* - *frëni*, *hĩ:* - *hĩni*, *mĩ:* - *mĩni* etj.

Për shkak të kundërvënieve fonologjike të fonemave zanore hundore me gjegjëset e tyre gojore, të tipit (na) *lam* ~ *lã:m* '(ne) lam - lëmë-a', (ata) *kan* ~ *kã:n* '(ata) kan - kën-ë,-a' etj. shumë të folme të gegërishtes në inventarin e tyre, përveç serisë së zanoreve gojore të shkurtra dhe të gjata, kanë edhe serinë e fonemave zanore hundore. Numri i fonemave hundore është më i

vogël sesa i gojoreve, prej 2-3 deri më 5-6: /ã/, /ë/, /ĩ/, /ỹ/, /ũ/ etj., por inventari i fonemave zanore e bashkëtingëllore duhet përcaktuar për çdo të folme veç e veç.

Shkalla e shqiptimit të ndërhumshëm ndryshon nga një krahinë në tjetrën. Marrë në përgjithësi, shkallë më të lartë të timbrit hundor kanë të folmet më veriore të gegërishtes, ndër to me nuancë më të fuqishme hundore dallohen të folmet verilindore e veriperëndimore të Gegërisë. Gjeografikisht duke zbritur më poshtë në të folmet e gegërishtes qendrore e më pas në ato të Shqipërisë së Mesme, shkalla e hundorësisë gradualisht zvogëlohet. Në të folmet kalimtare aty-këtu vetëm sa dëgjohet një timbër i lehtë hundor, ndërsa në të folmet e toskërishtes më nuk kemi zanore hundore e as të hundorëzuara.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Çështë hundorësia e zanoreve?
2. Përkufizo çfarë janë zanoret hundore e çfarë zanoret e hundorëzuara?
3. Cilat të folme të gegërishtes kanë zanore hundore e cilat zanore të hundorëzuara?
4. Çfarë zanoresh ka e folmja jote?

4.3. THEKSI

Tipare të përgjithshme të theksit në gjuhën shqipe

Theksi, në kuptimin më të ngushtë, zakonisht përkufizohet si të spikaturit e një rrokjeje me mjete të ndryshme fonetike. Theksi është të spikaturit e rrokjes me anë të forcës, të gjatësisë dhe të lartësisë së tonit. Rrokja që veçohet nga të tjerat për nga shqiptimi (me fuqi, gjatësi dhe lartësi më të madhe të tonit) është rrokje e theksuar, ndërsa të tjerat janë rrokje të patheksuara. Për shkak se njëra nga rrokjet që ka theksin dallohet nga rrokjet e patheksuara, në renditjen vijore të tingujve krijohet një kontrast fonetik. Tingujt e rrokjes së theksuar, ve]mas zanoret, dallohen fonetikiht nga tingujt e rrokjeve të patheksuara. Krahasoni zanoret e theksuara nga të patheksuarat në fjalët: *shkóllë, punëtór, përrúa, mësúes, përparimtar, líbër, njerí, lexój, dritáre, studént, pranvérë* etj.

Dihet se theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit të fjalëve, duke ruajtur pozicionin e tij të formave përfaqësuese (formave bazë të fjalëve), përkatësisht duke e ruajtur pozitën e tij të rasës emërore numër njëjës në lakimin emëror dhe atë të vetës së parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor. P.sh.: *mál, máli, i málit, málin, mále, málet, málesh, máleve; flútur, flútura, flúturat, flúture, flúturash, flúturave; qytetar, qytetári, qytetárit, qytetárin, qytetarë, qytetarët, qytetarësh, qytetarëve; láj, lán, lájme, láni, lájne; láva, láve, láu, lája, (kam, jam) lárë; punój, punón, punójme, punóni, punójne; punója, punóje, punónte, punónim, punónit, punónin; punóva, punóve, punói, punúam, punúat, punúan; kam punúar* etj. Te togjet e zanoreve, theksi bie mbi elementin e parë të togut: *i edukúar, grúa, përrúa, thúa, mësúes, i dëgjúeshëm, díell, qíell, fýell, përkthýes* etj. Pra,

karakteristikë themelore e gjuhës shqipe është se ajo ka theks të palëvizshëm (të qëndrueshëm), meqenëse gjatë lakimit ose zgjedhimit të fjalëve, theksi mbetet në po atë rrokje.

Tiparet e theksit në gjuhën shqipe janë: intensiteti, lartësia, gjatësia, përqendrimi apo shpërqendrimi dhe qartësia e timbrit, d.m.th., a) zanoret e theksuara shqiptohen me forcë dhe lartësi më të madhe, b) të theksuarat janë më të gjata se të patheksuarat, c) zanoret e patheksuara kanë prirje të bëhen më qendrore, dhe ç) zanoret e theksuara shqiptohen me qartësi më të madhe sesa të patheksuarat.

Theksi në fjalë leksikalisht të ndryshme mund të bjerë në rrokje të ndryshme, përkatësisht në një të njërin nga dy rrokjet e fundit të fjalës (rrallë në rrokjen e tretë). Përkatësisht, në gjuhën shqipe 54 % e fjalëve shqiptohen me theks parafundor, 44 % me theks fundor dhe vetëm 2 % me theks tejfundor.

Theksi përgjithësisht në gjuhën shqipe është i ngulitur. Më të shpeshta janë fjalët me theks fundor (lexóji), parafundor (shkóllë) e më të rralla me theks tejfundor (flútura, punúakemi). Në fjalët e prejardhura me prapashtesim (përveç prapashtesave -as, -ës dhe -je), theksi vendoset në prapashtesë (gojëtar), ndërsa në fjalët e përbëra a kompozita (botëkuptim) dhe në fjalët e përngjitura (dalëngadálë) theksi vendoset në elementin e dytë, përkatësisht në elementin e fundit fjalëformues.

Përmbledhtas mund të thuhet se ndër tiparet themelore të theksit të shqipes, të analizuarë e të pranuar nga shumë gjuhëtarë, janë:

- a) lidhur me llojin e theksit: *shqipja ka theks dinamik*;
- b) lidhur me lëvizshmërinë e tij: *shqipja ka theks të ngulitur në paradigmat e eptimit*;
- c) lidhur me vendin e theksit brenda fjalës: *shqipja nuk thekson mbaresat dhe ka prirje të theksojë zanoret parafundore*.

Karakter i parafundor i theksit të shqipes duhet pranuar vetëm në aspektin morfologjik, meqenëse shqipja nuk thekson mbaresat; si rrjedhim, duke pasur, përgjithësisht, një mbaresë, krijohen fjalë me theks parafundor (khs. *fish-ë, fish-e, fish-a; lis-i, lis-a; ha-më, ha-ni, tha-shë, puno-va* etj.). Kështu, karakteri parafundor i theksit të shqipes nuk qëndron për fjalën në vetvete, jashtë treguesve gramatikorë. Këtë e tregojnë fjalët e shumta me theks fundor, si emrat *armik, qersh, shtëpi, bukuri, punëtor, arsimtar, pullaz, ...*, foljet *punoj, mësoj, lexoj, bashkoj, ushqej, lulëzoj, ...*, që janë plotësisht në natyrë të shqipes (Kolec Topalli, Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995, f. 53-57).

Disa huazime leksikore shqipja i ka përshtatur (adaptuar) sipas natyrës së vendit të theksit në shqipen, ndërsa disa të tjera e ruajnë theksin si në gjuhën dhënëse (prej nga vijnë). Pra, përgjithësisht ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. Rol të rëndësishëm për adaptimin e theksit të fjalëve të huazuara luajnë koha (se a janë huazime të vjetra apo të reja) dhe denduria e përdorimit të tyre. Parimisht, sa më gjatë të jenë në përdorim, aq më tepër janë përshtatur; dhe sa më shpesh që përdoren aq më shumë kanë gjasa të adaptohen e anasjelltas. Shqipja ka prirje ta vendosë theksin e fjalës në rrokjen parafundore. P.sh. te sllavizmat dialektorë në gjuhën shqipe theksi nga rrokja e tretë zhvendoset në rrokjen e dytë, si sll. *névolja* - shq. *nevóje*, sll. *lópata* - shq. *lopátë*, sll. *lédina* - shq. *ledínë* etj., por disa fjalë shqiptohen me theks në rrokjen fundore.

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Zhvendosja e theksit te disa orientalizma në gegërishte nga rrokja fundore në rrokjen parafundore

Në karakterin e theksit, shqipja dialektore dhe standarde është mjaft unike: theksi gjithkund është dinamik, i lirë dhe i palëvizshëm. Rregulla e përgjithshme e vendosjes së theksit mund të përcaktohet si vijon: Në gjuhën shqipe letrare e dialektore theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese.

Tipar dallues, tani më i pranuar nga të gjithë gjuhëtarët, ndërmjet dy dialekteve të shqipes është zhvendosja e theksit te disa orientalizma në gegërishte nga rrokja fundore në rrokjen parafundore. Në karakterin e theksit shqipja dialektore (gege e toske) dhe standarde është mjaft unike: theksi gjithkund është dinamik, i lirë dhe i palëvizshëm. Rregulla e përgjithshme e vendosjes së theksit mund të përcaktohet si vijon: Në gjuhën shqipe letrare e dialektore theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese.

Në shtrirjen dialektore të shqipes, në theks dallohen pak fjalë të tipit: tosk. *njerí* - geg. *njëri*, *një:r*; tosk. *verí* - geg. *véri*, tosk. *qirí* - geg. *qíri*, *çíri* etj., të cilat përgjithësisht në të folmet e toskërishtes shqiptohen me theks fundor, ndërsa në të folmet e gegërishtes me theks parafundor (Shih hartat 130, 131, 1`32, 133 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Theksimi parafundor përbën modelin karakteristik të skemës theksore të fjalëve të shqipes, prandaj edhe disa fjalë të huazuara nga turqishtja, në të folmet e gegërishtes e rregullojnë theksin sipas natyrës së shqipes me të ashtuquajturin rregullim mekanik të theksit, ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohen me theks fundor (ashtu si ka qenë në gjuhën nga janë huazuar). Khs. fjalët e njëjta në toskërishte e në gegërishte: *kafé* - *káfe*, *teneqé* - *tenéqe*, *tenxheré* - *tenxhére*, *teqé* - *téqe*, *minaré* - *mináre*, *kadifé* - *kadífe*, *zahiré* - *zahíre*, *penxheré* - *penxhére*, *babá* - *bábë* > *bá:b*, *pashá* - *pásha* > *páshë* > *pá:sh*; *pará* - *páre*, *bakllavá* - *bakllávë* > *bakllá:v*; te disa emra vetjakë me burim oriental *Fatimé* - *Fatíme*, *Hatixhé* - *Hatíxhe*, *Ajshé* - *Ájshe*, *Makfiré* - *Makfíre* etj.

Kjo zhvendosje e theksit në disa orientalizma nga rrokja fundore në rrokjen parafundore trajtohet si dukuri dalluese fonetike ndërmjet dy dialekteve të shqipes. Por, duhet thënë se ka shumë fjalë të huazuara orientale që edhe në dialektin Verior shqiptohen me theks në rrokjen fundore, si p.sh. *sefá*, *belá*, *sevdá*, *e xhumá*, *dynjá*, *hatá*, *xhamí*, *bojaxhí*, *teneqexhí*, *rahmetlí*, *hujlí*, *sheherlí* etj.

Në gjithë shqipen (në gegërishte, në toskërishte e në standard) në fjali rëndom fjalët shërbyese (pjesëzat, lidhëzat, nyjat e përparme, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, parafjalët etj.) bëhen të patheksuara dhe shqiptohen me një theks të vetëm me fjalët emërtuese (emrat, mbiemrat, foljet, përemrat, numërorët, ndajfoljet), si *Një-lépur-i-ri zemërák u-ul nga-máli në-fúshë dhe-hýri në-një-pemíshhtë / ku-gjéti të-gjútha-të-mirat*. Përveç fjalëve të patheksuara, në ligjërim ka edhe fjalë të theksuara dobët (rrötull shtëpísë) e fjalë me theks dytësor (flùturím).

Theksimi në mënyrë të rëndomtë është tipar i ligjërimin asnjës (neutral), ndërsa shpeshherë edhe në ligjërimin dialektor përdorim theks logjik dhe emocional, me qëllim që të rritet pesha kuptimore a emocionale e thënies në variante të ndryshme. Variantet sjellin me vete ngjyrimet krahinore (*kafé* - *káfe*, *teneqé* - *tenéqe*, *njerí* - *njëri*, *verí* - *véri*), sociale, kulturore, që shfrytëzohen në gojëtarë, humor, teatër, film e më së shumti në poezi.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç'është theksi?
2. Thoni tiparet e përgjithshme të theksit në gjuhën shqipe.
3. Çfarë ngjashmërie dhe çfarë dallimi kanë të folmet shqipe në theksin e fjalës?
4. Si është bërë përshtatja theksore e huazimeve në shqipen?
5. Bëje një punim në temën: *Theksi në të folmen time*.

4.4. PËRCAKTIMI I INVENTARIT TË FONEMAVE ZANORE TË TË FOLMEVE

Tërësia e fonemave zanore e bashkëtingëllore të një të folmeje përbën inventarin vokalik dhe konsonantik të saj. Inventari i fonemave dhe kundërvëniet (opozicionet) që kanë ndërmjet tyre formojnë sistemin fonologjik të gjuhës përkatëse. Sistemet fonologjike të gjuhëve, dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve dallojnë midis tyre jo vetëm nga numri i fonemave që përfshihen në to dhe nga raportet që vendosen mes fonemave të një sistemi, por edhe nga substanca fonetike e tyre. Inventari i fonemave zanore përcaktohet në bazë të zanoreve në rrokje të theksuar.

Se një tingull është variant fonetik i një fonemeje të vetme apo fonemë më vete më së miri dallohet në çifte minimale fjalësh (fjalë që në përbërjen e tyre dallohen vetëm me një njësi vijore). Për të provuar funksionin dallues të fonemave, përdoret metoda e zëvendësimit (komutacioni) të një fonemeje me një tjetër. Në qoftë se në çifte minimale fjalësh këmbimet e fonemave dallojnë njërin nga tjetra për nga kuptimi ose nga ndonjë tipar morfologjik, atëherë ato janë fonema më vete. Por, nëse dy tinguj që i zëvendësojmë njërin me tjetrin në çifte fjalësh nuk kanë vlerë kuptimdaluese e as gramatikore, atëherë ato janë variante fonetike të një fonemeje të vetme. P.sh. /i/-ja dhe /y/-ja janë fonema më vete, sepse dallon kuptimi i fjalëve: *di ~ dy, si ~ sy, pikë ~ pykë, mik ~ myk*; ashtu siç janë fonema më vete bashkëtingëlloret /a/ dhe /e/ meqë në kundërvëniet (opozicionin) e tyre dallohet njëjësi nga shumësi (*dash ~ desh*), veta e parë nga veta e dytë (*dal ~ del, marr ~ merr*) etj. Në çiftet e fjalëve *tash ~ dash, tru ~ dru, ti ~ di, tu ~ du, tel ~ del*; /t/-ja dhe /d/-ja janë fonema më vete, por në variantin dialektor të Veriut e të Jugut në fjalët *vend - vënt, zog - zok, breg - brek* etj. [k]-ja dhe [g]-ja janë alofone dialektore që lidhen me pozicionin fundor të fonemës /g/, por jo fonema të veçanta.

Një nga detyrat parësore, të domosdoshme e të nevojshme të dialektologut është përcaktimi i sasisë së fonemave i të folmes që përshkruan. Në disa monografi dhe në përshkrime të tjera të tipit të mesëm e në skica dialektore të deritashme, nuk është dhënë inventari i fonemave të të folmes në vëzhgim. Praktikisht, shpeshherë tingujt janë vëzhguar vetëm nga pikëpamja fonetike, por jo edhe nga pikëpamja fonologjike, pra nga funksioni i tyre në gjuhë. Për

të inventarizuar me sukses fonemat zanore e bashkëtingëllore, lipset një përgatitje e mirë teorike e praktike fonologjike e dialektologut. Pa një parapërgatitje solide teorike fonetike e fonologjike nuk mund të përcaktohet me saktësi inventari i fonemave, veçmas i fonemave zanore, e as të nxirren në shesh me sukses tiparet fonetike e fonologjike të të folmes. Ngjashëm me këtë, nuk mund të bëhet përshkrimi morfologjik i të folmes, pa njohuri të thelluara të morfologjisë; nuk mund të studiohet leksiku i një të folmeje, pa njohuri solide leksikologjike, pa njohjen e sintaksës, nuk mund të studiojmë strukturën sintaksore të një të folmeje.

Fatmirësisht, deri më tani në studimet për shqipen është punuar jo pak dhe të interesuarit kanë çka të lexojnë e të mësojnë. Prandaj, për studentët si dhe për studiuesit e rinj që duan të merren me studime dialektore, e vlefshme është këshilla që: së pari duhet pajisur me njohuri teorike e praktike në atë fushë studimi, në shqip e në gjuhë të tjera (fonetikë e fonologji, morfologji, leksikologji, sintaksë), të lexojnë monografi dialektore, të shfletojnë e analizojnë me kujdes Atlasin dialektologjik të shqipes, të konsultohen me njerëz me përvojë etj., e më pas t'i rreken vjeljes së materialit dhe përshkrimit të një të folmeje të caktuar.

Në përshkrimin e të folmes nuk duhet të jemi robër të përgjithësimeve që vlejnë për gjithë makrosistemin a mikrosistemet. Fjala vjen, përveç të folmeve geqe, ka edhe të folme toske që kanë inventar të fonemave zanore të gjata; jo të gjitha të folmet geqe doemos duhet të kenë fonema zanore hundore; jo të gjitha të folmet e gegërishtes qendrore doemos të diftongojnë [i]-në dhe [u]-në e theksuar etj. Konceptet e këtilla janë të vjetruara, të tejkaluara e të pasakta.

Çdo areal ka një inventar të caktuar fonemash, që e dallon atë nga arealet e tjera dialektore. Asnjë areal nuk e ka gjithë numrin e inventarit të fonemave zanore të të gjitha të folmeve të marra së bashku. Në çdo areal sasia e fonemave zanore është gjithmonë më i vogël se inventari i përbashkët i të folmeve të të dy dialekteve. Areali me inventarin më të vogël ka gjashtë fonema zanore, kurse areali me inventarin më të madh ka nëntëmbëdhjetë fonema zanore. Arealet e tjera kanë një inventar që lëviz nga 7 deri në 17 fonema zanore. Areali me inventarin më të vogël shtrihet në pjesën jugore të Shqipërisë, në një hapësirë të kufizuar që përfshin qytetin e Gjirokastrës me rrethinat, zonën e Kardhiqit, Libohovën, Nepravishtën dhe zonën e Delvinës. Ato kanë vetëm inventarin e fonemave zanore gojore të shkurtra (siç e ka edhe shqipja standarde), por pa fonemën /y/, ashtu si mungon ajo edhe në disa të folme të labërishtes dhe në të folmet e çamërishtes (Gjinari - Shkurtaç, 1997: 113-114). Numri i fonemave zanore në të folmet e gegërishtes është më i madh sesa në të folmet e toskërishtes.


Në dialektin jugor të shqipes veçohen të folmet e labërishtes, sidomos ato të Kurveleshit dhe të Bregdetit, si dhe të folmet e çamërishtes, të cilat ruajnë ende zanore të gjata. Rrjedhimisht, ato kanë 12 fonema zanore, përkatësisht 6 të shkurtra: /ã, ẽ, ẽ, õ, ĩ, ũ/ dhe 6 të gjata: /a:, e:, ẽ:, o:, i:, u:/. Përgjithësisht dihet se të folmet e gegërishtes nuk kanë fonemë /ẽ/ në rrokje të theksuar, prandaj del se kanë serinë e fonemave zanore të shkurtrta, me 6 zanore: /ã, ẽ, õ, ĩ, y, ũ/; serinë e zanoreve të gjata me 6 zanore: /a:, e:, o:, i:, y, u:/ dhe ndonjë prej tyre edhe serinë e zanoreve hundore me 4 fonema: /ã, ẽ, ĩ, ũ, ÿ/. Zanorja /o/ në asnjë të folme të shqipes nuk është hundore, por e hundorëzuar, që është përfutur nga buzorëzimi i /ã/-së hundore. Në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore mungon fonema /y/, meqë ajo është zhbuzorëzuar në /i/, rrallëherë në /u/ e më pas ka pësuar diftongim (Shih hartat 18, 19, 20 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Të folmet shqipe dallohen dukshëm në alofoninë e fonemave zanore, si në shkallën e hapjes së zanoreve: diku shqiptohen më të hapura e diku më të mbyllura. Në të folmet e gegërishtes veriore zanoret gojore të shkurtra shqiptohen më të hapura se në të folmet e tjera të shqipes, sidomos se në të folmet e toskërishtes (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, ShBLU, Tiranë, 1997, f. 119). Disa zanore nëpër të folmet shqipe realizohen jo vetëm si variante më të hapura apo më të mbyllura sesa varianti kryesor i tyre (nëse shqiptimin e varianteve dialektore e krahasojmë me shqiptimin letrar), por edhe si diftongje, diftongoide, madje edhe si triftongje (disa gjuhëtarë në monografitë përshkruese për ndonjë të folme pohojnë se ajo e folme ka edhe për triftongje). Disa alofoni të tjera fonemash zanore vijnë për shkak të diferencave që kanë të folmet në tiparin e buzorësisë së ndonjë fonemeje, veçmas i [ã]-së: diku një fonemë shqiptohet e buzorëzuar e diku jo, diku timbri buzor është më i madh e diku më i vogël.

Shpjegim: Në përvojën tonë pedagogjike kemi vërejtur se jo gjithnjë studentët e kanë të qartë dhe e kuptojnë drejt alofoninë territoriale të fonemave, sidomos të zanoreve.

Në rrjedhën e të folurit (në fjalë e fjali) fonemat zanore realizohen si nuanca fonemash përkatëse: ato modifikojnë radhën, shkallën e buzorëzimit, mund të hundorëzohen etj. Variantet e tingujve të nyjëtuar në pozitë të izoluar (të nyjëtuar veças, pa tinguj të tjerë) quhen variante themelore. Kurdo që përshkruhet nyjëtimi i fonemave zanore, zakonisht merret parasysh nyjëtimi i varianteve themelore të tyre.

Variantet krahinore lidhen drejtpërdrejt me përkatësinë territoriale të folësit. Në bazë të këtyre modulimeve pa ndonjë vështirësi mund të identifikojmë njeriun cilës të folme, krahine apo dialekti i përket. Për të përcaktuar se në çfarë varianti krahinor nyjëtohet një zanore në ndonjë të folme shqipe, si variant: më i hapur apo më i mbyllur, më i përparmë apo më i prapmë, variant i buzorëzuar etj., mbështetemi në variantet themelore që kanë zanoret në shqiptimin letrar, në shqipen standarde. Pra, përshkrimi nyjëtimor i zanoreve të cilësdo të folme shqipe bëhet duke krahasuar ato me sistemin vokalik të shqipes standarde. Kjo rrugë është e drejtë, meqë mënyra e nyjëtimt, vendi i nyjëtimt, shkalla e hapjes dhe buzorësia e zanoreve në shqipen standarde përgjithësisht janë të njohura (përshkrimi nyjëtimor i zanoreve të shqipes standarde




bëhet në tekstet e Fonetikës dhe mësohen në lëndën e Fonetikës, rëndom në vitin e parë). Në këtë kuptim (si në matematikë $x + 5 = 12$, $x = 12 - 5 = 7$: krahasohet një e panjohur (e folmja) me një të njohur (standardja), dhe kështu e panjohura bëhet e njohur për të gjithë.

Të përkujtojmë se vendi i ngritjes së gjuhës drejt qiellzës (në pjesën e përparme, të mesme apo të prapme të gojës), shkalla e hapjes së gojës (e hapur, gjysmë e hapur, e mbyllur) si dhe pjesëmarrja apo mospjesëmarrja e buzëve (të buzorëzuara, të pabuzorëzuara) në nyjëtim përcaktojnë tiparet e përgjithshme nyjëtimore të zanoreve. Përkujtohu, shih e analizo diagramin e dhënë:

Siç dihet, **fonemat** ekzistojnë në formën e varianteve **kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale e stilistike**. E shprehur me terma artikulative dhe akustike kjo do të thotë që çdo fonemë zanore ose bashkëtingëllore ka një zonë artikulative dhe akustike karakteristike brenda së cilës realizohen variantet e saj. Kjo quhet **fushë e përhapjes** (fr. champ de dispersion) së fonemave.

Variantet kombinatorë dhe pozicionale janë të detyrueshme, meqë kushtëzohen nga konteksti tingullor që përcaktohet nga tingujt fqinjë ose nga pozicioni i tyre në fjalë (në fillim, në mes a në fund të fjalës, në rrokje të hapur a të mbyllur, të theksuar a të patheksuar). Variantet krahinore, individuale e stilistike janë variante të lira, që kushtëzohen nga faktorët jashtëgjuhësorë, që mund të jenë shoqërorë ose individualë, si p.sh. realizimet e të njëjtës fonemë në variante krahinore të ndryshme.



Larmi alofonesh të fonemave zanore

Variant quhet cilido realizim konkret i fonemës në kontekste të ndryshme. Një fonemë ka aq variante sa ka edhe realizime kontekstuale. Pra, me variante të fonemave kuptohet realizimi i tingujve me veçori të ndryshme fizike, që në aktin e komunikimit kanë të njëjtin funksion, d.m.th. bashkohen dhe përbëjnë një fonemë. Variantet e fonemave quhen alofone. Grafiku më poshtë paraqet shumësi alofonesh të fonemave zanore:

Për të shtjelluar mëtej veçoritë dalluese në sistemin e zanoreve të të folmeve shqipe, me interes është të trajtojmë çdo zanore veç e veç, duke u ndalur sidomos në zanoret që na paraqiten në variante të ndryshme.



Pyetje, ushtrime, detyra:

1. Përcakto inventarin e fonemave zanore të të folmes tënde.

4.5. ZANORET E THEKSUARA DHE TË PATHEKSUARA

Zanoret e rrokjeve të theksuara shqiptohen me një forcë më të madhe, janë relativisht më të gjata e disi më të qarta se të patheksuarat. Prandaj, të theksuarat gjatë ligjërimin janë më të qëndrueshme, më të mbrojtura dhe u nënshtrohen më pak ndryshimeve sesa zanoret e patheksuara.

Po përsërisim se në ligjërim, zanoret e theksuara ruhen më mirë, ndërsa të patheksuarat rrëgjohen. Shkalla e tkurrjes së zanoreve të patheksuara varet nga pozicioni i tyre krahasuar me zanoren e theksuar si dhe nga natyra e rrokjes (e hapur ose e mbyllur). Rrokje e fuqishme (e mbrojtur) është rrokja e theksuar, ndërsa shkalla e reduktimit vjen duke u rritur sipas largimit nga rrokja e theksuar. Kështu, sa më larg theksit të jenë rrokjet e patheksuara, aq më shumë rrëgjohen dhe anasjelltas.

Megjithkëtë, rrëgjimi i zanoreve të patheksuara në të folmet toske (edhe në shqipen standarde) nuk është i madh. Ai është më tepër rrëgjim sasi (kuantitativ, i gjatësisë). Kështu, zanoret e patheksuara humbasin një pjesë të gjatësisë dhe të forcës, d.m.th. shkurtohen dhe dobësohen, por përgjithësisht e ruajnë cilësinë (kualitetin) dhe timbrin e tyre (megjithëse edhe në këtë drejtim vihen re disa përjashtime). Të dhënat eksperimentale provojnë që [-ë]-ja fundore e patheksuar ka prirje të bjerë edhe në të folmet e toskërishtes, por edhe në ligjërimin letrar, pa shkaktuar zgjatimin kompensator të zanores së theksuar para saj. Zanorja [ë] në pozitë absolute të fjalës tani më nuk shqiptohet në asnjë të folme geqe, duke shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse.

4.5.1. ZANORJA /A/

Në përgjithësi, varianti themelor i [a]-së në shqipen standarde përcaktohet si zanore e hapur, qendrore (e radhës së mesme), e pabuzorëzuar. Përgjithësisht, në të folmet e Jugut ajo shfaqet vetëm si gojore e shkurtër, ndërsa në të folmet e Veriut si gojore e shkurtër dhe e gjatë dhe si zanore hundore. Me fjalë të tjera, zanorja /ã/ gojore e shkurtër del pa përjashtim në të gjitha të folmet shqipe, ndërsa /a:/-ja e gjatë në të gjitha të folmet e gegërishtes si dhe në jo pak të folme toske: në të folmet e bregut të Jonit, duke filluar nga fshatrat në jug të rrethit të Vlorës e deri në të folmet jugore më skajore: të Tepelenës e të Sarandës në krahinën e Labërisë; në Filat, Karbunarë, Arpicë, Muzhakat e Prevezë në krahinën e Çamërisë si dhe në Peloponez në Greqi. Zanore /a:/ të gjatë kemi edhe në të folmet e arbëreshëve të Italisë, si në: rrethin e Puljes, Kamanisë, Bazilikatës, Kalabrisë e të Sicilisë (shih: gjatësia e zanoreve në këtë libër). Me nuancë hundore /ã/-në e dëgjojmë në shumicën e të folmeve të gegërishtes, por në asnjë të folme toske (rilexo: hundorësia e zanoreve; shih hartat 57-58 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Buzorëzimi i [ã]-së në [o]. Në shumicën e të folmeve të gegërishtes [ã]-ja e theksuar hundore në pozita të caktuara fonetike, në të shumtën e rasteve para bashkëtingëlloreve [n, m, nj], ka prirje të shqiptohet me shkallë të ndryshme buzorëzimi, sipas tipit: nãna > na^ona > n^aona > nona, bãna > ba^ona > b^aona > bona, hãna > ha^ona > h^aona > hona etj., deri edhe në buzorëzim të plotë në [o]. Nëse /ã/-ja ka qenë hundore, atëherë te [o]-ja e përfutur dëgjohet një timbre i lehtë hundor. Këtë dukuri nuk e ndeshim në të folmet toske. Dukuria e buzorëzimit të

[ã]-së në [o] është e shpeshtë në të folmet e Kosovës, të Maqedonisë, të Tiranës (Tirana > Tirona), Durrësit, Kavajës, Peqinit, Krujës, Matit; Kukësit, Tropojës, Ulqinit etj.

Në bazë të vrojtimeve tona, si për nga denduria, ashtu edhe për nga përndarje (frekuenca dhe distribucioni) e folmja e Rekës së Epërme të Gostivarit (Maqedoni) zë vendin e parë në dukurinë fonetike të buzorëzimit të plotë të [ã]-së në [o]: *jom* (< jam), *akshom* (< aksham), *thonun* (< thanun), *osht* (< ashtë), *tombël* (< tambël); *njo*, *nji* (< nja, ni), *nona* (< nana), *me dhombët* (< me dhambët), *ma hongri uki* (< ma hanger ujku), *e ka lonun* (< e ka lanun), *moz* (< maz, mëz), *kom* (< kam), *hon* (< han), *ngron* (< ngran), *do boheshin* (< do të baheshin), *njoni* (< njani), *njonen* (< njanen), *jon* (< jan), *ho:n* (< hanë, hënë), *rona* (< rana), *zo:n* (< zanë, zënë), *kan lo:n* (< kanë lanë), *flonz* (flanz), *mona* (< mana) etj.

Shënim: Reka e Epërme nga njëra anë paraqet një të folme shqipe shumë ruajtëse (arkaike) në fushën e fonetikës, të morfologjisë e të leksikut. Por, nga ana tjetër, ajo ka kryer disa zhvillime gjuhësore (risi, inovacione) që nuk i gjejmë në asnjë të folme tjetër përreth (të Tetovës, Gostivarit, Pollogut, Dibrës, Kërçovës) e më gjerë.

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Fonemave /ã/ dhe /ẽ/ hundore të gegërishtes i përgjigjet /ẽ/-ja e theksuar në toskërishten. Ruajtja e formave të vjetra të fjalëve me /n/ midis dy zanoresh dhe hundorësisë së zanoreve në të folmet Veriore, përkundër rotacizimit të /n/-së dhe çhundorëzimit të zanoreve në të folmet Jugore, ka bërë që fonemës /ã/ dhe /ẽ/-së hundore të gegërishtes t'i përgjigjet /ẽ/-ja e theksuar në toskërishten (me disa përjashtime). P.sh. (forma geqe - forma toske) *nã:n* - *nënë*, *nëntë*; *shullãni* - *shullëri*, *ãnërr* - *ëndërr*, *lã:m* - *lëmë*, *kã:m* - *këmbë*, *shkãm* - *shkëmb*, *zãni* - *zëri*, *bãni* - *bëri*, *lañi* - *lëngu*, *kãña* - *kënga*; *zêmër* - *zëmër*, *mrêna* - *brënda*, *vênd* - *vënt*, *mên* - *mënt*, *kuvên* - *kuvënt* etj. (Shih hartën 8 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

4.5.2. ZANORJA /E/

Varianti themelor i [e]-së së shqipes standarde dhe i toskërishtes veriore mund të karakterizohet si zanore *gjysmë e hapur*, *e përparme*, *e pabuzorëzuar*. Në përputhje me ato që u thanë për gjatësinë dhe hundorësinë e zanoreve, alofone të /e/-së së shkurtër dëgjohen në të gjitha të folmet shqipe, [e]-ja hundore ose e hundorëzuar na del përgjithësisht në të gjitha të folmet e gegërishtes, ndërsa e gjatë përveç në dialektin e Veriut shqiptohet edhe në të folmet toske në të folmet e bregut të Jonit, duke filluar nga fshatrat në jug të rrethit të Vlorës e deri në të folmet më jugore në Labëri e deri në Çamëri (rilexo: gjatësia e zanoreve dhe shih hartën 1 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Në shumë të folme të toskërishtes, [e]-ja e mbarë shqipes në disa fjalë është shndërruar në [ë], si: *ëmër* 'emër', *pë* 'pe', *frë* 'fre', *qën* 'qen', *zëmër* 'zemër', *vënt* 'vend', *kuvënt* 'kuvend', *brënda* 'brenda', *qëndër* 'qendër' etj. Në disa të folme të gegërishtes veriore si dhe të gegërishtes qendrore [e]-ja e theksuar gojore, sidomos pas një bashkëtingëlloreje qiellzore [q, gj, j], shfaqet e diftonguar në [ië]: *lîepër* 'lepur', *lîetër* 'letër', *lîesh* 'lesh', *cîerga* 'cerga', *qîeth* 'qeth', *qîese* 'qese', *qîef* 'qef', *gjîel* 'gjel', ku *jîe*, *ië* 'ku je', ti *kîe* 'ti ke' etj.

Pjesa dërrmuese e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore (me Shkodrën si qyteti më i madh) dhe e të folmeve verilindore (të folmet e Kosovës) kanë [ɛ]-të hapur, si variant i [e]-së së theksuar gojore, p.sh.: *pɛ:s* ‘pesë’, *dhɛ:n* ‘gdhend’, *zhgɛ:dh* ‘zgjedhë’, *thɛ:rr* ‘ferrë’, baba *jɛm* ‘babai im’, *fɛmɛn* ‘femër’, *dhɛ:* ‘dheu’, *e thɛv* ‘e theu’ etj. (Shih hartat 2, 9, 59, 68-74 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

4.5.3. ZANORJA /Ë/

Varianti themelor i [ɛ]-së për nga tiparet nyjetimore në shqipen standarde dhe në toskërishten është zanore **qendrore** (e radhës së mesme), **gjysmë e hapur**, e **pabuzorëzuar**.

Zanorja /ɛ/ në të folmet e toskërishtes e në shqipen standarde gjendet në pozitë të theksuar ose të patheksuar. Në shqiptimin e tyre ka dallim. Kur është e theksuar, zanorja /ɛ/ shqiptohet me forcë më të madhe, është më e qartë dhe më e gjatë sesa kur është e patheksuar. Vetëkuptohet se /ɛ/-ja e patheksuar shqiptohet si më e dobët, më e errët dhe më e shkurtër. Ajo hyn në grupin e zanoreve që quhen të lëvizshme, të paqëndrueshme. Në pozitë të theksuar, kjo zanore ruhet mirë. Por, kur është e patheksuar, në përgjithësi rrudhet (tkurret, reduktohet, shkurtohet) në shkallë të ndryshme. Sipas studimeve që janë bërë në fushën e fonetikës eksperimentale, është provuar se në shqiptimin letrar në rrokje të theksuar [ɛ]-ja nyjtohet në kohëzgjatje prej 10 të qindta të sekondës (qs), ndërsa në rrokje të patheksuar vetëm 4.5 qs.

Studimet në fushën e fonologjisë historike të shqipes japin prova se zanorja [ɛ] e patheksuar ka burim tjetër nga /ɛ/-ja e theksuar. /ɛ/-ja e theksuar është një inovacion i përfutur vetëm në dialektin e toskërishtes para shekullit V-VI të erës sonë nëpërmjet evoluimit të zanoreve të theksuara hundore /ã/ dhe /ɛ/ në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore. Zanorja [ɛ] e patheksuar rrjedh nga reduktimi i zanoreve të tjera të patheksuara (Demiraj, 1996 : 57-72, 81).

Në rrokje fundore të hapur kjo zanore nuk shqiptohet më në asnjë të folme geqe, por edhe as në shumicën e të folmeve toske. Në pozitë fundore të patheksuar absolute të fjalës ruhet vetëm në të folmet e Çamërisë, të Gjirokastrës dhe në ato të Korçës e të Përmetit. Të dhënat statistikore mbi dendurinë e përdorimit të fonemave të veçanta dhe të kombinimeve të tyre në ligjërime dëshmojnë se /ɛ/-ja është një ndër fonemat më të përdorshme në shkrimin e shqipes standarde (me mbi 9% denduri përdorimi).

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Prania e /ɛ/-së së theksuar në Jug dhe mungesa e saj në Veri. Proceset gjuhësore në rrjedhë të kohës të të dy dialekteve të shqipes kanë sjellë për pasojë që të folmet toske në inventarin e fonemave zanore të theksuara të kenë fonemën /ɛ/, ndërsa në të folmet e gegërishtes kjo fonemë të mungojë, sepse në vend të saj kanë /ã/ ose /ɛ/ hundore. Pra, të folmet e toskërishtes në inventarin vokalik kanë edhe /ɛ/, ndërsa të folmet e gegërishtes nuk kanë fonemë /ɛ/, por ajo funksionon vetëm si tingull [ɛ]. Si rrjedhojë, **të folmet toske e kanë fonemën /ɛ/, ndërsa të folmet geqe nuk e kanë këtë fonemë** (Shih hartat 7, 64-66 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Në të folmen e Karadakut të Shkupit, por edhe në të folmet e tjera geqe, në pak parafjalë, si për, *nëpër*, *nër*, *ndër* [ɛ]-ja shqiptohet e theksuar kur këto fjalëza janë bartëse të theksit logjik të kumtimit (të fjalisë). Megjithatë, duhet thënë se rëndom këto parafjalë nuk janë bartëse të

theksit logjik dhe në fjali, si fjalë shërbyese që janë, e humbin theksin dhe bëhen proklitike, sipas tipit: *për-t'thān*, *për-me-thā:n* 'për të thënë', *nëpër-ara*, *nër- sjetëll* 'nën sqetull', *nër-u:dh* 'ndër, nën udhë' etj. Në disa të folme të gegërishtes qendrore, por edhe në ndonjë të folme të gegërishtes verilindore e veriperëndimore gjejmë [ë] të theksuar te pak orientalizma, si *hëz*, *hafëz*, *ërrz*, *ërrsk* a *rrësk* si dhe te disa shprehje onomatopeike: turreci ban *tërr-tërr*, s'ka *këk-mëk*, zogi *tërr* fjaroj, zilja ban *cërr*, *përr* tiki-tiki (ndjellen pulat), *hërrip* e piv kafën, miza ban *bëz-bëz* etj. Edhe në pak barbarizma në të folmet shqipe të Maqedonisë, mund të dëgjohet një [ë] e theksuar, meqë në këto fjalë nuk ka zanore tjetër, si *shtërk* 'lejlek', *tërll* 'vathë, vend i rrethuar me gardh', *kërp* 'leckë', *gërb* 'shpinë' etj. (Hamiti, 1999 : 50). Në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit si pasojë e protezës, përkatësisht e aferezës janë përfutur dy fjalë me [ë] nistore të patheksuar: *ërrnon* < rnon 'rron, jeton', *ërfuni* < përfundi (Hamiti, 1999 : 51).

Zanorja [ë] në të folmet Jugore shqipe përdoret shumë shpesh, ndërsa në të folmet Veriore përdoret rrallë. Një ndër tiparet dalluese të qenësishme ndërmjet të folmeve të dy dialekteve të shqipes në fushën e fonetikës e të fonologjisë përbën denduria e përdorimit të /ë/-së. Në toskërishte zanorja /ë/-ja përdoret shumë shpesh si në rrokje të theksuar, ashtu edhe në rrokje të patheksuar, në çdo pozitë të fjalës (në fund, në mes e në fillim); ndërsa në të folmet e gegërishtes [ë]-ja dëgjohet vetëm në rrokje të patheksuar dhe vetëm në mes të fjalës. Në gegërishte nuk kemi fjalë që fillojnë me [ë], as edhe fjalë që mbarojnë me [ë]. Krahasoni format fonetike të fjalëve të njëjta në gegërishte me ato në toskërishte: *dam* - *dëm*, *dhām* - *dhëmb*, *i amël* - *i ëmbël*, *amëlsin* - *ëmbëlsirë*, *gërshā:n* - *gërshërë*, *mrāmje* - *mbrëmje*, *njāni* - *njëri*, *rrāj* - *rrënjë*, *go:j* - *gojë*, *a:r* - *arë*, *pu:n* - *punë*, *lo:p* - *lopë*, *mo:ll* - *mollë*, *shko:ll* - *shkollë* etj. Rënia e [ë]-së në pozitë fundore të fjalës në këta 3-4 shekujt e fundit në të folmet Veriore ka shkaktuar zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse (Shih hartat 88-99 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Mosshqiptimi i [ë]-së në mes të fjalës në të folmet e gegërishtes. Shpeshherë edhe në mes të fjalës [ë]-ja në të folmet e Veriut nuk shqiptohet, si p.sh. *tly:n* 'tëlyen', *malsi* 'malësi', *msu:s* 'mësues', *nxa:ns* 'nxënës', *gzim* 'gëzim', *malsi* 'malësi', *udhtar* 'udhëtar', *kta* 'këta', *kmi:sh* 'këmishë', *knu:s* 'këndues', *nimdhet* 'njëmbëdhjetë' etj.

Ruajtja e [ë]-së në mes të fjalës. Në mes të fjalës, zakonisht kur gjendet para sonoreve /r, rr, l, ll, n, m/ [ë]-ja ruhet edhe në gegërishte: *motër*, *kokërr*, *tamël*, *femën*, *darsëm* etj.

Qiellzorëzimi i [ë]-së në [i]. Nën ndikimin e përngjashmimit të [ë]-së nga bashkëtingëlloret në takim, ajo në rrjedhë të kohës ka fituar nyjëtimit më të përparmë, saqë tani është shndërruar në zanore të përparme [i]. Në shumë të folme të gegërishtes [ë]-ja e patheksuar në pak fjalë qiellzorëzohet në [i]: *liku:r* 'lëkurë', *çinroj* 'qëndroj'; *ni*, *nji* 'një', *çilloj* 'qëlloj', *xhimoj* 'gjëmoj'; *nigoj*, *nigjoj* 'dëgjoj', *çinis* 'qëndis', *nimdhet* 'njëmbëdhjetë' etj.

Velarizimi i [ë]-së në [u]. Në të folme të caktuara të gegërishtes, sidomos në të folmet e Shkupit, të Gostivarit, të Shkodrës, të Elbasanit etj. në numër të konsiderueshëm fjalësh [ë]-ja velarizohet në [u], si në fjalët: *muzat* 'mëzat', *mushterr* 'mështjerrë', *mushtell* 'mbështjellë', *dhëlpun* 'dhëlpër', *femun* 'femër', *kushuri* 'kushëri', *xharpun* 'gjarpër' etj. Dukurinë fonetike të shndërrimit të [ë]-së në [u] e ndeshim edhe në disa të folme të toskërishtes, si në Berat, Gjirokastër, në Çamërishten etj.

4.5.4. ZANORJA /O/

Në përgjithësi varianti themelor i [o]-së është zanore gjysmë e hapur, e prapme, e buzorëzuar. Ndërmjet të folmeve shqipe nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm lidhur me përdorimin e kësaj zanoreje. Në përputhje me atë që u tha për gjatësinë e zanoreve, kuptohet se të folmet e Veriut kanë /ǒ/ të shkurtër dhe /o:/ të gjatë, si edhe pak të folme të toskërishtes. Të folmet gege shqiptojnë edhe një [o] të hundorëzuar, që është përfutur nga buzorëzimi i [a]-së hundore (nona < nana, shih: buzorëzimi i [a]-së në [o]) (Shih hartën 6 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Hapja dhe zhbuzorëzimi i [o]-së në [a]. Në të folmet e Shkodrës, Bregut të Bunës, Krajës, Ulqinit, Mirditës, Matit, Krujës, Tiranës, Durrësit [o]-ja gojore e shkurtër nuk del në rrokje nistore të hapur, në vend të saj del zanorja [a]: *aborr* ‘oborr’, *aficer* ‘oficer’, *axhak* ‘oxhak’, *katec* ‘kotec’, *dallap* ‘dollap’, *daktor* ‘doktor’, *damote* ‘domate’ etj. (Gjinari - Shkurtaj, 1997 : 123). Këto variante fonetike krahinore janë fituar nga veprimi i shpërngjashmimit (disimilimit), asimilimit (përngjashmimit) ose nga ndonjë dukuri tjetër. Edhe në të folmet shqipe në Maqedoni është mjaft e përhapur kjo dukuri. E folmja e Rekës së Epërme të Gostivarit shquhet për shndërrimin shumë të shpeshtë të [o]-së në [a]. P.sh.: në këtë areal gjuhësor pjesëzat *do + të* shkrihen në *da*, sipas tipit: *da marrësh* ‘do të marrësh’, *da vdesë* ‘do të vdesë’, *da shkaj* (< do të shkoj) etj. Pjesëza *da* (< do të), përveç në të folmen e Rekës së Epërme del edhe në të folmet e Mallakastrës, të Tuhinit të Kërçovës, të Prilepit e të Krushevës, e të Karshiakës.

Me anë të përngjashmimit (asimilimit) ose të shpërngjashmimit (disimilimit) paravajtës a prapavajtës të tingujve [o]-ja këmbëhet me [a]-në edhe në shumë fjalë të tjera, si: *aja* (< ajo), *a bu:rr* (< o burr), *shkan* (< shkon), ku *shkan* (< ku shkon), *t’shkajm* (< të shkojmë), e *parasiten* (< e porositën), *pa:sht* (< posht), *sante* (< sonte), *aja* (< ajo), *pqat* (< plot), *çabani* (< çobani), *akolla* (< okolla), *zatni* (< zotni), *kalib* (< kolibe), *çaban* (< çoban), *t’kindajsh* (< të këdosh), *a moter* (< oj motër), *ngja* (< ngjo, dëgjo, ngo) etj.

4.5.5. ZANORJA /Y/

Në përgjithësi varianti themelor i [y]-së në shqipen është zanore e mbyllur, e përparme, e buzorëzuar. Shumica e të folmeve të gegërishtes qendrore (të folme gege), përkatësisht të folmet e zonës së Lumës, Lurës, Matit, Mirditës, Krujës, Peshkopisë, Dibrës, Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, të folmet lindore të rrethit të Strugës; të labërishtes e të çamërishtes (të folme toske) në sistemin vokalik nuk e kanë fonemën /y/, për shkak se në këto të folme /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/, më rrallë është shndërruar në /u/ si në fjalët dy < *di*, sy < *si*, ymyt < *umut* etj. Në të folmet e gegërishtes qendrore /y/-ja jo vetëm që është zhbuzorëzuar, por ajo edhe është diftonguar sipas tipit sy > *si* > *sâi*, frymë > *fri:m* > *frâim* (Shih hartat 4, 11, 81-85 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Në të folmet shqipe të rrethit të Prilepit dhe të Krushevës në Maqedoni, në dallim nga pjesa më e madhe e të folmeve të tjera të gegërishtes qendrore, ruhet /y/-ja (*ky*, *dry:*, *qylym*, *gjysh*, *gjym*, *bry:m*, *bylyk*, *lyps*, *klysh* etj.). Karakteristikë për këtë të folme është edhe diftongimi

i /y/-së në fillim, në trup dhe në fund të fjalës: *âyll* ‘yll’, *âymër* ‘ymër’, *âymërgja:t* ‘ymërgjatë’; *fraÿm* ‘frymë’, *faÿt* ‘fyt’, *taÿm* ‘tym’, *ftaÿr* ‘fytырë’; *sâÿ* ‘sy’, *ataÿ* ‘aty’, *fraÿ* ‘fry’ etj. (Ibrahimi, 2005 : 78). Në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, diftongimi ka prekur mesin dhe fundin e fjalës, por shumë rrallë zanoret në pozitë nistore.

Edhe e folmja e Rekës së Epërme të Gostivarit e ruan zanoren buzore /y/, si në fjalët *dy*, *syni*, *fryni*, *aty*, *dy*, *zhdryp* (< zbrit), *pyes*, *dylber*, *bylbyl*, *synet*, çobani *hypën* mbrenda (< hyni, hyri brenda), e ka *mbyttun*, *i pytka* (< i pyetka), e ka *pyttun* (< e ka pyetun), *u kthye kan* (< u kthye kan), *u rrukullyka* (< u rrokulliska), ta *fyti kryt* (< ta fus kryet, kokën), kan botun me *tybe* (< kan ba tybe, janë betuar) etj. Po kështu, kjo e folme nuk i diftongon zanoret e ngritjes së lartë /i, u/ në rrokje të theksuar. Përdoren me [i] të pashpërbërë fjalët *shpi*, *rri*, *rrit*, *nip*, *ti*, *trim* etj., të cilat në të folmet e tjera të gegërishtes qendrore rëndom dalin në formë të diftonguar, si variante fonetike të fonemës /i/; si edhe me /u/ fjalët *aru:sh*, *shu:m*, *nuse* etj. Rastet me forma të diftonguara janë shumë të rralla, si *shtâi* (< shti, tashti, tani) (Haruni, 1994 : 8-15).

4.5.6. ZANORET /I/ DHE /U/

Në shqipen standarde si dhe në shumicën e të folmeve të toskërishtes varianti themelor i [i]-së realizohet si zanore e përparme, e mbyllur dhe e pabuzorëzuar. Ashtu siç u tha edhe gjatë shpjegimit të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve, të folmet e toskërishtes si dhe shqipja standarde përgjithësisht kanë vetëm /i/ të shkurtër, ndërsa të folmet e gegërishtes kanë /i/ të shkurtër, /i:/ të gjatë (edhe pak të folme toske) dhe një /i/ hundore, apo me timbër hundor (Shih hartat 3, 10, 75-80 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Buzorëzimi i [i]-së në [y]. Në të folmet e Kosovës, të Preshevës, të Bujanovcit, Tiranës, Krujës, Durrësit, Kavajës etj. në vend të [i]-së (së shkurtër apo të gjatë) del [y]-ja sidomos në ato fjalë ku gjendet para ose pas bashkëtingëlloreve dybuzore [p, b, m]: *rryp* ‘rrip’, *hyp* ‘hip’, *kry:p* ‘kripë’, *zhdryp* ‘zhdrip, zbrit’, *krym* ‘krimb’, *shype* ‘shqipe’, *çylym* ‘qilim’, *shpyrt* ‘shpirt’ etj.

Varianti themelor dhe më i përhapur në shqipen i [u]-së shqiptohet si zanore e prapme, e mbyllur, e buzorëzuar. Përgjithësisht të folmet e toskërishtes kanë vetëm /u/ të shkurtër, ndërsa të folmet e gegërishtes edhe /u:/ të gjatë dhe [ũ] të hundërozuar, ndonjë prej tyre ndoshta /ũ/ hundore.

Këmbimi i [u]-së së patheksuar në [ë]. Marrë në përgjithësi, mund të thuhet se [u]-ja e patheksuar shndërrohet në [ë] në shumë të folme geqe, sidomos në grupin *-ull, -ur*, si në fjalët *vetëll* ‘vetull’, *petëll* ‘petull’, *shpatëll* ‘shpatull’, *mashkëll* ‘mashkull’, *kumëll* ‘kumbull’, *flutër* ‘flutur’, *mjegëll* ‘mjegull’, *ufëll* ‘uthull’, *akëll* ‘akull’, *kukëll* ‘kukull’, *hekër* ‘hekur’ *lepër* ‘lepur’ etj. (Shih hartat 42-43 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Fonemat /y/, /i/ dhe /u/ në të folmet e gegërishtes qendrore shpeshherë relizohen edhe si diftongje. Të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, sidomos gegërishtja qendrore. Denduria e diftongjeve në të folmet e gegërishtes qendrore, në dallim nga të folmet e tjera të shqipes, qëmoti është shtuar nga shpërbërja (diftongimi) e zanoreve të mbyllura /i, y, u/ në rrokje të theksuar në një numër të madh fjalësh në pozicione të caktuara fonetike.

Në të folmet e gegërishtes qendrore, fonemat zanore të ngritjes së lartë /y/, /i/ dhe /u/ realizohen edhe si variante fonetike ose fakultative në formën e diftongjeve dytësore, përkatësisht:

a) Fonema /i/ shumë shpesh në kushte të caktuara fonetike del në formë të diftongjeve: [ai, ei, ei, oi], sipas tipit mík > m^{ai}k, m^{ei}k, m^{ei}k ose m^{oi}k; shtëpí > shpí : shp^{ai}, shp^{ei}, shp^{ei}, shp^{oi} etj. Në një të folme zakonisht dalin dy nga diftongjet që vijnë prej /í/-së: [ai] dhe [ei]; [ei] dhe [oi].

b) Fonema /ú/ shumë shpesh realizohet si diftong [au] dhe [ou], sipas tipit núse > n^{au}use, n^{ou}use; arúshë > arú:sh > ar^{au}ush, ar^{ou}ush, ara:sh. Diftongjet që vijnë prej /ú/-së zakonisht gjenden të dyja në të folmet lindore të gegërishtes qendrore, por në to më tepër përdoret varianti [au], kurse në anën perëndimore gjendet pothuaj vetëm varianti [ou].

4.6. DIFTONGIMI I FONEMAVE /I/, /Y/ DHE /U/ NË TË FOLMET E GEGËRISHTES QENDRORE

Përgjithësisht zanoret e shqipes standarde, pavarësisht nga rrethimi tingullor (edhe sikur para ose pas tyre të kenë cilëndo zanore ose bashkëtingëllore që lejon parimi i bashkëlidhjes) karakterizohen me qëndrueshmëri (stabilitet) nyjëtimore. Për këto zanore thuhet se kanë stadium gojor dhe janë zanore të thjeshta. Por megjithkëtë, nganjëherë ka edhe raste kur ndonjëra nga zanoret në kontakt me zanoren tjetër e humb stadiumin gojor. Stadium gojor do të thotë të qëndruarit për një kohë të caktuar (disa të qinda të sekondës) në një formë e pozitive të caktuar të aparatit të të folurit. Kjo është veçori e zanoreve.

Nga pikëpamja nyjëtimore diftongjet janë tinguj të përbërë. Për prodhimin e tyre, organet e të folurit kalojnë me rrëshqitje nga pozicioni i nyjëtimit të një zanoreje në pozicionin e nyjëtimit të zanores tjetër. Ndryshimi i vëllimit dhe i formës së rezonatorit të gojës në këto lëvizje bëjnë që gjatë prodhimit të diftongut të përkapen dy timbre të ndryshëm. Si gjithë tingujt e përbërë, diftongjet në disa gjuhë mund të funksionojnë si fonema më vete, krahas fonemave të tjera zanore. Në gjuhën shqipe diftongjet janë variante kombinatorë (alofone) të fonemave zanore përkatëse dhe nuk konsiderohen si fonema të veçanta.

Gjuhët me ndërndikim të theksuar ndërmjet tingujve, veçmas në zgjatjen dhe shkurtimin e tingujve, kanë prirje të posaçme t'i realizojnë fonemat zanore me zhvillim të plotë nëpërmjet diftongjeve.

Diftongimi dhe mosdiftongimi në të folmet e gegërishtes qendrore

Të folmet e gegërishtes qendrore lidhur me nyjëtimin e zanoreve të mbyllura [i] dhe [u] karakterizohen me modelet:

- a) që kanë stadium gojor (stabilitet nyjëtitor) dhe
- b) që nuk kanë stadium gojor (jostabilitet nyjëtitor).

Pra, zanoret [i] dhe [u] në të folmet e gegërishtes qendrore, përdoren a) si monoftongje (njëzëshe), te të cilat ngjyrimi në pikëpamje akustike mbetet e pandryshueshme gjatë gjithë kohës së artikulimit dhe b) si diftongje (dyzëshe), në artikulimin e të cilave ndryshon ngjyrimi i zërit. Thjesht, në fillim të diftongut dëgjohet një ngjyrë zanoreje, ndërsa nga fundi një ngjyrë tjetër.

Diftongimi i zanoreve të mbyllura /í/ dhe /ú/ në [áí], [éí], [ëí] dhe [ôí]; përkatësisht [áú], [ôú] paraqet një ndër inovacionet më qenësore të gegërishtes qendrore. Në këto të folme, përveç diftongjeve që dëgjohen shumë shpesh, ndonjëherë dëgjojmë edhe diftongoide (k^uodër, m^uotër, fl^uok), por ndonjëherë edhe triftongje.

Në gjuhësi, sipas analizës së materialit gjuhësor të shumë gjuhëve, është provuar e konstatuar se diftongohen zanoret gjata në rrokje të theksuar. Edhe prof. Remzi Nesimi e ka trajtuar hollësisht diftongimin e zanoreve në të folmen e Dervenit. Meqë në gjendjen e sotme të diftonguar jo vetëm [i:] në e gjatë, por edhe atë me gjatësi të mesme e të shkurtër, për kronologjinë e diftongimit prof. Remziu shprehet se: “së pari është diftonguar [i:] -ja e gjatë, pastaj [i.] -ja me gjatësi të mesme dhe në fund [i] -ja e shkurtër.”

Nga monografitë dhe skicat dialektore mund të nxirret si përfundim se në gegërishten qendrore në pozita të caktuara fonetike në formë të diftonguar përdoren jo pak fjalë shqipe, huazime latine, greke si dhe huazime të hershme sllave e turke. Përgjithësisht, huazimet e vonshme sllave shqiptohen të padiftonguara, si *raki*, *bollni:c* < *bollnica* ‘spital’, *stani:c* < *stanica* ‘stacion’, *grani:c* < *granica* ‘kufi’, *stoli:c* < *stolica* ‘karrige’ etj. Edhe te huazimet turke kemi forma të dyfishta, të padiftonguara, si *jeshil*, *katil*, *pestil*, *gjigjim*, *sifir*, *bitis*, *kurtalis*, *terezi* etj. dhe të diftonguara, si *xhamâi*, *munafâik*, *pazarllâik*, *begenâis*, *iqindâi*, *askerllâik*, *temcâi*, *çivâi*, *axhamâi*, *saballâik* etj.

Një gjë është e rregullt dhe gjithëpërfshirëse: zanoret [í] dhe [ú] diftongohen vetëm rrokje të theksuar, sidomos kur kanë kushte të volitshme kontekstuale për nyjetim të plotë dhe të papenguar, e pikërisht të tilla janë zanoret e gjata. Megjithëkëtë, në gjendjen e sotme gjejmë edhe përjashtime. Në këtë kuptim, gjejmë jo pak fjalë ku zanorja e gjatë e mbyllur [i:, u:] nuk është diftonguar, por nga ana tjetër edhe ku zanorja e shkurtër [í, ú] është diftonguar. P.sh.: zanore të gjata të padiftonguara kemi në fjalët: *hi:*, *bli:*, *gji:*, *hi:rr*, *bri:*, *hu:*, *dru:*, *pu:n*; zanore të shkurtra të diftonguara: *mâik* (< *mík*), *krâip* (< *kríp*), *rrâip* (< *rríp*), *nâip* (< *níp*) etj.

Siç dihet, një ndër inovacionet fonetike më karakteristike të gegërishtes qendrore është diftongimi i /i/-së dhe i /u/-së së theksuar, përfshirë edhe zhbuzorëzimin e /y/-së në /i/. Mbizotëron mendimi se diftongimi është dukuri e hershme, që ka fillet e saj në fillim të shekullit XV. Pra, izoglosa e diftongimit të zanoreve të mbyllura [í, y, ú], siç dihet, është gegërishtja qendrore. Kjo dukuri fonetike inovuese ka përhapje të gjerë në gjithë gegërishten qendrore. Sipas njohurive të derisotme, vetëm pak të folme të kësaj izoglose nuk e kanë këtë dukuri risimtare të shpërbërjes. Diftongimi është i pranishëm në të folmet e Lurës, Lumës, Krujës, Mirditës, Matit, Peshkopisë (në Shqipëri); të folmet shqipe në Maqedoni, si: disa fshatra të Kumanovës, të folmet e Shkupit, të folmet e Pollogut: Tetova me rrethinë, Gostivari (përjashtim bën e folmja e Rekës së Epërme); Struga (me përjashtim të të folmeve toske), Dibra, diftongohet edhe në Kërçovë, Karshiakë, Prilep, Krushevë.

Dukuria e diftongimit përgjithësisht ka përfshirë edhe të folmet shqipe në Maqedoni, e hasim që nga Kumanova e deri në Strugë. Megjithëse diftongimi përgjithësisht përfshin të folmet gege në Maqedoni, edhe këtu ka përjashtime. Ka izoglosa që nuk e kanë dukurinë e diftongimit. Kështu, zanoret /i/ dhe /ú/ nuk diftongohen në pak fshatra të Kumanovës, që i takojnë gegërishtes verilindore: Vaksincë, Llojan e Izvor; në tri fshatra të Prilepit: Buzallkovë, Jabollçishti i Epërm dhe i Poshtëm; në disa katunde në rrethinën e Shkupit: Patishka Rekë, Sveta Petkë, Černivor, Nerez i Epërm dhe i Poshtëm, Krushopek, Gërçec (meqë banorët e këtyre katundeve të Prilepit e të Shkupit janë nga Reka e Epërme e Gostivarit); në rrethin e Tetovës: e folmja e Sallarevës dhe e Gurgunicës, Reka e Epërme dhe Korita e Gostivarit si dhe të folmet e rrethit të Strugës: Radolishtë, Frëngovë, Kalishtë, Zagraçan dhe Shum (Ajten Qamili, *Të folmet shqipe të rrethit të Strugës (në kontekstin ballkanik)*, Shkup, 2011, f. 72-74).

Lidhur me diftongimin e /i/-së së theksuar një dukuri mjaft interesante në të folmet shqipe në Maqedoni kemi edhe tek emrat vetjakë të gjinisë femërore. Në Derven, Karshiakë, Shkup, Tetovë, Gostivar si dhe përgjithësisht në gjithë Maqedoninë Perëndimore, pas martesës gratë nuk i thërritnin me emrin e vërtetë, por me emrin e burrit, duke ia shtuar prapashtesën sllave *-i:c*, *-aic* (-ica), në formë të diftonguar ose të padiftonguar, varësisht nga shprehitë nyjetimore dhe tingullit fundor të temës së emrit të burrit, sipas tipit bashkëshorti Hasan - bashkëshortja e tij *Hasani:c* ose *Hasanâic*, burri Arif - gruaja e tij *Arifi:c* ose *Arifâic*. Në këtë mënyrë emri i vërtetë i gruas është fshehur dhe atë rrallëkush e ka ditur, përkatësisht vetëm familja e ngushtë, ndërsa emri i dytë i ndërtuar nga emri i burrit ka pasur përhapje të gjerë (Nesimi, 2008 : 110-112). Ky ripagëzim i grave të martuara ende bëhet në familjet patriarkale.



Pyetje, ushtrime dhe detyra:

1. Zanoret e mbyllura [i, u dhe y] të theksuara në të folmen tënde shqiptohen si në gjuhën standarde dhe në shumicën e të folmeve shqipe apo diftongohen: *sy* a *si* apo në variantet dytësore të diftonguara *sâi*, *sêi*, *sôl*, *sêl*; *mik* apo *mâik*, *mêik*, *mêik*; *nip* apo *nâip*, *nêip*, *nêip*; *rrip* a *rryp* apo *rrâip*, *rrêip*, *rrêip*; *nuse* apo *nâuse*, *nêuse*, *nêuse*, *nase*; *aru:sh* apo *arâush*, *arêush*, *arêush*, *ara:sh*; *frymë*, *fry:m* a *frim* apo *frâim*, *frêim*, *frêim* etj.

2. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të gegërishtes qendrore në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.

3. A janë diftongjet [âi, êi, ôi, êi; âu, êu] variante fonetike territoriale të fonemave përkatëse /i, u/, apo janë fonema më vete? Pse? Arsyetoje mendimin tënd.

4. Përkufizo shtrirjen e diftongimit të zanoreve /i, u, y/ në shqipen dialektore.

5. Cilat të folme shqipe në Maqedoni e kanë dukurinë e diftongimit, e cilat nuk e kanë këtë dukuri?

4.7. PRIRJA E MONOFTONGIMIT TË DIFTONGJEVE DYTËSORE

Fillimet e dobësimit të diftongimit të zanoreve të mbyllura, si proces, në të folmet e gegërishtes qendrore i hasim që nga periudha e vonshme e sundimit turk në Ballkan, përkatësisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Lidhur me këtë një gjë është e sigurt: diftongimi në të folmet e gegërishtes qendrore ka pushuar së vepruari. Është e natyrshme që format e diftonguara të ruhen brez pas brezi, por fjalët e reja shqipe dhe huazimet e kohës edhe nga pjesëtarët e gegërishtes qendrore tani përdoren në formë të padiftonguar, si *liri*, *demokraci*, *parti*, *taksi*, *radi* etj.

Në të folmet e gegërishtes qendrore në gjendjen e sotme hetohet edhe prirja e monoftongimit të diftongjeve dytësore, të përfutuara nga /i/-ja e theksuar, si p.sh. *calli* < *câlli* < *ca'lli* < *cilli* < *cili*, që dëgjohet në gjithë arealin e Karadakut të Shkupit dhe në pjesën më të madhe të gegërishtes qendrore. Monoftongim të diftongut [âi] kemi dëgjuar edhe në zonën e Shkupit: *mbëllshna* < *mbëllshna* < *mbillshna*, *she* < *shêi* < *shi*. Edhe në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës e njëjta fjalë në disa lokalitete përdoret me zanore të diftonguar e në disa të tjera të padiftonguar, si *vâiç* - *viç*, *mâish* - *mish*, *mâiç* - *miç*, *mâiz* - *mi:z*, *atai* - *ati(j)* etj. (Sulejmani, 2006 : 83-84. Në të folmen e Karshiakës (Ymeri, 1997 : 54), si edhe të folmen e Tetovës janë shënuar disa fjalë të monoftonguara, si *nep* < *nip* < *nip*, *mek* < *mêk* < *mik*, *trem* < *trêim* < *trim*, *fes* < *fêis* < *fis* etj. (Nesimi, 1997 : 87. Monoftongimi [êi > e] dëgjohet edhe në Lurë e në Mat (Beci, 1962/2, : 242), më pak në Krujë (Gjinari, 1964 : SF, 3, 4) e më shumë në Mirditë (Beci, 1982 : DSh, IV).

Në disa të folme, si në të folmen e Karadakut të Shkupit, te i njëjti folës dëgjohej dy format: *sêi* - *si*, *temcêi* - *tepsi*, *mullêi* - *mulli*, *mêi* - *mi*, *shpâi* - *shpi*, *kusâi* - *kusi* etj. Po në këtë të folme, prirja e monoftongimit të diftongjeve është shumë e shprehur, sidomos në të folmen e fshatit Brezë dhe Grushinë ku diftongu [âu] është monoftonguar plotësisht në [a:] të gjatë, sipas tipit *sha:m* < shumë, *trap* < trup, *call* < cullë 'fëmijë', *rra:sh* < rrush, *nase* < nuse, *ca:c* < cucë, *lakna:r* < laknu:r, laknuer 'lakror', *fta:rk* < turk 'cfurk', *prrae* < përrue 'përrua', *shkra:j* < shkruaj 'shkruaj', *fërtan* < furtunë, *mashtrae* < mashtrue, *çekshta:* < çekështu (çe+kështu 'ja+kështu'), *fta:* < ftue, (me) *puna:* < me punue, (me) *msa:* < me mësue, (me) *shtra:* < me shtrue etj. (Hamiti, 1999 : 56-66).

Ky monoftongim duhet të jetë kryer shkallë-shkallë. Pas diftongimit të [u]-së në [âu], kjo [u] e konsonantizuar e diftongut (e ngjashme me shqiptimin e]v]-së) në pozitë të patheksuar në rrjedhë të kohës ka pësuar reduktim në cilësi dhe në gjatësi, duke u shqiptuar gjithnjë e më dobët, derisa të ketë humbur krejtësisht që tani të dëgjohet vetëm një ëa:] e pastër, sipas tipit *shumë* > *shâum* > *sha^um* > *sha^ëm* > *sha:m*.

Procesin e monoftongimit e kanë ndihmuar dhe po e përshpejtojnë disa faktorë:

a) Grupi i të folmeve të gegërishtes qendrore me diftongje dytësore është një izoglosë e veçantë gjuhësore e dallueshme nga të folmet e tjera shqipe përreth dhe gjuhët e tjera joshqipe në takim.

b) Te të gjitha gjuhët standarde ballkanike nuk ka diftongje dytësore, prandaj krahas shqipes së përgjithshme dialektore dhe asaj standarde, edhe gjuhët e huaja (pa diftongje) kanë ndikim të madh në zvogëlimin e dendurisë së përdorimit të formave të diftonguara.

c) Dialektizmat fonetike që i shqiptojnë në formë të diftonguar pjesëtarët e gegërishtes qendrore kanë përhapje të ngushtë territoriale dhe si forma të dallueshme fonetike nga grupet e tjera të të folmeve shqipe, rrjedhimisht edhe jonormative, shpeshherë përqeshen e kritikohen nga të tjerët.

ç) Me shkollimin në masë të shqiptarëve, me ndikimin gjithnjë e më të fuqishëm të medieeve, me lëvizjen tonë brendakombëtare gjithnjë e më të shpeshtë, me lidhje miqësore krahinash të ndryshme, me komunikimin më intensiv (sidomos tani nëpërmjet Internetit) etj., format e diftonguara të fjalëve po zëvendësohen me ato të padiftonguara dhe si rrjedhojë: denduria e përdorimit të fjalëve të diftonguara në gegërishten qendrore gjithnjë e më tepër po zvogëlohet.

Monoftongimi i diftongjeve dytësore, bashkë me disa dukuri të tjera njësuere të përgjithshme të gegërishtes drejt shqipes standarde, siç janë: çkundorëzimi i zanoreve, zbehja e vlerës fonologjike të zanoreve të gjata, zvogëlimi i nuancave tingullore (alofoneve) të fonemave të njëjta, zëvendësimi i formave morfologjike lokale me format e shqipes standarde si dhe shumë zhvillime të tjera rrafshuese, bashkë me ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore ndër ne (duke lënë anash disa thyerje të normës letrare në praktikën tonë gjuhësore), janë tregues të mirë se dialektet dhe gjuha shqipe përgjithësisht po ecën me hapa të shpejtë drejt njësimi gjuhësor kombëtar. Ky konvergjim i dialekteve të gjuhës sonë çdo ditë e më tepër po intensifikohet.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. A monoftongohen diftongjet dytësore në të folmen tënde. Jep shembuj.
2. Në cilat të folme monoftongohen diftongjet dytësore? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje mbani shënime gjatë të dëgjuarit të vëmendshëm të incizimeve zanore në pikat dialektore të gegërishtes qendrore në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
3. Çfarë e ka ndihmuar procesin fonetik të monoftongimit të diftongjeve?

4.8. TOGJET E ZANOREVE, DIFTONGJET DHE DIFTONGOIDET

Siç dihet, gjuhët e botës kanë zanore të mirëfillta (të thjeshta, monoftongje, njëzëshe), ngjyra akustike e të cilave për veshin e njeriut mbetet gjithnjë e njëjtë gjatë gjithë kohës së artikulimit; dhe diftongje (dyzëshe), që gjatë nyjetimit ndryshojnë ngjyrimin. Në fillim të diftongut dëgjohet timbër i një zanoreje, ndërsa nga fundi timbër i një zanoreje tjetër. Gjuhë tipike me shumë diftongje është anglishtja, po edhe gjermanishtja. Gjuhët që kanë diftongje karakterizohen me artikulum të shtendosur, përkundër gjuhëve që nuk kanë diftongje, që dallohen me artikulum të tendosur.

Në gjuhën e sotme shqipe, në rrjedhën e të folurit ndodh që të shqiptohen njëra pas tjetrës dy a më shumë zanore, si p.sh *përrua, kuadër, kuotë, mësues, diell, kau, punoi, aeroplan, teori* etj. Po qe se dy zanore në kontakt shqiptohen veçmas, duke formuar secila rrokje më vete, kemi **tog a grup zanoresh**. Të tilla janë p.sh. zanoret që janë pranë njëra-tjetrës në fjalët *grua, ftua, muaj, duar, mësues, përkthyes, krye, arsyë, fyell* etj. Në këto raste secila nga zanoret ruan pavarësinë e vet dhe formon rrokje më vete. Me fjalë të tjera, në shumicën e fjalëve të shqipes standarde, në përbërjen e të cilave ka dy zanore që vijnë njëra pas tjetrës, asnjëra nga zanoret e njëpasnjëshme nuk bëhet gjysmëzanore, rrjedhimisht formohen togje zanoresh. Te togjet e zanoreve theksi zakonisht bie në zanoren e parë.

Diftong (< gr. *dis* “i dyfishtë“ + *phthongos* “tingull” = dytingullsh, tingull i dyfishtë) formojnë dy zanore, po qe se shqiptohen me një rrokje të vetme. Dy zanore për të formuar një rrokje të vetme, e patheksuara duhet ta humbasë aftësinë rrokjeformuese, të reduktohet dhe të shndërrohet në gjysmëzanore a të konsonantizohet. Këtë aftësi rrokjeformuese e humbin zakonisht zanoret e mbyllura [i, u, y] kur janë të patheksuara, si **âi** [aj]: *babâi, vëllâi*; **âu** [av]: *âutobus, thâu, kâu, lâu*; **êu** [ev]: *prêu, thêu, krêu, Europë*; **uá** [va]: *kuálitet, akuárium, kuálifíkoj*; **ói** [oj]: *punói, shkói, ftói* etj., ku dy zanore formojnë një diftong, sepse zanoret e mbyllura shndërrohen në gjysmëzanore. Shqiptohet si diftong edhe togu [iá] në raste të tilla si: *iá dha* [ja dha], *iá thashë* [ja thashë] etj. Kur zanorja e mbyllur është e theksuar, atëherë s’kemi diftong, por tog zanoresh. Por, edhe nga këto grupe, vetëm një pjesë e vogël e tyre mund të gëzojnë edhe statusin e diftongut. Vetëm grupet **ai, au; ei, eu; ia, ie, io, iu; oi, ou; ui, uo** dhe **yu** mund të jenë edhe diftongje në gjuhën standarde shqipe.

Nga pikëpamja fiziologjike diftongjet kanë nyjetim të përbërë, elementet e të cilave janë të lidhura ngushtë midis tyre. Për nyjetimin e tyre organet aktive kalojnë me rrëshqitje nga nyjetimi i njëzës zanore në tjetrën, dhe me gjithë ndryshimin e timbrit, veshi i përkap ato si një nyjetim të vetëm. Për sa i përket gjatësisë, diftongjet dalin 1.5 deri 2 herë më të gjata se zanoret e thjeshta, por më të shkurtra se togjet e zanoreve gjegjëse.

Diftongjet e shqipes janë natyrash të ndryshme. Ndonjë prej tyre është i vjetër, i formuar nga zberthimi i një zanoreje, si p.sh. diftongu *ié*; një pjesë tjetër kanë hyrë nëpërmjet huazimeve, ndërsa disa janë krijuar si rrjedhim i takimit brenda fjalës në kufij morfemash apo në kushtet e sandhisë sintaksore, si te *shtëpia, shkoi, shtyu* etj.

Meqë zakonisht zanorja rrokjeformuese e diftongut është e theksuar, sipas vendit ku bie theksi, në zanoren e parë apo në të dytën, dallojmë diftongje zbritëse dhe diftongje ngjitëse. Kur zanorja e theksuar ndodhet në fillim, diftongu quhet *zbritës*, si p.sh. *káu, théu, kréu, aríu, fshíu, babái, vëllái*; ndërsa kur vjen pas, kemi diftong *ngjitës*, si në fjalët *kuótë, kuádër, kuárc, piáno* etj. Por, ka edhe diftongje në të cilat të dyja zanoret janë të patheksuara (mjauállín). Këto quhen duftongje të *ekuilibruara*.

Përgjithësisht zanoret e shqipes standarde, pavarësisht nga rrethimi tingullor (edhe sikur para ose pas tyre të kenë cilëndo zanore ose bashkëtingëllore që lejon parimi i bashkëlidhjes) karakterizohen me qëndrueshmëri (stabilitet) nyjetimore. Për këto zanore thuhet se kanë stadium gojor dhe janë zanore të thjeshta. Por megjithkëtë, nganjëherë ka edhe raste kur ndonjëra nga zanoret në kontakt me zanoren tjetër e humb stadiumin gojor. Stadium gojor do të thotë të qëndruarit për një kohë të caktuar (disa të qindta të sekondës) në një formë e pozitive të caktuar të aparatit të të folurit. Kjo është veçori e zanoreve.

Mungesa e stadiumit gojor është tipar i diftongjeve dhe i diftongoideve. Gjatë kohës së nyjetimit të diftongjeve kemi ndërrimin e pozitës së organeve të folurit (sidomos të gjuhës), gjatë së cilës në këtë tërësi artikuluere shfaqen dy faza të shkrira nyjetimi, rrjedhimisht edhe dy fragmente. Zakonisht në fillim të diftongut dëgjohet një timbër i një zanoreje, ndërsa në fund një timbër i ndonjë zanoreje tjetër (Savicka - Spasov, 1997 : 24).

Pra, nga pikëpamja nyjetimore diftongjet janë tinguj të përbërë. Për prodhimin e tyre, organet e të folurit kalojnë me rrëshqitje nga pozicioni i nyjetimit të një zanoreje në pozicionin e nyjetimit të zanores tjetër. Ndryshimi i vëllimit dhe i formës së rezonatorit të gojës në këto lëvizje bëjnë që gjatë prodhimit të diftongut të përkapen dy timbra të ndryshëm. Si gjithë tingujt e përbërë, diftongjet në disa gjuhë mund të funksionojnë si fonema më vete, krahas fonemave të tjera zanore. Në gjuhën shqipe diftongjet janë variante kombinatorë (alofone) të fonemave zanore përkatëse dhe nuk konsiderohen si fonema të veçanta.

Të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, sidomos gegërishtja qendrore. Në rrafshin dialektor të shqipes, të folmet e gegërishtes qendrore kanë diftongje dytësore, që na jep të drejtën të themi se në këtë grup të folmesh krahas shqiptimit të tendosur të zanoreve, kemi edhe shqiptim të labërguar (të shtendosur) (Hamiti, 2005 : 119).

Gjuha standarde si dhe të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, si në fjalët *babái, vëllái, ái, punói; dhéu, préu* etj. Në fjalët e këtilla zanoret e patheksuara fundore konsonantizohen dhe shqiptohen si gjysmëzanore ([i]-ja nyjtohet afërsisht si [j]-ja, ndërsa [u]-ja si [v]-ja). Pra, mund të arrijmë në përfundimin se diftongjet e shqipes standarde janë fonetike.


Të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, sidomos gegërishtja qendrore. Denduria e diftongjeve në të folmet e gegërishtes qendrore, për dallim nga të folmet e tjera të shqipes, qëmoti është shtuar nga shpërbërja (diftongimi) e zanoreve të mbyllura (/i, u, y/) në një numër të madh fjalësh në pozicione të caktuara fonetike. Kështu, në pozitë të theksuar, /i/-ja e gjatë e theksuar (í) shpërbëhet në variante dytësore diftongore [*ai, ei, ëi, oi*]: *shpi* > *shpai*, *shpeí, shpëí, shpoi*; /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/ dhe më vonë ka pasur të njëjten rrugë zhvillimi, është diftonguar si edhe /i/-ja parësore: *sy* > *si* > *sai, sei, sëi, soi*; ose /u/-ja në [*au, ou, ôu*]: *núse* > *naúse, noúse, nôuse* e në shumë fjalë të tjera.

Mund të përmbyllim se: të folmet shqipe si edhe gjuha standarde kanë togje zanore me përdorim mjaft të dendur; nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, ndërsa nga pikëpamja fonologjike nuk kanë diftongje njëfonemëshe (me përjashtim të pranisë së tyre në një numër të kufizuar fjalësh të huazuara: *akuarium, herbarium, kolokuium* etj.).

Të ngjashme me diftongjet janë edhe një kategori tingujsh që quhen *diftongoide* (nga greq. *diphthongos + eidos* “i ngjashëm me diftongun”). Diftongoidet janë zanore që kanë në fillim ose në fund një element të parëndësishëm të ndonjë zanoreje tjetër. Ky timbër i ndryshëm që merr zanorja në fillim ose në fund shkaktohet nga ndryshimi i formës dhe i vëllimit të zgavrës së gojës gjatë kohës që zgjat prodhimi i tingullit, gjë që shkakton kalimin nga një nyjetim më i mbyllur në një më të hapur ose anasjelltas. Por ky tingull i shkurtër përbën vetëm një ngjyrim plotësues ndaj timbrit themelor të zanores, prandaj diftongoidet nuk janë tinguj të përbërë. Gjuha standarde shqipe nuk ka diftongoide, por ato dëgjohen në të folmet e gegërishtes, si [m^uolla] “molla”, [n^oana] “nana”, [b^oab] “babë”, [d^uora] “dora”, [lⁱepër] “lepur”, [l^etër] “letër” etj.

PËRGJITHËSIME DIALEKTORE. Gegërishtja ka grupin zanor *ue* (shpeshherë të monoftonguar në *u:*), ndërsa toskërishtja grupin *ua*.

1. Grupet *ua* dhe *ue* janë përfutur nga togu *ou*, që më vonë ka dhënë *uo*, ndërsa nga ky i fundit është zhvilluar grupi *ue* në Veri dhe grupi *ua* në Jug. Vargu i zhvillimit fonetik të grupeve të zanoreve *ua* në toskërishte dhe *ue > u:* në gegërishte është ky:



Dy dialektet e gjuhës shqipe dallohen edhe për togjet e zanoreve, sepse gegërishtja përdor togun zanor *ue*, ndërsa toskërishtja togun *ua*. Togun *ue* shpeshherë e dëgjojmë të monoftonguar në *u:* të gjatë. P.sh. (fjalë të njëjta në gegërishte - toskërishte): *grue, gru:* - *grua*; *mue, mu:* - *mua*; *thue, thu:* - *thua*; *ftue, ftu:* - *ftua*; *due, du:* - *dua*; *u gzue, u gzu:* - *u gëzua*; *shkruej, shkruj - shkruaj*; *(kam) shkue, shku:* - *(kam) shkuar, (jam) msue, msu:* - *(jam) mësuar*; *me lexue, me lexu:* - *për të lexuar* etj. (Shih hartat 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).


Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve të njëjta me grupin *ua* dhe *ue*, në shqipen standarde normative janë format e fjalëve me *ua* (shih shembujt e mësipërm). Togu zanor *ue* i gegërishtes ka hyrë edhe në gjuhën letrare nëpërmjet fjalëve të veçanta, si *mësues, sulmues, e punueshme, i qëndrueshëm, e pabesueshme, e këshillueshme, e parashikueshme* etj.

2. Gegërishtja i përngjashmon (asimilon) grupet e zanoreve, ndërsa toskërishtja ato i ruan

Vështruar në planin e përgjithshëm, një dallim tjetër fonetik në rrafshin dialektor paraqet edhe ruajtja e togjeve të zanoreve në të folmet e toskërishtes, përkundër përngjashmimit të tyre në të folmet e gegërishtes (me ndonjë përjashtim). Kjo më së miri hetohet te togjet më të shpeshta të zanoreve *ue, ye, ie*: *dëgjues - dëgju:s, bluej - blu:j, shkruiej - shkru:j, gatues - gatu:s, shkruiej - shkru:j; dyer - dy:r, pyes - py:s, fyell - fy:ll, lyej - ly:j; miell - mi:ll, diell - di:ll, qiell - qi:ll, bie - bi:, ziej - zi:j* etj.

3. Gegërishtja ka në fillim të fjalës grupin nistor *vo*, ndërsa toskërishtja grupin *va*

Të folmet Veriore dhe ato Jugore dallohen edhe në përbërjen fonematike të të njëjtave fjalë. Grupin *vo* në fillim të fjalës e përdor gegërishtja, ndërsa grupin *va* toskërishtja: *vorr - varr, voj - vaj, votër - vatër, i vukt - i vakët, i vorfun - i varfër* etj. (Shih hartën 113 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007, f. 181).





Pyetje, ushtrime e detyra:

Pyetjet i kemi bërë për të folmen tënde.

1. Fjalët *njeri, veri, qiri, kafe, teneqe, tenxhere, xhade, xhevze, dysheme, Ajshe, Makfire, Fatime* në të folmen tënde shqiptohen me theks në rrokjen fundore apo në rrokjen parafundore?

2. A formojnë në të folmen tënde zanoret e shkurtra me zanoret e gjata kundërvënie fonologjike, si në çiftet e fjalëve: *plak* (gj. m.) ~ *pla:k* (gj. f.), *kunat* (gj. m.) ~ *kuna:t* (gj. f.), *krushk* (gj. m.) ~ *kru:shk* (gj. f.), një *vesh* ~ shumë *ve:sh*, një *dyshek* ~ shumë *dyshe:k*, *oxhak* ~ *oxha:k*, *baxhanak* ~ *baxhana:k*, *dollap* ~ *dolla:p*, *kos* ~ *ko:s* (kosi - kosa), *boll* ~ *bo:ll* (mjaft - lloj gjarpri), *shtat* ~ *shta:t* (trup - shtatë), *boj* ~ *bo:j* (trup - ngjyrë) etj.

3. A ka në atë të folme çifte fjalësh që dallohen për nga kuptimi vetëm me kundërvënien zanore gojore ~ zanore hundore, si (ne) *lam* ~ *lã:m* 'ne lam - lëm/ë, -a', (ata) *kan* ~ *kã:n* 'kën/ë, -a, (djemtë) e *mi* ~ *mĩ* 'miu' ose ndonjë tjetër.

4. E folmja juaj ka /ã/, ndonjëherë /ẽ/ hundore apo /ë/ të theksuar: *nã:n* apo *nënë*, *ãnërr* apo *ëndërr*, *zã* apo *zë*, *zëmër* apo *zëmër*, *vënd* apo *vënt* etj.

5. Në të folmen tënde përdoret [-n-]-ja ndërzanore ose [-r-]-ja ndërzanore: *pêni* apo *peri*, *frêni* apo *freri*, *lakën* apo *lakër*, *bãna* apo *bëra*, *syni* apo *syri* etj.

6. Të hetohet prania ose mungesa e zanores [ë] në fund dhe në mes të fjalës: *lopë* ose *lo:p*, *pulë* ose *pu:l*, *dorë* ose *do:r*, *farë* ose *fa:r*, *e hollë* ose *e ho:ll*; *udhëtar* ose *udhtar*, *nxënës* ose *nxans*, *këta* ose *ka* etj.

7. Në fillim të fjalës përdoret grupi *va* ose *vo*: *varr* apo *vorr*, *vaj* apo *voj*, *vatër* apo *votër*, *i vakët* apo *i vokët/i vokt* etj.

8. Zanorja [y] ruhet apo zhburorëzohet në [i]: *dy* a *di*, *aty* a *ati*, *ky* a *ki*, *brymë* / *bry:m* a *bri:m*, *yndyrë* / *yndy:r* / *yny:r* a *ini:r* etj.

9. Zanoret e mbyllura [i, u dhe y] të theksuara shqiptohen si në gjuhën standarde dhe në shumicën e të folmeve shqipe apo diftongohen: *sy* a *si* apo në variantet dytësore të diftonguara: *sãi*, *sëi*, *soi*, *sëi*; *mik* apo *mãik*, *mëik*, *mëik*; *nip* apo *nãip*, *nëip*, *nëip*; *rrip* a *rryp* apo *rrãip*, *rrëip*, *rrëip*; *nuse* apo *nãuse*, *nëuse*, *nëuse*, *nase*; *aru:sh* apo *arãush*, *arëush*, *arëush*, *ara:sh*; *frymë*, *fry:m* a *frim* apo *frãim*, *frëim*, *frëim* etj.

4.9. DALLIMET DIALEKTORE NË SISTEMIN E BASHKËTINGËLLOREVE

Në sistemin e bashkëtingëlloreve dallimet dialektore janë më të pakta se në sistemin e zanoreve. Është për t'u theksuar se të folmet janë shumë të afërta, sidomos në inventarin e fonemave bashkëtingëllore dhe në organizimin e tyre në sistem, çka është e rëndësishme për anën fonologjike. Dallimet më të shumta shfaqen në përbërjen fonematike të fjalëve, kurse dallime në variantet fonetike të fonemave bashkëtingëllore pothuajse nuk ka fare.

Po t'i japim së bashku të gjitha fonemat bashkëtingëllore që kanë të folmet në inventarët e tyre, duke përfshirë këtu si fonemat e përbashkëta, ashtu edhe fonemat e veçanta të disa të folmeve, ato formojnë një inventar të përgjithshëm prej 37 fonemash. Në këtë inventar të përgjithshëm ka 8 fonema më tepër se ato që ka gjuha letrare dhe shumica e të folmeve të dialektit jugor të shqipes (Gjinari - Shkurtaj, 1997 : 128).

Diferenca e të folmeve në numrin e fonemave bashkëtingëllore është e vogël: të folmet me inventarin më të madh kanë 30 fonema, shumë të tjera kanë 29 dhe disa kanë më pak se 29: disa kanë 27, kurse disa të tjera 26 fonema (Gjinari - Shkurtaj, 1997 : 129).

Shumica e të folmeve të toskërishtes dhe të folmet kalimtare kanë në inventarin e tyre ato 29 fonema bashkëtingëllore që ka edhe gjuha letrare:

Vendi i formimit	Buzore		Gjuhore					Glortale		
			Paragjuhore			Mes-gjuhore	Prapa-gjuhore			
			Ndërdhëmbore	Alveo-dhëmbore	Alveolare	Palato-alveolare	Qiellzore (palatale)			Grykore (velare)
<i>Mënyra e formimit</i>		p		t			q	k	të shurdhëta	
		b		d			gj	g	të zëshme	
					c	ç			të shurdhëta	
					x	xh			të zëshme	
		f	th		s	sh			h	të shurdhëta
		v	dh		z	zh				të zëshme
<i>Hundore</i>	m				n		nj			
<i>Anësore</i>				ll	l					
<i>Mesore</i>							j			
					r					
					rr					

Në disa të folme të jugut nuk kemi bashkëtingëllore /h/ si dhe shumëdrishësen /rr/. Rrjedhimisht, në këto të folme na dalin 27 fonema bashkëtingëllore: $29 - 2 (/h, rr/) = 27$.

Në të folmet e gegërishte verilindore (kosovarishtes) fonemat mesgjuhore /q, gj/ janë afrikatizuar në /ç, xh/. Pra, shqiptimi më i përparmë i bashkëtingëlloreve mesgjuhore [q, gj] në të folmet Veriore deri në shkallën e afrikatizimit të plotë në [ç, xh], si *çi:ll* ‘qiell’, *ça:f* ‘qafë’; *xhak* ‘gjak’, *xhu:m* ‘gjumë’ etj. ka për pasojë mungesën e mesgjuhoreve /q, gj/. Mirëpo, këto të folme kanë edhe një bashkëtingëllore prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore /ŋ/ e përfituar nga përngjashmimi i grupit *ng*, si në fjalët *ngat* > *ŋat*, *cung* > *cuŋ*, *ngaj* > *ŋaj*, *ngarkoj* > *ŋarkoj*, *mëngjes* > *mengez* > *meŋe:s*, *kungull* > *kuŋëll*, *bung* > *buŋ*, *opangë* > *opa:ŋ*, *cung* > *cuŋ* etj. Nga kjo del se këto të folme kanë $29 - 2 (/q, gj/) = 27 + 1 /ŋ/ = 28$ fonema bashkëtingëllore (Shih hartën 27 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).



Dallime më të mëdha në sistemin e bashkëtingëlloreve ndërmjet të folmeve shqipe dalin në përndarjen dhe dendurinë e përdorimit. Duke përgjithësuar dukuritë që janë më të përhapura në dy dialektet e shqipes, si më të rëndësishme janë:

i. Gegërishtja e ruan /-n-/-në ndërzanore, ndërsa toskërishtja e ka rotacizuar

Në fushën e fonetikës rotacizmi përbën një nga dallimet themelore ndërmjet dy dialekteve të shqipes: /n/-ja midis dy zanoresh ruhet në gegërishte, ndërsa kjo është shndërruar në /r/ në toskërishte.

Por, kjo dukuri nuk sjell as dallime në organizimin e fonemave, as dallime kuptimore. Si rrjedhim, ai është një dallim sasior e jo cilësor, d.m.th. lidhet vetëm me përndarjen e fonemave /r/ dhe /n/, ose me dendurinë e përdorimit të njëres e të tjetres fonemë, pa ndonjë kushtëzim fonetik. Këto fonema përdoren që të dyja në të dy dialektet, veçse si pasojë e rotacizmit të dikurshëm, në Jug ka denduri më të madhe /r/-ja, kurse në Veri ka denduri më të madhe /n/-ja.

Historikisht, rotacizmi që ka vepruar vetëm në toskërishten e në asnjë të folme të gegërishtes para më se 1300-1500 vjetësh, ka lidhje të ndërsjellë me hundorësinë e zanoreve, sepse, nga njëra anë, bashkëtingëlloret /n/ ka hundorëzuar zanoret që ndodheshin para saj; kurse, nga ana tjetër, zanoret e hundorëzuara, nyjetimi i të cilave ndryshonte nga zanoret gojore, kanë ndikuar në kthimin e bashkëtingëllores /n/ në /r/.

Dukuria e rotacizmit është shfaqur kryesisht në fjalët e trashëguara si dhe në huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja. P.sh.: *venë* - *verë*, *peni* - *peri*, *druni* - *druri*, *freni* - *freri*, *syni* - *syri*, *zani* - *zëri*, *vuna* - *vura*, *zuna* - *zura*, *bana* - *bëra*, *emën(ë)* - *emër(ë)*, *dimën(ë)* -

dimër(ë); lakën(ë) - lakër(ë), pjepën(ë) - pjepër(ë); ranë - rërë, kunorë - kurorë, femën(ë) - femër(ë), lini - liri, i varfën(ë) - i varfër(ë) etj.

Por, në toskërishten dhe në shqipen standarde ka mjaft fjalë, në të cilat [n]-ja ndërzanore nuk është rotacizuar, si p.sh.: *hënë, nënë, punë, unazë, anë, enë, e shtunë, dhunë, unë, tanë, tona; disa pjesore të foljeve të tipit zënë, thënë, lënë, qenë, vënë etj.*

Duke qenë se rotacizmi nuk prek sistemin e fonemave, kjo e ka lënë rrugën të hapur që gjuha letrare të marrë edhe fjalë të tjera që nuk i ka, me /n/ nga gegërishtja për pasurimin e fjalorit të vet, p.sh. *zanë-zana, zanore, zanafillë, vranësi, (i, e) vranët, krenar, kryeneç, grunore, ranishte, drenushë, rrypinë, barnatore, emnak, kodrinë, rini etj.*


4. Gegërishtja i përngjashmon (asimilon) grupet e bashkëtingëlloreve, ndërsa toskërishtja ato i ruan

Vështruar në planin e përgjithshëm, një dallim tjetër fonetik në rrafshin dialektor paraqet edhe ruajtja e togjeve të bashkëtingëlloreve në të folmet e toskërishtes, përkundër përngjashmimit të tyre në të folmet e gegërishtes (me ndonjë përjashtim). Kjo më së miri hetohet te togjet më të shpeshta të bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng**. Po sjellim disa shembuj me përngjashmim të plotë në kontakt të togjeve të bashkëtingëlloreve *mb > m, nd > n* ose *d* dhe të *ng > η* apo *g, k; si: mbush > mush, mbaj > ma:j, mbaroj > maroj, tambël > tamël, hambar > hamar, dhamb > dha:m, shkumbë > shku:m; vend > ven, ndër > nër, nderë > ne:r, ndaje > daje; ngat > ηat, cung > cuη, kungull > kuηëll, nga > ka a kah; ngutu > gutu etj.* (Shih hartat 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Shënim: me shkronjën <η> është shënuar bashkëtingëllorja prapagjuhore, mbylltore, sonante, hundore e përfutuar nga përngjashmimi i grupit *ng*, që e kanë shumë të folme të gegërishtes (Shih hartën 29 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

5. Gegërishtja e ruan kundërvënien fonologjike të bashkëtingëlloreve dridhëse /r/ ~ /rr/, ndërsa toskërishtja këtë kundërvënie e ka rrafshuar

Bashkëtingëlloret gjithashtu dallohen nga pikëpamja e gjatësisë: të shkurtra ~ të gjata. Edhe kjo gjatësi mund të ketë vlerë fonetike ose fonologjike. Në shqipen standarde dhe në të folmet e gegërishtes dallohen dy fonema bashkëtingëllore që i kundërvihen njëra-tjetrës në gjatësi me vlerë fonologjike (kuptimdalluese): /r/ ~ /rr/. Kjo më së miri mund të shihet në çifte



minimale fjalësh, si: *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, var ~ varr* etj. (Shih hartën 22 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Karakterit fonologjik i çiftit të bashkëtingëlloreve njëdridhëse /r/ dhe shumëdridhëse /rr/ ruhet mirë në gegërishten, ndërsa në toskërishten është bërë rrafshimi i kësaj gjatësie, duke u shndërruar /rr/-ja në /r/.

6. Fonema /nj/ ruhet mirë në toskërishten, ndërsa në gegërishten përdoret vetëm në fillim të fjalës

Në aspektin e përgjithshëm dialektor, fonemën mesgjuhore, mbylltore, tingëlluese, hundore /nj/ e kanë të gjitha të folmet e shqipes, si edhe shqipja standarde. Por, dallimi qëndron në faktin se kjo bashkëtingëllore ka përdorim të dendur në të folmet toske, ajo shqiptohet në të gjitha pozitat në fjalë (në fillim, në mes dhe në fund), ndërsa në të folmet gege ka përdorim të kufizuar, sepse ruhet vetëm në fillim të fjalës, si *njeri, njani, i njo:m, nja, njof, nje:rk* etj.

Në pak fjalë edhe kur gjendet në fillim të fjalës [nj] > [n], si *ni* ‘një’, *nizet* ‘njëzet’, *nisoj* ‘njësoj’. Në pozitë mesore e fundore të fjalës [nj]-ja shndërrohet në [j], si p.sh.: *e zoja* ‘e zonja’, *brËja* ‘brinja’, *rrËja* ‘rrënja’, *ftoj* ‘ftonj’, *hËj* ‘hunj’, *pËj* ‘penj’, *t’kqij* ‘të këqinj’ etj. (Shih hartat 28, 125, 126 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

7. Në të folmet e dialektit Verior [h]-ja dëgjohe mirë, ndërsa në ato të Jugut shqiptohet si më e dobët ose nuk dëgjohe fare

Bashkëtingëllorja glotale, shtegore, e shurdhët [h] dëgjohe mirë në të folmet e gegërishtes (përveç në të folmen e Dibrës e në ndonjë tjetër), ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohet me frymëtim (aspirim) më të dobët shkallësh të ndryshme ose nuk dëgjohe fare, me gjithë kufizimet në përndarjen e saj (diku nuk shqiptohet në asnjë pozitë të fjalës, diku nuk shqiptohet në fund e diku në mes të fjalës). P.sh: *ëna* ‘hëna’, *a* ‘ha’; *undë* ‘hundë’, *laet* ‘lahet’, *gjuja* ‘gjuha’, *i ftot* ‘i ftohtë’; *kra* ‘krah’, *pleh* ‘ple’, *sho* ‘shoh’, *njo* ‘njoh’ etj. (Shih hartat 21, 114, 115, 116, 117 122, 123 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

8. Të folmet e gegërishtes bashkëtingëlloren [h] në pozita të caktuara e këmbëjnë me [f]-në

Të folmet e dialektit verior dallohen prej të folmeve të dialektit jugor në fushë të fonetikës edhe për shkak se në disa raste të caktuara, sidomos në pozitë para [t]-së, por ndonjëherë edhe në pozita të tjera fonetike (më shpesh në fund të fjalës); në vend të [h]-së, shqiptojnë bashkëtingëlloren buzore-dhëmbore [f], si *i ftoft* ‘i ftohtë’, *i ngroft* ‘i ngrohtë’, *i preft* ‘i mprehtë’, *me njoft* ‘për të njohur’; *shof* ‘shoh’, *njof* ‘njoh’; *mshef*, *mçef* ‘fshehur’, *rraf* ‘rrah’, *qylaf* ‘qylah’ etj. (Shih edhe hartën 56 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

9. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës në toskërishte dhe ruajtja e tyre në gegërishte

Kur bashkëtingëlloret e zëshme [b, v, d, z, x, xh, zh, dh, gj, g] ndodhen në pozitë fundore absolute, ato ndërrohen me përgjegjëset e tyre të shurdhëta [p, f, t, s, c, ç, sh, th, q, k] në të folmet jugore: *elp* ‘elb’, *qelp* ‘qelb’, *dif* ‘div’, *urof* ‘urov’, *funt* ‘fund’, *njerës* ‘njerëz’, *heth* ‘hedh’, *u loth* ‘u lodh’, *u doq* ‘u dogj’, *brek* ‘breg’ etj., ndërsa në të folmet veriore e ruajnë zëshmerinë (Shih hartat 44, 45 e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Shikuar në aspektin fonologjik, me dukurinë fonetike të shurdhimit asnjësohet kundërvënja e zëshmerisë së fonemave, sepse bashkëtingëlloret e shurdhëta janë variante pozicionale të fonemave të zëshme. Kur të zëshmet nuk gjenden në pozita fundore, ato nuk e humbin zëshmerinë, si *zok - zogu, brek - bregu, vënt - vëndi, u doq - u dogja* etj.

Në shumë të folme të gegërishtes qendrore në shumicën e fjalëve ku të folmet e tjera kanë fonemën prapagjuhore /g/, ato kanë fonemën qiellzore mbylltore /gj/, si në fjalët: *gjisht* ‘gisht’, *gjur* ‘gurë’, *gjo:j* ‘gojë’, *gjardh* ‘gardh’, *pagjuj* ‘paguaj’, *zagjar* ‘zagar’, *megjëll* ‘mjegull’, *magjar* ‘gomar’, *argjat* ‘argat’, *burgj* ‘burg’, *lu:gj* ‘lugë’, *pragj* ‘prag’, *degj* ‘degë’, *largj* ‘larg’, *frâigj* ‘frikë’ etj. Por, këto të folme kanë edhe fjalë në përbërjen e të cilave ka /g/: *grue, grusht, gru:n, griq, gro:sh, gërsha:n, gu:m* etj. Prandaj, mund të konstatojmë se në këto të folme nuk mungon krejtësisht fonema /g/, edhe pse përdoret më rrallë, meqë në vend të saj shpeshherë kemi /gj/. Pra, në inventarin e fonemave bashkëtingëllore në të folmet e gegërishtes qendrore kemi /g/ e /gj/ (Shih hartat 118, 119, 120 e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

10. **Zhvillimi (refleksi) i grupeve të vjetra konsonantike [kl] e [gl].** Një pikë me rëndësi ku dallohen të folmet e shqipes është zhvillimi i ndryshëm i grupeve të bashkëtingëlloreve [kl] e [gl]. Grupet e vjetra bashkëtingëllore [kl] e [gl] i gjejmë të shkruara qysh në shekullin XVI te Meshari i Gjon Buzukut, por nuk i gjejmë te Budi e as tek autorët e mëvonshëm (Çabej, 1968, I, II). Grupet e vjetra [kl] e [gl] kanë evoluar në katër variante:

a) **Rajtja e grupeve [kl], [gl].** Ende ruhen të pandryshuara në të folmet më jugore të shqipes: në çamërishten si dhe tek arbëreshët e Greqisë e të Italisë, te kolonia shqiptare e Ukrainës dhe arbëreshët e Zarës (Gjinari, 1988 : 109; Çabej, 1987 : 97), si në fjalët: *klaj*, (kam) *klenë, klumësht, kloftë, klishë; gluha, glishiti* etj.

b) **Zhvillimi i [kl]-së në [kj] dhe i [gl]-së në [g-j]** në të folmet e gegërishtes veriperëndimore me qendër në Shkodër: *kjaj*, (kam) *kje:n, kjo:ft; g-juha, g-jishti*.

c) **Zhvillimi i [kl]-së në [k] dhe i [gl]-së në [g]** në të folmet e gegërishtes verilindore (në kosovarishte) bashkëtingëlloret e dytë, [l]-ja ka rënë dhe ka mbetur vetëm elementi i parë i grupit, gjegjësisht [k]-ja dhe [g]-ja: *kaj*, (jam) *ka:n, ko:ft, ku:sht < klumësht; guha, gishti*.

ç) **Qiellzorëzimi i [kl]-së në [q] dhe i [gl]-së në [gj]** në të folmet e toskërishtes si dhe në pjesën më të madhe të të folmeve të nëndialektit të gegërishtes jugore (në të folmet e grupit të të folmeve të Shqipërisë së Mesme si dhe të gegërishtes qendrore): *qaj, qoftë*; (kam) *qenë* (kam) *ka:n* (në disa të folme të gegërishtes qendrore), *gjuha* (Shih hartat nr. 121, 122, 123 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Në përshkrimet dialektore, përveç çështjeve përgjithësuese që i përmendëm, është e udhës të vëzhgohen edhe në çfarë forme dalin grupet e bashkëtingëlloreve [tj], [dj], [pj], [mj] e [vj], [pl], [bl], [fl] meqë nëpër të folmet shqipe përdoren në variante fonetike të ndryshme: diku ruhen si të tilla, në disa të folme janë shndërruar në ndonjë variant fonetik tjetër, si *plak > pjak > pqak > qak; flutur > flutër > fjutër > fqutër > qutër, bletë > ble:t > bje:t > bgje:t > gje:t* etj. Mirëpo, kjo më së mirë mund të shihet kur bëhet fjalë për çdo të folme veç e veç.



Pyetje, ushtrime dhe detyra:

Përgjigjet i jep për të folmen tënde.

1. Në të folmen tënde përdoret [-n-]-ja ndërzanore ose [-r-]-ja ndërzanore: *pêni* apo *peri*, *frêni* apo *freri*, *lakën* apo *lakër*, *bâna* apo *bëra*, *syni* apo *syri* etj.
2. Togjet e bashkëtingëlloreve *pl*, *bl*, *fl* përdoren të plota apo përngjashmohen (asimilohen): *plak* a *pqak*, *qak*; *plep* apo *pqep* a *qep*; *pleh*, *pqeh* a *qeh*; *plot*, *pqot* a *qot*; *bletë/ble:t* a *bgje:t*, *gje:t*; (kam) *ble*, *bgje* a *gje*; *bjeshkë/bje:shk* a *bgjeshk*, *gjeshk*; *flutur/flutër* a *fqutër*, *qutër* etj.
3. A qiellzorëzohet [g]-ja në [gj]: *gojë/go:j* apo *gjo:j*, *gisht* apo *gjisht*, *gardh* apo *gjardh*, *argat* apo *argjat*, *mjegull/mjegëll/megëll* apo *megjëll*, *larg* apo *largj*, *lugë/lu:g* apo *lu:gj* etj.
4. Bashkëtingëlloret [q, gj] shqiptohen si mesgjuhore, disi më të përparme apo afrikatizohen në [ç, xh]: *qen*, *q'en* apo *çen*, *qilim*, *q'ilim* apo *çilim*, *qershi*, *q'ershi* apo *çershi*; *gjak*, *gj'ak* apo *xhak*, *gjumë*, *gju:m*, *gj'u:m* apo *xhu:m*, *gjeth*, *gj'eth* apo *xheth* etj.
5. A ruhet kundërvënia fonologjike e bashkëtingëlloreve dridhëse /r/ dhe /rr/ apo /rr/-ja është shndërruar në /r/, si në fjalët *ara* ~ *arra*, *ruaj* ~ *rruaj*, *var* ~ *varr* etj.
6. Bashkëtingëllorja [nj] ruhet apo këmbëhet me [j]-në ose [n]-në në fjalët: *njëzet* a *nizet*, *njësoj* a *nisoj*, *e zonja* apo *e zoja*, *penj* apo *pej*, *thonj* apo *thoj*, *ftonj* apo *ftoj* etj.
7. Sa dëgjohet [h]-ja: ashtu si në gjuhën letrare, e rrëgjuar apo nuk dëgjohet fare, si në fjalët *hënë/ha:n* apo *^hënë/^ha:n* ose *ënë*, *a:n*; *herët*, *^herët* apo *erët*, *krah*, *^hkrah* apo *kra:*, *shoh*, *^hsho* apo *sho* etj.
8. A këmbëhet [h]-ja me [f]-në në fjalët: *i ftohtë* > *i fto:ft*, *i nxehtë* > *i nxeft*, *shoh* > *shof*, *i ngrohtë* > *i ngro:ft* etj.
9. A shurdhohen bashkëtingëlloret e zëshme kur gjenden në pozitë fundore, duke u kthyer në korrespondueset e tyre të pazëshme: *breg* ose *brek*, *shteg* ose *shtek*, *zog* ose *zok*, *vend* ose *vënt*, *mend* ose *mënt*, *brez* ose *bres* etj.

4.10. DALLIME NDËRMJET FOLËSVE TË SHQIPES

NË BAZËN ARTIKULATIVE

Në pikëpamje gjuhësore në përgjithësi mund të themi se gegët dhe toskët dallojnë paksa edhe në bazën artikulative të tyre. Dihet se tërësia e të gjitha artikulimeve të nevojshme për nyjëtimin e tingujve në një gjuhë quhet *bazë artikulative*. Po të krahasohet baza nyjëtimore ndërmjet gjuhëve të veçanta, vërehet se ajo pak a shumë është e ndryshme. E dallueshme është edhe baza artikulative e varianteve territoriale të një gjuhe të përbashkët. Nyjëtimi i tingujve të gjuhës amtare bëhet sipas shprehive të fituara, ashtu siç dëgjohet në familje, në mjedisin e në territorin ku jeton njeriu, sidomos gjatë periudhës së fëmijërisë (Asllan Hamiti, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe, Shkup, 2005, 2011, f. 77-79).

Disa nga dallimet e shprehive nyjëtimore të shqiptarëve të Veriut e të Jugut tani më u përmendëm në shtjellimin e hundorëzimit dhe të gjatësisë së zanoreve. Përkatësisht, shprehi nyjëtimore të gegëve janë: shqiptimi i ndër-hundshëm i disa zanoreve, shqiptimi i zanoreve të gjata, theksimi paroksiton i disa orientalizmeve etj.; ndërsa shprehi të përgjithshme nyjëtimore të toskëve janë: nyjëtimi i zanoreve vetëm si gojore, mungesa e zanoreve të gjata, theksimi oksiton i disa orientalizmeve etj. Baza artikulative dallohet e identifikohet jo vetëm ndërmjet folësve gegë e toskë, por edhe ndërmjet pjesëtarëve të nëndialekteve, grupeve të folmeve e të folmeve të një krahine. Fjala vjen, shprehi nyjëtimore tipike e pjesëtarëve të gegërishtes qendrore është zhburorëzimi i [y]-së në [i], diftongimi i zanoreve të ngritjes së lartë [i] dhe [u] në diftongje dytësore, qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] etj. Pikërisht, në sajë të shprehive nyjëtimore ne me saktësi (relative) mund të identifikojmë përkatësinë territoriale të folësit, aq sa përcaktojmë jo vetëm cilit dialekt i përket, por lokalizojmë edhe krahinën a zonën, bile edhe rrethin; po të jemi të asaj zone, me saktësi mund të përcaktohet edhe katundi i folësit. Këtë identifikim territorial të folësit e bëjnë jo vetëm gjuhëtarët, sidomos dialektologët, por edhe njerëzit e profesioneve të tjera.

Edhe në jetën e përditshme shpeshhrë themi: nga mënyra si flet kuptova se je tetovar, strugan, dibran, shkodran, tepelenas, vlonjat, arbëresh... apo se je shqiptar që jeton në Gjermani, në Amerikë, në Turqi etj., të fundit për shkak të ndikimit të gjuhëve të huaja të mjedisit. Për t'u bindur për këtë mjafton të zbritni nga Interneti e të shihni ndonjë nga episodet e komedisë së serialit televiziv "O sa mirë", emetuar nga Digitalb, ku aktorë krahinash të ndryshme shqiptare (në rolin e nxënësve) çdonjëri nga ta flet në të folmen vendore të tij.

Shumëllojshmëria e shqiptimit të tingujve ka bazë gjeografike, pra është i lidhur me prejardhjen regjionale të folësve. Në një vështrim përgjithësues, mund të thuhet se **gegët** dhe **toskët**, përveç shumë **shprehive nyjëtimore të përbashkëta**, kanë edhe disa **shprehi nyjëtimore dalluese**:

1. Theksi dinamik te gegët është më i fuqishëm sesa te toskët (si në mbarë shqipen edhe në toskërishte theksi është dinamik, por toskërishtja ka më shumë elemente të theksit muzikor).
2. Gegët dallohet me zgjatjen e zanoreve të theksuara, mosshqiptimin e zanoreve të patheksuara, me shqiptim më të hapur të zanoreve krahasuar me toskët.
3. Gegët karakterizohet me shqiptim më të përparmë të bashkëtingëlloreve (tipike është afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]).
4. Gegët shquhet me prirje më të shprehur për të ekonimizuar të folurit, për të lehtësuar shqiptimin, me një shkallë më të lartë të përshtatjes nyjëtimore (akomodimit) të tingujve sesa toskët etj., dhe përgjithësisht
5. Gegët flasin më ngadalë sesa toskët dhe janë më të kursyer në fjalë.

Natyrisht, në çdo përgjithësim ka edhe përjashtime. Këto çështje deri më sot nuk janë trajtuar sa duhet. Do të përpiqemi të japim pak shpjegime e supozime lidhur me disa pohime të mësipërme. Meqë dukuritë gjuhësore janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, ato edhe gjatë shpjegimit të tyre vështirë se mund të ndahen veç e veç.

Siç dihet, shqipja standarde, por edhe variantet dialektore (gegërishtja e toskërishtja) kanë theks dinamik, të lirë e të palëvizshëm në paradigmat e eptimit. Te gjuhët me theks dinamik, forca është elementi mbizotërues që e dallon rrokjen e theksuar nga të tjerat. Por, duhet pasur

parasysh se rrokja e theksuar dallohet jo vetëm për forcë më të madhe, por edhe për gjatësi më të madhe, ton më të lartë etj. Pra, theksi i shqipes karakterizohet nga katër tipare që bashkëveprojnë: intensiteti, gjatësia, lartësia dhe cilësia e zanores. Të gjitha këto elemente veprojnë së bashku, prandaj është e vështirë të dallojmë ç'rol luan njëri ose tjetri tipar i marrë veças. Theksi dinamik i shqipes duket:

- a) në ndryshimet kuantitative ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara: zanoret e theksuara janë më të gjata sesa të patheksuarat;
- b) në tkurrjen, por edhe në rënien e zanoreve të patheksuara;
- c) në krijimin e një zanoreje të rrëgjuar [ë], nga zanoret e patheksuara;
- ç) në krijimin e fjalëve të patheksuara brenda fjalisë (trajtat e shkurtra, parafjalët, pjesëzat etj.).

Në gjuhët e dialektet që kanë theks dinamik ose intensiv (i quajtur nganjëherë edhe ekspirator) rrokja e theksuar dallohet nga të tjerat për fuqinë dhe intensitetin e shqiptimit; domethënë rrokja e theksuar shqiptohet më fuqishëm sesa rrokjet e patheksuara (të patheksuarat shqiptohen më dobët). Theks muzikor (theks tonik apo kromatik) kanë gjuhët e dialektet ku rrokja e theksuar dallohet nga të patheksuarat për nga numri i dridhjeve në sekondë, domethënë nga toni më i lartë (nga lartësia e tonit); me të cilin shqiptohet zanorja e theksuar, në krahasim me zanoret e patheksuara; duke krijuar kështu, me ngritjet dhe uljet e tonit, elemente të melodive muzikore.

Por, ndërmjet këtyre dy tipave të theksit (theksit muzikor dhe theksit dinamik) nuk ekziston një dallim i prerë. Ata nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, pasi fuqia më e madhe e shqiptimit kushtëzon rritjen e numrit të dridhjeve, që përcaktojnë lartësinë e tonit; ashtu si edhe tonet më të larta çojnë në rritjen e intensitetit. Për këtë arsye mund të flitet për gjuhë, në të cilat mbizotëron njëri ose tjetri tip theksimi (theksi dinamik apo muzikor). Kështu, në gjuhën shqipe rrokja e theksuar jo vetëm që është më e fortë, por edhe me ton më të lartë, më e gjatë dhe më e qartë sesa rrokja e patheksuar.

Nga shpjegimet e mësipërme, mund të nxirret si përfundim se **gegërishtja ka theks dinamik më të spikatur, ndërsa toskërishtja ka theks dinamik me elemente të theksit muzikor**. Këtë pohim e mbështesim edhe në faktin se:

Gjuhët e dialektet me theks muzikor i ruajnë mirë të gjithë tingujt zanorë në ëdo pozicion, të theksuar e të patheksuar. Në këtë kuptim, toskërishtja i ruan më mirë tingujt zanorë në çdo pozicion të theksuar e të patheksuar.

Në gjuhët e dialektet me theks dinamik dallimi në gjatësi i zanoreve të theksuara ndaj zanoreve të patheksuara është më i madh sesa në gjuhët me theks muzikor. Zanoret e theksuara në gegërishte janë dy herë më të gjata sesa të patheksuarat, ndërsa në toskërishte të theksuarat janë fare pak më të gjata sesa të patheksuarat. Pra, zanoret e theksuara në gegërishte shqiptohen më të gjata sesa në toskërishte. Në toskërishten dhe në shqiptimin letrar përpjesëtimi në gjatësi ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10 : 7; ndërsa në gegërishte ky raport është 2 : 1. Me metodën e fonetikës eksperimentale, prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1 (Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të*

shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995, f. 232). Po i njëjti dialektolog konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7 (në artikullin *Sistemi fonologjik ...*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 93-109).

Në të folmet e gegërishtes rrëgjimi i zanoreve të patheksuara është më i madh sesa në të folmet toske. Zanoret e patheksuara në gegërishten jo vetëm që kanë prirje të tkurren, por shpeshherë edhe bien, si p.sh. *flútur* > *flútër*, *përrállë* > *prrá:ll*, *móllë* > *mó:ll*, *shtëpí* > *shpí*, *shtëllúngë* > *shllú:ng*, *bashkëtingëllore* > *bashktingllore*, *bashkëkohór* > *bashkohór* etj. Shembujt e dhënë dëshmojnë se ndonjëherë nuk shqiptohen jo vetëm zanoret e patheksuara, por edhe gjithë rrokja e patheksuar. Tani më është përdëftuar përgjithësisht se shkalla e rrëgjimit deri në rënie të plotë të zanoreve të patheksuara në të folmet e gegërishtes është më e madhe sesa në të folmet e toskërishtes dhe në shqipen standarde. Këtë pohim më së miri e mbështet mosshqiptimi i [ë]-së fundore, jo vetëm në fundin absolut të fjalës, por shpeshherë edhe në mes të fjalës (jo vetëm: *mo:ll*, *shko:ll*, *na:n*, *lo:p*, *mi:r* ‘mollë, shkollë, nënë, lopë, mirë’; por edhe *përmirsím*, *msu:s*, *anta:r* ‘përmirësim, mësues, anëtar’ etj.).

Shprehi nyjëtimore e gegëve është që togjet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve të mos i shqiptojnë të plota, përkatësisht të bëjnë monoftongimin e togjeve të zanoreve dhe përngashmimin e togjeve të bashkëtingëlloreve. Për shkak të lehtësimit të shqiptimit, në vend të formës fonetike të plotë, në gegëri kemi forma të përngjashmuara (asimiluara), si *arsy:.*, *fy:ll*, *kry:.*, *ly:j*, *py:s*, *thy:j* a *the:j*; *dëgju:s*, *msu:s*, i *lexu:shëm*, i *pajtu:shëm*, i *vazhdu:shëm*; i *arsy:shëm*, i *pathy:shëm* (< arsyë, fyell, krye, lyej, pyes, thyej; dëgjues, mësues, i lexueshëm, i pajtueshëm, i vazhdueshëm; i arsyeshëm, i pathyeshëm). Zanorja që mbetet gjatë monoftongimit shqiptohet gjithmonë e gjatë ([ye] > [y:], [ue] > [u:] (përkatësisht në /y/ dhe /u/ të gjata). Edhe togjet e bashkëtingëlloreve toskët përgjithësisht i shqiptojnë të plota, ndërsa gegët i përngjashmojnë, si *maj* (< mbaj), *kumëll* (< kumbull), *nimój* (< ndihmoj), *fun* (< fund), *nat* (< ngat) etj.

Dihet se nyjëtimi themelor i tingujve merr nuanca plotësuese, varësisht nga rrethimi tingullor, pra tingujt u përshtaten kushteve fonetike në të cilat gjenden ose siç thuhet akomodohen. Sa i përket ndikimit të kontekstit tingullor të drejtpërdrejtë ndaj ngjyrës së zanoreve, në shqipen janë të njohura disa dukuri, si: *ndryshimi i lartësisë së nyjëtimimit*, *zhvendosja nyjëtimore para/prapa*, *qiellzorëzimi*, *buzorëzimi*, *velarizimi*, *hundorëzimi* i zanoreve etj. Në shumicën e rasteve, modifikimet në shqipen, në thelb, janë ndërlidhje të nevojshme gjatë nyjëtimimit të fonemave në rrjedhën e të folurit. Toskërishtja (dhe shqipja standarde) bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve pa përshtatje të theksuar të tingujve, pra janë joakomoduese. Gegërishtja krahasuar me toskërishten është më shumë akomoduese, pra bën përshtatje nyjëtimore më të madhe të tingujve të kushtëzuara nga nga rrethimi tingullor ose nga pozicioni. Alofoia e fonemave zanore është më e madhe sesa e bashkëtingëlloreve.

Dukuri akomoduese mjaft e shpeshtë në gegërishte është **qiellzorëzimi**, përkatësisht nyjëtimi i bashkëtingëlloreve me një timbër qiellzor, kur gjenden në kontakt me ndonjë zanore të përparme. Kështu, prapagjuhoret /k, g/ shqiptohen si më të përparme kur ndodhen para zanoreve të përparme /i, y, e/, duke u afruar me qiellzoret, si *gisht* [g'isht] (në gegërishten qendrore *gjisht*), *kemi* [k'emi]. Në disa të folme të gegërishtes /e/-ja bëhet edhe më e përparme, përkatësisht nis me tingullthin [i], kur vjen pas një bashkëtingëlloreje qiellzore: *qeth* [q'eth], *lepur* [l'epër], *gjeth* [gj'eth], *gjel* [gj'el] etj. Edhe **buzorëzimi** (labializimi), që është shqiptimi i tingujve jobuzorë me nuanca buzorëzuese e që ndodh gjatë kontaktit të ndonjë bashkëtingëlloreje

ose zanoreje jobuzore me një tingull tjetër buzor, është shumë e shpeshtë në të folmet e gegërishtes, veçmas të shndërrimit të [ã]-së hundore në [o], sipas tipit nãna > na^ona, nona; hãna > ha^ona, hona etj. Po kështu, **hundorësia** e zanoreve (nazalizmi), që është dukuri fonetike e shqiptimit të ndër-hundshëm të zanoreve, është shprehur nyjëtimore gege, e papranishme te toskët. Hundorëzimi i zanoreve, pasojë e përngjashmimit prapavajtës në takim (asimilimit regresiv në kontakt), ka ndodhur kur zanoret janë gjetur apo edhe sot gjenden para bashkëtingëlloreve hundore /m, n, nj/, si *hû, sÿ, pê, frê; hûni, sÿni, pêni, frêni* etj. Shkalla e hundorësisë së zanoreve në të folmet gege është e larmishme: në veri është më e lartë, ndërsa sa më në jug që shkohet, hundorësia e zanoreve zvogëlohet. Kjo dukuri nuk i ka përfshirë të gjitha të folmet e gegërishtes: diku kemi zanore hundore me vlerë fonologjike, ndërsa diku hundorësia është defonologjizuar dhe dëgjohen zanore të hundorëzuara. Në toskërishten (dhe në shqipen standarde) zanoret hundore nuk bëjnë pjesë në inventarin e fonemave zanore.

Shkalla e alofonisë së fonemave, veçmas e zanoreve, te gegët është shumë më e madhe sesa te toskët (dhe në shqiptimin letrar): gegërishtja ka trashëguar nga shqipja e moçme dhe ende e ruan shqiptimin e ndër-hundshëm të zanoreve; dukuri fonetike shumë të shpeshta te folësit gegë janë: buzorëzimi i zanoreve në shkallë të ndryshme (zãni > za^oni > zoni), diftongimi i zanoreve të ngritjes së lartë [i, u] (mirë > mair, nuse > nause - vetëm në të folmet e gegërishtes qendrore), shqiptimi i zanoreve të mirëfillta si diftongoide (lepur > lⁱepër), nyjëtimi më i përparmë dhe më i mbyllur i disa zanoreve të patheksuara (flutur > flutër), qiellzorëzimi i bashkëtingëlloreve (gojë > gjo:j - në gegërishten qendrore), afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore (qen > çen, gjak > xhak - në shumicën e të folmeve të gegërishtes veriore), përngjashmimi i grupeve të zanoreve e të bashkëtingëlloreve (mësues > msu:s, mbaj > maj - në shumë të folme të gegërishtes veriore), metateza (lëshoj > shloj - dukuri më e përhapur në të folmet e gegërishtes) etj.



Pyetje, ushtrime e detyra:

Analizoje leksionin sipas skemës:

1. Shpjegoje mësimin.
2. Çfarë rëndësie kanë të dhënat e sjella në këtë leksion?
3. Jepi vlerësimet e tua rreth këtyre të dhënave.
4. Çfarë lidhje ka ky mësim me mësimet paraprake?
5. Si do të mund t'i përdor këto njohuri në punën time profesionale?

KREU V

5. DALLIMET DHE NGJASHMËRITË MORFOLOGJIKE

Edhe në fushë të morfologjisë, krahas bazës së gjerë të përbashkët, ka disa dallime ndërmjet dialekteve të shqipes. Ato vërehen më shumë në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, përkatësisht në kategoritë gramatikore të emrit, të mbiemrit, të përemrit, të foljes; ndërsa më pak në pjesët e pandryshueshme, si në ndajfolje, në parafjalë, në lidhëza etj.

5.1. NDËRRIMET MORFONOLOGJIKE NË TË FOLMET SHQIPE

Gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe janë zhvilluar disa procese fonologjike me vlerë morfologjike, të cilat zakonisht quhen dukuri morfonologjike. Ndonjë nga dukuritë morfonologjike është shumë e vjetër, e përftuar qysh në gjuhën “nënë” të shqipes. Por shumica e dukurive të këtilla të shqipes së dokumentuar janë, në thelb, zhvillime të brendshme të vetë kësaj gjuhe, megjithëse procesi për ndonjë prej tyre mund të ketë nisur qysh në gjuhën “nënë” të saj. Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane me morfonologji të zhvilluar, hasen (Demiraj, 1996 : 120):

- a) *ndërrime fonemore që shërbejnë si mjet i vetëm gramatikor dhe*
- b) *ndërrime fonemore që veprojnë krahas me ndajshitesat eptimore.*

Ndryshimet fonemore kanë prekur mesin ose fundin e fjalës. Ndryshimet e fonemave nistore janë tepër të rralla në shqipen e sotme, sepse ato janë më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve. Kjo është shpjeguar me atë që për ndjenjën gjuhësore të shqipfolësit, ndryshimi i fonemës nistore të një morfeme shpie në prishjen e identitetit kuptimor të saj.

Dihet se kundërvëniet morfonologjike në mbarë shqipen janë më të shpeshta në paradigmat emërore (sipas numrit, trajtës, rasës) dhe në paradigmat foljore (sipas vetave, numrit, kohëve, mënyrave dhe diatezës), e më pak në sistemin mbiemëror (Demiraj, 1996 : 120).

Në çështjen e ndërrimeve morfonologjike shqipja na del mjaft e njësuar (unike), meqë po të njëjtat këmbime kanë shtrirje të përgjithshme territoriale. Dukuri më të përhapura në të dy dialektet janë qiellzorëzimi, metafoia, apofonia si dhe disa ndërrime të tjera zanoresh e bashkëtingëlloresh.

Duhet përmendur se të folmet gege realizojnë edhe kundërvënien e gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve, që të folmet toske përgjithësisht e kanë bjerrë këtë.

Qiellzorëzimi i fonemave si dukuri morfonologjike e ndërrimit të një foneme joqiellzore në një fonemë qiellzore ka shtrirje mbarëdialektore. Nga bashkëtingëlloret qiellzorëzohen /k/-ja në /q/, /g/-ja në /gj/; /l/-ja, /l/-ja dhe /r/-ja në /j/. Ndërrimin e /k/ ~ /q/ e gjejmë tek emrat mashkullorë, kryesisht të burimit shqip, por edhe të huaj. Me qiellzorëzimin e /k/-së në /q/ nga forma e njëjësit shumësin e formojnë disa emra mashkullorë.

Për të parë ndërrimet e fonemave në të folmet e veriut mbështetje mund të gjejmë në skicat dhe monografite dialektore, por kjo nuk do të ishte e mjaftueshme, pa vjeljen e materialit me vëzhgim të drejtpërdrejtë. Një ndërmarrje e këtillë kërkon punë disaveçare ekipore të koordinuar.

Ne me këtë rast për të trajtuar këtë temë do të mbështetemi në format toske e standarde, duke i krahasuar me format e disa të folmeve të gegërishtes të nxjerra nga monografite dialektore:

ka ~ qe (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është shtrirja teritoriale e larmishme e formës së shumësit të emrit *ka*. Në bazë të të dhënave që kemi mundur të sigurojmë, të folmet e nëndialektit të gegërishtes veriore, veçmas ato të Kosovës e deri te të folmet veriore të Shkupit e ruajnë formën e vjetër të paqjellzorëzuar *kije*, me përjashtim të të folmes shqipe të Peshterit, ku krahas formës *kije* përdoret edhe forma *qe* ose *çe* (si variant teritorial me afrikatizimin e [q]-së në [ç]) si dhe e folmja e Prilepit dhe e Krushevës *qie*. Në të folmet e tjera në shtrirje gjeografike në jug të Tetovës dëgjojmë formën e palatalizuar *qe*. P.sh.: *ka ~ kie* (Kosovë, Karadak i Shkupit), *qie* (Prilep e Krushevë), *çe* (Pollog), *qe* dhe *kie* (Peshter), *kije* (Moravë e Epërme dhe e Poshtme), *çie* dhe *kie* (Tetovë).

Tek emrat *mik*, *anmik*, *plak*, *ujk*, *krushk* në të gjitha të folmet geqe, ashtu si edhe në ato toske kemi qiellzorëzim të plotë të /k/-së fundore në /q/. Në të folmet e gegërishtes veriore dëgjojmë format me /q/ të afrikatizuar, ndërsa në gegërishten qendrore me /i/ dhe /u/ të diftonguar, përkatësisht në *miq*, *miç*, *mâiq*; *pleq*, *pleç*, *pqeq*, *qeq*; *uq*, *uç*, *âuq*, *ôuq*; *anmiq*, *anmiç*; *krushq*, *krushç*. Këtë mund ta dëshmojmë me shembujt:

mik ~ miq (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *miç* (Kosovë, Karadak i Shkupit), *mâik* - *mâiq* (Prilep e Krushevë), *miç* (Pollog).

armik ~ armiq (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *anmik* - *anmiç* (në Kosovë e Maqedoni).

plak ~ pleq (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *plak* - *pleç* (në Kosovë, në Karadakun e Shkupit, në Malësinë e Sharrit të Tetovës), *pleq* në Peshter, *pqak* - *pqeç* por edhe *qak* - *qeq* (Pollog), *pleq* (Peshter), *plak* ose *qak* - *pleq* ose *qeq* (në Karadakun e Shkupit).

ujk ~ ujq (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Edhe shumësi i fjalës *uk* na del me /k/ fundore të qiellzorëzuar. P.sh.: *uk* - *uç* (Kosovë e Maqedoni), në Prilep e Krushevë me /u/ nistore të diftonguar në [âu]: *âuk* - *âuq*, në Karadakun e Shkupit me /u/ nistore të diftonguar në [ôu]: *ôuk* - *ôuq*; *uç* (Pollog), *ujq* (Peshter), *uç* (Tetovë).

krushk ~ krushq: *krâushk* - *krâushq* (Prilep e Krushevë), *krushç* (Kosovë).

peshk ~ peshq (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Shumësi i emrit *peshk* del i larmishëm në të folmet e Veriut. Kështu, në Kosovë dëgjojmë formën *peshçi*, në Karadakun e Shkupit *peshki*, në Karshiakë të Shkupit e Derven (zonë gjuhësore midis Shkupit e Tetovës) kemi formën me /i/ fundore të diftonguar *peshkâi* dhe *peshka* si dhe formën *peshqe* në Prilep e Krushevë.



Një numër emrash të tjerë, përveç ndërrimit të /k/-së fundore në /q/ > [ç], marrin edhe prapashtesën -e ose nuk e qiellzorëzojnë /k/-në dhe marrin mbaresën -a, mjaft të përhapur te të folmet e veriut, si p.sh:

bark ~ barqe: Te forma e shumësit *bark* po kështu ka vepruar qiellzorëzimi. Prandaj është përfutur forma *barqe*, *barçe* (në Kosovë, Preshevë, Bujanovc, Peshter e Maqedoni), ndërsa sipas të dhënave që kemi, vetëm në Derven është ruajtur /k/-ja fundore e paqiellzorëzuar, përkatësisht formës së njëjësit i shtohet mbaresa -a: *bark* - *barka*.

bllok ~ blloqe (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *blloka* (në Kosovë e në Derven), *blloka* e *blloqe* (në Karadakun e Shkupit, në Karshiakë), *blliûok* – *blliûoqe* (në Prilep e Krushevë).

prag – prej (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *praga* (në Karadak, në Derven), *pragje* (në Prilep e Krushevë).

dyshek – dyshekë (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes njëjësi i emrit *dyshek* shqiptohet me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi me zanore fundore të gjatë, pra me kundërvënie fonologjike zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë, përkatësisht *dyshek* - *dyshe:k* (në gjithë Kosovën dhe në Karadak e Karshiakë), ose pa qiellzorëzim, duke i prapavënë njëjësit mbaresën -a: *disheka* (në Derven), por edhe me qiellzorëzim + mbaresën -e: *dysheqe* (në Prilep e Krushevë).

oxhak ~ oxhaqe (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Forma më e përhapur e shumësit të emrit *oxhak* është ajo me zanoren /a:/ të gjatë: *oxha:k*, por edhe *oxhaqe* (Prilep e Krushevë), si dhe *oxhaçe* e *oxheç* (Moravë e Epërme në Kosovë).

brisk ~ brisqe (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Edhe forma e shumësit *brisk* është e shumëllojshme: *brisç* (në Kosovë), *briska* (në Derven), *brisqe* (në Prilep e Krushevë).

Siç dihet, në gjuhën shqipe disa emra shumësin e formojnë duke qiellzorëzuar tingullin e fundit të temës /g/ në /gj/:

zog ~ zogj (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Me interes për morfonologjinë dialektore është edhe shtrirja teritoriale e larmishme e emrit *zog*. Nga të dhënat që kemi arritur të sigurojmë për të folmet e veriut, kemi hetuar se në to gjallojnë katër forma shumësi: 1. *zogj* (ose në variantet fonetike *zoq*, *zoxh*), 2. *zøj*, 3. *zoxhi* dhe 4. *zoga*. Forma më e përhapur në gjithë Kosovën e deri në veri të Shkupit është *zoxh*, por në Moravë të Epërme, në të folmen e Drinit të Bardhë (Kosovë) dhe në Pollog (zonë ndërmjet Tetovës e Gostivarit) mbizotëron forma *zøj*. Në Karshiakë të Shkupit thonë *ni zogj* – *shumë zogj* por edhe *zoga*, *zûog* – *zûoq* (Prilep e Krushevë), *zøj* (Pollog, Moravë e Epërme, Drini i Bardhë), *zoq* e *zøj* (Peshter), *zoxhi* (Tetovë).

pllug ~ pllugje (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *plluga*, *pllugje* por edhe *ni pllugj* - *sha:m pllugja* (Tetovë dhe në f. Brest të Karadakut të Shkupit, për shkak të qiellzorëzimit të [g] > [gj]), *plluxh* (Kaçanik, Moravë e Poshtme).

breg ~ brigje (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): *bregje*, *brega*; *ni bregj* – *sha:m bregja* (Tetovë, Karadak), *brexhe* (Pollog, Moravë e Epërme), *brega* dhe *brexhe*, rrallë *brixhe* (Derven).

shteg ~ shtigje: *shtega* dhe *shteqe* (Karadak), *shtexhe* (Pollog), *shtixhe* (Kosovë), *shteqe* dhe *shtiçe* (Peshter).

varg ~ vargje: *varga* dhe *vargje* (Karadak), *varxhe* (Pollog), *varxhi*, *verxhi* (Kosovë), *vargja* (Tetovë).

Derisa në shumë të folme shqipe qiellzorëzohet edhe /-ll/-ja fundore e formës së njëjës në /-j/ te disa emra mashkullorë në shumës, në të folmet e veriut ka edhe fjalë të tipit të tillë me /ll/ të paqiellzorëzuar edhe në shumës, si p.sh.:

kungull ~ kunguj (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): forma më e përhapur në Kosovë është kuñëll - *kuñi*, kungëll - *kungi* në Pollog, në Derven e në Karshiakë; ndërsa *kunglla* në Karadakun e Shkupit.

yll ~ yje: *yje* në Kosovë e në Pollog, *ill* - *illzi*, *illa* në Karadakun e Shkupit, *yllzi* në Kaçanik.

mashkull ~ meshkuj (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Me interes për morfonologjinë e gegërishtes është edhe shtrirja territoriale e larmishme e formës së shumësit të emrit mashkull: *mashkëll* – *mashkllí* (Prilep e Krushevë), *mashki* (në Derven, në Karshiakë). Nuk është qiellzorëzuar /ll/-ja as te shumësi i emrit *kalli*: *ka:ll* - *kallí*, *kallëi*, *kallaî* dhe *kallzi* (në Karadak e në Kaçanik), *kajzi* (në shumë të folme të Kosovës).

hamall ~ hamaj: Shumësi i emrit *hamall* bën me mbaresën -a: *hamalla* (në Kosovë, Karadak, Derven). Ndërrimi /ll/ ~ /j/ është ndër më prodhuesit nga ndërrimet e bashkëtingëlloreve. Atë e ndeshim në një shumicë emrash mashkullorë që dalin me fundoret -ull, -all, -ill, -ell, -yell, -uall, -iell, -yll, -ëll dhe -oll: *akull* ~ *akuj*, *mangall* ~ *mangaj*, *kërmill* ~ *kërmij*, *kërçell* ~ *kërcej*, *fëndyell* ~ *fëndyej*, *buall* ~ *buaj*, *truall* ~ *troje* etj. (Memushaj, 1989 : 119-122).

kalë ~ kuaj (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Përgjithësisht në gegërishten veriore emri *kalë* përdoret vetëm në trajtë të shquar *kali*. Shumësin e bën në disa forma: *kali* - *kual* (Kosovë), *kval*, por edhe *kol* (në Karshiakë), *ka:l* - *kol* (në Derven, Tetovë), *kval* (Pollog).

lepur ~ lepuj (në të folmet toske dhe në shqipen standarde): Marrë në përgjithësi, nuk qiellzorëzohet as /r/-ja fundore te shumësi i emrit *lepur*, por ose ruhet /i/-ja e moçme fundore ose merr mbaresën -a të shumësit. P.sh.: *lepër* - *leprí* por edhe *lepra* e *leprëi*, *lepraî* (në Karadak të Shkupit), *ljepër* - *ljeprí* (Prilep e Krushevë), *leprí* (Pollog), *lepura* (Peshter).

Si përfundim mund të thuhet se:

1. Format e fjalëve me ndërrime morfonologjike të të folmeve toske përgjithësisht janë marrë edhe si forma normative të shqipes standarde. Të folmet e gegërishtes ruajnë disa forma të vjetra të ndërmjetme të paqiellzorëzuara të shumësit të emrave. Bie fjala, mund të nxirret një përgjithësim se emrat *peshk*, *kungull*, *lepur*, *mashkull*, *ka* etj. në shumë të folme geqe ende e ruajnë mbaresën e vjetër -í: *peshkí*, *kungí*, *leprí*, *mashkí*, *kie*. Kjo vërteton bindshëm pohimin se bashkëtingëlloret /q/ e /gj/ janë përftuar nëpërmjet qiellzorëzimit të prapagjuhoreve /k-/ dhe /g-/ nën ndikimin e zanores së përparme të mbyllur /-i/. P.sh. nga forma bazë *peshk* është kaluar te forma *peshq* nëpërmjet një faze të ndërmjetme *peshkí*, pra: *peshk* - *peshkí* > *peshq* (Çabej, 1976 : 218). Shtrirja gjeografike e formave morfologjike të fjalëve janë të dobishme jo vetëm për gjeografinë gjuhësore të shqipes, por edhe për historinë e gjuhës.

2. Forma e shumësit pa qiellzorëzimin e /g/-së në /gj/, por vetëm me mbaresën -a: *zoga*, *plluga*, *shtega*, *brega*, *varga*, *barka*, *praga*, *blloka*, *briska*, *peshka* ende gjallon në disa të folme të Veriut, krahas shumësit me qiellzorëzimin e bashkëtingëllores prapagjuhore /g/ (*zogj*, *shtigje*, *brigje*, *vargje*, *barqe*, *pregj*, *blloqe*, *brisqe*, *peshq*).

3. Në të njëjtën të folme gjallojnë një, dy ose më shumë forma shumësi: *breg* ~ *brega*, *bregje*, *brigje*; *bark* ~ *barka*, *barqe*; *bllok* ~ *blloka*, *blloqe*; *prag* ~ *praga*, *pragje*.

4. Në disa të folme të gegërishtes shumësi bëhet me metaforë, ndonjëherë duke i shtuar edhe mbaresën **-ni**, si *dash ~ desh, vllah ~ vllah; kunat ~ kunet*, por edhe *kunet-ni, muzat ~ muzet* dhe *muzet-ni*.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Çështë morfonologjia?
2. Çjanë dukuritë morfonologjike?
3. Kur dhe si janë zhvilluar ndërrimet morfonologjike në shqipen?
4. Cilat ndërrime fonemash në eptimin e fjalëve janë më të shpeshta në shqipen?
5. Çfarë kupton me termet qiellzorëzim, metaforë e apofoni?
6. Ndërrimet fonemore kanë prekur fillimin, mesin apo fundin e fjalës? Pse?
7. Si bën shumësi i këtyre emrave në të folmen tënde: ka, mik, armik, plak, ujk, krushk, peshk, bark, bllok, prag, dyshek, oxhak, furrik, dushk, qark, brisk, zog, pllug, breg, shteg, varg, muskul, popull, kungull, gumbull, yll, buall, mashkull, hamall, portokall, lepur, bir, flamur; dash, natë, djalë, asht, shtrat, kunat, mëzat.

5.2. EMRI

Siç dihet, në të folmet e shqipes, si dhe në gjuhën letrare, emrat kanë gjini, numër, rasë dhe trajtën e shquar e të pashquar. Në të gjitha këto kategori gramatikore ka një mal ngjashmëri, por gjithsesi hetohen edhe dallime ndër-dialektore.

a) **Gjinia**. Ndryshimet midis të folmeve të shqipes që shihen për kategorinë e gjinisë tek emrat janë shumë të pakta. Dallime vërehen në gjininë asnjansë tek emrat e parmë, që tregojnë lëndë ose pjesë të trupit. Për t'u vënë në dukje është se në të dy dialektet gjinia asnjansë po shkon drejt zhdukjes, me dallim se në të folmet e toskërishtes ruhet disi më mirë, ndërsa në të folmet e gegërishtes kanë ngelur vetëm disa gjurmë të kësaj gjinie. Kështu, në Jug të gjinisë asnjansë përdoren emrat *vajt(ë), ujt(ë), misht(ë), dhjamt(ë), gjalpët, dylltë, lesht(ë), brumët, ballët, mjaltët*; ndërsa në Veri kanë kaluar në gjininë mashkullore, si *voji, mishi, dhjami, dylli, leshi, brumi, balli, mjalti* (diku në gjininë femërore *mjalta*).


Gjurmë të gjinisë asnjane në gegërishte ende ruhen në trajtën e pashquar të emrave *kryet, ujt, dhallt,*; por kur shquhen dy emrat e fundit kalojnë në gjini mashkullore (ujt-i ose uj-i, dhallt-i ose dhall-i, llall-i), ndërsa i pari në disa të folme në gjini femërore (kre-j-a). Në të folmet gege ka disa emra mbiemërorë që përdoren vetëm në gjininë asnjane, si i ra *t'fikt*, m'shkoj *t'rit*, *t'bardht* e voes, blema do *t'bardh*, ngjite do *t'kuq*.

Emrat asnjane të ardhur prej foljeve (emrat prejfoljorë, prejpjesorë: të tipit të *lexuarit* nga folja *lexoj*) dhe emrat që vijnë prej emërzimit të mbiemrave (emrat prejmbiemërorë: të tipit

të zitë nga mbiemri *i zi*) janë krijime të reja në gjuhën standarde. Emrat prejpjesorë të shqipes standarde: *të ecurit, të kënduarit, të mësuarit* etj. që janë të gjinisë asnjane, në të folmet e gegërishtes janë të gjinisë femërore në formën *e hecmja, e knumja, e msumja* etj.

Disa emra me prejardhje turke, si *baba, pasha, dai* ose sllave *xhaxha* në dialektin verior janë të gjinisë femërore: *ba:b - baba, pa:sh - pasha, dai - daia* ose *axh - axha*; kurse në dialektin jugor janë të gjinisë mashkullore: *babai, pashai, daiu, xhaxhai*.

b) **Trajta e shquar e emrave.** Të folmet e toskërishtes dhe disa të folme të gegërishtes jugore për trajtën e shquar të emrave mashkulorë kanë mbaresat **-i** ose **-u**. Të folmet veriore të gegërishtes dhe disa të folme të gegërishtes jugore të gjithë emrat mashkulorë (duke përfshirë edhe ata që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret **-k, -g, -h** dhe zanore të theksuar), shquarësinë e bëjnë me mbarsën **-i**: *miki, plaki, zogi, bregi, krahi, ahi, plehi, ka-v-i, dhe-v-i, shi-v-i, vlla-v-i, pe-n-i, bri-n-i, mulli-n-i, dru-n-i* etj.



Shpjegim: Në shembujt e dhënë (si *ka-v-i*) v-ja është epentetike, antihijatizuese. N-ja para mbarsës **-i** (*pe-n-i*) dikur ka qenë pjesë përbërëse e trajtës së pashquar të emrave (*pen*).

Për sa i përket trajtës së emrave, interes nga pikëpamja dialektore paraqet edhe trajta e shquar e emrave mashkulorë numri njëjës që në të pashquarën mbarojnë me togzanor **ua** në Jug dhe **ue** ose **u:** në Veri. Të gjitha të folmet e Jugut dhe ato të Shqipërisë së Mesme e formojnë trajtën e shquar të këtyre emrave duke nxjerrë përsëri zanoren **o** në vend të diftongut dhe duke

marrë mbaresën shquese **-i**: ftua/ftue/ftu: - *ftoi*; thua/thue/thu: - *thoi*; krua/kruë/kru: - *kroi* etj. Të folmet e tjera të gegërishtes, shtojnë edhe **n**-në e temës së vjetër: ftue/ftu: - *fto-n-i*, thue/thu: - *tho-n-i*, kruë/kru: - *kro-n-i*.

c) **Numri**. Për formimin e shumësit të emrave dallime shihen pothuajse vetëm tek emrat mashkullorë. Megjithë laryshinë e të folmeve shqipe, mund të nxirret një konstatim i përgjithshëm se në të folmet Jugore, si edhe në gjuhën letrare, shumësi i emrave bëhet me prapashtesa trajtëformuese të shumta, si me **-a, -e, -ë, -nj, -ënj -enj, -inj, -ër, -ra**; ndërsa në ato Veriore shumësi bëhet me më pak prapashtesa, zakonisht me **-a, -n-a, -j**. Po sjellim disa çifte fjalësh të gjinisë mashkullore në numrin shumës në formën përfaqësuese toske e geqe që të shihet kjo: *hunj - hûj, drunj - drûj, barinj - barij, ftonj - ftoj, thonj - thoj; gjarprinj, gjarpënj - gjarpna, gjarpnoj; drapinj, drapënj - drapna, drapnoj; gishtrinj - gishta, priftrinj - prifta; oficerë - oficera, doktorë - doktora, (disa) mësuës - msusa; hajdutër - hajduta, nipër - nipa* etj.

Në dialektin verior disa emra shumësin e bëjnë me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve fundore. Kështu, emrat në njëjës shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa në shumës me zanore të gjatë: *vesh ~ ve:sh, dham ~ dha:m, lejlek – lejle:k, fyshek ~ fyshe:k, dyshek ~ dyshe:k, oxhak ~ oxha:k, baxhanak ~ baxhana:k, dollap ~ dolla:p* etj.

Shpjegim: Historikisht kjo shpjegohet me faktin se emrat e këtillë formën e shumësit e kanë bërë me prapashtesën **-ë**, por me rënien e zanores [ë] në pozitë fundore absolute, proces që ka filluar qysh para 2-3 shekujsh në mbarë gegërishten, është shkaktuar zgjatja kompensatore e zanores në pozitë para saj, si (njëjës) *dyshek – (shumës) dyshekë > dyshek^ë > dyshe:k*.

ç) **Rasat**. Të gjitha të folmet e shqipes kanë nga pesë rasa, si edhe gjuha standarde; me dallim se Toskëria Veriore dhe Shqipëria e Mesme, kanë edhe një formë më tepër: **rasën vendore** (lokativin).

Rasa vendore përbëhet nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa *t(ë)*, që paraprihen nga parafjalët *në, mbi, nën, nëpër, me* ose *për: në gropët, në fikt, në malt, në misrit, mbi gurt, nëpër misrit, nëpër lumt, me lugët, me thikët, për bukët* etj.

Edhe në format rasore të emrave hetohen disa dallime ndërdialektore. Shumica nga to lidhen me përbërjen fonematike të të njëjtës formë. I tillë është dallimi që vërehet për **kallëzoren** e emrave mashkullorë të shquar në numrin njëjës. Kështu, tek emrat që në të pashquarën mbarojnë me **-ua** në toskërishte dhe **-ue** (apo **-u:**) në gegërishte; në të folmet e Jugut rasa kallëzore e shquar formohet duke u ngjitur pas temës së emrit mbaresa **-n(ë)**: *ftua-n, thua-n, krua-n, ulli-n(ë), mulli-n(ë), kushuri-n(ë), hu-n(ë), sy-n(ë)* etj.

Në të folmet e Veriut temës së vjetër të këtyre emrave (me **n:** fton) i shtohet zanorja **i** (si tingull i ndërfutur midis dy bashkëtingëlloresh për të lehtësuar shqiptimin, e quajtur zanore anapitike) dhe mbaresa **-n**: *fton-i-n, thon-i-n, kron-i-n, ullin-i-n, mullin-in, kusherin-i-n, hun-i-n, syn-i-n* etj.

Me praninë ose mungesën e **i**-së ose **u**-së lidhet edhe dallimi tjetër midis të folmeve të shqipes për formën e kallëzores së emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore. Në të gjitha të folmet veriore dhe pak në ato jugore (si në ato të Beratit, Myzeqesë dhe të Mallakastrës) kjo formë ndërtohet me temën e emrit (mal), zanoren **i** ose **u** dhe mbaresën **-n**, si: *mal-i-n, det-in,*

plak-i-n ose *plak-u-n*, *zog-i-n* ose *zog-u-n* etj. Në të folmet jugore pas temës së emrit ngjitet drejtpërdrejt po e njëjta mbaresë -n(ë): *mal-në*, *det-në*, *plak-në*, *zog-në* etj.

Edhe në trajtën e pashquar të emrave në numrin shumës në **rasën rrjedhore** hetohet dallim morfologjik ndërmjet dy dialekteve të shqipes: deri sa në të folmet e toskërishtes forma e rrjedhore shumës me **-sh** përdoret shumë rrallë (por është njësuar me formën e shquar, me mbaresën -ve), në të folmet e gegërishtes kjo ka përdorim të dendur, si: ka pi: u:j *bretkocash*, kena pas lujt *arash*, koçak *pulash*, o:d *burrash* etj.

Rrjedhorma ka përdorim më të dendur në dialektin Verior, ndërsa në dialektin Jugor funksionin e rrjedhore shpeshherë e luan emërorja me parafjalën *nga*, si p.sh. *une jam prej Shkupi - unë jam nga Korça*.

Siç u tha edhe në dallimet ndërmjet dialekteve në trajtën e emrit, meqenëse në shumicën e të folmeve të gegërishtes emrat e gjinisë mashkullore trajtën e shquar e bëjnë me -i, të gjinisë femërore me -a ose -(j)a dhe nuk kanë emra të gjinisë asnjësore, del se të folmet geqe kanë vetëm dy **lakime**: në lakimin e parë hyjnë të gjithë emrat mashkullorë, ndërsa në lakimin e dytë emrat femërorë, duke përfshirë edhe disa emra mashkullorë që shquhen me -a (mixha, daja, hoxha, Hamzija, Ganija, Barija etj.).


5.3. MBIEMRI


Për mbiemrat shihen shumë pak dallime dialektore në gjuhën tonë. I vetmi ndryshim vërehet në mbiemrat cilësorë të ardhur nga pjesorja e foljes (që mbarojnë me -r(ë), të quajtur **mbiemra prejpjesorë**. Në të folmet e Jugut veç nyjeve të përparme (*i* për gj. mashk. dhe *e* për gj. fem.) nuk kanë ndonjë tregues tjetër për dallimin e gjinisë: *i lar(ë) - e lar(ë)*, *i zier - e zier*, *i lyer - e lyer*, *i bler(ë) - e bler(ë)*; ndërsa në të folmet e Veriut mbiemrat e gjinisë femërore dallohen nga mashkullorët jo vetëm nga nyja e përparme (*i* për gjininë mashkullore dhe *e* për femëroren), por edhe nga mbaresa -e, si *i la:m - e lame*, *i zi:m - e zime*, *i ly:m - e lyme*, *i ble:m - e bleme* etj.

5.4. PËREMRI

Në format e përemrave ka shumë pak dallime midis dialekteve të shqipes dhe gjuhës standarde. Shumica e këtyre dallimeve janë të natyrës fonetike, d.m.th. format përemërore të larmishme janë variante territoriale të të njëjtit përemër. Ndër dallimet më të rëndësishme janë:

Të folmet e gegërishtes kanë **përemra vetvetorë**, që tregojnë vetën që kryen veprimin dhe ky veprim bie mbi të. Të tillë janë *vetja*,





vetvetja; të cilët lakohen nëpër rase (vetja, vetes, veten; vetvetja, vetvetes, vetveten). Gjithashtu, gegërishtja ka edhe **përmra pronorë vetvetorë**: *i vet, e vet, t'vet*, si p.sh. *djali i vet, çika e vet, fmit e vet, fmise t'vet* etj., të cilët nuk i ka toskërishtja, por në vend të tyre përdor përmra pronorë: *i tij, e tij; i saj, e saj, të tij, të saj* etj. Përmrat vetvetorë dhe përmrat pronorë vetvetorë, që i ka gegërishtja, ndërsa mungojnë në toskërishte, kanë hyrë në sistemin përmëror të gjuhës standarde shqipe.

Në **përmrat vetorë** nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm, sepse në të shumtën e rasteve dallimet janë të natyrës fonetike. Kështu, në dialektin Verior dhe në atë Jugor kemi këto forma të përmrave vetorë në rasën emërore: *ũne, ũ:n* ose *ũ: - unë* (forma e vjetër *u:* përdoret ende në të folmet e gegërishtes dhe në Çamërishte); *ti, tã - ti, tinë; aj - ai, ay, aynë; ajo - ajo; na - ne, neve; ju - ju, juve; ata - ata, ato - ato*.

Shpjegim: Në të folmet e gegërishtes qendrore dukuria e diftongimit të zanoreve të mbyllura të theksuara /i, y, u/ ka vepruar edhe te përmri *ti*, prandaj kemi variantet e diftonguara të të njëjtit përmër në [*tã, tẽ,*

tẽi]. Në disa të folme të këtij grupi, përmrat vetorë *ata* dhe *ato* nuk dallojnë gjini, prandaj kemi *ata burra - ata gra* ose *ato burra - ato gra*.

Forma *aj* e gegërishtes 'ai' është krijuar nga konsonantizimi i [i]-së në [j]. Përmrat *neve, juve* që përdoren për rasat e drejta (emëroren dhe kallëzoren; për ne, ju) në disa të folme toske, janë forma analogjike të rasave të zhdrejta (të gjinore, dhanore dhe rrjedhores).

Ndryshime të vogla vërehen edhe për trajtat e **përmrave dëftorë**. Shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej variantit standard, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më gjerë) për faktin se përmrat dëftorë shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *qeky/çeky, qekjo/çekjo, qekta/çekta, qaj/çaj, qajo/çajo, qata/çata, qeto/çeto* etj. sesa në formën me shtritje në të dy dialektet *ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato*.

Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) 'ja' dhe një përmër dëftor *ky: çe+ky, çe+kjo* 'ja+ky, ja kjo'... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem. - Çeky është gjali jem. 'Ky është djali im. - Ja, ky*

është djali im'. *Ajo a:r është ma e mira. – Çajo a:r është ma e mira. 'Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.'*

Të folmet e gegërishtes dallohen për një numër **përemrash të pacaktuar**, që mungojnë në të folmet e toskërishtes. Të tillë janë përemrat e përngjitur *kurkush, gjithkush, dikush, askush, tjetërkush, kurrnjã* etj.

5.5. FOLJA

Folja është pjesa e ligjëratës më e pasura me trajta gramatikore, rrjedhimisht edhe me hijezime kuptimore të tyre. Folja është bërthama e fjalisë.

Folja në gjuhën shqipe karakterizohet me trajta të ndryshme gramatikore. Është e njohur se folje janë fjalët që tregojnë një veprim ose një gjendje. Kësaj detyre kryesore i shtohen edhe një mori funksionesh të tjera të rëndësishme, d.m.th. bashkë me veprimin ose gjendjen që shpreh folja përcaktohet edhe mënyra, koha, veta, numri e diateza. Gërshetimi i këtyre kategorive gramatikore, të cilat shpesh lidhen edhe me ndërrime leksikore, e bën foljen si pjesën më komplekse të ligjërit.

Sistemi i foljes në gjuhën shqipe ka ruajtur shumë veçori arkaike indoevropiane të trashëguara nga periudha e hershme. Të tilla janë si për shembull, supletivizmi, apofonia, aoristi sigmatik, kategoritë gramatike të vetës, mënyrës, kohës etj. Megjithatë, me kalimin e kohës janë krijuar edhe ngjashmëri të përbashkëta me gjuhët e tjera ballkanike, por janë zhvilluar edhe dukuri të veçanta, siç janë habitörja dhe dëshirorja.

Në sistemin morfologjik dallime më të shprehura midis të folmeve janë ato që vërehen te foljet. Por, ato nuk janë të një karakteri të thellë strukturor: ka disa që lidhen me variante fonetike të ndajshitesave, të tjerat me dendurinë e përdorimit, diku janë rindërtuar forma foljore me anë të analogjisë, ndonjë me praninë apo mungesën e formave të dyta të mbipërbëra etj.

Me fjalë të tjera, edhe në fushën e sistemit foljor hetohen dallime të caktuara në shtrirjen territoriale të gjuhës shqipe. Dallimi ka të bëjë me format e ndryshme fonetike për të njëjtat mënyra etj., me praninë ~ mungesën e një forme foljore dhe zëvendësimit të saj me formë tjetër; si edhe me dendurinë dhe përndarjen (frekuencën dhe distribuimin) e tyre.

Në gjuhën standarde janë kodifikuar trajtat e foljeve, por në përdorimin e përditshëm ruhet ende një laramani e madhe e trajtave dialektore. Të tilla janë paskajorja e gegërishtes (me + pjesorja: me punue), e barasvlershme në toskërishte paskajorja *për të punuar* ose lidhorja të *punoj*; e pakryera asigmatike e mënyrës dëftore në diatezën veprorë në toskërishte *punoja* dhe sigmatike në gegërishte *punojsha*, forma sintetike joveprorë e toskërishtes *lahesha* dhe *u lajsha / u lajshna* në të folmet gege; ekzistimi i trajtave të dyta të mbipërbëra për kohën e shkuar në dialektin Verior (*kam pas punu.*; *kisha pas punu*, *pata pas punu.*), si dhe shumë forma të tjera foljore. Në vijim do të shpjegojmë pak më hollësisht këto dallime midis dy dialekteve që shfaqen te foljet:

1. Në toskërishte e pakryera e mënyrës dëftore në formën veprorë është asigmatike (punoja, punonja), ndërsa në gegërishte është sigmatike (punojsha, punojshna)

Nëpër të folmet e shqipes gjejmë një larmi të madhe formash foljore të së **pakryerës së dëftores**. Dallohen dy areale kryesore:

- areali i gjithë toskërishtes, i të folmeve kalimtare dhe i një numri shumë të vogël të folmesh të gegërishtes ku ruhet forma e vjetër **asigmatike** (josigmatike, pa –sh- në mbaresë). Mbaretat e së pakryerës në **diatezën veprorë** janë: (unë) *la-nja* ose *la-ja*, (ti) *la-nje* ose *la-je*, (ai, ajo) *la-nte*; (ne) *la-nim*, (ju) *la-nit*, (ata, ato) *la-nin*, dhe
- areali i gegërishtes ka forma sigmatike (me –sh-) në mbaresa, si për foljet që mbarojnë me temë në zanore: (une) *la-jsha* ose *la-jshna*, (ti) *la-jshe*, (aj, ajo) *la-nte* ose *la-jke*; (na) *la-jshim*, *la-jshëm* ose *la-jshmi*; (ju) *la-jshi*, (ata, ato) *la-jshin*; ashtu edhe për foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore: (une) *dal-sha* ose *dal-shna*, (ti) *dal-she*, (aj, ajo) *dil-te* ose *dal-ke*; (na) *dal-shim*, *dal-shëm* ose *dal-shmi*; (ju) *dal-shi*, (ata, ato) *dal-shin*.


2. E pakryera joveprorë e dëftores në toskërishte është sintetike (lahesha), ndërsa në gegërishte është analitike (u lajsha, u lajshna)

Edhe në formën joveprorë të së pakryerës së dëftores ndërmjet dy dialekteve të shqipes ka dallime. Kështu:

- Në toskërishte, pavarësisht nga dallimet e pjesshme që vërehen në mbaretat, foljet në këtë diatezë kanë të njëjtën strukturë si në gjuhën standarde. E pakryera e mënyrës dëftore në formën joveprorë në toskërishte është **sintetike**. Temave të foljeve të kohës së tashme të zgjedhimit jovepror u shtohen mbaretat vetore: (unë) *la-(h)esha*, (ti) *-(h)eshe*, (ai, ajo) *-(h)ej*, *-(h)esh*; (ne) *-(h)eshim*, (ju) *-(h)eshit*, (ata, ato) *-(h)eshin*. Alomorfet me *-h-* i marrin foljet me temë në zanore (si *la-h-esha*, ...).
- Në pjesën më të madhe të gegërishtes kjo formë kohore është **analitike**, e përbërë nga pjesëza përemërore **u** dhe nga forma e së pakryerës veprorë të gegërishtes, me variantet përkatëse sipas të folmes: (une) *u lajsha* ose *u lajshna*, (ti) *u lajshe*, (aj, ajo) *u lante* ose *u lajke*; (na) *u lajshim*, *u lajshëm* ose *u lajshmi*; (ju) *u lajshi*, (ata, ato) *u lajshin*.

3. Gegërishtja ka edhe dy apo tri forma të dyta të mbipërbëra për kohën e shkuar (kam pas punu:, kisha pas punu, pata pas punu:)

Në qoftë se në variantin standard dhe në toskërishte janë karakteristike vetëm tri forma të përbëra të kohës së shkuar: **e kryera** (*kam punuar*), **e kryera e plotë** (*kisha punuar*) dhe **e**



kryera e tejshkuar (*pata punuar*), në të gjitha të folmet e gegërishtes ekzistojnë edhe dy, vende-vende edhe tri, forma të tjera të përbëra (folja ndihmëse ‘kam’ + pas + pjesorja e foljes): **e kryera e dytë** (*kam pas punu:*, *ki/ke pas da:l*, *ka pas shku:*, ...), **e kryera e plotë e dytë** (*kisha/kishna pas punu:*, *kishe pas da:l*, *kish pas shku:*, ...), por edhe **e kryera e tejshkuar e dytë** (*pata pas punu:*, *pate pas da:l*, *pat pas shku:*, ...).

Në të folmet e gegërishtes për rrëfyer ndonjë veprim a ngjarje që është kryer në një të kaluar shumë të largët, përdoren edhe dy apo diku edhe tri kohë të tjera. Në fakt, nga koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejshkuar ndërtohen forma të dyta të mbipërbëra dhe me to tregohen veprime që kanë ndodhur në kohë të lashta, në kohët më të errëta të historisë së tyre fare pak të njohur, përkatësisht në kohën e panjohur e më të lashtë që mund të mbajë mend njerëzimi ose diçka që është bartur brez pas brezi në formën e folur, si në përralla, legjenda, gojëdhëna etj. Për shembull: *Ish pas kã:n ni bu:rr e ni gru: // Ata nuk kishin pas asni fmi: // Ish pas kãn ni arap i zi // Për dit e kish pas lyp me ngrãn ka ni njeri ...// Zakonisht me këto kohë të dyta të mbipërbëra të së shkuarës fillojnë përrallat, ndërsa më pas përdoren kohë të tjera foljesh që tregojnë kohë më afër të sotmes.*

Sipas strukturës që kanë, foljet e mbipërbëra janë analitike. Ndërtohen nga koha më se e kryer si dhe nga e kryera e tejshkuar me ndërftutjen e foljes **pas** ndërmjet foljes ndihmëse dhe pjesores, sipas tipit: *kishna shku:* (koha më së e kryer) - **kishna pas shku:** (më se e kryera II), gjegjësisht *pata dal* (koha e kryer e tejshkuar) - **pata pas da:l** (e kryera II e tejshkuar) etj.

Këto kohë të dyta të mbipërbëra, që tregojnë të shkuarën më të largët të mbamendjes kolektive, edhe në të folmet e Veriut kanë përdorim të kufizuar. Ndryshimet që po bëhen në shoqëri, në mënyrën e jetesës, sidomos me zhvillimit e teknikës e të teknologjisë, sjellin me vete edhe ndryshime në gjuhën e njerëzve. Te ne shqiptarët rrallëkund rrëfohen përralla, legjenda e gati më askund nuk ka oda të dikurshme kuvendesh, bile as në malësi. Njerëzit gjithnjë më pak flasin e evokojnë të kaluarën e largët. Pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalojnë para televizorit, kompjuterit apo edhe gjithë ditën e kalojnë me telefon në dorë, duke këmbyer porosi ose duke surfuar në internet. Në gjuhën e komunikimit të përditshëm fare pak gjejmë kohët e shkuara, aspak të mbipërbërat. Më nuk tregon kush e as që dëgjon kush përralla e legjenda. Rrjedhimisht edhe këto dy kohë të mbipërbëra, edhe ashtu fare pak të ruajtura në të folmet e Veriut, do të humben, treten e shuhën plotësisht.

4. Të folmet e gegërishtes kanë pjesore të reduktuar (la:), ndërsa të folmet e toskërishtes kanë pjesore të plota (larë)

Siç dihet, të folmet e gegërishtes kanë **pjesore të reduktuar** (të cunuar, të shkurtuar, pa mbaresa), ndërsa të folmet e toskërishtes kanë **pjesore të plota**, me njërin nga mbaresat -ë, -rë, -në, -ur, -uar ; khs. pjesoret (participet) toske e geqe:

<i>pjesore toske</i>	<i>pjesore geqe</i>	<i>pjesore toske</i>	<i>pjesore geqe</i>
(kam) vjelë / vjelur	vje:l	fshirë	fshī:
mbjellë / mbjellur	mbje:ll, mje:ll	blerë	ble:
marrë / marrur	ma:rr	lidhur	li:dh
thënë / thënur	thã:n	pjekur	pje:k
bërë	bã:	lexuar	lexu:
dhënë / dhënur	dhã:n	mësuar	msu:

lënë / lënur	lã:n	larë	la:
--------------	------	------	-----

5. **Të folmet e gegërishtes kanë paskajoren gege (me punue), ndërsa të folmet toske nuk e kanë këtë formë, por në vend të saj përdorin lidhoren (të punoj) ose formën (për të punuar)**

Tipi i **paskajores** së gjuhës letrare i përbërë nga pjesëza parafjalore **për** dhe emri foljor asnjans i pashquar (**për të punuar**) ekziston në gjithë toskërishten (në të folmet kalimtare, të Shqipërisë së Mesme; paralelisht me paskajoren gege edhe në të folmet qendore); ndërsa në të folmet e gegërishtes është tipike paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore **me** dhe nga pjesorja e foljes (**me punue**). Kjo paskajore e quajtur gege kryen shumë funksione të lidhores dhe të paskajores toske. P.sh. *shkova me punue – shkova për të punuar – shkova të punoj; kam me dal, du me dal – kam për të dalur – do të dal*.

6. **Koha e ardhme në pjesën më të madhe të të folmeve gege shprehet me të ardhmen e domosdoshme, ndërsa në të folmet toske me të ardhmen e dëshiruar**

Në mbarë shqipen (dialektore e standarde) koha e ardhme shprehet me dy forma të përbëra:

a) të folmet gege këtë kohë e formojnë nga folja ndihmëse **kam** + **paskajorja**, apo kam + me + pjesore: *kam me shku.; kam me punu.; kam me dal, ...*

b) tjetra formë (kushtimisht e thënë toske) ndërtohet me pjesëzën **do** (e desemantizuar nga folja due, du, dua) + **folja** themelore në mënyrën lidhore, sipas tipit: *do të shkoj, do të punoj, do të dal, ...*

Në fakt, njëra është karakteristike dhe mbizotëruese në të folmet e gegërishtes (kam me msu:), ndërsa tjetra në të folmet e toskërishtes (do të mësoj). Megjithatë, siç dihet, në të folmet e gegërishtes qendrore kemi përdorimin e dyfishtë të të dy formave (*kam me ardh* dhe *do t'vâi*), me shtrirje më të gjerë të formës së dytë (fatur volitiv).

Në studimet albanologjike përgjithësisht është pranuar se këto dy forma të veçanta foljore të së ardhmes dallojnë jo vetëm në pikëpamje strukturore, por edhe në pikëpamje kuptimore, ose së paku tregojnë nuanca me vlerë kuptimore (semantike).

Në fakt, forma gege e kohës së ardhme *kam me a:rdh*, e quajtur në shqip **e ardhme e domosdoshme** a **e detyrimit** (futurum necessitatis), është konstatuar se tregon veprime që duhen patjetër të kryhen, që janë të domosdoshme, të detyrueshme për t'u bërë, apo parashikimet e premtimet për t'u realizuar diçka thuhet me një siguri shumë të lartë, premtimet janë bindëse, folësi zotohet për atë që e thotë se do ta bëjë.

Ndërkaq, me formën tjetër toske e standarde *do të vi*, e emërtuar në shqip **e ardhme e dëshiruar** (fatur volitiv), shprehet një siguri më e ulët për atë që pritet të realizohet, një mëdyshje për atë që do të kryhet, diçka që është mirë të bëhet, por nuk është e domosdoshme. Me fjalë të tjera, me futur necessitatis tregohet një veprim që me të vërtetë do të kryhet, ndërsa me futur volitiv shprehet një veprim që duam të kryhet.

Kjo kundërvënie (dyshe) binare: e vërtetë, e sigurt ~ e mundshme, e pritshme apo e domosdoshme, e patjetërsueshme ~ e dëshirueshme, e parapëlqyeshme shihet edhe në përbërjen (strukturën) e tyre: forma foljore gege (kam me a:rdh) ndërtohet me mënyrën dëftore

(indikativin), ndërsa forma toske (do të vi) me mënyrën lidhore (konjunktivin). Të rikujtojmë se me mënyrën dëftore shënjohej një e vërtetë, diçka reale; ndërsa me mënyrën lidhore – e dëshirueshmja, e pritshmja.

7. Përcjellorja në gegërishte formohet me pjesëzën tu (tue, tuj) dhe pjesoren, ndërsa në toskërishte me duke + pjesoren e foljes

Përcjellorja (gerundivi) është formë e pashtjelluar analitike që përbëhet nga *pjesorja* dhe pjesëza *tu* ose në variantet *tue*, *tuj*, sipas tipit: *tu he:c*, *tu fol*, *tu shkru:*, ... në të folmet e Veriut dhe *duke*, sipas tipit: *duke ecur*, *duke folur*, *duke shkruar*, ... në të folmet e Jugut. Në të dy dialektet përcjellorja ka funksion të njëjtë: me të tregohen veprime që zgjasin dhe që janë duke u bërë edhe në momentin kur flasim: *jam tu punu:* = *jam duke punuar*. Edhe forma geqe (tu msu:) edhe forma toske (duke mësuar) shprehin po të njëjtin kuptim që shprehet nga forma analitike e mënyrës dëftore me pjesëzën po: *po punoj*.

Përkundër këtyre dallimeve të krijuara në rrjedhë të kohës, të folmet, rrjedhimisht edhe dialektet, në pikëpamje strukturore në sistemin foljor kanë bazë të gjerë të përbashkët.



Të folmet popullore kanë veçori të përbashkëta si dhe dallime të caktuara edhe te pjesët pandryshueshme të ligjëratës. Në përgjithësi, ato kanë funksion të njëjtë në mbarë shqipen dialektore e standarde, por, nënkuptohet se disa prej tyre dallohen në përbërjen tingullore nga forma që kanë në njërin dialekt nga forma që kanë në dialektin tjetër. Ndonjë prej tyre e gjejmë në njërin dialekt dhe nuk e dëgjojmë në dialektin tjetër. P.sh. në rafshin ndër-dialektor te ndajfoljet dhe parafjalët ka disa laramani, por shumica e dallimeve dalin për arsye se në të folme të ndryshme përdoren variante të ndryshme të të njëjtës fjalë. Khs. format toske e geqe të ndajfoljeve: *këtej*, *këndeje* - *knej/knena*, *pastaj* - *masandej/masanej*, *tashti/tani* - *tash/shti*, *pas/prapa* - *mbas*, *mas*; e të parafjalëve: *nga* - *ka/kah*, *prej* - *pej/pi*, *tek/ke* - *te etj*.

Pyetje, ushtrime e detyra:

Për të hetuar tiparet themelore morfologjike të të folmes suaj, do të japim një pyetësor të shkurtër me disa pyetje të zgjedhura. Ju mund të parashtroni edhe pyetje të tjera dhe të përgjigjeni, varësisht nga veçoritë dalluese të të folmes dhe interesimi juaj për të:

1. A ka e folmja jote emra të gjinisë asnjane?
2. Në çfarë gjinie përdoren emrat *baba*, *pasha*, *xhaxha* (*axha*)?
3. Me ç'mbaresë e bëjnë trajtën e shquar emrat *plak*, *mik*, *shok*, *zog*, *breg*, *krah*, *pleh*, *ah*, *ka*, *dhe*, *shi*, *vëlla*, *pe*, *bri*, *mulli*, *dru*; *ftua/ftue*, *krua/kruë*, *thua/thue* në të folmen tënde?
4. Si e bëjnë shumësin në atë të folme emrat: *hu*, *dru*, *bari*, *ftua/ftue*, *krua/kruë*, *drapër/drapën*, *gisht*, *prift*, *oficer*, *doktor*, *mësues*, *hajdut*, *nip*; *dhëmb/dha:m*, *lejlek*, *dyshek*, *oxhak*, *dollap*, *baxhanak*?
5. A e ka e folmja jote rasën vendore?
6. Cili tip i mbiemrave prej pjesorë përdoret: *i larë* - *e larë* apo *i la:m* - *e lame*?
7. Çfarë trajtash kanë përemrat vetorë në atë të folme. A ka ajo përemra vetvetorë?

8. Përemrat dëftorë përdoren të ju pa pjesëz treguese (ky, kjo, ai, ajo etj.) ose me pjesëzën treguese *qe* a *çe* + një përemër dëftor (çeky, çekjo, çaj, çajo etj.)?
9. Format e foljeve në kohën e pakryer të dëftores në diatezën veprorë janë asigmatike (punoja, punonja) apo sigmatike (punojsha, punojshna)?
10. Në diatezën pësore të kohës së pakryer foljet janë sintetike (lahesha) apo analitike (u lajsha/u lajshna)?
11. A përdoren në të folmen tënde forma të mbipërbëra të kohës së shkuar. Nëse ka të tilla, cilat janë ato dhe si ndërtohen?
12. Në atë të folme pjesoret janë të plota (kam larë, parë, lexuar, shkruar etj.) apo të reduktuara (kam la:, pa:, lexu:, shkru: etj.)?
13. Çfarë forme ka paskajorja në të folmen tënde? Krahas paskajores gege (me punue) a përdoret edhe lidhorja (të punoj)? Cili është përpjesëtimi i tyre: cila formë përdoret më shpesh e cila më rrallë?
14. Cilat janë veçoritë e tjera qenësore morfologjike të të folmes suaj?

KREU VI

6. NGJASHMËRITË DHE DALLIMET LEKSIKORE E FRAZELOGJIKE

6.1. NGJASHMËRITË DHE DALLIMET LEKSIKORE


Siç dihet, shqipja ka mbi 2.500 fjalë të trashëguara nga fondi i lashtë indoevropian. Të kësaj lëndeje të lashtë indoevropiane janë ato elemente, të cilat kanë analogji në gjuhët e tjera i.e. P.sh.: *numërorët prej 11-19* me sistem mbledhjeje, emrat *ujk, natë, dimër, dhëndër, bir, bijë, vjehërr, motër, ballë, gjë, gju, i gjatë, i madh, i lig*; përemrat *ti, mua, imi, ky, kjo*; foljet *bie, jam, rri, shoh, bredh, hedh, mbjell, djeg, mbledh, sjell, mjel, dal, marr, bëj, bind, hap, ha, pi, zë, lë, vë* etj.

Leksiku i gjuhës standarde shqipe përmban si elemente nga më të lashtat e shqipes, ashtu edhe elemente nga më të rejat, si fjalë të mbarë shqipes, ashtu edhe fjalë me prejardhje dialektore e me burim të huaj. Shtresën kryesore të leksikut të shqipes së sotme standarde e përbëjnë fjalët e shprehjet **që i takojnë gjithë truallit gjuhësor të shqipes**, të cilat nuk mund të cilësohen më si të këtij a si të atij dialekti. Kjo shtresë përfshin pjesën kryesore të fjalëve, të shprehjeve e të frazeologjizmave të mbarë shqipes, pa të cilën nuk do të kishim një gjuhë të përbashkët.

Të tilla janë fjalët që emërtojnë sendet që na rrethojnë, cilësitë, veprimet etj., që janë të përbashkëta për dy dialektet, si *dorë, ditë, diell, punoj, shkruaj lexoj, shoh, eci, i mirë, i kuq, vonë, larg, me, për, ngul këmbë, marr vesh, heq dorë, ...* Në këtë shtresë përfshihen edhe ato fjalë që në dialekte e në të folme të ndryshme dalin në variante fonetike të ndryshme, si *nëna (nāna, nōna), këmba (kāmba, kāma, kōma), rëra (rāna, rōna), huri (hūni), druri (drūni), ulliri (ullīni), është (āsht, ōsht, ā:, ō:)* etj., sepse nga ana leksikologjike këtu kemi një fjalë me trajtat përkatëse fonetike.

Duhet theksuar se mënyrat, modelet dhe mjetet kryesore për formimin e fjalëve, nuk kanë qenë dhe nuk janë vetëm pronë e njërit dialekt, por pronë e mbarë shqipes, e të dy dialekteve. Kështu, në cilëndo të folme të Veriut apo të Jugut, rrjedhimisht edhe në shqipen standarde fjalët krijohen gjithkund njësoj. Kështu, në mbarë shqipen dialektore e standarde, pa përjashtim, mënyrat më produktive të formimit të fjalëve janë: a) fjalëformimi me parashtesim, b) me prapashtesim, c) me mënyrën e dyfishtë (të përzier): me paranyjëzim dhe prapashtesim, ç) me kompozim dhe përngjitje. Prandaj, qindra e mijëra fjalë të tilla, si *këpucar, shqiptar, malësor, pleqësi, orizore, lulishte, kufizoj, përparoj, mendjehollë, mendjelehtë, farefis, flokëgjatë, syzezë ...*, nuk mund t'i cilësojmë si të burimit dialektor.

Një shtresë tjetër të leksikut të gjuhës së sotme standarde shqipe e përbëjnë fjalët e shprehjet që janë formuar brendapërbrenda shqipes ose janë huazuar nga gjuhë të tjera. Shumë fjalë e shprehje i kapërcejnë kufijtë e dialekteve e të folmeve dhe ngrihen në normë. Kjo është shtresa që formohet nga veprimi pasurues i dialekteve mbi leksikon



e shqipes standarde. Gjuha letrare merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zymtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyrimë emocionale etj. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë - grunore - grunajë* ‘arë e mbjellë me grurë’, *tamblak* ‘qengj pirës’; *tamblatore, tamblore, tamëltore* ‘lopë që jep shumë qumësht’; *tambloriz, tamëloriz* ‘oriz me qumësht’, *lule a bar tampli; drynoj* ‘mbyll me dry’, *shpeshtinë* ‘pyll i dendur’, *shterpni* ‘të qenit shterp’ etj.

Edhe në fushën e formimit të fjalëve gjuha standarde shqipe ushqehet nga dialektet. Kështu, për formimin e disa emrave të vepruesit (si: *mësues, sulmues, ndërtues, përfaqësues, pastrues* etj.), të disa mbiemrave (si: *kërkues, studime krahasuese, shtëpi botuese* etj.), të disa fjalëve të përbëra (si: *hekurudhë, udhëkryq, mbikëqyrës, udhëpërshkruar, hekurpunues, vetëshkarkues* etj.) dhe të mbiemrave me prapashtesën *-shëm* (si: *i kuptueshëm, i lejueshëm, i pranueshëm, i arsyeshëm* etj.) ka shërbyer si temë prodhuese pjesorja e dialektit të Veriut, që mbaron me togun zanor *-ue* (*mësue, sulmue, rregullue, kuptue*), kurse vetë trajta e pjesores së foljeve dhe trajta e mbiemrave (*punuar, shkruar, mbaruar* etj. dhe *i punuar, i shkruar, i mbaruar* etj.) është ajo e dialektit të Jugut. Ja se si dy mjete me prejardhje dialektore janë ngritur në normë dhe janë bërë pronë e gjuhës letrare.


Edhe pse një pjesë e madhe e leksikut të të dy dialekteve është e përbashkët, megjithatë ka fjalë të cilat dallohen se janë pronë e njërit apo tjetrit dialekt. Shumica e tyre në shqipen standarde krijojnë çifte sinonimike fjalësh dialektore. P.sh. toskërisht - gegërisht: *fshat - katund, vajzë - çikë, qumësht - tambël; fqinj, gjithon - kojshi, komshi; nxjerr - qes, ftoj - thirr, derr - thi, kyç - çelës, litar - konop, tërkuzë; rrugë - udhë, kokë - krye, kurriz - shpinë, hap - çel, tërë - gjithë, gjalpë - tëlyen, mëmëdhe - atdhe, ngordhë - cofë, dehem - pihem, dyzet - katërdhet, tigan - fultere, fërtere; fshehurazi - tinëz, gënjeshtër - rrenë, kafshë - gjã, hajvan; mbyll - mshel, rrogos - hasër, këpucë - kundra, shportë - kosh, kopsht - bahqe, patate - kompir, misër - kallamoq, sopatë - sakicë, kotec - koçak, këndez - knus, gjel; gomar - magar; kërric, pulisht - përllak, kec - edh, bushtër - kuçkë, lingua - zagar, luleshtrydhe - dredhëz, xhaxha - mixhë, fik (zjarrin) - shkym (zjarrin), çlodhem - pushoj, dem - m(ë)zat, ajër - frymë, eja - hajde, buf - hut; tregoj, rrëfej - kallëzoj, shikoj - kqyr etj.*

Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes standarde me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyrimë fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi leksikun e gjuhës letrare është i barabartë. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

Me zhvillimin dhe përsosjen e sistemit të gjuhës standarde dialektet vërtet vijnë duke u tërhequr, por në fushën e leksikut, ky proces i tërheqjes së dialekteve bëhet kryesisht në rrugën e

integritimit të fjalëve krahinore në gjuhën standarde e letrare. Bashkëmarrëdhëniet midis shqipes standarde e letrare dhe dialekteve të saj do të vijojnë edhe në të ardhmen, por mbetet si detyrë që pasuria leksikore e dialekteve të vilet, të përpunohet e të sistemohet me kujdes nëpër fjalorë të tipave të ndryshëm.

Ndikimet e huaja shfaqen sidomos në leksik dhe në ndërtimet sintaksore, por me punë të organizuar shkencore e hulumtuese ato mund të mënjanojnë nga përdorimi. Leksiku i shqipes standarde karakterizohet edhe me prirjen për pastrimin nga fjalët e huaja. Kështu, janë nxjerrë nga përdorimi shumë fjalë me origjinë orientale, greke, sllave etj. Është ngushtuar edhe veprimi i prapashtesave e parashtesave të huaja me zëvendësimin e tyre me ato të shqipes, si: *-xhi, -çi, -llëk, anti-* etj., p.sh. *furrxhi - furrtar, sahatçi - orëndreqës, dembellëk - dembeli, përtaci; antitank - kundërtank.*



Shqipja standarde merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zyrtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikon e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyrime emocionale etj. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë-grunore-grunajë* “arë e mbjellë me grurë”, *tamblak* “qengj pirës”; *tamblatore, tamblore, tamëltore* “lopë që jep shumë qumësht”; *tambloriz, tamëloriz* “oriz me qumësht”, *lule a bar tambl;*

drynoj “mbyll me dry”, *shpeshtinë* “pyll i dendur”, *shterpni* “të qenit shterp” etj.

Ky planifikim gjuhësor duhet bërë me ndërjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja kanë denduri të madhe përdorimi, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i shqipes standarde me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe.

Ndryshimet dialektore (fonetike e fonologjike, morfologjike, leksikore e sintaksore) humbasin e tretën në shumësinë e elementeve të përbashkëta të sistemit të gjuhës.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç'emra keni dëgjuar për këta frymorë e sende: *vajzë, djalë, gjel, vaj, çelës, bretkosë, veturë, orë, pus, poq elektrik, shporet.*
2. Dielli kur del në mëngjes, te ju thonë: *lind dielli apo del;* ndërsa kur perëndon thonë ...
3. Harkut me shtatë ngjyra që duket në qiell pas shiut i thoni *ylber, ilber, brez, sho:k* apo ...
4. Pjesa e fortë që kanë brenda frutat e kumbullës, pjeshkës etj. te ju quhet *bërthamë, koc* apo ...
5. Ju i thoni *misër, kollomboq, kallamoq* apo ndryshe?
6. Cilën fjalë e përdorni në të folmen e juaj: *fasule, pasul, bathë; presh, praz, purri; kastravec, trangull, sallatë; gomar, magar, magjar; gomare, gomaricë, magjaricë; çerdhe, fole, strofull, koshtar; kërmill, skërmill, pizhimuzh;* (grua) *shtatzënë, me barrë, me bark, me ymyt; hap derën, çel derën; mbyll derën, mshel derën; ndez zjarrin, kall zjarrin; shuaj zjarrin, fik, shkym, shim zjarrin; ngrohem, nxehem; zbres, zhdrypi; qerre, kerr, rab; fërgoj, skuq, përzhiti; tundës, tpi, mti, mutaj; litar, tërkuzë, konop; zgjua, koshiqe, koshere* apo ... (arka a koshi ku mbahen bletët); *katërdhet a dyzet; ngas, drejtoj, grahi, çoj, voziti* (qetë, makinën); *lopatë, llopatë, kaci, kacaj; ujit, vadit; hulli, vi, brazë.*
7. A mund të përmendni ndonjë fjalë të rrallë ose që është karakteristike në të folmen e juaj e që mungon ose përdoret ndryshe në të folmet e tjera shqipe.
8. A ka ndonjë fjalë që përdoret te ju, e cila nuk është pasqyruar në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe dhe që mund të hyjë e të bëhet pjesë e leksikut të shqipes standarde.
9. Gjeni fjalë të prejardhura në gjuhën standarde me bazë gege, si rastet në vijim: *rrejshëm, kryetar, i lexueshëm, bëzan, zanore, hekurudhë* etj.
10. Nga teksti në vijim nxirrni tiparet dalluese fonetike, morfologjike dhe leksikore. Përcaktojeni nga cili dialekt e nëndialekt është sjellë kjo anegdotë:

U ka:n Nasradi Hoxha me ni katun / e ni dit jet pa lira e del nu:dh/ e lut zotin mja qit do lira / vetëm niqin i dojke as ma pak e as ma shu:m / as nadhtena^on bile jo // Tu fol Nasradini vet me veti e nin ni njeri / I mer nadhtena^on lira i shtin me ni bo:çe e i qet permi u:r e vet hin ner u:r e kshir se shka po ban Nasradini //Nasradini tu kalu ka u:ra e she boçen / e qel kur i she lirat menon se zoti e paska ngu: po kur i njen i dalin nadhtena^on po ai i mer edhe boçja qe niqin lira / kur ta she ai njeri i thot Nasradinit se ti a: thave se si mar nadhtena^on po vetem niqin / Nasradini i thot se ti sti lypa shka po perzihesh e qeshtu tu shty me lla:fe ki njeri i thot me shku: te kadija (te gjyqtari) me zgjedh ket pun se smunte mja mar lirat / Nasradini i thot qysh me shku: kur skam kali po ki meniher hajt se un ta jap / po as gÿj nuk kam qe edhe gÿjen po ta jap / edhe shko:jn // Kur mrin ati Nasradini e lidh kalin e hi:n mrena / Nasradini meniher ja prit / o: kadi le:je bre kta se krejt qka me vet ki thot se jan tmijat edhe kalin qka e lidha esht e ktina / ai po de e e:mja / edhe gÿjen qka e kam vesh thot e:mja / ai po de e e:mja // e kshtu Nasradini e mashtron at njerin e ja mer lirat//

11. Tekstin në vijim kthejeni në të folmen tuaj. Thoni dallimin mes tekstit dhe të folmes suaj.

Më dha baba te ay/ shifeshim/ boeshim/ kishim turp pe burrit/ s'kishte dashuria aterne// po t'na shifte burri/ zinjim nganjër qanjim/ thoshim: "Na pa burri/ për lerë"//

Un e kishe babën plak/ e kishe të sëmur^ë/ burri më zuri mua të vogël gjashm^ëet vjet//
dhëndrri çunin/ Gurinë e kishte të vogël/ pandaj burri im vinte te çeshme xhami m'i sillte dru:t//
Nje aty/ s'vinte në shpit/ kishte turp// Un ishe me nalle/ me katër shtëmba në dorë/ utova/ u xrova
edhe i theva të katërta//

Edhe nje ashusoj jan meselet e mija//.... N'ato koa ta mbante burri fëmin në kra?!
Kurrasnjër// Njime bojn qef kto nuse//

6.2. FJALËT KRAHINORE E DIALEKTORE DHE LEKSIKU I SHQIPES STANDARDE

Ç'janë krahinorizmat e dialektizmat?

Termtat “dialektizëm” e “krahinorizëm”, akademik Jani Thomai i përkufizon kështu: “Mund të pranojmë me marrëveshje një kriter dallues të përafërt ndërmjet dialektizmave e krahinorizmave: kur fjala, që nuk e ka gjuha letrare, gjendet vetëm në një të folme ose në të folmet vetëm të një krahine, të merret si krahinorizëm; kur fjala gjendet në tërë dialektin ose në disa të folme të një dialekti (kuptohet, që mund të jenë edhe të krahinave të ndryshme), të merren si dialektizëm.”

Prof. Thomai pranon tri kritere për të përcaktuar karakterin dialektor a krahinor të fjalëve:

a) Kriteri i grupimit paradigmatic, d.m.th. kur fjala është dysor a sinonim dialektor i qartë i një fjale tjetër që është pranuar si e normës letrare të tipit: *uzdajë* - shpresë, *pendël*, *shpendël* - pupël, *thi*, *guc* - derr; *gjã*, *hajvan* - kafshë; *kaposh*, *kokosh*, *knus* - këndes, gjel; *kallamboq*, *kollomoq* - misër; *gjiton*, *kojshi*, *komshi* - fqinj; *konop*, *tërkuzë* - litar etj.

b) Kriteri i gjuhësor-fjalëformues, pasi cilësohen si dialektore a krahinore edhe variantet fjalëformuese (veç varianteve fonetike) që nuk janë normë letrare, si p.sh. në Has, në Shkrel e gjetkë për të treguar banorët e një vendi u shtojnë emrave të vendeve vetëm një të përparme *i*: *i shaljan*, *i hazjan*; *i shkrel*, *i hot*, *i kastrat*. Në Gjilan të Kosovës banorët e fshatrave thonë jam (ai është) *i Godenve*, *i Shurdhanve*, *i Dunavëve*, *i Biçakve*, *i Çelikve* (në kuptimin banor i fshatit Goden, Shurdhan, Dunav, Biçak, Çelik). Në të folmen e fshatit Brezë të Karadakut të Shkupit për formën standarde “çka” përdorin krahinorizmin mjaft të përhapur në shumë të folme të tjera të gegërishtes qendrore *xhit*, ndërsa për “diçka” thonë formën e përngjitur *dixhit*.

Në Veri kemi formime fjalësh me prapashtesën *-shëm*, në Jug me *-uar*: *i punueshëm* - *i punuar*, *i dëgjueshëm* - *i dëgjuar*, *i kuptueshëm* - *i kuptuar*, *i thyeshëm* - *i thyer* ... kuptohet që të dyja format janë normative dhe se ka dallim kuptimor ndërmjet formave të fjalëve me *-shëm* nga ato me *-uar*. Fjala vjen, kur themi se materiali që gjendet brenda një pakoje është *i thyeshëm*, d.m.th. atë duhet bartur me kujdes se mund të thyhet, ndërsa nëse themi se diçka është *e thyer* kuptojmë se tani më veprimi ka mbaruar.

c) Kriteri i fushës leksikore ose i fushës tematike (emrat e bimëve, të kafshëve, të shpendëve, të orendive shtëpiake, të veshjeve, të veglave të bujqësisë e të zejtarisë etj., kur janë lokale ose kur ndryshojnë mjaft nga një krahinë në tjetrën).

“Dialektet e të folmet kështu përbëjnë një pasuri të pamatshme jo vetëm me njësi leksikore, por edhe me tipa e mjete fjalëformuese të specializuara për kategori gramatikore, klasa leksikore ose fusha konceptore të veçanta.” Gjerësia e shtresës leksikore e krahinore, që përfshihet në rrethin e gjuhës letrare, sa vjen e rritet. Në këtë brez bëhet “fermentimi” i nevojshëm, gjatë të cilit fjalët krahinore fitojnë vlera të reja në atë shkallë sa bëhen “mbidialektore”, pra, nga krahinorizma bëhen ish-krahinorizma në gji të gjuhës letrare.

“Sinonimia leksikore është mundësi gjuhësore nxitëse edhe për thithjen e fjalëve nga të folmet. Shtresa më e gjerë e fjalëve dialektore e krahinore përbëhet nga ato fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si sinonime leksikore të fjalëve më të përgjithshme a të dialektit tjetër, duke sjellë jo vetëm larmi, por edhe pasurim me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj. (tipi *piskamë, ushtimë, jehonë, dashakeq, keqdashës, cep, kënd, rrok, i rremë, rrekem* etj.).”

Nga studimi mbi leksikon dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme në veprën “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” të prof. Jani Thomait, Tiranë, 2001 përvijohet dy porosi dobiprurëse për gjuhën dhe kombin tonë:



Porosia e parë: Vetëdijesimi ynë për shfrytëzimin e leksikut dialektor e krahinor si burim kryesor për pasurimin e fjalësit të shqipes letrare. Thjesht, vepra del me parimin se lënda gjuhësore (fjalët dhe tipat fjalëformues) nuk duhet “importuar” pa nevojë nga gjuhët e tjera të Evropës e të botës, kur kemi “prodhimin tonë” e mund ta gjejmë gjithandej ku flitet shqipja dhe kur e gjejmë të sjkruar në letrat shqipe.

Porosia e dytë: Leksiku është sfera më e lëvizshme e gjuhës. Pasuria leksikore e pashtershme e shqipes dhe pak e shfrytëzuar deri më tani duhet të jetë burimi më i rëndësishëm për pastrimin nga elementi i huaj dhe për pasurimin e shqipes standarde me njësi leksikore, semantike e stilistike. Në procesin e standardizimit të mëtejshëm e të modernizimit të shqipes, për ta bërë atë të aftë që të përmbushë nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës, prirja kryesore duhet të jetë **thjeshtimi i formave gramatikore dhe zgjerimi i fondit leksikor me burim anas** (dialektor e krahinor).

Në konkurrencën normative - pohon Thomai - një (ose dy) mund të mënjanohet, por më e zakonshme është ngulitja si dysorë leksikore, që në shumë raste është arritur përfundimisht, sikurse *hap - çel, ngre - çoj, kokë - krye, kurriz - shpinë, def - dajre, rrok - kap, sjell - bie, sjell - godit, sos - mbaroj, spec - piperkë, trangull - kastravec* etj., që mund të thuhet se janë barasvlerës si nga kuptimi, ashtu edhe nga shtrirja në përdorim.

Në të folmet shqipe ka edhe shumë fjalë të njëjta, por me variante fonetike të dallueshme, të tipit *borë, bor, vdorë, xborë, zborë; shtëpi, shpi, shpaj/shpoj/shpëj; lëshoj, lshoj, shloj; fëmijë, fmi, fmajë; syri, sýni, sajni; punoja, punonja, punojsha, punojshna* etj.

Përveç zhvillimit të brendshëm e të mëvetësishëm gjuhësor, në degëzimin dialektor deri diku kanë ndikuar, sidomos në leksikon dhe në sintaksën e të folmeve anësore, gjuhët e huaja në kontakt. Kështu, ndikimi i gjuhëve sllave është më i madh në të folmet shqipe të Maqedonisë, në

kosovariste e shqipen e Malit të Zi; në Shqipërinë e Jugut vërehet më shumë ndikimi i greqishtes, në pjesën e bregdetit veriperëndimor është më i fuqishëm ndikimi i italishtes etj. Disa huazime të tilla kanë përhapje të vogël, vetëm në pak të folme të shqipes, janë të panevojshme e për të cilat shqipja e krahinave të tjera ka fjalë gjegjëse anase, andaj quhen barbarizma. Të tilla janë sllavizmat: *brazdë, zheg, fllad, mraz, torishtë, voz, llovaçkë, potvërd, okolla, apet (opet)* etj. orientalizmat: *asker, azgan, badihava, begenis, dost, gajle, haber, hyzmeqar, kollaj, sebeb, tuxhar* etj., por edhe jo pak greqizma në të folmet e Jugut.

Përgjithësisht është konstatuar se shumë huazime leksikore nëpër të folme kanë mbetur si historizma a arkaizma, të gjitha këto me emëruesin e përbashkët si krahinorizma.

Ndarja fetare e shqiptarëve (në islamë, ortodoksë e katolikë) nuk ka lënë gjurmë të thella në ndryshueshmërinë gjuhësore të tyre, përveç në emrat vetjakë dhe në fondin e fjalëve që lidhen me ceremonitë, zakonet e kulturën fetare përkatëse.

Thomai sjell qindra shembuj dialektizmash ose krahinorizmash që s'ë kanë ende një sinonim të mirëfilltë në gjuhën letrare (me kuptime ose nuanca kuptimore të veçanta) dhe që mund të përgjithësohen lehtë e të hyjnë në gjuhën letrare, si: *angërduf* "ai që fryhet e kapërdiset si gjel deti; ai që mbahet më të madh"; *ankojë* "njeri që qahet e ankohet vazhdimisht", *cikon* "nxjerr lëng (pema)", *defatore* "grua që i bie deficit, *cucërrohem* "mblidhem shuk, bëhem grusht (nga frika etj.)", *cukëlan* "që i ka rënë leshi vende-vende (për bagëtinë)", *cullohem* "bëhem si fëmijë", *eracak* "që nuhat mirë, që i bie në erë gjahut shpejt (zakonisht për qenin)", *faran* "misër i farës", *gërdhajë* "pjesët e padobishme të një fruti (pjesa e brendshme e frutit (p.sh. mollës) që nuk hahet bashkë me farat)" e një varg fjalësh të tjera.

"Të tilla fjalë e kuptime fjalësh ndër të folme ka me mijëra. Kartoteka e leksikut të shqipes (KLSH) - thotë Thomai - përmban shumë prej tyre, por ende ka shumë të tjera të pambledhura, që janë pasuri e çmuar e gjuhës dhe që mund të pasurojnë më tej gjuhën letrare kombëtare. Prandaj, me gjithë ndërlikimet që ka, studimi i kësaj shtrese është me rëndësi të veçantë. Studimi i tipave të dialektizmave e të krahinorizmave dhe i ndërthurjes së faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, karakterizimi i historisë së fjalëve dhe i gjendjes së sotme, përcaktimi i marrëdhënieve me shtresat e tjera leksikore, sidomos me leksikun e gjuhës letrare, zbulimi i vlerave dhe i fushave të përdorimit, dallimi i elementeve vetjake nga huazimet, shtresimet nga pika të ndryshme vështrimi e çështje të tjera që janë objekt i këtij punimi, nuk marrin fund këtu, ato presin të çohen më tej me punime të tjera."

Është e njohur se para konstituimit të shqipes standarde (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 1972) pothuajse të gjitha veprat e shkrimtarëve tanë janë shkruar në gjuhën dialektore a krahinore, shpeshherë me përpjekje për një gjuhë mbidialektore a mbikrahinore. Por, edhe pas normimit të shqipes, përdorimi i fjalëve dialektore e krahinore në letërsinë artistike është i lejueshëm: asaj i jep një ngjyrim popullor, bisedor. Fjalë të këtilla gjejmë edhe në shumë vepra të shkrimtarëve bashkëkohorë (si te veprat e Gjergj Fishtës, Lasgush Poradecit, Jakov Xoxës, Mitrush Kutelit, Dritëro Agollit e të shumë shkrimtarëve të tjerë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në diasporë).

Dialektizmat e krahinorizmat në një tekst letrar përfshihen për qëllime stilistike. Ato shpesh i përdorin shkrimtarët për tipizimin e gjuhës së personazheve dhe për karakterizimin e mjediseve përkatëse në veprat letrare. Funksionet që marrin krahinorizmat janë jo të pakta: për përshkrimin e peizazhit të fshatit ose të qyteteve të tjera, për riprodhimin e mjedisit, jetës

familjare, për individualizimin ose tipizimin e personazhit (sepse shkrimtari e lidh personazhin për një të folme a krahinë, për një grup shoqëror, profesional ose kulturor) si dhe për efekte lirike a komike. Në prozën e Mitrush Kutelit, p.sh. krahinorizmat janë përdorë për të arritur efekte të dyskajshme: si shfaqje e një gjuhe pa prestigj, inferiore që pasqyron mungesën e zhvillimit, për të dhënë humor e satirë, dhe në skajin tjetër, për të shprehur dinjitetin e jetës popullore, të banorëve të lashtë, të vlerave folklorike e burimore.

Me ngulitjen e normës së gjuhës standarde, krahinorizmat bëhen identifikues të përkatësisë territoriale të folësit e personazhit, evokojnë veçantinë e kulturës materiale e shpirtërore të tyre.

Akademik Thomai shpreh bindshëm disa nga **veçoritë themelore të normës letrare në leksik:**

a) Veçori e përgjithshme e normës letrare në leksik, në krahasim edhe me atë të nënsistemeve të tjera, është, siç dihet, gjerësia relative e veprimit të saj, që lejon praninë e dysorëve e madje të vargjeve normative, ku bëjnë pjesë, si gjymtyrë të barasvlershme, edhe fjalë dialektore a me burim dialektor. Dysorë e vargje të tilla, si: *fshat - katund, hap - çel, kokë - krye, udhë - rrugë, shpinë - kurriz, i shkathët - zhdërvjellët, gjel - këndes - kokosh, vajzë - çupë - cucë - goçë - çikë - vashë* etj., fjalorët shpjegues të shqipes i japin si të rrafshit normativ, duke vënë, pa dyshim, në vendin e parë njërin fjalë, dominanten, që është më e përgjithshme, më asnjënjëse, më e zhvilluar semantikisht, më e ngulitur në përdorim.

b) Si veçori e dytë e normës leksikore mund të përcaktohet perspektiva e saj e hapur, lëvizja dhe zhvillimi dinamik i pandërprerë, ndryshe nga sistemi fonetik ose struktura morfologjike, që, pas një precipitimi normativ, stabilizohen, fiksohen, duke pakësuar vazhdimisht variantet e dysorët, ndërkohë që në sistemin leksikor variantet nuk pakësohen, madje edhe mund të shtohen, pasi gjuha letrare kërkon një leksik të pasur, të larmishëm, me shumë sinonime.

c) Veçori tjetër e normës letrare në leksik është përshtatja me kërkesat e stileve në një shkallë më të gjerë se mjetet e nënsistemeve të tjera (më afër qëndron sintaksa). Kjo lejon që edhe në fjalorin shpjegues kombëtar leksiku dialektor të zërë vend më të gjerë, shumë herë jo si normë e përgjithshme, por me vlera stilistike të veçanta dhe me prirjen drejt ngulitjes si normë stilistike. Kalimi nga norma stilistike te norma e përgjithshme letrare është njëra rrugë që i çon edhe i rrënjos shumë fjalë dialektore në fondet leksikore të gjuhës letrare.

Duhet vazhduar dhe intensifikuar gjurmimin, mbledhjen dhe studimin e leksikut dialektor e krahinor të shqipes

“Fjala shqipe - thotë profesor Jani Thomai - është një nga krijesat e pavdekshme të popullit, e cila, duke kapërcyer shekujt, ka hyrë në kohën tonë më e pastër e më e fuqishme, sepse në të krijuesi i madh popull ka vënë dorën e dashurinë e vet. Gjuhëtari e gjurmoi me ngulm dhe ia zbuloi vlerat, shkrimtari e lëmoi dhe e zbukuroi, poeti e futi në këngë dhe ia shtoi forcën. Në fjalën shqipe ka hyrë e ngjeshur tërë jeta shumëshekullore e popullit tonë të lashtë e luftarak, kultura e tij e gjerë dhe e ruajtur mirë, një histori e lavdishme plot beteja. Tek ajo janë kthyer përherë sytë e brezave dhe kanë gjetur armë të fuqishme për mbrojtjen e njëjtësisë së vet si popull e komb.

“Fjalës shqipe i janë përkushtuar breza të tërë luftëtarësh e atdhetarësh, dijetarësh e dashamirësish të gjuhës amtare. Gjuha shqipe ka heronjtë e dëshmorët e vet. Nuk ka vepër shkrimtari të mirë, - thotë profesori, - që të mos ketë nxjerrë në dritë një numër fjalësh e shprehjesh të rralla e me vlerë të burimit popullor. Leksiku shqip dialektor është në bërthamën e leksikut popullor.


Gjurmimi, mbledhja e studimi i fjalës shqipe me kohë është kthyer në detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare...”



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç’janë krahinorizmat e dialektizmat?
2. Cilat janë kriteret për të përcaktuar karakterin dialektor a krahinor të fjalëve?
3. Thoni porositë që na dalin nga studimi mbi leksikun dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme të prof. Jani Thomait.
4. Çjanë barbarizmat?
5. Shëno disa barbarizma nga e folmja jote dhe zëvendësoi me fjalë të shqipes.
6. Cilat janë veçoritë themelore të normës letrare në leksik?
7. Arsyetoje mendimin: duhet vazhduar dhe intensifikuar gjurmimin, mbledhjen dhe studimin e leksikut dialektor e krahinor të shqipes.

6.3. FRAZELOGJIZMAT DIALEKTORË - PRONË E SHQIPES LETRARE DHE STANDARDE



Fjalët përdoren zakonisht jo të veçuara, por të lidhura me të tjerat. Lidhjet e tyre përcaktohen në bazë të lidhjes së gjërave siç paraqiten në realitet dhe në bazë të logjikës. Mund të thuhet, p.sh. *dru molle, dru i fortë; pres dru, djeg dru* etj., por jo *dru libri, dru i qelqtë; shkruaj dru* etj., sepse biem ndesh me realitetin e logjikën, edhe pse gramatikisht këto lidhje janë të rregullta. Pra, çdo fjalë mund të lidhet me një varg fjalësh të tjera, ka një fushë semantiko-sintaksore të gjerë, duke formuar kështu togfjalësha të ndryshëm.

Një pjesë e lidhjes së fjalëve në togje krijohen në çastin kur flasim ose kur shkruajmë, ndërtohen me lidhje të lira aty për aty gjatë ligjërimit, prandaj edhe quhen *togfjalësha të lirë*, si *lule fushe, dega e lisit, bukë gruri; rrugë e gjerë, tokë e fortë; lexoj librin, ndërtoj një shtëpi; flas haptas, shkruaj bukur* etj. Pa dyshim, këta togfjalësha nuk i përdorim veç e veç, por të lidhur në njësi më të

madhe gjuhësore, në fjali e fjalitë në periudha.

Përveç këtyre togfjalëshave të lirë, në gjuhë ka edhe **togfjalësha të qëndrueshëm**, që nuk formohen në çastin e ligjërit, por janë ndërtuar në rrjedhë të kohës (gjatë zhvillimit historik), janë bërë të pazbërthyeshem dhe përdoren si njësi e gatshme, njësoj si fjalët. Të tillë janë *të zitë e ullirit, var hundët, ha dru, i hurit e i litarit, shkel e shko, ngre krye, e merr nëpër këmbë, e merr me mend* etj. Këto shprehje quhen **njësi frazeologjike** ose **frazeologjizma**.

Njësitë frazeologjike. - Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë quajttëse (shënuese, kuptimplota, fjalë emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme. Gjithë togfjalëshat e këtij lloji në gjuhën tonë përbëjnë frazeologjinë shqipe.

Elementet përbërëse të njësive frazeologjike e humbin pavarësinë kuptimore, kështu që kuptimi i frazeologjisë nuk del nga shuma e kuptimit të fjalëve, por nga shkrirja e tyre në një kuptim figurativ tërësor. Shumë njësi frazeologjike janë të barasvlefshme me një fjalë të vetme, por kanë figurshmëri më të fuqishme, si p.sh. *zë besë* (besoj), *vë re* (vërej), *marr vesh* (kuptoj). *U bënë pikë e pesë* (u shpërndanë). *Nuk bën pesë para* (fare s'vlen). *Mori dheun. Nga sytë, këmbët* (u arratis). *Punon nën dhe* (në fshehtësi të madhe). *I tregoi derën* (e përzuri). *Nuk e zë dera* (ka mbipeshë) etj.

Struktura dhe vlera e madhe shprehëse e frazeologjizmave. - Njësitë apo shprehjet frazeologjike për nga modelimi strukturor përbëhen prej fjalëve shënuese, emërtuese, kuptimplota (emra, mbiemra, folje, ndajfolje, numërorë e përemra) dhe fjalëve shërbyese (parafjalë, lidhëza, pjesëza).

Një numër i vogël frazeologjizmash përbëhen prej një gjymtyrë: *flet në tym* (kot), *punon pas shpine* (tinëzisht); por shumica kanë strukturë dygjymtyrëshe, të cilat mund të jenë dy emra: *kockë (asht) e lëkurë, udhë e pa udhë, me mish e me shpirt*, (si) *mali me borë*; një emër dhe një mbiemër: *punë e madhe, përshkrim i gjallë*; dy folje: *dha e mori, shkel e shko, hyn e del, thur e shtur*; një folje + një emër: *lëshoj pe, ia dal në krye, m'u mbush mendja, heq dorë, e mori në qafë, i doli boja*; prej shumë gjymtyrësh, si (folje + emër + emër): *s'ka sy e faqe, e ka halë në sy*; (emër + mbiemër + emër): *vrëma (bira) e fundit e kavallit* etj., dhe njësi frazeologjike më shumë se tri gjymtyrë ose me strukturë fjalie: *Ha bukën e përmbys kupën. Ia vuri të dy këmbët në një këpucë. I lirë në miell e i shtrenjtë në krunde. Ku rafsha mos u vrafsha.*


Sikurse fjalët, edhe njësitë frazeologjike mund të marrin shumë kuptime, krijojnë sinonimi, antonimi e homonimi. Karakteristikë e përgjithsme e frazeologjizmave është se ato kanë një kuptim (ndryshe nga fjalët), por disa kanë më shumë se një kuptim, varësisht nga konteksti, si p.sh. frazeologjia *hap sytë* mund të shprehë: 1. çudi, 2. kujdes, 3. kërkesë, 4. arsimim, 5. përpëlitjet e fundit të jetës (së dikujt) etj.: 1. I hapi sytë sa të kaut kur e pa. 2. Hapi mirë sytë. 3. Mos i hap sytë, se mjaft të dhash. 4. Shkolla t'i hap sytë. 5. I hapi sytë, e shkoi n'at dynja.

Ka variante të shumta frazeologjike, që krijohen me ndryshime gramatikore dhe leksikore, duke shprehur nuanca të ndryshme kuptimore e emocionale: *e nxjerr nga zemra* (dikë) - *e shkul nga zemra* (dikë) - *e shlyj nga zemra* (dikë); *i hapi barkun* (dikujt) - *i hapi zemrën*

(dikujt); *më hyri në shpirt* (dikush) - *më hyri në zemër* (dikush); *më dhemb në shpirt* (për dikë a diçka) - *më therr në zemër* (për dikë a diçka) etj.

Me njësi frazeologjike mund të ndërtohen çifte sinonimike, si: *rreh ujë në havan - çan dërrasa - i bie legenit, shkel e shko - sa për sy e faqe - sa për sy të botës, ma ha mendja - ma merr mendja - ma pret mendja - ma kap mendja* etj.; si edhe antonime: *ngul këmbë - lëshoj pe, shtie në dorë - më doli nga dora, i iku mendja - i erdhi mendja* etj. Rastet e homonimeve janë të rralla (*merr erë* “kupton nga ndonjë punë”, *merr erë* “qelbet”).

Frazeologjizmat, si pjesë e leksikut, janë pasuri e madhe shprehëse. Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* vetëm me foljen *bëj* ose me emrin *dorë* janë dhënë mbi 200 njësi frazeologjike, me emrin *sy* mbi 250, me foljen *ha* 150 njësi. Ja disa njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë fjalën *sy*: *s' më punojnë sytë, ia bën me sy, i shkeli synë, më vret sytë, i nguli sytë, ia ka vënë synë, më mbetën sytë* (në të), *mbylli sytë* (vdij), *i hedh një sy* (gazetës), *nuk ma zuri syri, si sytë e ballit, e ka halë në sy, s'i trembet syri...* Mund të merrni me mend se ç'pasurim e zgjerim të leksikut të gjuhës sonë sjell frazeologjia në përgjithësi.



Leksikologu i shquar shqiptar, Jani Thomai botoi një “Fjalor frazeologjik të gjuhës shqipe” (Tiranë, 1999) me një vëllim prej 10.000 - 12.000 njësisish frazeologjike. Nga fundi i parathënies thuhet: “vlerat e fjalorit frazeologjik pasqyrojnë vlerat e vetë frazeologjisë gjuhësore: normative dhe ekspresive, teorike e praktike. Frazeologjia, veç vlerave gjuhësore, më shumë se fjalët, mbart tregues të psikologjisë e të mendësisë së popullit, të historisë e të kulturës së tij.”

Secila gjuhë ka frazeologji të veten, prandaj ato nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë nga një gjuhë në një tjetër, por duhet gjetur një frazeologjizëm paralel a të ngjashëm, ose duhet të përkthehet kuptimi me ndonjë fjalë përkatëse të natyrës së asaj gjuhe.

Proverbat e disa fjalë të urta i afron me frazeologjinë gjuhësore figurshmëria dhe qëndrueshmëria e strukturës. Shprehjet e figurshme të gjuhës me anën e frazeologjizmave janë shpesh përshkrime të gjalla domethënëse, të lidhura me fakte e shoqëri me emocionale, që kanë të bëjnë me historinë e popullit e të vendit, me jetën dhe kulturën e popullit. *Duart nga mielli, sytë nga qielli* - është një tablo e vogël për amvisen që nuk e ka mendjen aty kur mbrun bukën, por përbën edhe një përgjithësim për pakujdesinë në punë.

Frazeologjia është sidomos karakteristike për ligjërimin bisedor, ajo buron nga populli dhe përdoret më së shumti në gjuhën dialektore, rrjedhimisht edhe në krijimtarinë folklorike. Nga goja e popullit dëgjojmë më shumë frazeologjizma, që kanë ngarkesë emocionale e figurshmëri të fuqishme.

Përdorimi i shprehjeve frazeologjike në letërsinë e shkruar është tipar i stilit popullor të shkrimtarit. - Shembull i përdorimit të goditur të njërive frazeologjike janë veprat e Naimit, Çajupit, Nolit, J. Xoxes, Sh. Musarajt, D. Agollit, Dh. Shuteriqit, A. Kondos, T. Laços etj. Po japim disa vargje të D. Agollit:

*Ka njerëz që pakëz pozitivë të kenë
E ngrysin ballin dhe fjalët shtrëngojnë në dhëmbë,
Dhe janë të lumtur kur shpirtin ta brejnë*

*Dhe janë të lumtur
Kur ndjenjat t'i shtypin me këmbë! ...
O njerëz, kur dega thyhet dhe bini,
Atëherë ju njohim më mirë,
Atëherë edhe duart tona lëpini, ...*

Frazeologjizmat përdoren më shpesh në prozë: *Jeta vërtet mund të jetë e vështirë, por mendjen duhet ta ruash dhe të mos e kesh kurrë zembrën akull. Edhe shumë i bindur nuk jam, por po shkel në akull e të dalë ku të dalë. Mirëpo Hysniu na doli arrë e fortë dhe ata të së majtës nuk e bënë dot për vete. Fali Zot, bagëti e trashë, nuk dinë ç'bëjnë. Në atë çast te dera bëri ballë Pali Milla. Po miletu nuk ha bar.*

Në poezinë e sotme, frazeologjia e mirëfilltë gojore është pak e pranishme, sepse më shumë përdoret frazeologjia librore dhe kulturore, që në pjesën më të madhe është kalkuar, d.m.th. është përkthyer fjalë për fjalë nga gjuhë të tjera, si *i hedh hije, shpërthen një derë të hapur, thyej akullin, kullë e fildishtë, më bën përshtypje, ka vend, marr masa, marr pjesë* etj. Në shkencë, në fushën politiko-shoqërore, në gazetari etj., frazeologjizmat librorë përdoren kryesisht pa ngjyrim emocional dhe në një stil të ngritur: *Kjo është alfa dhe omega e çështjes që duhet ta kuptojnë të gjithë. Nuk është se ashtu mendoj, por po bëhem avokat i djallit që të shoh ç'mendon ti. Para këtij rreziku të papritur, ra boria, që të çoheshin të gjithë për të mbrojtur kështjellën* etj.



Pyetje, ushtrime e detyra:

Ushtrimi 1. Gjeni njësitë frazeologjike në pjesët e nxjerra nga letërsia artistike.

1. Hëm, ngrihet në mes të mbledhjes dhe ia tregon babait arat! 2. Vajza, - thirri Liza, - mos u mërzitni, ne kemi shoqet që s'do të na lënë në baltë. 3. Muret kishin lëshuar bark e çatia ishte varur mënjanë si strehë kapeleje. 4. Asnjë fjalë të keqe për prindërit tanë, se ata mikun në besë kurrë nuk e kanë prerë. 5. Disa studentëve të Institutit u kishte zënë rrota bishtin. 6. Me bukë e kripë e pret shqiptari mikun në derë, me barut e plumb të zi pret armikun. 7. Hajt, moj, se zanati im ha bukë më shumë se yti. 8. Tashti që u rrit, në vend që t'ia lirosh burgjitë (vidhat, burmat), ti po ia shtrengon më shumë. 9. U arratis me cull e mull në tokën e osmanëve. 10. Nazmi beut një çehre i vinte, një çehre i shkonte.

Ushtrimi 2. Gjeni frazeologjizmat e sjellë nga ligjërimi i folur.

1. Si i ati dhe i biri, si ai që bëri t'anë, njësoj janë, bëmë baba të të ngjaj. 2. Aq i mirë e aq i dashur ishte, sa të gjithë bënë be për të. 3. Ai është bishti i fshesës në shtëpi. 4. Po pate bisht ta presin, po s'pate ta ngjesin. 5. Shkoi si cjapi te kasapi. 6. Mos u mërzit, ia bëjmë çaren. 7. Ti, kurdo që vjen, e ke derën çelë. 9. Bushatit i ka ra luga n'mjalt. 10. Ati shumë i kcen damari. 11. Kapu për rraje, mos u kap për degë. 12. Nusja tash ka lshue rraj. 13. Nënë, mos u bëj merak, jam rritur e nuk shkel në dërrasë të kalbur. 14. Të paska hy dreqi në bark. 15. Prej kësaj pune laj duart.

Ushtrimi 3. Me njësitë e dhëna frazeologjike formoni nga një fjali.


Vuri flakën, i ka duart flori, jap fund, gacë e mbuluar, vë buzën në gaz, hap gojën, derdh gjak, rrah gjoks, s'i pushon gjuha, i doli gjumi, i mbeti hatri, i hodhi pluhur syve, i ka hije, u bë hirrë, merr hov, ngrënë hudhra, e ka çuar hundën, dhashë e mora, erdhi te hunda, lidh jetën, i heq

kapelën, s'ka këmbë, me këmbë të mbarë, me mish e me shpirt, luaj këmbët, prerë kërthizën, kokë më kokë, lë kokën, ha bukën kot, ia lidhi kryet, hyri nëpër lakra, u bë lesh, nuk e nxë lëkura, i lëshon goja lëng, më ranë thonjtë.

Detyrë: Mblidhi frazeologjizmat e të folmes tënde. Shënioni ato dhe shpjego kuptimin e tyre.

KREU VII

7. TIPARET GJUHËSORE TË GRUPEVE TË TË FOLMEVE



7.1. GEGËRISHTJA VERILINDORE

Shtrirja territoriale. Të folmet lindore të gegërishtes veriore shtrihen nga Novi Pazari në Veri e deri në Kumanovë e Malet e Sharrit në jug; nga Shala e Shoshi në perëndim deri në Jabllanicë, Bujanovc e Preshevë në lindje. Brenda kufijve të sotëm të Shqipërisë në grupin e gegërishtes verilindore bëjnë pjesë të folmet e Nikaj-Mërkurit, të Krasniqes, të Gashit, të Bytyçit të rrethit të Tropojës, të Hasit të Kukësit dhe e folmja e Pukës. Por, pjesa më e madhe e të folmeve të këtij grupi shtrihen në Kosovë, Bujanovc e Preshevë. Andaj, grupi i të folmeve të gegërishtes verilindore shpeshherë emërtohet edhe me kosovarishte.

Në formë më të përmblodhur mund të thuhet se gegërishtja verilindore flitet në pjesën verilindore të Shqipërisë (në krahinën e Nikaj-Mërturit, në Krasniqe, në Gash e Bytyq të Tropojës, në Pukë e Kukës), në gjithë Kosovën si dhe në Preshevë e në Bujanovc.

Ndër tipare të përbashkëta të gegërishtes verilindore me mbarë të folmet e gegërishtes merren:

1. Kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat zanore të theksuara gojore në pak raste si këto: *hã:n* “hënë -a” ~ *ha:n* “ata hanë” (çiftet minimale që dëshmojnë këtë dukuri ndryshojnë nga një e folme në tjetrën). Por, duhet thënë se shkalla e hundorësisë së zanoreve po zvogëlohet, kanë mbetur vetëm pak çifte minimale fjalësh me kundërvënien gojore ~ hundore, d.m.th. hundorësia po defonologjizohet. Zanoret me timbër hundor po shndërrohen në variante krahinore me kushtëzim pozicional të të njëjtës fonemë.
2. Ka serinë e zanoreve të shkurtra dhe serinë e zanoreve të gjata, si fonema më vete për shkak të kundërvënies fonologjike, përkatësisht funksionit kuptimdallues, por edhe më shpesh funksionit gramatikor, në rastet si *kõs* “kos-i” ~ *ko:s* “kos-a”; *plãk* “plak-u” ~ *pla:k* “plaka”, *shõk* “shoku” ~ *sho:k* “shokë-t”, *lejlëk* ~ *lejle:k* “lejlek (njëjës) ~ lejlekë (shumës)” etj.
3. Ruajtja e /n/-së ndërzanore të shqipës së moçme, përkundër rotacizmit në toskërishten në periudhën paraletrare, si *sÿni* “syri”, *pëni* “peri”, *bãna* “bëra”, *hãna* “hëna”, *lakna* “lakra” etj.
4. Mungesa e fonemës /ë/ të theksuar (meqë në vend të saj historikisht mbarë shqipja ka pasur, gegërishtja e ka ruajtur /ã/-në ose /ẽ/-në hundore), si dhe përdorimi i kufizuar i [ë]-së së patheksuar ([ë]-në në gegërishte asnjëherë nuk e dëgjojmë as në fillim e as në fund të fjalës, ndërsa rrallë në mes të fjalës).
5. Përdorimi i togut *vo* në fillim të fjalës: *voj*, *vorr*, *i vokt*, *votër* (në toskërishte kemi grupin *va*: *vaj*, *var*, *i vakët*, *vatër*) etj.
6. Siç e vumë në dukje edhe te shpjegimi i dallimeve ndërmjet dialekteve të përemrat, shumica e të folmeve gege (të gegërishtes veriore, por disa edhe të gegërishtes qendrore) dallohen prej gjuhës letrare, të folmeve toske dhe arealit tjetër të gegërishtes (Shqipëri e Mesme e më në jug) për faktin se përemrat dëftorë shumë më tepër përdoren në formën e përngjitur: *çeky* ‘ja ky’, *çekjo* ‘ja kjo’, *çekta* ‘ja këta’, *çaj* ‘ja ai’, *çajo* ‘ja ajo’, *çata* ‘ja ata’, *çeto* ‘ja ato’ etj., sesa në formën me shtritje në të dy dialektet *ky*, *kjo*, *këta*, *këto*, *ai*, *ajo*, *ata*, *ato*. Me forma të këtilla të përbëra nga pjesëza e patheksuar treguese (deiktike, gr. *deixis* – dëftoj, tregoj me gisht) **qe** (çe) ‘ja’ dhe një përemër dëftor *ky*: *çe+ky*, *çe+kjo* ‘ja+ky, ja kjo’ ... veçohet ose dallohet më mirë frymori, objekti apo sendi që ndodhet afër ose larg folësit. Krahasoni variantet e fjalive: *Ky është gjali jem.* - *Çeky është gjali jem.* ‘Ky është djali im. – Ja, ky është djali im’. *Ajo a:r është ma e mira.* – *Çajo a:r është ma e mira.* ‘Ajo arë është më e mira. – Ja, ajo arë është më e mira.’
7. Ruajtja e paskajores e tipit *me* + pjesore e reduktuar gege: *me ba:*, *me punu:*, *me msu:*, *me lidh*, *me hec*, *me dal*... Paskajores gege toskërishtja i përgjigjet me lidhoren (të bëj, të punoj, të mësoj, të lidh, të ec, të dal ... ose me formën toske *për të* + pjesoren e foljes: për të bërë, për të punuar, për të mësuar, për të lidhur, për të ecur, për të dalur...).
8. Po e përsërisim konstatimin se: në të gjitha të folmet e gegërishtes ekzistojnë edhe dy, vende-vende edhe tri, forma të mbipërbëra (folja ndihmëse ‘kam’ + pas + pjesorja e foljes): **e kryera e dytë** (*kam pas punu:*, *ki/ke pas da:l*, *ka pas shku:*, ...), **e kryera e plotë e dytë** (*kisha/kishna pas punu:*, *kishe pas da:l*, *kish pas shku:*, ...), por edhe **e kryera e tejshkuar e dytë** (*pata pas punu:*, *pate pas da:l*, *pat pas shku:*, ...).

9. E shohim të arsyeshme të themi këtu edhe një herë se të folmet e gegërishtes kanë **pjesore të reduktuar** (të cinguar, të shkurtuar, pa mbaresa), ndërsa të folmet e toskërishtes kanë pjesore të plota, me njërën nga mbaresat -ë, -rë, -në, -ur, -uar; khs. pjesoret toske e gege: (kam) vjelë/vjelur - *vje:l*, mbjellë/mbjellur - *mbje:ll*, marrë/marrur - *ma:rr*; thënë/thënur - *thã:n*, bërë - *bã:*, dhënë/dhënur - *dhã:n*, lënë/lënur - *lã:n*; vrarë - *vra:*, larë - *la:*, fshirë - *fshî:*, blerë - *ble:*; lidhur - *li:dh*, pjekur - *pje:k*, kullotur - *kullo:t*; lexuar - *lexu:*, mësuar - *msu:*, punuar - *punu:* etj.

Në përcaktimin e tipareve karakteristike (dalluese) që e veçojnë një grup të folmesh nga grupet e tjera, disa veçori kanë *vlerë absolute* (ato që kanë përhapje në të gjitha të folmet e atij areali), ndërsa ndonjë veçori gjuhësore ka *vlerë relative* (ai tipar që nuk përfshin të gjitha të folmet e atij grupi, por pjesën më të madhe të tij).

Për tipare dalluese (absolute e relative) të të folmeve të gegërishtes verilindore janë pranuar:

10. Prania e fonemës /k/ në një grup fjalësh që në të folmet e tjera dalin me fonemën /q/, si: (jam) *ken*, *kan* “(kam) qenë”, *keshi* “qeshi”, *kime* “qime”, *ke:p* “qepë”, *kelb* “qelb”, *kofsha* “qofsha”, *kie* “qe”, *kerr* “qerre” etj.
11. Grupet e vjetra konsonantike *kl*, *gl* janë reduktuar, duke mbetur vetëm elementet e para: *kl* > *k*, kurse *gl* > *g*, si në fjalët: *klaj* > *kaj*, *klumësht* > *ku:sht* “qumësht > *hirrë*”; *gluha* > *guha* “gjuha”, *glishti* > *gishti* “gishti”, *gluni* > *guni* “gjuri”, *i glatë* > *i ga:t* “i gjatë” etj.
12. Afrikatizimi i plotë i bashkëtingëlloreve mesgjuhore qiellzore mbylltore /q, gj/ në paragjuhoret afrikate /ç, xh/: *qafë* > *ça:f*, *qen* > *çen*; *gjumë* > *xhu:m*, *gjashtë* > *xha:sht* sidomos në të folmet e Kosovës. Në inventarin konsonantik të të folmeve të Kosovës mungojnë tërësisht bashkëtingëlloret mesgjuhore /q, gj/; meqë të gjitha janë afrikatizuar në /ç, xh/.
13. Togjet e vjetra të shqipes *ae*, *oe* në këtë grup të folmesh janë monoftonguar në /a:/, /o:/ të gjatë (është ruajtur zanorja e parë, ndërsa e dyta ka rënë). Kjo shpjegohet me faktin se zanorja e parë ka qenë e theksuar dhe në rrjedhë të kohës ajo është ruajtur mirë, ndërsa zanorja e patheksuar e togut është shqiptuar si më e shkurtër deri sa tani më nuk dëgjohet fare. Ky proces fonetik ka zgjatur me shekuj, duke kaluar nëpër disa faza të ndërmjetme, si: (ti) *tháe* > *tháe* > *tháe* > *tháe* > *thá* “ti the”, *páe* > *pa:* “pe”, *ráe* > *ra:* “re, rënë”; *vóe* > *vo:* “vezë, ve”, *dróe* > *dro:* “droje, frikë”. Si rregull, nga tkurrja e dy zanoreve përftohet një zanore e gjatë: Në rastin tonë *áe* > *a:* (a të gjatë), ndërsa *óe* > *o:* (o të gjatë).
14. Togjet e zanoreve *ue*, *ie*, *ye* në shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore për lehtësi shqiptimi monoftongohen në zanoren e parë të togut, por në disa të folme edhe ruhen, andaj kemi dysi formash: *grue* - *gru:*, *thue* - *thu:*, *prue* - *pru:*; *diell* - *di:ll*, *qiell* - *çi:ll*, *miell* - *mi:ll*, *dyer* - *dy:r*, *fyell* - *fy:ll* etj. Prirja për monoftongimin e grupeve të



zanoreve *ue, ie, ye* është më e shprehur kur këto gjenden në trup të fjalës sesa në fund të fjalës.

15. Zanorja [ã] hundore në shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore shpeshherë shqiptohet e buzorëzuar në shkallë të ndryshme, duke u shndërruar deri në një variant të [o]-së së rëndomtë me nuancë hundorëzimi. P.sh. *nāna > nã^ona > nã^ona > nāna > nōna*; *bāna > bã^ona > bã^ona > bāna > bōna*, *hāna > hã^ona > hã^ona > hāna > hōna* etj.
16. Marrë në përgjithësi, grupet *mb, nd, ng* janë përngjashmuar (asimiluar) në *m, n, η*: *mbret > mret*, *mbaj > maj*, *dhamb > dham*; *nderoj > neroj*, *ndihmoj > ni:moj*, *ndreq > nreç*, *kuvendoj > kuvenoj*, *vend > ven*; *ngarkoj > ηarkoj*, *ngat > ηat*, *ngusht > ηusht*, *deng > deη* etj.
17. Emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me *-k, -g* ose *-h* shquhen me mbaresën *-i*: *miki, plaki, bregi, krahi*. Kjo mënyrë e formimit të shquarsisë nuk është karakteristike për të folmen e Nikaj-Mërturit, meqë emrat e këtillë shquarsinë e bëjnë me mbaresën *-u*: *bung-u, breg-u, prag-u* etj.
18. E pakryera është sigmatike: un *punojshta/ punojshna*, ti *punojshe*, aj *punojke*; na *punojshmi / punojshëm*, ju *punojshti / punojshni*, ata *punojshin*. Tipike është formimi i vetës së parë njëjës të së pakryerës së dëftores së foljeve në diatezën veprorë me anë të mbaresës *-shna (-jshna)* dhe në vetën e tretë me anë të mbaresës *-(j)ke*: un *dalshna, msojshna*; aj *dalke, msojke*.
19. Një dukuri tjetër që do vërejtur në fushën e foljeve është se në të folmet e Kosovës dhe në të folmet verilindore në përgjithësi është mjaft e përhapur trajta e së kryerës së formuar me të tashmen e foljes **jam** + *pjesore* në vend të **kam** + *pjesore*, sipas tipit *jam shkue, jam kan, jam ardh* “kam shkuar, kam qenë, kam ardhur” që shpjegohet si ndikim i sllavishtes. Sipas akad. Rexhep Ismajlit në të folmen e Preshevës kjo dukuri s’ka qitur krye deri tash, pra *kom shkue, kom ardh, kom i:k* etj., por te folja *me qenë* është bërë kjo (thuhet *jam ko:n*), ndoshta për shkak të njësimi tingullor të formave *kom* dhe *kon* (kom kon). Në disa të folme të gegërishtes qendrore kemi *kam ka:n* “kam qenë”. Sipas këtij gjuhëtari të shquar, kjo dhe disa arsye të tjera nga realiteti gjuhësor dialektologjik na shtyjnë të mendojmë se nuk mundet çdo gjë nga specifika e dialektit të shpjegohet vetëm me ndikimin e gjuhëve fqinje.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. Përkufizo shtrirjen territoriale të gegërishtes verilindore.
2. Thoni disa tipare të përbashkëta të gegërishtes verilindore me mbarë të folmet e gegërishtes.
3. Cilat janë veçoritë kryesore të të folmeve të gegërishtes verilindore?
4. Dëgjo ndonjë nga incizimet e postuara në Internet me humor popullor nga Kosova. Çfarë e karakterizon ligjërimin e aktorëve?
5. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të gegërishtes verilindore në: www.albanianlanguage.net.

6. Lexo një monografi për një të folme të gegërishtes verilindore. Shkruaj një recension për monografinë e lexuar.
7. Shikojeni dokumentarin “Molla e kuqe (pjesën e 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9)” në <http://www.youtube.com>

7.2. GEGËRISHTJA VERIPERËNDIMORE

Shtirja territoriale. Të folmet veriperëndimore të shqipes shtrihen nga Plava e Gucia në veri, deri në Mat në Jug, nga Tivari e Ulqini në perëndim deri në Nikaj-Mërkur e Pukë në lindje.

Sipas prof. Bahri Becit, brenda kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë në këtë grup të folmesh bëjnë pjesë të folmet e Kelmendit, të Hotit, të Kastratit, të Shkrelit, të Buzës së Ujit, të Koplikut, të Grizhes, të Lohes, të Reçit, të Rjollit, të Shalës, të Shoshit, të Pultit, të Postribës, të Shllakut, të Temalit, të Shkodrës, të Bregut të Bunës, të Bregut të Drinit dhe të Zadrimës. Jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë në këtë grup të folmesh bëjnë pjesë të folmet e Plavës, të Gucisë, të Triepshit, të Grudës, të Trobainit, të Kojës, të Fundnave, të Tuzit, të Krajës e të Malësive të saj, të Shestanit, të Anës së Malit, të Ulqinit me rrethina dhe të Tivarit me rrethina.

Hoti, Gruda, Triepshi, Kelmendi, Shkreli, Kastrati së bashku quhen Malësi e Madhe. Poshtë Malësisë së Madhe në veri të qytetit të Shkodrës shtrihen rrajzat e Mbioshkodrës, ku bëjnë pjesë Buza e Ujit, Kopliku, Grizhja, Lohja, Reçi, Rrjollli. Malësia e Madhe dhe Rranzat quhen së bashku zona e Mbishkodrës ose Mbishkodra. Në lindje të tyre shtrihen Shala, Shoshi dhe Pulti, të cilat emërtohen së bashku Dukagjin. Poshtë tyre shtrihen Postriba, Shllaku e Temali. Në jug të qytetit të Shkodrës ndodhet Nënshkodra, ku bëjnë pjesë Bregu i Bunës, Bregu i Drinit dhe Zadrima.

Pra, në nëngrupin verior të gegërishtes veriperëndimore përfshihen të folmet e Malësisë së Madhe (Kelmendi, Hoti, Gruda, Triepshi, Shkreli, Kastrati), të Dukagjinit (Pulti, Shala, Shoshi), të Krajës (Brisku, Shestani), të Rranzave të Mbishkodrës (Buza e Ujit, Kopliku, Grizhja, Lohja, Reçi, Rrjollli), të Postribës, të Shllakut, të Temalit, të Gucisë e të Plavës. Në nëngrupin jugor përfshihen të folmet e qytetit të Shkodrës dhe të fshatrave përreth, të Bregut të Bunës, të Bregut të Drinit, të Zadrimës, si edhe të folmet e Anës së Malit dhe të Ulqinit.



Në formë më të shkurtër mund të themi se gegërishtje veriperëndimore shtrihet në anën veriperëndimore të Shqipërisë: Shkodër, Malësi e Madhe, Dukagjin, Zadrimë, Mirditë dhe përfshin të folmet shqipe në Mal të Zi.


Disa nga tiparet e përbashkëta me të folmet e gegërishtes verilindore janë:

1. Prania e serisë së zanoreve gojore dhe hundore, zanoreve të gjata dhe të shkurtra.
2. Theksimi në rrokjen e parafundit të fjalëve: *véri, qíri (çíri), njëri*.
3. Formimi i trajtës së shquar të emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me *i* të theksuar gojore me anë të mbaresës *-ja*, karakteristike për emrat e gjinisë femërore: *kojshi-ja, hanxhi-ja, kafexhi-ja, Ali-ja, Hamzi-ja, Sali-ja* etj.
4. Formimi i trajtës së shquar njëjës të emërores së emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me *-ue* me anë të mbaresës *-ni*: *prvue - prroni, thue - thoni, ftue - ftoni* etj. Emrat e këtyllë në rasën kallëzore marrin mbaresën *-nin*, sipas tipit: *prronin, thonin, ftonin*.
5. Përdorimi i formave përemërore *djali jem, çika (vajza) jeme* në vetën e parë, kur prona dhe pronari janë në njëjës.
6. Mungesa e fonemës /ë/ të theksuar dhe përdorimi i kufizuar i të patheksuarës.
7. Përdorimi i paskajores: *me punue, me shkue, me msue...*

Tipare dalluese të grupit të të folmeve të gegërishtes veriperëndimore janë:

1. Togjet e zanoreve [ae] dhe [oe] janë monoftonguar në zanore të gjata, përkatësisht grupi [ae] > në [e]: të hapur, si në fjalët: (ti) *pae, thae, lae, rae* > (ti) *pë:, thë:, lë:, rë:*; ndërsa togu *oe* në zanore të përparme të ngritjes së mesme e buzore [ö:], *voe* > *vö:* “vezë”, *voen* > *vö:n* “vezën” etj. Është tipik kontraktimi i grupit të zanoreve [oe] në [e] në nëngrupin verior dhe në [ö] në nëngrupin jugor.
2. Kalimi i grupeve të vjetra të bashkëtingëlloreve [kl, gl] në [k-j, g-j] ka vlerë absolute (të plotë) për të gjitha të folmet e këtij grupi: *kloft* > *k-joft* (qoftë), *klaj* > *k-jaj* (qaj), *klumësht* > *k-jumësht* (qumësht); *gluha* > *g-juha* (gjuha), *gluni* > *g-juni* (gjuni, gjuri) etj. Në fjalët *klishë* > *kjishë* > *kishë* > *ki:sh*; *glisht* > *gjisht* > *gisht*; (kam) *klen* > *kjen* > *ken*; *glemb* > *gjem* > *g-jemb* > *gemb* grupet e bashkëtingëlloreve [kl, gl] kanë përfunduar në [k, g] në mbarë të folmet e gegërishtes veriperëndimore (e verilindore).
3. Grupi i bashkëtingëlloreve [fsh] është thjeshtuar në [sh], jo vetëm në mënyrën dëshirore të foljeve me temë në zanore: e *gëzofsh* > *e gzosh*, *rrnofsh* > *rrnosh*, por është përgjithësuar edhe në raste të tjera, si: *kjosh* (qofsh), *mnash* (mëndafsh).
4. Mungesa e buzorëzimit të [ã]-së hundore: *bāna, kām, nāna* etj.
5. Në dallim nga të folmet e gegërishtes verilindore, ku bashkëtingëlloret mesgjuhore [q, gj] janë afrikatizuar plotësisht në [ç, xh]; në të folmet e gegërishtes veriperëndimore shkalla e afrikatizimit është më e vogël, përkatësisht atje dëgjojmë një mesgjuhore më të përparme ose një afrikate më të prapme [cʰ], [gʰ], të tipit *c'af, g'ak* “qafë, gjak”.
6. Kalimi i [a]-së së theksuar në disa fjalë në një tingull më të përparmë dhe më të mbyllur [ã] ose [e]: *nält, präp, zjärm* ose *nělt, prëp, zjërm* “nalt, prap, zjarm”.

7. Grupet [mb, nd, ng] janë përngjashmuar (asimiluar) në [m, n, ŋ]. P.sh.: [mb] > [m]: mbush > *mush*, mbarre > *marre*, mbaj > *maj*, dhamb > *dham*; [nd] > [n]: nder > *ner*, ndasht > *na:sht*, nandë > *na:n*, vend > *ven*; [ng] > [ŋ]: ngat > *ŋat*, (mos u) nguc > (mos u) *ŋuc*, kungull > *kunjell*, bung > *buŋ* etj.
8. Grupet e zanoreve [ue, ye, ie] ruhen, sidomos kur gjenden në rrokje të hapur fundore: *grue*, *thue*, *ftue*, me *punue*; krye (kam) *thye*, *frye*; *diell*, *qiell*, *miell* etj. Marrë në përgjithësi, në të folmet e grupit verior të gegërishtes veriperëndimore është karakteristike prania e grupeve të zanoreve, ndërsa monoftongimi i tyre në të folmet jugore.
9. Në të folmet e grupit verior ruhet grupi i vjetër [uo] dhe e variantit të tij [ua] ose [ue], si në fjalët *kruo* / *krua* / *krue*, *gruo* / *grua*, *duor* / *duer* etj. Këto grupe zanoresh të të folmeve veriore sa më shumë shkojmë drejt lindjes (te të folmet e grupit jugor) dëgjohen në togun [ue] ose [u:].
10. Prania paralele e dy mbaresave: *-i*, *-u* për formimin e vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë të foljeve me temë në zanore: *rrethoi*, *punoi*, *lshoi* dhe *pagou*, *fillou*, *shkrou*.
11. Në shumë të folme mbaresën *-u* marrin emrat që mbarojnë me bashkëtingëlloret *-k*, *-g* (bujku, zogu), ndërsa mbaresën *-i* emrat që mbarojnë me *-h* (ahi, krahi). Mbaresa *-u* përdoret edhe për vetën e parë njëjës të së tashmes te foljet me temë në *-k*, *-g*: *hiku*, *pjeku*, *djegu*, *lagu* etj.
12. Emrat e gjinisë femërore në rasën rrjedhore marrin mbaresën *-et*: mish *lopet*, buk *theknet*, prej *Shkodret*.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ku shtrihet gegërishtja veriperëndimore?
2. Thoni disa tipare të përbashkëta të gegërishtes veriperëndimore me gegërishten verilindore.
3. Cilat janë karakteristikat kryesore të grupit të të folmeve të gegërishtes veriperëndimore?
4. Dëgjo ndonjë nga incizimet e postuara në Internet me humor popullor nga Shkodra.
5. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të gegërishtes veriperëndimore lindore në: www.albanianlanguage.net.
6. Lexoje monografinë e prof. Bahri Becit, “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës”, Tiranë, 1995.
7. Shkruaj një recension për këtë monografi.

7.3. GEGËRISHTJA QENDRORE

Të folmet e gegërishtes qendrore shtrihen në territorin që përshkohet nga lumi i Matit dhe degët e tij, Fani i Madh dhe Fani i Vogël, nga Drini i Zi dhe rrjedhja e sipërme e Vardarit. Këtu përfshihen të folmet e Fushë-Krujës, të Krujës, të Malësisë së Madhe, të Matit, të Mirditës, të Lumës, të Peshkopisë, të Shkupit, të folmet e fshatrave jugperëndimore të Kumanovës, pra, të gjitha të folmet shqipe të Maqedonisë perëndimore deri te të folmet lindore të rrethit të Strugës. Si kufi verior i tyre mund të merret përafërsisht rruga automobilistike Vau i Dejës - Pukë - Kukës, Drini i Bardhë, malet e Sharrit dhe Mali i Zi i Shkupit. Kurse si kufi jugor i tyre llogariten lumi i Ishmit, Malësia e Tiranës, malet e Çermenikës dhe Drini i Zi në Strugë.

Po të duam ta përkufizojmë në vija të trasha shtrirjen gjeografike të grupit të të folmes së gegërishtes qendrore, mund të themi se ajo shtrihet në Lurë, Lumë, Krujë, Mirditë, Mat, Peshkopi (në Shqipëri); të folmet shqipe në Maqedoni që nga Kumanova në veri e deri në Strugë në jug: në disa fshatra të Kumanovës, në Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Prilep, Krushevë, Kërçovë dhe të folmet veriore të Strugës.

Ky grup është larguar mjaft në fonetikë prej tipit të përbashkët të gegërishtes. Po të lëmë mënjandë disa dukuri me një shtrirje më të kufizuar territoriale, si tipare të përbashkëta do të ishin këto (Gjinari - Shkurtaç, Dialektologjia, Tiranë, 1997, f. 185):

Veçoritë fonetike:


1. Në pjesën veriore të të folmeve të gegërishtes qendrore emrat *veri*, *qiri*, *niri* (*njeri*) në trajtën e pashquar janë me theks parafundor, kurse në të gjitha të folmet e tjera të këtij grupi këto fjalë janë me theks fundor. Te shumica e huazimeve orientale theksi zhvendoset nga rrokja fundore në rrokjen parafundore: *bakllá:v* (bakllavá), *bá:b* (babá), *tenéqe* (teneqé) etj.
2. Të folmet e gegërishtes qendrore ashtu si edhe të folmet e tjera të gegërishtes karakterizohen edhe nga kundërvënia e zanoreve të gjata me të shkurtrat. Kjo gjatësi nuk kushtëzohet nga pozita fonetike. Zakonisht ndeshen në rrokje të hapur në fund të fjalës: *fr̥̃:*, *ka:*, *hū:*, *p̃̃:*, *gī:*, *gru:*, *ftu:* etj. Por edhe në rrokje të mbyllur të ketë zanore të gjata, si pasojë e rënies së [ë]-së fundore: *ko:s* (kosë), *lo:p*, *shok ~ sho:k* (shokë) etj. (Shih: Gjatësia e zanoreve).
3. Karakteristikë e përgjithshme e të folmeve të gegërishtes qendrore është dobësimi i shkallës së hundorësisë së zanoreve. Në gegërishten qendrore kanë mbetur vetëm pak çifte minimale fjalësh me kundërvënie fonologjike të një zanoreje gojore kundrejt një zanoreje hundore, si (ne) *lam ~ lām* 'lëmë', (ata) *kan ~ kân* 'kënë'. Në këtë grup të folmesh zanoret jo vetëm që kanë timbër hundor më të dobët, por edhe po defonologjizohen. Kjo prirje është më e shprehur sidomos në të folmet shqipe në Maqedoni. Mjafton të dëgjojmë e të krahasojmë çfarë shkalle hundorësie ka kur flet një plak i pashkolluar nga Kumanova, Karadaku i Shkupit, Karshiaka, Derveni, Tetova, Prilepi, Krusheva, Gostivari, Dibra e Struga. Kemi përshtypjen se nga Kumanova e deri në Tetovë sikur mund të hetohet një hundorësi e lehtë e zanoreve, ndërsa duke filluar nga Tetova e vazhduar nga jugu, pothuajse zanoret shqiptohen pa hundorësi. Edhe po të dëgjohet një timbër i lehtë hundor, kjo është rezultat i përshtatjes nyjëtimore të zanores kur gjendet para një bashkëtingëlloreje hundore. (Shih: Hundorësia e zanoreve).
4. Siç dihet, të folmet e dialektit të Veriut nuk kanë fonemë /ë/ në rrokje të theksuar. Por, në të folmet shqipe të Maqedonisë në pak fjalë të huazuara nga gjuhët sllave, në mungesë të

zanoreve të tjera, [ë]-ja shqiptohet e theksuar, ajo është rrokjeformuese, si: *shtërk* ‘lejlek’, *tërll* ‘vathë bagëtish’, *gërb* ‘shpinë, kurriz’, *sërb* ‘serb’; në pak huazime orientale: *hëz*, *hafëz*, *ërrz*, *ërrsk*, *rrësk*; te disa shprehje onomatopeike, si: (turreci ban) *tërr-tërr*, (s’ka) *këk-mëk*, (zogi) *tërr* (fjaroj), (zilja ban) *xërr*; përr (tiki-tiki, ndjellen pulat), *hërrp* (e piv kafën), (miza ban) *bëz-bëz*.

5. Në çështjen e [ë]-së së patheksuar, edhe te ky grup të folmesh i gjejmë tiparet e përgjithshme dialektore: në rrokje të patheksuar [ë]-ja del me kufizime pozicionale (nuk përdoret as në fillim e as në fund të fjalës), ka denduri të vogël përdorimi dhe është mjaft e paqëndrueshme. Rënia e [ë]-së në fundin absolut të fjalës dhe zgjatja kompensatore e zanores paraprirëse, si *a:r* < arë, *do:r* < dorë, *bu:rr* < burrë, *pla:k* < plakë, *dishe:k* < dyshekë. Mossqiptimi i shpeshtë i [ë]-së në pozitë të patheksuar edhe në mes të fjalës: *tlin* < tëlyen, *malsâi* < malësi, *udhta:r* < udhëtar, *lku:r* < lëkurë etj.

6. Labializimi i [ã]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o], si në fjalët *hã:n* > *ho:n*, *nã:n* > *no:n*, *kãma* > *koma*, *bãna* > *bona*.

7. Diftongimi i zanoreve të mbyllura të theksuara /í/ dhe /ú/ në diftongje dytësore, përkatësisht i /i/-së në [ãi, êi, ôi, ëi] dhe i /ú/-së në [âu, ôu], si shpí: > *shpãi*, *shpêi*, *shpôi*, *shpëi*; núse > *nãuse*, *nôuse*. Kjo dukuri mendohet se mund të ketë vepruar, pikërisht gjatë sundimit të principatës së Kastriotëve (1370-1468), sepse gegërishtja qendrore shtrihet në këto kufij.



8. Zhbuzorëzimi i [ý] > [í] dhe shpërbërja e mëtejme në diftong dytësor (*sý:* > *sí:* > *sãi*, *sêi*), si dhe shndërrimi i /y/-së në [u]: *shyt* > *shut*, *dynja:* > *dunja:*, *ymyt* > *umut*.

9. Grupet e vjetra [ae] dhe [oe] përgjithësisht ruhen: *ti m'dhae*, *m'pae*, *roe*, *voe*, *hae*.

10. Monoftongimi i togjeve të zanore [ie] dhe [ue] në zanore të gjata [i:] dhe [u:]: *diell* > *di:ll*, *qielli* > *çilla*, *mielli* > *milli*; *grue* ~ *gru:ja*, *ai ka knue* ~ *ata knu:n*, *lirue* ~ *e liru:n*, *du:r*, *luj*, *bie*, *zie*, *përzie*; *kam punue* > *kam punu:*, por edhe diftongimi dytësor i /u/-së gjatë në [âu] (*punâu*).

11. Qiellzorëzimi i [g]-së dhe i grupit të vjetër konsonantik [gl] në [gj]: *gisht* > *gjisht*, *gur* > *gjur*, *gojë* > *gjo:j*, *prag* > *pragj*, *larg* > *largj*; nga forma e vjetër *gluha* > *gjuha*, *gluni* > *gjuni*; *i*, *e* *glatë* > *i*, *e* *gja:t* etj.

12. Palatalizimi i grupit [dj] > [gj]: *dja:l* > *gja:l*, *dje* < *gje*, *djegës* > *gjegës*, *djersë* > *gjers* etj. Në të folmet e gegërishtes qendrore [gj]-ja e përfutur nga grupi bashkëtingëllor [dj] përgjithësisht nuk afrikatizohet në [xh].

13. Grupet e vjetra [kl] dhe [gl] kanë kaluar në [q] dhe [gj], të cilat në disa raste kanë evoluar në fërkimoret [q'] dhe [g']: *qumsht* < *klumësht*, *qan* < *klan*, *gjuha* < *gluha*, *i gja:t* < *i glat*, *ka qõn*, *q'en* < *klen*, por në zonat më veriore hasen edhe format: *kuj* (quaj), *koft* (qoftë), *kaj* (qaj) etj.


14. Bashkëtingëlloret [q] dhe [gj] kanë prirje të afrikatizohen në një farë mase, të bëhen qiellzore fërkimore mesgjuhore [q'] dhe [g']: *q'afa* ‘qafa’, *miq'* ‘miq’, *gj'ak* ‘gjak’, *gj'asht* ‘gjashf’,

gj'arpën 'gjarpër', *q'iri* 'qiri' etj., por jo të afrikatizohen plotësisht si në gegërishten verilindore (*gjak* > *xhak*, *gjumë* > *xhu:m*, *gjarpën* > *xharpën*).

15. Grupet e bashkëtingëlloreve [mb] dhe [nd] në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes qendrore ruhen dhe bashkëjetojnë me variantet e tyre të reduktuara [m] dhe [n]: *vend*, *nder*, *mbare*, *mbrenda*, *tombli*, *ondër*, *dhondër*, *i ombël*, *i ndihmon* ose *i ndëif*, por: *dho:m*, *plloûm* ose *pllum*, *përmi* etj.
16. Grupet [tj] dhe [dj] qiellzorëzohen në [q] dhe [gj], që ndonjëherë dëgjohej edhe si mesgjuhore fërkimore [q'] dhe [gj']: *qetri*, *gjal*, *gjath*, *gjers*, *aqe* etj.
17. Grupet e bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] në pak vende ruhen si të tilla, në pjesën më të madhe janë shndërruar në [pj, bj, fj], e në disa zona në rrjedhë të kohës janë qiellzorëzuar plotësisht në [q, gj], si: *plak* > *pjak* > *qak*, *plot* > *pjot* > *qot*, *plep* > *pjep* > *qep*, *bletë* > *bje:t* > *bgjet* > *gje:t*, *bluaj* > *bgjuj* > *gjuj*, *flaka* > *fjaka*, *flutur* > *fjutur*, *flokë* > *fjok*, *fletë* > *fjet* etj. Në fakt, procesi i evoluimit të këtyre grupeve në qiellzore apo afrikate është një dukuri relativisht e re dhe ka ndjekur rrugën që vijon: [pl] > [pj] > [pq] > [q] > [q'] (> [ç]); [bl] > [bj] > [bgi] > [gj] > [gj'] (> [xh]). Marrë në përgjithësi, vetëm në pak të folme të gegërishtes qendrore grupet [pl, bl] në gjendjen e sotme kanë përfunduar në afrikate [ç, xh], meqë në shumicën e tyre kanë arritur deri në fazën e qiellzorëzimit ose më së largu deri në afrikatizim të pjesshëm, por jo të plotë. Edhe grupet [pj, bj] janë palatalizuar në [q] dhe [gj]: *qekim* 'pjekim', *qergull* 'pjergull', *gjerma* 'bjerma'.
18. Grupet e bashkëtingëlloreve [pj], [mj], [vj] kanë prirje të reduktohen në elementin e parë të togut, përkatësisht në [p], [m], [v]: *pje:shk* > *pe:shk*, *përpyjetë* > *përpe:t*, *kam mje:l* > *kam me:l*, *vjehërr* > *vehërr*, *vjet* > *vet*, *vjeshtë* > *ve:sht*.

Veçoritë morfologjike:

1. Emrat e gjinisë mashkullore që në trajtën e pashquar mbarojnë me **-k** apo **-g** (edhe kur kjo e fundit ka përfunduar në **-gj**) apo **-h**, në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore trajtën e shquar e formojnë me mbaresën **-i**, si: *qaki*, *ibriki*, *uki*, *zogi*, *zogji*, *bregi*, *bregji*, *krahi*, *ahi*, *qehi*; ndërsa në pak të folme edhe me **-u**, si: *qaku*, *ibriku*, *ôuku*, *zogu*, *bregu*, *krahu*, *ahu*.
2. Emrat në rasën kallëzore me parafjalët *më*, *në*, *me*, *për*, *nën*, *ndër* vetëm në disa të folme të këtij grupi të folmesh marrin mbaresën **-t**, e cila është mbeturinë e rasës vendore: *n'fillxhant*, *n'hamart*, *m'vaktit*, *me dorët*, *m'terrt*, *n'muejt*. Në të gjitha të folmet e tjera rasa vendore është zhdukur.
3. Përemrat dëftorë përdoren më shpesh në formën e përngjitur: *çeki* 'ja ky', *çekjo* 'ja kjo', *çekta* 'ja këta', *çaj* 'ja ai', *çajo* 'ja ajo', *çata* 'ja ata', *çeto* 'ja ato' etj.
4. Në jo pak të folme të gegërishtes qendrore, sidomos në të folmet shqipe në Maqedoni, nuk bëhet dallimi i gjinisë së përemrave vetorë **ata** (veta e tretë shumësi për gjininë mashkullore) dhe **ato** (për gjininë femërore), meqë përdorin vetëm një rën formë për të dy gjinitë: **ata** ose



ato (për të dy gjinitë). P.sh. *ata burra - ata gra; ato burra - ato gra*. Ky mosdallim formash në gjini shfaqet si në të folur, ashtu edhe në të shkruar edhe te të shkolluarit.

- Në të folmet perëndimore të gegërishtes qendrore, gjegjësisht në anën e majtë të rrjedhës së Drinit të Zi mbaresa e vjetër **-e** e gjinore-dhanores shumë bashkëjeton me mbaresën e re **-ve**, sidomos tek emrat që në temë mbarojnë me bashkëtingëllore.
- Foljet e zgjedhimit të dytë, të dy klasat në vetën e parë njëjës në kohën e tashme të dëftores dalin pa mbaresë në pjesën veriperëndimore: (unë) *korr, vel / vjel, mjel / mel, pjek, var*, kurse në të folmet tjera marrin mbaresën **-i**: (unë) *foli, hedhi, mëlli, prashëiti, lidhi, mushi*, por: *marr, dal*.
- E pakryera e mënyrës dëftore në pjesë më të madhe të këtyre të folmeve është sigmatike **-(j)sha**:

Un puno(j)sha

Ti puno(j)she

Aj / ajo puno-nte /-jte / -ke

ne puno(j)shim

ju puno(j)shi(t)

ata / ato puno(j)shin

- Foljet me temë në zanore në vetën III njëjës të së tashmes së lidhore dalin me mbaresën **-(j)e**: *ai t'kalo(j)e, t'puno(j)e, t'fillo(j)e*. Ndërkaq foljet me temë në bashkëtingëllore dallojnë dy forma: në pjesën perëndimore marrin mbaresën **-i**, kurse në pjesën lindore marrin mbaresën **-e**: (ai) *t'ece / t'eci, t'mjelle / t'mjelli, t'marre / t'marri*.



Pyetje, ushtrime e detyra:

- Lexoje studimin me vlerë: Bahri Beci, Të folmet qendrore të gegërishtes, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Shkruaj një recension për këtë studim.
- Shikoni "Dasmën e Rekës së Epërme të Gostivarit", pjesa 1/4 incizuar nga Burim Proi, postuar në <http://www.youtube.com/>
- Shikojeni Reportazhin "Reka e Epërme - Nistrova", Josif Bageri, në <http://www.youtube.com>
- Shiheni: Reka e Epërme (Dysa katunde të Rekës), publikuar nga Burim Proi në <http://www.youtube.com>.
- Dëgjoni Këngë polifonike nga Reka e Eperme e Gostivarit në <http://www.youtube.com/>
- Shikojeni incizimin "Rikthimi i shqipes në Rekën e Epërme", postuar në <http://www.youtube.com/>




7.4. GEGËRISHTJA E SHQIPËRISË SË MESME

Të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme janë të folmet e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit. Në veri kufizohet me të folmet e gegërishtes qendrore, ndërsa në jug me të folmet kalimtare. Në to mungojnë shumë veçori tipike të gegërishtes dhe në mënyrë të natyrshme afrohen me të folmet e toskërishtes.

Të folmet e këtij grupi nuk kanë ndonjë tipar gjuhësor specifik, përveç dukurive në vijim:

1. Tani më në këto të folme zanoret jo vetëm që kanë shkallë të ulët hundorësie, por realizohen si gojore.
2. Zanoret e gjata pothuajse nuk janë më pjesë e shprehisë nyjetimore të banorëve të Shqipërisë së Mesme.
3. Dukuria më tipike e këtij grupi të folmesh është se në çdo pozitë dhe në të gjitha rastet pa përjashtim togjet e zanoreve monofongohen në zanore të thjeshta: [ue] > [u:], [ye] > [y:], [ie] > [i:], [oe] > [e:], [ae] > [e:]: *du:r, mu:, u ly:, dy:r, di:ll, u zi* (u zie) etj.
4. Zanorja [ã] hundore e mbarë gegërishtes buzorëzohet në [o]: *nona, Tirona, bona*.
5. Ndryshe nga gegërishtja qendrore dhe gegërishtja veriore, qiellzoret [q, gj] ruhen si mesgjuhore, nuk afrikatizohen (si në toskërishten).
6. Për këtë grup të folmesh është karakteristike rasa vendore. Siç dihet, rasa vendore përbëhet nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa *t(ë)*, që paraprihen nga parafjalët *në, mbi, nën, nëpër, me* ose *për: në gropët, në fikt, në malt, në misrit, mbi gurt, nëpër misrit, nëpër lumt, me lugët, me thikët, për bukët* etj.
7. Në krahsim me të folmet e tjera të gegërishtes, këtu lidhorja (të punoj) ka përdorim të dendur dhe përdoret në më shumë funksione, ndërsa paskajorja *gege* (me punu:) dëgjohet rrallë dhe me funksione të pakta.
8. Përemrat pronorë përdoren në format toske: *im, ime, tat, tate*, si: *çuni im, goca ime; çuni tat, gopca tate*.
9. E kryera e thjeshtë është në formën sigmatike (me -sh): *u lodhësh* (u lodha), *u lash* (u lava).



7.5. TË FOLMET KALIMTARE

Të folmet kalimtare ndodhen në një zonë ndërmjet dy dialekteve të shqipes, gjegjësisht përreth lumenjve Shkumbin dhe Drini i Zi. Ato shtrihen në një brez toke përgjatë krahut të majtë të Shkumbinit, që nga qyteti i Strugës, Qafa e Thanës në lindje e deri në bregdet, te derdhja e Shkumbinit në perëndim. Në këtë grup të folmesh bëjnë pjesë: Rajca, Bërzeshta, Vërça, Shpati, Polisi, Sulova, Dumrea, Darsia e Peqinit, Bregdeti i Poshtëm i Kavajës dhe pjesa veriore e fushës së Lushnjës (shih hartën e paraprake). Të folmet e kësaj treve formojnë vetëm grup të folmesh e jo dialekt më vete, sepse nuk kanë tipare të vetat të ndryshme nga ato të toskërishtes apo geglishtes, por kanë tipare të përziera nga të dy dialektet. Që një e folme të përcaktohet si e folme kalimtare duhet t'i ketë të përziera pesë nga tiparet kryesore që dallojnë toskërishten nga gegërishtja dhe jo nëse kanë të përziera çdo lloj tiparesh nga dy dialektet, përkatësisht nëse përzihet:



hundurësia dhe rotacizmi ose mungesa e hundorësisë me [n]-në ndërzanore. Në mënyrë të përgjithshme mund të themi se të folmet e skajit lindor kanë më tepër tipare toske, ndërsa ato të qendrës e sidomos ato të skajit perëndimor kanë më tepër tipare gege. Ja disa nga tiparet më karakteristike të të folmeve kalimtare:

1. Prania e zanoreve hundore *zāri*, *pēri*, *ullīri* në Vërçë, Bërzeshtë, Shpat, Polis, Dumre, Darsi dhe në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës, kurse në zonat e tjera ato mungojnë etj.
2. Zanojra e theksuar hundore [ā] gjendet në Polis e Shpat *zāri* 'zëri', *gjā* 'gjë'; si zanore [a] gojore dëgjohet në fushën e Lushnjës: *zari*, *gja*; variantin e buzorëzuar [ā^o] e gjejmë në Dumre, Darsi dhe në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës: *zā^ori*, *gjā^o* dhe plotësisht të buzorëzuar në [o] e kemi në

Sulovë: *zori*, *gjo*. Gjegjësja e saj toske [ē]-ja me variantin kryesor del në Sulovën Jugore, herë-herë edhe në Vërçë e në Rajcë, kurse si [ē^a], e prapme e ngritjes së ulët, që i afrohet [a]-së ndeshet më tepër në Vërçë dhe në Rajcë.

3. Bashkëjetojnë togu [ua] dhe [u]-ja e ardhur nga monoftongimi i togut [ue]. Togzanori [ua] i toskërishtes gjendet në të gjitha rastet në Vërçë e në Rajcë (ftua, duar), kurse në të folmet e tjera ai vërehet vetëm në rrokje fundore të hapur (ftua, grua). Në pozitat e tjera ka [u] si *dur* (< duer), *i martur* (< i martuem), *i harur* (< i harruem).
4. Grupi [va] gjendet në qendër dhe në lindje (Vërçë, Rajcë, Bërzeshtë, Shpat, Polis, Sulovë), ndërsa [vo] në perëndim (Dumre, Darsi, Fushë e Lushnjës, Bregdeti i Poshtëm i Kavajës).

5. Rotacizmi është shumë i përhapur në të gjitha të folmet kalimtare, por nuk mungojnë edhe rastet me [-n-] ndërzanore, që janë më të rralla se të parat: *rār* 'rërë', *shullori* 'shullëri', *lakrur* 'laknuer', *kam bār* 'kam bërë', *kam lërur* 'kam lëruar'; *dimën* 'dimër', *pleqni* 'pleqëri', *e shkurtën* 'e shkurtër' etj.
6. Paskajorja (infinitivi) e gegërishtes (me punue) është e pranishme te shumica e të folmeve kalimtare, por me një përdorim shumë të vogël bile përdoret më shumë si folje kallues i një fjalie qëllimore dhe shkakore: *do të shkoj me punur*, *desha me dal* etj. (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, Dialektologjia, shblu, Tiranë, 1997, f. 180).




Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ku shtrihen të folmet kalimtare?
2. Thoni tiparet gjuhësore të të folmeve tranzitore.
3. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të të folmeve kalimtare të postuara nga Robert Elsie në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.

7.6. TOSKËRISHTJA VERIORE

Toskërishtja veriore shtrihet në rrethet e Beratit, të Fierit, të Skraparit, Të Pogradecit, të Korçës, të Kolonjës, në ato zona të rretheve të Përmetit e të Tepelenës që ndodhen në krahun e djathtë të Vjosës e shkon më në jug të Vlorës (në Shqipëri); në pjesën perëndimore të rrethit të Strugës, në Prespë, e në Manastir (në Maqedoni). E folmja e qytetit të Strugës dhe e qytetit të Ohrit me lëvizjet fshat - qytet tani më nuk mund të karakterizohen se janë as geqe e as toske, por të folme kalimtare. Ky grup të folmesh ka vetëm zanore gojore, nuk ka fonema zanore të gjata e as hundore.

1. Në këto të folme ruhet /y/-ja.
2. Zanorja hundore [e] e mbarë shqipes (tani vetëm e gegërishtes) nuk ka kaluar në të gjitha rastet në [ë], kanë mbetur me [e] rastet si *peri*, *freri*, *femër*, *gjenj*, *e enjte* etj.
3. Vetëm në rrokje fundore të hapur grupet [ua, ie, ye] shqiptohen si togje zanoresh: *dua*, *mua*, *bie*, *shtie*, *u thye*; kurse në pozita të tjera ato shqiptohen si diftongje, si: *dûar*, *grûaja*, *zîen*, *pyës* etj.
4. Bashkëtingëlloret e zëshme në pozitë fundore shurdhohen: *zok*, *vënt*, *mënt*, *zëmër* (zog, vend, mend, zemër).
5. Ruhet rasi vendore: *në malt*, *në gropët* (në mal, në gropë).



7.7. TOSKËRISHTJA JUGORE

Toskërishtja jugore shtrihet në Labëri, në anën e Gjirokastrës e të Delvinës dhe në Çamëri.

Dihet se nëndialekti i toskërishtes jugore ka qenë më pak inovues, më ruajtës. Fjala vjen, ajo ka ruajtur zanoret e gjata si edhe gegërishtja (në Çamëri në një masë më të vogël), po edhe disa forma gramatikore të shqipes së moçme.

1. Në toskërishten jugore mungon fonema /y/, meqë është shndërruar në [i], më rrallë në [u]: *di* (dy), *ill* (yll), *birek* ose *burek* (byrek).
2. Zanorja hundore [e] e mbarë shqipes (tani vetëm e gegërishtes) ka kaluar në të gjitha rastet në [ë], si në fjalët *përi* (< pëni), *frëri* (< frëni), *fëmër* (< fëmën), *zëmër* (< zëmër) etj.
3. Grupet [ua, ie, ye] (aty ku ka [y]) shqiptohen si togje zanoresh në çdo pozitë: *dua*, *mua*, *bie*, *shtie*, *u thye* etj.
4. Në pozitë fundore bashkëtingëllorja [nj] ka kaluar në [j] te mbaresat e foljeve dëftore të kohës së tashme e në format e të së pakryerës, si *laj*, *punoj*, *shkoj* dhe të *punojë*, *punoje*, *punojim* etj.
5. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fundin absolut të fjalës (zok < zog, vënt < vend, brek < breg) nuk është karakteristik si në të folmet e toskërishtes veriore.
6. Mungon rasa vendore.
7. Format e së pakryerës të foljeve në dëftore janë më të vjetra në toskërishten jugore se në toskërishten veriore: a) në toskërishten jugore *jeshë*, *jeshë*, *ish*, *keshë*, *kish*, *kërkoj(ë)*, *kërkoje*, *kërkon* ose *kërkonej*; b) në toskërishten veriore *isha*, *ishe*, *ishte*, *kërkonja*, *kërkonje*, *kërkonte*.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Krahasoni tiparet dalluese ndërmjet nëndialekteve të toskërishtes, duke i shënuar ato në dy kolona paralele, sipas modelit të mëposhtëm:

Toskërishtja veriore	Toskërishtja jugore
1.	1.
2.	2.
3.	3.
4.	4.
5.	5.

7.7.1. LABËRISHTJA

Labërishtja dhe çamërishtja ndahen gjeografikisht te lumi i Shalësit, aty në jug të Delvinës. Përfshin të folmet e Vlorës, të Gjirokastrës, të Lunxhërisë e të Kurveleshit. Ndër tiparet më të rëndësishme gjuhësore të labërishtes janë:

Zanoret e gjata përdoren më dendur se në të folmet e çamërishtes.

1. Zanorja /ë/ e theksuar shqiptohet shumë më e prapme [ə] se varianti themelor i [ē]-së, e cila në disa vise, si në anët e Himarës e të Kurveleshit të Epërm, arrin deri në zanore të prapme jobuzore [ʌ]: *nəna*, *bəri*, *zəri*, e deri në zanore të ngjashme me një [o] jobuzore: *nna*, *bri*, *zri* (nëna, bëri, zëri).
2. Zanorja /y/ është zhbuzorëzuar në /i/.
3. Grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] asimilohen në [m, n, ŋ]: *mërthej* (mbërthej), *ner* (nder), *neh* (ngreh).
4. Pjesoreve me -ë, -në u ngjitet një mbaresë e dytë, mbaresa -ur: *dalur* (dalë), *marrur* (marrë), *thënur* (thënë), *lënur* (lënë) etj. (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaç, Dialektologjia, shblu, Tiranë, 1997, f. 186).

Pyetje, detyra e ushtrime:




1. Përkufizo shtrirjen gjeografike të labërishtes.
2. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të labërishtes në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
3. Thoni tiparet dalluese gjuhësore të labërishtes.

7.7.2. ÇAMËRISHTJA

Çamëria është krahinë e madhe gjeografike dhe etnografike në pjesën më jugore të trevave të banuara prej Shqiptarëve.

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore. Çamëria shtrihet përgjatë bregdetit të Jonit, nga lumi i Pavllës (ose i Shalësit) në veri deri në Gjirin e Prevezës në jug, në gjatësi rreth 107-108 km, ndërsa në lindje shkon deri te malet e Kurillës dhe te shkalla e Paramithisë, që e ndajnë nga pellgu i Janinës në një gjerësi 36-37 km. Çamësia ka një sipërfaqe rreth 3900 km.² Qendrat kryesore të Çamërisë janë: Filati, Gumenica, Lura, Margëllëçi, Arta, Paramithia, Parga e Preveza. Portet kryesore janë: porti i Prevezës, i Gumenicës, i Sajadhës, i Pargës, i Volës e i Sallahorës. Mbizotërojnë kodrat e malet e ulëta me lartësi deri në 1000 m. Midis maleve gjenden ultësira dhe lugina pjellore. Çamërinë e përshkojnë disa lumenj: lumi i Pavllës, Kalamai, Luri, lumi i Frarit, lumi i Nartës.



Vështrim historik. Në vitin 1913 me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës pjesa më e madhe e Çamërisë iu dha Greqisë. Brenda kufijve të shtetit shqiptar mbetën vetëm dhjetë fshatra: Dishat, Janjar, Konispol, Markat, Ninat, Shalës, Vërvë (me popullsi myslimane) dhe Çiflik, Mursi, Xarrë (me popullsi ortodokse).

Emri “çam” e “Çamëri” lidhen me emrin antik të lumit *Thyamis* që përshkonte territorin e Tesprotisë, i banuar nga fisi ilir i Tesprotëve. Kufiri jugor i Thyamisit shkonte deri në gjirin e Ambrakisë (sot gjiri i Artës). Historia e Tesprotëve është pjesë e historisë së Epirit antik. Më vonë Tesprotia kaloi nën sundimin e Romës dhe të Perandorisë Bizantine.

Ekonomia: Banorët e Çamërisë më tepër janë marrë me bujqësi e blegtori, vend të rëndësishëm në ekonominë e krahinës zinte kultivimi i ullirit, i agrumeve dhe i orizit. Vaji dhe qitrot e Çamërisë janë çmuar shumë në tregjet evropiane, afrikane dhe aziatike. Vendbanimet në Çamëri janë të tipit të grumbulluar shtëpi një-, dy-, e trekatëshe të ndërtuara prej guri. Çamëria është e pasur me monumente historike që nga lashtësia deri në periudhën venedikase e osmane. Në maja kodrash gjenden rrënoja fortesash ilire, mbi të cilat më vonë u ngritën kështjella venedikase dhe osmane, si kështjella e Rogoit dhe Karavostarit. Shpopullimi i Çamërisë nga elementi shqiptar ka sjellë dëmtimin e shumë vlerave arkitekturore në fshatrat dhe qytetet e Çamërisë.

Etnografi. Nga pikëpamja etnografike e gjuhësore, Çamëria bën pjesë në trevat jugore shqiptare. Veshja popullore e burrave ka qenë e njëjtë pavarësisht nga besimi, dhe ka ndjekur shtresëzimin kohor të veshjeve shqiptare. Deri në mesin e shek. XIX veshja karakteristike ka qenë ajo me fustanellë të bardhë, e cila këtu bëhej me 300-500 pala, këmisha e bardhë pa jakë, mëngorja dhe jeleku të qëndisur mjeshtërisht me fije ari dhe argjendi, silahu (silah quhet një brez i gjerë lëkure, shpesh i zburkuar me qëndisje të arta, që shërbente për të mbajtur armët e brezit dhe pajimet e tyre rreth mesit), ku vendoseshin armët e brezit etj... Këngët çame janë shumëzërëshe, por gratë këndojnë edhe vetëm. Janë të njohura vallet çame, sidomos të burrave, disa prej tyre janë të përhapura edhe te grekët dhe njihen me emrin “çamiko” (marrë nga Fjalori enciklopedik shqiptar 1, Tiranë, 2008, f. 373-375).

Tiparet gjuhësore të çamërishtes. Çamërishtja ruan ende elemente të vjetra fonetike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore e leksikore, të cilat hasen rrallë në të folmet e tjera shqipe ose pjesërisht te autorët e vjetër shqiptarë dhe te disa të folme arbëreshe. Disa dukuri ruajtëse gjuhësore të çamërishtes i gjejmë edhe në të folmet geqe. Kjo është një dëshmi se shqipja e moçme ka qenë më unike se sa tani. Tipare më karakteristike të çamërishtes janë:

1. Ruajtja e zanoreve të gjata, si në fjalët *o:d, gj:i:z, ve:s, bru:m, sevda:, shpi:, thëngji:ll, de:t*, pjesoret e foljeve (kam) *fshi:r, pre:r, pi:r* etj.
2. Ka theks fundor te fjalët me origjinë orientale (turke): *hisé, çifté, xhezvé, qoshé, hallvá, Merjemé, Hanifé* etj.
3. Ruhet [l]-ja ndërzanore e shqipes së moçme, e cila në shumicën e të folmeve shqipe në këtë pozicion ka evoluar në [j]: *val* “vaj”, *fal* “faj”, *mi:l* “mijë”, *bi:l* “bijë”, *go:l* “gojë”, *kual* “kuaj” etj.
4. Ruhën togjet e vjetra bashkëtingëllore [kl, gl] (klj, glj) e [lk]: *klaj* “qaj, kaj”, *klumusht, kljumësh* “qumësht, kusht”, *kljishë* “kishë”, *gluri* “gjuri, guni”, *gleth* “gjet”, *i gljatë* “i gjatë”, *gljishiti* “gishti”, *gljuhë* “gjuhë”, *alk* “ajkë”, *ulk* “ujk” etj.

5. Mungon zanorja /y/ dhe në vend të saj kemi /i/, si p.sh.: *si*: “sy”, *krie* “krye”, *thiej* “thyej”, *qip* “qyp”, *ki* “ky”, *ti*: “ty”, *di:ll* “dyell”, *i:ll* “yll”, *gjiq* “gjyq”, *pëlqier* “pëlqyer”, *pienj* “pyes” etj.
6. Zanorja [e] e theksuar në shumë fjalë është shndërruar në [ë]: *vënt* “vend”, *mënt* “mend”, *zëmër* “zemër”, *ëmër* “emër”, *flë* “fle” etj.
7. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore të fjalës: *vënt* “vend”, *mënt* “mend”, *zok* “zog”, *brek* “breg”, *i math* “i madh”, *dhëmp* “dhëmb”, *u ljoth* “u lodh”, *tunt* “tund” etj.
8. Ruhet bashkëtingëllorja /rr/ në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, si: *rrall*, *rrap*; *harram* “haram”, *Muharrem*, *grrusht* “grusht”, *prrua*; *burr*, *marr*, *nxjerr*, *varr*, *zjarr* etj.
9. Bashkëtingëllorja [t] në rrënjë të emrave apo të foljeve, gjatë eprimit të fjalëve, kur ndodhet para mbaresës -*në* përngjashmohet (asimilohet): *t + në > nnë > në*, si në fjalët *shinë* < shitnë, *thërrinë* < thërritnë, *mbenë* < mbetën, *denë* < detnë etj.
10. Bashkëtingëllorja /h/ në përgjithësi përdoret në çdo pozicion të fjalës. P.sh.: *hall*, *hell*, *hajde*, *hak*; *ahere* “atëherë”, *sahat*, *groh* “ngroh”, *ftoh* etj.
11. Bashkëtingëllorja [sh] në mbasesat e lidhore së vetës së dytë njëjës, të dëshirores e të kohës së kryer (aoristit) sigmatike është shndërruar në [ç]: *dalç* “dalsh”, *vafç* “vafsh, shkofsh”, *marrç* “marrsh”, *laç* “lash”, *thaç* “thash”, *ra:ç* “rashë”, *pa:ç* “pashë” etj.
12. Ruhet mirë gjinia asnjëse në tri grupe emrash: a) në emra të tipit *krie* dhe në emra që tregojnë lëndë, si: *kljumësh*, *ljesh*, *mish*, *rrush*, *kos*, *djathë*, *miall*, *dillë*, *grurë*, *gjalpë*, *mjaljtë*; b) në emra abstraktë të ardhur nga emërzimi i mbiemrave përkatës: *të mirë*, *të tëmbëljë*, *të gjatë*, *të thellë*, *të ngrohtë*; c) në emra të ardhur nga emërzimi i pjesoreve përkatëse: *të ardhur*, *të vajturë*, *të hirë*, *të kljarë*, *të marrë*, *të ljarë*, *të ljiërë*.
13. Ruan gjininë e numërorit *tre* (për gjininë mashkullore) dhe *tri* (për gjininë femërore): *tre burra*, *tri gra*; *të tre*, *të tria*.
14. Përemri vetor i vetës së parë njëjës, rasa emërore, ka formën **u**, si në shembullin *ti je i vogëljë*, *po u jam e madhe*; kurse në shumës **na**, duke u përputhur, kështu, me shumicën e të folmeve të gegërishtes.
15. Përdor përemrin vetvetor **vetëhe** me forma të lakueshme si emër: *vetëheja*, *vetëhesë*, *vetëhenë*, p.sh. *dragonjë të erdhë ndë vetëhe*; *tha me vetëhenë*.
16. Emrat mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar në rasën kallëzore marrin mbasesën -*në*: *vllanë* “vëllain”, *kanë* “kaun”, *njerinë* “njeriun”, *sinë* “syrin”, *dhenë* “dheun”, *gljunë* “gjurin”, *thonë* “thoin”, *ftonë* “ftoin” etj.
17. Nga fusha e fjalëformimit tipike është formimi i shpeshtë i deminutivave (emra zvogëlimi e përkëdhelie) me prapashtesën -*ëth* / -*th*, si *djaljëth* < djaljë, djalë; *burrëth* < burrë, *vllath* < vëlla, *ljumëth* < ljumë, lumë; *ujëth* < ujë, *krieth* < krie, krye; *mikth* < mik, *birth* < bir, *zokth* < zog.
18. Në togfjalëshat emër + emër në rasën gjinore apo emër + mbiemër i nyjshëm zanorja e patheksuar [ë] elidohet në fund të fjalës para nyjes së përparme e ose para trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, si *kohe*: *vjetër* < kohë e vjetër, *hale kurrizut* < halë e

kurritzit, *buze malit* < buzë e malit, *çupe tia* < çupë e tia, *te marrç* < të e marrç, *e bile atit* < e bilë e atit, *rrote mullirit* < rrotë e mullirit etj. Në togfjalëshat me një emër që shquhet me mbaresën -i dhe një emri në gjinore a mbiemri të nyjshëm, për lehtëshqiptim nuk përdoren të dy i-të, por vetëm njëra, si p.sh.: *Pusi Alikushit* < Pusi i Alikushit, *djali: vogël* < djali i vogël, *Lisi Glat* < Lisi i Gat, Lisi i Gjatë etj.

19. Ndërtimi i kohëve të përbëra të pësorës me pjesëzën **u** dhe trajta të foljes ndihmëse *kam*: *u kam larë* “jam larë”, *u ka bërë* “është bërë”, *u kam lodhur* “jam lodhur”, *u kish lagur* “ishte lagur” etj.

20. Në lëmin e haurimeve, vendin kryesor e zënë fjalët greke, pak ato të turqishtes e fare pak ato sllave.




Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të çamërishtes në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
2. Shikojeni incizimin Çamëria, përse kanë frikë grekët? Top Channel, postuar në <http://www.youtube.com/>
3. Shikojeni incizimin Çamëria (pjesa 1, 2, 3) postuar në <http://www.youtube.com/>

KREU VIII

8. TË FOLMET SHQIPE TË DIASPORËS

Diasporës së moçme shqiptare i përkasin arbëreshët e Greqisë e të Italisë, të Ukrainës, të Bullgarisë e të Kroacisë. Për arsye ekonomike, po edhe politike e fetare janë krijuar edhe disa diaspora më të reja shqiptare, të formuara në periudhën pas shekullit XVIII e deri në shekullin XX, si në Turqi, në Evropën qendrore (Gjermani, Belgjikë, Zvicër etj.), Egjipt, Amerikë, Australi etj.



Të folmet arbëreshe janë ishuj gjuhësorë në fshatrat arbëreshe të Italisë së Jugut (Kalabri, Molize, Sicili etj.) dhe në fshatrat arvanitase të Greqisë (Salaminë, Vurkoti, Atikë, Tebë, Eube, Beoti, Hidra, Specie, Kranidhi etj.), të themeluar para më se pesë shekujsh. Këto të folme i përkasin toskërishtes. Ato paraqesin veçori gjuhësore që i bashkojnë me të folmet e toskërishtes jugore, labërishten e çamërishten.

Në ngulimet tradicionale të Arbëreshëve të Italisë, si dhe në shumë qendra të mëdha urbane, ka ende më se 100 mijë veta që e ruajnë shqipen, e cila sot mësohet dhe në shkollat e krahinave arbëreshe. Me të folmet arbëreshe janë marrë një varg studiuesish të njohur, të cilët kanë botuar studime për to. Nga Arbëreshët e Italisë kanë dalë shkrimtarë e studiues të njohur, si Jeronim de Rada, Gavriil Dara i Riu, Zef Serembe, Anton Santori, Zef Skiroi, F. Solano etj. Prej disa dhjetëvjeçarësh në universitetet italiane të Palermos, të Kalabrisë, të Napolit, janë çelur lektorate të gjuhës shqipe dhe të dialekteve arbëreshe, ku kanë dhënë ndihmesa të vjera studiues si A. Guxeta, I. K. Fortino, F. Altimari, M. Mandalai etj. Po kështu edhe për të folmet e Arbëreshëve të Greqisë janë bërë mjaft studime dhe është mbledhur e botuar një lëndë e pasur gjuhësore e folklorike nga Hans-Jyrgen Zase, T. Johalas, N. Belushi etj. Nga Arbëreshët e

Grequisë kanë dalë shkrimtarë, studiues e veprimtarë të njohur si P. Kupitori, A. Kullurioti, P. Furiqi, A. Kolia etj. (Fjalor enciklopedik shqiptar 1, Tiranë, 2008, f. 706).

8.1. ARBËRESHËT E ITALISË

Marrëdhëniet iliro-romake dhe shqiptaro-italiane. Marrëdhëniet ndërmjet Arbërisë së Moçme dhe Italisë kanë qenë gjithmonë të shpeshta për shkak të afërsisë gjeografike (i ndan deti i gjerë vetëm 75 km).

Takimet e para iliro-latine. – Mbreti i Epirit, Aleksandër Mollosi në vitin 331 para erës sonë kaloi në brigjet e Italisë me qëllime pushtuese. Po kështu, Pirroja më 280 p.e. sonë ndërmori një nismë për shtrirjen Epirote në perëndim, por të dy dështuan.

Roma me lakmi donte të pushtonte tokat e Shqipërisë e pastaj Mesdheun për të depërtuar në Selanik e Bizant. Aso kohe romakët ndërtuan edhe rrugën “Egnatia” nga Durrësi në Selanik e Orient.

Ilirët themeluan Barin (Itali) që shpjegohet me shqipen bar-i (= it. Erba). Në perandorinë Romake ka pasur shumë ushëheqës të shquar ilirë si ushtarakë e kishtarë. Shumë personazhe historike kanë studiuar në shkollat e Ilirisë. Cezari ka studiuar në Durrës, Perandori Augusti në Apoloni. Kjo dëshmon se dy popujt fqinjë iliro-shqiptarët dhe romako-italianët kishin një shkallë të lartë të marrëdhënieve. Ka pasur edhe martesë të ndërsjella qysh në kohën parahistorike e historike. Edhe legjendat tona flasin për martesë të largëta.

Historia tregon për shqiptarë të mërguar në Itali, në Pulje më vitin 1267, pastaj disa u shpërngulën më 1450. Vala e dytë e mërgimit arbëresh që gjithashtu e natyrës ushtarake. Pas vdekjes së Alfonsit të Aragonës, kur hipi në fron Ferdinandi I, banorët u quan në rrebelim. Pas ndihmës që kërkoi ky i fundit, Skënderbeu zbarkoi në Barleta dhe mundi rrebelët. Për këtë ndihmë, Skënderbeu u shpërblye me disa toka jugore në Apuli dhe furnizim me armë. Këtu u vendosën disa shqiptarë.

Perandoria Osmane me ushtri të shumta e të stërvitura mirë, pa ndonjë qëndresë të madhe pushtoi Trakinë, Greqinë, Bullgarinë e Serbinë. Për 25 vjet Skënderbeu i mbajti tokat arbërore të papushtuara. Por, pas vdekjes së tij (më 17 janar 1468), pasi rezistoi edhe nja 10 vjet të tjera pa kryetrimin, ra, së pari nën protektoratin e Venedikut e pastaj në perandorinë Osmane. Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit shpërnguljet u shtuan. Me rënien e Krujës (1478) Gjoni, i biri i Skënderbeut së bashku me tëmën Donikën u vendos në tokat e falura në Apuli. Dega mashkullore e familjes së Kastriotëve u shua në shekullin XVII. Kjo është koha kur filloi dyndja më e madhe e arbëreshëve në Itali, që vazhdoi në disa valë të njëpasnjëshme. Këta u vendosën kryesisht në pjesën jugore të Italisë: në Kalabri e Sicili.

Janë rreth 100 mijë arbëreshë, shumica e tyre shqipfolës, të grupuar kryesisht në dy areale: në Kalabri dhe në Sicili, po edhe në Molise, Pulje, Abruco, Kampania, Bazilikatë si dhe në qendrat e mëdha të Italisë Jugore (Napoli, Kozencë, Potencë, Palermo etj.), po edhe shumëkund në Italinë Qendrore e Veriore (Romë, Firencë, Milano, Torino etj.). Prej këtu, disa

kanë migruar jashtë Italisë, sidomos në Amerikë, në Argjentinë e në Brazil (Jorgji Gjinari e Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 221-330).

Pra, arbëreshët (Shqiptarët e Italisë) sot janë një pakicë etnike shqiptare që jeton në Itali, që nga shekulli XV dhe XVI. Janë emërtuar si arbëreshë, pasi në kohën kur u larguan nga Shqipëria, ajo quhej Arbëri. Arbëreshët u vendosën në Itali në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, sidomos pas vdekjes së heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Njihen shtatë eksode të mëdha që nisin që nga koha menjëherë pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, nga shekulli XV e deri në fundi i shek. XVIII (1780-1790).

8.1.1. TË FOLMET E ARBËRESHËVE TË ITALISË

Siç u tha edhe në tekstin paraprak, arbëreshët në Itali u shpërngulën grupe-grupe nga pjesët jugore të Shqipërisë si dhe nga ngulimet arbëreshe të Greqisë, qysh në kohën sa qe gjallë Skënderbeu, ndonëse vala më e madhe migroi pas vdekjes së tij (nga shekulli XV deri në shek. XVIII). Tani ka rreth 100 mijë arbëreshë të vendosur kryesisht në Kalabri dhe Sicili, por edhe në Molise, Pulje, Abruce, Kampania, Bazilikatë si edhe në qendrat e mëdha: Napoli, Kozencë, Potencë, Palermo; Romë, Firencë, Milano, Torino etj. Prej këtu, disa kanë migruar jashtë Italisë, sidomos në Amerikë, Argjentinë e në Brazil.

Gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqet një formë më vete, prandaj është quajtur edhe dialekt i tretë i shqipes. Në të vërtetë, kjo e folme i përket toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamërishtes e të labërishtes, por edhe me gjuhën e autorëve të vjetër gegë. Por, duke qenë se kjo gjuhë që nga shekulli XV-XVI e këtej është në kontakt të vazhdueshëm me italishten, ajo pësoi mjaft ndikime nga kjo gjuhë. Është e kuptueshme se arbëreshët e Italisë, përveç gjuhës amtare, arbërishtes, njohin edhe italishten. Por, arbërishten e kanë, siç e quajnë ata “gjuhë të zemrës”, ndërsa italishten “gjuhë të bukës”.



Dialektologjia arbëreshe, bashkë me letërsinë e romantizmit, ka lindur para asaj shqiptare. Me të folmet arbëreshe u morën Maksimilian Lamberci që shkroi për ngulimet arbëreshe të Molizes e të Puljes, e pastaj Henrih Rajnholdi, Gustav Majeri, Holger Pedersen etj. Me dialektologji arbëreshe e letërsi u morën edhe Nikollë Keta, Andrea Dara, Françesko Antonio

Santori, Pietro Kamodeka, Xhuzepe Noçiti, Bernard Bilota, Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda etj. Kërkime të mirëfillta dialektologjike kemi nga Maksimilian Lamberci (albanolog i shquar Vienez, Austri); Eçrem Çabej, Gerhard Rolfs, Martin Camaj, Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaç, Françesko Solano, Imri Badallaj etj.

Tiparet gjuhësore:

Të folmet e katundeve arbëreshe të Italisë kanë karakteristika gjuhësore të përbashkëta, por ato kanë edhe ndryshime. Kjo shpjegohet me faktin se banorët e këtyre katundeve kanë prejardhje të ndryshme prej Shqipërisë jugore, Shqipërisë veriore e disa prej kolonive arbëreshe të Greqisë që migruan në kohë të ndryshme. Bile, ka katunde edhe me origjinë gege. Përgjithësisht, të folmet arbëreshe i përkasin tipit tosk, pa mohuar praninë e pak elementeve gege. Këto të folme mund të ndahen në areale gjuhësore. Shprehja arbëreshe “gjaku i shprishur” tregon se katundet arbëreshe janë bashkim i një gjaku të shpërndarë. Megjithatë, ashtu siç na paraqiten sot, të folmet arbëreshe të Italisë së Jugut pothuajse nuk kanë gjurmë të gegërishtes; i përkasin të gjitha shqipes jugore, duke iu afruar veçanërisht çamërishtes, çka i përgjigjet edhe historisë së këtyre komuniteteve.

Veçori gjuhësore më tipike të arbërishtes së Italisë janë:

1. Mungojnë fonemat zanore hundore. Të folmet arbëreshe të Italisë kanë 6 fonema zanore: /i, u, e, ë, o, a/ (mungon /y/-ja). Në sistemin bashkëtingëllor dallohen me të folmet toske me fonemat /gh/, /lj/ (< l).
2. Pjesa më e madhe e të folmeve arbëreshe kanë fonema zanore të gjata: plak ~ *pla:k*, (ai) bën ~ (ata) *bë:n*.
3. E ka rotacizmin.
4. Mungon fonema /y/ meqë është zhbuzorëzuar në /i/: *frin*, *gjims*, *grika*, *hin*, *sit* (frynë, gjysmë, gryka, hyn, sytë) në të gjitha të folmet arbëreshe.
5. [e]-ja e patheksuar kalon në [a], p.sh.: *a bila* (e bija), *misht a viçit* (misht e viçit, mish viçi), *vajz a bukur* (vajzë e bukur), *ma sit shogh* (me sy të shoh) etj.
6. [o]-ja e theksuar kalon në [a]: *da ma jap* (do të ma japë), *jat ëm* (jot ëmë).
7. [i]-ja e patheksuar fundore kalon në [e]: *ai shkrove* (ai shkrovi, ai shkroi), *ai pite* (ai piti = piu), *ai veje* (ai veji = vente).
8. [u]-ja kalon në [ë] në disa fjalë italiane, po edhe në fjalë të vjetra shqipe, si: *fërtun* (< furtuna), *mënd* (< mund).
9. Janë të pranishëm togu i vjetër [uo], bashkë me grupin e ri të toskërishtes [ua], krahas rasteve të monoftongimit të tyre: *gruoja* (gruaja), *kruoj* (kroi), *huoji* (i huaj), *duorat* (duart); *dua*, *bekur* (bekuar) etj.
10. Togu [ie] diku ruhet e diku monoftongohet në [i]: *dhit* (dhjetë), *mikra* (mjekra), *liper* (lepur), *i miri* (i mjeri).
11. Ashtu si në mbarë toskërishten, edhe këtu ruhen grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng, ngj]: *kundi* (kund), *kumbari* etj.

12. Ruhen grupet e vjetra [kl] dhe [gl]: *gluha* (gjuha), *gluri* (gjuri), *gliper* (gjilpërë), *glishti* (gishti); *kluhem* (quhem), *klisha* (kisha), *kloft* (qoftë), *kleti* (ai qe); ndërsa në disa katunde këto grupe janë qiellzorëzuar në [q, gj].
13. E ruan [l]-në ndërzanore si në shqipen e moçme: *bilë* (bijë), *golë* (gojë), *fëmilë* (fëmijë), *ndëlesë* (ndëjesë, ndjesë) etj.
14. Bashkëtingëllorja [ll] realizohet si një tingull frikativ i prapmë, afërsisht si [gh]: *baghët* (balli), *djaghi* (djalli), *dieghi* (dielli), *doghi* (dolli), *figh* (fill).
15. Te shumë fjalë që nisin me zanore u parashtohet një [gh]: *ghar* (< arë), *gharëz* (< arëz, anëz), *ghati* (i ati = babai), *gheci* (eci) etj.
16. Në fjalët me origjinë italiane [d]-ja shndërrohet në [dh]: *idheja* (ideja), *lunedhi* (lunedi) etj.
17. Mungon përemri pronor vetvetor *i vet, e vet* (ashtu siç mungon në mbarë toskërishten, meqë në vent të tij ka përemra pronorë i tij, e saj).
18. E pakryera si në mbarë toskërishten është asigmatike (punonja).
19. Ruan rasën vendore (lokativin): *ndë dhet* (në dhe).
20. Foljeve italiane u vihen mbaresa shqipe dhe zgjedhohen në shqip.
21. Ka një numër të madh italianizmash.

Arbërishtja ka ruajtur mirë disa veçori arkaike të shqipes, por megjithatë edhe kjo gjuhë ka pasur rrugën e saj të zhvillimit.

<i>Shembuj në arbërisht e në shqipen e sotme:</i>	
<i>në arbërishte</i>	<i>në shqipen e sotme</i>
Falem!	Përhëndetje!
Çë bën? Si rri / Si je?	Çka po bën? Si je?
Si të thonë?	Si e ke emrin?
Më thonë...	Quhem...
Gëzuar të të njoh!	Jam i lumtur që ju takova!
Ka më ndjesh	Më fal
Zën fill sotmenatë	Fillon këtë mëngjes
Të haristis!	Falemnderit!
Ka vjen?	Nga ku je?
E parkales!	Ju lutem zotëri!
Zotrote	Zotëria juaj
Nëng e ndëlgova	Nuk e kuptova
O / Ëj	Po
Jo	Jo

Arbëreshët nuk e kanë harruar vendin e të parëve dhe ruajnë të gjalla, traditat e tyre të pasura, si gjuhën, veshjet dhe ritet e doket që kishin në mëmëdhe. Nga gjiri i tyre dolën një varg

shkrimtarësh dhe njerëzish të ditur, të cilët dhanë ndihmesë të madhe për lëvrimin e gjuhës së popullit dhe për njohjen e historisë së tij.

Arbëreshët po bëjnë sot përpjekje për të siguruar të drejtën për mësimin e gjuhës amtare në shkollat fillore të komunave të tyre. Ata mbajnë lidhje të vazhdueshme me vendin mëmë, gjendjen e të cilit e ndjekin me vëmendje e dashuri. Bashkë me gjuhën amtare, që ka tipare arkaike, kolonitë arbëreshe ruajnë deri në ditët e sotme doket e zakonet, traditat e lashta në fushën e kulturës materiale e shpirtërore që na japin mundësinë të njohim nëpërmes tyre një pjesë të kulturës sonë popullore të shek. XV. Dallohen sidomos kostumet popullore të grave me bukuritë e pasuritë e stolisjeve të tyre, folklori i pasur me poezinë epike heroike, në të cilën ruhet i gjallë deri në ditët tona kujtimi i luftërave legjendare të Shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut. Në zakonet e dasmës e të lindjes, në festat popullore, në këngët, lojërat e vallet që i shoqërojnë, ruhet ende një numër i madh elementesh e dukurish që kanë me ato të atdheut amë. Ato dëshmojnë për njësinë kulturore etnike të trungut të kombësisë shqiptare, nga i cili arbëreshët u shkëputën para shumë shekujsh, pa humbur dashurinë e lidhjet gjithmonë të gjalla me mëmëdheun e tyre të lashtë (në Fjalor enciklopedik shqiptar 1, Tiranë, 2008, f. 90-91).




Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Dialektologët e mirënjohur Jorgji Gjinari e Gjovalin Shkurtaç edhe në tekstin universitar “Dialektologjia”, Tiranë, 1997 arbëreshëve të Italisë u kanë kushtuar vëmendje të veçantë, duke na dhënë informata të dobishme, të sakta e të hollësishme në mbi 100 faqe të librit (221-330). Lexojeni atë dhe shkruani një punim përmbledhës.
2. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të të folmeve arbëreshe të Italisë në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
3. Lexojeni tekstin për Horën e Arbëreshëve në: http://sq.wikipedia.org/wiki/Hora_e_Arberesheve/Gjuha
4. Dëgjoni dokumentarin Arbëreshët e Italisë 1, 2, 3, 4 në <http://www.youtube.com/> ose në <https://www.facebook.com/Presheva.jone>
5. Shikojeni incizimin O e bukura More - Historia e këngës 600-vjeçare në <http://www.youtube.com/>

8.2. ARBËRESHËT E GREQISË

Arbëreshët e Greqisë janë popullsi me prejardhje shqiptare në krahina të ndryshme të Greqisë, e vendosur atje qysh nga mesjeta, sidomos në shek. XII-XIV. Presioni nga ana e Perandorisë Bizantine dhe i feudalëve vendas ndaj fshatarësisë, presioni i pushtimeve serbe e më në fund edhe rritja demografike, ishin faktorët që nxitën grupe të mëdha të fshatarësisë së Shqipërisë së Jugut të viheshin në lëvizje drejt jugut: drejt Thesalisë, Greqisë qendrore e jugore dhe Peloponezit, ku kishte vise të shumta të shpopulluara. Arbëreshët - emri i vjetër etnik i popullit shqiptar, të cilin e mbanin ata – dhanë një ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin



ekonomik të Greqisë, në hapjen e tokave të reja, në zhvillimin e lundrimit e të tregtisë si dhe për rritjen e potencialit njerëzor të vendbanimit të tyre të ri... Popullsia arbëreshe ishte një faktor demografik me rëndësi në shtetin e ri grek. Në mesin e shek. XIX ajo përbënte afërsisht **një të tretën e popullsisë së këtij shteti**. Me gjithë rrudhjen dhe asimilimin e tyre gjatë kohës, arbëreshët përbëjnë edhe sot një masë popullsie kompakte në krahinat e Atikës, Beotisë, Lokridës dhe në gjithë Morenë, në ishujt

e Eubesë, Hidrës, Speces, Salaminës etj. Arbëreshët ose Arvanitët, siç i quajnë në gjuhën e tyre Grekët, ruajnë një varg tiparësh të kulturës së tyre popullore, doket e zakonet, virtytet, të trashëguara nga koha e lashtë e sidomos **gjuhën e tyre me tipare arkaike** aq interesante.

Në veshjet, në zakonet e dasmës, në ritet kalendarike, në këngët e vallet, që vazhdojnë t'i mbledhin edhe sot midis tyre folkloristët dhe etnografët, ruhen mjaft dukuri të ngjashme me ato të trojeve të sotme të popullit shqiptar, ashtu siç ruhen edhe në onomastikën e vendbanimeve të tyre të sotme. Arbëreshët nuk i kanë ndërprerë lidhjet me trungun shqiptar. Nga radhët e arbëreshëve të Greqisë dolën figura të shquara që kanë kontribuar në zhvillimin e kulturës shqiptare dhe në çlirimin kombëtar të mëmëdheut të lashtë. Të tillë kanë qenë: shkrimtari e publicisti i Rilindjes Anastas Kullurioti, filologët P. Kupitori, P. Furiqi etj. (Fjalor enciklopedik shqiptar 1, Tiranë, 2008, f. 89-90).

8.2.1. TË FOLMET E ARBËRESHËVE TË GREQISË

Arbëreshë e shqiptarë në Greqi. Dihet se, gjatë disa shekujve me radhë në Mesjetë, hapësira të mëdha të Greqisë kontinentale dhe të ishujve të Egjeut u populluan me arbërorë, herë artificialisht me ftesë të feudalëve bizantinë që kishin nevojë për ta, herë natyrshëm, falë shtimit të madh natyror të popullsisë arbërore midis shekujve XII-XIV. Këta arbërorë kanë mbijetuar pjesërisht edhe sot e kësaj dite si arvanitë, por një pjesë edhe në Itali, si arbëreshë që u vendosën atje pasi krejt Moreja ra në duar të turqve; pa folur pastaj për shqiptarët çamë myslimanë dhe ortodoksë, të cilët jetonin në vijueshmëri gjeografike-hapësinore me shqiptarët e tjerë më në veri, derisa iu nënshtruan spastrimit etnik nga ana e administratës greke. Dialektet arbërore janë vazhdim i natyrshëm i çamërishtes (nga pikëpamja fonetike), njëlloj sikurse është çamërishtja vazhdim i natyrshëm i labërishtes. Madje arbërishtja e Greqisë (sikurse ajo e Italisë), së bashku me çamërishten, kanë tipare të spikatura të një dialekti arkaik, periferik të shqipës, i cili ka ruajtur disa trajta gjuhësore më të vjetra që, përndryshe, në shqipe janë zhdukur (<http://www.phoenixhollo.com>).

Me fjalë të tjera, arbëreshët e Greqisë u shpërngulën nga pjesa jugore e Shqipërisë dhe u vendosën nëpër vende të ndryshme greke të pabanuara në periudhën midis shekujve XI-XV. Arbëreshët e Greqisë veten e quajnë arbëror, por më shpesh arvanitë dhe gjuhën e tyre arvanite.

Sipas studiuesit arbëresh (prift nga Kalabria e Italisë) Antonio Bellushi, sot ka mbi 400 ngulime arbëreshe (në Atikë 73, në Beoci 108, në Eube 49, në Peloponez e More 92). Numri i tyre është vështirë të përcaktohet, por thuhet se ka rreth 25 mijë veta. Kryesisht shqiptare është popullsia e ishujve të detit Egje: Eube, Hydra, Specia, Poros etj. Arbëreshë ka edhe në Beoci, Atikë, Athinë, More; në krahinat Korintia, Agrolis, Mesenia etj., por, me trysninë e gjatë të helenizimit, shumica e tyre e ka humbur gjuhën. Rrjedhimisht, arbërishtja e Greqisë është në zhdukje e sipër.

Veçoritë gjuhësore në fushë të fonetikës:

1. Mungon fonema /y/, e cila është delabializuar në [i]: *di* (< dy), *brima* (< bryma), *illi* (< ylli), *pienj* (< pyes), *dierë* (< dyert).
2. Ruan grupet e zanoreve [ua] dhe [ie], si: *muaj*, *dua*, *duar*, *bie* etj.
3. Ruhet /lj/-ja e vjetër: *biljë* (bijë), *valj* (vaj).
4. Ruhen grupet e moçme bashkëtingëllore [klj], [glj]: *i gljatë* (i gjatë), *gljëm* (gjemb), *gljishti* (gishti), *glju* (gju), *gljuhë* (gjuhë); *klja* (qa), *kljshë* (kishë), *kljumësh* (qumësht) etj.
5. Bashkëtingëlloret e zëshme në pozitë fundore shurdhohen, ashtu si në mbarë toskërishten: *i math* (i madh), *zok* (zog), *dhëm* (dhëmb), *u trëm* (u tremb), *katunt* (katund), *u doq* (u dogj) etj.
6. Grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng, ngj] thjeshtohen, duke rënë bashkëtingëllorja sonore [m, n], dhe ruajtur elemtet e dyta [b, d, g, gj], si: *mbljeth* > *bljeth* (mbledh), *mbrëmë* > *brëmë* (mbrëmë), *mbill* > *bill* (mbyll), *ndonjë* > *donjë* (ndonjë), *ndrishe* > *drishe* (ndryshe), *ndronj* > *drronj* (ndërroj), *ndihmë* > *dihmë* (ndihmë), *ndë* > *dë* (ndë), *ngjaljë* > *gjaljë* (ngjalë), *nga* > *ga* (nga), *ngarkonj* > *garkonj* (ngarkoj), *ngrenë* > *grënë* (ngrenë), *ngrihem* > *grihem* (ngrihem). Këtë dukuri nuk e gjejmë as në të folmet e toskërishtes e as tek arbërishtet e Italisë, por e gjejmë në disa të folme gege, si në Kastrat, Kelmend, Hot, Grudë, Malësi të Madhe e Karadakun e Shkupit. Kështu, në të folmen e fshatit Bllacë të Karadakut të Shkupit (Maqedoni) grupi [ng] krahas rasteve të herëpashershme të asimilimit të plotë në [ŋ], ose të ruajtjes së tij, ky grup në të shumtën e rasteve reduktohet vetëm në elementin e dytë, si: *gare:n* (< ngarend), *gra:n* (< ngranë), *ga:t* (< i ngatë), *gat* (< ngat), *e garkon* (< e ngarkon) etj.
7. Bashkëtingëllorja [p] kur ndëdhet para mbaresës *-në* kalon në [m], si *hamnë* (< hapmë), *jimnë* (jipni), *jimni* (< jipni), *dullamnë* (< dullapnë ‘dollapin’).
8. Bashkëtingëllorja [t] në rrënjë të emrave apo të foljeve, gjatë eptimit (lakimit dhe zgjedhimit) të fjalëve kur ndodhet para mbaresës *-në* asimilohet: *t + në* > *nnë* > *në*, si *shinë* (< shitnë), *thërrinë* (< thërritnë), *mbeinë* (< mbetnë), *denë* (< detnë).
9. Bashkëtingëlloret qiellzore [q, gj] para mbaresave *-në* e *-më* përngjashmohen në *-j*: *pojnë* (< poqnë), *dojnë* (< dogjnë), *pijnë* (< piqni); *pojnë* (< poqnë), *dojnë* (< dogjnë) etj.

Në fushën e morfologjisë për të folmet e Arbëreshëve të Greqisë tipike janë këto veçori:

10. Ruhet mirë gjinia asnjëse në tri grupe emrash: a) në emra të tipit *krie* dhe në emra që tregojnë lëndë, si: *kljumësh*, *ljesh*, *mish*, *rrush*, *djathë*, *miall*, *dillë*, *grurë*, *gjalpë*, *mjaljtë*; b) në emra abstraktë të ardhur nga emërimi i mbiemrave përkatës: *të mirë*, *të tëmbëljë*, *të*

gljatë, të thellë, të ngrohtë; c) në emra të ardhur nga emërzimi i prejpjesoreve përkatëse: të ardhur, të vajturë, të hirë, të kljarë, të marrë, të ljarë, të llierë.

11. Ruhet forma e gjinisë asnjane për pronorët: *imi* (gj. mashkullore), *imea* (gj. f.), *timtë* (gj. asnjane); *imi* (gj. m.), *jona* (gj. f.), *tënëtë* (gj. as.).
12. Shumësi i disa emrave del si në shqipen e moçme (e në gegërishte): njëjës djajë - shumë *djelj, djeljm* (si në disa të folme gege: *djel, djelm*).
13. Rasa kallëzore e emrave mashkulorë që mbarojnë me zanore të theksuar bëhet me mbaresën *-në*: *vllanë, kanë, njerinë, sinë, dhenë, gljunë, ftonë* etj.
14. Ruan gjininë e numërorit *tre* (për gjininë mashkullore) dhe *tri* (për gjininë femërore: *tre burra, tri gra; të tre, të tria*).
15. Përemri vetor i vetës së parë njëjës në rasën emërore ka formën e moçme *u* (unë), kurse në shumë *na* (ne), duke u përputhur me të folmet e arbëreshëve të Italisë, me çamërishten si dhe me shumë të folme të gegërishtes.
16. Nga fusha e fjalëformimit, si në të folmen arbëreshe të Greqisë, të Italisë e në mbarë toskërishten dendur formohen fjalët deminutive (zvogëluese a përkëdhelëse), sidomos me prapashtesën *-ëth / -th*: *djaljëth* (< djaljë), *burrëth* (< burrë), *vllath* (< vëlla), *ljumëth* (< ljumë), *ujëth* (< ujë), *krieth* (< krie), *mikth* (< mik), *birth* (< bir), *zokth* (< zok, zog).
17. Përcjellorja formohet me pjesëzën *tuke* + pjesoren e foljes: *tuke kënduarë, tuke hapurë, tuke martuarë* (si në mbarë toskërishten: *duke kënduar, ...*).
18. Paskajorja është *toske*. Ajo formohet me pjesëzat për të + pjesoren e foljes: *pljaku isht për të vdekurë*.

Arvanitasit e Greqisë, më të pafat se arbëreshët e Italisë. Statusi gjuhësor i shqipes në Greqi, qoftë në atë pjesë ku shqiptarët janë në trojet e veta e në vijim të atdheut të vet, Shqipërisë, në Çamëri, qoftë në diasporën arvanite, është kudo i njëjtë: ***injorim e mohim i plotë i pranisë së albanofonisë***. Pra, si në Çamëri, ashtu edhe në diasporën arvanite, shqipja është vetëm gjuhë e zemrës, por e papërfillur dhe e panjohur zyrtarisht. Arbërishtja e Greqisë është në zhdukje e sipër. Sot ata nuk e njohin veten si shqiptarë, por si arvanitë dhe gjuhën e tyre si gjuhë arvanite. Ata të huajve u thonë se janë arbëreshë të Greqisë, por edhe grekë. Arbërishtja e Greqisë është në zhdukje e sipër: brezi i ri gjithnjë e më pak flet arbërisht.

E folmja e arbëreshëve të Greqisë ka zgjuar interesim si për studiuesit e huaj, ashtu edhe për ata të vendit. Kështu, Hahni botoi “Albanische Studien” (Studime shqiptare) 1854; Rainholdi “Netë Pellazgjike”, Athinë, 1855; albansisti gjerman Klaus Hebler botoi një “Gramatikë të së folmes arbëreshe të Salaminës”, më 1965 në Vizbaden etj. Ndhimesë të madhe në studimet arvanite kanë dhënë Androkli Kostallari, Antonio Bellushi etj.

Të folmet arbëreshe të Greqisë janë pasqyruar pjesërisht edhe në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe. Për shkak të pengesave politike, dialektologëve shqiptarë nuk iu lejua që të bënin ekspedita për vjeljen e materialit dialektor tek arbëreshët e Greqisë. Këto të folme në Atlas u hartografuan në bazë të studimeve të bëra nga disa albanologë të huaj si dhe gjuhëtarë shqiptarë.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të arbërishtes së Greqisë në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net.
2. Shikojeni incizimin Shqiptarët e Greqisë në <http://www.youtube.com/>
3. Shikojeni incizimin Shqiptarët në Greqi, Shqipëria tjetër në <http://www.youtube.com>
4. Shënoni në fletore tiparet e përbashkëta të të folmeve arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë në dy kolona, në formën e mëposhtme:

Arbërishtja e Italisë	Arbërishtja e Greqisë
1.	1.
2.	2.
3.	3.
4.	4.
5.	5.
6.	6.

8.3. E FOLMJA E ARBNESHËVE TË ZARËS (DALMACI)

Në rrjedhë të kohës, për arsye të ndryshme olitike e ekonomike, grupe masive shqiptarësh janë shpërngulur nga trojet e tyre edhe në disa vende të ish-Jugosllavisë, si në Zarë të Dalmacisë (në Kroaci), dhe kelmendasit që u ngulitën në Srem të Sllavisë në Peshter.

Kjo koloni shqiptarësh u themelua aty nga fillimi i shekullit XVIII (1726-1733). Banorët janë të ardhur nga Malësia e Shkodrës: nga Brisku, Shestani, Kraja etj. (të cilat më 1913 mbetën jashtë shtetit shqiptar dhe iu dhenë Malit të Zi). Këta u vendosën në katundin *Arbnesh* (Borgo Erico, Erikovo Sello, Varosh Ericin, Arbanas). Arbnesh ka pasur edhe në vetë qytetin e Zarës, por ata u asimiluan, ndërsa arbneshët e Borgo Erikos ende e ruajnë shqipen.

Interesimi për të folmen arbneshë ka qenë i madh si ndër gjuhëtarët e huaj, ashtu edhe ndër shqiptarët. Për këtë të folme shkruan Franc Miklosiçi, Tulio Elber, Gustav Vajgandi, Karlo Taliavini, Norbert Jokli, Idriz Ajeti, Kruno Krstiqi, Aleksandër Stipçeviçi, Zeqirja Neziri etj. Punë të frytshme kanë dhënë edhe historianët Hasan Kaleshi, Muhamet Tërnavë e Zija Shkodra.

Krahas studimeve të mirëfillta gjuhësore e historike, për njohjen e së folmes së Zarës janë edhe një varg veprash letrare të shkruara në atë të folme: dramat e Josip Relës dhe poezitë e Shime Deshpalit.

Arbneshët kanë kontribuar mjaft edhe për kulturën kroate. Bie fjala, Aleksandër Stipçeviqi është arbnesh, ilirologu më i njohur, por edhe bibliograf i njohur kroat. Në qershor të 2013 falë Unionit Gjithëshqiptar "Vëllazërimi ynë" me seli në Tetovë, u botua fjalori arbërisht – shqip -kroatisht, me titull "Fjalori i të folmes së sotme të arbëreshëve të Zarës" i autorit dr. Kruno Krstiq, përkthyer e shqipëruar nga Mehmet Latifi. Lexoje informatën në tërësi: <http://prizrenpress.com/kulture>.

Veçoritë gjuhësore në fushën e fonetikës:

E folmja e arbneshëve të Zarës përfshihet në grupin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore. Këtë e dëshmojnë tiparet fonetike dhe morfosintaksore, nga të cilat më të rëndësishme janë:

1. Zonorja [a] johundore e hundore, më shumë se në çdo të folme tjetër gege, është buzorëzuar në [o]: *i gjol* (i gjallë), *oç* (aç), *boet* (baet, bahet), *goti* (gati), *klosi* (klasa), *bori i thot* (bari i thatë). Edhe [ã]-ja hundore e mbarë gegërishtes është shndërruar në [o], si në fjalët: *gjo* (gjã), *asgjo* (asgjã), *bo* (bã), *asonotje* (asonâte).
2. Nuk shqiptohet fare [ë]-ja fundore e patheksuar (si në mbarë gegërishten): *pu:n* (punë), *këpu:c* (këpucë), *i ra:nd* (i randë).
3. Një nga dukuritë më interesante të së folmes së Arbneshit të Zarës është prania e togjeve të zanoreve [ua] dhe [uo], ashu si edhe në të gjitha të folmet e Malësisë së Madhe (brenda e jashtë territorit të Shqipërisë). Aty kemi format e fjalëve: *arnua* (arnuar), *buu* (dëbuar), *arua* (harruar), *barsua* (mbarsuar, mbarsur), *bisedua* (biseduar); *bashkuon* (bashkuan), *bluon* (bluan), *me buo*, *gruo*, *ka vot*, *kam than ni gruos*.
4. Zonorja [y] është shndërruar në [u], por edhe në [ë]: *kruç* (kryq), *gjus* (gjys); *shtëp* (shtyp).
5. Nuk shqiptohet në asnjë rast [h]-ja, prandaj kemi format e fjalëve: *undi* (hunda), *anger* (hangër), *ekur* (hekur), *idhnim* (hidhnim) etj.
6. Bashkëtingëllorja [rr] është zbutur në [r]: *arua* (harrua), *ar* (arrë).
7. Nën ndikimin e kroatishtes, gjeneratat e reja në vend të [th]-së shqiptojnë [s], si në fjalët: *me sa:n* (me thanë), *sonji* (thonji), *sot* (thotë).
8. Shpesh bashkëtingëllorja [dh] shqiptohet ose si [ll] ose si [l] (edhe kjo nën ndikimin e kroatishtes): *llent* (dhent), *erl* (erdhi), *arll* (ardh), por ka edhe raste që [dh] zëvendësohet me [d] ose [t]: *ard*, *art* (ardhë).
9. Bashkëtingëllorja [ll], po kështu nën ndikimin e kroatishtes, kalon në [l] apo në [lj]: *lomi* (llomi), *mola* (molla), *pljumbi* (pllumbi).
10. Grupi [fsh] thjeshtohet në /sh/: *kashat* (kafshatë), *mandash* (mëndafsh).
11. [k]-ja nistore zëshmohet në [g]: *me gërkuu* (me kërkue), *me gaxuu* (me kallzue), *gërçele* (kërçele, gëlqere).
12. Ruhen të plota grupet [mb, nd, ng, ngj, nx], si në fjalët: *mbojt* (mbajt), *mbar*, *mbarim*, *mbars*, *mbarua*, *mbaruom*, *mbath*, *të mbathuna*, *mbet*; *i ndershim*, *i nderuom*, *ndesh*,

ndimua, ndjes; mundim, i munduom; ngarkim, i ngarkuom, ngas, ngatruom, nge, ngij, ngri; ngjat, ngjatua.

Tiparet morfologjike:

Si një pjesë e madhe e tipareve fonetike, ashtu edhe ato morfologjike paraqesin shumë forma ruajtëse (konservative) të tilla si të ato të “Mesharit” të Buzukut. Krahas vjetërsive, ndeshim edhe mjaft risi të përfutuara në kushte të dygjuhësisë e gjuhëve në kontakt, siç është bie fjala kthimi i foljeve të parregullta në të rregullta sipas analogjisë si dhe krijimin e formave të shumësit të emrave të parregullt në “forma të rregullta” të tipit të gjuhës së fëmijëve, si *dorat* (për duart), *derat* (dyert).

13. Emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresën *-i* (djali, mishi, peni) ose *-u* (gjaku, fiku, bregu, shiu, miu, kau); ndërsa emrat e gjinisë femërore marrin *-a* ose *-ja* (rana, vëneshta, gjoja (gjaja, gjëja).
14. Gjinia asnjane, ashtu si në mbarë shqipen, ka shkuar duke u rrudhur. Janë të gjinisë asnjane emrat prejpjesorë dhe prejmbiemërorë, të tillë si: *të çeshun, të shkruom, të ngritët, të kuçt* etj.
15. Mungon rasa vendore dhe funksionin e saj e ka marrë rasa kallëzore me perafjalë (në shpi, në katund, në Zadër).
16. Haset dysorësia e disa foljeve, si p.sh.: *vir* dhe *vjer, piç - pjek, nxir - nxjer*; pjesoret *pat - pas, ngajt - nga, rua (ruo) - ruajt, mbet - jet*.
17. Në vetën e parë shumës të kohës së tashme përdoren më dendur format e foljeve me mbaresën *-na*, në vend të formave të vjetra me *-m* apo *-mi*, si *shkona, jena*; si dhe *shkom(i), jem(i)*.
18. Koha e tashme, si në shumë të folme të tjera, përdoret me funksion të kohës së ardhme: *vinj nesër* (në kuptimin do të vi nesër), me të cilën shprehet një siguri më e madhe për veprimin që do të ndoshë në të ardhmen.
19. Koha e kryer e thjeshtë e foljeve formohet në dy mënyra: a) me mbaresën e paraprirë nga antihijatizuesja *-v+a*, pra me *-va*; b) ose me mbaresat e paraprira nga *-jt+a*, p.sh.: *shkova* ose *shkojta, këceva* ose *këcejta*.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Lexoje tekstin në faqen e Internetit: Zara ende frymon arbërisht nga Dashnim Hebibi në <http://www.dialogplus.ch/>
2. Shikojeni dokumentarin Shqiptarët e Kroacisë nga Gerti Xhaja në <http://www.youtube.com>.
3. Shikojeni dokumentarin Arbëreshët e Zares (pjesa 1, 2, 3) në <http://www.youtube.com/>
4. Dëgjoni incizime zanore në pikat dialektore të Krajës, Tivarit, Ulqinit e të Zarës në faqen e Internetit: www.albanianlanguage.net. Krahasoni ato.

8.4. E FOLMJA SHQIPE E KATUNDIT MANDRICA (BULLGARI)

Katundi Mandrica gjendet në krahinën e Ivajllogradit, në këndin juglindor të Bullgarisë, në kufirin bullgaro-turko-grek. Mandricarët janë me origjinë nga Korça ose nga Vithkuqi i Korçës. Shtegtimi u bë në shek. XV. Mandrica ka pasur 650, tani ka vetëm 200 shtëpi.

Për këtë të folme kanë shkruar Dhimitër Shuteriqi, Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica, studim dhe te keste, në Studime filologjik, 1, 1965, f. 103-141 dhe Mahir Domi e dhimitër Shuteriqi, Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës, në Studime filologjike, nr. 2, 1965, pastaj edhe albanologë të tjerë. Me vlerë janë studimet e albanistes bullgare Bojka Sokollova, e cila jep disa të dhëna për të folmen shqipe të Mandricës në pikëpamje sociolinguistike, si gjuhë në takim me bullgarishten, po edhe me gjuhë të tjera fqinje me të, sidomos me greqishten e me turqishten.

Kjo enklavë gjuhësore (ishull gjuhësor shqipfolës) ka ruajtur mjaft dukuri të moçme të shqipes, por edhe është zhvilluar në kushte të tjera gjuhësore, të ndryshme nga shqipja e trungut, rrjedhimisht edhe ka pasur rrugë tjetër evoluimi në kushtet e shumëgjuhësisë (plurilinguizmit) e të diglosisë. Si e tillë, ajo paraqet interes të veçantë për dialektologjinë, posaqërisht për dialektologjinë historike, po edhe përgjithësisht për historinë e gjuhës.

Tiparet fonetike:

1. Ashtu si mbarë toskërishtja, edhe kjo e folme e ka grupin zanor [ua], por e ka ruajtur edhe togun e vjetër [uo]; në disa raste gjejmë edhe [ue, u-v-e, u, o], si p.sh.: *grua* (edhe *gruve, gruo, gruvë*); *prua* (edhe *pruve, pru*); *mua, dua, duall* (edhe *duoll, duol*); *kërkuan, muar, muarnë, suall* (edhe *suoll*), *shkruaj* (edhe *shkruoj, shkruon*); *gëzuoka, kërkuka, punuoka; duoll, mbuoll, suoll; shtuekan, domë (duam), donë (duan)* etj.
2. Zanorja [ë] ruhet mirë si në mbarë toskërishten. Në disa raste [ë]-ja e patheksuar është ka kaluar në [u], ashtu si në çamërishten: *kupucë, kushtu, kutu, sumundë, jam sumurë* etj.
3. Zanorja [y] nën ndikimin e bullgarishtes ka kaluar në [u] ose në rrokjen [ju]: *du, dju* (dy), *frunish* (frynte) *jut* (yt), *kush* (qysh), *qutet* (qytet), *berjumë* (brymë), *djullë* (dyllë), *djumbëzjetë* (dymbëdhjetë) etj.
4. Një tipar interesant i kësaj të folmeje është mungesa e krasit në trajtat e shkurtra. Siç dihet, në mbarë shqipen në përgjithësi zanoret në takim [ë] + [e] në trajtat e shkurtra janë shkrirë në [a] (të e dhash librin = ta dhash librin, më + e = ma). Në shqipen e Mandricës, ashtu si në çamërishten dhe në disa të folme të tjera skajore konservative (tek arbëreshët e Italisë, në Malësi të Madhe) [ë] + [e] ruhen si të tilla, nuk janë shkrirë në [a]: *t'e pres* (= të e pres = ta presë), *t'e hamë* (të e hamë = ta hamë), *t'e marr* (= të e marr = ta marr) etj.
5. Nën ndikimin e bullgarishtes pothuajse janë zhdukur bashkëtingëlloret ndërthembore [dh, th], sepse në vend të [dh]-së dëgjohet [d] ose [z], ndërsa në vend të [th]-së kemi [s], si në fjalët: *dardë* (dardhë), *bardë* ose *barzë* (bardhë), *verdë, erda, erza* (erdha), *zënder* (dhëndër), *zea* (dhea = dheu), *më zëmb zëmbi* (më dhemb dhëmbi), *zi* (dhi), *uzë* (udhë), *i maz* (i madh), *trizjetë* (tridhjetë) etj. [th] > [s]: *sua, sonj* (thua, thonj), *djasë* (djathë), *drisë* (drithë), *sekër* (thekër), *sikë* (thikë), *Viskuqi* (Vithkuqi), *sellë* (thellë). Ka edhe raste që ruhet [th]-ja: *thom, tha, arthka*.

6. Ruhen grupet e vjetra të bashkëtingëlloreve [kl], [gl]: *klishë* (kishë), *klumësht* (qumësht), *shkla* (shka, shkja), *kle* (qe), *klakam* (qenkam), *klaka* (qenka), *klaj* (qaj); *glufënë* (gjuhën), *glisht* (gisht), *glemb* (gjemb), *glu* (gju), *të glatë* (të gjatë), *u nglinmë* (u ngimë = u ngopëm), *të nglet* (të ngjet = të ngjan).
7. Ruhet gjithashtu edhe [-l-]-ja ndërzanore në po ato fjalë që ruhen edhe në çamërishten: *bilë* (bijë), *bilëra* (bijëra), *fëmilë* (fëmijë), *milë* (mijë), *val-i* (vaji), *ndëlej* (ndjej, fal), *ulk* (ujk) etj.
8. Bashkëtingëllorja [ll] nën ndikimin e bullgarishtes është shndërruar në [l]: *akul* (akull), *djela* (dielli), *ul* (yll) etj.
9. Bashkëtingëlloret e zëshme në pozicion fundor shurdhohen, si edhe në mbarë toskërishten, si në fjalët *lis* (liz < lidh), *mblës* (mblez < mbledh), *vënt* (vend).

Tiparet morfosintaksore. E folmja shqipe e Mandricës ka disa dukuri e trajta të lashta morfologjike, sidomos te foljet, si edhe mjaft ndikime morfologjike e sintaksore nga bullgarishtja.

10. Janë të gjinisë femërore disa emra që në mbarë shqipen janë mashkullorë, si: *djella* (dielli), *pleha* (plehu), *shija* (shiu), *zeja* (dheu), *hija* (hiri), *klumështa* (qumështi), *zëja* (zëri) etj.
11. Shumë emra të gjinisë asnjane që tregojnë lëndë kanë kaluar në gjininë femërore: *djasa* (djathi), *mjalta* (mjalti), *dula* (dylli), *uja* (uji), *gjalpa* (gjalpi), *drisa* (drithi).
12. Rasa kallëzore e e mrave formohet duke marrë drejtpërdrejt mbaresën -në: *emërnëm hesapnë*, *kalnë*; rrallë edhe me mbaresën -in(ë): *vendinë*.
13. E kryera e thjeshtë e foljeve më shumë bëhet me -t- në vend të -v-së së mbarë shqipes, e tipit: *punojta*, *shkojti*, *shpëtojti*, *shtrojti* etj.
14. Koha e ardhme formohet me pjesëzën *o* (< do) + lidhoren (ashtu si në mbarë toskërishten): *o t' bëjmë* (do të bëjmë), *un o t' e marr* (unë do të marr).
15. Pjesorja del me mbaresat -rë (larë, punuar;) si në mbarë toskërishten, ose me mbaresën -tur (këndojtur, shkrojtur).
16. Koha e pakryer për të gjitha foljet, në vetën e parë e të dytë njëjës ka mbaresat -nja, -nje, si: *hapënja*, *hapënje*; *mbillnje*, *merrnja*, *punonja*, *binja*.
17. “Errësimi i ndjejnës gjuhësore” në një varg dukurish të morfosintaksës, si p.sh. mospërshtatja e gjinisë së mbiemrit ose p;remrit me emrin që përcakton: *ai ditë* (në vend të ajo ditë), *ai këpucë* (ajo këpucë), *ai çupë* (ajo çupë), *tëndja mashkull* (mashkulli yt), *ndë vjetra fshat* (në fshatin e vjetër) etj.
18. Rasa gjinore përdoret pa nyjë të përparme (i, e, të, së), p.sh.: *Minkos shtëpi* (shtëpia e Minkos), *mbretit çupë* (çipa e mbretit), *malit çobanë* (çëbanët e malit), *verës kohë* (kohë e verës) etj.
19. Mbiemrat vihen përpara emrit që cilësojnë (si në gjuhët sllave): *bardë bukë* (bukë e bardhë), *bukorë djalë* (djalë i bukur), *lartmi klishë* (kisha e sipërme, e lartë).

20. Ndikimi i rendit të fjalëve i bullgarishtes në të folmen shqipe të Mandricës shihet edhe në raste të tjera, si: *djados vllahis djalë* (djali i vëllait të gjyshit), *babos motrëhisë nuse* (nusia e motrës së gjyshes) etj.

Në këtë të folme kanë ndikuar në masë të madhe bullgarishtja, turqishtja dhe greqishtja, por megjithatë ajo e ka ruajtur deri më sot fizionominë e saj, nuk është zhdukur.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ku gjendet katundi Mandrica, sa shtëpi e sa shqipfolës ka atje?
2. Cilat janë dukurit fonetike të të folmes shqipe të Mandricës?
3. Thoni dukurit morfosintaksore të kësaj të folmeje.
4. Nëse ju jepet mundësia, vizitoheni katundin Mandrica dhe shkruani një skicë dialektore për të.

8.5. E FOLMJA E SHQIPTARËVE TË UKRAINËS

Ngulim shqiptarësh të shpërngulur relativisht herët (shek. XVIII-XIX) janë edhe ata të Ukrainës. Me origjinë janë toskë nga Shqipëria juglindore (nga anët e Korçës e të Devollit) dhe janë shpërngulur në 2 valë: në 1774 në Krime dhe Odesa dhe më 1860 në Berdjansku. Këta shqiptarë kanë shtegtuar së pari në Bullgari, në fshatin Devnja, pastaj së andejmi në Ukrainë. Kjo shpërngulje nga Bullgaria për Ukrainë është bërë në shek. XIX.

Shqiptarët e Ukrainës deri më sot jetojnë në katër fshatra: Zhovetnjevoje – Karakurt, Devnjenskoe - Taz, Gamovka – Gjandran dhe Georgievka – Qushki. Fshati Karakurt është më i madhi ndër ta, që ndoshet në rrethinat e Odesës, nja 10 km larg qytetit të Bollgrad. Tre fshatrat e tjerë janë shumë afër njëri-tjetrit dhe gjenden në zonën e bregdetit Azov, afërsisht nja 10 km larg nga qyteti Melitopol.

Sot në Ukrainë jetojnë mbi 4.400 shqiptarë. Fshatrat janë heterogjene: me shumicë shqiptare, por edhe me bullgarë, ukrainas, rusë dhe gagauzë (turq). Shqiptarët që jetojnë në Ukrainë veten e quajnë *arnautë* dhe gjuhën e tyre *arnautçe*. Edhe foljen *flas* nuk e përdorin, por thonë *zallahit arnautçe* “flas shqip”.

Me historinë e shpërnguljes së shqiptarëve në Bullgari dhe së andejmi në Ukrainë janë marrë një numër studiuesh bullgarë, si L. Miletiç, D. Jaranov, V. Marinov dhe, sidomos, Bojka Sokollova, si edhe disa studiuesh rusë, si A. Skalkovskij, P. Kepen, N. Derzhavin, A. Desnickaja, L. Sharapova etj. Lubov Sharapova kishte botuar më 1990 një studim interesant me titullin Ngulimet arnautë në Bullgari e në Ukrainë. Më vitin 1996 në Shkup u botua monografia “E folmja e shqiptarëve të Ukrainës” nga bashkautorët Irina Voronina, Marina Domosileckaja dhe Lubov Sharapova.

Krahas shqipes që ka përdorim të kufizuar, këta dinë edhe rusisht. Edhe mësimin e ndjekin vetëm në rusisht. Nga viti 1995 ka nisur të dalë gazeta në gjuhën shqipe “Rilindja” me alfabetin e rusishtes, që ka ndihmuar zgjimin e vetëdijes etnike e kulturore.

Tiparet e së folmes së shqiptarëve të Ukrainës (në fonetikë):

1. Ka shtatë fonema zanore /i, e, a, ë, ëi, u, o/ dhe 35 fonema bashkëtingëllore.
2. Mungon fonema /y/. Në vend të saj përdorin fonemën /u/: *tu* (ty), *du* (dy), *su* (sy); në pozitë nistore shpeshherë me rrokjen *ju*, si *jull* (yll), që duhet të jetë nën ndikimin e gjuhëve sllave, bullgarishtes e rusishtes, që nuk e kanë zanoren /y/.
3. Monoftonguhën grupet [ua] > [u], [ye] > [e], [ie] > [i]: *gru* < grua, *du* < dua, *muj* < muaj, *kul* < kual, *kuaj*; *lun* < luaj, *luan*; *thu* < thua, *pus* < pyes, *kru* < krua, *dur* < dyer, *dill* < diell, *mill* < miell etj.
4. Ruhet /ë/-ja e e patheksuar si në toskërishten e moçme: *gëdhiet*, *të mbëdhenj*, *i ngroftë*, *të kositurtë*, *të zbardurtë*.
5. Ruhen grupet e vjetra [kl, gl, l'k, l'g], si në fjalët: *klumësht*, *klan*, *klinka* 'qenka', *gluhë*, *glu*, *a glatë* 'e gjatë', *zglidh*, *ulk*, *ndëlgon* 'dëgjon' etj.
6. Ruhet /l/ja e vjetër ndërzanore: *bilë* 'bijë', *golë* 'gojë', *fëmilë* 'fëmijë', *milë* 'mijë'.
7. Ruhen grupet [mb, nd, ng], por ndonjëherë reduktohen në [b, d, g], si *mbleth*, *vend*, *hengra*; *bë* 'mbë', *ga* 'nga', *dë* 'ndë' *doniherë* < ndonjëherë, *gaherë* < nganjëherë etj.
8. Shumëdridhësja /rr/ është zbutur në /r/: *rall* 'rrallë', *furë* 'furrë', *ëndër* 'ëndërr', *drasë* 'dërrasë', *ridh* 'rrjedh'.
9. bashkëtingëlloret fundore shurdhohen
10. Bashkëtingëlloret /h/-ja nuk shqiptohet fare në asnjë pozitë: *ajvan* 'hajvan', *she* 'sheh', *i ftohtë* 'i ftohtë', *i ngrohtë* 'i ngrohtë'.
11. Bashkëtingëlloret [f] nistore kalon në [h]: *hort* 'fort', *hurrë* 'furrë'.
12. Bashkëtingëlloret ndërthembore [th, dh] shqiptohen si [t, d]: *i bardë* 'i bardhë', *a verdë* 'e verdhë', *artka* 'ardhka'. Ndonjëherë [dh]-ja këmbëhet në [ll]: *ullë* < udhë, *lle* < dhe, *lljetë* < dhjetë. Këto dukuri janë pasojë e ndikimit të gjuhëve sllave në takim.

Në fushën e morfologjisë kryesisht ka tipare të njëjta me toskërishten veriore. Nder veçoritë morfologjike tipike janë:

13. Disa emra femërore marrin mbaresën e shquarsisë së gjinisë mashkullore -i: *nuse* - *nusi*, *mace* - *maci*, *lule* - *luli*, *gole* - *goli*, *puse* - *pusi*.
14. Emrat që mbarojnë me -o (kryesisht të huazuar nga gjuhët sllave) trajtën e shquar e formojnë me mbaresën -u: *mamo* – *mamu*, *babo* – *babu*, *tato* – *tatu* etj.
15. Emrat e gjinisë asnjënjësore janë pakësuar: *ujtë*, *mishtë*, *mielltë*, *djathtë*, *brëmët* (brumët), *gjalpët*, *d'ullët* (dyllët), *leshtë*, *kr'utë* etj; por edhe si mashkullore me -i: *mishi*, *milli*, *gj'alpi* ose me -a (si femërore): *djama* (dhjama), *dulla*, *mjalta* etj.
16. Ruhet rasa vendore, ashtu si në disa të folme të toskërishtes: *bishttë*, *ulktë*, *baltët* etj., treguesit gramatikorë të rasës vendore janë mbaresa -t dhe parafjala -ni: *Lujtkan n'i udhët me pluhur*. *Aju sheh n'i ujtë të bukur çupë*. Mund të shoqërohet edhe me parafjalën *dënë* (nën): *dënë gurtë*.

17. paralelisht përdoren edhe format e vjetra të gjinisë asnjëanëse të emrave të artikujve ushqimorë edhe forma në gjininë mashkullore: mishtë - mishi, miellte – milli
18. Mbiemri (përcaktori) përdoret para emrit si në gjuhët sllave: *i bukur trim* ‘trim i bukur’, *a bukur çupë* ‘çupë e bukur’, *plak nari* ‘njeri plak’, *plakë gru* ‘grua plakë’ etj.
19. Bashkëjetesa në mjedise në fillim bullgare e pastaj ruse ka kushtëzuar depërtimin e shumë fjalëve sllave në të folmen shqipe të Ukrainës. Ndikim të madh këto gjuhë kanë edhe në strukturën sintaksore e në fjalëformim. Ka edhe mjaft huazime nga turqishtja, të futura nga e folmja e gagauzëve.

Shqiptarët e Ukrainës e kanë shumë vështirë të ruajnë identitetin e tyre. “Kur luaj me vëllanë tim, luajmë në shqip”, thotë një i ri. “Por kur jemi të gjithë bashkë, atëherë luajmë në rusisht”. Kur i kërkuam që ta prezantojë veten në shqip, ai pati vështirësi derisa nuk u ndihmua nga një grup grash më të vjetra.”

Zhovetnjevoje është vend unik në Ukrainë pasi që 60 për qind të banorëve të tij janë shqiptarë. Tjerët janë bullgarë dhe gagauzë, me etni turq, gjë që dëshmon se për këtë pjesë të Detit të Zi kanë pasur pretendime fuqi e kombësi të shumta. “Ne kemi shikuar televizione satelitore shqiptare, por nuk mund t’i kuptonim ato, sepse njerëzit në to flasin shumë shpejt dhe gjuha e tyre ka evoluar në këto 200 vjetët e fundit”, shton Kirpik.

Komuniteti bullgar i Ukrainës, i cili numëron rreth 140.000 qytetarë dhe është i përqendruar në rajonin e Odesas, ka lidhje të ngushta me Bullgarinë. Ai merr ndihma nga organizata të cilat përkrahin kulturën bullgare, gjuhën dhe shkollimin në të gjitha nivelet, ndërsa që në tërë Ukrainën ka qendra të shumta kulturore bullgare.

Shumica e gagauzianëve, me etni turke dhe me fe ortodokse, jetojnë në afërsi të Gagauzisë, pjesën e cila mëton të shkëputet nga Moldavia dhe ndodhet në anën tjetër të kufirit, ku mund të udhëtojnë me lehtësi. Por, disa mijëra shqiptarë të Ukrainës kanë qenë larg vatrës së tyre për më shumë se 200 vjet, të shkëputur nga shqiptarët e Ballkanit. Megjithatë, ata tani nuk janë më të grumbulluar vetëm në lagjen shqiptare të Zhovetnjevoje (Albanskaja Mahala).

Ky komunitet ka shfrytëzuar internetin për t’u lidhur me komunitet e tjera të shqiptarëve në Ukrainë, si dhe me Kosovën dhe me Shqipërinë, duke u përpjekur kështu që të edukojë gjeneratën e re të shqiptarëve në vend lidhur me kulturën dhe gjuhën e vet.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Shikojeni dokumentarin Mbijetesa e shqiptarëve të Ukrainës, pjesa 1, 2, 3, 4, 5 në <http://www.youtube.com>.
2. Lexojeni monografinë I. Voronina, M. Domosileckaja, L. Sharapova “E folmja e shqiptarëve të Ukrainës”, Shkup, 1996 dhe shkruani një recension për të.

8.6. E FOLMJA E KELMENDASVE TË PESHTERIT

Kelmendasit e Peshterit (afër Novi Pazarit, trevë që gjendet në jugperëndim të Serbisë, midis qyteteve Novi-Pazar, Sjenicë dhe Bello-Polje në Sanxhak) janë me origjinë nga Malësia e Madhe, rrethi i Shkodrës. Edhe këta pas ekspeditave të shumta ushtarake të perandorisë Osmane, më vitin 1700 u shpërngulën nga trojet e stërgjyshërve. Tani në qarkun e Tutinit dhe të Sjenicës ka rreth 600 shtëpi shqiptare të shpërndara në 14 fshatra) etj. Pra, në vitin 1700 a 1702 me banorë të shpërngulur nga krahina e Kelmendit të Malësisë së Madhe, u formua në skajin jugperëndimor të Serbisë, në kufi me Malin e Zi, vendbanimi shqiptar i Peshterit me 14 fshatra. Për këtë të folme shqipe monografi kanë hartuar Latif Mulaku e Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, botuar në Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275-325.

Tipare fonetike të së folmes së Peshterit:

E folmja e shqiptarëve të Peshterit në përgjithësi ka po ato dukuri fonetike e morfologjike si të folmet e Shqipërisë Veriperëndimore, me të folmet e Malësisë së Madhe, duke u përputhur sidomos me të folmen e Kalmendit.

1. Ka serinë e fonemave zanore të shkurtra dhe të gjata, si në çiftet e fjalëve: *plak* (gj. m.) ~ *pla:k* (gj. f.), *grosh* (lloj monedhe) ~ *gro:sh* (fasule).
2. Ka zanore hundore: *pë, frë, mët* (mendt), *pës, hÿ, drÿ, hÿ, sÿ, drÿ* etj.
3. Theksi te disa fjalë të huazuara orientale, si në mbarë gegërishten, është parafundor (paroksiton): *pásha, bába, híle, tenéqe*; si dhe te disa fjalë shqipe: *véri, njéri, kállli* etj.
4. E ruan zanoren /y/, si në fjalët: *bylbyl, tym, hyp, zhryp, krypa, rryp*; por dalin edhe me [i]: *tim, hip, zhdrop*.
5. Grupi [ua] përdoret më shpesh: *kan varrua, me shkua, u plagua, grua, e kan fejua, me gatua, me çua, me gjallua*; por është vënë re se del edhe grupi [ue], si në fjalët: *luejshin, knues, dy duer, me ruejt*.
6. Edhe grupet [ye], [ie] dalin të pamonoftonguara: *krye, me lye, kryen pu:n; miell, diell, qiell, bërziej*.
7. Bashkëtingëllorja /h/ shqiptohet në çdo pozicion, si në fjalët: *hap, ha, hahet, hjek, i huaj, harroj, hekur, i holl; plehnua, ahi, krahi, shohëm, Hasan, me grah, sheh, e njeh, groh* (ngroh) etj.
8. Bashkëtingëlloret mesgjuhore [q, gj] përgjithësisht dallohen mirë, por ndonjëherë shqiptohen si afrikate: *qeni, zoqt, qaf, qashtu; gjarpën, gjasht, gjyshi*; por edhe me shqiptim më të përparmë, si *çeni, çaf, çashtu; xharpën, xhasht, xhyshi*.
9. Dallohen mirë bashkëtingëlloret dridhëse [r] e [rr]: *drresa, thrras, rrok, therra, furra, rrethoj, burri*.
10. Ruhen mirë edhe ndërthëmboret [th, dh]: *thika, thrras, thot, katërdhe:t*.
11. Grupet e moçme [kl, gl] kanë dhënë [kj, g-j]: *me kjën, kjofsha, shkja, kjaj, shkjet; g-juha, g-jasa*; por edhe *kofsha, ke kën, guha*.

12. Grupi [lk] del në formën [jk], si *ujk, ujqit*.
13. Grupet konsonantike janë thjeshtuar në bashkëtingëllore të thjeshta. a) Në këtë të folme grupi [mb] ka dhënë [b] ose [p]: *bledh* (< mbledh), *bathin* (< mbathin), *baroj* (< mbaroj), *breti* (< mbreti); *ka pet* (< ka mbet), *me piell* (< me mbiell), *pas* (< mbas). b) Grupi [nd] > [d] e [t]: *katudi* (< katundi), *mudi* (< mundi), *dimon* (< ndihmon), *ãdërr* (< andërr); *me kuvët* (me kuvendë), *tryshe* (ndryshe), *vet* (vend), *tat* (tand), *tesh* (ndesh). c) Grupi [ng] ka dhënë [g] ose [ŋ]: *me grãn* (me ngran), *thigilli* (thëngjilli), *garkon* (ngarkon); *me hanjër* (me hangër), *shtërroj* (shtërngoj), *shllunja* (shllunga, tosk. shtëllungë) etj.
14. Grupi [fsh] ruhet i plotë: *fsheh, fshaj, fshijm, kjo fsha*.
15. Në dallim nga të folmet e tjera të gegërishtes, bashkëtingëlloret e zëshme në pozitë fundore absolute të fjalës shurdhohen (si në të folmet e Jugut): *elp* (elb), *garth* (gardh), *rop* (rob), *erth* (erdh), *zok* (zog), *i math* (i madh).

Tiparet morfologjike:

16. Emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në *-h*, gjatë shquarsisë marrin mbaresën *-i*: *krah-i, ah-i, pleh-i, teh-i, Salih-i*; kurse emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në *-k* dhe *-g*, marrin mbaresën *-u*, si: *miku, zogu, turku*.
17. Disa emra të gjinisë mashkullore në këtë të folme përdoren në gjininë femërore: *nera, pylla, shmeta*.
18. Është karakteristik (shumë i shpeshtë) shumësi i emrave të gjinisë mashkullore me mbaresën *-a*, si në mbarë gegërishten, si: *lepura, pusa, grushta, jetima, oficera, nipa, bishta, doktora* etj.
19. Emrat mashkullorë që në emëroren e pashquar mbarojnë me zanore të theksuar (tipi vlla) në kallëzore marrin mbaresën rasore *-n*: *vllan, kan, thin, dhen, shkjan* etj. Emrat që mbarojnë me *-ua* (tipi prrua) në rasën kallëzore nxjerrin bashkëtingëlloren e temës *-n* dhe marrin mbaresën *-in*: *prronin, zanin, mullinin, drunin, synin* etj.
20. Përemri unë ruhet në formën e vjetër: *u* dhe *un* (shumë rrallë edhe *une*).
21. Format e rasës gjinore-dhanore të përemrave dëftorë ai, ajo, ky, kjo marrin edhe shtesën *-na*: *asajna, atina, ksajna, ktina*.
22. Përemrit dëftor i shtohet treguesi “qe”: *qeky, qekjo, qata, qato* (qe+ky, qe+kjo, q+ata, q+ato), dukuri mjaft e përhapur në gegërishten verilindore dhe qendrore.
23. Koha e ardhme në Peshter formohet në dy mënyra: a) kam + paskajore: *kam me ardh pej bjeshke; kam me dhãn, ke me ddir*; dhe b) do + paskajore: *un do me shkua, u do me da, a do me ble gjã*.
24. Paskajorja del në formën tipike gege: me + pjesore e reduktuar, si me *korr, me bledh, me dhez, me bërzie, me gjet, me shkua, me çua, me da* etj.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ku gjendet Peshteri?
2. A ka shqiptarë atje? Prej nga dhe kur kanë migruar?
3. Lexojeni studimin Latif Mulaku - Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, botuar në Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275-325.
4. Nëse ju jepet rasti, vizitoni ndonjë nga fshatrat e Peshterit me shqiptarë. Shkruani për gjuhën, traditat, folklorin, zakonet, dasmat e tyre etj.

8.7. SHQIPTARËT E TURQISË

Shqiptarët e Turqisë, për nga numri dhe për nga shtrirja, paraqesin ngulimin më të madh të shqiptarëve jashtë territoreve kompakte shqiptare. Deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore në Thracën turke kanë qenë dhjetë fshatra shqiptare, nga të cilat tri (Aftoni, Klazaki, Marmara) në breg të detit Marmara dhe shtatë të tjera (Aballar, Karahakli, Alituntash, Bazar-Dere, Ibrik-Tepe, Mandriç, Sulltan Koei, Zalof) në qarkun e Edrenës. Popullsia e këtyre fshatrave, duke qenë e besimit ortodoks, u depërtua në Greqi, kur u bë shkëmbimi i popullsisë midis Turqisë dhe Greqisë (Milaj: 1944, 120; Islami: 1994, 194).

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore u shpërngulën në Turqi 250.000 shqiptarë, po kështu, edhe në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, edhe 250.000 shqiptarë të tjerë. (Hoxha: 1976, 7-8).

Eqrem Çabej, lidhur me shqiptarët e Turqisë, ka shkruar: “Kolonja e Turqisë është sot elementi etnikisht më i rëndësishëm nga gjithë ngulimet shqiptare jashtë atdheut” (Çabej: 1967). Ata i gjen të grumbulluar në fshatra të tërë dhe në lagje të veçanta të qyteteve të mëdha, po edhe të shpërndarë në tërë Turqinë (Bahri Beci, Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Dituria, Tiranë, 2002, f. 12-13).

Si pasojë e doktrinës së shenjtë serbe për spastrimin etnik të shqiptarëve dhe si pasojë e migrimit shqiptarë gjatë kohës së perandorisë Osmane, një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kanë marrë shtetësinë e Turqisë pas krijimit të saj. Për shkak të mungesës së regjistrimit të popullsisë sipas përkatësisë etnike, numri i shtetasve turk me prejardhje shqiptare nuk mund të dihet saktësisht. Si do që të jetë, dihet se në Turqi sot jetojnë shumë shqiptarë që kanë migruar nga të gjitha viset e Ballkanit. Sipas të dhënave të Wikipedias në Turqi ka rreth 5 milionë shqiptarë. (<http://sq.wikipedia.org>).

Shqiptarët i gjen kudo në tërë porët e jetës turke, sidomos në poste drejtuese e komanduese si në aparatit shtetëror, në ushtri, në polici, në ekonomi, industri e tregti, në arsim dhe kulturë dhe ata gëzojnë respektin e mbarë popullsisë. Të përmendësh emrin shqiptar në Turqi, si dje dhe sot, është sikur të përmendësh një emër të shquar, të nderuar, me reputacionin më të mirë që mund të bëhet. Në tërë shtetasit e popullsisë, pavarësisht nga niveli shoqëror apo raca dhe në gjithë popullsinë e Republikës Turke, s’ka rëndësi përbërja etnike e saj, të thuash “arnaut” d.m.th. të kujtosh një emër me peshë të madhe, njerëzore që gëzon një respekt jo të zakonshëm.

Shqiptarët e Turqisë janë një potencial i jashtëzakonshëm sasior (përbëjnë numrin më të madh të shqiptarëve në botë) dhe cilësor dhe si të tillë kanë një mision fisnik të trefishtë (ndonjë segment i të cilit vjen natyrshëm nga shekujt), së pari, të kontribuojnë maksimalisht për vendin ku jetojnë e punojnë, Turqinë; së dyti, të shërbejnë si urë e fuqishme jo thjesht miqësie por vëllazërie midis Turqisë dhe vendeve shqiptare në Ballkan dhe, së treti, të shërbejnë në një mënyrë ose tjetër si një mbështetje dhe një lloj “leve Arkimedi” për zhvillimin e përparimin e krejt kombit shqiptar, mjafton që vendi amë mos mbetet i painteresuar ndaj tyre, siç e ka bërë deri më tani dhe të kujdeset për emancipimin e vazhdueshëm, sidomos shpirtëror, të tyre.

Arkivat e Turqisë mund të hedhin dritë mbi shqiptarët për pesë shekuj. Institucionet shqiptare, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kanë mungesë të ekspertëve osmanologë, të cilët merren me hulumtimin e dokumenteve të periudhës osmane. Udhëheqës të këtyre institucioneve thonë se ka miliona dokumente që u dedikohen trojeve shqiptare nëpër arkivat e Turqisë, të cilat duhet të përkthehen nga osmanishtja. Periudha pesëshekullore nën Perandorinë Osmane, është periudha më pak e studiuar, për shkak të mungesës së ekspertëve të kësaj fushe.

Historia e popullit shqiptar ende nuk është e kompletuar, duke ditur se në arkivat shtetërore të Turqisë ekzistojnë miliona dokumente të paeksploruara dhe të cilat flasin pikërisht për trevat dhe popullin shqiptar. Historianë e osmanologë shqiptarë, thonë se ka mungesë të osmanologëve dhe ekspertëve të kësaj fushe, të cilët duhet të merren me këto hulumtime, për të nxjerrë në dritë të dhëna dhe fakte që i përkasin popullit shqiptar për pesë shekuj nën Perandorinë Osmane. Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, kanë marrëveshje bashkëpunimi me Turqinë, për qasje në arkivat e tyre, në mënyrë që historianët të bëjnë hulumtime shkencore të asaj periudhe (<http://www.mesazhi.com>).

Edhe gjuha e shqiptarëve të Turqisë siguron material shumë të rëndësishëm e të dobishëm, sidomos për studime sociolinguistike.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Shikojeni dokumentarin Molla e kuqe Dokumentar (pjesa 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9) në <http://www.youtube.com>
2. Shikojeni incizimin e Radio Televizionit të Kosovës, Me Shqiptarët e Turqisë (2) 4/1, 4/2, 4/3, 4/4 postuar në <http://www.youtube.com>
3. Nëse do të keni mundësinë, vizitoni ndonjë vendbanim me Shqiptarë në Turqi dhe shkruani për çështje që lidhen me ta.

KREU IX

9. MARRËDHËNIET E DIALEKTEVE ME GJUHËN STANDARDE

Gjuha jeton përmes dialekteve, që janë limfa e jetës së saj. Kjo e vërtetë megjithatë shpesh harrohet dhe dialektet shihen si një shfaqje „historike“ dhe e tepërt, që njeriut modern nuk i duhet. Sidomos në kohën tonë të globalizimit dhe masmediave dialektet shumëkund janë në tkurrje dhe shuarje të plotë. Në rast se, në globin tonë çdo dy javë shuhet një gjuhë, sikundër e nxirrte një studim amerikan i para disa muajve, dialektet mund që ndoshta treten dita-ditës. E prapëseprapë askush nuk mund të thotë se ka rënë kambana e dialekteve ose të folmeve të veçanta dhe se njeriu modern nuk do t'i rikthehet edhe në këtë pikë asaj çka i kanë lënë trashëgim shekujt (shkruan Ardian Klosi, në një artikull në faqen e internetit: <http://www.forumishqiptar.com>).

Gjuha dhe dialektet janë në lidhje të krahasueshme me atë të rrënjës me trungun e degët e një peme, d.m.th. degëzimeve të mëdha, të përbëra nga degëza e filiza a bisqe më të holla, deri tek njësia më e vogël apo më e imët e mundshme, që është e folmja e individit apo idiolekti (Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 26).

Nga pikëpamja gjuhësore dialekti nuk ka dallime nga gjuha: *secili dialekt i shqipes, i marrë në vetvete, qoftë gegërishtja, qoftë toskërishtja, mund të quhet gjuhë shqipe*. Vetë gjuha letrare kombëtare nuk është tjetër veçse një dialekt që është përkrahur dhe është ngritur në përdorim nga i gjithë kombi, nga e gjithë bashkësia shoqërore përkatëse. Fjala vjen, frëngjishtja standarde është ngritur mbi të folmen e Parisit (kryesisht i të folmes së II të Francës), i cili për hir të forcës qendëruese të kryeqytetit, u shtri dalëngadalë në gjithë territorin e Francës. Maqedonishtja standarde ka për bazë të folmet e maqedonishtes qendrore, ndërsa bazë dialektore e shqipes standarde është toskërishtja veriore ose siç e thonë disa gjuhëtarë toskërishtja letrare e ngritur në standard (prof. Rami memushaj, prof. dr. David Luka në <http://www.forumishqiptar.com>).


Me gjuhë shqipe kombëtare nënkuptojmë shumësinë (tërësinë) e të gjitha ligjëtimeve të mundshme të saj: shqipen e letërsisë që nga dokumentet e shkrimet para të saj e deri në shkrimet e letërsisë bashkëkohore e në tekstet e çfarëdo lloji çofshin, shqipen dialektore: dialektet, nëndialektet e të folmet me vazhdimësi tokësore e gjuhësore dhe ato të diasporës si dhe shqipen standarde me të gjitha variantet stilistike. Pra, dialekt = gjuha e një krahine apo e disa krahinave së bashku; gjuha = tërësia e dialekteve dhe e varianteve gjuhësore të mbarë një populli, kombi.

Gjuha është një sistem i ndërlikuar mjetesh komunikative që përdoren në një bashkësi a kolektiv të dhënë shoqëror për të gjitha llojet e format e komunikimit, kurse *dialekti është vetëm një nga varietetet e shfaqjes së këtij sistemi e që kufizohet e përcaktohet nga tri aspekte*: aspekti gjeografik e shoqëror, aspekti funksional dhe aspekti strukturor (J. Gjinari - Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 43-44).

Prirja e hapërimit të ligjëritit krahinor drejt një varianti të përbashkët kombëtar. Me shkollimin në masë të shqiptarëve, me ndikimin gjithnjë e më të fuqishëm të medieeve, me lëvizjen tonë brendakombëtare gjithnjë e më të shpeshtë, me përzierje popullate krahinash të

ndryshme veçmas në qytete të mëdha, me pushimet e verës të shqiptarëve të Kosovës e Maqedonisë gjithnjë e më të shpeshta në bregdetin e Shqipërisë, me shkollimin e jo pak të rinjve jashtë krahinës (të Kosovës e Maqedonisë në Shqipëri e anasjelltas), me aktivitete tregtare e ekonomike brendakombëtare, me lidhje miqësore e martesore krahinash të ndryshme etj. gjithnjë e më tepër po intensifikohet procesi rrafshues i dallimeve dialektore.

Çhundorëzimi i zanoreve, zbehja e vlerës fonologjike të zanoreve të gjata, zvogëlimi i nuancave tingullore (alofoneve) të fonemave të njëjta, monoftongimi i diftongjeve dytësore në të folmet e gegërishtes qendrore, zëvendësimi i formave morfologjike vendore (lokale) me format e shqipes standarde si dhe shumë zhvillime të tjera rrafshuese, bashkë me ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore ndër ne (duke lënë anash disa thyerje të normës letrare në praktikën tonë gjuhësore), janë tregues të mirë se dialektet dhe gjuha shqipe përgjithësisht po ecën me hapa të shpejtë drejt njësimit gjuhësor kombëtar. Ky konvergjim i dialekteve të gjuhës sonë çdo ditë e më tepër po intensifikohet.



Ndikimet e huaja shfaqen sidomos në leksik dhe në ndërtimet sintaksore, por me punë të organizuar shkencore e hulumtuese ato mund të mënjanohej nga përdorimi. Leksiku i shqipes standarde karakterizohet edhe me prirjen për pastrimin nga fjalët e huaja. Kështu, janë nxjerrë nga përdorimi shumë fjalë me origjinë orientale, greke, sllave etj. Është ngushtuar edhe veprimi i prapashtesave e parashtesave të huaja me zëvendësimin e tyre me ato të shqipes (si, *-xhi*, *-çi*, *-llëk*, *anti-* etj., p.sh. *furrxhi* – *furrtar*, *sahatçi* – *orëndreqës*, *dembellëk* – *dembeli*, *përtaci*; *antitank* – *kundërtank*).

Në Evropën e Bashkuar, ky synojmë të hyjmë, gjuhët kombëtare duhet të bëhen të pajtueshme në nivelin e aftësive shenjuese e komunikuese. Duhet përcaktuar se si do të quhen në gjuhën shqipe shumë nocione dhe sende të botës së sotme, qoftë me fjalë shqipe ose të ndonjë burimi tjetër.

Planifikimi gjuhësor duhet bërë me ndërgjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja përdoren për një kohë më të

gjatë dhe më shpesh, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i gjuhës sonë letrare me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe.



Pyetje, detyra e ushtrime:

Shkruaj një artikull në temë: Marrëdhëniet e dialekteve me shqipen standarde.

9.1. BAZA DIALEKTORE E SHQIPES STANDARDE

Në nëtor të vitit 1972 u mbledh Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, tubim me përmasa kombëtare ku morën pjesë edhe studiues e përfaqësues të shkencës dhe të kulturës nga trevat shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe nga arbëreshët e Italisë, u mbeshtet dhe u miratua vija përbashkuese e ndjekur për drejtshkrimin dhe, pas këtij akti formal të ndërmarrë në një kongres shkencor, gjuha letrare shqipe e njësuar mbi bazën e variantit dialektor të toskërishtes (apo variantit letrar toskë) mori përhapjen e plotë kudo ku flitet e shkruhet shqip.

Në dhjetë vitet e fundit ndër temat më të nxehta, më të shpeshta, më të diskutueshme me larmi mendimesh e qëndrimesh, shpeshherë kundërtënjese janë: Cila është baza dialektore e shqipes standarde? Duhet apo nuk duhet të përmirësohet e të pasurohet standardi? Ky standard është vendim politik i kohës apo zgjidhje jopolitike e drejtë? Kush duhet bërë planifikimin gjuhësor e politikën gjuhësore? Çfarë duhet bërë që të përmirësohet niveli i zbatimit të standardit? A duhet shqiptarët të kenë dy standarde gjuhësore? etj. etj.

Në këto tema janë përfshirë të gjithë: gjuhëtarë, gazetarë, shkrimtarë, pedagogë e njerëz të të gjitha profesioneve të tjera. Trajtesa të çështjeve të këtilla e të ngjashme mund të gjeni të postuara në Internet, në mjetet e informimit publik (në formë të shkruar e të folur), në referime konferencash etj.

Në këtë leksion, nuk e marrim përsipër të japim as që mund të japim përgjigjen e duhur çështjeve madhore si këto më lart, por për nevojat e këtij teksti mësimor duam të sigurojmë pak të dhëna për bazën dialektore të shqipes standarde. Për të pasur një pasqyrë të bazës dialektore të shqipes standarde, pa i përfshirë elementet e përbashkëta të të dy dialekteve në shqipen e normuar, po paraqesim në mënyrë tabelore disa nga veçoritë kryesore të gegërishtes e të toskërishtes në fonetikë e fonologji, morfologji e leksik, duke i krahasuar me shqipen standarde:

<i>Gegërishtja</i>	<i>Toskërishtja</i>	<i>Shqipja standarde</i>
Në fonologji e fonetikë:		
1. ka zanore gojore dhe hundore (kam ~ kã:m)	ka vetëm zanore gojore (kam - këmbë)	nuk ka zanore hundore (kam - këmbë)

2. ka zanore të gjata me vlerë fonologjike (plak ~ pla:k)	nuk ka të tilla (plak – plakë)	gjatësia nuk ka vlerë fonologjike (plak – plakë)
3. /ã/-së hundore të theksuar (zã, nãn, hã:n)	i përgjigjet /ë/-ja gojore e theksuar (zë, nënë, hënë)	/ë/ gojore të theksuar (zë, nënë, hënë)
4. mungesa e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi i rrallë i të patheksuarës	prania e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi shumë i dendur i të patheksuarës	prania e /ë/-së së theksuar dhe përdorimi i dendur i të patheksuarës
5. grupi <i>ue</i> (u:) – grue	grupi <i>ua</i> (grua)	<i>ua</i> dhe <i>ue</i> (grua, mësues)
6. grupi nistor <i>vo</i> (voj, votër)	grupi nistor <i>va</i> (vaj, vatër)	grupi nistor <i>va</i> (vaj, vatër)
7. fjalë me /-n-/ ndërzanore (rãna, vëna, sÿni)	fjalë me /-r-/ ndërzanore (rëra, vera, syri)	shumë fjalë me /-r-/ ndërzanore dhe pak me /-n-/ ndërzanore
8. përngjashmimi i togjeve <i>mb > m, nd > n, ng > η</i>	ruajtja e tyre (mbush, nderoj, ngas)	ruajtja e tyre (mbush, nderoj, ngas)
9. mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshmeve në fund të fjalës	shurdhimi i të zëshmeve (i madh – i math, vend – vënt)	mosshurdhimi i të zëshmeve në fund të fjalës
10. ruajtja e kundërvënies fonologjike /r ~ rr/ (ruaj ~ rruaj, ara ~ arra)	mospërdorimi i /rr/-së (ruaj, ara)	ruajtja e kundërvënies fonologjike /r ~ rr/ (ruaj ~ rruaj, ara ~ arra)
11. [nj] > [j] ose [n] (rrãnja > rrãja, një > ni)	ruajtja e [nj]-së (rrënja, një)	ruajtja e [nj]-së (rrënja, një)
12. ruajtja e [h]-së (hãna)	mosshqiptimi i [h]-së (ëna)	ruajtja e [h]-së (hëna)
13. disa orientizma përdoren me theks në rrokjen parafundore (kãfe, tenëqe)	të njëjtat shqiptohen me theks fundor (kafé, teneqé)	ato shqiptohen me theks fundor (kafé, teneqé)
Në morfologji (në format gramatikore të fjalëve):		
1. plak-i, breg-i, krah-i	plak-u, breg-u, krah-u	plak-u, breg-u, krah-u
2. e hecmja, e shkrumja	të ecurit, të shkruarit	të ecurit, të shkruarit
3. i la:m, e lame	i larë, e larë	i larë, e larë
4. ka përemra vetvetorë (vetë, vetja, vetvetja)	nuk ka përemra të tillë	ka përemra vetvetorë (vetë, vetja, vetvetja)
5. ka pjesore të reduktuara, pa mbaresa (la:, ha:p)	ka pjesore të plota me mbaresë (larë, hapur)	pjesore të plota me mbaresë (larë, hapur)
6. e pakryera veprorë është sigmatike (punojsa)	e pakryera veprorë është asigmatike (puno-ja,-nja)	e pakryera veprorë është asigmatike (punoja)
7. e pakryera pësorë është analitike (u lajshna)	e pakryera pësorë është sintetike (lahesha)	e pakryera pësorë është sintetike (lahesha)
8. gegërishtja ka paskajoren gege (me punue)	ka lidhoren (të punoj) ose paskajoren toske (për të punuar)	këtë e shpreh me lidhoren (të punoj) ose paskajoren (për të punuar)
9. ekzistojnë forma të dyta të së shkuarës (kam, kisha, pata + pas + punu)	nuk përdoren forma të tilla të dyta (por: kam, kisha, pata + punuar)	nuk përdoren forma të tilla të dyta (por: kam, kisha, pata + punuar)
Në leksik (fjalë të ndryshme që përdoren për një send, një frymor etj.):		
katun	fshat	fshat, katund
tamël	qumësht	qumësht
dhelapën	skile	dhelapër
gjã, hajvan	kafshë	kafshë

u:dh	rrugë	rrugë, udhë
krye	kokë	kokë, krye
katërdhet	dyzet	dyzet
tly:n	gjalpë	gjalpë, tëlyen
tinëz	fshehurazi	fshehurazi
rrej	gënjej	gënjej

*Tiparet fonologjike, fonetike, morfologjike e leksikore midis dy dialekteve të shqipes
krahasuar me shqipen standarde*

Është fakt i pamohueshëm që varianti standard i shqipes është ngritur mbi bazën e fonetikë-fonologjisë e të morfologjisë së variantit toskë (apo variantit letrar toskë), por në fazën e tanishme të zhvillimit shqipja standarde përfaqëson variantin më të përpunuar për shumë vjet nga gjithë shqiptarët dhe tani ajo është shumëfish më e pasur, më e gjerë dhe ka kapërcyer jo vetëm bazën dialektore toske, por gjithë shqipen dialektore; e ngritur në nivel të lartë që të përmbushë të gjitha nevojat e shoqërisë shqiptare në të gjitha veprimtaritë shoqërore, si në arsim, në shkencë, në kulturë, në art, në teknikë e në çdo pore të jetës dhe e denjë të përballet me gjuhët më të lëvruara të Evropës. Me fjalë të tjera, **vetëm baza nyjëtimore e shumica e formave morfologjike të shqipes standarde janë toske**, por kjo bazë është mbindërtuar në të gjitha fushat e tjera, si p.sh. në leksik (janë krijuar fjalë të reja, janë huazuar terme, fjalë e frazeologjizma librorë; janë pranuar shumë fjalë e shprehje nga gegërishtja e nga krijimtaria letrare etj.), në sintaksë etj. Dialektet realizohen vetëm në formën e folur, kryesisht në stilin e shkujdesur dhe në stilin bisedor; ndërsa varianti standard realizohet përveç në formën e folur edhe në formën e shkruar, përveç në ligjërimin bisedor edhe në ligjërimin libror nëpërmjet stileve funksionale. Në shqipen standarde janë përvijuar pesë stile funksionale: a) stili i veprimtarisë shkencore e teknike; b) stili i veprimtarisë shtetërore e administrative; c) stili i veprimtarisë shoqërore e politike; ç) stili i veprimtarisë letrare artistike; d) stili i veprimtarisë fetare.

Natyrisht në këtë gjuhë standarde kombëtare të njësuar kanë hyrë dhe do të hyjnë vijimisht edhe jo pak elemente të gegërishtes, dhe ky është proces i pashmangshëm i bashkëveprimit dhe i shndërrimeve të bashkësisë shoqërore shqiptare në kushtet e reja gjeopolitike, historike, kulturore, demografike, përbashkuese e globalizuese. Do të na duhet një standard që di të vërë në punë të gjitha forcat e brendshme, për t'u rigjeneruar vazhdimisht e për të ofruar një larushi formash shprehëse, si mekanizëm mbrojtës ndaj ndikimeve të jashtme të gjuhëve të huaja.

Shqipja standarde duhet të ushqehet, të vishet, të lahet, të krihet e të jetë sa më afër e nën mbrojtjen, ngrohtësinë dhe përkujdesin amnor të mëmës së saj (toskërishtes) dhe tezës së saj (gegërishtes), meqë si njëra si tjetra do t'i japin më të mirën që kanë nga vetja, deri sa të shkrihen në bijën e tyre dhe nuk do ta tjetërsojnë kurrë. Në fakt nuk mund të kemi pasurim të vërtetë të standardit e as jetëgjatësi të standardit (rrjedhimisht edhe të shqipes) nëse nuk do ta ushqejmë atë nga rrënja e saj, por nga gjethet (gjuhët e huaja). Nga ana tjetër, standardin duhet ta përdorin të gjithë: mësuesi, mjeku, politikani, bujku... Nëse standardi do të largohet shumë nga nëna e saj, nga gjuha popullore, atëherë do të krijohet një gjuhë artificiale, e rëndë për ta zbatuar në veprimtarinë e në jetën tonë të përditshme, dhe kjo mund të sjellë pasoja të padëshirueshme, të dëmshme për ekzistencën e shqipes e të shqiptarëve.

Çdo element dialektor, toskë apo gegë është shumë më i mirë e më i padëmshëm për shqipen standarde sesa cilido element i huaj. Kjo mund të jetë e krahasueshme edhe me gjuhët sllave: maqedonishtja, bie fjala, ka huazuar e huazon vazhdimisht fjalë nga serbishtja, rusishtja, bullgarishtja e nga gjuhët e tjera simotra, por ato përshtaten aq mirë me sistemin gjuhësor të gjuhës marrëse saqë elementet e huaja leksikore nuk hetohen fare se janë trup i huaj. Në këtë pikëpamje, gegërishtja e toskërishtja, përfshirë edhe të gjitha shkrimet e deritashme në dialekte, janë shumë më të afërta e më të përshtatshme për t'u normuar, sesa futja e elementeve të gjuhëve të huaja (anglishtes, frëngjishtes, italishtes) në variantin standard të shqipes. Elementet e njëjta, të ngjashme a të përafërta që i shtohen një tërësie e ruajnë dhe nuk e prishin identitetin e saj, ndërsa elementet e huaja të shumta mund të ndërrojnë edhe identitetin e diçkasë. Kjo i ngjan edhe arnimit: për të zgjatur jetën rrobave, gjyshet e nënat tona qepnin arnin në vendin përkatës me ngjyrë më të përafërt me rrobën e grisur.

Planifikimi gjuhësor dhe politika gjuhësore. Planifikimi gjuhësor si çështje sociolinguistike nënkupton alfabetizimin e gjuhëve, problemet e caktimit të gjuhëve zyrtare, standardizimin e gjuhëve kombëtare dhe modernizimin e tyre. I fundit vjen stadi i modernizimit, që karakterizohet nga përpjekjet për ta bërë gjuhën tashmë të standardizuar të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Në përmbajtjen e planifikimit gjuhësor E. Haugeni, i cili e ka krijuar këtë term, përfshin “punën normëzuese të akademive dhe komiteteve gjuhësore, të gjitha format e kultivimit të gjuhës dhe gjithë propozimet për reformën ose standardizimin e gjuhës”. Planifikimi gjuhësor duhet parë si pjesë e planifikimit shoqëror. Ashtu si planifikimi shoqëror, që në përgjithësi është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave të zhvillimit për një shtet të caktuar, edhe planifikimi gjuhësor është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave gjuhësore për një bashkësi të dhënë (Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 325-326).

Për të bërë planifikimin gjuhësor ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 27 tetor 2004 në Tiranë, u themelua Këshilli Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe, që po mblidhet herë pas here; por, për çudi, pa praninë e asnjë shqiptari që gjallon e vepron jashtë Shqipërisë e Kosovës. Disa nga vendimet e marra dhe rezultatet e arritura janë bërë publike edhe për opinionin.

Asgjë në botë nuk është absolute, e paprekshme, e papërmirësueshme, e pandryshueshme. Pikërisht edhe zhvillimi i teknikës e i teknologjisë, i shkencës dhe i njerëzimit në përgjithësi mbështetet në përpjekjet që të arriturat e brezave të mëparshëm të përsosë, të përkryejë, të mbindërtojë e të përditësojë gjërat. Çdo herë njeriu ka qenë, është dhe do të jetë në kërkimin e së mirës, së përkryerës, së dobishmes. Nëse gjërat që jepen një herë, nuk ndryshohen kurrë, atëherë jeta dhe çdo veprimtari e njeriut do të ishte e pakuptimtë.

Në parim problemet kudo që hetohen, duhet zgjidhur me dashamirësi, me mençuri, qetë e shtruar. Po të anashkalohen e të mos zgjidhen në kohën dhe në mënyrën e duhur, ato mund të shtohen aq shumë, saqë çdo përpjekje për zgjidhjen e përnjëhershme “me shkopin magjik” të të gjitha problemeve të grumbulluara prej vitesh mund të dështojë.

Pikësynimi ynë duhet të jetë që shqipen standarde ta bëjmë të pranueshme e të lehtë për gjithë shqiptarët, pavarësisht nga përkatësia territoriale. Atë duhet ta përvetësojnë me lehtësi jo vetëm gjuhëtarët, por edhe mësuesit, gazetarët, nëpunësit, politikanët, nxënësit e moshave të

ndryshme etj. Do të duhej ta bëjmë të lehtë e joshëse për ta mësuar edhe të huajt. Në këtë kuptim, nuk kemi nevojë të përmbysim atë që është arritur deri më tani e të fillojmë nga e para, por të shohim mundësinë e përmirësimit të saj, duke vënë re sidomos problemet e zbatimit, në fakt të moszbatimit të normës.

Prirja për gegëzimin e shqipes standarde nga njëra anë dhe për hipertokëzimin e standardit nga ana tjetër janë dy kahe të kundërta, të dëmshme, prapakthyesë e të rrezikshme për unitetin e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar (Gjovalin Shkurtaç).

Shumica e intelektualëve shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të Rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme. E dëshirueshme është që rregullat e Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim.

Praktika e përdorimit të shqipes standarde në këto dyzet vjet dëshmon se shqipja, ashtu si të gjitha gjuhët e lëvruara, ka nevojë që t'i nënshtrohet periodikisht një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin e sistemit në të gjitha segmentet. Është e nevojshme që të shqyrtohen më tej disa rregulla të drejtshkrimit, me qëllim njësimin e tyre dhe shmangur edhe parregullsitë në shkrimin e të konfliktet e krijuara si pasojë e zbatimit të dy parimeve të ndryshme njëherësh (atij fonetik dhe atij morfologjik).

Leksiku i shqipes standarde është i hapur ndaj prurjeve nga dialektet, sidomos nga dialekti gegë dhe nga autorët e traditës letrare në këtë dialekt. Duhet të vazhdojë puna për pasurimin e leksikut me krijime të reja sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, si dhe për pastërtinë ndaj huazimeve të panevojshme.

Të thellohet puna për pasurimin, njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë në të gjitha fushat. Në sistemin morfologjik, të rishqyrtohet formimi i shumësit të emrave, për një saktësim të mëtejshëm paradigmatic, duke synuar njësimin dhe shmangien e përjashtimeve të shumta.

Në nxënien e shqipes në shkollë, në të gjithë hapësirën shqiptare, po shfaqen vështirësi dhe probleme, ndaj gjithandej propozohet të ngritet kultura e gjuhës, të përmirësohen programet mësimore, tekstet shkollore, të përdoren metoda bashkëkohore të mësimdhënies, të bëhet aftësimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës amtare etj.



Pyetje, detyra e ushtrime:

Lexojeni tekstin e mësipërm me vëmendje dhe vlerësoni të dhënat me shenjat e dhëna në tabelë. Në kompjuter skiconi një tabelë si kjo më poshtë dhe shkruani shkurtimisht faktet në kolonat përkatëse.

(√)	(-)	(+)	(?)
E dija	Nuk pajtohem me këto fakte	Sot mësova	Dua të di më shumë për:
1.	1.	1.	1.

2.	2.	2.	2.
3.	3.	3.	3.
4.	4.	4.	4.
5.	5.	5.	5.
6.	6.	6.	6.

9.2. UNITETI DHE VARIACIONI HISTORIK, TERRITORIAL, STILISTIK DHE SHOQËROR I GJUHËS SHQIPE

Në çdo gjuhë ka laramani gjeografike, sociale e stilistike. Ato nuk janë gjuhë të veçanta, por, variante të ndryshme të një gjuhe të përbashkët. Dialektet janë dukuri shoqërore që shfaqen për shkak të ndryshueshmërisë territoriale të gjuhëve. Gjuha standarde është fryt i marrëveshjes mes një grupi njerëzish në një kohë dhe në rrethana të caktuara historike. Edhe gjuha dialektore dhe ajo standarde kanë varietetet e tyre. Dialektet shfaqen të larmishme nëpër vende të ndryshme, ndërsa gjuha standarde shfaqet e larmishme në ligjërimi (të shkruar e të folur: në ligjërimin e shkujdesur, bisedor dhe në ligjërimin libror) dhe në stile funksionale (në stilin shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror, stilin e letërsisë artistike dhe në stilin fetar).

Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashtershme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme.

Ligjërimi nuk është aktualizim i thjeshtë i sistemit të gjuhës, por ai realizohet në kohë, në hapësirë e në kushte të caktuara historike-shoqërore nga individët. Ai është i shumëllojtë. Në të pasqyrohen: përkatësia shoqërore, mjedisi gjeografik, shkalla e arsimimit, temperament, karakteri, dëshira, d.m.th. një sërë faktorësh shoqërorë e psikofizikë që ndikojnë në të folurit tonë.

Një njeri flet sot shqip: ose në gjuhën standarde, ose në dialekt, ose në gjysmëdialekt në një fushë veprimtarie (në biseda të zakonshme, në shkencë, në letërsi, në politikë, në fe etj.) me njerëz të ndryshëm (me anëtarë të familjes, shokë, nxënës, shkencëtarë, administratorë etj.) për ndonjë qëllim të caktuar.

Gjuha shqipe tashmë është formuar si gjuhë letrare kombëtare e njësuar ose si standard i përgjithshëm me norma të ngulitura në të gjitha nënsistemet e saj. Ajo ka arritur në këtë shkallë në një rrugë të vështirë e të gjatë, duke i bërë ballë ndikimit të huaj asimilues, duke kapërcyer ndarjen dialektore dhe duke zhvilluar trajtat e saj të përbashkëta.

Ngulitja e gjuhës standarde, që ka një rrafsh të gjerë asnjans të kodifikuar, ka mundësuar që të dallohen më qartë sistemi i stileve: ngjyrimet e konotacionet, bashkëkohorja nga historikja, norma standarde nga krahinorja e zhargonet, të folurit nga të shkruarit. Kemi një shumësi të madhe burimesh gjuhësore që janë pasuri shprehëse të shqipes.

Shqipja e sotme është një tërësi:

1. variantesh **historike**,
2. variantesh **territoriale**,

3. variantesh **stilistike**, dhe
4. variantesh **shoqërore**.

Për studimin e këtyre larushive gjuhësore ka shkenca të veçanta. Me studimin e varianteve historike merret historia e gjuhës, me variantet territoriale merret dialektologjia, varietetet stilistike i studion stilistika, ndërsa larushitë shoqërore i studion sociolinguistika.

Gjuha standarde është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të civilizimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar. Ajo është bërthamë me strukturë të qëndrueshme, ndërsa realizimet e saj historike e të sotme janë variante. Variacioni është i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës. Tipat e varianteve dallohen për arsye të ndryshme.


1) Arsyeja e parë e larmisë është **ndryshimi historik** i gjuhës në rrjedhë të kohës: **ilirishtja - shqipja e vjetër - shqipja e mesme - shqipja e re**. Kështu, shqipja arkaike ose protoshqipja njëjtësohet me ilirishten. Shqipja e vjetër vjen deri në shek. VIII-IX, kur ishin degëzuar dy dialektet e saj kryesore (më së voni deri në shekullin X). Shqipja e mesme (e mesjetës) vjen deri në shek. XVII dhe quhet *arbërishte*. Me librin e Gjon Buzukut më 1555 na shfaqet si variant kryesor gjuha e autorëve të vjetër. Shqipja e re flitet nga shek. XVIII e deri në ditët tona dhe tashmë njihet me emrin gjuha shqipe. Në shqipen e re dallojmë tri faza zhvillimi:

- a) periudha e Pararilindjes (shek. XVIII),
- b) periudha e Rilindjes (afërsisht periudha midis viteve 1820 - 1920) dhe
- c) faza e shqipes së sotme (pas vitit 1920 e deri më sot).

Shqipja mund të degëzohet edhe në:

- a) periudhën Parakombëtare (që nga Buzuku - shek. XVI e deri më vitin 1920) dhe
- b) periudhën Kombëtare (nga Rilindja e këtej, përkatësisht nga viti 1920 e deri më sot).

2) Arsyeja e dytë e variacionit gjuhësor është **përhapja gjeografike**: degëzimi dialektor i gjuhës. Variantet krahinore ose dialektet e shqipes kanë ndryshime kryesisht në fushën e fonetikës e të fonologjisë, pjesërisht në gramatikë e në leksik. Arbërishtja e shqiptarëve të Italisë në këtë vështrim është variant gjeografik e historik. Gjuha standarde është një variant kundrejt dialekteve. Dialektet përballë gjuhës standarde janë të papërpunuara në shkallë normative e kulturore.



Në rrethanat e lëvizjeve të mëdha ose të jetesës në mjedise shumëgjuhësore lindin edhe ndikime (interferenca) ndër-gjuhësore. Sot ka larushi të shqipes, të ndikuar nga gjuha joshqipe e mjedisit (shqipja në Greqi, Itali, Turqi, ShBA, Rumani, në Mal të Zi, në Maqedoni etj.).

3) Arsyeja e tretë për variacion gjuhësor është përdorimi i shqipes **në ligjërime dhe në stile funksionale**: në *formën e folur dhe të shkruar*. Gjuha lind dhe jeton në radhë të parë si gjuhë e folur, në trajtën gojore. Në një shkallë të caktuar zhvillimi të kulturës lind shkrimi, kështu që krijohet varianti i shkruar i gjuhës.

Në modelimet gjuhësore veprojnë shumë faktorë jashtëgjuhësorë (kushtet e komunikimit, format e komunikimit, sferat e veprimtarisë shoqërore etj.) dhe faktorë gjuhësorë (funksioni mbizotërues i komunikimit, norma ose qëndrueshmëria e përdorimit të gjuhës etj.). Këta faktorë mundësojnë ndarjen e parë të madhe në: stile ligjërimore ose **ligjërime dhe stile funksionale**.

Ligjërimet në gjuhën shqipe kanë dy variante kryesore: **ligjërimin e folur dhe ligjërimin i shkruar**. Varësisht nga shkalla e zbatimit të normave standarde, dallohen: a) **ligjërimi i shkujdesur** (*ligjërimi i thjeshtë*), që del jashtë normës, sepse e shkel dhe e shtrembëron atë; b) **ligjërimi bisedor** me respektimin relativ të normës standarde, dhe c) **ligjërimi libror** si shkalla më e rreptë e zbatimit të normës.

a) **Ligjërimi i shkujdesur** (apo ligjërimi i thjeshtë, thjeshtligjërimi) është ligjërimi i përditshëm i njerëzve të profesioneve e të krahinave të ndryshme, që nuk i përmbahen në të folur normës standarde, e shkelin ose e shtrembërojnë atë. Norma shkelet ose shtrembërohet në skajshmëri, saqë ky lloj ligjërimi del jashtë gjuhës standarde. Kjo është shkalla më e ulët respektimit të normës letrare. Ndikimi dialektor në këtë ligjërim është i madh, por dallohet nga e folmja krahinore a vendore.

Rastet më të shpeshta të ligjërimin të shkujdesur paraqiten në mjediset me përzierje të folmesh të ndryshme, te njerëzit e paarsimuar ose analfabetë. Liria e fjalës shpërdorohet edhe nga disa individë të pakulturuar që flasin ose shkruajnë fjalë të ndyra, fyese e fjalë të pahijshme shqiptohen me zë të lartë në rrugë, autobus e në lokale publike. Fjalë të huaja të panevojshme ose të ndyra ndonjëherë përdoren edhe në fjalosjet e njerëzve, në zënkat e politikanëve, polemikat e botuara në shtyp, në disa përkthime etj. Një ligjërim të shkujdesur përdorin edhe ata që hedhin poshtë tërësisht gjuhën standarde.

Në komunikimin e përditshëm norma shkelet edhe kur ka prirje për t'u veçuar si grup, duke e ulur qëllimisht nivelin e mirësjelljes e të komunikimit. Të tilla kanë qenë të folmet sociale e argotë (dogançja, purishtja, dalipbebcja), si *Sa e ke qepën?* me kuptimin "Sa e ke orën". Edhe sot ka grupe shoqërore me profesion të njëjtë që e ulin nivelin e të folurit deri në ligjërimin e shkujdesur, si disa punëtorë krahu, tregtarë, sportistë, ushtarë, nxënës, studentë etj.

Shumica e fjalëve të huaja që nuk kanë përhapje të gjerë dialektore, por përdoren vetëm në disa të folme ose në ndonjë krahinë, janë pasojë e ligjërimin të shkujdesur, sepse në fillim janë përdorur nga një grup njerëzish e pastaj janë përgjithësuar edhe te shumë të tjerë. Pra, orientalizmat, sllavizmat, italianizmat e barbarizmat e tjerë të panevojshëm në gjuhën shqipe janë pjesë e ligjërimin të shkujdesur, si *allahile, askerllëk, jazëk, hazër, hallall, hasret, helbete; struj, grejalic, reshenje, potvërd, izvod, uverenje, liçna kartë, dozvollë* etj.; *Kah shkon e merr me veti prekolicën (rimorkion)* në vend të thotë bashkëshorten. *Stallno, ni dajm vjen te une. Gjith ditën çistat e radit...*

Në ligjërimin e shkujdesur bëjnë pjesë çdo fjalë e fjali e shtrembëruar ose e përdorur pa vend. Kjo dukuri hetohet shpesh në shpalljet publike, në reklama, ftesa, në mbishkrimet e shitoreve, po edhe në disa mjete informative etj. P.sh. *Shpia shitet. Fëmit mos i lani 3 jav mbasi kan bër vaksinën e tuberkulozit. Më jep dy ashtu. Ai nuk e frekuenton rakinë. Unë nuk e aplikoj qepën. Sa ashtu që je. Sapun me rahat.*

Në këtë grup hyjnë edhe të gjitha sharjet, fjalët e shprehjet e rënda fyese, që nuk janë pjesë e normës letrare. Shformimet në nivele të ndryshme, universalizimi i përdorimit, barbarizmat, kalkimi dhe renditja e fjalëve sipas gjedhes së huaj janë shprehje e nivelit të ulët të kulturës së folësit, rrjedhimisht edhe e kulturës gjuhësore të tij.

b) **Ligjërimi bisedor** afrohet me ligjërimin e thjeshtë, se edhe këtu kemi lëkundje të normës letrare. Në jetën e përditshme, në familje e punë, në tregti, argëtim, lojëra, udhëtime etj. në komunikim të drejtpërdrejtë gjatë çfarëdo bisede përdorim ligjërimin bisedor. Pra, ligjërimi bisedor është varianti që merr gjuha letrare kur përdoret në të folur e biseda të lira, kur norma nuk ruhet plotësisht. Brenda ligjërimin bisedor mund të hetohen disa nënshtresa: gjysmëdialektet (nëpër qytete me kompaktësi gjuhësore, p.sh. në Dibër) dhe interdialektet (e folmja e qyteteve të mëdha gjuhësisht heterogjene, si në Elbasan, Prishtinë, Shkodër, Shkup etj.). Njeriu i njëjtë varësisht nga rrethanat, mund të përdorë herë ligjërimin libror e herë ligjërimin bisedor. Bie fjala, në një mbledhje pune pjesëmarrësit priren drejt të folurit letrar, po të njëjtit njerëz pas mbledhjes duke pirë kafe rëndom flasin në ligjërimin bisedor.

Ligjërimi bisedor, sikurse thjeshtligjërimi, është spontan dhe organizohet aty për aty. Përdoret nga kushdo që është shkëputur nga norma dialektore dhe ndodhet nën ndikimin e normës standarde. Por, te shumica e folësve të shqipes ende vërehet një mbetje e së folmes krahinore, sidomos në fonetikë e në disa trajta morfologjike. Thjesht, ky ligjërim është përzierje elementesh e të folmes vendore me ato të gjuhës letrare. Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme, por flitet edhe për çështje të tjera që u interesojnë bashkëbiseduesve.



Ligjërimi bisedor zbaton shumë parimin e ekonomizimit të gjuhës dhe prirjen për lehtësimin e shqiptimit. Ai udhëhiqet nga parimi “sa më pak mund”, sipas të cilit me sa më pak mund synohet të arrihen efektet e duhura.

Parapëlqehen trajtat më të thjeshta, më të shkurtra: ndërtohen fjali të shkurtra e shpeshherë të paplota, me mbisundim të bashkërenditjes, me renditje të lirë fjalësh, duke nxjerrë në krye pjesën më të rëndësishme; kuptimet e fjalëve nuk kanë ndonjë përpikëri të lartë, fjalët përdoren me ngarkesa emocionale dhe shprehje përforcuese. Kështu, nga ana fonetike përdoren lloje të ndryshme intonacioni (i rrafshët, ngjitur, zbritës ose i kombinuar), ndeshen tinguj të panyjëtuar qartë, [ë]-ja e patheksuar zakonisht nuk shqiptohet, tingujt këmbehen njëri me tjetrin, përngjashmohen (asimilohen) tingujt e grupet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve, fjalët dhe emrat e përveçëm cungohen, përdoren forma metatetike (me inversion), shpesh ligjërimi ndërpritet etj. Në ndikimin e emocioneve, për përkëdheli ose për përçmim ndodhin ndërrime të gjatësisë së zanoreve, të theksit etj.

Lëkundje të *trajtave morfologjike* vërehen në kohët e foljeve, në rasat, në shumësin e emrave etj. Në aspektin *sintaksor* fjalitë janë të thjeshta, kanë pak gjymtyrë, emri nuk merr dy e tre përcaktorë; dalin ndërtime të paplota, të papërfunduara. Renditja e fjalëve i nënshtrohet logjikës afektive, me zhvendosje sintaksore, sipas rëndësisë vihen në dukje disa kulme. Shpesh ka përsëritje për t'ia imponuar dëgjuesit qëndrimin. Përgjithësisht, ka një kondensim sintaksor e semantik. Në bisedën shqipe zënë vend të madh frazeologjizmat, pasthirrat, përsëritjet, mallkimet, urimet etj.

Leksiku bisedor karakterizohet me fjalët e jetës së përditshme, që emërtojnë gjëra konkrete (materiale). Fjalët përdoren me kuptimet e zakonshme, por shpeshherë marrin shumë kuptime dhe kuptim figurativ. Përdoren krahnorizma, huazime, sinonime, antonime; trope e figura stilistike (me shpesh krahasimi, epiteti, hiperbola, perifriza, ironia, sarkazmi, numërimi, apostrofa etj.). Të shpeshta janë edhe frazeologjizmat.

c) **Ligjërimit libror** (letrar) është më i përpunuari në pikëpamje të normës. Në këtë ligjërim norma letrare ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera, prandaj çdo shkëlqje e saj hetohet menjëherë. Ky në përgjithësi zbatohet në gjuhën e shkruar, por ka edhe variantin e folur.

Përdorimi i ligjërimin libror kërkon një përgatitje paraprake arsimore e kulturore si dhe një përvojë të nevojshme gjuhësore. Formës së shprehjes i kushtohet kujdes i veçantë, ndërsa përmbajtja jepet në imtësi, duke u mënjeluar përsëritjet dhe çdo gjë që është e panevojshme. Interpretimi i fakteve është logjik dhe i saktë, duke mos lejuar mundësi për keqkuptime. Ky lloj ligjërimi ka një prirje të përgjithshme për të përdorur trajta më të plota e më të zgjeruara, me fjali e periudha më të ndërlikuara. Mendimet ndërtohen me periudha që kanë fjali me marrëdhënie bashkërenditëse e nënrenditëse të shkallëve të ndryshme. Ky ligjërim kërkon shqiptim të saktë të zanoreve e të bashkëtingëlloreve si dhe të grupeve të tyre. Edhe rregullat gramatikore zbatohen me një rreptësi të dukshme, ku ruhen format normative të fjalëformimit.

Nevojat e ligjërimin libror shpeshherë plotësohen me anë të fjalëve të reja të krijuara (neologjizmave) si dhe huazimeve. P.sh. *brendashkruaj, nëndetëse, jashtëmartesor, i shumëkuptimshëm, gjysmërrafsh, keqtingëllim, përngjashmim* etj. Shumë fjalë e shprehje të leksikut abstrakt që karakterizojnë këtë ligjërim, përdoren edhe si terma në fusha të ndryshme të shkencës. Si rrjedhim, në këtë grup ka edhe fjalë të huaja e ndërkombëtare, si termat e teknikës, të mjekësisë, të filozofisë, të gjuhësisë etj. Në leksikonin e ligjërimin libror nuk zënë vend krahnorizmat e arkaizmat, as fjalët e zhargoneve ose mjeteve të tjera që nuk pajtohen me normën letrare.




Funksioni dhe përshtatja e ligjërimin sipas veprimtarive njerëzore është kriter për dallimin e pesë **stileve funksionale**:

- a) *stili i veprimtarisë shkencore e teknike*, ku funksion mbizotërues është kumtimi;
- b) *stili i veprimtarisë shtetërore e administrative*, ku funksioni i kumtimit bashkohet me funksionin parashkrues;
- c) *stili i veprimtarisë shoqërore e politike*, ku funksioni i kumtimit gërshetohet me atë ndikues;
- ç) *stili i veprimtarisë letrare artistike*, ku mbizotëron funksioni estetik;
- d) *stili i veprimtarisë fetare*.

4) Arsyeja e katërt e larmisë gjuhësore lidhet me faktin se ka **grupe të ndryshme shoqërore e profesionale**, që dallohen nga përdorimi i gjuhës. Argotë apo dialektet sociale ndryshojnë nga të folmet vendore në një pjesë të leksikut: duke përdorur fjalë me kuptim metaforik, duke i ndryshuar nga përbërja fonematike ose duke përdorur fjalë të huazuara; në mënyrë që ligjërimi i tyre të jetë i kuptueshëm vetëm pjesëtarët e atij grupi (zejtarë, nxënës, studentë etj.) dhe i pakuptueshëm për ata që nuk i përkasin grupit përkatës. Përveç përdorimeve të përgjithshme, ka edhe *variacione individuale* (idiolekte).

Si përfundim, po ritheksojmë se ligjërimi nuk është aktualizim i thjeshtë i sistemit të gjuhës, por ai realizohet në kohë, në hapësirë e në kushte të caktuara historike-shoqërore nga individët. Ai është i shumëlojtë. Në të pasqyrohen: përkatësia shoqërore, mjedisi gjeografik, shkalla e arsimimit, temperament, karakteri, dëshira, d.m.th. një sërë faktorësh shoqërorë e psikofizikë që ndikojnë në të folurit tonë. Një njeri flet sot shqip: ose në gjuhën standarde, ose në dialekt, ose në gjysmëdialekt në një fushë veprimtarie (në biseda të zakonshme, në shkencë, në letërsi, në politikë, në fe etj.) me njerëz të ndryshëm (me anëtarë të familjes, shokë, nxënës, shkencëtarë, administratorë etj.) për ndonjë qëllim të caktuar.

Përmbledhtas mund të thuhet se shqipja e sotme na shfaqet me tri varietete: me larmi funksionale – stilistike (në formën e folur dhe të shkruar), me larmi gjeografike (dialektore) dhe me larmi shoqërore (sociale). Gramatika përshkruese e sotme për objekt studimi ka gjuhën standarde (letrare) në përdorimin asnjans, d.m.th. gjithë mjetet gjuhësore dhe normat themelore që përcaktojnë marrëdhëniet e tyre. Me studimin e larushive funksionale merret stilistika, larminë gjeografike e studion dialektologjia, ndërsa larminë shoqërore – sociolinguistika. Këtë larushi të shqipes së sotme mund ta paraqesim si më poshtë:



Sot gjuha standarde shqipe, - si varianti më i plotë, më i përpunuar dhe me prestigjin më të lartë kulturor e shoqëror, - del në rrafshin mbarëkombëtar, ka përhapje në tërë kombin, ajo përdoret si nga shqiptarët brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë kufijve të saj.

Njëjtësimi gjithëkombëtar i gjuhës është i domosdoshëm. Prania e këtyre dy prirjeve të kundërta: *njëjtësisë* dhe *variacionit* është forcë lëvizëse e zhvillimit dhe e lëvrimit të gjuhës. Gjuha standarde merr përsipër rolin historik për t'iu përgjigjur kërkesave të unitetit e të variacionit. Nga njëra anë, ajo synon një normë sa më të ngulitur e më të përgjithshme; nga ana tjetër, ajo shfaqet me një sistem tërësor variantesh ligjërimore e funksionale. Vendosija e normës standarde sjell ngadalësimin e ndryshimeve strukturore, sidomos në fonetikë e morfologji.

Sipas gjuhëtarëve, pasuria leksikore e një gjuhe sillet në rreth 200.000 fjalë (me përjashtim të anglishtes që numëron trefishin). Në varësi të aftësive, prejardhjes, shkallës së

arsimit, profesionit etj., njerëz të zakonshëm kanë në përdorim të përditshëm një fjalor aktiv me rreth 7.000 deri në 8.000 fjalë. Brenda këtij inventari fjalësh, një mjek do të ketë më të përdorshme terma të mjekësisë; një kritik letrar do të ndjehet më rehat me figura dhe togefjalësha letrarë; një politikan do të flasë me zhargonin e politikës (që, meqë ra fjala, është edhe pjesa më e ndotur e gjuhës), ndërsa një fshatar do të përdorë më tepër fjalë që kanë lidhje me tokën, bagëtinë dhe veprimtarinë e tij të përditshme. Gjithashtu, sipas krahinave prej nga vijnë, njerëz të ndryshëm do të përdorin më shumë fjalë apo shprehje gramatikore që përkojnë me ato anë - dialektin. Megjithatë, përdorimi që i bën secili nuk ka përse të dëmtojë të tjerën. Nga ana tjetër, asnjë njeri i veçantë nuk mund të jetë në gjendje të përdorë aktivisht të gjitha fjalët që përmban leksiku i gjuhës shqipe. Kjo është praktikisht e pamundur (Arben Kallamata, Dialekte dhe standarde, në: <http://arbenkallamata.blogspot.com>).



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Në çfarë variantesh shfaqet gjuha shqipe?
2. Në cilat periudha kohore kemi ilirishten, shqipen e vjetër, arbërishten dhe shqipen e re?
3. Çfarë e karakterizon periudhën Parakombëtare të shqipes dhe çfarë periudhën Kombëtare?
4. A kemi variante territoriale të shqipes? Pse dallohen të folmet shqipe në shtrirjen hapësinore?
5. Çfarë dallimi hetohet ndërmjet të folmes tënde dhe të folmeve të tjera shqipe?
6. Çfarë mund të thoni për ligjërimin e shkujdesur?
7. Çfarë është ligjërimi bisedor?
8. Ç'është ligjërimi libror?
9. Sa stile funksionale dallohen në shqipen dhe cilat janë ato?
10. Lexojeni fragmentin e mëposhtëm të "Mesharit" të Gjon Buzukut.

U Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluom n së Shkruomit shenjtë, n së dashunit së botësë sanë desha me u fëdigunë, për sa mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë, përse ata të mundë mernë sa i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim ashtë Zotynë atyne qi ta duonë m gjithë zemërë. U lus mbas sodi ma shpesh të vini m klisë, përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në mbarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbi ju. E ata qi u monduonë djerie tash, ma mos u mondonjënë. E ju t'ini të zgiedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë ka me klenë me ju, ju tue ndjekunë të dërejtënë e tue lanë të shtrembënë. E këta ju tue bam, Zotynë ka me shtuom ndër ju, se të korëtë taj të nglatëtë djerie n së vjelash, e të vjelëtë djerie n së mbjellash. E u ma duo të mbaronj vepërënë teme, Tinëzot tue pëlqyem. Ndë vjetët M.D.L.IV. njëzet dit ndë mars zuna nfill, e mbarova ndë vjetët një M.D.L.V. ndë kallënduor V dit. E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fejyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë

nde e mir. Përse nukë çuditem se në paça fëjyem, këjo tue klenë ma e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë.

Përse ata qi shtamponjinë kishnë të madhe fëdigë, e aqë nukë mundë qëllonjinë se faj të mos banjinë, përse përherë ndaj ta nuk mundë jeshë; u tue mbajtunë një klishë, mbë të dy anët më duhe me sherbyem. E tash u jam nfalë gjithëve, e lutëni Tënëzonë ende për muo.

ÇABEJ (1968), 387.

Fjalorth:

- të ndigluom* - të kuptueshme
- n së dashunit* - prej dashurisë
- u fëdigunë* - u lodhën, u munduan
- atyne* - për ata
- klishë* - kishë
- të korëtë* - të korrat
- të nglatëtë* - të zgjatet
- në keshë* - në paça
- fëjyem* - gabuam
- fajtë* - aty ku të jetë faji
- nde e mirë* - në të mirë
- tue klenë* - duke qenë
- ndaj ta* - ndaj tyre

11. Në kolonën e parë janë dhënë disa fjalë e grupe fjalësh nga teksti i mëparshëm. Në kolonën e dytë shënoni formën e fjalës të të folmes tënde dhe në kolonën e tretë formën standarde.

gjuha e Buzukut	e folmja ime	gjuha standarde
<i>tue u kujtuom</i>		
<i>gluha</i>		
<i>me ditunë</i>		
<i>me zdritunë</i>		
<i>mendetë</i>		
<i>atyne</i>		
<i>qi të ndiglonjinë</i>		
<i>ta duonë</i>		
<i>kini me gjegjunë</i>		
<i>ka me klenë me ju</i>		
<i>tue ndjekunë</i>		
<i>tue bam</i>		
<i>vepërënë teme</i>		
<i>ndë kallënduor</i>		
<i>mbë gluhët tanë</i>		

9.3. SHQIPJA DIALEKTORE, SHQIPJA STANDARDE DHE GJUHA E LETËRSISË

Marrëdhëniet e gjuhës së letërsisë sonë artistike me shqipen janë mjaft të ndërlikuara. Në letërsi gjen shfaqje më të qartë e më të qenësishme natyra kombëtare e gjuhës. Krahas funksioneve të tjera, *letërsia ka edhe funksionin e ruajtjes e të zhvillimit të kulturës gjuhësore të kombit*. Shkrimtari rritet e ushqehet me gjeninë e gjuhës amtare dhe është vegël e saj për ta mbajtur atë me gjallëri të pashuar, për ta përtërirë e për ta çuar më tej.

Kultura gjuhësore e letërsisë artistike ndikon në evoluimin e gjuhës në tërësi. Ngulitja e normës, standardizimi do të thotë në një kuptim ngadalësim i zhvillimit të vetvetishëm gjuhësor. Letërsia dhe gjuha e gjallë e folur e kompensojnë këtë shmangie nga ecuria spontane. Letërsia luan rol të veçantë për *marrëdhëniet e gjuhës së normuar me format e tjera, sidomos jostandarde*, të trajtës së shkruar me trajtën e folur. Nëpërmjet letërsisë artistike jo vetëm zgjerohen mundësitë shprehëse të shqipes, por edhe përtërihen ato, shtjellohen më tej ose edhe krijohet diçka e re. Një vepër letrare është edhe një qëndrim ndaj gjuhës për kohën e vet, të parë me syrin e artistit të fjalës. *Letërsia shfrytëzon të gjitha mundësitë e organizimit të gjuhës në stile*.

Gjuha është elementi kryesor dallues i kombit.- Çdo komb që respekton vetveten, duhet të ketë një gjuhë të njësuar, një gjuhë letrare kombëtare. Prej më se 40 e sa vjetësh (nga Kongresi i Drejtshkrimit, mbajtur në Tiranë, më vitin 1972) e deri më tani shqiptarët i bashkon *gjuha standarde shqipe* ose gjuha letrare kombëtare e njësuar. Gjuha standarde mund të përkufizohet si *variant i kodifikuar i një gjuhe* që u shërben nevojave të shumta dhe të ndërlikuara komunikative të një bashkësie gjuhësore që ka krijuar shtetin e vet kombëtar. Veçori themelore e gjuhës standarde është karakteri i saj *normativ*, d.m.th. prania e trajtave normative, të cilat janë të detyrueshme për t'u përdorur nga gjithë folësit e asaj gjuhe. Krahas formave të detyrueshme (sidomos fonetike e morfologjike), ka edhe forma të këshillueshme (veçmas leksikore e sintaksore).

Gjuha standarde është formë gjuhësore mbikrahinore, gojore dhe e shkruar, e ligjësuar historikisht dhe e institucionalizuar, që i nënshtrohet gjerësisht normimit dhe përhapet e kontrollohet nga institucionet e nga mediet publike.

Siç dihet, *gjuha standarde e normuar përcaktohet nga kodifikimi*, d.m.th., duke përzgjedhur midis variacionit bëhet e njësuar; ndërsa *teksti letrar është heterogjen nga ana gjuhësore*. Në faqet letrare, të gjitha përdorimet gjuhësore kanë rrugë të hapur, deri edhe shtrembërimet individuale. Në letërsi shfrytëzohen të gjitha mundësitë shprehëse të shqipes, qoftë edhe ato që dalin jashtë normës letrare, si: ligjërimet historike, krahinore, vetjake, shoqërore, kulturore etj. Kështu, për të bërë tipizimin e gjuhës së një bariu kosovar në një vepër letrare, shkrimtari përdor: paskajoren (me punu:), pjesoren e cunguar të foljeve (lidh), [-n-]-në midis dy zanoresh (sÿni), mosshqiptimin e zanores -ë në fund të fjalës (mo:ll), disa fjalë krahinore a dialektore të gegërishtes (çi:k, tamël, tlyn) etj., apo në gjuhën e një personazhi të gegërishtes qendrore do të shënojë diftongimin e zanoreve [i] dhe [u] të theksuara (shpâi, nâuse), qiellzorëzimin e [g]-së në [gj] (gjisht, gjur) etj.

Gjuha e letërsisë artistike është shumë më e gjerë sesa gjuha standarde. Fjalët në letërsinë artistike mund të zhvishen nga kuptimi themelor dhe të risemantizohen përmes

motivimit tekstor. P.sh. Rasini vetëm me 2000 fjalë na ka lënë drama të një shkalle të lartë artistike, aq sa edhe Shekspiri që ka përdorur mbi 20.000 fjalë. Shkrimtari ka liri të madhe në përdorimin e gjuhës: ai ka nevojë për një elasticitet dhe zgjerim gjuhësor, për fond të madh fjalësh e zgjerime kuptimore të tyre, për ndërtime të shumta gjuhësore, për një sintaksë shumë fleksibile; pra për një kod shumë më të hapët sesa korniza e gjuhës standarde.

Arsyeja e kapërcimit të konvencioneve gjuhësore në letërsi është motivimi artistik.- Shkelja e normave të shqipes standarde në letërsinë artistike pa motivim artistik sjell të meta stilistike, duke e bërë të papëlqyeshme gjuhën për lexuesin. Motivimi artistik u lejon shkrimtarëve ta kapërcejnë rrethin normativ. P.sh. një vepër mund të shkruhet edhe në gjuhën e pesë shekujve më parë, ose edhe në një dialekt me synime të veçanta, ashtu siç ka shkrimtarë që shkruajnë në dy gjuhë njëherësh (arbëreshët e Italisë, p.sh. botojnë poezi në dy gjuhë paralelisht shqip - italisht). Në rastin e fundit kemi të bëjmë me marrëdhëniet e letrarit me auditorin (lexuesit) dhe jo me gjuhën standarde shqipe.

Megjithëkëtë, krahas lirisë së madhe gjuhësore të shkrimtarëve, laramania në gjuhën e letërsisë artistike është e nevojshme që të ketë një forcë bashkuese, që të mos lejojë të lindë ndonjë efekt i padëshirueshëm shpërbërës gjuhësor e kombëtar. Njëjtësia sigurohet në gjuhën e autorit si rrëfyës. Edhe në prirjet natyraliste, për të dhënë gjuhën ashtu siç përdoret, edhe po të shkruhet në dialekt etj., shkrimtarët bëjnë një përpunim letrar artistik. Letërsia ka përpunuar një varg formash të rrëfimit, të monologut e të dialogut, mënyra të ndërthurjes së ligjëratave etj., të cilat janë përpunime e pasurime të gjuhës shqipe me vlera të veçanta. Ajo e ka rritur shijen artistike të lexuesve edhe për gjuhën shqipe përgjithësisht.

Vepra letrare është edhe krijim artistik edhe krijim gjuhësor, një eksplorim i mundësive të shqipes. Kjo prirje krijuese gjuhësore e shkrimtarëve nuk lidhet vetëm me krijimin e fjalëve të reja, sepse shumica e tyre janë neologjizma stilistikë, por edhe me të gjitha fushat e tjera të gjuhës.

Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shprehshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Natyrisht, krijimtaria letrare nisat nga funksioni themelor i mjeteve gjuhësore, por edhe punon për t'u dhënë atyre rol shprehës e artistik. Të gjitha këto arrihen jo me fjalë e forma të veçanta, por më tepër me mënyra tërthore, që mishërohen në organizimin dytësor. Rezultati që arrihet është një ndikim i fuqishëm mbi ndjeshmërinë e lexuesit, mbi përfytyrimin e shijen e tij, duke e bërë ta pranojë vetvetiu se diçka është thënë më bukur sesa do ta thoshte ai vetë.

Veprat letrare nuk bëjnë çmos që të shkëputen nga përdorimi i ngulitur i gjuhës; por, përkundrazi, pasuria e gjuhës kombëtare mbetet një visar i pashtershëm për të arritur efekte shprehëse artistike, me këtë edhe vetë letërsia shtresohet në vlerat kulturore të shqipes.

Në letërsi riprodhohet vetë gjuha.- Letërsia jep procesin e komunikimit gjuhësor, tipat e ligjëritimit, gjuhën e grupeve shoqërore, profesionale, të moshave të ndryshme, variantet krahinore e letrare. Të gjitha këto varen nga drejtimit artistike: sa më realiste është letërsia, aq më afër synon të japë realitetin gjuhësor dhe anasjelltas, sa më tepër largohet letërsia nga

realizmi, aq më tepër edhe gjuha largohet nga riprodhimi i përdorimit real. Prandaj, teatrit absurd i përgjigjet edhe absurditeti i fjalive. Romantizmit i përgjigjet gjuha romantike: ligjërimi ka emocionalitet të theksuar, priret nga tropet dhe parapëlqen subjektivitetin.

Shkrimtarët mbajnë qëndrim vlerësues ndaj ligjëritimit, i çmojnë ose i përçmojnë fjalët e tipat e shprehjes, përkrahin një shije a modë gjuhësore ose e satirizojnë atë. Nga kjo pikëpamje, shkrimtarët janë “gjuhëtarë” të një tipi të veçantë, vëzhgues, regjistruar e vlerësues të gjuhës. Nuk është e rastit, që vlerësimet më të shpeshta e më të goditura për gjuhën i japin letrarët. Bie fjala, shkrimtarët janë të parët që e kanë përhapur idenë se shqipja është gjuhë e ëmbël dhe e bukur.



Pyetje, detyra e ushtrime:

1. Ç'është gjuha standarde shqipe dhe kur u formua ajo?
 2. Çfarë dallimi ka ndërmjet gjuhës së letërsisë artistike dhe gjuhës standarde shqipe?
 3. Sa zbatohen normat e shqipes standarde në letërsinë artistike që është krijuar pas Kongresit të drejtshkrimit?
 4. A janë të lejueshme tani format jostandarde në gjuhën e veprave letrare, si p.sh. fjalë që i përdor populli por të cilat nuk janë pjesë e leksikut të shqipes së normuar, fjalë të vjetruara, fjalë të huaja etj.
 5. Për ç'arsye shkrimtari ndonjëherë nuk i respekton rregullat e drejtshkrimit?
 6. Analizojeni gjuhën në fragmentin e nxjerrë nga “Besa-besë” e Çajupit. A mund të hetoni shmangie nga norma e sotme e shqipes standarde dhe si i shpjegoni ato?
- Volteri tha: “Allfabeti ka qenë isvori i gjithë të njohuravet njeriut edhe i gjithë paramendimëve tij”. Dyke zgjedhurë allfabetnë turqishte, shqipëtarëtë nuku do të bëjnë tjetër për veç të dëftohen të pamengmë. Mbetëtë të flasim për allfabetnë greqisht. As ay nuku bën për të shkruarë gjuhënë tonë. Është vërtet që ay ka shkruarë një gjuhë, së cilës bot'e qytetëruarë detyron shumë të shkruara të mëdha, nga të cilatë është e çuditurë dhe e dashurë sot. Po këjo gjë nuku duhetë vënë re në të zgjedhurit e allfabetit. Grekomanët thonë se gjuha tonë nuk' është tjetër gjë veçse një dialekt i gjuhës greqishte, e cila thon' ata: e ëma. Po edhe njerë në thëncinë, fjal'e tyre është gjithaqë gënjeshtërë, bërë me qëllim të keq për nevojat që kanë për dëm të kombësisë tonë që kërkjnë ta shuajnë me gjithë sej ndë fitim të tyre ...

10. ONOMASTIKA DHE DEGËT E SAJ

Termi **onomastikë** rrjedh nga greqishtja (*onomastikē téchnē*: *onoma* “emër”, *téchnē* “mjeshtëri”), që ka kuptimin mjeshtëri e emërtimit ose e shpjegimit të emrave të përveçëm (emrave gjeografikë; emrave e mbiemrave të njerëzve dhe nofkave). Me termin onomastikë, pra emërtohet edhe (1) tërësia e emrave të përveçëm edhe (2) shkenca që merret me studimin e tyre. Onomastika, si shkencë është degë e gjuhësisë që studion emrat e përveçëm të vendeve dhe të njerëzve. Për të dalluar lëndën e studimit nga shkenca që merret me to, për këtë të fundit përdoret edhe termi *onomasiologji* (gr. *onoma* “emër”, *logos* “dije, shkencë”; pra shkencë që studion emrat).

Varësisht nga ajo se a studion emrat e vendeve apo të njerëzve, **onomastika** ndahet në **toponimi** dhe **antroponimi**, me degëzimet e dhëna si më poshtë:

1. **toponimia** (*studion emrat e vendeve*) dhe
 2. **antroponimia** (*studion emrat e njerëzve apo emrat vetjakë*).
1. **Toponimia** ndahet në:
- a) **oronimi** (*studion emrat e maleve, fushave, kodrave etj.*),
 - b) **hidronimi** (*emrat e ujërave: dete, lumenj, liqene, përrenj etj.*),
 - c) **oikonimi** (*emrat e vendeve të banuara: qyteteve, qytezave, katundeve, lagjeve etj.*).
2. **Antroponimia** merret me studimin: **e emrave të njerëzve, të patronimeve** (mbiemrave) dhe **të nofkave**.

Degëzimin e onomastikës grafikisht mund ta paraqesim kështu:



Hulumtimet onomastike janë të rëndësishme sidomos për studimin historik të tipareve kulturore e gjuhësore të popujve. Në mungesë të dokumenteve të shkruara, onomastika mbetet si “arkiv gojor” i historisë dhe i lashtësisë së kulturës shqiptare në hapësirën ballkanike. Emrat e vendeve dhe të njerëzve përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojnë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Në këtë vështrim, onomastika e një vendi duhet parë si një histori e pashkruar e popullit. Fusha e onomastikës ofron dhe do të ofrojë brumë gjuhësor me peshë të madhe për studimin e historisë së shqiptarëve e të gjuhës shqipe, si gjuhë e njërit prej popujve më të mëdhenj të Ballkanit, por e dëshmuar me shkrim relativisht vonë.

Gërshetimet e civilizimeve të ndryshme: me fqinjësi shumëshekullore, me dyndje, me zhvendosje të brendshme popullore, me luftëra të përgjakshme, urrejtje e mostolerancë, me egoizëm e prirje për të shlyer gjurmët e ekzistimit të tjetrit, me asimilime popujsh; me mbizotërim herë të njërit e herë të tjetrit (shpeshherë edhe të atij që nuk banonte në Ballkan); me paganizëm, politeizëm e monoteizëm (me përhapje më të madhe të tri besimeve: krishterizmit,

ortodoksizmit e islamizmit) dhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë *pasqyrohen edhe sot në kulturën materiale e shpirtërore të popujve të Ballkanit; në gjuhët e tyre, sidomos në fushën e leksikut, duke përfshirë edhe emrat gjeografikë, emrat e njerëzve, të bimëve, të kafshëve, të sendeve, të objekteve etj.*

Historia e trazuar e Ballkanit, që karakterizohet me ndërrim të shpeshtë të pamjes etnike e fetare, me administrim në gjuhë të huaja etj., pasqyrohet edhe në onomastikën e tij. Rrjedhimisht, onomastika e Ballkanit është shumë e larmishme: aty gjejmë emra të përveçëm me etimologji ilire-shqiptare, trake, latine, greke, sllave, turke, vllahe e nga ndonjë gjuhë tjetër. Krahas këtyre, ka edhe emra me forma të ndryshuara gjatë shekujve, të përkthyer a të kalkuara, shpeshherë edhe të riemërtuara; emra me forma të përziera (hibride) nga dy e më tepër gjuhë etj.

Për shkak të tretjes apo të mosnjohjes së gjuhëve të vjetra (në mungesë të dokumenteve të shkruara, por me gjurmë onomastike), për shkak të dallimit të ligjësisive të përgjithshme gjuhësore me ato onomastike..., etimologjia e një sasive toponimesh e antroponimesh ballkanike deri më sot kanë mbetur e ndoshta edhe në të ardhmen do të mbeten të pazbërthyeshme e të pashpjegueshme.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. Ç'është onomastika?
2. Si degëzohet ajo?
3. Si mund ta shpjegoni gërshetimin e civilizimeve të ndryshme në Ballkan në dritën e emrave të viseve dhe të njerëzve?
4. Pse materiali onomastik i Ballkanit dhe studimet onomastike për të kanë rëndësi shumë të madhe për gjuhën shqipe, historinë, etnografinë e arkeologjinë shqiptare?
5. Çfarë mund të thoni për emrat e vendeve dhe të njerëzve në fshatin a vendbanimin e juaj?
6. A janë bërë vëzhgime onomastike për emrat e përveçëm të vendit tuaj?


10.1. STUDIMET ONOMASTIKE SHQIPTARE

Emrat e vendeve dhe emrat e familjeve për historinë e një populli janë arkiv i vërtetë i tij, i shtresuar palë-palë gjatë mijëvjeçarësh të ndryshëm. Toponimet (emrat e viseve), antroponimet (emrat e njerëzve) dhe patronimet (emrat familjarë) kanë një rëndësi të veçantë, sidomos për gjuhësinë dhe për etnologjinë shqiptare, për të dëshmuar vazhdimësinë ilire të popullit shqiptar. Rezultatet e arritura nga studimet onomastike arrijnë të ndriçojnë edhe periudhat e mugëta para shkrimit të shqipes, ndonjëherë edhe ato epoka për të cilat mungojnë të dhënat historike, etnografike, gjeografike, arkeologjike etj.

Onomastika shqiptare ndihmon për shpjegimin e shumë çështjeve nga fusha e historisë së shqiptarëve, e arkeologjisë, e etnografisë, e folklorit, e gjeografisë e topografisë etj.

Onomastika ka qenë gur themeli dhe lëndë e parë me rëndësi parësore në të gjitha hulumtimet historiko-gjuhësore rreth iliro-shqiptarëve, së pari, për albanologët e huaj, pastaj edhe për studiuesit shqiptarë. Duke u interesuar për historinë e popujve dhe të gjuhëve të Evropës, shumë gjuhëtarë të huaj, kanë bërë edhe studime albanologjike me vlerë, duke përfshirë edhe ato onomastike shqiptare. Në mungesë të të dhënave për shqiptarët dhe trojet e tyre, prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës shqipe u bë objekt i një debati qindravjeçar të gjatë shkencor e joshkencor. Mbështetje kryesore për të argumentuar tezat e tyre se cili është djepi i shqiptarëve, nga cila gjuhë rrjedh shqipja, a janë shqiptarët autoktonë apo ardhës e të ngjashme gjenin në emrat e vendeve dhe të njerëzve.

Albanologjia është tërësia e studimeve që janë bërë dhe që po bëhen për historinë, gjuhën, folklorin dhe kulturën e popullit shqiptar. Këto çështje janë bërë objekt kërkimesh dhe hulumtimesh për albanologë e dijetarë të shquar të vendeve të ndryshme të botës. Një pjesë e mirë e tyre i kanë vështruar me objektivitet çështjet shqiptare dhe kanë hartuar vepra me shumë vlerë, por ka pasur dhe ka edhe sot studiues, të cilët, të nisur nga qëllime të paracaktuara, kanë mbajtur qëndrim antishkencor e antishqiptar.



Në studimet albanologjike dallohen katër periudha: a) Periudha e parë, parashkencore, e cila fillon nga fundi i shek. XVI e deri në fillimet e shek. XIX.; b) Periudha e dytë nis në fillimet e shek. XIX e vazhdon deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë; c) Periudha e tretë fillon më 1912 e vazhdon deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore; ç) Periudha e katërt fillon pas Luftës së Dytë Botërore dhe vazhdon edhe sot.

Shkrimtarët tanë të traditës, në të gjitha periudhat, përveç me vepra letrare, me veprimtarinë arsimore e patriotike, ndihmesë të madhe kanë dhënë edhe me vepra gjuhësore, duke hartuar abetare, gramatika, fjalorë, punime e studime me vlerë të qëndrueshme.

Kontribut të madh për albanologjinë kanë dhënë edhe gjuhëtarët e huaj, si Norbert Jokli, Gustav Majeri, Xylanderi, Miklosichi, Johan G. fon Hahni, Holger Pedersen, G. Vajgandi, Petar Skoku, Milan Shuflaj, Konstatin Jereçeku, Albert Thumbi, Meyeri, Vacllav Cimohovski, Paul Kreçmeri, Petar Skoku, Henri Bariçi Maksimilian Lamberci, Radoslav Katiçiqi, Karlo Tagliavini etj.


Para Luftës së Dytë Botërore ka pasur disa përpjekje të veçanta për kërkime e studime në lëmin e onomastikës. Disa autorë të huaj, edhe ndonjë vendës janë marrë me mbledhje e botime materiale, kryesisht nga fusha e toponomastikës. Vëzhgime për toponime të veçanta janë bërë edhe në punime të ndryshme historike e gjuhësore.

Në periudhën e pasluftës, kërkimet onomastike u vunë mbi baza shkencore të organizuara. Pranë disa sektorëve të shkencave shoqërore (të etnografisë, të gramatikës dhe të leksikologjisë) u ngritën edhe kartotekat e para të onomastikës shqiptare. Për mbledhjen e toponimeve janë organizuar ekspedita shkencore në të gjitha rrethet e Shqipërisë. Deri më sot janë grumbulluar mbi 200 mijë njësi toponimesh nga të gjitha krahinat. Krahas mbledhjes së materialit onomastik, janë botuar edhe një varg punimesh në rrafshin gjuhësor, historik etj. Të dhënat onomastike të grumbulluara kanë dhënë një ndihmesë të rëndësishme për të ndriçuar probleme themelore të historisë së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe.

Nga studiuesit shqiptarë për çështje të onomastikës shquhen prof. Eqrem Çabej, Mahir Domi, Kolë Luka, Palok Daka, Aleksandër Xhuvani, Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaj, Seit Mansaku, David Lluka, Kolë Luka, Çlirim Bidollari, Haredin Xhaferi, Xhelal Ylli, Xhevat Lloshi (Shqipëri); Aleksandër Stipçeviçi (arbnesh i Zarës), Idriz Ajeti, Selman Riza, Rexhep Ismajli, Shefki Sejdiu, Zef Mirdita, Mehmet Ahmetaj, Mehmet Halimi, Abdulla Zymberi, Begzad Baliu, Rexhep Doçi, Skender Gashi, Baftjar Kryeziu (Kosovë), Desnickaja (albanologe ruse); Qemal Murati, Haki Ymeri, Xhemaludin Idrizi, Fadil Sulejmani, Adnan Agai, Mustafa Ibrahim, Asllan Hamiti, Izmit Durmishi, Sevdail Kadriu, Idajete Mustafa (Maqedoni), Ruzhdi Ushaku (Mal të Zi), Zef Valentini (Itali), Fatos Rrapaj (Çamëri), Jusuf Shpuza por edhe një numër i madh gjuhëtarësh të tjerë, të cilët në përshkrimet dialektore të të folmeve, kanë shpjeguar edhe emrat e vendeve e të njerëzve që i takojnë atij areali.

Të arriturat e onomastikës shqiptare. - Nga studimet onomastike shqiptare mund të nxirret si përfundim se:

Në gjendjen e sotme, emërvende me origjinë ilire-shqiptare ka jo vetëm në trojet me vazhdimësi gjuhësore e tokësore ku tani shtrihen shqiptarët, por edhe në ngulimet shqiptare e në të gjitha viset e tjera të Ballkanit. Mirëpo, dihet se jo vetëm në trojet përreth Shqipërisë ku ka shqiptarë, por edhe në truallin brenda kufijve të Shqipërisë, përveç toponimeve me etimologji shqipe, të cilat mbizotërojnë, gjejmë edhe emra me etimologji gjuhësh të ndryshme: latine, greke, sllave, turke, vllahe, ndonëse ndonjë edhe me prejardhje të pashpjegueshme deri më sot. Pra, gjuha dhe kultura iliro-shqiptare kanë qenë nën ndikimin e gjuhës dhe të kulturës latine, greko-bizantine, sllave dhe turke. Kështu, mund të përfundohet se që nga periudha antike, shqiptarët banojnë pa ndërprerje në territoret ballkanike dhe vendbanimi i sotëm i shqiptarëve është përfundim i një ngushtimi të paprerë gjatë historisë.



Historia shqiptare i ngjan një vargoi të copëtuar, ku shumë unaza mungojnë. Unaza për lidhjen e vargoit të copëtuar krijon edhe onomastika. Në shekullin II të erës sonë gjeografi i Aleksandrisë së Egjiptit, Ptolomeu, në hartën e tij botërore shënon për herë të parë fisin *Albanoi* me qytetin *Albanopolis*, që gjendej në Shqipëri të Mesme, afër Krujës (Zgërdheshi i sotëm). Ky emër fisi u përgjithësua si emër i vjetër kombëtar *Arbër - Arbën, Arbëresh - Arbnesh*, me të cilin na quajnë edhe popujt e tjerë, it. *Albanesi*, gr. *Arvanites*, turq. *Arnaut*, sllav. *albanci* etj. Në shekullin XI kronistët bizantinë Mihail Attaliates e princesha Anna Komneni i përmendin shqiptarët: vendin me emrin *Albanon* e popullin si *Albanoi, Albanitai, Arbanitai*. Ky emër me trajtat *Arbër - Arbën* ruhet edhe sot, në Toskëri e në Gegëri, sidomos në ngulimet shqiptare të Italisë, të Greqisë, të Zarës etj. Emrin e ri *shqiptar* e gjejmë të shënuar për herë të parë te Buzuku, më pas edhe te autorët e tjerë të vjetër.

Toponimia në shumë vise të Gadishullit Ballkanik ruan deri më sot karakterin e vjetër ilir. Shqiptarët janë të vetmit që kanë ruajtur emrat ilirë, emrat e vendbanimeve, madje edhe emrat e njerëzve. Shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve. Përveç argumenteve historike, gjeografike, antropologjike etj., këtë e dëshmojnë edhe zbulimet arkeologjike dhe faktet gjuhësore, sepse emrat ilirë shpjegohen vetëm me anë të shqipes. Krahasimi i formave të lashta ilire të emrave të vendeve dhe të njerëzve me format përgjegjëse të

shqipes së sotme, vërtetojnë se ato janë zhvilluar me rregullat e fonologjisë dhe të gramatikës historike të shqipes. Po sjellim disa nga to:

Emri i **Dalmacisë** lidhet me fisin e Dalmatëve (Dalmatia, Delmatia), që shpjegohet me shqipen “*dele, delme*”, pra, fushë që ushqen shumë dele, dhen (me këtë lidhet edhe emri *delmer* “bari delesh”). **Dardania** që shtrihet në trekëndëshin midis qyteteve Shkup-Nish-Sofje gjen shpjegimin të fjala shqipe “dardhë”, vend ku kultivohen shumë dardhat. Emri i tillë për të emërtuar vise, lagje, njerëz etj. është trashëguar deri më sot, si Dardani (Kosova e sotme, por edhe një lagje e Prishtinës), Dardan,-e (emër vetjak), Dardhishta (patronim) etj. **Ulqini** (lat. Olcinium) është me etimologji nga forma e vjetër *ulk* (fem. ulkonjë, ulko:j), tani *ujk*. Emra ilire kanë edhe lumenjtë e ish-Jugosllavisë: **Drava, Sava, Drina, Kulpa, Una, Vrbas, Bosna, Morava** (dikur **Marga**), **Narenta, Pliva** (ilirisht **Pelua**), oronimi **Bora** (emër i një vargmali të Maqedonisë së lashtë juglindore, te Kajmakçalani). Emra vendesh, mëhallësh e njerëzish me rrënjën **Alb-, Arb-, Arn-, Arv-**, si **Albincë, Allbanaic; Arbnesh, Arbëresh, Arbër, Arbën, Arben; Arbinovë, Arbanashko, Arbanasi, Arbino, Arnaut, Arnavud, Arbasanci, Arvati; Arnaudov, Arnaqi, Arbanash, Arbanas** dëgjohen dendur në truallin e Ballkanit.

Studimet onomastike shqiptare dëshmojnë se edhe shumë toponime të tjera (emra qytetesh, malesh e lumenjsh) janë të lidhura me shtresën ilire, si **Shkup** (nga forma e lashtë Skupi), **Mali Sharr** (Skardus Mons), **Tomor** (Tomarus), **Vardar** (Bardouarios, Bardaros, Bardarion, Bardarus, Bardarum, Bardal, Vardarus, Vardar, nga bard, bardh, bardhar “lumë i bardhë”), **Nishi** (Naisus), **Drî/Drini** (Drinus), **Dibër** (Deborus), **Shtip** (Astibos), **Shkodër** (Scodra), **Durrës** (Durrachium), **Lezhë** (Lisus), **Vlorë** (Aulon), **Dimale** (Dimallum, dy/di male, në Çamëri), **Tergeste** (Trieshta, serb. Trogir shpjegohet me shqipen *treg*); emra njerëzish e vendbanimesh **Bardus, Bardhove, Bardove** (nga bardh) etj.

Onomastika shqiptare ka arritur në përfundim se edhe tek emrat e mbiemrat e njerëzve shihen përputhje të ilirishtes me shqipen. Ka analogji emrash ilirë, si **Bardus, Barduli, Bardyllis** me të shqipes **Bardhyl** (që të gjithë përmbajnë fjalën “bardh”; ilir. **Dasius, Dassius, Dasimus** - shq. **Dash-i**; ilir. **Bato** - shq. **Bato**; ilir. **Lacius** - shq. **Laç-i**; fisi ilir në Shqipëri të Mesme **Taulantët** - shq. emër personal **Taulant**; emri i **ilirëve** - shq. emër njeriu **Ilir**; emri i mbretëreshës **Teuta** - shq. emër femre **Teuta**; emri i fisit ilir **Dardan** – shq. emër njeriu **Dardan,-e** dhe emër lagjeje **Dardani**.


Këtyre barazimeve në emra vendesh e njerëzish duhet shtuar edhe përputhjet ilire-shqiptare në disa prapashtesa, që janë përdorur e përdoren për formimin e emrave të përveçëm. Kështu, është vënë re se prapashtesës ilire **-inium**, me të cilën janë formuar emra visesh prej kolektivash, si *Delminium, Olcinium* etj. i përgjigjet prapashtesa e shumësit **-inj** e shqipes, si *kërmij, shkëmbinj, barinj, gjarpërinj* etj. Po kështu, prapashtesës ilire **-ātes** që formonte emra fisesh e popujsh, si *Dalmates, Labeates, Daesitates* i përgjigjet prapashtesa **-at** e shqipes, e cila formon emra familjesh e vllaznish, si *Jashari - Jasharajt, Demiri - Demirajt, Isufi - Isufajt, Demi - Demát, Beqiri - Beqirát, Desh - Deshát* etj. dhe emra vendesh të krijuara nga to: *Jasharajt, Demirajt, Isufajt, Dukát, Filát, Progonát* etj. Prapashtesë tjetër paralele e dy gjuhëve, nënës dhe



bijës së saj, është ajo ilire **-este/-esta/-ista** (Tergeste, Ateste, Ladesta, Iovista) dhe shqipe **-shtë** (ahishtë, vreshtë/vneshtë).

Analiza e fakteve të shumta të gjuhës shqipe, dëshmon se stërgjyshërit e shqiptarëve në lashtësi kanë qenë fqinjët veriorë dhe veri-perëndimorë të grekëve të vjetër dhe të nënshtuarit e hershëm të Perandorisë Romake. Si rrjedhim, mendimi i mbrojtur nga një varg dijetarësh që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve jugorë, gjen një mbështetje të fuqishme në dëshmitë e shumta të gjuhës shqipe, e cila është zhvilluar nëpërmjet evolucionit të një a disa dialekteve, që flitëshin në lashtësi pikërisht në trevat e Ilirisë Jugore.

Mbledhja e toponimisë. - Duke njohur vlerën e madhe të toponimisë për studimet gjuhësore të fushave të ndryshme, Sektori i gramatikës dhe i dialektologjisë i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë ka hartuar një *Pyetësor për mbledhjen e toponimisë shqiptare* (nga prof. Mahir Domi dhe Gjovalin Shkurtaç), Tiranë, 1983. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ka vite që punon me një plan të rregullt ekspeditash për mbledhjen e toponimisë shqiptare. Mbi këtë bazë, si dhe me kontributin e dhënë nga një varg mbledhësish si bashkëpunëtorë të jashtëm, është formuar një kartotekë e pasur. Megjithatë, një mbledhje e plotë, tërësore e toponimisë mbetet për t'u bërë sa më parë. Ngutit e mbledhjes së toponimisë, siç e dimë, përcaktohet nga fakti që, zhvillimi i vrullshëm ekonomik e kulturor i vendeve po sjell kudo ndryshime të mëdha. Është e domosdoshme që emrat e vjetër që gjëllijnë ende, të mblidhen në mënyrë sa më të plotë, duke u bazuar sidomos në të dhënat e më të moshuarve.



Mbledhja e toponimisë mund të bëhet në dy mënyra: a) me ekspedita e anketime në terren; b) me vjelje të emrave të viseve, lumenjve, maleve etj. në dokumente të vjetra të shkruara. Për mënyrën e dytë, natyrisht nuk mund të shfrytëzohet pyetësor, ndërsa për mbledhjen e toponimeve në terren, mbështetja në një pyetësor të hartuar që më parë, ka një sërë të mirash.

Për fazën e mbledhjes së materialit janë të domosdoshme këto kërkesa: informatorët (njerëzit që pyeten) duhet të jenë nga më të moshuarit, të jenë vendës, të kenë shqiptim të rregullt, të jenë të pashkolluar, të mos njohin gjuhë të huaja, të mos kenë qëndruar për një kohë të gjatë jashtë vendit etj.

Mbledhësi duhet të ketë parasysh edhe këto udhëzime: me qëllim që të shënohet sa më besnikërisht shqiptimi i toponimeve, trajta vendore duhet të shkruhet në transkriptimin fonetik që përdoret në kërkimet dialektologjike; të jepen të dhëna të plota për çdo informator (mosha, arsimit, profesioni, mosnjohja a njohja e gjuhëve të huaja, lëvizjet jashtë lokalitetit, përshtypja e mbledhësit për vërtetësinë e informatave, shpjegimet e informatorit ose gojëdhënat a legjendat për etimologjinë e emrit). Është mirë që anketimi të bëhet në vend, që mbledhësi të shohë me sytë e vet lumin, përroin, malin apo kodrën; të dëgjojë e të shënojë pastaj emrin e të cilëve e jep informatori. Së bashku me emrin bëhet edhe përshkrimi i vendit, si p.sh: *Guri Zi* (Guri i zi) - shkëmb i madh i vetmuar, në ngjyrë të errët; *Livadhi Çikave* (Livadhi i çikave) - livadh në mes të malit, ku dikur rrinin e luanin vajzat; *Kodra Madhe* (Kodra e madhe) - kodra më e madhe nga kodrat e tjera përreth; *Ferre: Djegun* (Ferrë e djegur) - kullotë fushore në breg të Përroit të Thatë, vend me shumë ferra.

Mbledhësi duhet të japë edhe informata për vete, duke shënuar: emrin e mbiemrin, vitin e anketimit, arsimin, profesionin, vendin e punës, vendlindjen dhe vendbanimin.

Pyetje, ushtrime e detyra:



1. Cilat janë degët e onomastikës?
2. Kur filluan studimet onomastike shqiptare?
3. Cilët albanologë të huaj kanë dhënë ndihmesë të madhe për gjuhësinë shqiptare, veçmas për onomastikën?
4. Cilët gjuhëtarë shqiptarë shquhen për studime onomastike shqiptare?
5. Çka e karakterizon periudhën e studimeve onomastike shqiptare para Luftës së Dytë Botërore dhe periudhën pas saj?
6. Cilët emra të lashtë të vendeve ballkanike dhe të njerëzve mund të shpjegohen me shqipen e sotme?
7. A ka bashkëpërkime të tjera gjuhësore (përveç në onomastikë) ndërmjet ilirishtes e shqipes dhe cilat janë ato?
8. Ç'është dëshmuar me studimet onomastike shqiptare?

10.2. TOPONIMIA DHE DEGËT E SAJ


Toponimi (gr. *topos* “vend”, *onoma* “emër”, pra emër vendi, emërvend) quhet: 1. *tërësia e emrave të vendeve* (të krahinave, të qyteteve, të fshatrave, të deteve, të liqeneve, të lumenjve, të përrenjve, të maleve, të arave etj.), si dhe 2. *dega e onomastikës që merret me prejardhjen dhe kuptimin e toponimeve, përkatësisht të emrave gjeografikë*. Për të dalluar tërësinë e emrave nga shkenca që studion ato, për kuptimin e dytë përdoret edhe termi *toponomastikë* (shkenca që studion emrat e vendeve).

Emrat e vendeve të mëdha gjeografike, si të maleve, lumenjve, qyteteve, katundeve etj., janë **makrotoponime** (emërvende të mëdha), ndërsa emrat e vendeve të vogla: arave, mëhallëve, përrenjve etj., janë **mikrotoponime** (emërvende të vogla).

Në bazë të asaj se çfarë emri gjeografik studion, toponimia (më saktësisht toponomastika) degëzohet në:

a) oronimi (gr. *oro* “mal”, *onoma* “emër”; emër përmbledhës për malet, kodrat, bjeshkët etj.), që studion emrat e maleve, kodrave, kodrinave, fushave etj., si *Mali Sharr*, *Kodra e Trimave*, *Fusha e Pajtimit* etj.

b) hidronimi (gr. *hidro* “ujë”, *onoma* “emër”), që studion



emrat e ujrave: lumenjve, liqeneve, deteve, përrojeve, burimeve etj., si *Vardar, Shkumbin, Liqeni i Ohrit, Deti Adriatik* etj.

c) oikonimi (gr. *oiko* “vendbanim”, *onoma* “emër”; emër vendbanimesh), që studion emrat e vendeve të banuara: qyteteve, fshatrave, lagjeve, mëhallëve etj., si *Shkodër, Ulqin, Shkup, fshati Arbnesh* etj. Si pjesë e oikonimeve mund të merren edhe *etnonimet* (emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave etj.), ndërsa dija që studion ato quhet **etnonimi**.

Dukuri e përgjithshme për të gjitha gjuhët e botës është se toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe burojnë kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa). P.sh. nga emri i përgjithshëm *zog, -u* është formuar antroponimi *Zug, -u*; oikonimi *Zogaj* (emër fshati mjaft i përhapur); nga emri *lum, -i* janë formuar shumë toponime, si *Lumë, -a, Lumthi, Lumzi*; por edhe emra vetjakë *Lumi, Luma, Lumaj* etj.

Në toponiminë shqiptare mënyra kryesore e emërtimit të viseve ka karakter universal. Aty dallohen:

1) emërtime vendesh sipas formës a sipas konfiguracionit natyror, si *Guri Ga:t, Gurzina, Kodra Madhe, Ara Madhe, Ara e La:rgt, Kodra e Diellit, Livadhi Rra:fsh, Rrafshi, Shullāni, Lugi Gropave, Lugi Xha:n, Gurzina, Morava e Poshtme - Morava e Epërme, Koliçani i Poshtëm - Koliçani i Epërm* etj.;

2) emërtime vendesh sipas ngjyrës së tyre: *Mali i Zi, Guri i Zi, Guri Ba:rdh (Gjuri Ba:rdh), Guri Kuq, Ujt’e kuq, Ujt’e Bardh, Kroi Kuq, Dhevi Bardh* etj.;

3) emërtime vendesh nga emra kafshësh a shpesësh: *Ulqini* (nga ulk, ujk), *Guri Shqipes, Shpella Arushës, Pusi Shqerrave, Birat e Dhëlnës* etj.;

4) emërtime vendesh sipas emrave të bimëve që rriten a janë rritur dikur në atë vend: *Qafa e Thanës, Dardani* (nga dardhë), *Kompirishta, Lugi Shkozave, Shkozina, Ahishta, Molla Kuqe, Lugi Mollës, Ara Tranafilit, Lugi Firit, Lugi Therrës, Zabeli Çarrave* etj.;

5) emërtime vendesh me emra njerëzish: *Bardhovc, Tanushë* (në Shkup), *Shurdhani, Demirajt, Resula* (Gjilan), *Ferizaj* (nga Feriz), *Rrahmanli, Sefer* etj.;

7) emërtime vendesh sipas pronarit, banuesit të parë a banorëve të vendit: *Kodra Ajetit, Vrella Nuhis, Vija Hajrës, Kroi Murtezit, Ara Zahës, Stani Ademit, Arat e Idrizve, Hani i Elezit* etj.;

6) emërtime vendesh sipas ndonjë tipari tjetër dallues: *Kroni Katunit, Kroi Ftoft, Kodra Furrës, Ara Furrës, Roga Çikave, Ara Re, Lugi Spicave, Shpeshtaki* (mal i shpeshtë), *Rrezja, Lisi n’Kodër, Te Brija, Te Kalaja* etj.

Emrat e vendeve ruajnë forma të vjetra e të ngurosurat gjuhësore, ashtu siç janë shqiptuar e shqiptohen nga goja e banorëve anas. Prandaj, në materialet e studimet onomastike jepet forma autentike e tyre.

Në studimet toponomastike vështrohet ana gjuhësore e emrave (kuptimore, strukturore, fonetiko-gramatikore, fjalëformuese dhe etimologjike), si dhe lidhja e toponimisë me realitetin (natyrën e vendit, ngjarjet e rëndësishme që lidhen me të etj.).

Toponomastika në hulumtimet e saja merr parasysh edhe shtreshmërinë (stratigrafinë) e emërvendeve. Ajo studion shtresat e ndryshme të emrave të vendeve që janë krijuar nëpër shekuj për shkak të ndërrimit të gjuhës e të popullit në një truall të caktuar (migrimet, pushtimi i territoreve të ndryshme etj.) që pasqyrohen në emrat gjeografikë. Stratigrafia mbështetet në parimin se gjuhët dhe popujt mund të treten nga një territor, por emrat e vendeve, ashtu siç iu

kanë vënë popujt e tretur, mund të barten në mbishtresën (popullin që mbulon popullatën e zhdukur).

Dihet se shtresat toponimike nuk kanë të njëjtën rëndësi. Ato që janë më të vjetra e më të qëndrueshme (siç janë emrat e detrave, lumenjve, maleve e liqeneve të mëdhenj) janë më të rëndësishme sesa emrat e rinj, që shpeshherë janë riemërtime nga pushtuesit. Harta toponomastike e Ballkanit në rrjedhë të kohës pësoi ndryshime të shumta: shumë emërtime të vjetra u zëvendësuan me emërtime të reja. Një pjesë e madhe e toponimeve shqipe, të vjetra e të reja, u përkthyen ose u përshtatën sipas etnikumit sundues.

Në gjuhë të ndryshme toponimet mund të kenë emërtime të ndryshme, krahaso: *Dojçlland - Alemnagne - Germany - Gjermani - Njemaçka*; shq. *Shkodër - maq. Skadar, Durrës - maq. Draç, shq. Ferizaj - sll. Uroshevac* etj. Edhe në Maqedoni ka emra që përdoren në dy ose më shumë forma, varësisht nga përkatësia gjuhësore e folësve. Nga dysorët toponimikë shqip - maqedonisht, si *Shkup - Skopje, Tetovë - Tetovo, Manastir - Bitolla, Dibër - Debar, Kërçovë - Kiçevo* etj., për një kohë format e maqedonishtes ishin nën mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e shtetit, me qëllim që ato të përdoshin edhe në gjuhët e tjera që fliten te ne, veçmas në gjuhën shqipe.



Pyetje, ushtrime e detyra:

Për t'ju ndihmuar që të mblidhni, më pas mundësisht edhe të shpjegoni etimologjinë dhe strukturën gjuhësore të toponimeve të vendit tuaj, kemi zgjedhur disa pyetje dhe ato i kemi dhënë në formën e një *Pyetësori*, që do t'i shënojmë më poshtë:

I. Emrat e vendeve të banuara (toponimia shoqërore)

1. Si quhet fshati juaj? A ka pasur emër tjetër në të kaluarën?
2. Cilës krahinë i përket fshati juaj? Si quhen fshatrat me të cilët kufizohet ai?
3. Si quhen lagjet e fshatit tuaj ose (nëse ka) njësitë më të vogla se lagjja?
4. Si është terreni i fshatit tuaj dhe përreth tij (malor, kodrinor, fushor e trego edhe veçori të tjera).
5. Ç'mjeshtëri a zeje më të rëndësishme kanë pasur e kanë banorët e fshatit tuaj?
6. A kanë ndryshuar shtrirja dhe kufijtë e fshatit tuaj?
7. Sa familje ka fshati juaj? Cilat janë nofkat e tyre?
8. A ka rrugë që lidhin fshatin me qendrën e krahinës ose me qytetin?
9. A ka në fshatin tuaj ose afër tij ndonjë rrënojë vendbanimi të vjetër, ndonjë kështjellë, shpellë a gjurmë tjetër vendbanimesh a qytetërimi të hershëm?
10. A ka në fshatin tuaj ndonjë shesh, krua, shkollë, ngrehinë të kulteve fetare (kishë, xhami, manastir, tyrbe etj.)? Thoni toponimet që lidhen me to.

II. Emrat kryesorë gjeografikë (toponimia gjeografike)

A. Emrat e ujërave (hidronimia)

11. A ka në fshatin tuaj ose afër tij ujëra rrjedhëse? Përshkruaj ato.
12. A ka fshati juaj ose përreth tij ujëra amull (ndonjë liqen, kënetë, moçal, ujë të mbledhur nga shirat, pus etj.)?

B. Emra malesh e fushash si dhe emra të tjerë më të vegjël që lidhen me to

13. Ç' mal ose kodër ka në apo rreth fshatit tuaj. Sa larg fshatit është ai? Thoni të gjithë emrat që lidhen me ta (maja e malit, fundi i malit a i kodrës, a është pjesë e ndonjë vargmali, qafa, gryka, shpati i malit, shkëmbinj të mëdhenj, pjerrtësitë e mëdha etj.)!
14. Shkruani emrat e lugjeve, lëndinave a viseve të tjera të dallueshme e të emërtuara!
15. A ka shpella a gremina në malin e fshatit tuaj. Ç'emra kanë ato?
16. Thoni emrat e livadheve, kullosave, emrat e arave, tokave të reja të përfutuara nga shpyllëzimi, vendeve të zhveshura në mes të një pylli, vendeve me drunj të dendur etj.
17. Ç'emër të përveçëm lidhen me fjalët ah, bredh, frashër, lis, qarr, gështenjë, shelg, plep, shkozë, thanë, ferrë etj. (si p.sh. Ahishtë)?
18. Thoni emrat e përveçëm që lidhen me vendet ku mbillen kultura të tilla: elbi, thekra, gruri, pambuku, orizi, tërshëra apo diçka tjetër!
19. Si quhet vendi i mbjellë me perime të ndryshme?
20. Thoni emrat e përveçëm të tokave të punuara?
21. A ka, ose a ka pasur në të kaluarën vende të caktuara për pushimin e kafshëve, stane, vende ku mbahen zgjojet e bletëve etj?
22. A ka qenë e zhvilluar në fshatin tuaj djegia e qymyrit të drurit ose e gëlqeres? Ç'emra kanë vendet ku digjej ai?
23. A ka në fshatin tuaj vende të caktuara për nxjerrje gurësh për ndërtime, vende ku ka pasur dhe ka miniera? Ç'emra kanë?
24. A ka në fshatin tuaj ndonjë vend për të cilin rrëfihen gojëdhëna që lidhen me ndonjë besëtytni, ndodhi a njeri?
25. Thoni edhe çdo toponim që nuk përmbledhet në pyetjet e mësipërme!

10.3. ANTROPONIMIA DHE DEGËT E SAJ

Antroponime (gr. *anthropos* “njeri”, *onoma* “emër”) quhen emrat e përveçëm të njerëzve, që studiohen nga dega e gjuhësisë e quajtur **antroponimi**. Rrjedhimisht, me **antroponimi** emërtohet: 1. tërësia e emrave të përveçëm të njerëzve në një gjuhë a te një popull; dhe 2. dega e onomastikës që studion antroponimet, përkatësisht emrat e njerëzve ose të një grupi njerëzish, mbiemrat dhe nofkat, si *Bardhyl, Teuta, Hoxht, Memishallarë, Kryezi, Curr* etj. Antroponimia përfshin **emrat vetjakë, mbiemrat dhe nofkat**.

Emrat vetjakë janë shprehje civilizimesh të mëparshme, dëshmi të gjalla për besimet dhe botëkuptimet e dikurshme, por edhe ato të kohës së sotme. Sipas përbërjes, ata mund të jenë të parmë, si *Besë, Lule, Zanë, Shpend, Gjon* etj. ose jo të parmë (emra të prejardhur; të formuar me prapashtesim): *Lulëzim, Besnik, Bardhyl, Fitore, Krenare*; (të përbërë, duke u bashkuar dy tema në një emër të vetëm): *Fatmir, Fatlum, Fatbardha, Arjeta, Besmir, Rilind, Abdylkadri* etj.


Emrat e njerëzve dhe emrat e familjeve (mbiemrat) si emra të përveçëm janë sajuar kryesisht nga fjalë e shprehje të zakonshme të gjuhës, d.m.th. ata burojnë nga njësi të fushave të ndryshme të leksikut të gjuhës. Duke qenë elemente përbërëse të gjuhës, si toponimet ashtu edhe antroponimet zhvillohen dhe ndryshojnë, por ky zhvillim është më i ngadalshëm se zhvillimi i

leksikut të gjuhës, që sjell ndryshime të ndjeshme midis këtyre emrave dhe elementeve të leksikut, nga të cilët kanë rrjedhur këta emra të përveçëm.

Fondi i përgjithshëm i emrave të njerëzve ndër shqiptarë mbërrin në disa mijëra njësi. Po t'i hidhet një vështrim etimologjisë së emrave vetjakë ndër shqiptarët, për arsye historike të ditura, del se antroponimet e shqiptarëve janë me etimologji të llojllojshme.

Emrat vetjakë të shqiptarëve mund të klasifikohen në dy grupe të mëdha: a) *emra me burim vendës* (ilirë dhe shqiptarë) dhe b) *emra me burim të huaj* (kryesisht me burim fetar).

a) *emrat me burim vendës* janë *emra të vjetër ilirë* dhe *emra shqiptarë*. Emra me burim ilirë, të vënë mbi bazën e emrave të përgjithshëm, emrave të përveçëm të vendeve, të fiseve e personaliteteve ilire janë, për shembull: *Pul-ë/-a, Ros-ë/-a, Bjeshkë-ë/-a, Bor-ë/-a, Dash/-i, Gjel/-i, Uk-ë/-a, Zog/-u, Pëllumb/-i, Lul-e/-ja, Shpend-i, Gur-i, Luan-i; Han-ë/-a, Valbona, Saranda, Shkumbin, Tomor, Korab, Vardar; Ilir, Teuta, Ardian, Alban, Arben, Arbër, Arbëresh, Dardan, Gent/Genc, Bardhyl* etj.



Emrat kombëtarë shqiptarë kanë filluar të përdoren dendur nga Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe tanimë po përhapen gjithnjë e më shumë. Ndër ta, ka emra që janë farkuar sipas natyrës së shqipes së sotme nga dashamirët e gjuhës e të kombit, si *Agim, Afrim, Afërditë, Agon, Arlind, Armend, Ardit, Bashkim, Bekim, Betim, Besë, Bletë, Bukurie, Driton, Ermirë, Fatbardhë, Fatlum,-e, Fatmir, Fatos, Florie, Fisnik, Flamur, Lirie, Meritë, Mirditë, Migjen, Rilind, Rrezarta, Shkëlqim, Shpëtim, Urim, Uran, Valon, Vegim, Valdet, Valmirë, Ylber, Yll* etj.

b) *emrat me burim të huaj* janë rrjedhojë e besimit fetar. Në gjendjen e sotme, një numër i madh emrash vetjakë të shqiptarët lidhen me përkatësinë fetare të tyre. Kështu, përveç emrave të bartur brez pas brezi nga koha pagane, kemi edhe emra të tri besimeve më të përhapura ndër ne: të krishterimit, ortodoksizmit dhe të islamizmit, si *Kolë/ Kolec, Mark, Gjergj, Gjin, Gjon, Tereze, Prend, Marie, Nikollë, Andon, Sotir, Mihail, Jani, Stefan; Ali, Adem, Hajdar, Ibrahim, Sefer, Ramazan, Muharrem* etj. Mirëpo, para se t'i marrin këto antroponime, paraardhësit tanë kanë pasur emra vetjakë vendës.

Përveç trajtave të plota, emrat vetjakë në mbarë shqipen shpeshherë përdoren edhe në formën e dytë të cunuar, për shkaqe përkëdhelie dhe për arsye të tjera. Përkëdhelia gjen shprehje të gjerë në marrëdhëniet e prindërve me fëmijët, përgjithësisht të të rriturve me të vegjlit si dhe në mjediset intime, miqësore e shoqërore. Kudo ka pasur (e ka deri sot) një bigëzim formash: zyrtare të shkruara dhe jozyrtare gojore. Trajtat e dyta gojore, që ndonjëherë janë bërë edhe zyrtare, krijohen:

a) për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë për t'u shqiptuar, si *Koço* nga Konstantin, *Miço* nga Dhimitër, *Kosta* nga Kostaq, *Taqo/Taqi* nga Kristaq, *Kolë* nga Nikollë, *Gjy:l* nga Gjylie apo Gjylistan, *Xheva* nga Xhevrie, *Xen* nga Shkëlzen, *Din* nga Nexhmedin, Shemsedin, Burhamedin ose nga ndonjë tjetër;

b) nga nevoja për të mënjeluar dy emra vetjakë të njëjtë brenda familjes a rrethit të afërm familjar, sidomos kur emrat përsëriteshin nga babai, nëna, gjyshi, gjyshja etj. te pasardhësit (edhe

sot besohet se kur nëna lind shumë vajza, duhet një rës t'ia vejë emrin e vet, që pastaj të lindë djalë);

c) Dallimi i emrit të fëmijës nga gjyshi ose vënia e ndonjë emri të përçudshëm a të rrallë që ta mbrojë fëmijën nga “syri i keq”, si *Dak-a, Dok-a, Duk-a, Qok-u, Keç-i, Uk-a, Curr-i* etj.

Emri personal dhe i ndonjë vendi është vënë dhe sot e kësaj dite vihet varësisht nga dëshira dhe shija e njeriut, nga besimi fetar, nga mënyra dhe kushtet e jetesës etj. Por, onomastika ndonjëherë ka qenë nën mbikëqyrje shtetërore. Ka raste kur në shtete shumetnike, nën trysinë e administratës shtetërore, është ndaluar pagëzimi i fëmijëve me emra që lidhen me historinë dhe identitetin kombëtar të popullatës jodominuese, ose është ndaluar përdorimi i formave të dyta toponimike.



Toponimet dhe patronimet për nga prejardhja dhe struktura gjuhësore kanë lidhshmëri të mëdha. Disa emra njerëzish janë vënë në bazë të emrit të vendit dhe anasjelltas, ka raste kur sipas emrit të njeriut është emërtuar vendi. Nga emrat vetjakë dhe format e tyre të ndryshme janë përfutur shumë mbiemra ose emra familjarë. Shumica e prapashtesave janë të përbashkëta, sepse një numër i madh i tyre dalin tek emrat e vendeve, të njerëzve, të grupit etnik, të fiseve etj.

Mbiemrat (patronimet) janë emra familjesh që vihen pas emrave të njerëzve: emri e mbiemri. Në traditën e hershme shqiptare (por edhe të popujve të tjerë) emri vetjak i atit ka shërbyer si emër familjar. Edhe sot në bisedat familjare, me miqtë e farefisin, kur njeriu për të cilin flitet dhe i ati i tij njihen nga bashkëbiseduesi, shpeshherë thuhet emri i personit dhe emri i babait në rasën gjinore (si Urimi i Arifit, Xhemajli i Nazifit); ose mund të përcaktohet edhe raportit farefisnor i folësit me atë për të cilin flet (Urimi i dajës Arif, Xhemajli i bacit Nazif).

Në rastet kur personi në fjalë dëshirohet të përcaktohet edhe më mirë, thuhet emri i tij, emri i babait dhe i gjyshit (Urimi i Arifit të Murtezit, Xhemajli i Nazifit të Hafizit). Kur ka dy e më shumë emra të njëjtë në familje a farefisni, atëherë për t'u dalluar, çdonjëri prej tyre përcaktohet me emrin e babait ose me ndonjë tipar tjetër apo nofkë, si Fatmiri i Hysenit, Fatmiri i Destanit; Adnani i Trashë, Adnani i Hollë etj.

Në krye të herës patronimet përdoren në rasën gjinore (Gjergji i Gjonit, apo edhe në trajtë trigjymtyrëshe, Gjergji i Gjon Markut), ndërsa më vonë u përdorën në rasën emërore (në dy gjymtyrë: Gjergj Gjoni, apo në tri gjymtyrë: emri, emri i atit dhe i gjyshit Gjergj Elez Alija, por edhe në katër ose pesë gjymtyrë).

Mbiemrat, që quhen edhe patronime ose emra të familjeve, në gjuhën shqipe tani përdoren në trajtën e shquar të emërores dhe formohen nga emrat personalë (të gjyshit, stërgjyshit etj.), duke u prapavënë mbareza shquese të ndryshme, por më të shpeshta janë **-i, -u, -aj, -a, -o, -e**, si *Besnik Ymeri, Kadri Agolli; Sokol Bujku, Agron Musliu, Kushtrim Fetahu, Bardhyl Zenku; Fatos Demiraj, Shkodran Bibaj; Gjergj Fishta, Arsim Hoxha, Visar Lika; Zihni Sako, Pëllumb Doko, Drita Hame* etj. Edhe tek emrat e gjinisë femërore, mbiemri nuk ndërron gjininë, krahaso *Arbëresh Halimi - Arbëresha Halimi, Lulëzim Kadriu - Lulëzime Kadriu* etj., siç ndodh në disa gjuhë, p.sh. në maqedonishte ku mbiemri i njeriut i përshtatet gjinisë së emrit personal (Dragi Stojanovski - Dragica Stojanovska).

Nofkat. - Nofka (ofiqi, llagapi) është emër i dytë që i vihet diku për tallje, për shaka a përkëdhelje, duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar tjetër dallues i tij. Mendohet se nofkat historikisht janë krijuar para mbiemrave. Nofkat janë pagëzime popullore, ato nuk janë zyrtare, por bëjnë pjesë në thesarin leksikor.

Nofkat u jepen jo vetëm njerëzve, por edhe kafshëve etj. Rrallë ndodh që ndonjë njeri, sidomos në rini, të mos ketë nofkë, derisa po i njëjti mund të ketë një ose më shumë nofka. Ato përdoren në të shumtën e rasteve fshehtas (p.sh. ofiqet që ua japin nxënësit mësimdhënësve) dhe në një mjedis të kufizuar (si lagje, fshat, shkollë, kolektiv punues etj.). Nofka është krijim momental, shpesh autori nuk dihet, por ai ka aftësi për të krijuar dhe dalluar ndonjë tipar veçues të njeriut. Në të shumtën e rasteve përdoren për tallje, humor ose nënçmim. P.sh. njerëzve me kokë tullace i vënë njërin nga nofkat sinonimike *Koxhaku*, *Llusteri*, *Poçi* ose *Qeli*.

Në raste kur dëshirohet që bartësi i nofkës të përcaktohet më mirë, atëherë para nofkës përdoret emri vetjak, si Faredin *Gjiza* (njeri që tërë jetën është marrë me shitblerjen e gjizës), Sadri *Qeli* (tullac), Qahil *Karadaku* (me prejardhje nga Karadaku i Shkupit, por që fyhet rëndë kur i përmendin nofkën), Sefer *Hunqi* (që vazhdimisht i rrjedhin hundët), Basri *Huneci* (me hundë të madhe), Bashkim *Këmbëmadhi* (me këmbë shumë të mëdha), Afrim *Qorri* (që mban njërin sy gjysmë të mbyllur), Bujar *Stërdhambçi* (me dhëmbë të mëdhenj e të parregullt) etj.

Nofkat mund të jenë personale, familjare ose kolektive. Shumica e tyre krijohen nga brumi i shqipes, por ka edhe me prejardhje të huaj. Ato i kanë tiparet fonetike, morfologjike, fjalëformuese e leksikore të të folmes ku përdoren.

Disa nga emrat e profesioneve që kanë ushtruar njerëzit, në fillim kanë qenë nofka, por më vonë janë bërë emra familjesh (mbiemra), si *Duhanxhiu*, *Sapunxhiu*, *Jorganxhiu*, *Kafexhiu*, *Kallajxhiu*, *Sahatçiu*, *Samarxhiu*, *Topçiu*, *Nallbani* etj., por mjaft i përhapur është edhe profesioni hoxhë, që pasqyrohet te nofka *Hoxha*. Ka edhe nofka që lidhen me ndonjë veçori fizike apo me ndonjë të metë trupore: *Topalli*, *Shurdhaj*, *Buzaku*, *Qelaj*, *Qorraj*, *Curri* etj.

Duke vështruar fondin e emrave dhe të mbiemrave ndër shqiptarët e Maqedonisë, te një numër jo i vogël i tyre bie në sy një mospërputhje me normat e drejtshkrimit, për shkaqe gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Rëndom, veçoritë fonetike, morfologjike e fjalëformuese të të folmes vendore pasqyrohen edhe në emrat e mbiemrat e njerëzve. Përveç kësaj, në antroponiminë tonë kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë, si administrimi në gjuhë të tjera, përpjekja për shkombëtarizim etj. Jo rrallë hetohen:

a) forma të cinguarra të emrave me rënie tingujsh (*Memet* < *Mehmet*, *Asan* < *Hasan*, *Bejtulla* < *Bejtullah*);

b) zh buzorëzimi i /y/ në /i/ që përkon edhe me mungesën e /y/-së në maqedonishte, si gjuhë e vetme e deritashme e administratës shtetërore (*Imer* < *Ymer*, *Ilber* < *Ylber*);

c) mospërdorimi i fonemave /ë/, /y/, /th/, /dh/, /rr/ (*Gzim/Gezim* < *Gëzim*, *Taç* < *Thaç*, *Bardul* < *Bardhyl*, *Raman* < *Rrahman*) për shkak të shënimit të emrave nëpër dokumente personale vetëm në maqedonishte me alfabet qirilik (maqedonishtja nuk i ka këto fonema, rrjedhimisht nuk ka as shkronja për to);

ç) disa mbiemra që duhet mbaruar me -u, te ne shpeshherë dalin me mbaresën -i (*Burhan Alii*, *Aliji* < *Aliu*, *Jeta Jahii*, *Jahiji* < *Jahiu*, *Drita Fetahi* < *Fetahu*);

d) pas viteve 1945 në Jugosllavinë e atëhershme, pati një fushatë të përgjithshme asimiluese ndaj shqiptarëve, në emër të vëllazërim-bashkimit e të unitetit. Në këtë frymë, në zyrat e gjendjes civile mbiemrave të shqiptarëve u shtuan mbaresa sllave: *-iq, -viq, -ovski* etj. Kështu, *Ukaj* u bë *Ukiq*, *Bajrami* u bë *Bajramoviq*, *Mehmeti* u bë *Memedovski* etj. Disa mbiemra me mbaresa të tilla ende ruhen;

dh) tek emrat personalë në gjuhën shqipe emri përdoret para mbiemrit (Gjon Buzuku, Gjergj Kastrioti), ndërsa në maqedonishte herë para e herë prapa (Stojan Andreevski ose Andreevski Stojan), dhe kjo ka ndikuar që ndonjëherë edhe te shqiptarët e Maqedonisë të bëhet ky ndërrim vendesh, gjegjësisht të shkruhet ose të thuhet mbiemri para emrit (Latifi Bejzat).

Duke e vlerësuar emrin vetjak si shenjë e rëndësishme e njeriut, si shprehje e vetëdijes kombëtare, deri më tani janë botuar disa fjalorë të emrave të parapëlqyeshëm vetjakë, si udhëzues për pagëzimin e fëmijëve me emra të bukur e të gurrës shqipe, me një fond të pasur (me rreth 5000 emra meshkujsh e femrash).

Nuk ka arsye që rregullat e përgjithshme gjuhësore si dhe planifikimi gjuhësor të mos përfshijnë edhe onomastikën. Prandaj, është e nevojshme që edhe në këtë lëmë të shkencës, që lidhet me praktikën e përditshme shoqërore, juridike dhe administrative të merren masat e nevojshme. Zhvillimi i gjithanshëm i gjuhësisë sonë kërkon që edhe emrat e vendeve, emrat vetjakë dhe mbiemrat të jenë në përputhshmëri me rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde.



Pyetje, ushtrime e detyra:

1. Ç'është antroponimia dhe si degëzohet ajo?
2. Si mund të jenë emrat vetjakë sipas përbërjes te shqiptarët?
3. Në sa grupe mund të ndahen emrat tanë vetjakë sipas burimit?
4. Përveç formave të plota, a përdorim edhe forma të dyta të cinguar të emrave vetjakë dhe pse?
5. Ç'janë mbiemrat e njerëzve, në cilën rasë janë përdorur dikur dhe si përdoren tani?
6. Analizoni emrat vetjakë, nofkat e mbiemrin e familjes suaj (për nga burimi, kuptimi, përbërja gjuhësore, format e plota e gjegjëset e tyre të cinguar, formën zyrtare e jozyrtare, përputhjet apo mospërputhjet me rregullat e drejtshkrimit etj.).
7. Thoni disa nofka njerëzish dhe arsyetoheni emërtimin e tyre!
8. Si do t'i pagëzoni fëmijët tuaj?

11. TEKSTE DIALEKTORE

11.1. TEKSTE NGA TË FOLMET E GEGËRISHTES

Ondrra u bā: zhgāndërr

Kur ngrāihet sabajle ish ka:n dit e xhuma:// I thot babës vet: "E kum pa ni ondërr" (ama gjali n'bilik)//

- Thot kallxoma!

- S'ta kallxoj! / se s'i ka tha:n hajr ishalla/ ene baba j vet t'ja palloj n'shpāull//

Si erdh vakti xhuma:s secalli njer ç'i shkon n'xhuma: pe vet: "Pse ka:n be?"

- Thot: "E kum pa ni ondërr//

-Thot: "Kallxoma!

- S'ta kallxoj!// Sicalli po ja mshon ka ni shpāull// Māir ama n'at kataund ish ka:n ni padishah ose mret// Kur kapërcej aj i thot: "Pse kan be gjal?"

- E kum pa ni ondërr//

- Kallxoma!

- S'ta kallxoj// Ene aj kap e mu:r e msheli/ e kish pa:s shpēiën ngat// Ene shkoj n'xhamāi// Dul pej xhamāiës//

At'her kralija kishin pas takmiçenje¹ me krali:t/ me k'ta t'part e ton/ me bajrakta:rt// Krali i thot ktāi mretit: "Si t'mundish me gjodit, kam me ta dha:n çikën/ si mo t'mundish - kam me ta marr"// E shka me j çu: .../ ja çoj trāi molla// Cëlla asht e sivjetshme/ cëlla asht e vjetshme/ cëlla asht e parvjetshme? Mollat krejt ni çeshit//²

Ki ene rrafi dobosh// U mlodhën kah jan e kah s'jan djemnia// S'an pe gjoditin// Ki gjali po rri n'burg// Ajo çika mretit i tha: "Thāuj babës tem le t'çese ene tāi!" E çiti. Ki gjali thot: "Ma bini ni ko:f! E mbushi me u:j/ kap ato mollat/ kllum n'u:j// Ajo e sivjetshmja ra n'fund/ ajo e vjetshmja mbet n'xhime/ ajo qetra n'krit// E gjoditi.

Krali s'po kandëis³ ashtu// Thot kam me ta çu: ene ni nishan// Hajde çoe!// Kam me t'i çu: trāi bullāica: ni kime/ ni vuxhut/ ni bri:// Cëlla asht e sivjetshme/ cëlla asht e vjetshme/ cëlla asht e parvjetshme?

Opet ki rrafi dobosh// S'un pe gjoditin// Ki gjali nin// I msheli bullāicat n'ahër e t'ju hini n'qitek ...// Kur i lshoj/ ajo ma e forta dul përpara/ ajo e lishta - mas/ ajo ma e vogla/ menxi ç'i po del// I gjoditi//

Thot ene ni nishan kam me ta çu:// - Hajt thot çoe! Xhit me j çue ...?! Ja ka çu: tre gjur mullāini// Kush mundet me j shpu: me ni fuçi ene nja: mbāi nja:/ me ni t'mshume?!

Ki opet rrafi dobosh// At'her ki gjali du:l ene ding/ tu tre gjurzit i shpoj. At'he:r aj mreti tha: "Çe çikën/ çe mallin/ çe kejt// T'kofshin !//

- Po thot çe çat ondërr e kum pa:// At'her ja kallxoj ondrren// Po t'bahësh hazër e t'shko:jm te krali se kem me ja ma:rr ene çikën e atāi//

- Po ene çat ondërr e kam pa/ ç'i me: ma:rr ene çikën e atāi//

¹ takmiçenje – sllav. gara

² ni çeshit - njëlloj

³ kandëis - pajton

Ene u nëis ki tek/ vetën// Ki krali ka ba: jemek për treçin ve:t// Kur tu shkue nja:ni ni stre:ll⁴ e ka fu:g n'çi:ll para ni motmoti// Çat dit pe përgjon t'pâike//

- Shka ban be gja:l?

- E kam fu:g⁵ ni stre:ll n'çi:ll para ni motmoti/ pe përgoj t'pâike//

- E be gjeth kit fuçi:!

- Kurgja: une// Dhandrri mretit tre gjurzi mullâini me ni t'mshume i ka shpu://

- Une jam aj// - A bahesh shoç me mu:?

- Po//

U ba: vet i diti// Hajt/ hajt ma përte nja:ni e ka ma:rr ni marti:n⁶ sa t'i shohin sâit larg nishanin⁷ pe: vret//

- Thot: "Shka: ban be gja:l me kit marti:n?"

-Thot: "Sa t'ëm shohin sâit larg une vras"// - E bre/ thot/ gjeth kit fuçi:! - çaç larg me: vra: nishanin// Kurgja: une// Dhandrri mretit tre gjurzi mullâini me ni t'mshume i ka shpu://

- Une jam aj// A po bahesh shoq me mu:?

- Po// U ba: vet i treti//

Hajt/ hajt/ ma përte/ nja:ni ja ka vu: veshin tokës po ngjon narodin⁸ shka po folin hem n'to:k t'poshtër/ hem n'to:k t'epër//

- Thot: "Shka ban be gja:l?"

- Çe po j snimatim⁹ narodin shka folin hem n'to:k t'poshtër/ hem n'to:k t'epër// - He bre gjeth kit fuçi:! ... U ba vet i katërti//

Hajt/ hajt ma përte nja:ni i ka ma:rr nja di-tri tërplote¹⁰// Njanën ja ka vu: beshkës Sharrit/ njanën k'saj, ene pi luhat kodrat e Allait n'tërplote//

- Thot: "Shka ban be gja:l?"

- Çe/ jam tu: zanima:t¹¹ me kodrat e Allait// ... U ba: vet i pesti//

Hajt/ hajt/ nja:ni ja ka vu: turëin Vardarit ene bërtet: "O vdiça për u:j! O vdiça për buk!"

Veç ni nje:r bitevêi¹² Vardarin me shtëi n'to:k ene mos me u frâi//... U ba vet i xhashti//

Hajt/ hajt ma tugje nja:ni e ka li:dh ni gjur mullâini me ni ka:m/ ni gjur n'kamën qetër ene n'koft ç'i kan shku: n'Shkup për tre sahat/ ki për tre dakika po shkon me çat ransâi//

- Thot shka ban be gja:l me kta gjurzi?

- N'koft ç'i i ka Shkupi tre sahat/ une për tre dakika shkoj//

- E bre tha gjeth ket fuçi:! Çaç hëzli¹³ me hec!

- Kurgja: une// ... U ba vet i shtati//

Kralia po kshirin me dilbia // N'koft ç'i ja:n çata/ kena me: kall ni fu:rr e mej gjeg me magnet// N'koft ç'i jan çer:r, kena m'i përgju: si duhet// Kur mrrâin/ çata//

- Si bohet/ tâi ki a:rdh me shtat ve:t/ une kam ba: jemek për treçin ve:t?!

- Kadale/ ma fjalt e huxhta se frëik mirrna vesh, ene pe çet kit t'Vardarit përpara//

⁴ stre:ll - shigjetë

⁵ fug - hedhur, gjuajtur

⁶ marti:n - pushkë, lloj pushke

⁷ nishan - shenjë, cak

⁸ narod - popull, njerëz

⁹ snimat - incizoj, përcjell, vëzhgoj

¹⁰ tërplot:t - lopatë druri

¹¹ zanimat - merrem (me diçka), kaloj kohën (me diçka)

¹² bitevêi - gjithë, tërë, krejt

¹³ hëzli - shpejt, furishëm

- Ku i kini kazanat?
- Çe te i kan nreç// Ki veç po u frâin kazanave ene hërp/ kazanat ka e prapa ene veç bërtet: "O vdiça për buk! O vdiça për buk!"
- Thot kallne at furrën/ m'i gje:g// E kallën furrën// Ki ni t'frâime ene u fâik furra// Hi:n agje ene po bajn muhabet//
- Thot shko kshirne a u dogjën!
- More/ po bajshin muhabet!
- Çitni ktâu jasht se nôuk asht pu:n// Kur dulën jasht ata: "A pe ipni robin a jo?"

.....
 Pe apmi po e kina ni çeshme tre sahat larg u:dh// Si t'muni me shku: për tre dakika ene me ardh po va apmi// Ki me gjurzi mullâini u nâis// Për ni dakik shkoj/ mushi u:j ene e zu: gjumi ndër ni hije molle// Ki me at martinën po kshir...// E ka za:n gjumi//

- Thot: "A t'çes me marti:n e ta pkuti ni mo:ll e t'i bere n'ball t'ja çes gjumin? I rrâiti mollës tan/ molla i ra n'ba:ll ene ja çiti gjumin// Për tre dakika mrrâini n'vend//

- A pe ipni robin a jo? Opet kta nuk po du:n me dha:n...// Kur ja vu: ki ata terplotet shehrit/ ni t'shkunme/ bitevëi n'tok//

At'her hem shokve ka nja ene për veti/ i mu:r ene çikën e kralit ene çikën e mretit// ...

- Çiket ondërr e pa:sh//

Luboten (Karadaku i Shkupit), 1995
 Materialin e regjistroi:
 Asllan Hamiti

Rrëfeu: Rushit Jashari nga f. Luboten,
 69 vjeç. I lindur më vitin 1923, jeton në
 këtë fshat, nuk ka lëvizur shumë nga
 vendlindja, bujk, i pashkollë.

* * *

N'dimdhâitën sene kur ka hî: Serbia

N'dimdhâitën sene kur ka hî: Serbia ka shku: Turkia// Ka hi: Serbia ene kur ka hie si ja ka ni:s pi n'Gillan / tu i grî shipta:rt// Ene jan çue ata ma ca:ll/ me gra:/ me kejt me shku: n'Shkup// Kur kan ra n'Butel t'Shkupit/ atâi askeria jan kanën ene k'to dimdhe:t co:p kata:ne/ me ca:ll/ me kejt// Ene i kan hunxhën komkrâiq// Sicalli asker pushkën kah gjinja e kan thkâi ene përgjo:jn kumandantin mu va dha:n kumandën//

Kumandanti shkon te ni grue pi Izvori ene ja nre perçen me e marr për veti me çu: n'Serbi//

- Ajo bërtet: "A ka shipta:r n'duja:/ veç n'Serbi mos me m'la:n me shkue!"

Ni breznjan/ Kadri Breza/ i thot: "Hajt mos ki gajle moj fisnâike// N'kofsha nja çu kam me ka:n nër Serbi s'kam me t'la:n"// Shkon te ni shoçi vet/ Murtezan pi Strime// Thot: "Çat alltie me ma dha:n!"

- Thot: "Vallahi n'Lubeten e kam la:n/ nuk e kam// Ni saki:c n'kal e kam/ si ta dush shko te kali e kam mlu: me ferexh// Thkehet aj/ shkon te kali/ e merr sakicën ene e shtëje ner lu:rk// Tu afra:/ tu afra:/ u afra:// Aj kumandanti thkâi kah gruja te agje// Ene ma ki pi n'ket a:n i be/ ja he:k kriet ene aj rrxohet//

- Ene ma bërtet: "Kush â:, ikni se na mloj xhaki!"

Kush ka mun ka ik/ kush s'ka munën i kan vra atâi// Ca:ll/ gra: kan bri:t/ po akshã:m ã: kã:n// Ene ma aj ffillon dikah// Ajo gruja nisët përmas m'i shku://

- Ki i thot: "Aman mas mo m'hajde!" M'tho:jn hallki doni llaf/ mas mo m'hajde ma:!"
At'her ffillon aj// Sollarija¹⁴ i vihen mas// Aj shkon / hip me ni da:rdh. Aksham. Ata sollarija kapërcejn me kol ene ki at'her n'qetrën a:n// Ma pi atâi vâin n'Bre:z/ n'kata:n t'vet//

Atâi sa kan mu:n me vra:/ kan vra:// Sa s'kan munën kan ikën po ç'i t'sha:mtit ja:n kurtali:s// Ni grue ish vra: a di ca:llt kishin met xha:ll// Nja pi Izvori i merr gja:l e ca:c ene ka ik tërma: / përmâi Luba:c// Atâi ato jesin// E hek lurkën/ i mlon gja:l e ca:c/ vet ik//

.....
Kur kan shku: tont me nrra: kampira (n'at zaman çashta: ni kol kampira ene me hec dunja:n) ajo ka da:l/ thot:

- Kah jini?
- Pi Breze//
- Po tãi xhit jie? (shipen se kish harra: hiç)
- Na ka la:n baba atâi/ kur u çu:m n'sabah vllaj m'kish vde:k/ mu m'kan ma:rr / m'kan rrât/ m'kan marta:/ jam ba me ca:ll/ me pu:n/ veç se une jam pi Izvori//

f. Brezë (Karadaku i Shkupit), 1996
Materialin e regjistroi:
Asllan Hamiti

Rrëfeu: Avdi Kadri Abazi nga f. Brezë, 65 vjeç. I lindur më vitin 1931, jeton në këtë fshat, nuk ka lëvizur shumë nga vendlindja, bujk, i pashkollë.

* * *

Pat shku: ni he:r me ni mëik temin n'Turki:// Mëir po me voz tu shku: ka Edrenja ni gjerman kish ma:rr ni le:nt//

- Thot: "Mushe me kajk ship!" Ama ç'i mu mtekshin/ s'mu mtekshin// Ene aj mëiki thot: nëisja// T'kum pa n'be:shk tu knu: hiç pa na:l/ ktu s'un ja nëis! // Ama njeri kur s'e punon ni pu:n ã: zor// E ja nëisa ni kajke/ e çova/ ama me zor//

.....
Përpara a: ka:n si zakon te na ç'i mos me ra breshën ene me rujt verën/ pe: za:m/ dilshin ni gja:l e ni çik natën okolla shpëiës/ ni teneqe i bishin ene britshin: "Elemëia/ delemëia/ hikni bolla e xharpëia// Xharpëit mos me t'kaç//

f. Bllacë (Karadaku i Shkupit), 1996
Materialin e regjistroi:
Asllan Hamiti

Rrëfeu: Tefik Koka nga f. Bllacë, 66 vjeç. I lindur më vitin 1930, jeton në këtë fshat, nuk ka lëvizur shumë nga vendlindja, bujk, i pashkollë.

* * *

N'Shingjergj përpara k'tu n'katâund to:n ã: ka:n si tradi:t // Dilshmi ditën e Shingjergjit / i shlojshmi xha:n // Ma s'pari dilshmi nëpër ara / i ngulshmi ka ni krane nëpër bima/ mas anena i

¹⁴ sollaria - xhandarmëria

shlojshmi xha:t ene i krëipshmi // I bishmi n'dre:k te shpëia n'menjez e hajshmi fli:// Masi hajshmi fli: / dilshmi me ni livadh ose n'çarra// Dilshmi / lujshmi kadi:ja/ topçuk, topako:ll// Çeta pu:n ishin at'her//

.....

Çetu te na n'Fu:sh t'Shpellës ã: ni bi:r ose ni shpe:ll ç'i kallxojshin t'pa:rt përpara/ pleçt/ ç'i lepri ka hi k'tu:/ ka dalën n'Kriva Re:k - n'Kaçanik// Çaç shpe:ll e gja:t ç'i asht// Sod me hi:/ pe za:/ munësh serbez n'ka:m me he:c/ veç tutët mileti me hi//

f. Bllacë (Karadaku i Shkupit), 1996
Materialin e regjistroi:
Asllan Hamiti

Rrëfeu: Emërllah Fera nga f. Bllacë, 58 vjeç. I lindur më vitin 1938, jeton në këtë fshat, nuk ka lëvizur shumë nga vendlindja, bujk, i pashkollë.

* * *

Po kallxon aj mullixhija çish ja bi:n hallki drithin pa përsho:sh e t'përshosht/ çikaç ka blu: mullëini jem ... e po haka:t me: rre: lavërtarin// Lavërtari e përgoj terti i du:l n'çosh rrenës// Tha a: ki ma be shoç? - Jo tha// - Une po t'kallxoj kshtâu//...

Une tha me ni ko:h kur jam kã:n ma i ri / baba ka pa:s shâum ble:t// Shkojshna i rujshna ble:t xheth ditën/ n'aksham i bishna// Kur ni dit ni ble:t m'kish hu:p// Dul baba po i kshir n're:n ato ble:t// More/ filan bleta s'ka a:rdh bre!

- Thash: "Vallahi ka hup!"

- Po m'thot baba hup edhe ti// Ja e xha:n at mëiz blete ja n'shpëi mos um hajde!

- Haj kuku për mu! Ku xhinët mëiza e bletës?! Rash n'hall// Kah i kishna pa:s ble:tt s'u hecke ma//

E kum marr knusin e i kam hip// Knusi m'ka flatru:// Ha:jt/ kah ja:n kanën ble:tt// E knusi m'murr m'çiti n'kep t'Lubetenit/ n'maje t'kepit// Mirpo/ n'maje t'kepit ish ve:ni pak si rrash/ s'un shihsha kurgja// E mora xhilpanën e ñula n'maje t'kepit e po kshiri// Kur kshiri ... n'Ga:çk e kish xhet ni i gaçkës mëizën e bletës/ e kish za:n me kavin e livrojke// Apet i hipa knusit e rash n'Ga:çk//

- Puna ma:r be shoç!

- Ma:r paç.

- Pse be ma ke za:n bletën kshtâu?!

- Po e xheta be.

- Po a po e sheh be çish ja pahe vra: çafën bletës/ e pahe ba vira:n?! Ku e çoj u:n ma kit ble:t ç'i baba ka mëm mëit?!

Ki ç'i e xhet mizën tu livru/ aj shka i rujke ble:tt/ po i thot mullixhi:s: "Cilli e mujtëm me rrena?" - Le:/ le:/ ti kur hipe n'knus e pash ç'i m'mujte// Knusi se çon njerin!//

f. Tanushë (Karadaku i Shkupit), 1996
Materialin e regjistroi:
Asllan Hamiti

Rrëfeu: Mejdi Xhaferi f. Tanushë, 74
vjeç. I lindur më vitin 1922, jeton në
këtë fshat, nuk ka lëvizur shumë nga
vendlindja, bujk, i pashkollë.

* * *

T kishna pa:s / edhe ù i stra:jc pare / jesh shkua / edhe ù me vllazën / e kishna pa: dorën e
Zylfi:s // gjì natën e g-ja:t nuk flë / ën nate / kur çohet i bje narmën për mikun e t et/ ù tho:t dua
me shkua me ja ly:p i stra:jc pare se / noshta mi jep // e çohet ky prej atyhit / e bjen ën Pazar / si
me ra: Gusi: / e ly:p me ëmen se kush ã ay // edhe e gje: mikun e babs / ën o:d / me mjekërr de:j
ën brez / edhe falet me tã // si je: / ku je: i tho:t/ i ku:j je biro / tho:t jã i biri filanit / prej filan
katunit//

Rrëfeu: Sokol A. Bruçaj, 70 vjeç, Vuthaj - Guci
Marrë nga: Mehmet Ahmetaj, *E folmja shqipe e Plavës dhe e Gucisë*,
Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 335

* * *

Kishte qonun ni qak ene i kishte çômun gjemt (vocat) n'mal për dru:// Ata i kishin thon:
"O ba:b/ po t'na prëshet çierria ne s'dim ta gjodisim"// Baba u ka thon: "Fkateni nevojën ene
dë e gjodisni"// Ata kur kan shkômun n'mal o prëishun çierria// Njoni pi gjiemve ka dalun ene
ka bërtëit: "Oj nevo:j/ ajde t'na e gjodisish çierren!"// Amon/ iç kërkush s'erdhi/ Mësëndëi ata
kadal - kadal nëisën vet ta gjodisin// Kur ishin kthëimun n'shpëi i kishin thon babës vet: "Ce na
rrene o ba:b/ na thae ta fkasim nevojën t'na e gjodise çierren/ ene ne fkatëm e fkatëm amon
kërkush s'erdh"// Ater aj u tha: "Epo çajûo osht nevoja/ kur s'ka kush dët ndëife a ke zor/ ater
msoesh ene e sos pounën vet"//

Nga e folmja e fshatit Dollogozhdë, Strugë
Rrëfeu: Abdulla Zhaku 81 vjeç, bujk i pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari – Qamili

* * *

Kishte shkôu dy-tre er// Po shëi çish ka bo// Minjirend ka ik pi shpoes en kërkound s'un
shkue// Ni ftojr i ka mbet ni pllo:m// Asnjo pllac s'o shëit/ ta shese at/ ta marre at afër atëj/ kto
n'komshëi// En i tha mëirre// Po Dilit i ka thon aj voci// Ka ardh me niçin e pesët mi: fronga//ene
i kan thon atij eipja kujt dush se ôun nuk moundem// Ene aj ja dha atij/ vocit Nasoufit// Mëind
s'ka// Nuk mëjret ar tështëi/ kan dalldis n'Stru:g njerst q'era er ka thon ... nuk mblidhet pare
kollaj/ aj qi mbl'edh/ mbl'edh// S'ën xhish nisend me ata pare// Çish prëishi nisend vëit ne ta
b^uoe//

Nga e folmja e fshatit Veleshtë, Strugë
Rrëfeu: Halim Zhuta 77 vjeç, bujk i pashkolluar

Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Voci Myfterëimes ka prômun dymdhëmi: fronga ene i ka bo rrugt// Kan qon ata rrugt
têirs// Ke kuôdra e kuçe përreth-përreth ka bo ni rru:g// me paret e veita// Ki i ka ap me bagerr i
ka bo ka katër metër// Ka punou bagerrri kshy sa di:t// ene për ourën ka dhon pare aj/ m'duket//
Ktôu përfond shpëis/ pi andi// Ja kur t'shkûojm ka Struga dë ta shofish// Pi i vûogël ka shkôu
n'Shvajcari// Amo Austria jep ma môir pushim// Njer n'katërmdhë:t muj e pagjuojn// Di këndi/
di andi// Kour? Xhashçin ejro n'muj// Nêive na ôipshin dyçin euro n'muj//

Nga e folmja e fshatit Veleshtë, Strugë
Rrëfeu: Hajrije Nasufi 65 vjeçe, amvise e pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Qi thoshin përpara s'ke c'tbojsh/ ke nosja vllait s'un fûolish// Tu dija noset t'mojra jon//
Tështëi kur t'voe vëirës ta ape côucën// Po i vûogël mi o:sht voci/ s'e di si e qujn// Nuk dijet//
Kurxho s'kisha gj'e ala// Ôune veç bib'ërka/ ja sa kjûo e gjat/ kto t'gjona// Ktôu o: qetër soj/ epo
gurbîeti// Me internëit u njoftôun// Shiqir çashto e bon dasmën// Po mo ken do t'i bojn// i bojn
njerzit pi ktôu/ jo agje// Ja tëj si i ndrôve me trosëita/ me masa/ me gjoja/ krita i ndrôve// i ka
durt quôt// Tështëj çish t'i shkojsh agje/ çish dët ape// Kor t'vëj mi? Kishin thon sa e k'ëçe/ për
mouve ene ka ca njiers t'kçi ajuo// Mo vrrajt mi ce m'i qase vesht// Ene mo gjazi ku na shkote//
A sa kimi ç'esh//

Nga e folmja e fshatit Veleshtë, Strugë
Rrëfeu: Hajrije Nasufi 65 vjeçe, amvise e pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Kishte quon ni qak ene i kishte çôu gjemt n'mal për dru:// Ata i kishin thon: "O ba:b/ po
t'na prëishet çierrija ne s'dim ta gjodisim"// Baba u ka thon:"Fkateni nevojën ene dë e
gjodisni"// Ata kur kan shkôu n'mal o prëishun çierrija// Njoni pi gjiemve ka dalun ene ka
bërtëit:"Oj nevo:j/ ajde t' na e gjodisish çierren!"// Amon/ iç kërkush s'erdhi/ Mësëndëi ata
kadal - kadal nêisën vet ta gjodisin// Kur ishin kthëi n'shpëi i kishin thon babës vet:"Ce na rrene
o ba:b/ na thae ta fkasim nevojën t'na e gjodise çierren/ ene ne fkatëm e fkatëm amon kërkush
s'erdh"// Ater aj u tha:"Epo çajo osht nevoja / kur s'ka kush dët ndëife a ke zor / ater msoesh
ene e sos pounën vet"//

Nga e folmja e fshatit Livadhi, Strugë
Rrëfeu: Zeqije Ziba 70 vjeç, e pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Hoxha me tre ofçart

I kish pas pasën hoxha njëcin co:pa dhën e dhi:/ e kish pas ly:p ofçar me jav rujt dhën e dhi:t// Ishin pas kōn tre: vllazën fukara ç i kishin da:sht me shkue// I madhi thot:

Une po shkoj se jam maj madh// Ata ishin godit me hoxhën pi n'Shmitër deri n' Shinxherxh/ e cëlli t'idhnohet me jav hek tri dre:dh likur//

Ditën e pa:r shkoj me dhe:t e ly:pi bukën// Hoxha mazi u pjek buka/ ja lidhi n'bi:sht zagarit e i tha zagarit çoja bukën// Kur e pa ofçari nuk e hōnge:r bukën//

Kur u kthye i tho:t Hoxha: A u idhnove? Aj thot po va:llaj/ une bu:k s'ën hōngra// Hoxha ja he:k tri dre:dh edhe shkon//

Masa:nej vjen i dyti vlla/ e edhe me to ishin pa:s gotinën nja:hit// E si i pari edhe ky u nis me dhe:t n saba// Hoxha mese:len e njejt ja bōni edhe ktina me çenin e me bukën// Kur ja çōn/ as ky se hōnge:r/ e kur u kthy e veti Hoxha: A u idhnove?// Aj i tha po va:llaj/ ja heki tri dre:dh edhe shkoj//

I vogli tha shti shkoj une e ja kallxoj çefin// Kur shkoj i vogli e kish pas pasën edhe ni çifte me veti// Shkoj diën e pa:r / e hoxha apete meselen e nje:jt me zagarin// E ofçari e ha: bukën e e vre:t zagarin// Kur vje:n n'aksham i tho:t Hoxha: A u idhnove? Aj i thot jo// E mas darke nu:sja e hoxhes pe thi:rr zagarin/ e ofçari i tha hiç mos e thirr se e kōm vra: un// E ti Ho:xh a u idhnove? Jo/ jo/ tha hoxha se z'guxojke//

Kur t'ne:srit hoxha i thot du:e me mi pru: dhe:t tu kesh e dhi:t tu kcy:// Ky i tha ani hoxho se une s'ta prishi// N'aksha:m aj i zu dhe:nt e jav prêv ka ni bu:z// I zu dhi:t e jav prêv ka ni kōm // Kur i pa Hoxha dhe:nt tu kesh/ e dhi:t tu kcy:/ ama ni here z'guxojke me bō zō/ e t'nesrit kishin pas co:f edhe dhi:t edhe dhe:t// Shti hoxha u idhnu: e ja heki tri dre:dh likure hoxhës ofçari//

Nga e folmja e Preshevës
Materialin e mblodhi: Nurane Destani

* * *

Kullu sa t'dush se ma nuk ja shkurtoj

Ishin ko:n dÿ sho:k tÿj shku: udhes// Pa pri:t e pa kujtu:/ jav prejti udhen ni dhelpën // Hecen shka hecen/ hinen me ni konak// U çel muhabeti/ e njâni pi ktyne dy shokve i kish pa:s adet me rrêjt/ e tha: - e kena pa sod ni dhelpen/ e kish pa:s bishtin xhashthet pllâm t'ga//t // Shoçi vet u kÿll ni here/ m'i dhân isharet ç i mos t'rrêjn aç shu:m //

Ky e diktoj /e u kthy: e tha: - për xhashthet pllâm nuk e di/ veç katërdhet sigurisht i ka pa:s// Shoçi tina u kÿll edhe ni here/ e aj ra nizat pllâm// Mÿrpo/ shoçi u kÿll edhe ni here/ e ky ja shkurtoj edhe dhet pllâm// Kur u kÿll s'katri here/ ky ja kthej: - Kullu sa t'dush/ se ma nuk e shkurtoj//

Marrë nga Z. Rexhepi, *Kabashi i Moravës së Epërme*
(Viti afër Gjilanit, Kosovë), monografi, Prishtinë, 2003.

* * *

N'u kryet krypa – pjell edhe mushka

Ishin ko:n shku: nihe:r pariya e Moravës t'Po:shter mu:safir te pariya e Moravës Epërme//
KÛr u unxhën me hañer da:rk/ ço°rba s'kîsh pa:s krÿp sa du°het// Për me mlu: marren e t'zojës
t'shpijes/ ni krën i Moravës Epërme tha: - Hani more miç e dashamîr/ se na krypen e marmri
n'Tasjan (Ferizaj) /po dishka/ sivjet po na krymet kry°pa//

- N'ju past krym krypa/ shkoni e mjelne mushken/ e stërpikne krypen me tamël
t'mushkes/ e i myt krymat menihe:r/ ja kthëj ni krën i pariyes t'Moravës t'Poshter//

Po mushka s'pjell hej// as s'çet tamel/ ja kthej kreni i Moravës Epërme// - Po mos pjë:llt
mushka/ nuk krymet as krypa/ i përhexhi kreni i Moravës t'Poshtër//

Marrë nga Z. Rexhepi, *Kabashi i Moravës së Epërme*
(Viti afër Gjilanit, Kosovë), monografi, Prishtinë, 2003.

* * *

Sa her de:s njeri

Ishin ka:n tubue pleçt e Kosovës me ni vën// Ni plak e veti bajraktarin:

- Hajde me na kallxue dishka bajraktar //

Ky foli:

- He/ - tha – more pleç/ kur e kem zotin e shpi:s me veti/ nuk e kem zakon me fo:l mashkujt çer
para tij//

- Ka keni t'zotin e shpi:s?

- E kem Ramadan Shabanin//

- Çet hunmadh a?!

- Po! //

- He/ ti hunmadhi i Kosovës/ me na kallxue sa he:r de:s njeri//

- Njeri de:s tri he:r n'jet t'vet/ u përhexh Ramadani//

- Deka e pa:r ã:sht kur t'ja marrin xhemt zotshpllakin//

E dyta dek ã:sht kur ja mshelin dallap e sanak e s'ka me shka me j nerue miç e dashami:r//

Deka e tret a:sht për njerin kur nuk e nero:jn shpija/ as kojshija//

Kur de:s taman/ at'her nrro:n je:t//

* * *

Për ni fja:l, tri t'kosutne shku:n fa:l

Ish ko:n tÿj shku: udhes vjehri me t're:n// E reja ish ko:n nuse e re/ ish ly: e nxhy: si â
adeti/ e ish ko:n shumë e hëshme// Përskëj udhes ish ko:n do livadhe/ e kositshin do kosa:ç//
Krejt kosa:çt e nãle:n t'kositnen/ e ju mët syni n'kët nusen// Njâni pi ty:ne s'u duru: pa fo:l : -
Oj/buskuçja bacit/ lÿm aj bu:rr çit t'paska!//

Vjehri e ni:jtiti kët fja:l/ s'i ërdh hiç mi:r/ po e unxhi kry:t e heci udhës me t'rejën e vët/ e
shkôj n'shpi// Kosa:çt i kositÿn livadhet/ sana u tër/ e i banun stôxh// Vjehrii ksajna nuses/ shkoj
na°tën e jav shtini zjarmin stôxheve/ e ja ka°lli sanen// Vjetin e dy:t apët jav kalli t'kositnen e

dy:t// I zoti liva°dhit nuk e di:kke se kùsh p'i ja ka:ll sanën// E ky u çu: e ja ka°lli sanen edhe vjetin e tre:t//

Màs trí vjete ju çõj fja:l// U mledhën bu°rrat me pleçnu: kët pu:n// Meshlisi e çiti fajtor atâ çì kish pàs fo:l pa vën/ e ku z'duhet// Tri t'kositne shku:n fa:l për nì fja:l/ e bile: ja prejten edhe me pagu: xhÿs xhâ°ki/ se kish pre:k n'ërz e n'námüz//

Marrë nga Z. Rexhepi, Kabashi i Moravës së Epërme
(Viti afër Gjilanit, Kosovë), monografi, Prishtinë, 2003.

* * *

Katunari pa nafa:k

Ish ko:n nihe:r ni bu:rr e ni grue// ishin ko:n shum fukara: // gru:ja ni dit po: j thot burrit t'vet: - Shko e lipe nafakën/ nashta po e xhen// Burri e ngon gru:jën edhe nisët me shku:// Tu hec udhës/ i zatet do xhin çì jan ko:n melaqe/ po ktij po j dukën si puntor çì po pre:jn dru// Katunari ve:t// Kam dal me lip nafakën/ a e dini se ku muj me e xhe:t?// Puntor:rt i tho:jn/ - Rri me neve tri net e do ta shifsh se shfa:r nafake kije //

Natën e pa:r e ço:jn katunarin me ni shpi t'madhe e t'mi:r // Mas darkës ven ni zã pi jasht// Sonte ka le: ni thmi/ çish t'ja lom nafakën?// Nafakën po ja lojm sikur çish jemi sonte/ demek (d.m.th) thmija do t'ket nafa:k t'mi:r//

Natën e di:t shkojn me ni shpi jo aç t'mi:r// Edhe ati mas darkës ve ni zo dhe vet për nafakën e ni thmie çì ka le:// Nafakën po ja lojm sikur na çish jemi sonte// Natën e tre:t katunarin e ço:jn me ni shpi shu:m t'keçe ku s'patën shka me hangër // At na:t be edhe shi e shpija nis edhe me rre:dh/ po edhe asaj nate ve:n ni zo edhe vet për nafakën e ni thmije// Sikur çish jemi na sonte/ - tho:jn melaqet// Kur çohen n'sabah i tho:jn katunarit: - Çe edhe ti ke le ksi nate/ si sonte edhe je pa nafa:k//

Ajdin Mustafa, bujk 83 vjeç
Kumanovë, Maqedoni

* * *

Dy gra:t en gjali

Kan qien dy gra: / njûona¹⁵ ka pa:s ni xha:l / qietra s'ka pa:s yq¹⁶ // Ni dit bâurët¹⁷ u kan vde:k / en¹⁸ jen rrok¹⁹ gra:t t'tuzhiten²⁰ // Të dyja gra:t e gërkâujn²¹ xhalin// I sudit²² dovletit²³ /

¹⁵ njûona – njëra

¹⁶ yq – hiç, asnjë

¹⁷ bâurët – burrat

¹⁸ en – dhe

¹⁹ jen rrok – janë kapur, janë zënë

²⁰ t'tuzhiten - të paditen (para gjyqit)

²¹ gërkâun, fol. – kërkuan

²² sudit – gjykoj

²³ dovletit – shteti

en ja ep asaj çish²⁴ nâuk osh²⁵ xhali i vet // Kâur²⁶ dûolën²⁷ baba e pâyti: “Çish bone?”// Po tha: “Ma mâur mâu²⁸/ en ja dha asaj” // Ktheu i thot babës / nâuk o sudit drejt²⁹ //

Kâur shkon plaku ke dovlieti / I thot: “Nâuk ke sudit mâir / nami³⁰ âun³¹ di³² sudis// En i pâyti: “ i kujt o xhali ?”/ - temi!³³// E pâyti qietrën / temi // Si mâundet d’boet / ni xha:l t’ke:t dy nana: // Dimi³⁴ kshtâu sâun³⁵ u mar vesht / âun dëva da:j³⁶ xhalin// Gjysmën t’dë ta jap / gjysmën asaj// Ajûo çish nâuk e ka xha:l // Daje - thot // A gjien³⁷ ajôu qietra // Jûo – jûo - thot / “kjûo ne t’iet gja:ll / âipja asaj“// Tâni osh xhali / nâuk qienka i asaj çish thot daje // E shef dovliet si suditet drejt? / juo ashtâu si sudite tâi / kâur ja dhave asaj çish nâuk ishte xhali i vet//

Marrë nga monografia: Mustafa Ibrahim, *E folmja e Rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.

* * *

Âuku en dhielpna

Jen za:n pobratâima³⁸/ âuku en dhielpna// En aj da shkôojn/ tâyn ke ni vnesht// Vneshti i thâurët³⁹/ po ka pas vrenga:j// Ka mâunt en âuku⁴⁰/ t’jet atây// Dhielpna sherete⁴¹/ ka angër pak/ en ka probit⁴²/ mo jet frây⁴³ shâum// Qi t’shofe/ a mâunt dale// En âuku a:n⁴⁴// Dhielpna frâyet mâir/ en ja bon përt ene dûol// Sa diel nâis d’vikase:⁴⁵ “O vërdho⁴⁶/ ce⁴⁷ âuku ta angër vneshtin”// âuku o ke vryma/ po i frâym sâun dale// Ene kshtâu âukun/ e rrokin/ en e vrasin//

Marrë nga monografia: Mustafa Ibrahim, *E folmja e Rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.

²⁴ çish – çka

²⁵ osh – është

²⁶ kâur – kur

²⁷ dûolën – dolën

²⁸ ma mâur mâu – ma mori mua

²⁹ Nâuk o sudit drejt – nuk është gjykuar drejt

³⁰ nami – sillmi, bjerme

³¹ âun – unë

³² di – do t’i

³³ temi - i imi

³⁴ dimi – meqë, pasi

³⁵ s’âun, – nuk mund

³⁶ dëva daj *sintag.* – do t’ua ndaj

³⁷ a gjien – ndërsa

³⁸ pobratâin – vëllamth

³⁹ i thâurët - i thurur

⁴⁰ aûku – ujku

⁴¹ sherete – dinake, me sherr

⁴² probit – sllavizëm, provoj

⁴³ frây – fry, ngopur

⁴⁴ a:n – ha

⁴⁵ nâis d’vikase – nis të bërtasë

⁴⁶ vërdho – vrapo

⁴⁷ ce – pse

* * *

Tre vllazën

Ishin ko:n tre vllazën // ma i madhi i kish pasën ni par dilbi / i diti e kish pas xhe:t ni pustuqi/ e i treti e kish ni mo:ll n do:r// tu kshi:ri madhi me dilbija e she ni ç:i:k n midis t ujit me i guri/ mi:r ama çish me shku : me e ma:rr?// vllavi dit thot çe po hipmi n pustuqi// shko:jn te ajo çika/ mi:r ama ajo ish ko:n e un:t // vllavi vogël ç i e kish pa:s at mollën ja jep dhe e pshton pi dekës / se ajo ish kan tu dek:k // kur kthehen te shpija vllavi madh thot u pe mar / ajo po m be mu / se jam ma j madhi edhe une e pash / ku e shishi ju pa dilbia ? i diti thot pa pustuqi çish shkojshi me ma:rr?// i treti thot e pa moll çish e bishi / se me ko:n kish de:k n midis tudhës // ajo po m be mue / se dilbiat edhe pustuqi:n kurxho s'i ka xhe:t / e molla m ka hu:p mue // di vllaznit pajtohen me ja dhon t voglit //

Fatime Jashari/ 84 vjeçe

Fshati Runicë, komuna e Likovës, Kumanovë

* * *

Dhondri

Ni gjal i ri me ni vakët ishte kon martâue // ni dit pi ditve shkon te xhishja e vet me xhith nâusen // mâir amon / para se me u nis / kjo nâusja e mson ç i kur ta ven trâisen me honger buk / taj mos ha shâum se t'çeshin si dhondër / po kur t'nguci me kom une/ taj ta losh bukën // Nejse / shkon te xhishja // Mbas ni vakti e ven trajsen // Sa nisin me ngron buk / ni puste mac e prekën / ki meniher e len bukën // Xhishja ene kit i thon ha buk! // Jo / u frâina // Nejse / kur bin me fjet dikur / ki ngrâihet natën e kërkon buk // Shko e mere ni cop buk e çaqe osht vorba e bathës e ha // Ki kur shkon te vorba e bathës / i shtâi durët e i jesën // Ene ki potllâue e përçasën vorbën e bathës e e then ene i thot grues: ku t'shkoj t'i laj duert? Shko te reka e laj // Kur shkon aqe / tu hakat ta fugje vorbën e i bije xhishes se kishte kon tue u la // Kur vâin / xhishja i kallzon câucës vet: kshtâu / kshtau //

Tregoi Hafet Beqiri/ fshati Raoviq

Marrë nga: Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008, f. 452.

* * *

Mjekërrmaviti

Para shum vjetve ma: herët/ a kan ni nje:ri i calli e ka pas mjekrën e mavit// aj ã ka:n ma i dallu:mi n'katun për mjekrën dhe kejt katu:ni thi:rr mjekërrmaviti// A: a ka:n shum zengin// Ka pas shu:m gra: dhe krejt i kan de:k/ secëlla e ka pas histori:n e vet çysh ka de:k çysh jav ka kallu: katunarve//

Ni dit mjekërrmaviti don mu martu: me ni ç:i:k shu:m ma t're se a:j// Çaç pasuni ka pa:s sa edhe ent i ka pas t'allta:nit// Martoet me ç:i:kën dhe ban ni dasëm t'madhe dhe krejt katuni:n e

thi:rr// Mas ni kohe mas dasmës/ nusja asht shu:m e gzu:me me bu:rrin e vet po nuk e di: ni sekret shu:m t'keq çka asht mrena nshpi// Mjekërrmaviti e ban nijet mu nis me ni u:dh t'gat// Para se mu ni:s i thot grujës n'kejt shpijën çka don munet me bo/ ama te ni so:b n'podrum nuk guxon me hi se ka me denu shu:m keq//

Kjo e përcell burrin/ ama zemra ka qetra a:n si rri rahat se dojke me dit shka mshef burri vet n'at so:b// Tan koën s'dike ata çele a mos ta çele at sobën/ edhe e çel// Kur e çe:l çka me pa!// Shum sene trishtushme ka// Krejt gra:t çka i ka pas ky bu:rrin/ i kishte vra dhe krijët jav kishte ngjit n'mu:r//

Kjo me tu:t t'madhe e del pi sobe/ ama çelsin kur e mshel derën e përli:n me xhag edhe çelsi nuk fshi:het mi:r// Ven di:ta mu kthi bu:rrin// Senin e pa:r çka ba:n/ i li:p çelsat// Me shum tu:t ja jep çelsat e aj e merr vesh se gruja vet e ka çe:l de:rën dhe i ka pa tru:pat e dekt// Ja ka:p flokt dhe i thot se ka: me ja pre kri:jën si grave çysh jav ka bo// Kjo i thot: T'lutna t'shkoj deri te soba jeme e t'i lutna Zotit para se mem vra:// Ki i thot: Ani/ shko lutu e hajde miniher edhe mos u muno: me hi:k se kejt di:rt mshe:l i ki//

Kjo hip te soba vet e i çel xhamat edhe vi:kat: Ndi:m! ndi:m! Ni katuna:r tu punu: afro:het ngat shpijës e kjo i tregon çka pi ndodh// I thot shko thi:rrin vllaznit e mi e tvi:n tem shpëtojn sa ma shpejt// Mas ni kohe kjo zhdry:p napër shkall kadal/kadal// Kamt i dridhen se e din se ka me vra: ama kadal e lut Zotin t'i vi:n vllazni:t ma shpejt//

Zhdrip/ burri e spreh thi:kën me ja pre krijën ma let/ ajo ka:n e pisket/ n'momentin e funit kur e çon dorën me vra:/ me ni forc t'madhe hijn vllazni:t e vet/ thejn de:rën edhe e vrajn drejt n'zemër// Ato t'gzu:m shum kur e pan se e pshtu:n motrën e vet pi ati nje:rit t'keq edhe e vazhdu:n jetën t'gzume me familjen e vet//

Nga e folmja e fshati Dobëllde, komuna e Vrapçishtit, Gostivar

* * *

Nasradin Hoxha e lir

U ka:n Nasradin Hoxha me ni katun / e ni dit jet pa lira e del nu:dh// E lut zotin mja çit do lira / vetëm niqin i dojke/ as ma pak e as ma shu:m / as nadhtena^on bile jo // Tu fol Nasradini vet me veti e nñ ni njeri / i mer nadhtena^on lira i shtin me ni bo:çe e i qet permi u:r e vet hin ner u:r e kshir se shka po ban Nasradini //Nasradini tu kalu ka u:ra e she boçen / e qel// Kur i she lir menon se zoti e paska ngu: Po kur i njen i dalin nadhtena^on/ po ai i mer// Edhe boçja qe niqin lira // Kur ta she aj njeri i thot Nasradinit se ti a thave se si mar nadhtena^on po vetem niqin / Nasradini i thot se ti s'ti lypa/ shka po përzihesh e qeshtu tu shty me lla:fe ki njeri i thot me shku: te kadija me zgjedh ket pu:n se s'munte mja ma:r lir// Nasradini i thot/ qysh me shku: kur s'kam kali// Po ki meniher hajt se un ta jap / po as gūj nuk kam// Çe edhe gūjen po ta jap / edhe shko:jn // Kur mrin ati/ Nasradini e lidh kalin e hi:n mrena // Nasradini meniher ja prit: - Ooo kadi/ leje bre kta se krejt çka ki me vet/ ki thot se ja:n tmijat// Edhe kalin çka e lidha asht i ktina // Aj/ po de e emja / edhe gūjen çka e kam vesh thot e:mja // Aj/ po de e emja // e kshtu Nasradini e mashtron at njerin e ja mer lir//

E rrëfeu: Jeton Latifi 65 vjeç, nga fshati Batincë, Shkup

* * *

Une jam Haxhi Lutfija pi katunit Setapetkës // desha ta kallxoj ni pra:ll / mote kum boll / shtatdhe:t e dy vet i kom // Ka ko:n ni shok e ka shkue n'gurbet // Ka punue pesmdhe:t vet te mreti // Kur ka ardhën vakti ta kërkojn hakin çu ka punue / mreti i ka thonën: “A tri fja:l tët kallxoj / a tët ap tre mi: lira?” // Une i thash: “Do i marr fjalët / ma mi:r fitoj me fjalët se me paret” // Mreti tha: Ka t'shkojsh / t'shkojsh / drejt udhës shko e mos zhgjosh anema:n / sabër t'bosh ene kit stra:jc ruje”//

U ktheva te shpija / erdha n'pi:k natës / vkata te shpija: Kush je?” - ma kthej gruja // Une jom ni jabanxhi / a ka bujrëm se kom me:t // Hipa te shpija / kur zhgoj ni bu:rr // Un i bona sabër // Aj ish gjali jem pi pe:s vjeç nizet vjet i kishte bo: // Kur e çela strajcën / ajo m'du:l me pare // ma mi:r m'dulën fjalët se alltani//

Informator: Haxhi Lutfiu, 72 vjeç, Gumalevë, 1985.
Marrë nga: Haki Ymeri/ *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

* * *

Ishe qonën Iter Peja / ise ra: n'shehër // kur she ni berbe:r // “Iter Peja eja t'ët rrâuj!” // ene ki shkon e kurdiset // aj e ze bshtâin ene e rrâun t'tha:t // “a t'dhem Iter Pejo?”// “nejse” - tha Iter Peja // ene u: do ta gjek shpëirtin tâi” //

n'vaktin e pranverës kapërcen Iter Peja para diqanit atâi // ki e she: ene i thot “Iter Peja a di t'kîsh vne:sht? // “po!” // “po haj t'ma kîsh vneshtën teme // kîje / kur ta bitisish t'i jap paret” //

shkon Iter Peja me kopaç i shkulën kejt e ja ban gurma:d // me gurshâit e te duqani// “Iter Peja a e kîne?” // Aa – thot - hazër e bõna” // “a qante? // “mare ene tâi me e pa: / ene tâi do qajsh bilem” // ki ja jep hesapin e mas ni jave berberi e she vneshtën gurma:d / kejt ja ka shkulën / ene nisën t'qaje //

- Iter Peja/ eja ka – i tha berberi!// - tâi ma kishe shkulën vneshtën?
- Ee / po pse tâi m'rrâujte me bështâim//

Informator: Iljaz Mefaili, 60 vjeç, Çiflik, Shkup, 1985.
Marrë nga: Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.

* * *

Gruja en dhëit koka voet

Na ishte se ç'na ishte / nji saan me qifte / na qenka se ç'na qenka / nji saan me çenka//

Nji grue kishte qenë shôum kobarkë ene ileqare // ajo për xhdo saba / si i shkôuka bôuri në pounë / fërguka ka dhëit koka voe en i ngranka// bôuri e diktôuka // nji ditë e kishte rujt / kôur të t'i fërgonte voet // ajo i thejti voet / i shtëini në tavë ene shkojti në odën qetër të mer tëlien // bôuri me të nxitôume / thejti ene dhëit koka voe qera në tavë ene u mçef pa e diktôue e shoçja // gruja i fërgojti voet ene u ul t'i ae si uleshte për ditë // si i angër ximcat / u frëi // u mundôue t'i sosën / po s'onte//

- Eu/ tha/ përditë kom ngranë ka 10 koka / sot s'on i sosi! Ose jem sëmoun / ose tët sëmouem!

- I shoçi duel pi vendit ku ishte mçefë ene i tha:
- As je sëmoun e as të't sëmouesh // nuk je tue ngranë dhëit/ po njizet koka voe//
- Pi atë ditë gruja nuk angër kurxho pa të shoçin//
- Bofsh ajr mër bôur qi ma oçe ilen / se kush e di si të't ma pagonte Zoti - i thonte ajo vetvetes//

Përrallë nga e folmja e Dibrës.

Marrë nga: Mojsi Lutfiu, *Prozë popullore dibrane*, Shkup, 1988, f. 136.

* * *

Ubja me Shuben

Kishin qe:n di motra // njonën e qujshin Ube / kourse qetrën Shube // Të dija na kishin qe:n pak si t'çoukme kah mendja // Nji dit / si bon pounët e shtëpëis / dulën t'shëtëisin / e mbëshulën derën me dri ene drinin e mçefën n'vançkën e mōurit // Ōudhës u poçën me do gata:l // Atine u tha:n:

- Shëifni kaa! Mos shkoni n'shtëpëin to:n! Çe ajo osht dera ton qi shëifet! Kërkush s'ka n'shtëpëin ton// Birjanin e bo:m ene e kimi përmi so:b qi t'na rëije i ngrofët për sëill // Drinin e derës e kimi mçef n'vançk t'mōurit // Ne nuk te't rëim gjat / nja di saat / sa t'shëtëisim n'di vende // ajde çështëi / shkoni n'pounën e ju!

Gatalët / si i mōurën vesht t'gjitha pounët / shkōuen n'shtëpëi t'Ubes en Shubes / e angrën birjanin / e thkëijen tepsëin përmëis ene e vazhdōuen ōudhën e vet //

Kōur thkëijen di motrat n'shtëpëi / fillōuen t'zëijen njona me qetrën se kush va dëftojti gatalëve derën / drinin en birjanin //

Përrallë nga e folmja e Dibrës.

Marrë nga: Mojsi Lutfiu, *Prozë popullore dibrane*, Shkup, 1988, f. 144.

* * *

Jan natrru dedajt ner vetin / sebeci nji va:jz thon/ qi e kam nie prej pleqsh // per i gjys sahati kan met kater vet de:k e varrue/ dedaj kan ken t'kater / nji e kan varrue e tre kan met dekon//

Ajo vajza bani me be: si me than filani/ at'her ata t'kushrijt nodhen aty n'koder t'Arrs // asish edhe asish / u vran ner vetin per at shkajk//

Edhe Zagora e ken vra me Postrib// Shkuen dy prej Zagore me feju nji va:jz atje n'Domni /ater ata nuk jav dhan vajzën// Manij ata/ kur u çuen me a:rdh knejna / grabiten nji vajz Domnit/ ajo vajza qiti kushtrimin / edhe u lshuen veni edhe i vran kto dy//

Zagora ça bani mrapan mas disa kohve / për zotin s'di a kan pas shkua dy vjet masi men ata/ ... tu ul domni n'Shkod;r/ kjo Zagora u dul n'prit n'atom t'Golemit/atje te shtoja për me marr gjakun e ktyne dyve // Kto kjen tetmdhet/ ato kjen shu:m// Domni tu ul kjen kallablek bashk //

Megjithse (ishin) shu:m ata/ kta u fillun pushkën / edhe men gjasht asish domnit e nji grua shtat // Kta pshtu:n tetmdhet // Manij Shkreli ça bani! // U çuen tre vet e shku:n n'bjesk t'Vorfa vrau nji t'shkrel // Manij Shkreli ça bani// U çuen tre vet e shku:n n'bjesk t'Vorfs/ aty

n'bjeshk t'Vorfs po ja:n katër çoban prej Vorfet // Ja fillu:n pushkën kta shkrel/ edhe i vran
t'katërt ata/ kta tre pshtuen / erdhën shnosh n'Shkrel//

E tregoi Prek Husi, 75 vjeç nga Stoli i Zagorës, Shkodër

* * *

Kish qon ni cu:c e mi:r/ e ndershme e hishme // Nja tre vezir e lutin ta marën për grue / pa
aja nuk i ka desh se kan qon si t'moçëm// Masej ata vezirt shko:jn te mbreti e i tho:n se at cucën
e ka:n pa te bo qef ...// Mbreti e thirr at cucen ene thot a asht verte kta si thon se ke bo qef ...//
Cuca thot ja/ kta rren// A mbreti ju besan vezirve ene e mer at cucen ene e var// Gjali i mbretit e
ndin te qajt ket cucen ene i thot çfar kije/ pse qan?// Aja i thot baba jot m'ka var se i ka ngju
vezirët/ a ata e kan rrejt// Gjali shkan te baba vet ene i thot se ata t'kan rrejt/ nuk asht puna si
thon vezirët// Kja cuca asht ndrejt// Ene mbreti i thirr ata vezirt ene e thirr t'parin ene i thot çfar
boje kishte sheni// Aj thot t'bardh// E thirr dytin/ aj thot t'zi// E thirr tretin/ aj thot t'kush// Masej
aj i mladh te tre ene at cucën ene te tre permenjer i pyti çfar boje kishte sheni// Ata u kan ngatru
ndërmjet veti ene at'her mbreti e shlan at cucën ene i lidh vezirët//

E regjistruar në fshatin Gërçec, Shkup

11.2. TEKSTE NGA TË FOLMET KALIMTARE

Ni mret kishte nji moll // ajo molla bonte tri thërrime në vjet // të tri kto thërrimet i hante
kuçedra // vojti i tha çuni math: "do ta ruj un sonte kuçedrën" //

hapi nji grop në dhet ai / mur harkun me beren / e grefi harkun e po rrinte hazër t'i binte
kuçedrës // erdh kuçedra e hardallosur edhe ky sun i ra / se u tremb //

e hongri koqen e mollës kuçedra edhe iku // të dytn herës vajti e ruajti i mesmi // erdh
kuçedra e mori nej koqe e iku // sun e vrau as ky / se u trem // vajti natn e tret ky i vogli / Isufi / e
i tha: "baba / e vras un kuçedrën"

erdhi kuçedra ta mirrte edhe koqen e tret // ky ja çoi me beret edhe e plagosi kuçedrën
tepërtej // aty sprait iu lçu prapa kuçedrës // kuçedra hyni me j gryk pusi / ra posht / atje e kishte
meqan kuçedra// edhe Isufi prapa //

- ku osht / ku osht kuçedra? I tha Isufi Korit // ai tha: "e kemi smur kuçedrën" // edhe ky
tutje: spramit vajti te kuçedra // kuçedra u zgurdullu t'i hudhës ktij / ky lçoi m bertet // tak n koqe
t'syrit edhe e vrau kuçedrën//

Mbledhur nga Q. Haxhihasani Qafë (Sulovë), 1954

Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 414.

* * *

Kishte shku nja n malt // atje gjen i shesh t math me ba:r // bân n mên ky / se vunte me
gomart për dimër: "ta bije gomarin n vjesht e ta ma:rr n behart / se s'kam zahire t'i shtije" // erdhi

vjeshta e la atje // shkoi t marri gomarin m'kët vakt // kërkoi gomarin s'e gjet // vëni me ba:r si n'vjesht // toke rân teposht // si t'vinte te shpia // u poq me i bari me dhên//

- na ke qe:n?
- la:sh goma: kâ n'mal / mirpo nuk e gjeta // e kërkova / po s'e gjeta!
- po kur e le?
- n'vjesht//
- po un e pash goma:r tân//
- ku e pe? tha//
- n'Peqin//
- çere bânte?
- Ishte bâ kadi / po ti nuk de e jôfsh//
- un e jôf / tha / se i shtinja tagji / e kisha psu:m//
- po se ashu / merr trasjen edhe t'vjen ve:t e t'fut kryet n'trasjet//

edhe ky trasjen me i do:r tep a tërsâr / çere pat / edhe n'zyrt / te kadiu n'Peqin // edhe luji trasjen kshu // kadiu ishte psu: me ryshfet // ke e pa: trasjen ke dera qi e luji ai / u ngrit prap prej vënit edhe i vajt ke trasja / edhe shkoi çere ka n'trasjet // katunari e qepi për fyti / e nxori kapistrën edhe ja shtiu n'fyt // brriti kadiu / mirpo s'e lshonte ky // u ngrydhën t'gjith te kadiu // kadiu bërtite / ai nuk e lçonte // u mu:rn vesht me fja:l:

- pse s'e lçon?
- â gomari im / mor jahu / e kam lçum n'mal / erdh e u bâ kadi kâ //
- mir / tha / po nuk bahet gomari kadi //
- po un e jôf / se e kam msu: me trasje / edhe ky erdhi futi kryet mrena n'trasjet / edhe ju thoni qi nuk â gomari tem//

Tregoi: Sif Qosja, 67 vjeç

Mbledhur nga Mehmet Çeliku, Zavalinë (Shpat), 1961.

Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 416-417.

11.3. TEKSTE NGA TË FOLMET E TOSKËRISHTES

Po s'di me bi: un pralla / s'di // Të m'i teki njeri di të rrëfej pralla/ po këshu vet s'di // Tjetër sh'të tregoj me bi: / viranllëk / nje shëndetin tem ta tregoj // Në vakët / nje ashtu / kur ishim të reja ja si juve të mira s'kemi pa:r // E keqja më mbeti / ja ala e kam // Ayna na vdiq/ çuni vllait tem edhe më mbeti e keqja në barkut// E di si ay lepur i qi idhet? Nje ashu mua barku më idhet // Me apje po rroj // E nje ashusoj // Çuni i sëmur shtrir ësh / pe atje shkon atje / siç është rrëshqinja njer në bark / njer në kurriz / e thau edhe kokën/ i bie kokës me oft/ me bij // Të shofi/ shefën çuni këshu mi:r/ siç thonë / ama neve nuk na shef as nuk na fol/ ama po të ke:t zhu:rm gjikundi trembet / për të trembur trembet // Po të qajn fëmijët edhe ay ze qan// S'është jet me bij / neve e di:m edhe Allau //

Nje kjo e keqe q'e kemi / kët të keqe njeriut... mos e thëntë Zoti / se vdes njerët / epo do te qajsh / do te qajsh edhe t'e mbajsh në barkut // All i neve vdekje kemi përdite // Ajo nusja sun dali në pragn e derës/ jo për punë/ po as për qef sun dali// se un s'kam takat ta rue çunin/ u bora opraci// Cucat edhe nuset i vinë edhe i ndifin për çunin// Nje ashusoj po mirremi me vojttjet e ksaja// Çar t'i boj m? S'dim sh't'i boj m//

Ajo murga nuse e ndërron/ e bon/ e yshqen/ një çik kos i japim me të zort/ qumësh nuk an// Po qau/ ja ve gjëjat pe dyqani/ projt i// veçe me to rron//

* * *

Aterne sollën pelena/ nja dy çarça:f edhe nje ashusoj/ ilaçet i blejmë gj:i:th me pare/ po mos i ke:t ilaçet / sun rrojë ky// Jashtë gjikundi s'e kemi çuër// Po ku ta çosh me bij/ doktori tha që s'boet insan ky//

Kur ishte i vogël gjasht javë i ypi zar nxetsia edhe qau natën/ kur e çuëm në doktor/ e çuëm të vdekur// Ato i dhanë gjilpoërë/ veshtaçko.... shpëtoj/ po shpëtoj viran// Ja kishin marrë pacën pe kurrizit/ pasaj e zuri edhe një sëmundë tjetër/ po u shërua pe asaj//

Nga e folmja e fshatit Frëngovë, Strugë
Rrëfeu: Kumrije Selimi 78 vjeçe, amvise e pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Më dha baba te ay/ shifeshim/ boeshim/ kishim turp pe burrit/ s'kishte dashuria aterne// po t'na shifte burri/ zinjim nganjër qanjim/ thoshim: "Na pa burri/ për lerë"

Un e kishe babën plak/ e kishe të sëmurë / burri më zuri mua të vogël gjashmë et vjet// dhëndrri çunin/ Gurinë e kishte të vogël/ pandaj burri im vinte te çeshme xhamis m'i sillte dru:t// Nje aty/ s'vinte në shpit/ kishte turp// Un ishte me nalle/ me katër shtëmba në dorë/ utova/ u xrova edhe i theva të katërta//

Edhe nje ashusoj jan meselet e mija// ... N'ato koa ta mbante burri fëmin në kra?! Kurrasnjer// Njime boj n qef kto nuse//

* * *

Më bie në tepe të kokës e nje ashu më rri si kulerë// Më duket dita mot/ thom kur do ngriset që të flej// Vojta me fukarallëk/ s'kam dit të bardhë/ dit të zezë kam për vuxhutin tem//

Më thërriti cuca në dasëm// Nesër do shkoj/ do pi një apje edhe do shkoj më këmbë// Pe ksaja pi një në mbrëmjet/ një në saba/ ce u bora opraci/ e oqa tëmlin ce kishe gurë//

Në qosht e ka shpijën // Boju çunave telefon (ni tel) dëfteji ce ay burri iku pe atysh//

I mirrnjim kuënjt // e apnjim barin / pasaj i shtillnjim kup // edhe ynjem ke konaku im // fëmit rrinjin në ajat / shkonjën ande – kënde // Murga nuse s'un thoshte gjikafsh // cuca u fërcua a ni veçkë s'dinte të bojë//

Nga e folmja e fshatit Frëngovë, Strugë
Rrëfeu: Anife Iljazi 70 vjeçe, amvise e pashkolluar
Regjistroi: Ajten Hajdari - Qamili

* * *

Po laj robot// në fillim bëj zjarrë // bëj një kazan me ujë e filloj nem këmishët një e një të tëra me uj të vakur / jo shumë të nxetë // e kshu i fërkoj / i fërkoj një pa një // pastaj i shtrydh gjersa i sos ato të govatës // i sapunisim i shkojm të tëra me radh me sapun // bëjmë edhe alisivën // valojm i me ujë hi enë // edhe zjen shumë ajo // pastaj si mbaron së zjeri / i shtiem uj të ftot // e lem që kullon iri//

I shkojm tri er / katër er / ka rob që është me ndotur / e shkojmë më shumë // vem në çezm i qitim // i shtrydhim e pastaj i ndejm në tel ose litar // thaen // atyre të vazhgëta u themi//

Mbledhur nga Jorgji Gjinari më 1962 në Korçë (qytet)
Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 400.

* * *

Na ishte këtej nga Opari një grua e qu'anjin Nërënx / të shoqin e quanjin Gjozi // na kishin tre djem // edhe punën e kishte qeraxhi Gjozi / ata jetonjin mir edhe gruaja ikonomitare kishte gjë të gjall // kishte pula edhe i merte / ç'prodhonte / i shpinte ë trekt // edhe kishte pasuni mjaft // kishte argzën e bastun për në dhet //

kur na vdiq i shoqi / vdiq Gjozi // pastaj ata djemt mu^arën kuajt edhe punonin si i jati // qo mendoësh me mendjen e saja kam një pal shtëpi në mest // një pal do t'i bënj nga lindja e një pal nga perëndimi që të mos i luanj djemt // edhe i bëri shpit // edhe martoi djalin e madh //

porositi nusen si shkoi dasma: ti / nuse / do punoç tër natën! Të nxjerr mëma një thes me lesh / se un kshu kam punu^ar që kam vën gjith këtë pasuri//

- çar të bënj më përpara?

- Zër shkrif lesh / i tha e vjera / në qoft se mërzite më të shkrifur / zër kri / në qoft se mërzite dhe me të kreur / zër drith / tha / në qoftë se mërzite edhe me të dredhurit / tha / mer një dor uj udhja syvet që të dalin gjumi//

edhe nusja të gjitha keto i punoi //

- po bukën me çar t'a a? Tha nusja //

- më ke ata dhëmbët të rinj zëmbren sithëz mer nja dy dokra pe konistrës edhe mer dhe një qep / pak krip edhe a buk / i tha plaka // edhe nata-natës ajo pun ishte // edhe natë shpi që flinte ajo / të punonte dhe nusja//

- se un / tha plaka / bije posht / se jam plak un / tha / dhe ti këtë pun të bëç! Po prap ti të punoç / tha / se un kam dy pal sy / kam sy edhe prapa kokës / këta përpara ballit un i mbyll / këta prapa

kokës rin apt / shikojn tër natën/

Tregoi Dafina Bandilli, 70 vjeçe
pjesë përralle, mbledhur nga Jorgji Gjinari Berat (qytet), 1957
Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 402-404

* * *

U martua një djalë / edhe tri javë me të shoqen / edhe shkoi ay // bëri luftë Turqia me greknë / edhe u doq ajo kasabaja ku banonte ay djali // edhe vete gjetkë // edhe ay fshati / që ish / u doq edhe ay / edhe ndënji kaqe kohë e punon tutjetëhu // edhe e dinte të vdekur gruan//

vinin të shtunave çupëria mbushnjën ujë me shoqet në çezmë // na vinin qiraxhinjtë nga Stambolli / edhe na i zinte nata atje // prej Sarande vinin // edhe i thojnë njëra-tjetrës: Mos na vinë burrat nga Stambolli//

ajo nuk bënte shamatë / q'i kish mbetur burri // ajo zuri e qante // edhe i thonë shoqet: "pse qan ti?" u thotë: "mua më ka humburë burri / ju i prisni burrat"//

edhe ay u kthye / erdhi fjeti mbanë lumit / s'e gjente dot shtëpinë//

edhe ay ryri në fshat / edhe pyeti një djalë: "ku është shtëpi e V// Myftarit?" edhe ay e mer edhe shpie // gjetkë e kish bërë e shoqja shtëpinë// e trongeti te porta / sa mundi / vet ay // edhe ajo doli / e shoqja // ajo e hapi portën / edhe vështroj të shoqnë // edhe ay e vështroi / edhe u verdhë që të dy në fytyrë / kur u panë//

– pse m'u verdhe moj grua?

Edhe i ra zalia së shoqes / edhe e mori kënaçen / që kish prapa portës / e kish vënë që mbrëmave / edhe spërkati të shoqen / edhe erdhi ndërmet //

Tregoi: Sofi Pano, 75 vjeç
Mledhur nga Spiro Floqi, Ogren (Dangëlli – Përmet), 1956
Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 397.

* * *

Ishte një djalë e lëshojshe ga ushtarllëku / pastaj këtheet dënjë shtëpi të flerë // atë qënka lindur një çupkë e ja vinin embrin // ushtarit i bëet d'ëndër: që këtë foshnje ta març tinë//

ay djali e mer atë foshnjë me gjith pelenë edhe e eth më një garth / e uri i futet dënë sqetull // e ushtari iku natën ga ajo shtëpi//

foshnja shpëton // e mer e jëma dhe ritet // ajde / ajde / djalit i kërkon nuse që të ndërtoet // atë nuse q'e kërkon (çupkën e gardhit)/ atë ja dhanë // kur e mer ay atë nuse edhe ay i thotë: - ç'e ke atë nishan dë kraut? A ajo i thotë: që kur ma kanë vënë embrin // ka qënë një ushtar e i është bërë d'ëndër që të më merte mua / e ay më ka edhur më gardhit / e m'u bë ky nishan mua // ay i thotë se unë tam edhur dë gardhit//

Rrëfeu: Dile Elmazi, e lindur në Gjerman, jeton në Avrat, 80 vjeçe, amvise, analfabete
Marrë nga: Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996, f. 191.

* * *

Bujku meret me tokën // lëron arat / qëron baçat / rëmìn vreshtat / pret vreshtat / mbjell misër / fasule / grurë / thekër / kompira / kunguj / peçarka / çepajka / pyperka / domate / qepë / presh / bostan (karpuzë e kaunë)//

kur vjen vjeshta mbledhin: mollë / kaçka / lajthi / ftonjë//

* * *

Në prill fillojnë të lërojnë arat // më parë i shpjenë ple / e apin plenë / pastaj i lërojnë erën e parë // të dytën erë i përzejmë dy erë / e të tretën erë i mbjellim: misër / fasule / kompira / duan //

misri del / pastaj e prashitim / e mbushim // si e mbushim e lëmë dy javë / pastaje vaditim / e vaditim tri-katër erë // e në vjeshtë sefte ia marim majën misrit / pastaj i mbledhim fasulet / e më të funt e mbledhim misrin // arat i lërojmë i lërojmë / i edhim shalitër / e i mbjellim të dimbrit: grurë / thekër / elp //

dë prëndverë sefte vreshtat i qërojmë / pastaj i presim / i rëmimë / i llaçitim (i qërojmë) / i ndajmë krerët që kanë rush // i përskasim / ja thyejmë majën / i prashitim / e kur vjen vjeshta i mbledhim //

Rrëfeu: Ramadan Osmani, bujk, i lindur më 1931 në Kranjë,
ka kryer katër klasë të shkollës fillore.

Marrë nga: Zihni Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996, f. 184.

* * *

Një njeri ka pasur pare shumë / djali i tij ditka shumë // llafoska shumë me shkabonjet // ky djali i thotë t'et:

- mos gënje baba t'i tregosh gjësendi / se do t'i bësh qeder kokës tënde // ay i thotë: ti e di ku është shtëpia e kralit?

- ky i thotë: nuku e di / ti e di?

- nuku e di// shkabat e mëdha i thonë shkaponjkave të vogla: e gjeta – i thotë – si e gjete?

- mblidhuni / kush e ap këtë derë e prët kllëçi // vete i jati ta ape derën // ay i ra me kllëçt dhe ia preu kokën // ti / sa flori i mer?

- sa mer koka e babajt // prandaj syri është llakom // këta djem s'ngopen / bënë tri palë shtëpi njëri andej / tjetri këte / por s'ka të ngopur //

Rrëfeu: Tajor Jakupi, 75 vjeç, i lindur në Këshavë,
tani jeton në Zhabjan, Manastir

* * *

Edhe ky vete mer një kungull kaq të math / edhe e mbushi me kunguj // edhe kungulli thotë: mos më vër përfundi / vërmë përsipër / vërmë përsipër /vërmë përsipër // edhe ky e vuri përsipër kungullin // ndejti edhe ca ky / edhe e shpuri më shpi//

vërmë sipër penxheres - kungulli llafos // edhe ky e mer evë përsipër atë kungullin të penxheret //

shkon një djalë atije e dëgjon / e këndon kjo çupa / tingëllon // ç'është kjo që këndon?
Edhe ay djali thotë: ja e kërkoni atë vajzën të ati njeriut – thotë / të asaj shtëpije – thotë / ja se unë vritem // vras vetvetjen // këta dërgojnë vlyes strobjnik // të na japsh cucën?

- ore / çupë nuku kam unë //

- ajo që këndontë ç'ishte?

- abre ay është kungull / kungull /kungull

- po a na jep?

Dhe ky ja jep atë kungulli // e mer ay atë / e mer të dielën maksham // edhe ay kungulli fëëp edhe u ap / del çupë // e bukur e dheut është // e këta mileti çuditen / që ç'mori ky / kungullin e mori për grua më shpi?! Ç'ka ky aty më këtë? // edhe dolli ajo çupa / fjeti atë natë // më saba edhe i tha të shoqit / i tha: mos rëfe -tha / ce të dolla unë // mos rëfe – tha: ce po rëfeve / unë odma vdes - tha //

ky s'rëfeu natën e parë / natën e dytë nuk rëfeuti // as ca koë edhe vështuall të shtëpisë // thanë: ne ty të martuam / të bëmë nuse më këmbë s'të shomë / ç'është ky alli jot? Si flet ti me atë kungull?

- E unë ashtu fle//

- po ne atë kungullin o ta marim / o ta flakim // thermëni mua ta flakim kungullin // thotë ky: p'unë e kam nusen / brënda në kungullin më ri //

- si brënda në kungullit ri?

- brënda në kungullit// menjërë u ap kungulli / nusja u shtri / vdiq //

Rrëfeu: Alil Taipi, 85 vjeç, bujk, i pashkolluar, Këshavë, Manastir

* * *

Shkon Bledari rrugës
Çizmat gjer në gju
Jam zemëruër me babën
Më la pa fërcu
Rri/ or/ bir i babës
Rri/ mos thuëj ashtu
Je i ri i vogël
Në ushtri pa shku// (1)

Syzeza vetullpurtekë
Bojaxhinjtë kërkajnë drekë
Jam e zonja/ ja boj vetë
Boj bakllavën treqind petë
Kur dë vinë çoni aberë
Ta shtroj odën me minderë
T'u ap kafe me sheqer
Me sheqer e oronia
Ce ashtu na i çon shtëpia// (2)

(1) Këngë djalërie, (2) Këngë dasdash (e bojës), Zagraçan, Strugë.

Marrë nga: Bexhet Asani, *Këngët popullore rituale toske të trevës së Strugës*, Strugë, 2012, f. 102; 108.

11.4. TEKSTE NGA TË FOLMET ARBËRESHE

Rrikëza

Ishin di povarjelera e nëk kishin fëmijë / e kishin vetëm një rrikëzë / Nani ajo gruja dej shumë mir rrikëzën një bij e një ditë disperarij se kish bën finjin e neng dij kush kish të ja veje e laj ndë lum // Ajo rrikëza tha: Vete u?

E e j'ëma tha: E si ben sa të i lashë? Ka të më i shqiesh? // Ajo rrikëza tha: Vetëm mbi kurrizë // e u nis e vate ndë lum // Atje ajo rrikëzë u bë një vashëzë e bukur si dielli // Një furriz ce ish e rrëzoje pa e i pelqeu si ish e bukur e vate tek ajo gua e i tha: U dua fëmijë e bukur ce ju kini // E furrizi tha: Poka u dua ajo rrikëzë // Van furrizi e ikeza ndë kumon e u martuan//

Ajo vashëzë / ce kish lëkurën e derkut / mbrëmenet e nxori // E vjehra ja mori e ja dogji ndë zjarrë // Menatenet / kur u zgjua / vate tek zjarri e me qime bëri pameta likurën e e vuri ngrah // Tek jetra ditë vjehra dispetuze / nxori puru hit nga zjarri e ajo vashëzë pash mbeti pa likur//

Një ditë shkoj nga pullasi i regjit sa të mbjoj tek kroji llanxhellat // Regji e pa e pjeti: Kush është ajo vashëzë kështu e bukur? // I than rregjit se ajo ish një vashëzë ce një her ish një derkë // Regjit i pëlqeu shumë e tha se puru ai dej një derkë sa te e martoj//

Nani çoti vate tek një çë kish dirqe e i tha: Em një dosë se dua t'ë martojnë // Ndë ce ai furriz mori një rrikëzë e ju bë ashtu e bukur / u / ce jam rregji marr një dosë e më vjen një nuse edhe më ie bukur // E kështu bëri // Tuke u vat ndë kumon / dosa i shqori tirqit // I j'ati i tha: Bir / çë je ben? // Kur van mbrenda / dosa vate e u vu ndën triesa e i bëri me se deme // Qëndroj pa nuse përse dej të bëj si furrizi //

Nga e folmja arbëreshe e Kalabrisë

* * *

Gjella burrit e bënë rreth

Istorinë, kush e djovasën, e çon shkruar te veprat më të madhe. Burri te jeta shkrujti histori pjot jet. Kur, me një copë jet si shembull, e rrëfyn, ahina lëren një pedhatë.

Të djovasurit është të parkalesurit e burrit çë rri pas ktij mot i ri. Të diovasurit e njëi libri të mirë, është sikur të fjaçë me burra t'urt e motit çë shkoi. Burri ndë gjellë ka ater rrethe. I pari rreth i burrit, ai më i ngushti me fëmila: jëmë, jat, shoqe e bil. Tue u hapur i dijtj rreth, gjirí, shokë me k'shurben bashkë, çë mënd i lipsh kunxilë ndë ka një mendim trubull, kur ka një bëzonjë, s'thot jo. I treti rreth, ku jan ata çë ka kundrela, çë bën markat tue ndërruar copa petkë e fëtig'je per të paguar.

Alurtmu i katërti rreth: atje janë ata të ghuaj, ata çë s'njeh, të një vend i dheut llargu. Po këto kater rrethe së rrinë pa u tundur. çdo gher shtrëngohen, ahina i kështeu pa fuqi, trëmbet, mbulligjet me fëmilët te vatra tij: kështu burrëria së vete përpara, qëndron e fukartur. çdo gher ghapen, zgjirohen, ahina të kështeut i zbuloghen udhë të rea, dunaret se atë çë dukej i lik, e çon shok fëtig'je me k'mënd ndërronjë shurbise, të bënë bashkim, miqëri të rea.

Qëndronj pa besë, po urtëria burrit, ndë do, stisen shoqëri të rea, ecen udhë, vende që s'njeh; kur i rrethon i duken afërsë: të fala këtire fuqive, ku burri i farmirë ngrëghet ka bota, vet ndë run llargu, pa vën pengima gjelles, ai fjeturon te jeta. që te katanandet, arbëreshi pat nderonij vende, tue vat aprisu një ëndërr, bukë e besë, nde një manatë më e mirë; ectim dheun tue hapur rethin njera që rethuam dheun, së qindroi vend ku arbëreshi së shkeli boten.

Së qem të pritur me kolëndra e kragh ghaftë ka gjindja e vendit, kur ectim gjithë kta katunde tue lipur fëtigh sa t'stisjim një jetë e re, patim të reshtura, shqelbe e fjalë që dhëmbjin si shkafeta, po fjala prindëve na viniq nxe, pse ata na kin mirërritur me bukë e besë. Burri i urtë ka të ruanj me një bisht siu at mot, sot shomi se gjindë ka tjerë katunde jan ruajtur vrëret ka çdo vllezer. Miqria arbëresh ka t'jet një dritsore haptë, e shklëqier ka një sperë dëalli për ata gjindë.

Moti Madh / M. G. Miracco ka Shën Sofia (Cs)
http://www.arbitalia.it/stampa/riviste/jeta_arbereshe
Jeta Arbëreshe 70, prill 2011, f. 4.

* * *

Për të vdekurtë

Kur vdes nariu / thresën t'a lanë // kur vdes gruqa a lanë gratë / kur vdes nari thrasën bura ta lanë dhe a mvshën // i shtronnë nji krivattë / të mira roba // i ndezën të vdekurit qirinj // pëstaj venë a thresën plotnikun⁴⁸ // aju mer du kamëshë // dhe vin a mat të vdekurnë – sa të glatë dhe sa të gjerë // pëstaj plotniku a bën qaurnë⁴⁹ // A sellën qaurnë ta i vdekuri / a venë të vdekurtë ni qaurtë // pastaj mblidhën botë // Vinnë ndër varrë / a marën të vdekurnë / aqllën ta mblonë // pe part⁵⁰ mblonin⁵¹ me prift / tashi prift nok ka // kur vinnë gandej / hanë / pinë / ndelenë të vdekurnë: ndelezet se vdekurit! Kur ndelennë nok bënë të çokitesh kuprat ma raki ili⁵² ma vere// mukat⁵³

E folmja e fshatrave të bregdetit Azov
Marrë nga: Irina Voronina, Marina Domosileckaja, Lubov Sharapova,
E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, Shkup, 1996.

* * *

U inja i vongëlë e venja sembre ndë folé // tata imë më hishi:⁵⁴ ndë folé n'ka ve:sh se karakaça hotë kushtu:⁵⁵

⁴⁸ zdrukthëtarin

⁴⁹ arkivolin

⁵⁰ më parë

⁵¹ varrosnin

⁵² ose

⁵³ mëkat

⁵⁴ më thoshte

⁵⁵ Laraska thotë kështu

karaga:çë tru:ngë ke:
nga garricë bën një ve:
e i bën ku di ku tre
karagaçë trungë ke//
inja i vongël u / e kinja një dhëmb më bëj dëm / shumë dëmë // m3më ime më hishi: çëdo
një dhëmb i vjetër / e më jep një i re://
kur inja i vongëlë klanjase më dhimbinë dhëmbëtë // e m3ma më hishi: hue kushtu
bashkë me mua: hënë e re / hënë e re / çë të jap një dhëmb i vjetër / ti me jepë një i re//
im shoq ka vatër ndë Merikë // e nëng më ka shkruarë / ngë dinjë çë mankancia ia kam
bë:në⁵⁶ // përçë kur vin gjenë një i bukur dja:lë // njëqind li:r më ka tërgu:rë / manku për mielë
kanë mbasturë//⁵⁷

Informator: Françesko de Padova, 50 vjeç, e folmja e San Marcanos
Regjistruar nga Gjovalin Shkurtaç
Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 432.

* * *

Fshati kutu kle arnautë // fshati është kurdisurë nga tri vëllazëra / nera kleka prift / nera
çoban / nera kasap // u mbetkan kutu / e pëlqyekan vëndinë // bëkan shtëpi tri vëllazëra / u
martuokan // nernë grua e kanë marrë nga Gjyshçunar / jatrën nga Kajxhik / dë shkle // si u
martuokan / perendia i zënka këzane // u bëka maze fshati // dë Turqisë kohe / kur u rahnë me
Rusinë / ahëre erkan kutu keto vllazëra // klekan dostafçik / zënkën mish de turku / de muharebe
// turku e kish vëndinë / ai kle kutu mbret // turku e kish / ama glufënë nuk e ngati hiç // ze
skulontë nuk i ngati / ze klishtë nuk e ngati // skula ze klishtë klenë gërkishtë // gërkishtë
këndonim neve // shkllau jerd dë dymbëzjeta / kur u zun me turkun të rihen // ballkanit rahorë //
shkllau jerd e muor këtë vënt ze bitisi // u mbetmë de shkllan veçe ... prifti me dju vëllazëra nga
Korça klenë // unë aqe gjigja nga pleqtë // ka pesëqint vjeç fshati që ishte kurdisurë //

Informator: Risto Haxhiev, E folmja e Mandricës
Regjistruar nga Dh. S. Shuteriqi
Marrë nga: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 433.

⁵⁶ Nuk di se ç'mungesë më ka bërë

⁵⁷ Njëqind lira më ka dërguar, as për miell nuk kanë mjaftuar

LITERATURA E KONSULTUAR

- Agalliu, prof. dr. Fatmir - Angoni, dr. Engjëll - Demiraj, prof. Shaban - Dhrimo, prof. dr. Ali - Hysa, as. prof. dr. Enver - Lafe, prof. dr. Emil - Likaj, prof. dr. Ethem:** *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi I), Morfologjia*, Tiranë, 1995.
- Agalliu, Fatmir:** *A ka lakim të gjymtë dhe emra të palakueshëm në gjuhën shqipe?*, Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1988.
- Ajeti, Idriz:** *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 33.
- Akademia e Shkencave e RSh, IGjL:** *Pyetësori (fonetikë, morfologji, sintaksë, leksik)*, Tiranë, 1993.
- Akademia e Shkencave e RPSSh:** *Udhëzues për mbledhjen e fjalëve dhe shprehjeve të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
- AShSh:** *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.*
- AShSh:** *Fjalor enciklopedik shqiptar 1, 2, 3; Tiranë, 2008, 2009.*
- Aliu, Lulzim:** *E folmja shqipe e rrethit të Kërçovës*, Tetovë, 2011.
- Antosh, Antica:** *Osnove lingvističke stilistike*, Zagreb, 1974.
- Badallaj, Imri:** *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, Gjurmime albanologjike, SShF V, 1975, Prishtinë, 1976.
- Badallaj, Imri:** *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.
- Badallaj, Imri:** *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, ZA, nr. 10, Eianina (Cs), 1977.
- Badallaj, Imri:** *Disa fenomene fonetike në të folmen e Hasit*, Gjurmime albanologjike, SShF, nr. 6, Prishtinë, 1979.
- Badallaj, Imri:** *Probleme të objektit dhe të metodës në studimin e dialektologjisë*, Filologji, nr. 1, Prishtinë, 1996.
- Basha, Naim:** *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.
- Beci, Bahri:** *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1985, f. 93-109.
- Beci, Bahri:** *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.
- Beci, Bahri:** *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Beci, Bahri:** *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime Filologjike 1, Tiranë, 1985, f. 93-109.
- Beci, Bahri:** *Vendi i të folmeve shqipe të Maqedonisë në strukturën dialektore të shqipes*, Jehona 1-2, Shkup, 1994, f. 45-55.
- Beci, Bahri:** *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSh, 1962/2, 1963/3.
- Beci, Bahri:** *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike (15 - 21 nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 261-269.
- Beci, Bahri:** *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 39-50.

- Beci, Bahri:** *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Dituria, Tiranë, 2002.
- Beci, Bahri:** *Fonetika*, Prishtinë, 2004.
- Beci, Bahri - Topi, Ermira:** *Vëzhgime për dendurinë e përdorimit të fonemave zanore e bashkëtingëllore në gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1986, f. 61-76.
- Beci, prof. dr. Bahri:** *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë, 2001.
- Boriçi, Lumnie:** *Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe*, Studime filologjike nr. 2, Tiranë, 1987.
- Boriçi, Lumnie:** *Kontribut mbi aspektin akustik të zanoreve të shqipes e të disa zanoreve të frengjishtes*, Studime filologjike nr.1, Tiranë, 1977, f. 103-118.
- Besim Bokshi:** *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980.
- Bugarski, Ranko:** *Uvod u opštu lingvistiku*, Beograd – Novi Sad, 1991.
- Canaj, Afërdita:** *Mbi dendurinë e përdorimit të fonemave në gjuhën shqipe, përqasur me frëngjishten*, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë, 1999, f. 103-118.
- Cipo, Kostaq:** *Fonetika*, Tiranë, 2003.
- Cimohovski, Vacllav:** *Gjuha shqipe*, Prishtinë, 1988.
- Çabej, dr. Eqrem:** *Studime gjuhësore I – IX*, Prishtinë, 1977; ribotuar më 1989.
- Çabej, dr. Eqrem:** *Rotacizmi e ndalimi i tij*, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1987.
- Çabej, Eqrem:** *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987.
- Çabej, Eqrem:** *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1974, f. 429-441.
- Çabej, Eqrem:** *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*, Buletin i Shkencave Shoqërore 1, Tiranë, 1956, f. 126-146.
- Çabej, Eqrem:** *"Meshari" i Gjon Buzukut (1555) I, II*; Tiranë, 1968.
- Çabej, Eqrem:** *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, BUSH të Tiranës, SShSh nr. 1, Tiranë, 1958, f. 31-80.
- Çeliku, Mehmet - Domi, Mahir - Floqi, Spiro - Mansaku, Seit - Përnaska, Remzi - Prifti, Stefan - Totoni, Menella:** *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi II), Sintaksa*, Tiranë, 1996.
- Demiraj, Shaban:** *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.
- Demiraj, Shaban:** *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.
- Demiraj, Shaban:** *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.
- Demiraj, Shaban:** *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa I dhe II)*, Prishtinë, 1980.
- Demiraj, Shaban:** *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.
- Demiraj, Shaban:** *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
- Demiri, Sevdail:** *Flakadani i rezistencës karadakiane*, Kumanovë, 2006.
- Dizdari, Tahir:** *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- Dodi, Anastas:** *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970.
- Dodi, Anastas - Gjinari, Jorgji:** *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, Fonetika (maket)*, Tiranë, 1983.
- Dodi, Anastas:** *Fusha e shpërndarjes së zanoreve dhe problemet e normës së shqiptimit*, Gjuha jonë nr. 1- 4, Tiranë, 1986.
- Dodi, Anastas:** *Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore*,

- Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000.
- Dodi, Anastas:** *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1990.
- Dodi, Anastas:** *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, f. 759-765.
- Dodi, Anastas:** *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- Durmishi, Izmit:** *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar, 2008.
- Elsie, Robert:** *Dialektet e gjuhës shqipe*, www.albanianlanguage.net
- Filipoviq, dr. Rudolf:** *Suvremena lingvistika nr. 1*, Zagreb, 1966; *Suvremena lingvistika nr. 3*, Zagreb, 1964.
- Floqi, Spiro:** *Pyetësor për mbledhjen e materialit dialektor të gjuhës shqipe*, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971, f. 371- 447.
- Frashëri, Kristo:** *E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit*, gazeta “Shqip”, 9-10. 12. 2009.
- Gokaj, Nuri:** *Baza të Gjuhësisë së Përgjithshme*, Shkodër, 1997.
- Gosturani, Xheladin:** *E folmja e Hasit*, Dialektologjia shqiptare III, Tiranë, 1975.
- Gosturani, Xheladin:** *E folmja e Rogamit*, Dialektologjia shqiptare VI, Tiranë, 1990.
- Guberina, Petar:** *Zvuk i pokret u jeziku*, Zagreb, 1967.
- Gjinari, Jorgji:** *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1976.
- Gjinari, Jorgji:** *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
- Gjinari, Jorgji:** *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1986.
- Gjinari, Jorgji:** *Dialektologjia shqiptare*, Prishtinë, 1970.
- Gjinari, Jorgji:** *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975.
- Gjinari, Jorgji:** *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1998.
- Gjinari, Jorgji - Shkurtaç, Gjovalin:** *Dialektologjia*, Tiranë, 1997 (ribotuar më 2000).
- Halimi, Mehmet:** *Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 353-375.
- Hamiti, Asllan:** *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Hamiti, Asllan:** *Veçoritë leksikore të të folmes së Karadakut të Shkupit*, Vjetari i Fakultetit Filologjik “Bllazhe Koneski” të Shkupit, libri 26, Shkup, 200, f. 435-448.
- Hamiti, Asllan:** *Maqedonizmat në të folmen e shqiptarëve të Shkupit*, Shqyrtime albanologjike 2, Shkup, 1996, f. 95-100.
- Hamiti, Asllan:** *Theksi në gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 7, Shkup, 2004, f. 25-46.
- Hamiti, Asllan:** *Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike*, Aktet, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Vëllimi I, nr. 1, 2008.
- Hamiti, Asllan:** *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84.
- Hamiti, Asllan:** *Tiparet fonetike e fonologjike të të folmes së Karadakut të Shkupit*, kumtesë e Takimit V Ndërkombëtar të Alb-shkencës, Tiranë, më 2-5. 09. 2010.
- Hamiti, Asllan:** *Vëzhgime për leksikon e Karadakut të Shkupit*, Seminari IV Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 12 - 14 tetor 2010, f. 41-55.
- Hamiti, Asllan:** *Gjendja dhe perspektiva e studimeve gjuhësore në Maqedoni*, kumtesë në

- Konferencën VII Shkencore Ndërkombëtare Gjuha, Letërsia dhe Kultura Shqiptare nga Pavarësia deri sot, Tetovë, 23. 11. 2012.
- Hamiti, Asllan:** *Disa dukuri morfonologjike në të folmet e gegërishtes*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 31/1, Prishtinë, 2012, f. 731-737.
- Hamiti, Asllan:** *Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë dhe planifikimi gjuhësor*, Konferenca e parë Albanologjike, Ohër, 23-27 shtator 2007, f. 339-346.
- Hamiti, Asllan:** *Mikrotoponimet dhe antroponimet e fshatit Goshincë*, Instituti Alb-Shkenca, Takimi VI Vjetor Ndërkombëtar, Prishtinë, 1-4 shtator 2011.
- Hamiti, Asllan:** *Sistemi i zanoreve në të folmen shqipe të Rekës së Epërme*, Konferenca Shkencore “Reka dhe Shqiptarët e Rekës së Epërme”, Gostivar, 14 dhjetor 2013.
- Hamiti, Asllan:** *Toponimia dhe mikrotoponimia shqiptare në Maqedoni - dëshmi e autoktonisë*, Sesioni shkencor Toponimia shqiptare në Maqedoni, ITShKSh, Shkup, 03. 06. 2013.
- Hamiti, Asllan:** *Ndërrime të përbashkëta fonetike në shqipe e në maqedonishte*, Vjetari i Fakultetit Filologjik “Bllazhe Koneski” të Shkupit, libri 32, I, Shkup, 2006, f. 311-323.
- Hamiti, Asllan:** *Prirja e defonologjizimit të zanoreve hundore në të folmet e gegërishtes*, Java e Shkencës në Kosovë 2014, Prishtinë, 13-16 maj 2014.
- Hamiti, Asllan:** *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011.
- Hamiti, Asllan - Qamili, Ajten:** *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare “Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.
- Hamiti, Asllan - Qamili, Ajten:** *Shtrirja e orientalizmeve në të folmet shqipe në Maqedoni*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Leksikografi Tahir Dizdari dhe turkologët për shqipen”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 31. 01. 2013, Shkodër.
- Hamiti, Asllan - Sopaj, Nehas:** *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello, Shkup, 2004.
- Haruni, Sefedin:** *E folmja e Gostivarit*, Tetovë, 1997.
- Haruni, Sejfedin:** *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.
- Hudson, R. A.:** *Sociolinguistika*, Kumanovë, 2007.
- Hysa, Enver:** *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 76-80.
- Idrizi, Xhemaludin:** *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.
- Ibrahimi, Mustafa:** *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Shkup, 2005.
- Ibrahimi, Mustafa:** *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Ibrahimi, Mustafa:** *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2010.
- Ismajli, Rexhep:** *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987.
- Kadriu, Zeqir:** *Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni*, Tetovë, 2002.
- Kelmendi, Hasan:** *Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turicevcit*,

- Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 453-478.
- Këshilli redaktues:** Shemsi Bardhi, Rahman Selmani, Xhelal Jusufi, Hazbi Lusjani, Sami Tusha, Idaete Sinani, Ismail Sinani, Rakip Doçi, Abaz Islami, Qerim Lita, *Bllaca mes dhembjes dhe krenarisë*, Logos-A, Shkup, 2004.
- Klosi, Ardian:** Artikull në faqen e internetit: <http://www.forumishqiptar.com>
- Lafe, Emil:** *Një analizë matematike të formimit të fjalëve shqipe prej rrokjeve*, në Studime filologjike 3, Tiranë, 1969.
- Lafe, Emil:** *E folmja e Nikaj-Mërturit*, Studime filologjike, 3, Tiranë, 1964.
- Lafe, Emil:** *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 10-21.
- Lyons, John:** *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Londër, 1968, Dituria, 2001.
- Lloshi, Xhevat:** *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- Марковиќ, Марјан:** *Дијалектологија на македонскиот јазик I*, Скопје, 2001.
- Malmberg, Bertil:** *Fonetika*, Sarajevo, 1974.
- Martine, Andre:** *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983.
- Memushaj, Rahmi:** *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989.
- Memushaj, Rami:** *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
- Memushaj, Rami:** *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti “Eqrem Çabej”, Tiranë, 2004, f. 233-244.
- Memushaj, Rami:** *Gjuhësia gjenerative*, Shblu, Tiranë, 2003.
- Memushaj, Rami:** *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2003.
- Memushaj, Rami:** *Standardi dhe Kostallari*, 25 nëntor 2012, në <http://www.shqiptarja.com>.
- Mërkuri, Nexhip:** *E folmja e Përmetit*, Vlorë, 2009.
- Minović, dr. Milivoje:** *Uvod u nauku o jeziku*, Sarajevo, 1985.
- Munishi, Shkumbin:** *Gjuha standarde shqipe dhe konvergjenca e gjuhës së folur*, në <http://linguasocio.blogspot.com>.
- Mulaku, Latif:** *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 2005.
- Mulaku, Latif - Bardhi, Mehdi:** *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275-325.
- Muljačić, dr. Žarko:** *Opća fonologija i fonologija suvremenoga talijanskog jezika*, Zagreb, 1972.
- Murati, Qemal:** *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Murati, Qemal:** *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985.
- Murati, Qemal:** *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike, (SShF) 14 – 1984, Prishtinë, 1985;
- Raka, Fadil:** *E folmja e qytezës së Kaçanikut*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Riza, Selman:** *Vepra 1*, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman:** *Vepra 2*, AShAK, Prishtinë, 1997.
- Riza, Selman:** *Vepra 3*, AShAK, Prishtinë, 2002.
- Riza, Selman:** *Vepra 4*, AShAK, Prishtinë, 2004.
- Настева - Оливера, Јашар:** *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик VIII, libri i 2-të, Shkup, 1957.

- Настева - Оливера, Јашар:** *Македонските калки од турскиот јазик*, Македонски јазик, XIII – XIV, Shkup, 1962/63.
- Ndreca, Mikel:** *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 1986.
- Nesimi, Remzi:** *E folmja e Dervenit*, Tetovë, 2008.
- Nesimi, Remzi:** *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.
- Nesimi, Remzi:** *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Nesimi, Remzi:** *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Osmani, Ismet:** *Ndërrimet morfonologjike në gegërishte*, Logos-A, Shkup, 2010.
- Osmani, Zihni:** *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996.
- Osmani, Zihni:** *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997.
- Pajaziti, Naser:** *E folmja e Opojës*, Prishtinë, 2005.
- Pajaziti, Naser:** *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008.
- Poloska, Agim:** *Pasuria leksikore në të folmen e Prespës*, Jehona, nr. 8, Shkup, 1984.
- Poloska, Agim:** *Vëzhgime mbi leksikon e kuzhinës në regjionin e Prespës*, Jehona, nr. 1, Shkup, 1987.
- Poloska, Agim:** *Interferenca gjuhësore e maqedonishtes dhe e shqipes dialektore (disertacion doktrate)*, Shkup, 1996.
- Poloska, Agim:** *Leksiku dialektor në regjionin e Prespës*, Asdreni, Shkup, 2003.
- Qamili, Ajten:** *Variantet shoqërore në të folmet e Strugës dhe ndikimi ndërgjuhësor te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, 2008.
- Qamili, Ajten:** *E folmja shqipe e Strugës (në kontekstin ballkanik)*, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, 2012.
- Qamili, Ajten:** *E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot*, “Java e Shkencës 2013”, Prishtinë, 14-18 maj 2013.
- Reçani, Feim:** *E folmja e rrethit të Gostivarit (punim magjistrature në dorëshkrim)*, Prishtinë, 1977.
- Reçani, Fehim:** *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.
- Rrokaj, Shezai:** *Roli i dialekteve në zgjerimin e standardit*, në <http://www.panorama.com.al>.
- Савицка, Ирена - Спасов, Људмил:** *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997.
- Selmani, Asllan:** *Gjeografia e Maqedonisë antike*, Kumanovë, 2000.
- Simeon, Rikard:** *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, Zagreb, 1969.
- Simeon, Rikard:** *Opća enciklopedija 5*, Zagreb, 1979.
- Skok, Petar:** *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- Sylejmani, Fadil:** *Dukuritë fonetike në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Dituria 1, Prishtinë, 1983.
- Sylejmani, Fadil:** *Vokalizmi në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Gjurmime albanologjike (SShF), 1985/14 dhe 1986/15, Prishtinë.
- Sylejmani, Fadil:** *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Shkurtaç, Gjovalin:** *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.

- Shkurtaç, Gjovalin:** *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, Dialektologjia shqiptare IV, IGjL, Tiranë, 1982, f. 144-278;
- Shkurtaç, Gjovalin:** *E folmja e Kastratit*, Studime filologjike 2, Tiranë, 1967.
- Shkurtaç, Gjovalin:** *E folmja e Kelmendit*, Dialektologjia shqiptare III, Tiranë, 1975.
- Topalli, Kolec:** *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.
- Topalli, Kolec:** *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.
- Topalli, Kolec:** *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.
- Topalli, Kolec:** *Bashkëtingëlloret dyfishe të gjuhës shqipe*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Tiranë, 2004, f. 265-277.
- Trubeckoi, N. S.:** *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985.
- Thomai, Jani:** *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2001.
- Thomai, Jani:** *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010.
- Ullman, S.:** *The Principles of Semantics*, Glasgow - Oxford, 1957.
- Видоески, Божо:** *Кумановскиот говор*, Скопје, 1962.
- Veselaj, Nuhi:** *Paskajorja - çështje e shqipes standarde*, Prishtinë, 2000.
- Voronina, Irina - Domosileckaja, Marina - Sharapova, Lubov:** *E folmja e shqiptarëve të Ukrainës*, Shkup, 1996
- Xhaferi, Hajredin:** *Leksione dhe ushtrime për fonetikën*, Elbasan, 2008.
- Ylli, Xhelal:** *Rreth inventarit absolut dhe relativ të huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1995, f. 183-188.
- Ymeri, Haki:** *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Ymeri, Haki:** *Për një sistem grafik më ekonomik të gjuhës së sotme shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.
- Ymeri, Haki:** *Veçoritë morfologjike të së folmes së Kumanovës me rrethinë*, Jehona 1-2, Shkup, 1982.
- Ymeri, Haki:** *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore (shikuar sipas së folmes shqipe të Markova-Rekës)*, Jehona 3, Shkup, 1994, f. 79-87.
- Ymeri, Haki:** *Një përkitje ndërgjuhësore ballkanike në fushë të prozadisë*, Shqyrtime albanologjike, Shkup, 1997, f. 43-50.
- <http://gjuhashqipe.com/albanologji>
- http://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_shqipe).
- <http://www.phoenixhollo.com>
- <http://www.youtube.com/>
- <http://www.dialogplus.ch>: Zara ende frymon arbërisht nga Dashnim Hebibi.
- <http://www.youtube.com>: Arbëreshët e Zares (pjesa 1, 2, 3).
- <http://www.youtube.com>: Mbijetesa e shqiptarëve të Ukrainës, pjesa 1, 2, 3, 4, 5.
- <http://www.youtube.com>: Molla e kuqe Dokumentar (pjesa 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9).
- <http://www.youtube.com>: Me Shqiptaret e Turqisë (2) 4/1, 4/2, 4/3, 4/4.
- <http://www.youtube.com>: Dëshmi e gjallë për shqiptarët ortodoks të Rekës, Dëshmi e gjallë për shqiptarët ortodoksë të Rekës, Branko Manolovski, realizuar nga Driton Zenku.